

PASQYRA E LËNDËS

MIRËNJOHJE	9
DY FJALË PËR BOTIMIN	11
HYRJE E SHKURTËR	13
GJUHËT NË KONTAKT	15
NDIKIMI I ANGLISHTES NË GJUHËN SHQIPE	
NË BALLKAN	21
FJALËT ANGLEZE NË GJUHËN SHQIPE – ANALIZË	
FONOLOGJIKE	21
1. Problemi dhe detyra e punimit.....	21
2. Korpusi.....	28
3. Metoda e punës.....	29
4. KRAHASIMI I SISTEMEVE FONOLOGJIKE	
MIDIS ANGLISHTES DHE SHQIPES	33
4.1 Krahasime të përgjithshme gjuhësore.....	33
4.2 Theksi.....	33
4.3 Vendi dhe mënyra e artikulimit të fonemave.....	34
4.4 Gjatësia dhe cilësia e fonemave.....	34
(1) Bashkëtingëlloret.....	34
(2) Okluzivet.....	34
(3) Nazalet.....	35
(4) Zanoret.....	35
4.5 Përfundim.....	36
5. ANALIZA FONEMIKE E HUAZIMEVE ANGLEZE	
NË GJUHËN SHQIPE	37
5.1 Mbi analizën në përgjithësi.....	37
5.2 Zëvendësimi.....	38
(a) Zëvendësimi i zanoreve të pastra.....	38
(b) Zëvendësimi i diftongjeve angleze.....	47
(c) Zëvendësimi i bashkëtingëlloreve.....	51
(ç) Përfundim i zëvendësimit të tingujve.....	58
(d) Zëvendësimi i theksit.....	59

NDIKIMI I HUAZIMEVE ANGLEZE NË TOGJET BASHKËTINGËLLORE TË GJUHËS SHQIPE	63
ÇËSHTJE TË PËRSHTATJES GRAMATIKORE TË ANGLIZMAVE NË GJUHËN SHQIPE.....	77
1. Hyrje.....	77
2. Përcaktimi i gjinisë së emrit të huazuar	77
3. Trajtat e mbiemrave të huazuar të papërshtatur.....	80
4. Huazimi i emrave në trajtë të shumësit	81
5. Përfundim.....	81
DISA EMRA TË ANGLISHTES NË GJUHËN SHQIPE	83
SINTAGMA EMËRORE TË GJUHËS SHQIPE TË NDËRTUARA ME NDIKIM TË ANGLISHTES	89
HUAZIME TË VEÇANTA NGA ANGLISHTJA	93
TERMA ME PREJARDHJE NGA ANGLISHTJA	105
SHKRIMI I DISA HUAZIMEVE ANGLEZE.....	113
SI TË SHKRUHEN EMRAT ANGLEZË NË GJUHËN SHQIPE	117
SHQIPJA DHE HUAZIMET ANGLEZE SOT	123
1. Përmbledhje hyrëse.....	123
2. Shqipja në përgjithësi	123
3. Huazimet në shqipe	126
4. Përfundim	130
5. Vlerësime dhe propozime për disa huazime angleze të reja	131
6. Disa anglizma të panevojshëm	134
LISTA E HUAZIMEVE ANGLEZE NË GJUHËN SHQIPE	137
NDIKIMI I ANGLISHTES NË SHQIPEN E AMERIKËS.....	149
SHQIPTARËT NË AMERIKË DHE BRENKA PËR GJUHËN SHQIPE	149
1. Fillimi në vendin e ri	149
2. Jeta në konakë.....	152
3. Shoqëritë shqiptare	154
4. Shtypi shqip në Amerikë	157
5. Gazetat dhe revistat	159

6. Organizata <i>Vatra</i>	165
7. Edhe disa peripeci dhe suksese.....	169
8. Këndvështrim gjuhësor.....	170
9. Interferenca gjuhësore.....	176
10. Bilinguizmi.....	181
11. Gjendja e gjuhës.....	184
12. Ruajtja e gjuhës.....	189

INTERFERENCA FONEMIKE E ANGLISHTES NË

SHQIPEN E AMERIKËS	193
1. Në përgjithësi.....	193
2. Zanoret.....	196
3. Zëvendësimi i fonemave zanore.....	199
4. Zëvendësimi i fonemave bashkëtingëllore.....	201
5. Palatalizimi.....	205
6. Metateza.....	205
7. Tinguj epentetikë.....	205
8. Shurdhimi i bashkëtingëlloreve fundore të zëshme.....	206
9. Theksi në huazimet angleze.....	207
10. Përfundim.....	207

INTERFERENCA LEKSIKORE E ANGLISHTES NË

SHQIPEN E AMERIKËS	209
1. Hyrja.....	209
2. Huazimi.....	209
3. Kompozita dhe fjalë të përbëra.....	216
4. Fjalë të përbëra hibride.....	221
5. Kalke.....	224
5.1 Kalke të pastra.....	225
5.2 Kalke të përiferëta.....	228
5.3 Kalke të zgjeruara.....	229
6. Huazime semantike.....	233
7. Transfer kodi.....	234
8. Emra të njerëzve.....	241
8.1 Hibridizim i emrit.....	247
9. Përfundim i shkurtër.....	248

INTERFERENCA MORFOLOGJIKE E ANGLISHTES NË

SHQIPEN E AMERIKËS	249
1. Në përgjithësi.....	249
2. Emri.....	250

2.1 Gjinia	250
2.2 Numri i emrit	257
2.3 Rasa e emrit	262
3. Mbiemri	268
3.1 Gjinia e mbiemrit	269
3.2 Numri i mbiemrit	270
3.3 Përshtatja e mbiemrit në rasë	270
3.4 Krahasimi i mbiemrit	271
4. Folja	274
5. Përemri	280
5.1 Përemrat vetorë	280
5.2 Përemrat pronorë	280
6. Numërori	280
7. Ndajfolja	280

INTERFERENCA SINTAKSORE E ANGLISHTES NË

SHQIPEN E AMERIKËS	283
1. Rendi i fjalëve	283
2. Diateza pësore	288
3. Kundrina	294
4. Fjalitë e theksuara	297
5. Përdorimi i nyjave	298
6. Përdorimi i parafjalëve	301
7. Përdorimi i plotësorit kundrinor	303
8. Përdorimi i mënyrës dëshirore	303
9. Përdorimi i mënyrës habitore	304
10. Trajta alternative: <u>po ose jo</u>	304
11. Zhdukja e fjalëve funksionale	305
12. Mohimi	305

DREJTSHKRIMI I HUAZIMEVE ANGLEZE NË SHQIPEN E AMERIKËS

309

PËRFUNDIM

319

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

325

LITERATURA E KONSULTUAR

326

TREGUESI I EMRAVE

333

MIRËNJOHJE

Mirënjohje të veçantë ndjej nevojë t'i shpreh, pas vdekjes, akademikut Rudolf Filipović nga Zagrebi, për përkrahjen morale, ndihmën dhe stimulimin profesional e shkencor, që më ka ofruar si magjistrant dhe doktorant i tij.

Një mirënjohje të ngrohtë i shpreh bashkëshortes sime për durimin dhe mirëkuptimin që ka pasur gjatë gjithë punës sime profesionale e shkencore, duke më përkrahur e stimuluar dhe duke ma lehtësuar punën me angazhimin e saj shtesë duke marrë mbi vete edhe punët e mia si zot shtëpie.

Mirënjohje kolegjiale i shpreh edhe akademikut Rexhep Ismajli për inkurajimin, mbështetjen dhe këshillat e dhëna përkitazi me botimin e këtij libri.

U jam mirënjohës edhe redaktorëve (disave pas vdekjes) të revistave, buletineve dhe gazetave ku më janë botuar artikujt, analizat dhe shqyrtimet shkencore lidhur me temën bosht të përfshirë në këtë libër.

Vesel Nuhiu

DY FJALË PËR BOTIMIN

Libri që po sjellim para lexuesit merret tërësisht dhe vetëm me “Ndikimin e gjuhës angleze në gjuhën shqipe”. Ai paraqet rezultatet e hulumtimeve të autorit profesor dr. Vesel Nuhiu në këtë fushë. Dy studimet që përbëjnë boshtin e librit janë pjesë të një tërësie relativisht kompakte dhe janë bërë në një kohë të caktuar dhe me një metodologji të njëjtë. Autori e ka ndjekur rrugën e mentorit të tij akademik Rudolf Filipović nga Universiteti i Zagrebit, studiues i njohur në fushën e kontakteve të gjuhëve dhe konkretisht në studimin e elementit anglez në gjuhët e Europës. Horizonti teorik i këtyre studimeve është ai që tashmë njihet si klasik në fushat e bilinguizmit dhe të sociolinguistikës të Uriel Weinreichut dhe të Einar Haugenit.

Këtu përfshihen shqyrtime të ndryshme për ndikimet e gjuhës angleze në shqipen e Ballkanit, në një anë, dhe ndikimet e gjuhës angleze në shqipen e shqiptarëve të Amerikës në anën tjetër. Kohësisht ato kanë të bëjnë kryesisht me gjendjen para rreth tri dekadash, kur trysnia e anglicizmave në shqipen nuk e kishte arritur ende intensitetin që ka sot dhe me procese që tashmë kanë një histori dhe mund të vlerësohen edhe nga distanca. Rezultatet dhe përvoja e këtyre studimeve mund të jenë të dobishme për studime të reja në këtë fushë të përqendruara në gjendjen shumë dinamike aktuale.

Autori merret me tërësinë e ndikimeve të gjuhës angleze në shqipen në situata dhe rrethana të ndryshme: në Ballkan, ku shqipja përdoret në funksione institucionale shtetërore e kulturore të organizuara dhe në Amerikë, ku mërgata i është shtruar procesit intensiv të akulturimit. Për proceset e huazimit dhe të ndikimit janë këto dy situata krejt të ndryshme. Kohësisht këto studime kanë të bëjnë me vitet '80 e më herët të shekullit të kaluar dhe për sa i përket pjesës ballkanike merren kryesisht me aspektet e ndikimeve kulturore, ndërsa sa i përket arealit amerikan detyrimisht duhet të merren me gjuhën e folur dhe me aspektet e ndryshme sociolinguistike.

Duke pasur parasysh se në rrethanat e globalizmit shqipja e sotme i ka zgjeruar dhe intensifikuar shumë kontaktet me anglishten, tashmë gjuhë e botës, studimet e kësaj fushe paraqesin interes edhe praktik sa i përket kujdesit për përdorimet e shqipes, për mbrojtjen e saj nga ndikimet ekseseve dhe për zhvillimet në frymën e kërkesave të kohës. Për këto

aspekte të studimit mund të ketë interes më të gjerë. Për ndonjë aspekt interes mund të kenë edhe veprimtari si ato të Këshillit Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe. Seksioni e pa të arsyeshme që t'i botonte të gjitha në një vëllim.

Autori dr. Vesel Nuhii është profesor i pensionuar i gjuhës angleze i Universitetit të Prishtinës që mbi 40 vjet është marrë me mësimdhënien e gjuhës angleze, me studimin e saj dhe të përdorimit të saj në Kosovë.

Urojmë që ky botim të jetë dhe nxitje për shqyrtime të mëtejme të kontakteve gjithnjë në rritje të shqipes me anglishten në kuadër të proceseve globale në tërësi dhe të situatës krejtësisht të veçantë në Kosovë, ku funksionet e anglishtes në dekadat e fundit janë të një shkalle më të gjerë dhe cilësisht më të lartë se në hapësirat e tjera ku flitet shqipja.

Rexhep Ismajli

HYRJE E SHKURTËR

Për huazimin e elementeve gjuhësore të huaja në gjuhë të ndryshme është shkruar nga shumë autorë dhe në shumë gjuhë të ndryshme gjithandej nëpër botë. Janë hasur dhe paraqitur përvoja të ndryshme të të huazuarit të elementeve gjuhësore dhe janë dhënë shumë mënyra, rrethana e shkaqe të të huazuarit gjuhësor. Analiza janë bërë sidomos për huazimin e njësive leksikore dhe të shprehjeve të huaja në gjuhë të ndryshme. Janë shpjeguar edhe faktorë të shumtë sociolinguistikë që ndikojnë në të huazuarit gjuhësor. Të huazuarit është dukuri gjuhësore shumë e hershme, thuaja që nga ekzistenca e gjuhës në marrëdhënie me gjuhë të tjera. Natyrisht, nga materiali i gjerë që ekziston për huazimin gjuhësor dalin edhe përvoja të ndryshme që dallojnë në mes tyre. Prandaj ka nevojë që kjo dukuri të studiohet dhe të parashtrohet vazhdimisht, sepse ajo nuk pushon së ekzistuari, përveç kur gjuha ndikuese pushon së ekzistuari ose së funksionuari, si b.f. latinishtja, ose kur ndryshohen rrethanat e raporteve midis gjuhës ndikuese dhe gjuhës së ndikuar, si b.f. midis turqishtes me shqipes. Rëndom ndikon gjuha që ka ndonjë prestigj më të lartë në gjuhën që ka prestigj më të ulët brenda një komuniteti, shoqërie ose rajoni të caktuar. Qendër e shqyrtimit në këtë botim është paraqitja e huazimeve angleze në gjuhën shqipe.

Meqë gjuha shqipe ka prestigj më të ulët se, f.v. anglishtja, kjo e dyta ndikon në shqipen e jo shqipja në anglishten. Kur bëhet fjalë për anglishten, dihet se ajo tani thuaja është bërë gjuhë globale në botë, prandaj dhe ndikimi i saj mbi thujtjse të gjitha gjuhët europiane, por edhe më gjerësisht, është i dukshëm. Dhe kjo dukuri vjen gjithnjë duke marrë përmasa më të mëdha. Në këtë vepër del në shesh se ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe, para gjysmë shekulli ishte jashtëzakonisht i ulët kur të krahasohet me gjendjen e kësaj dukurie sot kur po botohet ky kontribut.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj dukurie, del nevoja për studime të vazhdueshme të ndikimeve gjuhësore. Së këndejmi, del i domosdoshëm studimi i përhershëm i ndikimit gjuhësor dhe analiza e faktorëve që ndikojnë në të, qofshin ata shoqërorë ose gjuhësorë.

Në këtë libër përmblihen kontributet e botuara, po edhe ndonjë i pabotuar, por i hartuar në rrjedhë të kohës sa jemi marrë me çështjet e huazimeve angleze në gjuhën shqipe. Kontributet këtu ndahen në dy pjesë: në ato që kanë të bëjnë me studimet e huazimeve angleze në gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur në Kosovë, në Shqipëri e gjetiu në Ballkan, dhe në ato që kanë të bëjnë me ndikimin e anglishtes në gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur në SHBA.

Jemi të vetëdijshëm se këto kontribute (përveç njërit të grupit të parë) kanë të bëjnë me gjendjen e ndikimeve të anglizmave në gjuhën shqipe në kohë të caktuar, deri në gjysmën e decenies së tetë të shekullit të kaluar. Dhe kjo pikërisht dëshmon se studime të tilla mund dhe duhet të bëhen edhe tani dhe në të ardhmen duke i përcjellë dukuritë e reja dhe, pa dyshim, fjalët dhe shprehjet e tjera, por pa lënë anash edhe ndikimet gramatikore në rrafshin morfologjik dhe sintaksor të shqipes, të cilat rëndom lënë pasojë më të rënda në gjuhën marrëse.

Nga vetë fakti se këtu diskutohen disa huazime, të cilat me parqitjen e tyre dukeshin të paqëlluara dhe të çuditshme, dhe në fillim propozohet që të hiqeshin nga përdorimi, me kohë përdorimi i tyre është bërë gjithnjë më i dendur dhe tani ato duken fjalë a shprehje shumë të rëndomta, saqë duket naive ideja që të hiqen nga fjalori i shqipes, flet për peshën e çështjes.

Prishtinë, tetor 2012

Autori

GJUHËT NË KONTAKT

Qëndrimi ndaj huazimit gjuhësor dhe terminologjia e tij

Huazimet gjuhësore e përcjellin tërë historinë njerëzore, sepse njerëzit gjithmonë kanë qenë në kontakt me njëri-tjetrin në rrethana e kushte të ndryshme. Në shekullin XVIII leksikografët, duke mbledhur materialin për fjalorë, hasën në problemin e huazimeve dhe nuk dinin si t'i klasifikonin fjalët, që nuk i përkisnin leksikut të një gjuhe tjetër.

Në punimet e gjuhëtarëve të shekullit XIX, si të Rasmus Raskut,¹ Franc Boppit dhe Jakob Grimmit, paraqiten pikëpamje e mendime të ndryshme lidhur me huazimet dhe përzierjen e gjuhëve. Ata konfirmonin se nuk kishte përzierje, meqë fjalët mund të huazohen, por jo edhe të ndryshojnë strukturën e gjuhës me ndikimet e gjuhës tjetër. August Schleicheri² madje pohonte se nuk kishte gjuhë të përzier. Këtë mendim e përkrahte edhe Max Mulleri, gjuhëtar i njohur i Oksfordit.

Përkundër këtyre qëndrimeve, gjuhëtari amerikan W. D. Whitney³ mendonte se mund të huazoheshin jo vetëm fjalët, por edhe e tërë gjuha e një populli mund të bartej te një popull tjetër. Duke studiuar anglishten, ky linguist hetoi se kjo gjuhë kishte gati gjysmën e elementeve të gjuhëve jogjermane, por megjithatë ato nuk kishin pasur ndikim në zgjedhimin apo lakimin e saj, ku këto kategori gramatikore i kishte dobësuar bukur shumë.

Shumë më larg në çështjen e studimit të përzierjes dhe të ndryshimit të gjuhëve kishte arritur Hugo Schuchardt.⁴ Përzierja e gjuhëve për të nuk ishte gjë e rastit – por rregull. Schuchardt mendonte se nuk kishte gjuhë që ishte plotësisht e papërzier.

Punën e Schuhardtit në këtë lëmë e kishte çmuar shumë keltologu Ernst Windisch.⁵ Ky, si dhe Schuhardt, nisej nga fakti se përzierja e gjuhëve mbështetej, pak a shumë, në dygjuhësinë e zhvilluar. Windischi konstatonte

¹ Rasmus K. Rask, *Undersogelse om det gamle nordiske eller islandske sprogs oprindelse* (Hulumtime të prejardhjes së gjuhës së vjetër norvegjeze ose islandeze), 1818.

² August Schleicher, *Lingustische Untersuchungen*, fl. II, Bonn, 1850.

³ W. D. Whitney, *On Mixture in Language*, **Transactions of the American Philological Association**, fl. XII, ff. 5-26, Cambridge, 1881.

⁴ Hugo Schuchardt, *Slavo-Deutsches und Slavo-Italianisches*, Graz, 1884.

⁵ Ernst Windisch, *Zur Theorie der Mischsprachen und Lehnwörter*, fl. 49, 1897.

se “gjuha e huaj e mësuar nuk bëhet gjuhë e përzier, por gjuhë e vetë një populli, nën ndikimin e gjuhës tjetër, të huaj”.

Huazohen më së shumti emrat. Për të pasur ndikim në foljet, është i nevojshëm kontakti më intim në mes dy popujve. Windischi mendonte se moda ndikonte më së shumti për të depërtuar huazimet në një gjuhë. Ai arriti në përfundim se nuk ka gjuhë të kulturuar pa elemente të huaja.

Filipović⁶ mendon se gjuhëtarët e kësaj kohe nuk kishin një pikë-vështrim të caktuar përkitazi me përzierjen e gjuhëve dhe huazimin gjuhësor. Derisa një palë e dallonin përzierjen nga huazimi i gjuhëve, të tjerët konsideronin se në mes këtyre dukurive nuk kishte kurrfarë dallimi. Prandaj Filipović thoshte se më kot kërkohet zgjidhja e vërtetë e kësaj çështjeje në veprat e gjuhëtarëve të asaj epoke.

Gjuhëtari Karl-Heinz Schönfelder⁷ theksonte se për gjuhën e përzier ishte biseduar që prej para dyqind vjetësh dhe ende nuk ishte gjetur përcaktim i përshtatshëm për të, përcaktim të cilin do ta përvetësonin të gjithë gjuhëtarët. Kjo rridhte ngase të gjithë gjuhëtarët nuk e kuptonin bërthamën e gjuhës njësoj, mendonte ai.

Gjuha e përzier, sipas Windischi, ishte ajo kur fjalët e huaja folësi i përdorte në vend të të vetave. Fjalët ekzistuese zëvendësohen me të huaja; ka shumë huazime të cilat përdoren edhe në fjalitë dhe shprehjet e fjalitë më të thjeshta; përveç huazimeve të emrave përdoren edhe foljet, madje edhe numërorët dhe format morfologjike.

Pra, siç shihet, të gjithë gjuhëtarët e kësaj epoke përzierjen e gjuhëve e shihnin në përmbajtjen e leksikut.

Shönfelderi dallonte nga këta. Ai thoshte se përzierja e gjuhëve bëhej me ndikim të njëanshëm ose bilateral të dy apo të më shumë gjuhëve. Ky ndikim shprehej jo vetëm në leksik, por edhe në përmbajtjet fonetike, morfologjike dhe sintaksore. Nëse ndikimi kishte të bënte me fjalën, sipas Shönfelderi, atëherë ishte fjala vetëm për huazime.

Në gjysmën e dytë të shekullit 19, me çështjet e gjuhëve vijuan të merreshin disa gjuhëtarë eminentë. Në mes të tjerëve, dallohej Hermann Paul⁸ me veprën standarde Parimet e teorisë gjuhësore. Ai mendonte se përzierja ishte shumë e rëndësishme për ekzistencën e gjuhëve. Sfera më e përshtatshme për përzierjen e gjuhëve ishte kufiri në mes të dy rajoneve të gjuhëve të ndryshme, ku paraqitej bilinguizmi. Nëse njëra nga dy gjuhët kishte prestigj më të madh,

⁶ R. Filipović, 1971.

⁷ Karl-Heinz Schönfelder, *Probleme der Wölker und Sprachmischung*, Halle, 1956.

⁸ H. Paul, 1937.

bilinguizmi shpinte në monolinguizëm, thoshte në mes të tjerash Pauli. Sipas tij, ndikimi i një gjuhe në tjetrën varet nga intensiteti i komunikimit ndërkombëtar, nga udhëtimet e njerëzve në vende të huaja, nga migrimet e grupeve të mëdha të popullsisë (kolonizimet) si dhe nga materiali i shkruar.

Duke përshkruar hyrjen e fjalëve të huaja në gjuhë, Hermann Pauli thoshte se fjalën e huaj e sillnin ata që e kishin mësuar gjuhën e huaj dhe ishin folës të gjuhës ku hynte fjala. Forma e fjalës modifikohet me zëvendësimin e tingujve të gjuhës së huaj me ata të gjuhës amtare. Fjalën e huaj pastaj e merrnin edhe ata që nuk e njihnin gjuhën prej nga kishte ardhur. Fjalën e huaj, thotë Pauli, së pari e përdor një rreth i kufizuar i folësve, të cilët janë të lidhur me territor ose me pikëpamje kulturore të njëjta.

Meqë tingujt e dy gjuhëve kurrë nuk përputhen, tingujt e fjalës së huaj zëvendësohen me ata më të afërmit të gjuhës së dytë. Përshtatja fonologjike më këtë rast bëhet nevojë. Kur fjala e huaj përdoret më gjatë, ajo merr edhe theksin e gjuhës marrëse. Ndonjëherë mund të ndryshojë statusi i fjalës në gjuhën marrëse, por ai mund të ndryshojë edhe në gjuhën dhënëse, thekson Pauli. E njëjta fjalë mund të huazohet disa herë në periudha kohore të ndryshme, e më këtë rast ajo mund të ketë disa forma e kuptime.

Në veprën *Gjuhësia historike dhe gjuhësia e përgjithshme*, Antoine Meillet⁹ merret me çështjet e përzierjes së popujve dhe të gjuhëve. Ai është kundër termit *gjuhë të përziera*. Kjo shprehje është e papërshtatshme, thotë ai, sepse kështu mund të mendohet se një gjuhë e ngjashme mund të dalë si përzierje e dy gjuhëve, që vihen në kushte të njëjta.

Meje pranon se një gjuhë mund të marrë elemente të një gjuhe tjetër, kurse huazimin e fjalëve e quan dukuri të natyrshme. Çdo gjuhë ka strukturën e vet, dhe folësi biling, që ka dy zgjidhje gjuhësore, nuk i përzien të dyja gjuhët. Meillet vjen në përfundim se huazohen kryesisht elemente leksikore dhe thujt nuk ka gjuhë pa huazime.

Me çështjen e huazimeve gjuhësore janë marrë edhe Edward Sapir,¹⁰ Leonard Bloomfield¹¹ dhe Einar Haugeni.¹²

Mirëpo, gjuhëtarët që veçanërisht rrahin çështjet e gjuhëve në kontakt dhe huazimet gjuhësore, i theksojnë tri elemente themelore. Uriel Weinreich¹³ i thekson ato në veprën e tij *Gjuhët në kontakt*. Një: gjuhët janë në kontakt kur i njëjti folës i përdor dy ose më shumë gjuhë sipas nevojës; dy: folësi që i

⁹ Antoine Meillet, *Linguistique historique et linguistique générale*. Paris, 1921 dhe 1936.

¹⁰ E. Sapir, 1921.

¹¹ L. Bloomfield, 1933.

¹² Einar Haugen, *Language*, New York, 1953

¹³ U. Weinreich, 1953.

përdor reciprokisht dy gjuhë, quhet *biling*, ndërsa kjo dukuri quhet *bilinguizëm*; tre, pasojat e bilinguizmit quhen *interferencë*.

Einar Huageni¹⁴ thotë se për ta kuptuar mirë bilinguizmin duhet ditur mirë shumë rrethana të tjera, si ato gjeografike dhe etnografike, pastaj ato sociologjike dhe juridike të folësve bilingë.

Weinreichu ka vërtetuar se studimi psikologjik i folësve bilingë është çështja më e rëndësishme për analizimin e dukurisë së bilinguizmit.

Në procesin e interferencës janë disa karakteristika të folësve bilingë, e që nuk janë studiuar akoma sa duhet, si b.f., aftësia për t'u përvetësuar gjuha e huaj, mjeshtëria për të kaluar nga njëra gjuhë në tjetrën, koha kur mësohet gjuha e dytë, si dhe motivi për të përdorur gjuhën tjetër. Aftësia për të mësuar gjuhën e huaj është çështje individuale. Ndërsa bilinguizmi ndihmon për ta mësuar më shpejt gjuhën e tretë, meqë folësit bilingë tashmë kanë më shumë përvojë në këtë punë, thotë Weinreich.

André Martinet, në parathënien e librit të Weinreichut "Gjuhët në kontakt", thekson se, përveç të tjerash, për të mundur të studiohen shembujt bashkëkohës të bilinguizmit, duhet të sqarohen edhe shumë probleme të tjera që lidhen drejtpërdrejt me bilinguizmin.

Pra, siç shihet, ndonëse është punuar shumë në këtë lëmë dhe ende punohet – shumë gjëra ende nuk kanë bërë zgjidhje fatlume. Kështu qëndron çështja edhe me terminologjinë. Siç u pa më sipër, në shekullin e 19-të përdorej termi gjuhët e përziera. Ky term u hodh poshtë më vonë, meqë fjala 'përzierje' dukej e papërshtatshme. Filloi të përdorej termi huazim gjuhësor, dhe ai u përdor shumë kohë. Fjalën huazim e përdorte edhe Sapiri në veprën e tij Gjuha. Mënyra më e thjeshtë e ndikimit të një gjuhe në tjetrën, është huazimi i fjalëve, thoshte ai. Sapiri e krijoi edhe termin huazim kulturor, dhe thoshte se me këtë lloj huazimi në gjuhë silleshin edhe fjalët që kishin të bënin me atë valë kulturore.

Bloomfieldi, në veprën e tij po ashtu Gjuha, bënte fjalë në tre kapitujt e saj për huazimin e fjalëve. Huazimin gjuhësor ai e përcaktonte si marrje të elementeve gjuhësore, e cila dallonte nga ato tradicionale. Ai dallonte dy tipa huazimesh:

- *huazimin dialektor*, i cili bëhej po nga ajo trevë (nga një dialekt në tjetrin) dhe
- *huazimin kulturor*, kur elementet e huazuara vinin nga një gjuhë tjetër, e largët.

¹⁴ André Martinet, *Eléments de linguistique générale*, Paris, 1961.

Sipas Bloomfieldit, fjala huazohej me *difuzion kulturor*, që domethënë bartja e gjësendeve dhe e zakoneve dhe dokeve nga një bashkësi në tjetrën. Me gjësendet prej njërit popull në tjetrin kalojnë edhe fjalët që i emërojnë ato gjësende.

Filipovići cek se termi *huazim* është një metaforë, e cila nuk është mjaft e saktë, prandaj në gjuhësinë e re tentohet të zëvendësohet me termat antropologjike *difuzion* dhe *akulturacion*.

Shkolla e Pragës përdorte termin *interferencë*, ndërsa Weinrichu e aplikoi atë në literaturën gjuhësore amerikane. Mirëpo, Haugeni mendon se as ky term nuk mund të mbulojë sferën e akulturimit. Nga ana tjetër, Weinrichu thoshte se termi në fjalë mund të përdorej për marrëdhënien në mes të strukturave gjuhësore koekzistente të folësve bilingjë. Mirëpo, posa një element nga gjuha A të merret në gjuhën B, kjo nuk është më interferencë, por *integrimit*.

Në veprën e tij *Elementet e gjuhësisë së përgjithshme*, Martinet, në një kapitull, cek edhe çështjen e gjuhëve në kontakt. Jeta e njeriut në vend të huaj dhe mësimi i gjuhës së huaj janë dy situata ku hasen folësit bilingjë ose multilingjë. Ai thekson se njëra nga dy gjuhët, në situata të ndryshme, përdoret më lehtë e më shpesh se tjetra, prandaj duhet të ekzistojnë rrethana të veçanta për të ekzistuar të dy gjuhët në të njëjtin nivel. Martinet i quan monoglotë ose unilingjë ata që përdorin vetëm një strukturë fonologjike, vetëm një morfologji e sintaksë, madje dhe një fjalor. Bilingjët mund të përdorin dy ose më shumë kode gjuhësore. Nëse përdorin më shumë se dy kode, ata quhen multilingjë.

Sa i përket interferencës, ky gjuhëtar francez thekson se ajo ekziston posa dikush të përdorë dy gjuhë. Ai konkludon se folësi biling bart nga njëra gjuhë në tjetrën vetëm *monemat*, të cilat nga forma janë të kufizuara mirë.

B. Havránek¹⁵ mendon se termi kontakt gjuhësisht nuk shpjegon asgjë, sepse nga kjo fjalë nuk dimë ç'është rezultati. Rruga që shpie në kontakt është e ndryshme: një gjuhë mund të ndikojë në tjetrën, gjuhët mund të ndikojnë njëra mbi tjetrën, një grup gjuhësh mund të ketë zhvillim konvergjent ose mund të paraqitet edhe substrati gjuhësor. Ky gjuhëtar nuk e pranon bilinguizmin në kuptimin e gjerë të fjalës. Një gjuhë mund të ndikojë mbi tjetrën kur të njihet shumë mirë gjuha tjetër, por bilinguizmi ekziston vetëm kur në një kolektiv të ekzistojnë dy struktura gramatikore dhe të përdorin fondin e fjalëve të atyre dy gjuhëve.

¹⁵ B. Havránek, *Problematika mešanja jezika*, Zadarska revija, nr. XIII, 1964.

Havráneku thotë se në Ballkan bilinguizmi bullgaro-grek, shqiptaro-sllav, rumuno-bullgar etj., ka ekzistuar vetëm në rrethet tregtare dhe është vështirë të thuhet se janë bilinguizma të plota.

Sa i përket ndikimit të gjuhës latine në gjuhët europiane, Havráneku mendon se ai ishte ndikim i njëanshëm. Për disa dukuri në gjuhët ballkanike ai propozon termin *zhvillim konvergjent*, që domethënë zhvillim i përbashkët i gjuhëve. Në këtë zhvillim të përbashkët pësojnë morfologjia e ndërlikuar flektive dhe tipi gramatikor sintetik. Gjuhën që merr elemente të gjuhës tjetër Havráneku e quan aktive, ndërsa gjuhën që jep e quan pasive.

Në fund duam të cekim se Kosova dhe Maqedonia janë treva shumë tipike dhe të përshtatshme për këtë lëmë studimi. Meqë në një territor, në rrethana dhe kushte të ngjashme jetojnë shumë kombe, është evident fakti i ekzistimit të huazimeve, kontakteve dhe ndikimeve gjuhësore në mënyrë reciproke në mes gjuhëve të ndryshme. Ekzistojnë ndikime të të gjitha anëve, të serbishtes, përkatësisht të maqedonishtes në gjuhën shqipe, të turqishtes në gjuhën shqipe, serbe dhe maqedonase (si pasojë e sundimit osman) si dhe ndikimi i shqipes në serbishte, turqishte dhe maqedonishte, sidomos shikuar në periudha të gjata. Në disa periudha mësimi i gjuhës tjetër ishte sanksionuar me ligj për zbatimin e barazisë gjuhësore. Kjo normë zbatohet plotësisht nga nxënësit shqiptarë në Kosovë dhe në Maqedoni. Por, ndonëse ekzistonte norma ligjore, kjo nuk zbatohet plotësisht dhe me vullnet nga nxënësit serbë e as maqedonas për të mësuar gjuhën shqipe. Kjo pasonte ngase ndikimi gjuhësor varet shumë nga prestigji që ka një gjuhë, kulturë dhe shoqëri në ambientin e caktuar, por edhe nga pozita dhe qëndrimi politik i një shoqërie të caktuar.

Ky lëmë hulumtimi në trevën tonë nuk është lëruar sa duhet, prandaj ajo mund të jetë temë shumë interesante dhe tërheqëse për teza magjistraturash dhe disertacione doktoratash për dashamirët e gjuhës dhe për gjuhëtarët tanë të rinj, që nuk kanë komplekse shoqërore.

NDIKIMI I ANGLISHTES NË GJUHËN SHQIPE NË BALLKAN

FJALËT ANGLEZE NË GJUHËN SHQIPE – ANALIZË FONOLOGJIKE

1. Problemi dhe detyra e punimit

Nevoja për t'u kuptuar dhe për të komunikuar në mes njerëzve është aq e vjetër sa dhe gjinia njerëzore. Njerëzit gjithmonë kanë pasur kontakte midis tyre. Ata kanë këmbyer gjësende materiale e shpirtërore, kanë pushtuar territore të reja, kanë vizituar vende të huaja etj. Në atë mënyrë, ata kanë bartur prej njërit te tjetri përvojën dhe diturinë e tyre, dhe së bashku me to edhe një pjesë të gjuhës së tyre.

Shtimi intensiv i njohurive të njerëzve shkon gjithnjë edhe me zhvillimin dhe pasurimin e gjuhës. Mirëpo, atë zhvillim dhe atë pasurim ka mundësi ta vërejë vetëm syri i mprehtë i gjuhëtarit. Pasurohet si gjuha e folur dhe gjuha e shkruar. Kjo bëhet në dy mënyra kryesore: nga rezervat dhe mundësitë e brendshme të vetë gjuhës dhe me huazim gjuhësor nga gjuhët e tjera. Pasurimi nga potenciali i brendshëm gjuhësor bëhet me anë të prodhimit të pasur të fjalëve të reja, të cilat krijohen në mënyra të ndryshme me anë të procesit të fjalëformimit dhe duke u dhënë kuptime të reja fjalëve ekzistuese, si dhe me anë të të huazuarit nga gjuhë të tjera. Objekt i këtij studimi është pikërisht pasurimi gjuhësor me anë të të huazuarit.

Nëse u hidhet një vështrim shtypit dhe materialeve të tjera të shtypura në gjuhën shqipe, mund të vërehet prania e një numri të madh fjalësh të huaja. Numri i këtyre fjalëve vjen duke u shtuar gjithnjë më shumë. Gjuha shqipe ka marrë dhe gjithnjë merr fjalë të huaja, prandaj edhe fjalë angleze. Duke vërejtur këtë dukuri dhe të dhënë e cila gjithnjë ua tërheq vëmendjen atyre që merren me gjuhën shqipe, shtrohet nevoja për t'iu përveshur studimit të kësaj dukurie gjuhësore. Një formë të studimit të tillë paraqet edhe ky punim. Mirëpo, nuk mund të themi se ky është hapi i parë në këtë drejtim. Jemi të vetë-

dijshëm se me këtë studim vetëm i japim një kontribut modest vepërimtarisë shkencore të këtij lloji në gjuhën shqipe.

Para se të flitet hollësisht për ndikimin e elementeve gjuhësore angleze në gjuhën shqipe dhe për asimilimin e tyre, është mirë të thuhet diçka mbi të huazuarit gjuhësor si proces i përgjithshëm lingistik dhe mbi problemet që paraqiten me atë rast. Do të përpiqemi të shpjegojmë shkurtas se çka është të huazuarit gjuhësor, kush e bën atë, prej kujt bëhet dhe pse bëhet, kur, si dhe çka ndodh gjatë atij procesi në përgjithësi.

Linguisti gjerman Hugo Schuhardt pohonte se asnjë gjuhë nuk është plotësisht e pastër¹. Pra, nuk ka gjuhë kulturore pa elemente të huaja. Aq më pak gjuha shqipe ka mundësi të jetë përjashtim.

Leonard Bloomfieldi ka dalluar të huazuarit “e drejtpërdrejtë” (intim) dhe të huazuarit “e tërthorët” (kulturor)². Të huazuarit e drejtpërdrejtë, sipas tij, është kur dy gjuhë fliten në bashkësinë unike në pikëpamje topografike e politike. Të huazuarit kulturor bëhet në mes të dy kombeve, të cilat topografikisht dhe politikisht nuk janë një njësi. Në këtë rast kontakti nuk është i shpeshtë.

Rudolf Filipović konsideronte se ata që sillnin elemente gjuhësore në gjuhën marrëse ishin bilingët e gjuhës marrëse, dhe ata në përgjithësi janë intelektualët, udhëtarët, turistët, punëtorët që punojnë jashtë vendit etj.³ Mirëpo, duket se në kohën e sotme rruga më efektive e të huazuarit të fjalëve të huaja është nëpërmjet medimeve, siç janë radio, televizioni, gazetatat, revistat, librat etj.

Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë gjeografikisht mjaft larg Kosovës a Shqipërisë, ku jeton pjesa dërrmuese e bashkësisë shqipfolëse, prandaj nuk mund të flitet për ndikimin e drejtpërdrejtë, por më shumë për të huazuarit kulturor të elementeve gjuhësore angleze.

E vetnja gjë që shqipja dhe anglishtja e kanë të përbashkët është fakti se që të dyja i përkasin familjes gjuhësore indoevropiane. Lidhur me ngjashmëritë e gjuhëve, Weinreichu thotë se nga pikëpamja e bilinguizmit, origjina e ngjashmërisë midis gjuhëve nuk është relevante.⁴

Numri më i madh i fjalëve angleze në gjuhën shqipe ka depërtuar me anë të mediumit të shkrimit. Kjo është rrjedhojë e pozitës dhe e

¹ Hugo Schuhardt, *Slavo-Deutsches und Slavo-Italienisches*, Graz, 1884 (sipas: *Kontakti jezika u teoriji i praksi* nga Rudolf Filipović, Zagreb, f. 92, 1971).

² Leonard Bloomfield, *Language*, kapitujt 25 dhe 26, Londër, 1970.

³ R. Filipović, *Kontakti jezika u teoriji i praksi*, Zagreb, 1971, ff. 91-103.

⁴ Uriel Weinreich, *Languages in Contact*, Mouton, The Hague – Paris, 1953, p. 2.

marrëdhënieve të viseve ku flitet shqipja me vendet ku flitet anglishtja. Në të kaluarën me siguri nuk ka pasur shumë kontakte njerëzish, përmes të cilave anglishtja e folur do të mund të ndikonte dhe të depërtonte drejtpërsëdrejti në gjuhën shqipe. Është i njohur fakti se ortografia ushtron ndikim të madh në formën e shkrimit, prandaj edhe të shqiptimit të fjalës së huazuar. Ndërkohë ky ndikim i formës së shkruar është shumë evident në huazimet angleze të marra në gjuhën shqipe. Ndikimi i tillë veçanërisht shprehet në fjalët, të cilat në gjuhën shqipe kanë hyrë me anë të gazetave, të objekteve të importuara dhe të materialeve të tjera të shtypura.

Pse huazohen fjalët e huaja? Gjuhëtarët kanë konstatuar se huazimet në përgjithësi i plotësojnë vendet e zbrazëta në gjuhën marrëse. Kur një popull shpik a prodhon diçka të vlefshme që u shërben edhe popujve të tjerë, ata e marrin jo vetëm atë objekt dhe/ose material, por nëse në gjuhën e tyre nuk kanë emërtim për të – e marrin edhe emrin e atij gjësendi. Është e qartë, pra, se fjalët e tilla në përgjithësi janë në përdorim të gjerë dhe të shpeshtë në rajone të ndryshme, prandaj ato disi bëhen fjalë të përdorura ndërkombëtarisht – gjenden rëndom në fjalorët e shumë gjuhëve.

Ndonëse konsiderohet se si rajon më i përshtatshëm për të ndikuar në një gjuhë tjetër është kufiri midis vendeve ku fliten ato dy gjuhë, ose ku zhvillohet jeta e përbashkët e dy bashkësive gjuhësore në të njëjtin territor, ku mund të paraqitet edhe dukuria e bilinguizmit, në rastin e ndikimit të gjuhës angleze në gjuhën shqipe nuk është fjala për një rrethanë tipike të tillë. Megjithatë, nuk do të mund të pohohej në mënyrë kategorike se midis gjuhës angleze dhe gjuhës shqipe nuk ka ekzistuar ose nuk ekziston kurrfarë kontakti i drejtpërdrejtë. Kur themi këtë, kemi parasysh këto fakte:

a) Para Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri ka punuar një shkollë e mesme në gjuhën angleze, në të cilën janë përgatitur quadro për nevojat shtetërore (diplomatike) dhe shkollore.

b) Shumë familje, sidomos nga Shqipëria, e më pak nga Kosova, kanë anëtarë ose farefis të tyre të mërguar në SHBA, me të cilët ata kanë mbajtur dhe mbajnë korrespondencë dhe kontakte të tjera të ndryshme. Di-sa nga ata njerëz kanë ardhur për të vizituar atdheun dhe farefisin e tyre në vendlindje.

c) Në Fakultetin Filologjik-Historik të Universitetit Shtetëror të Tiranës ekziston një katedër a degë e gjuhës dhe e letërsisë angleze.

ç) Në Tiranë, po ashtu, ekziston Instituti i Gjuhëve të Huaja, në të cilin të gjitha lëndët, përveç gjuhës amtare, janë në gjuhë të huaja, dhe për studentët e gjuhës angleze lëndët ligjërohen në gjuhën angleze.

d) Në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, që nga vitit 1961 punon Katedra / Dega e Gjuhës dhe e Letërsisë Angleze. Në këtë Degë, gjithnjë ka

pasur nga një e më shumë (deri në 6) lektorë anglezë ose amerikanë, që u kanë ligjëruar dhe ushtruar anglishten studentëve të kësaj gjuhe.

dh) Ekziston dhe Dega e Gjuhës dhe e Letërsisë Angleze në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Prizrenit. Edhe në të ka pasur së paku një lektor anglez ose amerikan që u ka ushtruar anglishten studentëve të asaj gjuhe.

e) Në fillim të viteve 1970 në shumë shkolla fillore dhe të mesme në gjuhën shqipe, e më vonë në të gjitha shkollat në gjuhën shqipe, anglishtja është mësuar si lëndë e obliguar.

ë) Në Kosovë organizohen shumë kurse dhe seminare në gjuhën angleze.

f) Emitohen radio-emisione shkollore në gjuhën angleze.

Të gjithë këta faktorë ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë që të përvetësohen dhe përhapen elemente të gjuhës angleze në gjuhën shqipe.

Sipas Paulit, ndikimi i një gjuhe mbi tjetrën varet, veç të tjerash, edhe nga intensiteti i qarkullimit ndërkombëtar, i udhëtimeve në vende të huaja si dhe nga importimi i materialit të shkruar. Ai mendon se ky ndikim varet shumë sidomos nga e dhëna nëse gjuha pranon material nga një gjuhë tjetër.⁵ Mendojmë se këto fakte janë gjithnjë më shumë evidente dhe kushtëzojnë depërtimin e elementeve gjuhësore në gjuhën shqipe.

Duhet vënë në dukje se fjalët angleze në gjuhën shqipe nuk janë me shumicë nga terminologjia profesionale, por, të shumtën, janë nga lëmenjtë e sportit, të argëtimit, muzikës, politikës, po edhe nga fusha ekonomisë etj.

Elementet gjuhësore barten prej një gjuhe në tjetrën edhe për shkak të prestigjit që e gëzon e para. Kështu, kur anëtarët e një bashkësie gjuhësore duan të zbukurojnë të folurit e tyre me shprehje të gjuhës tjetër, ata i huazojnë ato fjalë. Gjuha angleze, për shkak të pozitës ekonomike, politike dhe kulturore të Britanisë së Madhe, e sidomos të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, bën trysni të madhe për depërtimin e elementeve të saja gjuhësore në shumë gjuhë europiane dhe jashtëeuropiane. Prandaj, në këtë pikëpamje nuk ka ngelur anash as gjuha shqipe. Ky ndikim i gjuhës angleze është vërejtur sidomos pas Luftës së Dytë Botërore.

Të huazuarit gjuhësor mund të jetë edhe rezultat i nevojës dhe i modës. Në atë rast, fjalët e huaja më së shpeshti futen në gjuhën marrëse me gjësendet e importuara. Mirëpo, fjalët nuk huazohen vetëm për shkak të nevojës që ka gjuha marrëse. Shpesh ndodh që fjalët e huaja t'i përdorin njerëzit vetëm për të lënë me to një mbresë të shkallës së lartë të ngritjes arsimore, kulturore e intelektuale.

⁵ H. Paul, *Prinzipien der Sprachgeschichte*, Halle, 1937, 390, pas: R. Filipović, 1971, f. 94.

Elementi gjuhësor i gjuhës dhënëse ndonjëherë quhet *model*. Elementi i huazuar në mënyrën si shqiptohet nga ligjëruesit e gjuhës marrëse quhet *replikë*. Modeli bëhet replikë në atë moment kur huazimi hyn në gjuhën marrëse. Lëndë e këtij studimi, në të vërtetë, janë marrëdhëniet e replikës ndaj modelit, d.m.th. të gjitha dukuritë gjuhësore që paraqiten gjatë kalimit prej modelit në replikë.

Sistemet fonologjike të dy gjuhëve rrallë dhe pak mund të përputhen. Prandaj, në të shumtën e rasteve fonemat e gjuhës dhënëse zëvendësohen me format më të afërta të sistemit fonologjik të gjuhës marrëse. Megjithatë, fonemat e gjuhës dhënëse nuk zëvendësohen gjithëherë me të njëjtën fonemë të gjuhës marrëse, sidomos nëse në gjuhën marrëse nuk ekziston diçka e tillë. Për këtë arsye, togjet e bashkëtingëlloreve shpesh mund të zhduken në huazime gjatë hyrjes së tyre në gjuhën marrëse, ose mund të zëvendësohen me togje më të thjeshta e më të lehta të gjuhës marrëse.

Linguistët kanë arritur në përfundimin se në rrugën prej modelit deri në replikë ekzistojnë kryesisht tri faza.⁶ Faza e parë është transferi a bartja e elementit gjuhësor. Me këtë nënkuptohet se ligjëruesi në fillim e përdor fjalën e huaj fare të paasimiluar. Mandej vjen faza e dytë, kur paraqitet procesi i interferencës. Kjo është ajo shkallë e përshtatjes kur të dy gjuhët përputhen në ato fjalë. Interferenca, përveç formave të tjera, mund të shprehet edhe me theks të huaj të fjalës së huazuar.

Lidhur me interferencën, Weinreich thotë se ajo në ligjërime është si rëra të cilën e bart lumi, ndërsa në gjuhë është si rëra e shtresuar në fund të liqenit. Kjo domethënë se elementi i huaj i përdorur shpesh në ligjërime bëhet shprehur në gjuhë, ku vendoset, dhe nuk varet më nga bilinguizmi.⁷

Po qe se ligjëruesi biling i përvetëson mirë sistemet fonologjike të të dy gjuhëve, atëherë nuk ka interferencë, thonë shumë linguistë, si dhe Filipović.⁸

Faza e fundit në rrugë e sipër të përshtatjes së huazimit është *integrimit* i elementit gjuhësor të huaj. Në këtë fazë elementet gjuhësore të huaja përfshihen në sistemin e gjuhës marrëse. Tani fjala e gjuhës dhënëse nuk hetohet me asgjë se është e huaj, sepse nuk dallon me asgjë nga fjalët e gjuhës marrëse. Fjala e tillë quhet *huazim*.

Duke marrë parasysh shkallën e integritetit të fjalëve të huaja në gjuhën marrëse, fjalët e huazuara mund të ndahen në: *fjalë të huaja*, *fjalë të huazuara* dhe *huazime*.

⁶ R. Filipović, 1971, f. 106.

⁷ U. Weinreich, *Vep. e cit.*, f. 11.

⁸ R. Filipović, 1971, f. 106.

Fjalë e huaj është ajo e cila dëgjuesit ose lexuesit i duket e huaj, sepse ka fonema të huaja, shpërndarje të fonemave sipas një gjedheje të huaj dhe/ose vendin e theksit nuk e ka në rrokjen e rëndomtë të gjuhës marrëse.

Fjala e huazuar, në krahasim me fjalën e huaj, është e integruar më shumë sesa fjala e huaj në sistemin e gjuhës marrëse. Megjithatë, ajo ende mund të mbajë elemente të huaja fonetike.

Huazimi është plotësisht i integruar në sistemin e gjuhës marrëse. Ai nuk dallohet me tiparet fonologjike as fonetike nga fjalët e gjuhës marrëse.

Çdo ligjërues i parë, i cili huazon një fjalë të huaj, para se ajo të përvetësohet nga masa shoqërore, mund të formojë *replikën kompromise*. Ajo replikë, në rastet më të shpeshta, i ngjan shumë modelit. Ajo ka të bëjë njësoj edhe me zëvendësimin fonologjik. Prandaj ndodh shpesh që huazimi, përkatësisht elementi i huazuar, të ketë forma alternative, veçanërisht nëse vjen përmes dy medimeve – të shkrimit dhe të folurit.

Gjuha marrëse disa elemente gjuhësore të huaja i përvetëson, disa i merr të përkthyer dhe të tjerat i refuzon. Prandaj, në përgjithësi është e sigurt se nuk do të mbeten të gjitha huazimet më të reja në gjuhën marrëse, por është vështirë të jepet përgjigje, që përpara, se cilat prej tyre do të mbeten në atë gjuhë e cilat do të zhduken.

Ligjëruesi biling, i vetëdijshëm për prejardhjen e huaj të fjalëve, të cilat i bart në gjuhën marrëse, bën një lloj përzgjedhjeje dhe pak a shumë edhe ndryshime fonetike, mbase edhe fonologjike, si dhe grafolgjike, duke u përpjekur që t'ia afrojë sa më shumë që të jetë e mundur shqiptimit të gjuhës marrëse. Por kjo fazë nuk zgjat shumë. Ligjëruesit e tjerë, po ashtu, elementin gjuhësor të huaj provojnë t'ia afrojnë sa më shumë natyrës dhe sistemit të gjuhës marrëse. Ky proces vijon gjithnjë deri në integrimin ose zëvendësimin e plotë të atij elementi gjuhësor. Në këtë rrugë, ai element, pa dyshim, kalon nëpër fazën e replikës kompromise. Kur atë element të huaj gjuhësor e marrin ligjëruesit monolingë, fillon të bëhet integrimi i plotë i tij në gjuhën marrëse. Por, vetëm bashkësitë gjuhësore vendosin përfundimisht për fatin e fjalës së huaj – ose e përvetësojnë ose e refuzojnë.

R. Filipović⁹ e ka studiuar me kujdes dukurinë e kompromisit fonetik. Ai thotë se ajo është fazë kalimtare shumë e rëndësishme gjatë procesit të përshtatjes së fjalëve të huaja ndaj sistemit të gjuhës marrëse. Kompromisi fonetik paraqitet mjaft shpesh, por nganjëherë ka jetë të shkurtër,

⁹ R. Filipović, *The Phonetic Compromise*, SRAZ nr. 5, ff. 77-88, Zagreb, 1958, ff. 77-88.

për arsye se, sipas vetë natyrës, ai paraqitet si fazë kalimtare. Sipas këtij linguisti zagrebas, kompromisi fonetik paraqitet në këto forma:

- në përdorimin e fonemave të huaja;
- në shpërndarjen e huaj të fonemave, dhe
- në sistemin e huaj të theksit.¹⁰

Kompromisi fonetik, sipas Sapirit, përpiket që sa më pak të cenohet shprehitë fonetike të gjuhës marrëse.¹¹

Gjatë hyrjes së elementeve gjuhësore të huaja në gjuhën marrëse, më së shpeshti paraqitet nevoja për përshtatjen e fonemave, gjë që quhet *transfonemizim*. Filipović ka hetuar tri lloje të përshtatjes së fonemave.¹²

1) Fjala e huaj hyn në gjuhën marrëse pa ndryshime, nëse ajo ka fonema ekuivalente në sistemin fonologjik të saj. Po qe se këto fjalë barten sidomos me anë të të folurit – ato hyjnë në gjuhën marrëse pa pësuar kurrfarë ndryshimesh.

2) Mirëpo, nëse fjala bartet me anë të letrave dhe të shtypit, grafia mund të ketë ndikim të madh në shkrimin e saj e kështu edhe në shqiptimin e saj në gjuhën ku shkrimi dhe shqiptimi nuk dallojnë shumë midis tyre, përkundër të dhënës se fonemat e saj kanë ekuivalente në gjuhën marrëse. Kjo do të thotë se ndryshimet paraqiten jo për shkak se midis dy gjuhëve ekzistojnë dallime në sistemin fonologjik, por pse ligjëruesit e gjuhës marrëse i mashtron sistemi grafologjik i gjuhës dhënëse ose për ndonjë arsye tjetër e përfillin grafemën e huazimit.

3) Kur elementi i huaj gjuhësor hyn në gjuhën ku nuk ka ekuivalente fonologjike, ose bëhet zëvendësimi i fonemave ose shqiptimi i fjalës formohet në bazë të drejtshkrimit të gjuhës dhënëse.

Huazimi gjuhësor ndonjëherë mund të ndikojë edhe në numrin e fonemave të sistemit fonologjik të gjuhës marrëse. Po qe se numri i fonemave shtohet nën ndikimin e huazimeve, kjo dukuri në linguistikë quhet importim fonemik. Lidhur me këtë dukuri Jakobsoni theksonte se gjuha mund të marrë elemente të huaja strukturore, vetëm nëse ato janë në përputhje me tendencat e zhvillimit të saj.¹³ Një hap më tutje

¹⁰ R. Filipović, 1971, f. 88.

¹¹ Edward Sapir, *Language*, New York, 1921, p. 210; shih versionin shqip nga autori i këtij shkrimi: Sapir, Eduard, *Gjuha*, Rilindja, Prishtinë, 1990.

¹² R. Filipović, *The Phonemic Analysis of English Loan-Words in Croatian*, Institut za fnetiku Filozofskog fakulteta u Zagrebu, Zagreb, 1960-1, ff. 21-27.

¹³ Roman Jakobson, *Sur la théorie des affinités phonologiques entre les langues*, Appendix IV në Trubetskoy, N. S., *Principes de phonologie*, Paris, 1949, p. 359 (sipas: Rudolf Filipović, 1971, f. 117).

në këtë drejtim ka bërë Martinet. Ai thotë se elementet e huaja gjuhësore hyjnë më lehtë, nëse ato i përgjigjen vendit të zbrazët në sistemin e gjuhës marrëse.¹⁴ Kushtet në të cilat bëhet importimi fonemik i ka hartuar në mënyrë eksplicite prof. R. Filipović.¹⁵

Ka tashmë një kohë të gjatë që linguistët diskutojnë përkitazi me çështjen nëse huazimet gjuhësore sjellin fonema të reja në gjuhën marrëse. Ndodh shpesh që alofonet e gjuhës dhënëse të bëhen fonema në gjuhën marrëse dhe kështu ato të marrin pozicione të reja. Nëse huazimet sjellin me vete dhe ruajnë mbeturina të modelit, të cilat nuk zhduken gjatë procesit të përshtatjes gjuhësore – në gjuhën marrëse paraqitet *risi*. Një formë e risisë është edhe shpërndarja e fonemave në mënyrën çfarë nuk e ka gjuha marrëse.

2. Korpusi

Mbledhjen e materialit për elementet angleze në gjuhën shqipe kishim vendosur që korpusi të mbështetej në gjuhën e shkruar dhe të folur, duke marrë parasysh më tepër gjuhën e shkruar në viset ku flitet shqipja në Kosovë, në Maqedoni e në Shqipëri.¹⁶

Qëllimi ishte, nga një anë, që të përfshihej i tërë rajoni në Ballkan ku flitet dhe shkruhet gjuha shqipe, e nga ana tjetër, të shihej nëse ekzistonin farë dallimesh midis këtyre vendeve dhe në çfarë forme dhe shkalle ishte përdorimi i elementeve gjuhësore të huaja, përkatësisht i elementeve angleze, në mes Shqipërisë dhe viseve të tjera të Ballkanit ku flitet dhe shkruhet gjuha shqipe.

Për mbledhjen e materialit të elementeve gjuhësore angleze në gjuhën shqipe lexuam gjatë gjithë muajit dhjetor të vitit 1971 nga shtypi në gjuhën shqipe në viset e ish-Jugosllavisë: të përditshmen *Rilindja*, revistat javore *Zëri i rinisë*, dhe *Flaka e Vëllazërimit*, nga të cilat dy të parat botoheshin në Kosovë, kurse e treta botohej në Maqedoni. Nga shtypi i Shqipërisë lexuam: gazetat *Zëri i popullit* dhe *Bashkimi* të përditshme, si dhe të përjavshmet: *Zëri i rinisë*, *Sporti popullor*, *Mësuesi* dhe *Gruaja socialiste* (mujore) – të gjitha këto gjatë muajit tetor të vitit 1971.

Mirëpo, pas mbledhjes së materialit nga gazetat dhe revistat e cekura më

¹⁴ André Martinet, *Affinité linguistique*, Bolletino dell' Atlante Linguistico Mediterraneo, 1, Venezia-Roma, 1959, p. 151 (sips Filipović, 1971, f. 118).

¹⁵ R. Filipović, *Phonemic Importation*, SRAZ, nr. 9-10, ff. 177-189, Zagreb, 1960.

¹⁶ Materialin e kemi mbledhur së bashku me kolegun Ismail Mehmeti. Z. Mehmeti ka bërë në punimin e tij analizën morfologjike dhe semantike të huazimeve angleze.

sipër, u pa se materiali akoma nuk ishte i plotë, përkatësisht se në këtë kohë në shtyp nuk ishin hasur fjalët angleze, për të cilat tanimë dihej se përdroreshin në gjuhën shqipe. Prandaj vijuan më tutje të përcillnim paraqitjen e fjalëve angleze në gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur, madje edhe në radiostacionet e Prishtinës, të Shkupit dhe të Tiranës, veçmas në emisionet sportive në gjuhën shqipe. Duhet vënë në dukje se kjo punë e mëtejme për hulumtimin e elementeve gjuhësore angleze nuk ishte sistematike, e përditshme, por bëhej kohë pas kohe. Kemi lexuar kohë pas kohe edhe gazeta të tjera në gjuhën shqipe për të gjetur sa më shumë huazime angleze; kemi lexuar edhe disa libra të përkthyer nga anglishtja në shqip. Megjithatë, më së shumti është shfrytëzuar gazeta e përditshme “Rilindja”, si më e përditshmja dhe më e lehta për ta gjetur dhe më e pasura me materiale të shkruara të llojllojshme. Janë shfrytëzuar edhe dy fjalorë anglisht shqip: “Fjalor anglisht-shqip” nga autori Stuart Mann, i rishtypur në edicionin e botimeve “Rilindja”, Prishtinë, 1966, dhe “Fjalor anglisht-shqip” për shkolla të mesme, i rishtypur nga Enti i Botimit të Teksteve dhe të Mjeteve Mësimore, Prishtinë, 1969. Janë shfrytëzuar, po ashtu, fjalorët terminologjikë tekniko-shkencorë, I-XV, në botimin e Tiranës dhe të Prishtinës, të cilët janë në tri gjuhë, përkatësisht në katër gjuhë (botimi i Prishtinës), shqip, rusisht, frëngjisht (dhe serbokroatisht). Për fjalët të cilat nuk janë hasur në tekst të shkruar, janë shfrytëzuar indormantë të ndryshëm. Me këtë korpusi i studimit tonë u pasurua bukur mirë, meqenëse çdo ditë e më vonë haseshin fjalë të huaja të reja.

Korpusi përbëhet nga nja 900 trajta fjalësh (apelative) dhe nja 400 emra të përveçëm – të njerëzve dhe të vendeve (gjeografikë). Pos atyre që janë marrë nga fjalorët, fjalët janë marrë në kontekst në të gjitha format e mundshme fonologjike, fonetike dhe morfologjike, si dhe me aspekte të ndryshme semantike. Paradigmat e fjalëve nuk janë marrë parasysh, pse ato lakohen dhe zgjedhohen sipas paradigmave të përcaktuara të ngjashme me fjalët shqipe. Kur kishte përjashtime nga rregullat gramatikore të gjuhës shqipe, ato merreshin parasysh dhe regjistroheshin. Në këtë punim është marrë e njëjta fjalë disa herë kur është paraqitur në forma të ndryshme fonetike dhe grafologjike.

3. Metoda e punës

Në këtë punim nuk është bërë asnjë dallim i burimit të fjalëve në mes gjuhës angleze britanike dhe amerikane. Burimet janë trajtuar njësoj, por shqiptimi britanik i fjalëve është marrë si bazë fonetike e trajtave origjinale (angleze) të huazimeve.

Në punim është përfshirë edhe analiza e atyre elementeve gjuhësore që në shqipet kanë arritur nëpërmjet gjuhës angleze, po që u përkasin gjuhëve të vendeve të largëta, siç janë fjalët: gong, tajfun etj. Ato fjalë i kemi marrë si

fjalë angleze, sepse gjatë kohës ato janë përshtatur plotësisht në pikëpamje fonologjike dhe fonetike si dhe semantike sipas gjuhës angleze, kështu që tashmë mund të llogariten si elemente gjuhësore angleze.

Gjatë hartimit të studimit është bërë përpjekje që të konstatohet për disa elemente gjuhësore angleze se deri në çfarë shkalle të përshtatjes fonetike kanë arritur.

Po qe se përcillet ecuria e fjalëve angleze prej momentit kur hyjnë në gjuhën shqipe deri në integrimin e tyre të plotë, mund të vërehen dukuri të ndryshme linguistike. Në punim janë vërejtur dukuri të tilla, por nuk është përcjellë ecuria e së njëjtës fjalë nëpër faza të ndryshme të përshtatjes, meqë për këtë do të nevojitej kohë më e gjatë e përcjelljes dhe e perceptimit, gjë që nuk është e rëndomtë në punimet me karakter të këtillë. Pa dyshim, janë hasur fjalë të ndryshme në faza të ndryshme të përshtatjes në gjuhën shqipe.

Me rastin e analizës profesionale të kontaktit të gjuhës angleze me gjuhën shqipe, është zbatuar metoda përshkruese në të dy gjuhët.

Në bazë të punës së gjertanishme në këtë lëmë – në bazë të gazetave dhe të revistave bashkëkohore, si dhe të fjalorëve më të rinj anglisht-shqip – pati mundësi të bëhej analizë gjuhësor me qëllim që të vërtetohej se në çfarë mase elementet angleze ndikojnë në sistemin fonologjik dhe fonetik të gjuhës shqipe dhe si integrohen në të. Analiza është bërë në një korpus reprezentativ dhe në rrafshin e gjuhës standarde angleze dhe shqipe.

Në sajë të punës së begatshme dhe të zhvilluar një kohë të gjatë nga prof. R. Filipović, është përcaktuar një metodologji e punës në këtë lëmë të veprimtarisë shkencore, të cilën e kemi vijuar. Analizat bëhen zakonisht në fushat linguistike: fonologjike e fonetike, morfologjike dhe semantike. Shumë rrallë në studimet e tilla është përfshirë edhe interferenca në fushën e sintaksës. Qëllimi i këtij studimi është të bëhet analiza fonologjike e fonetike e elementeve gjuhësore të anglishtes në gjuhën shqipe. Detyrë e këtij punimi është që të nxirret në shesh interferenca e gjuhës angleze në shqipen – në fushën fonologjike e fonetike. Shtojmë se nuk kemi folur shumë për të dhënat se kur ka filluar interferenca e ndonjë elementi gjuhësor, pikërisht pse për këtë nuk kemi pasur tregues të sigurt. Nuk e kemi shqyrtuar as rrugën nëpër të cilën fjalët angleze kanë hyrë në gjuhën shqipe, por që janë cekur mundësitë e depërtimit të përgjithshëm përmes ndonjë rruge – gjuhe tjetër, po edhe të ndonjë mediumi të caktuar, kur për këtë ka pasur tregues të sigurt. Jemi përpjekur që në përgjithësi të pasqyrojmë gjendjen si ka qenë elementi gjuhësor anglez kur është hasur ose vjelë materiali që është analizuar dhe kur është hartuar ky punim. Pra, është bërë vetëm një prerje horizontale e ecurisë linguistike të përshtatjes së fjalëve angleze në gjuhën shqipe, gjatë një periudhe afër dyvjeçare.

Si udhërrëfyes për përshkrimin fonologjik e fonetik të gjuhës shqipe në këtë studim e kemi përdorur *Fonetikën* e Anastas Dodit.¹⁷

Për bazë të sistemit fonologjik e fonetik të gjuhës angleze, na kanë shërbyer teksti i fonetikës nga Daniel Jones¹⁸ dhe teksti i fonetikës nga A. C. Gimson.¹⁹

Me rastin e krahasimit të sistemeve fonologjike të gjuhës angleze dhe të gjuhës shqipe në tërësi, janë përfshirë tipat e fonemave që ekzistojnë në të dyja gjuhët dhe ato të cilat nuk ekzistojnë në njërin nga ato, si dhe shpërndarja fonemike, që paraqitet në huazimet angleze në gjuhën shqipe. Mirëpo, nuk ka mjaftuar të kemi vetëm listën e fonemave të të dyja gjuhëve. Jemi detyruar, po ashtu, të mësojmë dhe të konstatojmë edhe cilësitë fonetike të alofoneve të të dyja gjuhëve.

Për të vërtetuar nëse kanë ndikuar huazimet angleze në gjuhën shqipe, përkatësisht nëse ato kanë sjellë ndonjë risi në shpërndarjen fonemike ose të togjeve bashkëtingëllore në pozicionet nistore, mesore dhe fundore, kemi analizuar së pari ato dy dukuri të huazimeve angleze në gjuhën shqipe. Për të konstatuar këtë ndikim na ka munguar burimi përkatës i shpërndarjes fonemike në gjuhën shqipe. Prandaj, jemi përpjekur që në *Fjalorin e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1954,²⁰ të analizojmë vetë shpërndarjen e togjeve bashkëtingëllore të shqipes.

Gjatë analizës fonologjike jemi mbështetur në fonemat e gjuhës angleze dhe me shembuj kemi ilustruar rezultatet e përshtatjes në gjuhën shqipe. Analizat fonologjike e fonetike janë bërë përkitazi me theksin, zanoret, bashkëtingëlloret, si dhe togjet bashkëtingëllore dhe zanore.

Për të studiuar elementin gjuhësor anglez në gjuhën shqipe, kuptohet, se si kushti i parë është që të njihen mirë dhe të analizohen me sukses si anglishtja ashtu dhe shqipja. Pos tipave të fonemave dhe shpërndarjes së tyre, duhet të merret parasysh edhe çështja e theksit. Kjo është shumë e rëndësishme, meqë të dy gjuhët kanë theks të ashtuquajtur dinamik. Pos kësaj, ndërrimi i vendit të theksit është bërë zakonisht në fjalët me dy e më shumë rrokje. Theksi është vend shumë i përshtatshëm për interferencën fonetike, prandaj atij i është kushtuar vëmendje e veçantë.

Është fakt se kur gjuhët janë në kontakt,²¹ ekziston njëfarë tendence që

¹⁷ Anastas Dodi, *Fonetika e gjuhës so sotme shqipe*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSAK-së, Prishtinë, 1970.

¹⁸ Daniel Jones, *An Outline of English Phonetics*, 1964.

¹⁹ A. C. Gimson, *An Introduction to the Pronunciation of English*, Londër, 1970.

²⁰ Në kohën kur u hartua ky studim (1973), ky ishte fjalori më i plotë i gjuhës shqipe.

²¹ Këtu nuk mendohet vetëm për kontaktin fizik në kuptimin e ngushtë të fjalës, por

elementet e një gjuhe të njësohen me elementet e gjuhës tjetër. Kjo dukuri në gjuhësi quhet *identifikim gjuhësor*.²² Kjo do të thotë se në studim duhej të shpjegoheshin ato identifikime dhe se në analizën fonologjike e fonetike duhej të përfshiheshin edhe kuantiteti fonetik i fonemave të të dy gjuhëve, me alofonet dhe përbërësit kryesorë.

Në punim janë analizuar fonemat e fjalëve, në mënyrë që të vërtetohet deri ku ka arritur interferenca fonemike në huazimet angleze, meqë ajo mund të jetë prej zeros deri në integrimin e plotë. Në të vërtetë, integrimi do të thotë se interferenca është zhdukur. Aspekti i cili transferohet në këtë mënyrë quhet *importim*, domethënë forma të cilën e ka marrë replika. Aspekti që është zëvendësuar me ndonjë ekuivalent nga sistemi i gjuhës shqipe, quhet *substitucion* a *zëvendësim*. Në studimin e fjalëve të huaja, në rastin konkret të fjalëve angleze në gjuhën shqipe – me analizë gjuhësore vërtetohet shkalla e zëvendësimit dhe e importimit që paraqitet në huazim – në nivelin fonologjik.

Për të vërtetuar ndryshimet fonetike në mes modelit dhe replikës, u përpilua një tekst nga materiali i gjuhës amtare, ndërsa fjalët u përzgjedhën sipas nevojës dhe u integruan në kontekst. Nga indormantët shqipfolës u kërkua që të lexonin tekstin dhe kjo u incizua në kasetofon. Në këtë mënyrë, me më shumë përpikëri dhe saktësi është vërtetuar se si shqiptohen disa tinguj në fjalët e huaja.

Për transkriptimin e fonemave dhe të fjalëve, kur u analizuan dhe u krahasuan sistemet fonologjike të dy gjuhëve, u shfrytëzua alfabeti fonetik ndërkombëtar.

Transkriptimi i fjalëve angleze është bërë sipas doracakut *Everyone's English pronouncing Dictionary* nga Daniel Jonesi.

Për transkriptimin e huazimeve angleze në gjuhën shqipe dhe të fjalëve të tjera të gjuhës shqipe, kur ishte e nevojshme, shfrytëzohim fjalorët e gjuhës shqipe dhe udhëzimet e foneticientëve të gjuhës shqipe mbi drejtshqiptimin e fjalëve shqipe. Kemi përfuar edhe nga përvoja jonë si shqipfolës, në bazë të njohurive gjuhësore, e sidomos fonologjike.²³

për kontaktin kulturor, i cili në këtë rast të studimit tonë është më i pranishëm.

²² R. Filipović, 1971, f. 107.

²³ Për shkak të vendit jo të mjaftueshëm, këtu do të flitet vetëm për dallimet dhe ngjashmëritë që ekzistojnë midis sistemeve fonologjike të gjuhës angleze dhe të gjuhës shqipe, si dhe për zëvendësimin e fonemave të gjuhës angleze në shqipe. Në një rast tjetër i diskutojmë gjerësisht risitë që sjellin fjalët angleze në sistemin fonologjik të gjuhës shqipe, si dhe drejtshkrimin e këtyre huazimeve.

4. KRAHASIMI I SISTEMEVE FONOLOGJIKE MIDIS ANGLISHTES DHE SHQIPES

4.1. Krahasime të përgjithshme gjuhësore

Analiza e dallimeve dhe e përkimeve në mes dy gjuhëve, përkatësisht dy sistemeve fonemike, ka rëndësi të madhe për të parë se çka ndodh me huazimet angleze në gjuhën shqipe, përkatësisht si përshtaten ato nga pikëpamja fonemike dhe fonetike, si dhe ku ekzistojnë mundësi teorike për t'u paraqitur dukuria e transfonemizimit, e zëvendësimit dhe e importimit të fonemave. Nga krahasimi midis dy gjuhëve mund të shihet se ku ekzistojnë mundësi potenciale të përshtatjes, kurse më vonë, në analizën konkrete, vërtetohet nëse janë shfrytëzuar ato mundësi, apo disa nga fonemat, përkatësisht elementet angleze, nuk kanë vijuar rrugën e mundshme të përshtatjes.

Së pari krahasohen karakteristikat e përgjithshme të dy sistemeve fonemike e fonetike, pastaj bëhet krahasimi i hollësishëm i fonemave për të vërtetuar se cilat prej tyre mund të jenë të zëvendësueshme duke u paraqitur në të dy anët si ekuivalente, dhe cilat transfonemizohen, asimilohen dhe bëjnë zëvendësimin konkret me fonemat e gjuhës marrëse – shqipe.

4.2. Theksi

Si fonemat angleze, ashtu dhe ato shqipe, janë më të qarta dhe më shumë të artikuluar kur gjenden në rrokjet e theksuara, kurse janë më të paqarta dhe artikulohen më pak kur janë në rrokjet e patheksuara. Rrokjet e patheksuara mund të jenë të tilla, saqë mund të shpien gati në reduktim të plotë të disa fonemave. Kjo mund të ndodhë për shkak se që të dyja gjuhët kanë theks dinamik. Nganjëherë zanoret zhduken në shqiptim në rrokjet e patheksuara, ndërsa format e tyre mund të ruhen në drejtshkrim. Sa u përket cilësive të theksit, pra, nuk ka dallime të mëdha në mes njërës gjuhë dhe gjuhës tjetër.

Vlen të dihet fakti se anglishtja ka theks të lirë, por edhe theks të fiksuar. Ka theks të lirë nga pikëpamja e vendit të rrokjes mbi të cilën bie theksi; ai mund të bjerë mbi rrokjen e parë, mbi rrokjen e dytë, mbi rrokjen e tretë, e kështu me radhë, në fjalët shumëërrokëshe. Por fjala përkatëse rëndom nuk e ndërron vendin e theksit edhe kur asaj i shtohen ndajshtesa. Kurse gjuha shqipe ka vendin karakteristik të theksit në rrokjen e parafundit ose të fundit të temës së fjalëve me dy e më shumë rrokje. Te foljet theksi rëndom bie mbi rrokjen e fundit të temës, kurse tek emrat dhe mbi-

emrat ai rëndom bie mbi rrokjen johundore të temës, por ka dhe përjashtime.²⁴ Ky dallim i përcaktimit të vendit të theksit ka gjasa që të paraqesë raste të ndërrimit të llojlojshëm të vendit të theksit në huazimet angleze, kur ato integrohen në gjuhën shqipe.

4.3. Vendi dhe mënyra e artikulimit të fonemave

Dallimet e shqiptimit të disa fonemave të gjuhës angleze dhe të gjuhës shqipe ekzistojnë në pozicionin (vandin) e organeve të të folurit ku ato formohen. Pozita e buzëve, e gjuhës në përgjithësi dhe e disa pjesëve të saj, dallon në të shqiptuarit e disa fonemave, kurse pozita e qiellzës së butë dhe e kordhave të zërit gati përputhet në të dy gjuhët.

4.4. Gjatësia dhe cilësia e fonemave

(1) Bashkëtingëlloret

Gjuha angleze ka 24 fonema bashkëtingëllore, kurse gjuha shqipe ka 29 sosh. Ndonëse shqipja duket se ka përparësi në sasi të bashkëtingëlloreve, anglishtja dallon me cilësinë e fonemave, siç janë: aspiracioni më i madh i disa bashkëtingëlloreve të pazëshme, velarizimi i fonemës /r/ etj. Dallimi i këtyre cilësive fonetike është i dukshëm sidomos kur krahasohet vendi dhe mënyra e artikulimit të tyre.

(2) Okluzivet

Gjuha shqipe ka 8 fonema okluzive, ndërsa anglishtja i ka 6 sosh. Në të dyja gjuhët ka palë të okluziveve sipas zëshmërisë, d.m.th. ndaj çdo okluzivi të zëshëm ekziston edhe okluzivi i pazëshëm. Okluzivet qiellzore /q/ dhe /gj/²⁵ i mungojnë gjuhës angleze. Okluzivi grykor /ʔ/ ekziston në të dy gjuhët. Në gjuhën shqipe ai ka më tepër karakter dialektor dhe duket se sipas intensitetit është më i dobët se në anglishte dhe haset shumë më rrallë. Mirëpo, në asnjërën nga këto dy gjuhë ai nuk ka vlerë fonemike.

Aspiracioni i okluziveve të pazëshme /p/, /t/ dhe /k/ në gjuhën shqipe është në shkallën minimale, kurse në gjuhën angleze ai është mjaft i fuqishëm, sidomos në disa pozicione, para zanoreve të përparme të mbyllëta. Pala e okluziveve /t/ - /d/ sipas vendit të formimit, në gjuhën angleze është alveolar, kurse në gjuhën shqipe është alveodental.

²⁴ Shaban Demiraj, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996, ff. 33-46.

²⁵ Meqë këto dy bashkëtingëllore /q/ e /gj/ nuk ekzistojnë në anglishte, ato po i shënojmë me alfabetin e gjuhës shqipe.

(3) N a z a l e t

Këto dy gjuhë, sipas numrit të nazaleve që kanë, nuk përputhen. Anglishtja ka 3 bashkëtingëllore nazale, kurse shqipja ka 2 sosh. Mirëpo, nazali velar /ŋ/ në gjuhën angleze është fonemë, kurse në gjuhën shqipe është alofon i fonemës /n/, përkatësisht ai është fonemë në dialektin gegë. Palatali nazal /ɲ/ (nj) nuk ekziston në gjuhën angleze. Ai haset vetëm në disa fjalë të huaja. Kurse kjo fonemë në gjuhën shqipe është e rëndomtë.

(4) Z a n o r e t

Mospërputhje më të madhe se te bashkëtingëlloret midis këtyre dy gjuhëve tregon sistemi i zanoreve. Me numër, anglishtja ka 20 fonema zanore, nga të cilat 12 janë të ashtuquajtura zanore të pastra, dhe 8 janë diftongje. Gjuha shqipe ka vetëm 7 fonema zanore.

Anglishtja bën dallimin midis fonemave zanore të gjata dhe të shkurtra. Kjo d.m.th. se gjatësia e zanoreve në gjuhën angleze ka vlerë fonemike. Të këtilla janë 4 çifte: /i/ - /i:/; /o/ - /o:/, /u/ - /u:/, si dhe /ə/ - /ə:/. Opozicionin e fonemës zanore të gjatë e të shkurtër shqipja e konsideron me vlerë vetëm fonetike, por edhe në kontekst morfologjik. Kjo është kështu së paku sipas studimeve të gjertanishme.

Gjatësia nuk është cilësi e përhershme e zanoreve të shqipes. Ajo pëson ndryshime gjatë përdorimit të formave paradigmore të fjalëve, varet nga konteksti morfologjik. F.v. lis /lis/ - /li:sa/; plak /plak/ - /pla:ku/. Gjatësia e mesme mund të vërehet më pak, por zanoret e shkurtra dhe të gjata janë evidente.

Pos kësaj, dallime të dukshme midis këtyre gjuhëve, shikuar nga aspekti fonemik, ekzistojnë edhe te diftongjet. Anglishtja ka diftongje fonetike, meqë ato konsiderohen fonema. Shqipja ka vetëm diftongje fonetike, të cilat nuk janë fonema, po variante (alofone) të fonemave përkatëse.

Shikuar nga aspekti i gjuhës standarde, asnjëra nga këto dy gjuhë nuk ka zanore hundore.

Shqipja ka zanoren e parme të ngritjes së lartë të labializuar /y/. Anglishtja nuk e ka këtë zanore.

Mund të përfundohet se, përveç disa diftongjeve, të cilat nuk kanë ekuivalente në gjuhën shqipe, gati të gjitha fonemat zanore të tjera të anglishtes kanë ndonjë lloj ekuivalence bukur përkatëse në këtë gjuhë marrëse, qoftë të jenë fonema ose alofone.

4.5. Përfundim

Nga e gjithë kjo që u tha, mund të përfundohet si vijon:

a) Disa fonema angleze me cilësitë e tyre janë gati të njëjta me fonemat e shqipes. Ky lloj i fonemave, me rastin e kalimit të fjalëve angleze në gjuhën shqipe, do të mund të ruhej i pandryshuar, duke mos pësuar shumë ndryshim në vlerën e tyre fonetike.

b) Disa fonema të gjuhës angleze dhe të gjuhës shqipe janë pak a shumë të ngjashme. Në këtë grup bëjnë pjesë ato fonema, të cilat, në të vërtetë, kanë ekuivalente në gjuhën shqipe, por për shkak të disa cilësive specifike përsëri dallojnë nga fonemat shqipe. Këto fonema, në të shumtën e rasteve, zëvendësohen me fonemat përkatëse të shqipes.

c) Një numër i fonemave angleze nuk ka ekuivalente në gjuhën shqipe. Në këtë grup bëjnë pjesë ato fonema, të cilat nuk ekzistojnë në sistemin fonologjik të gjuhës shqipe. Me rastin e të huazuarit të elementeve angleze, këto fonema zëvendësohen shumë lirisht me fonema të shqipes. Zëvendësimi zakonisht bëhet sipas shqiptimit të ngjashëm me fonemat e afërta ose vijohet sipas drejtshkrimit të huazimeve angleze.

d) Një numër i fonemave shqipe nuk ka ekuivalente në gjuhën angleze, sepse nuk ekzistojnë në sistemin fonemik të anglishtes. Ndonëse fonemat e këtij grupi nuk kanë ekuivalente në gjuhën dhënëse, për shkak të nevojës së zëvendësimit dhe të hiperdiferencimit të fonemave,²⁶ mund të përfshihen edhe ato në fjalë të huazuara nga gjuha angleze.

Për ta pasur më të qartë çështjen, këtu po japim në grupe listën e fonemave në një rën gjuhë dhe në tjetrën.

Lloji i fonemave	Grupi I	Grupi II	Grupi III	Grupi IV
Zanore	/i/, /u/, /e/, /ə/, /o/	/i:/, /a:/, /u:/, /o:/, /ʌ/	/æ/, /ə/	/y/
Diftongje		/ai/, /au/, /ei/, /oi/, /əu/	/iə/, /uə/, /ɛə/	
Bashkë-tingëllore	/b/, /m/, /f/, /l/, /s/, /ʃ/, /tʃ/, /g/, /n/, /v/, /h/, /z/, / /ʒ/, /dʒ/, /θ/, /ð/, /j/	/p/, /d/, /t/, /k/, /r/	/ŋ/, /w/	/λ/, /ts/, /dz/, /tʃ/, /ç/, /đ/, /ɲ/

²⁶ U. Weinreich, *Vep. e cit.*, f. 18; shih dhe: Žarko Muljačić, *Opća fonologija i fonologija suvremenog talijanskog jezika*, bot. 2. i zgjeruar, Školska knjiga, Zagreb, 1972, f. 210.

5. ANALIZA FONEMIKE E HUAZIMEVE ANGLEZE NË GJUHËN SHQIPE

5.1. Mbi analizën në përgjithësi

Objekt i studimit tonë të huazimeve angleze në fushën fonemike janë ndryshimet që bëhen gjatë kalimit prej gjuhës angleze në gjuhën shqipe. Gjatë këtij procesi mund të paraqiten tri shkallë të përshtatjes:

- 1) Fjala angleze përdoret plotësisht e paasimiluar dhe e papërshtatur, domethënë kalon drejtpërsëdrejti në gjuhën shqipe, përkatësisht, në gjuhën e dytë. Kjo dukuri quhet transferim.²⁷
- 2) Nëse huazimi vete deri në atë shkallë sa të arrihet përputhja e dy gjuhëve, fjala e ndërron formën e vet, por procesi nuk përfundon me kaq. Ky proces i përshtatjes gjuhësore quhet interferencë.
- 3) Materiali linguistik i gjuhës dhënëse, përkatësisht i anglishtes, përdoret në gjuhën marrëse, përkatësisht në gjuhën shqipe. Kjo shkallë e përshtatjes gjuhësore quhet integrim.

Dy shkallët e para në pikëpamje kohe janë të shkurtra. Ato nuk zgjasin shumë, sepse posa të hyjë fjala në gjuhën marrëse, fillon përshtatja e saj. Periudha kohore e dy shkallëve të para është në marrëdhënie të zhdrejtë me dendurinë e përdorimit, domethënë sa më shpesh të përdoret elementi i huaj gjuhësor, aq më shpejt ai përshtatet. Në këto dy shkallë, mendojmë se nuk gjenden shumë huazime angleze në gjuhën shqipe. Duhet theksuar se është shumë vështirë të tërhiqet ndonjë vijë e caktuar midis dy shkallëve të para të përshtatjes gjuhësore.

Shkalla e tretë - integrimi – është më e sigurta për ta studiuar. Prandaj më së shumti do të ndalemi në integrimin e huazimeve, duke filluar me zëvendësimin e tyre.

Në këtë analizë, përveç apelativëve (emrat e përgjithshëm, mbi-emrat, foljet), janë përfshirë edhe emrat e njerëzve dhe emrat gjeografikë. Kjo është bërë për shkak se ata kanë trajtim njësoj si dhe apelativët; emrat e përveçëm transkriptohen me alfabetin shqip, marrin shqiptimin dhe theksin e shqipes, domethënë përshtaten në mënyrë fonemike dhe fonetike sipas sistemit përkatës të gjuhës shqipe.

Për shkak se emrave të përveçëm në analizën fonemike u kemi dhënë të njëjtin trajtim si dhe apelativëve, sepse ashtu e do puna, ata nuk i analizojmë hollësisht në ndonjë kapitull të veçantë.

²⁷ R. Filipović, 1971, f. 114.

Me rastin e ilustrimit me shembuj, së pari japim drejtshkrimin e fjalëve angleze dhe të fjalëve shqipe, pastaj në kllapa japim edhe shqiptimin e tyre. Në rastin kur e lyp puna, japim edhe shqiptimin e fjalëve shqipe me alfabetin fonetik ndërkombëtar. Theksin e fjalëve, si të njëjës gjuhë dhe të gjuhës tjetër, e shënojmë me (˘) para rrokjes mbi të cilën ai bie. Gjatësinë e zanoreve të shqipes, kur të ketë nevojë, e shënojmë me shenjën e gjatësisë, f.v. [mūr]. Kur ilustrojmë me shembuj, së pari i japim apelativët, pastaj emrat e përveçëm dhe këta të radhitur sipas drejtshkrimit anglez, si për njërin lloj të shembujve, ashtu dhe për tjetrin.

5.2. Zëvendësimi

Zëvendësimi fonemik është ai aspekt i të huazuarit gjuhësor, kur elementi i gjuhës dhënëse zëvendësohet me ndonjë ekuivalent fonemik të gjuhës marrësve. Në këtë kapitull do të merremi kryesisht me këtë çështje, duke pasur parasysh zëvendësimin e fonemave angleze me ato të gjuhës shqipe në huazimet angleze.

(a) Zëvendësimi i zanoreve të pastra

1. Zanorja angleze e gjatë e mbyllur /i:/ në huazimet angleze në gjuhën shqipe zëvendësohet me /i/ (të shkurtër) të shqipes, për shembull:

freeze [fri:z] > friz /[friz],
 leader [˘li:də] > lider [li˘der],
 Heath [hi:θ] > Hith [hiθ] etj.

Nën ndikimin e drejtshkrimit, huazimi anglez *meeting* nganjëherë, sidomos në shtypin kosovar, shkruhet *meting*, në ç'rast paraqitet zëvendësimi: /i:/ > /e/.

2. Fonema angleze e shkurtër e hapët, deri diku qendrore /i/, zëvendësohet me ekuivalentin më të afërm të shqipes /i/, për shembull:

business [˘biznis] > biznis [biz˘nis],
 design [di˘zain] > dizajn [di˘zajn],
 Foreign (Office) [˘forin] > Forin [˘forin] (Ofis) [fo˘rin] etj.

Në fjalën angleze *business* në Shqipëri kjo fonemë zanore zëvendësohet me /e/, mbase e ndikuar nga drejtshkrimi: [biz˘nes].

Nën ndikimin e drejtshkrimit të huazimit anglez, shpesh bëhet zëvendësimi i /i/ angleze me /e/ të shqipes, p. sh.:

budget [˘bʌdʒit] > buxhet [bu˘dʒet],
 racket [˘rækit] > raket [ra˘ket],
 Dickens [˘dikinzi] > Dikens [di˘kens] etj.

Në disa raste, drejtshkrimi i huazimeve angleze, ndërron edhe strukturën fonetike të fjalës, kështu që /i/ angleze zëvendësohet me /ej/ të shqipes, në mbështetje të shkrimit të huazimit me *ey*, p.sh.:

hockey [‘hoki] > hokej [ho’kej],
jockey [‘dʒoki] > xhokej [dʒo’kej/],
Sidney [‘sidni] > Sidnej [sid’nej] etj.

Kemi hasur edhe në këtë lloj zëvendësimi: /i/ > /e/, i cili nuk mbështetet në ndonjë ngjashmëri.

cottage [‘kotidʒ] > kotexh [ko’tedʒ].

3. Zanorja e anglishtes gjysmë e hapur, e shkurtër /e/ zëvendësohet kryesisht me /e/ të shqipes, për shembull:

best-seller [’bestselə] > bestseler [bestse’ler],
sketch [sketʃ] > skeç [sketʃ],
Bench [bentʃ] > Benç [bentʃ] etj.

Në materialin e vjelë kemi hasur dhe këto lloje të zëvendësimit:

- /e/ > /a/:
flannelette [flænə’let] > flanelatë [flane’latə];
- /e/ > /i/:
engineering [‘endʒi’niəriŋ] inxhinjering [indʒinjer’ring].

Drejtshkrimi nuk do të mund t’ia linim ‘fajin’ për ndikimin e zëvendësimit të tillë, sepse atë shembujt nuk e argumentojnë. Mirëpo, meqë është fjala vetëm për nga një shembull të atyre dy llojeve të zëvendësimit të fonemës /e/, këtë e konsiderojmë përjashtim, e jo rregull.

4. Meqë zanorja e anglishtes e hapur /æ/ nuk ka ekuivalent në gjuhën shqipe, sepse ajo bie në grupin e tretë sipas ngjashmërisë dhe dallimeve të fonemave midis anglishtes dhe shqipes, ajo zëvendësohet kryesisht në dy mënyra: me /a/ dhe me /e/.

a) Zëvendësimi i kësaj foneme angleze me /a/, që është bërë sipas ndikimit të shkrimit, mund të shihet në këta shembuj:

gangster [‘gæŋstə] > gangster [gang’ster],
skylab [‘skailæb] > skajlab [skaj’lab],
Max [mæks] > Maks [maks].

b) Zëvendësimin /æ/ > /e/ mund ta hasim në këta shembuj:

back [bæk] > bek [bek],
handicap [‘hændikæp] > hendikep [hendi’kep],
Stan [stæn] > Sten [sten] etj.

Këtë lloj zëvendësimi e shpjegojmë si rezultat të dy faktorëve. Njëri është gjuha ndërmjetëse, me anë të së cilës kanë arritur disa huazime

angleze në gjuhën shqipe si të përshtatura të gatshme me zëvendësimin /æ/ > /e/. Gjuhës marrëse, në këtë rast, nuk i mbetet të bëjë tjetër, përveç ta pranojë fjalën angleze ashtu siç është – në formën tashmë të përshtatur.

Faktor i dytë është fakti se në disa të folme të shqipes ekziston alofoni /ɛ/ i fonemës /e/. Këtë tingull e kishte vërejtur edhe G. S. Lowman,²⁸ i cili pohonte se ai ishte fonemë, se gjendej në një numër foljesh në veten e dytë njëjës të kohës së kryer të thjeshtë dhe se qëndronte në një të tretën e largësisë nga zanorja kardinale angleze /æ/, si dhe se ishte formuar nga kontraksioni /a:e/. Ky tingull i ngjan një varianti të gjatë të zanores angleze /æ/. Lowmani jep si shembull: A i the (æ/? Ti e pe /pæ/ etj.

Për ekzistimin e kësaj foneme zanore në disa të folme shqipe flet edhe Anastas Dodi.²⁹

Mendojmë se ky tingull është alofon i fonemës /e/ në shqipe pse ka rajon të ngushtë të përdorimit dhe numër të kufizuar të rasteve ku ai përdoret.

Meqë gjuha shqipe, pra, ka këtë alofon të fonemës /e/, fonema angleze /æ/ për veshin e shqipfolësit mund të dëgjohet më shumë si /e/ sesa si /a/. Prandaj, kur huazimi hyn drejtpërsëdrejti në gjuhën shqipe, ka më shumë mundësi që fonema angleze /æ/ të zëvendësohet me /e/. Kjo është sigurisht arsye dhe përgjigje që përkundër të dhënës se numri më i madh i huazimeve angleze në shqipet hyn me anë të shkrimit, kemi gati numër të njëjtë të zëvendësimit të kësaj foneme angleze me /a/ shqipe si dhe me /e/. Është me interes të vihet në dukje se shpesh mund të hasen rastet kur i njëjti huazim i anglishtes të bëjë zëvendësim dy llojesh, p.sh.:

jazz [dʒæz] > xhaz [dʒaz] e xhez [dʒez],³⁰

match [mætʃ] > maç [matʃ] e meç [metʃ],

sandwich [ˈsænwɪtʃ] > sanduiç [sandˈvitʃ] e senduiç [sendˈvitʃ],

gary [ˈgæri] > Gari [ˈgari] e Geri [ˈgeri],

Jack [dʒæk] > Xhak [dʒak] e Xhek [dʒek] etj.

Zëvendësimi i /æ/ me /e/, sipas gjendjes në korpusin tonë, është i pranishëm më shumë në gjuhën shqipe në Kosovë e Maqedoni, ndërsa

²⁸ G. S. Lowman, *The Phonetics of Albanian*, p. 282.

²⁹ A. Dodi, 1970, f. 60.

³⁰ Zëvendëmi i fonemës /æ/ me /e/ mbizotëron në Kosovë e Maqedoni, mbase si rrjedhojë e ndikimit të gjuhës ndërmjetëse (sllave), përmes së cilës hyjnë shumë elemente gjuhësore angleze, ndërsa zëvendësimi i saj me /a/ haset më shumë në Shqipëri, mbase nën ndikimin e grafisë.

zëvendësimi me /a/ në Shqipëri. Kjo dukuri, mendojmë, vjen nga fakti se këto dy vendet e para ishin më të hapura, sesa Shqipëria ndaj Perëndimit, kishin më shumë kontakte dhe marrëdhënie me ato vende, sidomos me SHBA-në, prandaj dhe në vendet e cekura të para hyjnë fjalë angleze më shumë në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndërsa në Shqipëri fjalët e tilla më shumë hyjnë me anë të shkrimit, ku shkrimi ka ndikim më të madh.³¹ Faktor i dytë është se gjuha shqipe në Kosovë dhe në Maqedoni pranon numër më të madh huazimesh, sigurisht më së shumti, nëpërmjet gjuhës ndërmjetëse – serbokroatishtes, ku mbi-zotëron tendenca e zëvendësimit të fonemës angleze /æ/ me /e/.

5. Fonema angleze e prapme e gjatë e hapur /a:/ nuk ka ekuivalent adekuat në gjuhën shqipe si fonemë. Ekziston vetëm varianti i gjatë i fonemës /a/, i cili është mjaft i ngjashëm me këtë fonemë zanore angleze, por e para është pak më e hapur, përkatësisht më pak e labializuar.

a) Mirëpo, nën ndikimin e drejtshkrimit të huazimeve angleze, e meqë pas /a:/ në shkrim ndodhen shkronjat *r* e *l*, këto dy bashkëtingëllore paraqiten në shqiptimin e atyre huazimeve në gjuhën shqipe, ndonëse në anglishte nuk shqiptohen fare. Në këtë mënyrë edhe bëhet zëvendësimi në rastet më të shpeshta: /a: > /ar/, për shembull:

bar [ba:] > bar ;[bar],

farmer ['fa:mə] > farmer [far'mer],

Arthur ['a:θə] > Arthur [ar'θur] etj.

b) Po ashtu, ekziston rasti, kur në bazë të shkrimit anglez, /a:/ në shqipet të zëvendësohet me /all/, duke e nxjerrë në sipërfaqe // e shurdhër angleze, e cila në gjuhën dhënëse nuk shqiptohet, p.sh.:

half [ha:f] > half [half].

c) Në një rast, në mbështetje të shkrimit të anglishtes, /a:/ në shqipet është zëvendësuar me /er/:

Derby ['da:bi] > derbi ['derbi].

ç) Kjo zanore angleze e gjatë zëvendësohet edhe me /a/ të shurdhët të shqipes:

basket-ball ['ba:skitbo:l] > basketboll [basket'bol],

dancing ['da:nsɪŋ] > dansing [dan'sing],

khaki ['ka:ki] > kaki ['kaki] etj.

d) U tha më sipër se shqipja ka alofonin kuantitativ të /a/, për-

³¹ Lexuesit i bëhet me dije se ky studim mbështetet në materialin e mbledhur para vitit 1972.

katësisht /ā/. Mirëpo, kjo mundësi e shqipes është shfrytëzuar shumë pak për përshtatjen e huazimeve. Në materialin tonë hasen vetëm këta dy shembuj:

farm [fa:m] > farmë [‘fā:rmə],
pyjama [pi’dʒa:mə] > pixhamë [pi’dʒā:mə].

6. a) Fonema zanore e shkurtër e hapur e anglishtes /o/ zakonisht zëvendësohet me fonemën zanore më të afërt të shqipes – me /o/, e cila është paksa më e mbyllët se ajo e anglishtes:

golf [golf] > golf [golf],
tommy [‘tomi] > tomi [‘tomi],
Bobby [‘bobi] > Bobi [‘bobi] etj.

b) Nën ndikimin e shkrimit /o/ e anglishtes, në disa fjalë, zëvendësohet me /a/ të shqipes:

watt [wot] < vat [vat],
yaht [jot] > jaht [jaht],
Wallace [‘woləs] Valas [va’las] etj.

7. a) Zanozja e gjatë e mbyllur angleze /o:/, në rastet më të shpeshta, zëvendësohet me /o/ të shqipes, p.sh.:

crawl [kro:l] > krol [krol],
football [‘futbo:l] > futboll [fut’bol],
Austin [‘o:stin] > ostin [os’tin] etj.

b) Nën ndikimin e shkrimit kjo fonemë angleze zëvendësohet me /or/ të shqipes:

corner [‘ko:nə] > kornër [kor’ner],
lord [lo:d] > lord [lord],
Ford [fo:d] > Ford [ford] etj.

c) Por ortografia angleze, në disa raste, ndikon që të ndërrohet struktura fonemike e huazimit. Kështu ekziston zëvendësimi i /o:/ me /a/ shqipe, p.sh.:

water [‘wo:tə] > vater [‘vater],
waterpolo [‘wo:təpuələu] > vaterpolo [vater’polo].

8. Zanozja e shkurtër e hapur e anglishtes /u/ zëvendësohet me /u/ të shqipes, e cila është shumë e ngjashme me të parën, p.sh.:

pudding [‘puɪŋ] > puding [pu’ding],
football [‘futbo:l] > futboll [fut’bol],
Eastwood [‘i:stwu:d] > Istvud [ist’vud] etj.

9. Fonema angleze e mbyllur e gjatë /u:/ zëvendësohet me /u/ të

gjuhës shqipe, p.sh.:

boom [bu:m] > bum [bum],

shoot [ʃu:t] > shut [ʃut],

Cooper [ˈku:pə] > Kuper [ku'per] etj.

10. Zanorja qendrore e shkurtër e anglishtes /ʌ/ nuk ekziston si fonemë në sistemin fonologjik të gjuhës shqipe. Prandaj me rastin e përshtatjes së huazimeve angleze në shqipe është zëvendësuar me disa fonema të ndryshme:

a) Më së shumti është zëvendësuar me /a/:

summit [ˈsʌmit] > samit [sa'mit],

upercur [ˈʌpəkʌt] > aperkat [aper'kat],

Douglas [ˈdʌgləs] > Daglas [da'glas] etj.

b) Në një numër bukur të madh huazimesh, zëvendësimi i kësaj foneme angleze bëhet në mbështetje të shkrimit të huazimeve:

dumping [ˈdʌmpɪŋ] > dumping [dum'ping],

jungle [ˈdʒʌŋgl] > xhungël [ˈdʒungəl],

trust [trʌst] > trust [trust] etj.

c) Në disa huazime fonema e anglishtes /ʌ/ zëvendësohet me /e/ të shqipes:

jumper [ˈdʒʌmpə] > xhemper [dʒem'per],

rugby [ˈrʌɡbi] > regbi [ˈregbi],

Dunlop [ˈdʌnlɒp] > Denlop [den'lop] etj.

Përshtatja e këtillë është bërë në gjuhën ndërmjetëse, domethënë në serbokroatishte, gjermanishte etj.³²

ç) Korpusi ynë na jep edhe zëvendësimin e /ʌ/ angleze, me /o/ të shqipes, rast që bën përjashtim nga të tjerat, p.sh.:

bluff [blʌf] > blof [blof].

Kjo formë e zëvendësimit zbatohet vetëm në Shqipëri, kurse në gjuhën shqipe në Kosovë e Maqedoni përdoret trajta *blef*, e cila ka pësuar ndikim të gjuhës serbe, përkatësisht maqedonase, nëpër të cilat ka arritur në gjuhën shqipe. Kjo do t'i përkiste rastit nën c) këtu më sipër.

11. Për zanoren qendrore të gjuhës angleze /ə:/, për shkak se nuk ka ekuivalent në gjuhën shqipe, bëhen zëvendësime të ndryshme. Në të shumtën e rasteve gjuha marrëse gjen si rrugë më të lehtë dhe zgjidhje më të thjeshtë të vijoje shkrimit e huazimit në trajtën origjinale.

a) Ka fjalë të cilat, sipas shkrimit të tyre në trajtën origjinale,

³² R. Filipović, *Phonemic Importation...*, 1960-2, f. 41.

këtë fonemë e zëvendësojnë në gjuhën shqipe me /er/, p.sh.:

detergent [de'tə:dʒənt] > deterxhent [deter'dʒənt],

sterling ['stə:liŋ] > sterling [ster'liŋ],

Bert [bə:t] > Bert [bert] etj.

b) Nën ndikimin e shkrimit të fjalës bëhet edhe zëvendësimi i kësaj foneme me /ir/ në shqipe:

flirt [flə:t] > flirt [flirt],

Birmingham ['bə:miŋəm] > Birmingham [birmin'gem],

Kirby ['kə:bi] > Kirbi ['kirbi] etj.

c) Kemi hasur nga një shembull edhe të këtyre llojeve të zëvendësimit të bërë sipas shkrimit të huazimeve angleze:

1. /ə:/ > /ar/: furlong ['fə:lɒŋ] > farllong [far'long],

2. /ə:/ > /or/: Hayworth ['heiwə:θ] > Hejvorth [hej'vorθ],

3. /ə:/ > /ur/: Melbourne ['melbə:n] > Melburn [mel'burn].

ç) Në fund, ekziston edhe zëvendësimi i fonemës angleze /ə:/ me kombinimin /ər/ të shqipes, natyrisht, nën ndikimin e shkrimit, por që konsiderojmë se është forma më e përafërt e shqiptimit, pra, mënyra më adekuate e përshtatjes. P.sh.:

sir [sə:] > sër [sər],

sterling ['stə:liŋ] > sterling [ster'liŋ],

Firwood ['fə:wud] > Fërvud [fër'vud] etj.

Nga shembujt e cekur më sipër, mund të shihet se shqipja ka prirje që sa më shumë t'i afrohet shqiptimit origjinal. Kështu, f. v., emri *Birmingham* shkruhet edhe *Birmingham* edhe *Bërmिंगem*; përveç formës *flirt*, haset edhe forma *flert*, gjë që vë haptas në dukje atë përpjekje, pse /e/ është më afër zanores qendrore /ə:/, sidomos për nga shkalla e ngritjes. Përpjekje edhe më e madhe për shqiptimin e drejtë të huazimeve angleze vërehet nga shembujt që i shënuam nën zëvendësimin e fonemës /ə:/. Me të janë shfrytëzuar të gjitha mundësitë fonemike që i ka gjuha shqipe për përshtatjen sa më të mirë, meqë në këtë gjuhë, përveç zanores së shkurtër qendrore /ə/, nuk ka asnjë fonemë tjetër, e cila do të ishte më afër fonemës angleze /ə:/.

Emri *Birmingham* duhet dhe mund të transkriptohej me *Bërmिंगem* ose *Bërmिंगam*, ndërsa fjala *flirt* të shkruhet *flërt*. Rasti i parë do të ishte krejtësisht i natyrshëm në gjuhën shqipe, meqë theksi nuk bie në rrokjen ku është fonema /ə/ në trajtën shqipe, si dhe tek emrat e tjerë shqip: përmendore, ndërmarje etj. Edhe trajta *flërt* nuk do të paraqiste rast jashtë rregullave të shqipes, sepse në këtë gjuhë ka fjalë njërrrokëshe me zanoren /ə/, siç janë: dëm, bën, zë etj.

Në këtë mënyrë këto fjalë dhe të ngjashme do t'i afroreshin deri në maksimum shqiptimit origjinal të huazimeve, kurse nga ana tjetër, nuk do të ishin në kundërshtim me natyrën e gjuhës shqipe.

12. Veçanërisht është interesant zëvendësimi i zanores qendrore të shkurtër të anglishtes /ə/ në shqipe. Në këtë rast, gjuha shqipe e ka këtë fonemë, e cila është mjaft e ngjashme dhe mund të thuhet se është ekuivalent i /ə/ angleze. Megjithatë, ajo fonemë gati në 99% të rasteve nuk është zëvendësuar me /ə/ shqipe. Është vështirë të thuhet me siguri se cili është shkaku i vërtetë i kësaj të dhëne, por duket se ekzistojnë disa faktorë që kanë ndikim në të.

Së pari, e dhëna se në shumë raste fonema /ə/ në huazimet angleze është në rrokjen në të cilën bie theksi, kur huazimi bëhet pjesë e inventarit leksikor të gjuhës shqipe. Theksi, sipas natyrës së vet, sidomos ai në gjuhët dinamike, siç është shqipja, kërkon që zanorja ku ai bie, të jetë e fuqishme, më e gjatë dhe më e qartë, sesa zanoret e tjera ose, së paku, të ketë një rënë nga këto cilësi. Zanorja /ə/ nuk ka asnjë rënë nga tiparet e cekura më sipër, prandaj nuk parapëlqehet të qëndrojë në rrokjen e theksuar në fjalët me mbi një rrokje, nëse ka mundësi të përgjidhet ndonjë zanore tjetër. Për shembull:

corner [ˈko:nə] > kornër [korˈnɛr],
 detector [diˈtektə] > detektor [detekˈtɔr],
 gallon [ˈgælən] > gallon [gaˈlon] etj.

E dyta, shkaku pse fonema e anglishtes /ə/ në një numër huazimesh nuk zëvendësohet me /ə/ të shqipes, është se në të ka ndikim edhe gjuha ndërmjetëse, në të cilën deri diku formohet trajta dhe shqiptimi i huazimit, e kjo bëhet sipas sistemit fonemik të asaj gjuhe. Kjo ndodh aq më shpesh, nëse gjuha ndërmjetëse nuk e ka fonemën /ə/ në sistemin e saj fonemik.

E treta, në zëvendësimin e fonemës /ə/ në disa huazime angleze në gjuhën shqipe ka ndikim të madh edhe shkrimi i fjalëve angleze, sipas të cilit mjaft shpesh bëhet përshtatja fonemike në gjuhën shqipe. Materiali ynë i grumbulluar ofron bukur shumë raste të zëvendësimit të tillë.

a) Një numër i madh i rasteve tregon zëvendësimin e fonemës /ə/ angleze me /a/ të shqipes sipas shkrimit:

slogan [ˈsləʊgən] > slogan [sloˈgan],
 taboo [təˈbu:] > tabu [taˈbu],
 Donald [ˈdɒnəld] > Donald [doˈnald] etj.

b) 1. Në mënyrë të ngjashme si më sipër është bërë zëvendësimi i /ə/ angleze me /e/ të shqipes:

detergent [di'tə:dʒənt] > deterxhent [deter'dʒənt],
 happening ['hæpənɪŋ] > hepening [hepe'ning],
 Lawrence ['lo:rəns] > Lorens [lo'rens] etj.

b) 2. Ka raste kur zëvendësimi i kësaj foneme është bërë me /e/ të shqipes, që nuk është pasojë e ndikimit të shkrimit të huazimit anglez:

congressman ['kɒŋɡresmən] > kongresmen [kongres'men],
 businessman ['biznismən] > biznismen [biznis'men],
 Ashbury ['æʃbəri] > Ashberi [eʃ'beri] etj.

c) Nën ndikimin e shkrimit të huazimeve angleze është bërë edhe zëvendësimi i fonemës në fjalë me /o/ të shqipes, p. sh.:

nylon ['nailən] > najlon [naj'lon],
 Ashton ['æʃtən] > Eshton [eʃ'ton],
 Harold ['hærəld] > Harold [ha'rold] etj.

ç) Ekziston, po ashtu, zëvendësimi i kësaj foneme me grupin /ar/ në gjuhën shqipe:

dollar ['dɒlə] > dollar [do'lar],
 Edgar ['edgə] > Edgar [ed'gar],
 Richard ['ritʃəd] > Riçard [ri'tʃard] etj.

d) Numri më i madh i rasteve të zëvendësimit të fonemës /ə/ të anglishtes paraqitet në shqip me grupin /er/, për shkak të shkrimit, p.sh.:

boxer ['bɒksə] > bokser [bok'ser],
 tanker ['tæŋkə] > tanker [tan'ker],
 Fisher ['fiʃə] > Fisher [fi'jer] etj.

dh) Kjo fonemë e anglishtes, nën ndikimin e shkrimit, haset e përshtatur në shqipet me grupin /or/:

humour ['hju:mə] > humor [hu'mor],
 tractor ['træktə] > traktor [trak'tor],
 Oxford ['ɒksfəd] > Oksford [oks'ford] etj.

Ekzistojnë edhe këto raste të zëvendësimit të kësaj foneme nën ndikimin e shkrimit të huazimeve:

e) Fonema /ə/ me grupin /ir/ të shqipes:

Virginia [və'dʒiniə] > Virxhinia [virdʒi'nia],
 Yorkshire ['jɒkʃə] > jorkshir [jork'ʃir].

ë) Fonema angleze /ə/ me fonemën /u/ të shqipes:

omnibus ['ɒmnibəs] > omnibus,
 campus ['kæmpəs] > kampus [kam'pus].

f) 1. Në fund, është bërë edhe zëvendësimi, i cili më së shumti i afrohet shqiptimit origjinal: /ə/ me grupin /ə/, p.sh.:

mister [ˈmɪstə] > mistër [ˈmɪstər],³³
 pull-over [ˈpʊləʊvə] > pulovër [pʊlˈovər],
 Gloucester [ˈgləʊstə] > Glostër [ˈglɒstər] etj.

f) 2. Në shembujt vijues është bërë zëvendësimi i /ə/ angleze me grupin /ər/ pa ndonjë ndikim të madh të shkrimit, p.sh.:

acre [ˈeɪkə] > akër [ˈakər],
 fibre-glass [ˈfaɪbəɡlaːs] > fibërglas [fɪbərˈglas].

Dy mënyrat e fundit të zëvendësimit të fonemës angleze /ə/, përkatësisht të zëvendësimit me grupin /ər/, i konsiderojmë si më adekuate, sepse më mirë se me mënyrat e tjera janë shfrytëzuar mundësitë për t'iu afruar shumë mënyrës së shqiptimit anglez të formës së cekur.

Në fund, pasi i analizuam mënyrat e zëvendësimit të kësaj foneme angleze, do të provojmë të themi edhe mendimin tonë lidhur me to.

Ndonëse gjuha shqipe e ka fonemën /ə/ në sistemin e saj fonemik, bukur shumë e ngjashme me atë angleze dhe do të mund ta zëvendësonte pa ndryshime të mëdha cilësore, kjo nuk është bërë. Mendojmë se e vetmja mënyrë e mundshme për zëvendësimin e fonemës angleze /ə/ në pozitë fundore të fjalëve të shqipes është me grupin /ər/, e jo me /ə/.

Mirëpo, jemi bindur se në disa raste, sidomos kur fonema /ə/ në huazimet angleze gjendet në pozitën mesore të fjalëve, ajo mund dhe duhet të zëvendësohet me /ə/ të gjuhës shqipe, për shkak se në atë mënyrë shqiptimi i saj në shqipe do t'i afrohej më së shumti shqiptimit të anglishtes. Përndryshe, duket se kjo tendencë është e pranishme në gjuhë në përgjithësi, e po ashtu edhe në shqipet. Kështu, fjalët vijuese do të dukeshin si vijon:

bungëlou në vend të *bungalou*,
komënuelth në vend të *komonuelth*,
pentëgon në vend të *pentagon*,
Bretënvud në vend të *Bretonvud*,
Kantërberi në vend të *Konterberi* etj.

13. Fonema e shqipes /y/, e cila sipas klasifikimit tonë të ngjashmërive dhe dallimeve i përket grupit të katërt të fonemave, meqë nuk ka ekuivalent përkatës në gjuhën angleze, nuk është integruar në asnjë huazim anglez të korpusit tonë në gjuhën shqipe.

(b) Zëvendësimi i diftongjeve angleze

U tha më herët se gjuha shqipe nuk ka diftongje fonologjike, po

³³ Shpëtohet edhe mister [mɪsˈtɛr].

vetëm fonetike. Diftongjet e anglishtes, pra, zëvendësohen me diftongjet fonetike të shqipes. Mirëpo, ai zëvendësim nuk vijon në mënyrë konsekuente atë rrugë, prandaj nganjëherë zëvendësohen me zanore, siç do të shohim nga shembujt.

1. a) Diftongu i anglishtes /ei/ në disa raste zëvendësohet me grupin /ej/ të shqipes, p.sh.:

baseball [ˈbeisbo:l] > bejzboll [bejzˈbol],
 long-play [ˈlɒŋplei] > longplej [lɒŋˈplej],
 David [ˈdeivid] > Dejvid [dejˈvid] etj.

b) Në një numër bukur të madh huazimesh diftongu /ei/ i anglishtes zëvendësohet me zanoren /e/ të shqipes:

cake [keik] > kek [kek],
 lady [ˈleidi] > ledi [ˈledi],
 Davis [ˈdeivis] > Devis [ˈdevis] etj.

c) Në zëvendësimin e këtij diftongu ka ndikim edhe shkrimi i huazimeve angleze, prandaj bëhet zëvendësimi /ei/ > /a/:

cambric [ˈkeimbrik] > kambrik [kamˈbrik],
 favourite [ˈfeivərɪt] > favorit [favoˈrit],
 David [ˈdeivid] > David [daˈvid] etj.

2. a) Diftongu i anglishtes /ai/, në të shumtën e rasteve zëvendësohet me grupin /aj/ të shqipes, p.sh.:

combine [ˈkɒmbain] > kombajn [komˈbajn],
 sniper [ˈsnaɪpə] > snajper [snajˈper],
 Mike [maɪk] > Majk [majk] etj.

b) Nën ndikimin e shkrimit janë edhe këta shembuj të zëvendësimit /ai/ > /i/:

cyclone [ˈsaɪklən] > ciklon [cikˈlon],
 fibre-glass [ˈfaɪbəglɑ:s] > fibërglas [fībërˈglas],
 Iceland [ˈaɪslənd] > Islandë [isˈlandə] etj.

3. a) Gati të gjitha huazimet angleze, të cilat në vete kanë pasur diftongun /au/, e kanë zëvendësuar atë me diftongun e shqipes /au/:

clown [klaun] > klaun [klaun],
 out [aʊt] > aut [aut],
 Capetown [ˈkeɪptaʊn] > Kejptaun [kejɔˈtaun] etj.

b) Nën ndikimin e shkronjës angleze *w*, që në gjermanisht shqiptohet /v/ dhe ka trajtë të ngjashme me *v*, disa huazime angleze me diftongun /au/ të paraqitur në shkrim me *ow*, e bëjnë zëvendësimin e /au/ > /ov/, p.sh.:

clown [klaun] > klovn [klovn],
 cowboy [ˈkauboi] > kovboj [kovˈboj].

c) Diftongu /au/ i anglishtes zëvendësohet me /u/ në këta shembuj:

ounce [auns] > unsë [ˈunsə],
 Round [raund] > rund [rund].

4. Diftongu anglez /əu/ i përket grupit të dytë të klasifikimit të fonemave sipas dallimeve dhe ngjashmërive në mes dy gjuhëve. Ai mund të dëgjohet, jo aq shpesh, në urdhëroren e vetës së dytë njëjës të disa foljeve në të folmen jostandarde të shqipes: çou, zgjou etj. (pa /h/ epitentike).

a) Meqë diftongu ou është i rrallë në gjuhën shqipe, ky diftong i anglishtes rrallë zëvendësohet me diftongun përkatës të shqipes. Kemi hasur në disa shembuj vetëm të përshtatjes së emrave të njerëzve dhe të emrave gjeografikë me anë të transkriptimit praktik. Për shembull:

Glasgow [ˈgla:sgəu] > Glazgou [glazˈgou],
 Hope [həup] Huop [houp],
 Pope [pəup] > Poup [poup] etj.

Zëvendësimi i /əu/ së anglishtes me /ou/ të shqipes është një dukuri e re. Ky zëvendësim po zhvillohet ngadalë. Për këtë ndoshta janë të nevojshme kushte të veçanta, para së gjithash, njohja e gjuhës angleze nga masat, sidomos nga ana e gazetarëve, shkrimtarëve dhe punëtorëve të tjerë publikë.

b) Analiza e korpusit ka treguar se ka më së shumti zëvendësime të diftongut /əu/ me zanoren e shqipes /o/, për shkak të ndikimit të ortografisë angleze, p.sh.:

goal [gəul] > gol [gol],
 joker [ˈdʒəukə] > xhoker [dʒoˈker],
 Soams [ˈsəumz] > Soms [ˈsoms] etj.

Me rastin e zëvendësimit të fonemave të fjalës folklore [ˈfauklo:] > folklor [folˈklor], mbështetur në shkrimin e fjalëve angleze, në shqipet paraqitet edhe /l/ e shurdhër e anglishtes e cila nuk shqiptohet në gjuhën dhënëse.

Fjala *gol* në ligjërimin e përditshëm, veçanërisht në Kosovë, shqiptohet [go:l]. Kjo do të thotë se me kuantitetin e zanores tentohet t'i afrohet shqiptimit origjinal të kësaj fjale në anglishte, meqë zanorja e gjatë gjithësesi është më e afërt me diftongun sesa është zanorja e shkurtër. Mirëpo, nuk mund të thuhet me siguri sa është kjo përpjekje e vetëdijshme e masës që e shqipton fjalën gol ashtu. Ka më shumë gjasë që folësit e tillë t'i kenë dhënë kësaj fjale gjininë gramatikore femërore, dhe si e tillë ajo të ketë marrë atë shqiptim.

c) Nën ndikimin e shkrimit, në disa raste është bërë zëvendësimi i diftongut /əu/ me //ov/, p.sh.:

bungalow [ˈbʌŋgələu] > bungalow [bungaˈlov],

Glasgow [ˈglɑːsgəu] > Gllazgov [glazˈgov].

5. Diftongu i anglishtes /oi/ zëvendësohet në shqipet me [oj]:

boiler [ˈboilə] > bojler [bojˈler],

convoy [ˈkonvoi] > konvoj [konˈvoj],

Joyce [dʒoɪs] > Xhojs [dʒoɪs] etj.

6. Zëvendësimi i diftongut të anglishtes /iə/ në gjuhën shqipe bëhet në disa mënyra:

a) Ai zëvendësohet me /ir/, në bazë të shkrimit, p.sh.:

Devonshire [ˈdevənʃiə] > Devonshir [devonˈʃir],

Hampshire [ˈhæmʃiə] > Hampshir [hampˈʃir],

Wiltshire [ˈwiltʃiə] > Uiltshir [uiltˈʃir] etj.

b) Ky diftong, nën ndikimin e shkrimit, zëvendësohet me /io/ të shqipes:

trade union [ˈtreɪdˈjunɪən] > tredjunion [tredjuˈnion],

Albion [ˈælbɪən] > Albion [alˈbion].

c) Në material kemi hasur edhe zëvendësimin e /iə/ të anglishtes me /i/ të gjuhës shqipe:

clearing [ˈkliəriŋ] > kliring [kliˈring],

Shakespearian [ˈʃeɪksˈpiəriən] > shkespirian [ʃekspiˈrian].

7. a) Diftongu i gjatë qendror i anglishtes /eə/, bën zëvendësimin në gjuhën shqipe kryesisht me grupin /er/, p.sh.:

fair [fɛə] > fer [fer],

Flair [flɛə] > Fler [fler],

Irwell [ˈɛəwel] > Eruell [erˈuel] etj.

b) Mirëpo, haset edhe zëvendësimi me /e/ të shqipes:

Mary [ˈmɛəri] > Meri [ˈmeri],

Maryland [ˈmɛəriˌlænd] > Merilend [meriˈlend].

8. Përshtatja e diftongut /uə/ të anglishtes bëhet kryesisht në mbështetje të shkrimit të huazimit anglez, p. sh.:

Stewardess [ˈsjuːədɪs] > stjuardesë [stjuarˈdesə],

Samuel [ˈsæmjuel] > Semjuel [semˈjuel].

Proces më të ndërlikuar dhe më interesant për gjuhësi paraqesin fonemat, të cilat, sipas ndarjes sonë të ngjashmërive dhe dallimeve, i përkasin grupit të tretë. Përshtatja dhe zëvendësimi i atyre fonemave është me interes për ne, meqë ato nuk ekzistojnë në sistemin fonologjik të gjuhës

shqipe. Pra, ato nuk kanë ekuivalente në gjuhën marrëse. Gjatë përshtatjes së tyre ekziston një larmi dhe zëvendësohen shumë lirisht me fonemat e gjuhës shqipe. Ai zëvendësim ndonjëherë nuk ka kurrfarë lidhjeje me shqiptimin e fjalëve të anglishtes. Po qe se ka mundësi, në ato raste vijohet sipas shkrimit të huazimeve angleze, kështu që fjalët e tilla shqiptohen sipas rregullave të shkrim-shqiptimit të gjuhës shqipe. Në ato raste, në shqiptim paraqiten edhe disa fonema të shurdhra të anglishtes.

(c) Zëvendësimi i bashkëtingëlloreve

Bashkëtingëlloret përshtaten kryesisht duke u zëvendësuar me ekuivalente ose me fonema të ngjashme të gjuhës shqipe, prandaj nuk e shohim të udhës të ndalemi veç e veç për çdo fonemë-bashkëtingëllore. Do të flasim për ato raste kur, për një arsye ose për një tjetër, fonemat angleze nuk zëvendësohen me fonemat përkatëse të shqipes dhe për ato të cilat nuk kanë ekuivalente në gjuhën shqipe, domethënë për fonemat-bashkëtingëllore, të cilat i përkasin grupit të tretë, sipas klasifikimit të mësipërm, duke dhënë shembuj për çdo rast të tillë. Do të flitet edhe për tipare e dukuri të tjera fonetike të fonemave-bashkëtingëllore, po qe se ato paraqiten.

1. Okluzivi i pazëshëm dental /t/ përveç me /t/, nganjëherë zëvendësohet edhe me frikativin ndërthëmbor të pazëshëm të shqipes /θ/, dhe kjo, pa dyshim, nën ndikimin e shkrimit, p.sh.:

Thomas [ˈtoməs] > Thomas [θoˈmas].

2. Një nga bashkëtingëlloret e anglishtes, që nuk ekzistojnë në sistemin fonologjik të gjuhës shqipe si fonemë, është grykorja hundore /ŋ/. Kjo fonemë, në të vërtetë, ekziston në dialektin gegë të shqipes. Në gjuhën standarde ajo është vetëm alofon i fonemës /n/. Ky alofon realizohet kur fonema /n/ u paraprin fonemave /g/ ose /k/ në fjalë. Meqë nuk ekziston si fonemë në gjuhën letrare marrëse, kjo fonemë bën zëvendësimin sipas shkrimit, domethënë me grupet /ng/ ose /nk/, p.sh.:

parking [ˈpa:kiŋ] > parking [parˈking],

pingpong [ˈpiŋpɔŋ] > pingpong [pingˈpɔŋ],

tanker [ˈtæŋkə] > tanker [tanˈker] etj.

3. Laterali alveolar i anglishtes /l/ bën shpesh zëvendësimin me likuidin alveolar të shqipes /l/:

leader [ˈli:də] > lidër [ˈlidër], po edhe: lider [liˈder],

slogan [ˈslɔʊgən] > slogan [sloˈgan],

Liverpool [ˈlivəpu:l] > Liverpool [liverˈpul] etj.

Sistemi fonologjik i shqipes ka dy likuide: alveolarin /l/ dhe alveopalatalin /ll/. Këto likuide, me tiparet e tyre, nuk përputhen në të dy gjuhët, duke pasur parasysh edhe alofonin e anglishtes /l/. Na duket se likuidi i shqipes /λ/ është shumë më i hapur se ai i anglishtes. Kështu, na duket se likuidet e anglishtes ndodhen diku midis dy likuideve të shqipes. Duke marrë për bazë variantin e hapur dhe atë të mbyllur si dy anë të kundërta ose më të largëtat në mes vete, likuidet e dy gjuhëve do t'i paraqitnim kështu:

anglisht:/l/...../l/.....

shqip: /λ/...../l/

Mund të shihet se likuidet e anglishtes ndodhen diku në mes të atyre të shqipes.³⁴ Prandaj edhe në huazimet angleze bëhet shpesh zëvendësimi i dyfishtë i likuideve, meqë është e njëjta distancë nga njëri likuid i shqipes dhe tjetri. Zëvendësimi i kësaj foneme do të dukej kështu:

[λ]

[l]

[l]

Duhet theksuar se zëvendësimi i kësaj foneme është bërë pa ndonjë parim të caktuar, me dy fonemat e shqipes, p.sh.:

clown [klaun] > kloun [kλoun], po edhe klloun [kloun],

college [ˈkolidʒ] > kolexh [koˈλedʒ], po edhe kollexh [koˈledʒ],

hall [ho:l] > hol [hoλ], po edhe holl [hol] etj.

Në zëvendësimin e fonemës angleze [l] ka ndikim mjaft të madh edhe shkrimi i huazimeve, p.sh.:

dollar [ˈdɒlə] > dollar [doˈlar],

football [ˈfʊtbɔ:l] > futboll [futˈbol],

film [film] > film [fɪλm],

goal [gəʊl] > gol [gol] etj.

4. Dentali frikativ i pazëshëm /θ/, pos zëvendësimit me interdentalin e shqipes /θ/, shpesh ndodh të bëjë zëvendësimin me okluzivin /t/, p.sh.:

Bertha [ˈbɛ:θə] Berta [ˈberta],

Catherin [ˈkæθrin] > Ketrin [ketˈrin],

Heath [hi:θ] > Hit [hit] etj.

Fonema /θ/ nuk është paraqitur në asnjë rast të pozitës nistore të huazimeve angleze në gjuhën shqipe.

³⁴ Nuk jemi plotësisht të sigurt për këtë, sepse në këtë të dhënë kemi ardhur në mbështetje të përshkrimit të kësaj foneme në të dy gjuhët, ndërsa nuk kemi pasur ndonjë instrument për të matur, i cili do të ishte konstatim më i sigurt.

5. Në gjuhën shqipe nuk kemi hasur në asnjë huazim anglez me fonemën /z/ në pozicionin nistor.

6. Nuk gjendet asnjë huazim anglez në gjuhën shqipe me fonemën /ʒ/ në asnjë pozicion të fjalës. Ndonëse në ndonjë fjalë të origjinës angleze gjendet kjo fonemë, ajo është imponuar nga gjuha shqipe e nuk është prodhim i trajtës origjinale, si f.v.: *buldozher*, në vend se *buldozer*; *zhungël* në vend se *xhungël*; *pizhamë* në vend se *pixhamë* etj.³⁵

7. Frikativi postalveolar i anglishtes /r/ zëvendësohet në gjuhën shqipe me të vetmin ekuivalent – me vibrantin alveolar /r/, i cili ka një mënyrë tjetër të artikulimit. Mirëpo, meqë nuk ka fonemë tjetër më të afërt, në gjuhën shqipe, ajo zëvendëson këtë frikativ postalveolar anglez, p.sh.:

ring [riŋ] > ring [ring],

trainer [ˈtreinə] > trener [trejˈner],

Raider [ˈreidə] > Reder [reˈder] etj.

Fonema /r/ e anglishtes mund të zëvendësohet edhe me fonemën /r̥/ - (rr) të shqipes, e cila nuk ekziston në gjuhën dhënëse, dhe kjo bëhet sipas hiperdiferencimit të fonemave.

Kjo fonemë nuk është ndeshur në asnjë huazim anglez në pozicionin fundor. Paraqitja e saj në pozicion fundor të fjalëve angleze në gjuhën shqipe është imponuar me ndikimin e shkrimit origjinal të huazimeve angleze.

8. Fonema /h/ e anglishtes nuk është hasur në asnjë huazim anglez të pozicionit mesor dhe fundor.

9. Afrikatet postalveolare të anglishtes /tr/ dhe /dr/,³⁶ meqë nuk kanë ekuivalente as ndonjë fonemë të afërt në shqipet, zëvendësohen kryesisht me togjet bashkëtingëllore /tr/, respektivisht (dr), të cilat në gjuhën shqipe përbëhen nga dy fonema (t+r), respektivisht (d+r).

foxtrot [ˈfokstrot] > fokstrot [foksˈtrot],

trainer [ˈtreinə] > trejner [trejˈner],

dribbling [ˈdribliŋ] > driblim [dribˈlim] etj.

Këto dy fonema nuk janë paraqitur në asnjë rast në pozicionin fundor të huazimeve angleze në gjuhën shqipe.

10. Për shkak se në disa vise të Kosovës dhe të Shqipërisë Veriore shqipfolësit nuk e dallojnë sa duhet afrikatin palataloalveolar /tʃ/ nga okluzivi /ç/, shpeshherë bëhet zëvendësimi i të parit me të dytin në huazimet angleze, ndonëse dihet se sistemi fonologjik i anglishtes nuk ka

³⁵ Shih për këtë edhe kur bëhet fjalë për zëvendësimin e fonemës /dʒ/.

³⁶ Këto nuk janë fonema standarde (brenda numrit 44) të anglishtes.

fonemë /č/. Kështu, pra, gjenden fjalë me dy forma në shqipet, nga të cilat, njëra është formë e drejtë e tjetra e gabuar, p.sh.:

Bromwich [‘bromwit] > Bromviç [brom’viç],
Ipswich [‘ipswit] > Ipsviç [ips’viç] etj.

11. a) Ajo që u tha për fonemën /t/ vlen edhe për zëvendësimin e /dʒ/ angleze. Mund të thuhet madje se kjo ka të bëjë edhe më shumë me bashkëtingëlloren /dʒ/. Kështu bëhet zëvendësimi i fonemës /dʒ/ me okluzivin /d/ në shqipet, i cili po ashtu nuk ekziston në sistemin fonologjik të anglishtes, p.sh.:

college [‘kolidʒ] > koleg [ko’leđ],
genteelness [dʒen’ti:lnis] > gjentilencë [dentilencə],
manager [‘mænɪdʒə] > menagjer [mena’đer] etj.

Duhet cekur se format e huazimeve me /d/ janë shumë më të rralla se ato me /dʒ/.

b) Sigurisht nën ndikimin e gjuhës frënge, e cila në sistemin e saj fonologjik nuk e ka fonemën /dʒ/, e meqë në gjuhën shqipe kanë hyrë shumë huazime angleze edhe nëpërmjet kësaj gjuhe, në disa fjalë paraqitet nganjëherë edhe zëvendësimi i /dʒ/ me /ʒ/, si p.sh.:

college [‘kolidʒ] > kolezh [ko’leʒ],
jersey [‘dʒə:si] > Zhersej [ʒer’sej],
jungle [‘dʒʌŋl] > zhungël [‘zʌŋël],
pyjama [pi’dʒa:mə] > pizhamë [pi’ʒamə] etj.

12. Një fonemë, që nuk ekziston në sistemin fonologjik të gjuhës shqipe, është gjysmëzanorja dybuzore /w/. Për këtë arsye kjo fonemë në huazimet angleze në gjuhën shqipe zëvendësohet me dy mënyra.

a) Mënyra e parë e zëvendësimit të saj është me frikativin labiodental të shqipes /v/:

sandwich [‘sændwit] > sendviç [send’vit],
waggon [‘wæɡən] > vagon [va’ɡon],
Quinn [kwɪn] > Kvin [kvin] etj.

b) Mënyra tjetër e zëvendësimit të /w/ është me zanoren e shqipes /u/.³⁷ Ky lloj, ndonëse është mënyra e normuar drejtshkrimore e transkriptimit në gjuhën shqipe, është më i rrallë në shqipen e folur e të shkruar në Kosovë e Maqedoni, p.sh.:

quiz [kwɪz] > kuiz [kuiz],

³⁷ Shih: *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, kapt. III, parag. 36 e 37, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1974.

squire [skwaɪə] > skuajër [skuajər],

Wales [weɪlz] > Uels [ueɫs] etj.

c) Gjysmëzanorja e anglishtes /w/ mund të zëvendësohet me zanoren e shqipes /u/, pos në ato raste kur kjo fonemë në huazimet e anglishtes gjendet para fonemës /u/, meqë një zëvendësim i tillë (dyfishimi i zanores /u/ do të ishte i papajtueshëm me natyrën e gjuhës shqipe), p.sh.:

Wood /wud] > Vud [vud].

Hollywood [ˈholiwud] > Holivud [holiˈvud],

Woolf [wulf] > Vullf [vulf] etj.

ç) Materiali i mbledhur tregon se zëvendësimi i /w/ me /v/ është bërë më shpesh, sesa me /u/.³⁸ Në këtë pikëpamje ekzistojnë dallime midis disa huazimeve nga gjuha angleze në shqipen e Shqipërisë dhe të Kosovës e të Maqedonisë. Përkatësisht, në Shqipëri është bërë më shumë zëvendësimi i kësaj foneme me fonemën /u/, sesa me /v/. Pos të tjerash, është për t'u cekur rasti i emrit gjeografik *Washington*, i cili në Shqipëri gjithnjë shkruhet Uashington, kurse në shqipet në ish-Jugosllavi, sidomos në gazetën "Rilindja" deri vonë shkruhej Vashington. Mirëpo, edhe në Shqipëri huazimet e kohës së mëhershme janë përforcuar me zëvendësimin e fonemës /w/ me /v/, p.sh.:

kilowatt [ˈkɪləwɒt] > kilovat [kiloˈvat],

tramway [ˈtræmwei] > tramvaj [tramˈvaj],

waterpolo [ˈwɔːtəpəʊləu] > vaterpolo [vaterˈpolo] etj.

d) Sa është i pasigurt zëvendësimi i fonemës /w/ tregon e dhëna se disa huazime të anglishtes, që kanë atë fonemë, e bëjnë zëvendësimin e saj me /v/ e herë me /u/. Në korpusin tonë gjenden disa fjalë me zëvendësimin e tillë të dyfishtë. Ja disa shembuj:

quiz [kwɪz] > *kviz* dhe *kuiz*,

week-end [ˈwi:kend] > *vikend* dhe *uikend*,

Edward [ˈedwəd] > *Edvard* dhe *Eduard*,

Wales [weɪlz] > *Vels* dhe *Uels* etj.

dh) Në fund, shtrohet pyetja se cila nga këto dy mënyra të përshtatjes, përkatësisht, të zëvendësimit të fonemës angleze /w/ është më e drejtë në gjuhën shqipe. Thamë se sipas vendit dhe mënyrës së shqiptimit, përkatësisht, artikulimit, fonema /w/ e anglishtes duket të jetë më e afërt me

³⁸ Huazimet nga anglishtja deri në vitet 1970 kishin hyrë në shqipen e folur e të shkruar në ish-Jugosllavi kryesisht nëpërmjet serbishtes e maqedonishtes, prandaj përshtatja e fonemës /w/ të anglishtes ishte bërë në ato gjuhë ndërmjetëse vetëm me fonemën /v/.

zanoren /u/ të shqipes, sesa me bashkëtingëlloren /v/. Ky fakt deri diku është i kuptueshëm, sepse fonema /w/ është gjysmëzanore. Mirëpo, përkundër këtij fakti, zëvendësimi i /w/ angleze me /v/ të shqipes del të jetë më i përshtatshëm, më praktik, për arsytet që po i theksojmë këtu më poshtë.

e) Në gjuhë pranohet roli i shkrimit i gjuhës dhënëse gjatë përshtatjes së fjalëve të huazuara në gjuhën marrëse. Kjo ka të bëjë sidomos me fonemën /w/ të anglishtes, e cila në shkrim i ngjan më shumë shkronjës v sesa shkronjës u. Ajo edhe quhet *dubël v* (ve). Në gjuhën gjermane shkronja w shqiptohet /v/. Në gjuhën shqipe ka depërtuar një numër huazimesh gjermane, që bëjnë të forcohet ndikimi i kësaj gjuhe dhënëse në të huazuarit në shqipet – me këtë edhe në zëvendësimin e fonemës /w/ me /v/.

ë) Fonema /w/ e anglishtes në shumë gjuhë të tjera, me rastin e përshtatjes fonemike, është zëvendësuar me fonemën /v/, si në gjermanishte, në frëngjishte, në gjuhët sllave etj. Ky fakt ndikon edhe në shqipen.

f) Kur fonema /w/ i paraprin zanores /u/, bëhet e pamundur të zëvendësohet me zanoren /u/, sepse si rrjedhojë do të krijonte një grup vokalik /uu/, që është kundër natyrës dhe praktikës së gjuhës shqipe. Domethënë se, po që se pranojmë rregullën e zëvendësimit të fonemës angleze /w/ me zanoren e shqipes /u/, këto raste do të ishin përjashtime.³⁹

g) Fonema e gjuhës shqipe /v/ është më pak e labializuar sesa /v/ e anglishtes, domethënë se dhëmbët e sipërm nuk e shtypin buzën e poshtme aq sa kjo bëhet në anglishte gjatë shqiptimit të asaj foneme, por shpesh vetëm e prekin. Kjo domethënë se ky tipar dallues fonetik midis /v/ shqipe dhe /v/ angleze tregon dallim, prandaj nga ky fakt del se dallimi është më i vogël midis /v/ shqipe dhe /w/ angleze, sesa midis /v/ dhe /w/ angleze. Kjo domethënë se fonema /v/ e shqipes deri diku i afrohet /w/ angleze, prandaj i jep të drejtë gjuhësore edhe për ta zëvendësuar e para të dytën.

gj) Jemi dëshmitarë të përvojës se gjatë të mësuarit të shqiptimit të fjalëve angleze, kur kemi vërejtur se nxënësit dhe studentët dhe të tjerët që mësojnë anglishten, para se të përvetësojnë shqiptimin e drejtë të fonemës /w/, shumica e tyre në fillim e shqiptojnë atë si /v/, e rrallëkush si /u/. Kjo deri diku tregon se në takimin e parë këtë fonemë të anglishtes /w/ shqipfolësi e sheh më shumë si /v/, sesa /u/.

h) Kjo fonemë e anglishtes në asnjë rast nuk mund të formojë rrokje në fjalët angleze, gjë që tregon se ajo nuk ka cilësi të zanores, së këndejmi

³⁹ Shih më sipër nën (c) Zëvendësimi i bashkëtingëlloreve, 12. c). Po ashtu: V. Nuhiu, *Shkrimi i disa fjalëve nga gjuha angleze*, Rilindja, 2.10. 1972. dhe *Rreth disa huazimeve*, Jehona, nr. 3/4, ff. 39-53, Shkup, 1975; botohet edhe në këtë përmbledhje.

del edhe emri i saj gjysmëzanore.

i) Dhe në fund, ajo që është mjaft e rëndësishme në gjuhësi, është se zëvendësimi i /w/ angleze me /u/ të shqipes, në disa huazime formon grupe vokalesh, të cilat paraqesin rishpërndarje të fonemave në gjuhën shqipe. Kjo domethënë që mënyra e zëvendësimit të /w/ me /u/, prek edhe sistemin fonologjik të shqipes në strukturën shumë të ndjeshme – duke shkaktuar rishpërndarje të fonemave. Kështu, për shembull, janë grupet zanore të krijuara vetëm në huazimet angleze:

- /ua/ - në Uashington (Washington),
- /ue/ - në uestern (western), uebsajt (web-site),
- /ui/ - në uikend (weekend), windouz (windows),
- /uo/ - në Uoll Strit (Wall Street), dhe trajtën e çoroditur:
- /uu/ - Uudrou (Woodrow), Holiuud (Holywood) etj.

Asnjë fjalë shqipe nuk fillon me asnjë nga grupet e tilla të zanoreve. Kjo domethënë se ato grupe zanoresh paraqesin risi (inovacion) që sillen me huazimet angleze në gjuhën shqipe. Ndërkaq në gjuhësi dihet e dhëna se risitë nuk përvetësohen pa vështirësi dhe rezistencë nga gjuha marrëse, e kjo sidomos ndodh kur është fjala për risitë në shpërndarjen e fonemave.

Nga e gjithë kjo del të jetë më i drejtë zëvendësimi i gjysmëzanosës angleze /w/ me /v/, sesa me /u/ të shqipes. Me këtë lloj zëvendësimi do të zgjidheshin të gjitha vështirësitë, që shkaktohen me zëvendësimin /w/ me /u/. Përndryshe do të nënkuptonte se shqipja duhet t'i hedhë të gjitha këto fakte dhe fakte të tjera si jorelevante dhe të pranonte të gjitha vështirësitë gjuhësore vetëm për të përvetësuar një mënyrë të zëvendësimit të kësaj foneme në gjuhën shqipe, që nuk ka kurrfarë mbështetje të fortë e të bindshme. Tekefundit, nuk është fare i sigurt supozimi se fonema /w/ e anglishtes qenka më afër zanores /u/, sesa bashkëtingëllores /v/ të shqipes. Ky parim sot qëndron vetëm me arbitrimin e rregullave të shkruara sipas Kongresit të Drejtshkrimit të vitit 1972. Masa shqipfolëse, në përgjithësi, nuk e pranon lehtë zëvendësimin e fonemës angleze /w/ me /u/ të shqipes.⁴⁰

⁴⁰ Për këtë kishim hartuar një tekst me disa huazime angleze me fonemën /w/, për të testuar se si e shqiptonin këtë fonemë të anglishtes shqipfolësit. Informatorët tanë (studentë të Degës së Gjuhës Shqipe të Fakultetit Filozofik të Prishtinës) fonemën /u/ e cila zëvendësonte fonemën angleze /w/, në të shumtën e rasteve e shqiptonin si /v/. Vetëm disa më pedantët e shqiptonin si /u/, por në aso mënyre që ishte shumë larg shqiptimit normal. Kur në bisedë, të cilën e kemi incizuar në shirit kasetofoni, i nxisnim bashkëbiseduesit të përdornin huazime angleze me fonemën /w/, asnjë informator nuk e shqiptoi si /u/, po vetëm si /v/ të shqipes.

(ç) Përfundim i zëvendësimit të tingujve

Me rastin e analizës së përshtatjes fonologjike e fonetike të huazimeve angleze në gjuhën shqipe kemi vërejtur se paraqiten disa dukuri gjuhësore, të cilat nganjëherë ndikojnë në ndryshimin e strukturës së fjalës. Këto dukuri shprehen në këto forma:

1. Shtimi i numrit të rrokjeve në disa huazime angleze, p.sh.:

farm [ˈfa:m] > farmë,
jungle [ˈdʒʌŋl] > xhungël,
Maible [ˈmeibl] > Mejbëll etj.

2. Disa zanore të huazimeve angleze humbin në gjatësi, p.sh.:

boom [bu:m] > bum,
leader [ˈli:də] > lider, lidër,
Bean [bi:n] > Bin etj.

3. Disa zanore të huazimeve fitojnë në kuantitet fonetik, p.sh.:

cup [kʌp] > kupë,
penalty [ˈpenəlti] > penalti,
taxi [ˈtæksi] > taksi etj.

4. Ndryshohet shumë cilësia e disa zanoreve angleze, p.sh.:

bulldozer [ˈbʌldəʊzə] > buldozer,
round [raʊnd] > rund,
Derbi [ˈda:bi] > Derbi etj.

5. Nën ndikimin e shkrimit të huazimeve paraqiten fonema të cilat më parë në historinë e gjuhës angleze kanë ekzistuar, kurse më vonë janë zhdukur, por ende qëndrojnë në shkrim, p.sh.:

folklor [ˈfəʊklo:] > folklor,
half [ha:f] > half.

Kjo çështja e fundit ka të bëjë sidomos me fonemën /r/ të shurdhët kur është në fund të fjalës ose pas zanores dhe para bashkëtingëllores vijuese brenda po të njëjtës fjalë, p.sh.:

bar [ba:] > bar,
sport [spo:t] > sport etj.

6. Nën ndikimin e shkrimit të anglishtes krijohen forma të panatyrshme, si p.sh.:

Bedger [ˈbedʒə] > Bedxher,
Bromwich [ˈbrɒmɪtʃ] > Bromyç etj.

Pasqyra e zëvendësimit të bashkëtingëlloreve angleze në huazimet angleze në gjuhën shqipe

	F	o	n	e	m	a	t	a	n	g	l	e	z	e									
	p	b	t	d	k	g	m	n	ŋ	l	f	v	s	ʒ	ʒ	θ	ð	r	h	tʃ	dʒ	w	j
F	p																						
o	b	x																					
n	t		+														+	+					
e	d			+																			
m	q																				*		
a	đ																					*	
t	k					+																	
s	m					x																	
h	n						x	*															
q	nj						*																
i	l								x														
p	ll								+														
e	f									x													
v																							*
s	z											x											
ʃ												*	x										
ʒ														x									*
θ																x							
j	h																		x				x
ç																					x		
r	rr																		+				
																			+				

Legjenda: x - ekuivalente; ± - e afërt; * - tjetër

(d) Zëvendësimi i theksit

Nga aspekti i theksit, gjuha angleze dhe ajo shqipe janë gjuhë me theks dinamik. Gjatë krahasimit të fonemave angleze me ato të shqipes, hetohet një tipar i përgjithshëm i shqiptimit të fonemave të njëres gjuhë dhe të tjetres. Përkatësisht, fonemat e njëres gjuhë dhe të tjetres artikuloohen qartë dhe të plota vetëm në rrokjet e theksuara, kurse në të patheksuarat një pjesë e tingullit reduktohet. Reduktimi shkon deri në zhdukje të plotë të disa fonemave.

Mirëpo, këto dy gjuhë dallojnë shumë sipas vendit të rrokjes së theksuar. Shqipja deri diku ka rregull të caktuar për vendin e theksit, ndërsa kjo nuk mund të thuhet për anglishten. Prandaj, vendi të cilin e ka marrë theksi pas përshtatjes së huazimeve angleze në gjuhën shqi-

pe, është një çështje e cila meriton kujdes të veçantë. Shumë me interes është të vërehen rastet kur theksi e ka ruajtur vendin e vet edhe pas integritimit të huazimeve në gjuhën shqipe.

Theksi i shqipes, në numrin më të madh të fjalëve, vihet në rrokjen e fundit të temës së emrave dyrrrokësh në trajtë të pashquar dhe në rrokjen e fundit të fjalëve me dy e më shumë rrokje. Këtë rregull fonetika e gjuhës shqipe e rekomandon si rregull, si normë standarde edhe për huazimet që hyjnë në të.⁴¹ Sipas gjendjes në korpusin tonë, sa i përket theksit, ka të drejtë Bevingtoni,⁴² kur thotë se theksi në gjuhën shqipe vihet mbi zanoren e fundit të rrënjës së fjalës. Analiza jonë ka treguar se vetëm 1/5 e huazimeve angleze me dy e më shumë rrokje e kanë theksin paroksiton, ndërsa 4/5 të tyre e kanë theksin oksiton.

Meqenëse huazimet angleze janë kryesisht emra dhe folje (ka pak edhe mbiemra), dhe ata emra janë shumica të gjinisë gramatikore mashkullore, e foljet janë marrë vetëm në veten e parë njëjës të kohës së tashme, mendojmë se ajo që është hasur, nuk paraqet gjendjen e vërtetë të gjuhës shqipe, sa i përket çështjes së vendit të theksit të fjalëve. Ajo që thamë për theksin, ka të bëjë vetëm me trajtat themelore – rrënjët – e fjalëve, ndërkaq theksi nuk është marrë parasysh në trajta paradigmatiche të fjalës.

Ndonëse sa i përket rrokjes mbi të cilën bie theksi në fjalë të gjuhës angleze dhe shqipe, këto dy gjuhë nuk përputhen, ekzistojnë edhe raste përjashtimi. Në disa huazime shumërrrokëshe ndodh që vendi i theksit të përputhet në të dy gjuhët. Kjo, pas mendimit tonë, mund të ndodhë në këto raste:

a) Nëse theksi në fjalët angleze është në rrokjen e fundit, ai nuk e ndërron vendin edhe kur ajo fjalë hyn si huazim në gjuhën shqipe, p.sh.:

antitank [ænti'tæŋk] > antitank [anti'tank],
bamboo [bæm'bu] > bambu [bam'bu],
design [di'zain] > dizajn [di'zajn],
McLane [mæk'lejn] > Maklejn [mek'lejn] etj.

b) Nëse theksi në fjalët angleze me mbi dy rrokje është në rrokjen e parafundit, atëherë ai nuk e ndërron vendin edhe kur ajo fjalë bëhet pjesë e inventarit të gjuhës shqipe si huazim, p.sh.:

anti-baby [ænti'beibi] > anti-bebi [anti'bebi],

⁴¹ A. Dodi, 1970, f. 99.

⁴² Gary Bevington, *Albanian Phonology*, PhD, Graduate School of the University of Massachusetts, USA, 1970, p. 26.

computer [kəm'pjutə] > kompjutër [kom'pjutër], por përdoret edhe trajta kompjuter [kompju'ter],

Chicago [ʃi'ka:gəu] > Çikago [tʃi'kago] etj.

Kjo rregull nuk mund të merret pa përjashtim, sepse ka fjalë shumërokëshe me theks mbi rrokjen e parafundit në anglishte, të cilat në gjuhën shqipe kanë ndërruar vendin e theksit në të fundit, p.sh.:

Bloomfieldian [blu:m'fi:ldiən] > Bloomfieldian [blumfiλ'dian],

detergent [di:'tə:dʒənt] > deterxhent [deter'dʒənt],

Elizabethan [i:lizə'bi:θən] > elizabetian [elizabe'tian] etj.

c) Nëse fjalët, përkatësisht, emrat dyrokësh përfundojnë në /i/, çka do të thotë se ato në shqipe janë integruar në gjininë gramatikore mashkullore, për analogji me emra të gjinisë mashkullore në trajtë të shquar, siç janë: hapi, lumi, mali etj. – theksi në ato fjalë bie në rrokjen a parafundit, ashtu siç bie edhe në fjalët angleze, p.sh.:

khaki ['ka:ki] > kaki ['kaki],

pony ['pəuni] > poni ['poni],

Billy ['bili] > Bili ['bi:li] etj.

Disa huazime, si *gini*, *ragbi* etj., kanë nganjëherë theksin në rrokjen e fundit: [gi'ni], [rag'bi]. Se në cilën rrokje do të bjerë theksi në këto dhe në këso fjalësh varet deri diku edhe nga fakti se në cilën gjini ato do të integrohen. Po qe se integrohen në gjininë gramatikore mashkullore, theksi do të bjerë, sigurisht, në rrokjen e parafundit, siç është rasti me shembujt e cekur më sipër. Por nëse integrohen në gjininë gramatikore femërore, zanorja e tyre e fundit, pa dyshim, do të jetë e theksuar dhe e gjatë: [gi'nī], [rag'bī], njësoj si edhe te huazimi i anglishtes [tak'sī], i cili, sigurisht, për analogji me fjalë të tjera të shqipes: saksi [sak'sī], tepsi [tep'sī] etj. – është integruar në gjininë femërore.

Në të gjitha rastet e tjera në huazimet e anglishtes në gjuhën shqipe theksi e ndërron vendin sipas rregullave të shqiptimit të fjalëve në gjuhën shqipe.

NDIKIMI I HUAZIMEVE ANGLEZE NË TOGJET BASHKËTINGËLLORE TË GJUHËS SHQIPE

Me rastin e të huazuarit gjuhësor në fonologjinë e gjuhës marrëse dalin dy forma të efektit strukturor: rishpërndarja dhe përbartja e fonemave.¹ Përvoja gjuhësore ka treguar se rishpërndarja e fonemave është dukuri krejt e natyrshme dhe haset në një numër të madh rastesh, kurse përbartja e fonemave është dukuri më e rrallë. Në këtë punim e kemi shqyrtuar vetëm çështjen e rishpërndarjes së fonemave në huazimet angleze në gjuhën shqipe.

Huazimet e gjuhëve të ndryshme kanë dhënë kontribut për pasurimin e shpërndarjes së llojllojshme të fonemave të gjuhës shqipe. Por këtu kemi shkoqitur vetëm efektet që janë rezultat i huazimeve angleze. Veçanërisht jemi përpjekur të gjejmë rezultatin që kanë dhënë huazimet angleze për të pasuruar togjet bashkëtingëllore të shqipes me ato të gjuhës angleze. Duhet të vihet në dukje që në fillim se ajo që kemi konstatuar për shpërndarjen e fonemave dhe rishpërndarjen e tyre nuk do të thotë se duhet të jetë e dhënë me fuqi të përhershme në gjithë shqipen. Disa nga të dhënat tona mund të kenë karakter të përkohshëm. Gjatë përshtatjes së fjalëve në sistemin fonologjik të shqipes, po pati mundësi, zhduken disa nga risitë që krijohen në ndikimin e huazimeve të anglishtes, meqë risitë në përgjithësi gjuha marrëse i pranon me vështirësi duke bërë rezistencë ndaj tyre.

Dukurinë e efekteve të togjeve bashkëtingëllore e kemi studiuar në tri pozitat e fjalëve: në fillim, në mes dhe në fund. Kemi ndjekur këtë rrugë: i kemi analizuar togjet bashkëtingëllore në të tri pozitat e huazimeve angleze sipas një korpusi të caktuar.² Pastaj i kemi analizuar togjet e bashkëtingëlloreve të shqipes në bazë të fjalorit.³ Pos kësaj, kemi krahasuar togjet e bashkëtingëlloreve të të dy gjuhëve dhe i kemi konstatuar dallimet.

Po ashtu ka mundësi që të ketë më shumë togje bashkëtingëllo-

¹ Einar Haugen, *The Analysis of Linguistic Borrowing*, Language, Vol. 26, No. 2, ff. 201-231, 1950.

² Vesel Nuhiu, *Fjalët angleze në gjuhën shqipe, analiza e tyre fonologjike*, Buletini, Fakulteti Filozofik i Prishtinës, nr. XI, ff. 267-314, 1973; po ashtu në këtë botim.

³ *Fjalori i gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 1965.

resh se që kemi gjetur ne, meqë fjalori i cekur më sipër nuk i përfshin të gjitha fjalët e gjuhës shqipe. Kjo vlen për të tri pozitat e fjalëve, po sidomos për grupet e bashkëtingëlloreve në mes të fjalëve, kur dihet se kjo çështje nuk është studiuar shumë në gjuhën shqipe.

Numrin dhe kombinimet e mundshme të togjeve bashkëtingëllore në pozitat nistore dhe fundore ka provuar t'i japë linguisti Leonard Newmark.⁴ Mirëpo, duhet të konstatohet se ai nuk ka pasur sukses të plotë në këtë çështje.⁵

Pos dallimeve në numër, që dalin midis analizës së Newmarkut dhe tonën, ekzistojnë dallime edhe në cilësi të togjeve bashkëtingëllore. Ky linguist amerikan shpesh e ka asgjësuar zanoren qendrore /ə/ në pozitën fundore të fjalëve, sigurisht për arsye se ashtu e ka dëgjuar nga informatorët e tij, prandaj togu fundor i bashkëtingëlloreve i ka dalë edhe atje ku ai në të vërtetë është mesor, p.sh.:

bursë [ˈbursə], tek ai është [burs],
 forcë [fortsə], tek ai është [forts],
 zhurmë [ˈzurmə], tek ai është [zurm] etj.

Në analizën tonë, siç u tha edhe më sipër, veçanërisht e ndërlikuar dhe jo e sigurt është çështja e togjeve të bashkëtingëlloreve në pozitën mesore. Kjo vjen nga se këtë çështje deri tani askush nuk e ka studiuar veçmas dhe, ngase këso togjesh ka shumë, e këtë çështje ne e kemi studiuar vetëm në fjalët e veçuara, të nxjerra nga fjalori.

Materiali i analizuar tregon se fjalët angleze në fillim hyjnë në gjuhën shqipe duke pasur parasysh shumë sistemin fonologjik të kësaj gjuhe. Këtë të dhënë e dëshmojnë fjalët më të reja që janë huazuar në gjuhën shqipe, siç janë: *mjuzikël*, *corporejshën*, *Bejls* etj. Po ashtu këtë fakt e vërtetojnë edhe disa fjalë të huazuara më herët, si b.f. *xhentëllmen*, të cilën e kemi hasur edhe *xhentllmen*. Kjo trajtë del nga folësi a shkruesi që e përdor fjalën e huaj për herë të parë, sidomos nëse e di gjuhën nga vjen huazimi, mundohet ta shqiptojë sa më ngjashëm me origjinalin. Format e cekura më sipër janë hasur nga disa herë në mediat në gjuhën shqipe, ndonëse hasen edhe në forma shumë më të përshtatura. Ato, pra, kanë nga dy ose më shumë forma, nga të cilat njëra është e huaj për sistemin fonologjik

⁴ Leonard Newmark, *Structural Grammar of Albanian*, The Graduate School of the Ohio State University and the Social Science Research Council, USA, 1957.

⁵ Më gjerësisht për këtë çështje: V. Nuhii, *Gramatika strukturale e shqipes nga Leonard Njemark* – vështrim, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, nr. 5, ff. 213-217, Fakulteti Filozofik i Universitetit të Prishtinës, Prishtinë, 1980; po ashtu në këtë botim.

të gjuhës shqipe dhe, pa dyshim, i përket periudhës së mëhershme të përshtatjes. Më vonë, të njëjtat elemente gjuhësore i përshtaten më shumë gjuhës marrëse dhe me këtë e kalojnë të ashtuquajturin kompromis fonetik dhe bëhen fjalë plotësisht të asimiluara.

Mirëpo, siç ndodh edhe me rastin e zëvendësimit të fonemave, këtu mund të vërehet se fjalët, të cilat përdoren nga njerëzit e shkolluar dhe shkencëtarët, janë më pak të përshtatura, përkatësisht, kanë më shumë elemente të huaja, sidomos togje bashkëtingëllore të huaja. Po qe se togu i tillë i bashkëtingëlloreve gjendet në huazimin anglez të futur në gjuhën shqipe edhe pas asimilimit të tij – këtë dukuri e konsiderojmë si risi në shpërndarjen e fonemave.⁶

Dukurinë e shpërndarjes së fonemave e kemi trajtuar njësoj, si në fjalët angleze plotësisht të asimiluara, edhe në ato që janë në përshtatje e sipër në gjuhën shqipe, meqenëse që të dy llojet e fjalëve përdoren me denduri gati të njëjtë. Sa më i rëndomtë dhe më i përdorur të jetë huazimi, aq më stabile dhe më e përcaktuar do të jetë pozita e togut të fonemave bashkëtingëllore në sistemin fonologjik.

Meqë shqipfolësit mund të kenë disa vështirësi për shqiptimin e disa togjeve bashkëtingëllore, të cilat janë të huaja për ta, ekzistojnë dy tendenca që kanë të bëjnë me togjet e bashkëtingëlloreve në huazimet e anglishtes.

Njëra është zbërthimi i togjeve me ndonjë zanore epentetike. Kjo zanore, në të shumtën e rasteve, është /ə/ e shqipes, për shembull:

gangster [ˈgæŋstə] > gangster,
gentlman [ˈdʒentlmən] > xhentëlmen,
jungle [dʒʌŋɡl] > xhungël etj.

Tendenca tjetër është reduktimi i togjeve bashkëtingëllore. Kjo ndodh më së shumti me togjet e bashkëtingëlloreve me më shumë se dy elemente në pozitën mesore të fjalëve. Në këtë mënyrë, disa togje me tri bashkëtingëllore reduktohen në dy, kurse togjet me katër bashkëtingëllore reduktohen në togje me tri sosh, p.sh.:

beefsteak [ˈbiːfsteɪk] > biftek,
roast-beef [ˈrəʊstbiːf] > rozbif,
rump-steak [ˈrʌmpsteɪk] > ramstek etj.

⁶ Për çështjen e risive të bashkëtingëlloreve shih: R. Filipović: *Consonants innovations in the Phonological System as a Consequence of Linguistic Borrowing*, SRAZ, Zagreb, 1959, ff. 39-62.

Në huazimet angleze në gjuhën shqipe, sipas hulumtimit tonë, dalin 28 togje të bashkëtingëlloreve në pozitën nistore të fjalëve; prej tyre 25 janë me nga dy dhe tri me nga tri bashkëtingëllore. Nga këto, 25 togje ekzistojnë në fjalët shqipe (duke përfshirë këtu edhe huazimet nga gjuhë të tjera, pos anglishtes), kurse tri togje me nga tri bashkëtingëllore paraqesin risi në sistemin fonologjik të gjuhës shqipe.

Pasqyra e huazimeve angleze në gjuhën shqipe me togje nistore të bashkëtingëlloreve

Togjet nistore të bashktingëll.	Fjalë angleze	Fjalë shqipe
bl -	blazer bluff blue	blejzer blof blu
br -	brandy brig brige	brandi brig brixh
dr -	dress dribbler	dres dribler
fl -	flickball flirt	flickboll flirt
fr -	freeze	Friz
gr -	grapefruit	grejpfruit
kl -	clown club	klaun klub
kr -	cricket crawl cross	kriket krol kros
kv -	quaker quiz	kveker kviz
mj -	musical	mjuzikl
pl -	play-back plajboj	plej-bek plejboj
pr -	protestant	protestant
sk -	skylab sky-liner scalp sketch ski scooter	skajlab skajlajner skalp skeç ski skuter
sl -	slang slogan	sleng slogan
sm -	smog smoking	smog smoking
sn -	sniper snack-bar snob	snajper snek-bar snob

sp -	speedway	spidvej
	speaker	spiker
	sport	sport
spr -	spray	sprej
	sprint	sprint
st -	standard	standard
	start	start
	stake	stekë
	sterling	sterlinë
	stop	stop
stj -	steward	stjuard
	stewardess	stjuardesë
str -	strip	strip
	strip-tease	striptiz
tr -	tramway	tramvaj
	trainer	trejner
	training	trening
	trend	trend
	trick	trik
	trolley-bus	trolejbus
	trust	trust
tv -	twiggy	tvigi
	twin-lid	tvinlid
	twist	tvist

Pasqyrë e togjeve nistore të bashkëtingëlloreve të huazimeve angleze në gjuhën shqipe

	p	t	k	l	ll	m	n	v	j	r
p				x						x
b				x						x
t								z		x
d										x
k				x				z		x
g				x	x				x	x
m									x	
f				x						x
s	x	x	x	x		x	z		x	
h									x	
st									x	x
sp										x

Legjenda: z - risi

Në pozitën mesore të huazimeve angleze në gjuhën shqipe, që kemi studiuar, dalin 197 togje bashkëtingëlloresh. Nga këto, 122 janë me 2, 67 me 3 dhe 8 me 4 bashkëtingëllore. Nga këto togje, 6 me 2, 46 me 3 dhe të

gjitha të tjerat me nga 4 bashkëtingëllore janë risi në gjuhën shqipe, meqë nuk ka fjalë shqipe, të cilat i kanë ato togje në trupin e tyre.⁷

Pasqyrë e huazimeve angleze në gjuhën shqipe me togje mesore të bashkëtingëlloreve

Togje mesore të bashkëting.	Fjalë angleze	Fjalë shqipe
- bl -	dribler	dribler
- br -	chery-brandy	sheribrendi
- btr -	globe-trotter	globtroter
- dj -	trade union	tredjunion
- dm -	badminton	badminton
- dn -	kidnaping	kidnapim
	kidnapp	kidnapoj
- dv -	speedway	spidvej
- fs -	offside	ofsajd
	offset	ofset
- ft -	beefsteak	biftek
	fifty-fifty	fifti-fifti
	lieutenant	leftner
	taftin	tafting
- ftb -	softball	softboll
- gb -	rugby	ragbi
- gl -	raglan	reglan
- ht -	yacht	jahtë
- jb -	trolley-bus	trolejbus
	volley-ball	volejboll
- jd -	outsider	autsajder
- jh -	sky-hawk	skajhouk
- jk -	boycott	bojkot
	bookmaker	bukmejker
- jl -	boiler	bojler
	nylon	najlon
	skylab	skajlab
	sky-liner	skajlaner
- jn -	designer	dizajner
	container	kontajner
	sky-liner	skajlajner
	trainer	trajner
- jp -	linotypist	linotajpist
	sniper	snajper
- js -	laser	lejser
- jsh -	bicycle	bajshikël

⁷ Kjo nuk është krejt e sigurt derisa të mos vërtetohet numri i vërtetë i këtyre togjeve në gjuhën shqipe.

- jxh -	teenager	tinejxher
- jz -	blazer	blejze
	geyser	gejzer
	laser	gejzer
- jsb -	baseball	bejsboll
- jsk -	boy scout	bojskaut
- jzb -	baseball	bejzboll
- kb -	flick-ball	flikboll
- kd -	knockdown	nokdaun
- kl -	aero club	aeroklub
	cyclone	ciklon
- km -	bookmaker	bukmejker
- kn -	cockney	kokni
	picnic	piknik
- kp -	blackpool	blekpul
- kr -	auto-cross	autokros
- ks -	Anglo-Saxon	anglo-sakson
	boxer	bokser
	mixer	mikser
	sex-appeal	seksipil
	sexy	seksi
	taxi	taksi
- ksp -	export	eksport
	Shakespearian	shekspirian
- kspr -	express	ekspres
- kstr -	ekstreem	ekstrem
- kt -	detektor	detektor
	cocktail	koktel
	tractor	traktor
- ld -	Bloomfieldian	Bloomfieldian
	bull-dozer	buldozer
- lg -	goal-getter	golgeter
- lkl -	folklore	folklor
- lm -	film	filmor
	gentleman	xhentëlmen
- lv -	revolver	revolver
	welvet	velet
- lt -	penalty	penalti
- lld -	bulldog	bulldog
- pt -	helikopter	helikopter striptiz
	strip-tease	tiptop
	tip-top	
- rb -	derby	derbi
- rd -	stewardess	stjuardesë
- rdm -	recordman	rekordmen
- rfl -	butterfly	beterflaj
- rgl -	five-glas	fibërglas
- rk -	uppercut	aperkat
	marketing	marketing

	parking	parking
- rkr -	hover-craft	hoverkraft
- rksh -	Yorkshire	jorkshir
- rl -	darling	darling
	parliament	parlament
	sterling	sterlinë
- rlst -	Charleston	çarlston
- rll -	furlong	farllong
- rm -	farmer	fermer
	conformist	konformist
	supermarket	supermarket
- rn -	corner	korner
- rp -	waterpolo	vaterpolo
- rpl -	fair play	ferplaj
- rs -	jersey	zhersej
- rt -	chartist	çartist
	charter	çarter
	export	eksportoj
	farthing	farting
	sportive	sportiv
- rt-h -	Apartheid	apartheit
- rtn -	partner	partner
- rv -	Darwinism	darvinizëm
- rvj -	interview	intervju
- rxh -	detergent	deterxhent
- sk -	basket-ball	basketboll
	escalation	eskalacion
	cross-country	kroskontri
	whisky	viski
- sm -	businessman	biznismen
	congressman	kongresmen
- st -	protestant	protestant
	roast	rosto
	western	vestern
- str -	destroyer	destrojër
- sts -	best-seller	bestseler
- tb -	basket-ball	basketboll
	football	futboll
- tl -	cutlet	kotletë
	Scotch	skotlandez
- ts -	outsider	autsajder
- vb -	cowboy	kavboj
- zb -	jazz-band	xhazband
- zg -	Glasgower	gllazgovas
- zn -	business	biznes, biznes
	Disneyland	Diznilend

Pasqyrë e togjeve të bashkëtingëlloreve me dy elemente të huazimeve angleze në gjuhën shqipe

	p	b	t	d	k	g	m	n	l	ll	f	v	s	z	sh	J	h	ç	xh	r
p			x		x															x
b									x											x
t		x			x				x		x		x		x	j				x
d						z	x	x	x		z	x	x			x				
k	z	x	x	x		z	x	x	x				x							z
g		x							x	x										
m	x	x						x	x		x	x		x		x				
n		z	x	x	x	x			x		x	x	x		x		x	x	x	x
l		x		x		x	x				x	x	x	x						
ll		x	x	x																
f			x					x					x							
v		x							x											
s	x	x	x		x		x	x	x			x								
z			x			x		x												
sh	z	x					x		x											
j	x	x	x	x	x		x	x	x			x	x	x	x		x		x	x
h			x																	
ç				x			x													
xh												x								
r	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x				x	x	x	

Legjenda: z - risi

Nga togjet e bashkëtingëlloreve në pozitën fundore të huazimeve angleze në gjuhën shqipe kemi evidencuar 60 sosh. Prej tyre, 52 janë me dy dhe tetë me tri bashkëtingëllore. Në gjuhën shqipe ekzistojnë 43 prej tyre, kurse numri prej 17 togjesh për këtë gjuhë marrëse është inovacion – 12 me dy dhe pesë me tri bashkëtingëllore.

Pasqyrë e huazimeve angleze në gjuhën shqipe me togje fundore të bashkëtingëlloreve

Togjet fundore të bashkëtingëll.	Fjalë angleze	Fjalë shqipe
- ft	lift	lift
- ht	yacht	jaht
- jd	offside	ofsajd
- jf	life	lajf
- jl	cocktail	koktejl
- jn	combine	kombajn
	design	dizajn
- jp	teletype	teletajp
	grape (fruit)	grejp (frut)
- jr	esquire	eskuajr
- js	rolls-royce	rols-rojs
- jt	copyright	kopirajt
	all rigat	olrajt
- jv	live	lajv
- kl	musical	mjuzikl
- ks	Anglo-Saxon	anglosakson
	box	boks
	cakes	keks
	coke	koks
	mix	miks
	sex	seks
- kst	mixed	mikst
- kt	viaduct	viadukt
- ld	Mc Donald	mekdonald
- lf	half	half
	golf	golf
- lm	film	film
- lp	scalp	skalp
- lt	colt	kolt
	commonwealth	komonvelth
- lth	Commonwealth	komonvelth
- lls	beatles	bitëlls
- nc	hands	enc
	ounce	unc
- nç	inch	inç
	lynch	linç
	punch	punç

- nd	big band	big-bendd
	brandy	brend
	happy-end	hepiend
	trend	trend
	week-end	vikend
	jazz-band	xhazband
- ng	boomerang	bumerang
	dancing	dansing
	darling	darling
	dumping	dumping
	gong	gong
	camoing	kamping
	king	king
	meeting	kliring
	ping-pong	miting
	puding	pingpong
	slang	puding
	smoking	sleng
	sterling	sterling
	shilling	shiling
	tafting	tafting
	training	trening
- nk	antitank	antitank
	tank	tank
- nks	antitanks	antitanks
	tank	tanks
- nt	cent	cent
	detergent	deterxhent
	sprint	sprint
	state department	state departament
- ps	jeeps	xhips
- rc	shorts	shorc
- rd	bard	bard
	Ford	ford
	yard	jard
	lord	lord
	landlord	lendlord
	record	rekord
	standard	standard
	steward	stjuard
- rk	park	park
- rn	western	uestern
- rns	Barnes	barns
- rt	export	eksport
	flirt	flirt
	import	import
	insert	insert
	quart	kuart
	sport	sport

- sk	start	start
- st	computer	kompjuteresk
	bul-dozer (driver)	buldozerist
	chartist	çartist
	essayist	eseist
	hockey (player)	hokeist
	conformist	konformist
	labuor	laburist
	test	test
	trust	trust
	tvist	tvist

Pasqyrë e togjeve fundore të bashkëtingëlloreve të huazimeve angleze në gjuhën shqipe

	p	t	d	k	g	n	n	l	f	v	s	th	c	ç	xh	r	st	ls	lz	ks	ms	ns	
p								z			x												
t								z			z												
d											z												
k		x						z			x						x						
m	x										x												
n		x	x	x	x						x		x	x							x		
l	x	x	z			x			x		x	x		x									
ll											z												
f		x																					
v								z			z												
s		x		x																			
j	z	x	x	x	z		x	x	x	z	x						x		z			z	
h		x																					
r		x	x	x			x	x			x		x	x	x		x	z	z				z

Legjenda: z - risi

Siç shihet nga shembujt e të gjitha llojeve të togjeve, disa lloje bashkëtingëlloresh të huazimeve angleze në gjuhën shqipe, nuk janë formuar në bazë të togjeve origjinale të fjalëve angleze, por për shkak të ndikimit të shkrimit të fjalëve angleze, për shkak të adaptimit të mëparshëm në gjuhën ndërmjetëse ose për arsye të ndonjë ndryshimi në shqiptimin e fjalëve angleze në shqipet, për shembull:

[rtn]: partner ['pa:tnə] > partner

[rdm]: recordman ['reko:dmən] > rekordmen etj.

Po qe se i vërejmë togjet e bashkëtingëlloreve në të gjitha pozitat e fjalëve dhe i krahasojmë rezultatet, mund të shihet se togjet e bashkëtingëlloreve të gjuhës shqipe janë pasuruar më së shumti në

pozitën mesore, pastaj vjen pozita fundore dhe në fund pozita nistore. Por, siç është cekur më sipër, disa nga këto togje nuk mund të qëndrojnë si të tilla, sepse hasin në rezistencë të natyrës së gjuhës marrëse – shqipe. Mirëpo, ato përshtaten më tutje dhe ashtu mund të zhduken si togje duke u zbërthyer me ndonjë zanore.

Edhe një herë në fund të nënvizojmë se sa u përket togjeve të bashkëtingëlloreve të gjuhës shqipe në pozita të ndryshme të fjalëve, nuk mund të thuhet me siguri se kemi të drejtë për disa raste, meqenëse nuk është e mjaftueshme ajo që kemi bërë për t'i hulumtuar. U tha se për identifikim e kemi shfrytëzuar vetëm fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1956. Nuk i kemi pasur para vetes as të gjithë emrat e përveçëm dhe gjeografikë të shqipes, e as emrat e institucioneve dhe të lokacioneve të ndryshme. Për këtë arsye, ajo që është thënë këtu për togjet e bashkëtingëlloreve të gjuhës shqipe duhet të merret me rezervë, për hir të saktësisë shkencore. Po të kishin në dorë listën e plotë të këtyre togjeve në gjuhën shqipe në të gjitha pozitat e fjalëve, do të mund të vërtetohej më me siguri dhe saktësi se sa ka dhe cilat janë risi të shpërndarjes së fonemave që janë krijuar me ndikimin e huazimeve angleze në gjuhën shqipe. Shprehim njëherësh bindjen se është detyrë më se e nevojshme dhe aktuale e albanologëve që sa më shpejt ta hulumtojnë dhe nxjerrin në dritë çështjen e përndarjes së fonemave në gjuhën shqipe.

Buletini, nr. 13, ff. 411-432, 1976, Fakulteti Filozofik i Universitetit të Prishtinës.

ÇËSHTJE TË PËRSHTATJES GRAMATIKORE TË ANGLIZMAVE NË GJUHËN SHQIPE

1. Hyrje

Gjuha shqipe ka huazuar dhe vazhdimisht po huazon një numër të konsiderueshëm fjalësh angleze. Duhet theksuar se elementet e gjuhës dhënëse në fillim të gjallërimit të tyre janë truptha të huaj në gjuhën marrëse, me ndikim të veçuar vetëm në vetvete, pa pasur ndonjë efekt të dukshëm në sistemin e gjuhës marrëse. Pra, çdo dukuri gramatikore apo dukuri tjetër që ndodh gjatë procesit të huazuarit të anglizmave në gjuhën shqipe, mbetet, tash për tash, vetëm në ato elemente të huazuara, pa u shtrirë në fjalët me burim të mirëfilltë të shqipes. Mirëpo, ndonjëherë analogjia, si gjithkund tjetër edhe në gramatikë, mund të ketë dhe ka shprehur një tendencë ndikimi edhe në strukturën e mirëfilltë të gjuhës shqipe.¹ Kësaj radhe do të marrim në shqyrtim vetëm disa çështje, që i konsiderojmë me interes për një vështrim të veçantë.²

Duhet vënë në dukje se nga anglishtja në gjuhën shqipe deri tani janë huazuar më së shumti emrat, pastaj vijnë foljet, mandej biemrat, ndërsa, rrallëherë, ndonjë pjesë tjetër e ligjëratës.

2. Përcaktimi i gjinisë së emrit të huazuar

Gjatë përshtatjes gramatikore të emrave të anglishtes, apo të fjalëve angleze të marra si emra, në gjuhën shqipe, atyre u jepet gjinia gramatikore, ndonëse ajo nuk ekziston në gjuhën angleze. Gjinia gramatikore tek

¹ Kjo dukuri është vënë në dukje në: V.Nuhiu, *Disa sintagma emërore të ndërtuara nën ndikimin e anglishtes*: Studia Philologica, nr. 1-2, f. 161-164, Shoqata e Gjuhëve dhe Letërisve të Huaja e Kosovës, Prishtinë, 1981.

² Ismail Mehmeti i ka trajtuar çështjet gramatikore të anglizmave në gjuhën shqipe në mënyrë të përgjithshme në punimin e tij të magjistraturës, me titull, *Engleski element u albanskom jeziku - morfoloska i semanticka analiza* (ruhet në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Zagrebit). Ai është koautor i këtij artikulli. Po ashtu një kontribut i tij gjendet në botimin e posaçëm të Rudolf Filipović, *The English Element in the Main European Languages*, Institut za Lingvistiku, Filozofski Fakultet, Zagreb, vol. II, f. 28-56, 1982, me titull, *The English Element in Albanian — A Grammatical Analysis*.

emrat e tillë caktohet rëndom sipas tingullit fundor të emrit anglez në numrin njëjës. Pastaj veprohet sipas analogjisë me emra të ngjashëm të gjuhës shqipe. Shumica e emrave që mbarojnë me bashkëtingëllore, marrin gjininë mashkullore në gjuhën shqipe. Kështu janë, për shembull: *dres - dresi, radar - radari, ring - ringu, hit - hiti* etj. Mirëpo, ka raste kur bëhet përjashtim nga kjo rregull, ngase gjatë rrugës së vet huazimi mund të kalojë nëpër ndonjë gjuhë ndërmjetëse, në të cilën bëhet, b.f. integrimi i emrit në ndonjërin nga gjinitë gramatikore. Kështu është rasti me disa emra anglezë, si: *jahtë - jahta, jardë - jarda, rundë - runda* etj., që te ne kanë arritur përmes gjuhës serbokroate, kur edhe është bërë përshtatja gramatikore në gjininë femërore, ndonëse mbarojnë me tingullin fundor bashkëtingëllor. Këta emra shpesh i hasim si të tillë, sidomos në mjetet e komunikimit masiv, ndonëse sipas *Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe* ata janë: *rund - rundi, jaht - jahti, jard - jardi*.

Emrat anglezë me rrënjë që u mbaron me zanore në gjuhën shqipe, rëndom integrohen në gjininë femërore, për shembull: *diditi - diditia, gini - ginia, ski - skia, taksi - taksia* etj. Duhet thënë se në këta shembuj dhe të tjerë, tingujve (zanoreve) të fundit të huazimeve angleze shpesh u mvishet gjatësi, meqë shqipja, si duket, ka nevojë për një gjë të tillë për t'i bërë emrat të gjinisë femërore. Pra, kemi *taksi* /'taksi/ e bëhet /tak'si:/, *diditi* /'dititi/ bëhet /didi'ti:/ etj. ndërsa emri *ski* /ski/ e ka vetë zanoren të gjatë edhe në anglishte. E gjithë kjo bëhet për shkak të theksit, i cili për ta integruar emrin në gjininë femërore, duhet ta ndërrojë ndonjëherë edhe vendin (rrokjen); ndonëse në anglishte mund të ketë qenë fjalë me theks paraoksiton, kur huazohet në gjuhën shqipe emri mund të bëhet fjalë me theks oksiton, siç u pa në disa nga shembujt e zënë ngoje më lart.

Mirëpo, ka një numër emrash, mbi një duzinë sish, të prejardhjes angleze, që mbarojnë me zanore, po nuk integrohen në gjininë gramatikore femërore. Ata emra mbarojnë me zanoren *i* dhe sillen në mënyrë jonormale për gramatikën e gjuhës shqipe. Të këtillë janë emrat: *derbi, hipi, hobi, janki, kantri, kokni, ledi, peni, poni, ragbi, remi, tokivoki, tomi, tvigi, uiski* etj. Këta emra, në të vërtetë, shpesh dalin sikur të mos e kishin atë *-i* fundore si element të rrënjës, por si mbaresë të gjinisë mashkullore, pra, sikur të ishin: *derb+i, hip+i, pon+i, rem+i, uisk+i* etj. Disa prej tyre edhe janë hasur në gjuhën shqipe si të tillë, në të përditshmen „Rilindja”, për shembull: „*Jenkët e rinj shtyhen në portat e tyre*”; „...*hobet e tij janë të çuditshme*”; „*E kishte një pon të ri*”.

Këta emra duket sikur janë barazuar me emrat e shqipes: *kali, deti, guri* etj., që në disa të folme të shqipes përdoren gjithmonë në trajtë të shquar, edhe atëherë kur janë të pashquar, pra e kanë rrafshuar shquarsinë,

si b.f.: „Ka shkuar në *deti*”. „Erdhi me *kali*”. „E hodhi një *guri*”. Natyrisht, kjo nuk është në pajtim me normat e shqipes standarde.

Huazimi anglez *taxi* në gjuhën letrare shqipe ka gjini (gramatikore) femërore, pra shqiptohet /tak'si:/. „Erdha me taksi /tak'si:/. Kurse në të folurit e përditshëm e dëgjojmë, sidomos në Kosovë dhe gjetiu jashtë Shqipërisë /'taksi:/. „Erdha me taksi”. „E pagova taksin”.

Na e merr mendja se po të mos ishte krijuar tashmë një shprehi e përdorimit të këtyre emrave si të tillë dhe po të mos ishte ushtruar ndikim nga ndonjë gjuhë ndërmjetëse, pothuaj të gjithë këta emra, përveç *janki* e *poni*, të cilët kanë edhe gjini natyrore, meqë shënojnë frymorë të seksit mashkullor, do të mund të përdroreshin në gjininë femërore. Ata emra do të shqiptoheshin. *derbi* - *derbia*, *hobi* - *hobia*, *peni* - *penia*, *remi* - *remia*, *ragbi* - *ragbia*, *uiski* - *uiskia* etj. Në atë rast, theksi do të ndërronte vendin nga rrokja e parë në të fundit, përkatësisht do të kalonte mbi /i/ dhe veç kësaj tingullit /i/ do t'i shtohej gjatësia, në pajtim me natyrën e gjuhës shqipe.

Në këtë mënyrë edhe do të „kontaminoheshin” (siç përdoret ky term ndonjëherë në literaturë të të huazuarit gjuhësor) me emra të gjuhës shqipe të ngjashëm për nga fusha semantike, pra *derbia* do të krahasohej me “ndeshja”, *penia* me “paraja”, *remia* me “barazia”, *uiskia* me “rakia” etj. Në anën tjetër, emrat *poni* dhe *jenki* ose *janki*, për shkak të gjinisë së tyre natyrore, do të mund të përshtateshin në gjininë mashkullore dhe të thuhej në trajtë të shquar: *poniu*, *jankiu*.

Prandaj mund të përfundohet se përshtatja e këtyre emrave anglezë në gjininë përkatëse gramatikore ende nuk ka marrë fund. Mu për këtë arsye, duket se këta emra u ikin trajtave të shquara si dhe përdorimit në rasi të ndryshme.

Ka interes të shqyrtohet në këtë kontekst edhe përdorimi i huazimit anglez *ledi* apo *lejdi* që d.m.th. „zonjë”, „damë”, i cili, pra, shënon një person të gjinisë femërore. Megjithatë, trajtat e këtij emri të huazuar, edhe pse të përdorur jo shpesh, hasen të papërcaktuara mirë e qartë. Zakonisht i iket përdorimit të tij nëpër rasi të tjera përveç emërores. Kështu, nuk dëgjohej të thuhet, apo nuk shihet të shkruhet: “Kjo është *ledia* (*lejdia*) ime”; “E pashë *ledinë* (*lejdinë*) tënde” etj., gjë që do të ishte shumë normale për gjuhën shqipe. Por, përkundrazi, dëgjohej: “E pashë *ledin* tënd”. Pra, për nga trajta dhe përdorimi sintaksor barazohet me emrat e gjinisë mashkullore.

Diçka e ngjashme ndodh edhe me dy emrat anglezë, që mbarojnë me diftongun *ou*: *shou* dhe *bungallou*. Në shqipen e përdorur në mjetet e komunikimit publik shpesh hasen të reduktuar në *sho* dhe *bungallo*, madje edhe *bungallov*: “Xhemil *sho*” (Rilindja), përdorim përbuzës; “mbeti në

afërsinë e një *bungallovi*” (Rilindja). Edhe në këta emra, shqipfolësit i duket sikur ka të bëjë me trajta të shquara, prandaj kur i përdor të pashquara ndonjëherë, përpiqet t'ua heqë atë *-u* si shënues të nyjës shquese. Me trajtat e tyre të ndryshme ata emra provojnë se ende nuk e kanë bërë vendin e tyre të sigurt në gramatikën e gjuhës shqipe.

Përkritazi me këtë çështje, është me interes të bisedohet edhe për dukurinë që paraqitet me rastin e përdorimit të disa emrave personalë anglezë të gjinisë femërore, pra disa emrave të grave. Shumë prej tyre mbarojnë me bashkëtingëllore (në trajtë të pashquar në gjuhën shqipe) ose me zanoren *-i*, duke marrë trajtat paradigmore të gjinisë mashkullore. Kështu janë, për shembull: *Xhejn - Xhejni* e jo *Xhejna*, *Xhenet - Xheneti* e jo *Xhenetja*, *Meri - kjo Meri* e jo *Meria*, *Xhuli - e pashë Xhulin* dhe jo: *Xhulinë* etj.³

Pos këtyre emrave të gjuhës angleze të zënë ngoje më lart, në gjuhën shqipe janë huazuar edhe disa fjalë, që ende nuk e kanë zënë vendin e tyre të denjë me trajtat gjegjëse gramatikore. Një ndër ta që përdoret mjaft shpesh është emri *bum*. Deri tani e kemi hasur vetëm në trajtën e emërores ose kallëzores *së* pashquar, b.f. “Kjo bëri *bum* të madh” (Rilindja), por ‘nuk na ka rënë’ ta shohim apo ta dëgjojmë në trajtë të shquar.

3. Trajatat e mbiemrave të huazuar të papërshtatur

Disa mbiemra të huazuar nga anglishtja nuk i nënshtrohen asnjë ndryshimi trajtash edhe kur përdoren në gjini të ndryshme dhe numër të ndryshëm në gjuhën shqipe. Të këtillë janë: *blu*, *fer*, *kaki*, *mini*, *seksi*, *super* etj. Këta mbiemra disi kanë vetëm një gjini, siç duket mashkulloren apo ndoshta neutrale, dhe nuk u nënshtrohen ndryshimeve gramatikore të gjinisë femërore të shqipes me trajtat përkatëse. Së paku jo ende. Kështu thuhet: „Ai njeri është *fer*”; por është dëgjuar të thuhet “Kjo lojë qe *fer*”, e jo: “Kjo lojë qe *ferë*”. Pastaj thuhet: “Ai djalë është *seksi*”, por edhe: “Ajo vajzë është *seksi*”. Mbiemrat që shënojnë ngjyrat *blu* dhe *kaki*, po ashtu, kanë vetëm këtë trajtë për emrat e të dy gjinive - mashkullore dhe femërore - të gjuhës shqipe. Mbiemri *mini* gjithashtu shënon, pa ndryshim trajte, si gjininë mashkullore edhe gjininë femërore: *mini* fustani, *mini* fundi, *mini* ferma etj.

Po i theksojmë dallimet e ndryshme në gjini, sepse shënuesi gra-

³ Kjo dukuri po vjen e po bëhet modë edhe me disa siemra të gjuhës shqipe, si: *Fiki*, *Liki*, *Lili*, *Miri*, *Shuki*, *Seki* etj. që janë shkurtime apo formime të ndryshme nga emrat i përveçëm të mirëfilltë. Dhe s'do mend që nuk përkojnë shumë me natyrën e shqipes.

matikor i gjinisë mund të vërehet më së shumti nga të gjithë shënuesit e tjerë gramatikorë të mbiemrave, madje edhe te mbiemrat e panyjshëm të huazuar nga gjuhë të ndryshme, p.sh.: *interesant - interesante, standard - standarde, pompoz - pompoze, bombastik - bombastike* etj.

Pra, mund të konstatohet se mbiemrat e huazuar nga anglishtja, të shënuar më sipër, ende nuk janë integruar plotësisht në sistemin gramatikor të gjuhës shqipe.

4. Huazimi i emrave në trajtë të shumësit

Në fund, një dukuri tjetër gramatikore, që haset gjatë të huazuarit të anglizmave në gjuhën shqipe, është marrja e trajtës së shumësit të emrit të anglishtes për trajtën njëjës në shqipe. Kjo dukuri është e pranishme në përvojën e të huazuarit nëpër gjuhë të ndryshme, por na duket se kjo dukuri e emrave të anglishtes sikur është tepër e dukshme në këtë aspekt. Kështu, b.f., emri *cake* në shqipe është huazuar *keks*, pra së bashku me shënuesin e shumësit të anglishtes: *cake+s /keik+s/ > keks*. Të këtij tipi janë edhe *koks* (*coke+s*), *tanks* (*tank+s*), *bitëlls* (*beatle+s*). Pra, shumësi i shqipes i shtohet tashmë shumësit të anglishtes: *keks+a > keksa, koks+a > koksa, tanks+a > tanksa, bitëlls+a > bitëllsa*. Natyrisht, dukuria e të huazuarit të trajtës shumës të anglizmave nuk ka ndonjë pasojë në gjuhën shqipe, madje ajo as që vërehet nga ata që s'e njohin anglishten. Mirëpo, ka rëndësi të shihet si dukuri gramatikore gjatë analizës së procesit të të huazuarit gjuhësor.

5. Përfundim

Këtu i shtruar disa çështje problematike përkitazi me përshtatjen gramatikore të disa huazimeve angleze në gjuhën shqipe. Shprehëm mendimin si do të mund të përshtateshin disa nga ato huazime.

Mirëpo, në gjuhë parashikimet nuk realizohen gjithëherë, sepse rrjedhat e gjuhës lëvizin sipas një rruge shpesh të paparashikuar. Ndërsa të bëhesh arbitër për disa çështje gjuhësore, duket sikur të ofrohet guxim i tepruar.

*

DISA EMRA TË ANGLISHTES NË GJUHËN SHQIPE

Çdo gjuhë që pranon elemente gjuhësore të huaja, qoftë fjalë ose emra, pothuajse menjëherë, e me siguri pas një kohe, do të fillojë të bëjë përshtatjen e tyre sipas sistemit fonologjik dhe gramatikor të saj. Qëllimi kryesor dhe synimi i fundit i përshtatjes së elementeve gjuhësore të huaja, siç del nga përvoja e pasur e shumë gjuhëve, është që fjala e huaj të ‘përpunohet’, të ‘gdhendet’, të ‘latohet’ sipas gjedheve të gjuhës që i pranon. Pra, fjala e huaj duhet t’i afrohet dëgjuesit ose folësit të vet, duke bërë përpjekje që ajo t’i tingëllojë e t’i duket si e vetja. Vetëm në fillim, madje jo gjithëherë, mund të ndodhë që fjala ose emri i huaj t’i tingëllojë folësit e çuditshme. Si duket, pra, gjuha vazhdimisht duhet të kujdeset që ‘malli’ (materiali gjuhësor) i huaj t’i nënshtrohet shijes së ‘konsumatorit’ të vet (folësit të gjuhës së vet).

Shqipja, si çdo gjuhë tjetër, në kohën e sotme të komunikimit shumë intensiv, deshi s’deshi, duhet të përdorë elemente gjuhësore të huaja, qofshin ato apelative ose emra njerëzish, emra gjeografikë etj. për të emërtuar njerëz, vende e ngjarje të ndryshme të huaja. Duke vështuar praktikën tonë të deritashme, mund të konstatohet se shqipja, domethënë shqipfolësi, sillet në mënyrë mjaft inferiore ndaj elementeve gjuhësore të huaja. Kësaj të dhëne mbase mund t’i gjendet edhe burimi psikologjik. Për ne këtu ai le të mbetet, tash për tash, vetëm i supozuar – fakti se shqipja ndjehet si gjuhë e rendit të dytë përballë ndonjë gjuhe tjetër me prestigj më të lartë shoqëror. Mirëpo, duhet të mbizotërojë vetëdija e qartë se asnjë gjuhë, sa i përket aftësisë së të komunikuarit, nuk është më e aftë se ndonjë gjuhë tjetër, si dhe se çdo gjuhë është mjaft e aftë për të shprehur atë për të cilën ka nevojë. Pra, nga vetë qenia gjuhësore, si sistem komunikimi që është, secila gjuhë është e aftë për vetveten. Ndonëse duhet të thuhet se ka gjuhë me më shumë fjalë dhe sosh me më pak fjalë. Këto të fundit mbase mund të shprehin realitetin në mënyrë më të saktë, sesa ato të parat. Gjuhët për nga rëndësia dallojnë vetëm në mbështetje të statusit që u japin bashkësitë shoqërore-politike, pra dallojnë për nga tiparet e cilësitë që nuk janë gjuhësore – po janë jashtëgjuhësore. Prandaj, me ato tipare gjuha as mund të krenohet, as duhet të dëshpërohet. Së këndejmi, mendojmë se shqipja

duhet të jetë e sigurt dhe të veprojë në mënyrë parimore edhe me elementet gjuhësore të huaja, ashtu si vepron me elementet vetjake, qoftë për një çast ose përgjithmonë.

Këtu bëhet fjalë për përdorimin sidomos të emrave të huaj në gjuhën shqipe, ekziston një prire, për fat të mirë jo të gjithë, që emrat e huaj të përdoren nga shqipfolësit dhe shqipshkruesit me një ‘servilizëm’ bukur të madh ndaj tyre, duke u përpjekur që të mos i ‘preket sedra’ emrit të huaj, se ndoshta mund të ‘fyhet’ po t’i ndërrohet forma sipas ‘adetit’ të shqipes. Ne duhet ta kuptojmë një rregull të përgjithshme njëherë e përgjithmonë. Me vetë aktin e marrjes së emrit të huaj për përdorim në gjuhën shqipe, ai, aty për aty, bëhet element i inventarit të shqipes, prandaj, si i tillë, duhet të bartë edhe etiketën e shqipes. Me fjalë të tjera, emrat e huaj duhet t’u nënshtrohen të gjitha rregullave gjuhësore të shqipes, pa marrë parasysh prej nga vijnë ata. Kjo është rruga më e thjeshtë, më e shkurtër dhe, mbase, edhe më e drejtë. Këtu, pra, konkretisht është fjala për mënyrën e të shqiptuarit dhe të të shkruarit të atyre emrave, por edhe për përshtatjen e tyre gramatikore sipas gjinisë, rasave etj. të gjuhës shqipe.

Sa i përket shqiptimit, duhet të kihet parasysh dy gjëra: a) që tingujt e emrit të huaj të zëvendësohen me tinguj të ngjashëm që i ka gjuha shqipe, e jo me të tjerë që nuk i ka shqipja, vetëm për hir të emrit të huaj dhe b) që theksi i emrit të huaj, nëse nuk përputhet me vendin e theksit të gjuhës shqipe për secilin rast konkret, të zhvendoset sipas natyrës së gjuhës shqipe, e jo të përdoret emri në gjuhën shqipe me theks të huaj, të panatyrshëm për shqipen. Me një fjalë, emrat dhe elementet gjuhësore të tjera të huaja duhet të ‘natyralizohen’ në sistemin e gjuhës shqipe dhe, si të tillë, të bëhen më të pranueshëm në ligjërimin e rëndomtë.

Po i marrim në shqyrtim konkret vetëm disa raste, të cilat ka kohë që na bien në sy ose që na i zë veshi. Është fjala për disa emra të përveçëm anglosaksonë që dëgjohen nga spikerët e radios ose të televizionit, po edhe që shkruhen nëpër gazeta, revista e gjetiu. Spikerët e radios ose të televizionit, po edhe gazetarët dhe të tjerët, nëse e ‘mësojnë’ dhe e përvetësojnë se si shqiptohet një emër në ndonjë gjuhë të huaj, ose ndonjë fjalë tjetër çfarëdo qoftë ajo, nuk domethënë se ata duhet ta shqiptojnë atë si f.v. anglezët. Detyra e spikerit, është thënë shumë herë e po e themi edhe një herë, është e ndjeshme po edhe me përgjegjësi (shumë të madhe) gjuhësore, ndërsa shqiptimi i tyre duhet të shërbejë si gjedhe, mostër ose model për të gjithë të tjerët. Sa për ilustrim të rolit të spikerit në të shqiptuarit e drejtë, po zëmë ngoje spikerët e Radiotelevizionit Britanik – BBC-së, shqiptimi i të cilëve konsiderohet gjedhe e shqiptimit të anglishtes standarde britanike.

*

Një emër i përveçëm me denduri bukur të madhe në mjetet e informimit publik në vitet e fundit është Margaretë Thaçeri. Ky emër do të duhej të shkruhej kështu dhe sipas kësaj edhe të shqiptohej. Emri Margaretë - Margareta është i gjinisë femërore, prandaj si i tillë duhet të shkruhet duke rimuar me Luljetë, e jo Margaret, që rimon me Sheremet, sepse nuk duhet të barazohet me emra mashkullorë. Shqipja, për dallim nga disa gjuhë, i dallon shumë qartë emrat e njerëzve të gjinisë femërore nga ata të gjinisë mashkullore, madje kështu edhe emrat e huaj.

Mbiemri i kryeministres së tanishme britanike do të duhej të shkruhej Thaçer - Thaçeri, Thaçerin etj. dhe të rimonte me emrat Fisher, Kamer etj. për shumë arsye. E para, shkronja a e këtij emri në anglishte shqiptohet /æ/, i cili është një tingull që gjendet midis zanoreve /a/ dhe /e/ të shqipes, po nuk është asnjëra prej tyre. Shqipja nuk ka tingull të tillë. Mund të thuhet se më shumë anon nga /a/ për nga tiparet fonetike të shqiptimit britanik, sidomos kur të bëhet krahasimi me tiparet fonetike të zanoreve të shqipes. E dyta, edhe sikur të ishte kjo fonemë njësoj e largët nga fonemat /a/ dhe /e/ të shqipes, pse do të duhej t'i ndërronim pamjen e saj grafike pa nevojë? E treta, shqipja tashmë ka krijuar një traditë (sidomos në gjuhën letrare), që këtë fonemë të gjuhës angleze në fjalët e huazuara ta zëvendësojë më shumë me fonemën e shqipes /a/, sesa me /e/, f.v. *xhaz* nga *jazz* (më herët shkruhej dhe shqiptohej në Kosovë *xhez*, nën ndikimin e serbishtes, pastaj *vagon* nga fjala angleze *wagon*, *bandë* nga *band* (p.sh. *bandë xhazi* nga *jazz band* e anglishtes) etj. Natyrisht, kjo mënyrë përshtatjeje mund të dallojë në huazimet që në gjuhën shqipe depërtojnë përmes serbokroatishtes, e cila, si një gjuhë e ndërmjetme, bën përshtatjen e saj fonematike.

Trajta e hasur vazhdimisht *Theçër* (me *ë*) krijon edhe një vështirësi tjetër gramatikore në gjuhën shqipe. Me rastin e sajimit të paradigmes së saj, nëse shkruhet dhe shqiptohet *Theçër* (me *ë*), do të paraqiteshin trajtat *Theçri*, *Theçrin*, *Theçrit* etj., sipas rregullave morfosintaksore të gjuhës shqipe, me analogji të emrit shqip *Pjetër*, do të krijoheshin trajta që largohet aq shumë nga trajta e saj burimore, saqë e humb trajtën burimore të vet, dhe e gjithë kjo bëhet pa nevojë. Këtë shmangie nga trajta e mundshme e këtij patronimi nuk mund t'ia mveshim gjuhës serbe si gjuhë e ndërmjetme, sepse në atë gjuhë përdoret trajta *Taçer*. Ndonëse qëllimi i gjuhës 'marrëse' është t'i përshtatë elementet gjuhësore të huaja, ekziston një kufi i arsyeshem deri ku mund të arrijë përshtatja. Në çdo gjuhë ekziston një traditë e krijuar me kohë dhe ajo duhet të respektohet. Kundër kësaj mënyre të përshtatjes së emrave anglezë dëshmojnë shumë emra të

tjerë të përveçëm të përdorur tashmë në shqipe: *Fishër, Bejkër, Kartër, Sojër* e ndonjë tjetër (me theks mbi rrokjen e dytë). Ku do të na shpinin trajtat origjinale të anglishtes (dhe jo vetëm të anglishtes) po të përdorëshin në shqipe ashtu si i shqiptojnë vetë anglezët a amerikanët apo anglofonët? Kjo do të ishte fare e pamundshme për shqipfolësit e sotëm, si në fjalët: *Làndën* do të duhej t'i thoshim Londrës, *Britën* (Britanisë) etj.

Por trajta më e shtrembëruar dhe e shëmtuar e këtij patronimi anglez dëgjohet ndonjëherë në lajmet e Radio-Prishtinës: *Thejçër*. Kësaj vetëm mund t'i thuhej të bëhesh më anglez se vetë anglezët.

Nga pikëvështrimi gramatikor, në mbështetje të parimeve të përgjithshme që duhet të vlejnjë për emrat e huaj, ky emër dhe të tjerë duhet të përdoren në rasi përkatëse si dhe emrat e shqipes. Pra, duhet të thuhet: kryetarja *Margaretë Thaçeri*; e priti *Margaretë Thaçerin* etj.

*

Po në valët e Radio - Prishtinës shpesh dëgjohet, nuk dimë për çfarë arsyeje, të shqiptohet *internejshënël* (pres), që është një agjenci lajmesh. Çështja e kësaj fjale qëndron sikur me patronomin *Thejçër* që u zu ngoje më sipër. Kjo fjalë duhet të shqiptohet /*internashë`nal*/. Për hir të theksit të natyrshëm në gjuhën shqipe, e parapëlqejmë trajtën e shënuar më sipër [*intërnashë`nal*], me theks mbi rrokjen e fundit - `nal, e cila mbase i afrohet më shumë mënyrës si shqiptohen fjalët e huaja në shqipe. Por asfare [*inter`nejshënël*]. Theksi i vënë si në fjalën e fundit (nej), do të binte mbi rrokjen preparoksitone, gjë që nuk është i rëndomtë për shqipen.

*

Në valët e Radio - Prishtinës na i ka zënë veshi edhe disa emra të tjerë të shqiptuar (gjoja) si anglezët ose amerikanët, si për shembull, *Teksës* shqiptohet /*tëksës*/, me theks mbi rrokjen e parë dhe me ndryshim zanoreje në rrokjen e fundit /a/>/ë/. Toponimi *Kanzas*, po ashtu një shtet i SHBA-së, shqiptohet /*kënzës*/. Edhe për këta emra e emra të tjerë vlen të respektohet ligjshmëria e gjuhës shqipe dhe tradita tashmë e krijuar me këta emra dhe me emra të tjerë të ngjashëm. Pra, duhet të shkruhet *Teksas, Teksasi, Teksasin, Teksasit; Kanzas, Kanzasi, Kanzasin* etj., gjithnjë me theks mbi rrokjen e dytë të rrënjës duke rimuar f.v. me *Vërbas*. Duhet ta ruajmë gjuhën shqipe nga çoroditjet. Përndryshe do të kemi një gjuhë me theksime më të parëndomta, duke u larguar gjithnjë më shumë nga gjedhet e theksimeve tradicionale.

*

Hasen ndonjëherë në trajta të gabueshme të të shqiptuarit dhe të shkruarit edhe të emrave të përveçëm, qofshin patronime a toponime, kur ata janë në gjininë mashkullore dhe rrënja u mbaron me /i/, si *Kenedi*, *Helsinki*. Kur përdoren në trajtën e shquar në shqipe, këta emra nuk ndryshojnë trajtën rrënjësore dhe duket sikur të kishin trajtat e pashquara: *Kened*, *Helsink*. Prandaj i hasim në trajta të gabuara: *Kenedët* (shumës), *Helsinki* (i shquar). Kur përdorim fjalë a emra të huaj në gjuhën shqipe, kemi të drejtë, mbase edhe detyrim, t'i përshtatim sipas rregullave gramatikore të gjuhës shqipe, por nuk duhet t'i cungojmë, t'ua prishim rrënjën. Mbiemri në fjalë është *Kenedi* e jo *Kened*, prandaj shumësi duhet të jetë *Keneditë*. Emri i qytetit finlandez është *Helsinki* e jo *Helsink*, prandaj nuk mund ta përdorim në trajtën e shquar **Helsinki*, **Helsinkun* etj., por *Helsinki*, në *Helsinki* etj.

Dukuri e ngjashme me dy emrat e përveçëm më sipër janë edhe emrat *taksi* e *alibi*. Trajta e tyre e pashquar mbaron me *i* e jo me bashkëtingëllore, pra *taksi* /taksi/ e jo *taks* /taks/, si dhe *alibi* /ali`bí/ e jo *alib*. Që të dy këta emra kanë theksin mbi rrokjen e fundit (mbi *i*). Ata shqiptohen /tak`sí/ me theks mbi rrokjen e fundit dhe /ali`bí/ me theks mbi rrokjen e dytë. Prandaj, është gabim të thuhet: Erdha me *taksi* /`taksi/, ose Ai pati *alibin* /a`líbin/ e fortë, por: E pashë *taksinë* e zezë. E pata *alibinë* e sigurt,

*

Gjuha shqipe, nr. 3, ff. 51-54, 1987, Instituti Albanologjik i Prishtinës.

SINTAGMA EMËRORE NË GJUHËN SHQIPE TË NDËRTUARA ME NDIKIM TË ANGLISHTES

Gjuhët e ndryshme kanë edhe struktura të ndryshme, domethënë rregullim të brendshëm që mund të dallojë nga një gjuhë tjetër. Konstrukti gjuhësor bie në sy më pak se leksiku, prandaj edhe rreziku është më i madh nëse aty bëhen ndikime, meqë ato nuk hetohen lehtë as nuk shmangen lehtë. Së këndejmi, shtrohet si detyrë e gjuhëtarëve që të jenë më syçelë për t'i hetuar, e nëse duhet, edhe për t'i luftuar ndikimet gjuhësore të huaja në rendin e fjalëve në sintagma e fjali.

Gjuha shqipe, sidomos e medimeve këtu në Kosovë, po tregohet mjaft e gatshme për të përvetësuar fjalë të huaja shumë herë pa kurrfarë nevojë. Prandaj vlen të vihet në shqyrtim njëherë në mënyrë të gjithanshme pse po ndodh kështu dhe si t'i shmangemi kësaj sëmundjeje gjuhësore.

Gjuhësia si shkencë tashmë ka vërtetuar disa nga arsyet pse huazohen elemente gjuhësore të huaja. Arsyeja kryesore është për të emërtuar gjësendet dhe dukuritë e reja që vijnë nga jashtë e për të cilat nuk gjenden fjalë përkatëse në gjuhën marrëse, në rastin tonë - në gjuhën shqipe. Shkak për të huazuar mund të jetë edhe njëfarë mode e disa folësve për shprehje e fjalë të reja, të huaja, me të cilat ata tregohen se gjoja janë të ngritur, të arsimuar dhe se njohin gjuhë të tjera. Arsyet konkrete për këtë dukuri ndër ne mbeten të hulumtohen nga gjuhëtarët, e sidomos nga ata që do të merren me çështjet ose problemet sociolinguistike, meqë kjo dukuri nuk është vetëm çështje e pastër gjuhësore. Mendojmë se kjo është një fushë me material të bollshëm për hulumtime shkencore dhe me interes të madh për shkencën e albanistikës.

Gjuha shqipe, sipas një ndarjeje që ka bërë L. Tesnière⁴ në veprën "Elementet e sintaksës strukturale", duhet t'i përkasë grupit të gjuhëve me rend strukturor centrifugal. Me fjalë të tjera, sipas këtij linguisti, kriter për klasifikimin tipologjik të gjuhëve është rendi i fjalëve në fjali. Sipas këtij fakti, ai dallon gjuhët me rend të fjalëve të strukturës centrifugale, siç janë gjuhët romane, në të cilat në sintagmën emërore me mbiemër si

⁴ L. Tesnière, *Eléments de syntax structurale*, Paris, 1959.

përcaktor prin emri dhe pas tij vijon mbiemri. Gjuhët që kanë rend të fjalëve në sintagmë të kundërt me këtë, siç janë gjuhët gjermanike, sllave etj., Tenieri i quan gjuhë centripetale. Ky dallim midis gjuhëve të ndryshme është i rëndësishëm për klasifikimin e tyre tipologjik dhe njëherësh për identifikimin e tyre, prandaj dhe gabimet e bëra në këtë aspekt duhet të konsiderohen shkelje të rregullave të gjuhës shqipe.

Mirëpo, siç thamë, në shtypin tonë dhe në radio e televizion, si dhe në ligjërim të përgjithshëm të shqipfolësve, hasen shpesh konstrakte që nuk përkojnë me natyrën e gjuhës shqipe. Përveç të tjerash, ky mosrespektim i natyrës së gjuhës shqipe bëhet edhe me huazimet angleze, të cilat janë temë e këtij shqyrtimi. Do të cekim këtu vetëm disa nga rastet që hasen bukur shpesh, duke bërë me dije se ky konstatim nuk është rezultat i ndonjë studimi dhe hulumtimi të përpiktë, të thellë dhe afatgjatë. Me një hulumtim më të sistemuar sigurisht do të dilnin në dritë edhe shumë dukuri të tjera që nuk janë përmbledhur në këtë kumtesë.

Fjala angleze në formë të shkurtuar *pop*, e cila del nga *popular* “i/e popullarizuar”, është inventar bukur i shpeshtë sidomos si term muzikor. Kështu hasim:

“Radio stacioni i njohur “Karolina” ndërpreu programin e vet të njohur të *pop muzikës*”, po ashtu: “13.00: *Pop muzeu*, (të dy rastet në “Rilindja”, 22 mars, 1980).

Pastaj mund të haset edhe kompozita e dyfishtë: “*Pop-rok jehona*, emision foljor muzikor”, (“Rilindja”, 13.12.1979).

Do të ishte shumë më me vend dhe do të tingëllonte më shqip dhe bukur, duke mos humbur asgjë nga efekti e ngjyra emocionale, stilistike ose çfarëdo qoftë tjetër, sikur në vend të sintagmave emërore të cekura më sipër të përdreshin sintagmat shqipe: *muzikë e popullarizuar*, *muzeu i popullarizuar*, *jehonë e popullarizuar e rokut*, nëse fjalën *rok* duam dosido ta përdorim si huazim.

Po kështu, sipas po këtij modeli, shkruhen dhe thuhën edhe këto:

-*rok muzikë*, po edhe “...të udhëhequr nga *rok këngëtari* Xhim Morison” (të dy rastet në “Rilindja”, Programi i radios, 7 korrik 1978).

-“*Hit paradë*”. Në emisionin muzikor “*Parada e hiteve*” do të ...” (“Rilindja”, 13 shkurt, 1980). Shumë më mirë do të tingëllonte sikur të thuhej: *muzikë roku*, *këngëtar i rokut*, *paradë hiti*.

Sipas kësaj skeme të huaj për gjuhën shqipe përdoren edhe shumë

sintagma emërore të tjera duke vënë mbiemrin para emrit, si p.sh.:

- boks meç*: “Në episodin e shtatë Xhulia dhe Rudi shkojnë në *boks meç* të shohin Tomin”. (“Rilindja”, 24 qershor 1977).
- vikend programi*: “Temë e emisionit të *vikend programit* të TV Sarajevës...” (“Rilindja”, 22 qershor 1980).
- training programi*: “Opinionit iu prezantua se çfarë është *training programi* i njëjive ushtarake...” (“Rilindja”, 15 shkurt 1979).
- shopping qendra*: “*Shopping qendra* e parë kosovare” (titull) (“Rilindja”, 12 prill 1978).
- seks bombë*: “Rakel ishte një kohë të gjatë si *seks bombë* dhe sidomos seksual i Holivudit” (“Rilindja”, 24 qershor 1977, Programi i RTV).
- seks simbol*: “Ish aktorja e njohur amerikane, *seks simboli* i njohur...” (“Rilindja”, 27 nëntor 1980).
- Grand hoteli*: “Nën platonë e mbrapme të *Grand hotelit*...” (“Rilindja”, 27 nëntor 1980).

Na e merr mendja se duhet të shkruhet shqip dhe të thuhet përkatësisht: *meç boksi*, madje edhe më mirë *ndeshje boksi*, pastaj *program vikendi*, *program treningu* ose edhe më mirë *program ushtrimi* a *stërvitjeje*, *qendër tregtie* (ose *tregtare*) dhe të mos përdoret fare huazimi *shopping*, sepse nuk sjell asgjë të re në fushën e semantikës.

Në gjuhën shqipe hasen edhe shumë togfjalësha e kompozita me njërin nga elementet ose që të dytë (të gjithë) të huazuar nga gjuha angleze, si b.f.: (happy end) *hepiend*, (disk jokey) *disk-xhoke*, (Jambo Jet) *xhamboxhet*, (fair play) *ferplej*, (mini-computer) *minikompjuter*, (taxi-meter) *taksimetër*, (showman) *shoumen*, (show-gerl) *shougerl*, (super-show) *super-shou*, (call-gerl) *kol-gerl*, (gegman) *gegmen*, (superman) *supermen*, (Intelligence Service) *Intelixhens Servis*, (Foreign Office) *Forin Office* etj.

Këto kompozita e togfjalësha, nëse duam t’i pranojmë si huazime në gjuhën shqipe, nuk kemi si t’i përdorim ndryshe, meqë ato tashmë janë njësuar dhe bërë një fjalë madje edhe shkruhen si një fjalë ose fjalë e ndarë me vijëz lidhëse, përveç dy togfjalëshave të fundit: *Forin Ofis* dhe *Intelixhens Servis*, të cilët shkruhen ndaras si dy fjalë. Këto fjalë, pra, në gjuhën shqipe trajtohen si dhe fjalët e tjera të përbëra, p.sh.: hekurudhë, elektromotor etj., që dalin nga fjalët *udhë hekuri* dhe *motor elektrik*, respektivisht. Madje, shumica e folësve as që e dinë se ato fjalë të huazuara nga anglishtja janë kompozita, por merren si një fjalë.

Këtu u vunë në dukje vetëm disa shembuj të ndërtuar me modelin e

cekur të huaj për gjuhën shqipe, më shumë për ta theksuar problemin, sesa për të tentuar të shteret i gjithë materiali i tillë, që është në dispozicion të hulumtuesit. U shqyrtua, pra, kjo çështje më shumë si dukuri që duhet luftuar, sepse i dhunon rregullat e mirëfillta të gjuhës shqipe dhe e rëndon natyrën e saj si një gjuhë tipike që është. Qëllimi është të jepet shenjë për një dukuri të papëlqyeshme dhe mundësisht t'i ndalet hovi, meqë nëse kështu vazhdohet, nuk dihet ku mund të ndalet.

Vlen të shtohet edhe kjo e dhënë sa për sqarim. Këtu u dhanë shembuj të nxjerrë vetëm nga gazeta “Rilindja”, gjë që është vetëm e rastit, po kjo nuk do të thotë se mediumet e tjera nuk përdorin struktura të tilla e të ngjashme.

*

Studia Philologica, nr. 1-2, ff. 161-164, 1981, Fakulteti Filozofik i Universitetit të Prishtinës.

HUAZIME TË VEÇANTA NGA ANGLISHTJA

Huazimet gjuhësore gjithmonë kanë qenë temë për gjuhëtarët. Me shtimin e mënyrave dhe të mjeteve të komunikimit, huazimeve gjuhësore u hapen dyert gjithnjë më shumë. Sado që një gjuhë të jetë konservative dhe puristët e saj të bëjnë çmos për ta ruajtur atë të “pastër”, nuk mund t’ua ndalin hovin huazimeve gjuhësore; ata vetëm mund ta ngadalësojnë depërtimin e tyre. Sot nuk ka gjuhë plotësisht të “qëruar” nga huazimet.

Dikur të huazuarit bëhej më shumë në gjuhën fqinje, kur dy popuj ishin afër njëri-tjetrit ose jetonin të bashkuar, të përzier, ose, së paku, kishin marrëdhënie të mira midis tyre. Sot mjetet e komunikimit janë përsosur aq shumë, saqë për huazimet territori e kufiri nuk paraqesin më pengesa të mëdha. Një fjalë e re, b.f. një “skajlab” (skylab), brenda disa orësh mund të dëgjohet në shumë gjuhë e në shumë vende të botës.

Në këtë mënyrë edhe gjuha angleze, ndonëse vendet ku ajo flitet janë në largësi të mëdha gjeografike nga vendi ynë, me elementet (fjalët) e saj ushtron ndikim edhe në gjuhën shqipe gjithandej, qoftë në sferën sportive, muzikore, politike, tregtare etj. Prandaj nuk është e tepërt as pa dobi që ato të studiohen edhe në gjuhën shqipe, ndonëse ndikimi dhe prania e tyre në gjuhën shqipe, tash për tash, nuk është në përmasa të tilla siç janë huazimet e turqishtes, të gjuhëve sllave dhe të frëngjishtes.

Duke studiuar huazimet angleze në gjuhën shqipe, kësaj radhe në rrafshin fonemik, hulumtohen ndryshimet që kanë hyrë dhe hyjnë nga anglishtja në gjuhën shqipe. Përkatësisht, hulumtohen ndryshimet që kanë pësuar ose pësojnë fonemat e anglishtes duke u zëvendësuar me të gjuhës shqipe, ose duke u përshtatur fonemave të shqipes. Ky proces është i pranishëm gati përherë dhe në çdo huazim, sepse sistemet fonemike të të dy gjuhëve thuajse kurrë nuk janë të njëjta, madje shikuar në mënyrë të mprehtë, nuk hasen në asnjë fonemë, po që se merren parasysh të gjitha tiparet karakteristike të fonemave në një gjuhë me tiparet përkatëse të tyre në gjuhën tjetër.

Sipas R. Filipoviçit,¹ fjalët e huaja, gjatë kalimit prej gjuhës ma-

¹ R. Filipoviç, *Morphemic Importation...*, 1960.

rrëse në gjuhën dhënëse, u nënshtrohen tri fazave:²

1. Nëse fjala e huaj në gjuhën marrëse përdoret fare e paasimiluar, domethënë është bartur në mënyrë të drejtpërdrejtë në gjuhën e dytë, pa asnjë përshtatje, ajo konsiderohet fazë ose dukuri e *bartjes së drejtpërdrejtë*, kurse fjala e tillë quhet *fjalë e huaj*.

2. Nëse fjala e huaj gjatë përshtatjes në gjuhën marrëse fillon të pranojë disa tipare të sistemit fonemik të kësaj gjuhe, në të vërtetë paraqitet dukuria e përputhjes së dy sistemeve fonemike, dhe kjo gjendje quhet *interferencë*. Fjala e huazuar në këtë fazë të përshtatjes quhet *huazim i huaj*.

3. Materiali gjuhësor i huaj përdoret një kohë të gjatë në gjuhën marrëse. Gjatë përdorimit të shpeshtë e të gjatë ai rëndom i përshtatet shumë gjuhës marrëse, saqë më në fund nuk dallon me asnjë fonemë apo tipar foneme nga sistemi fonemik i gjuhës marrëse. Kjo fazë e përshtatjes quhet *integrim* ose *asimilim*, ndërsa fjala në këtë fazë quhet *huazim*.

Procesi i përshtatjes gjatë fazës së parë dhe të dytë rëndom nuk zgjat shumë, sepse fjala e huaj, posa të hyjë në gjuhën marrëse, fillon procesin e përshtatjes, i cili vazhdon derisa të mos arrijë në integrim apo asimilim të plotë. Dy fazat e para, sipas kohës, janë në përpjesëtim të zhdrejtë me dendurinë e përdorimit të fjalëve të huaja, që domethënë se sa më shpesh të përdoren fjalët e huaja, aq më shpejt ato përshtaten në gjuhën marrëse. Në këto dy fazat e para gjenden jo shumë fjalë angleze në gjuhën shqipe dhe ato vazhdimisht lëvizin drejt fazës së tretë - integrimit të tyre të plotë. Mund të thuhet se të studiohen fjalët e huaja nga ky këndvështrim nuk është punë e lehtë; sidomos është vështirë të përcaktohen kufijtë midis fazës së parë dhe të dytë të përshtatjes së tyre në gjuhën marrëse. Mund të thuhet se fjalët në këto dy faza nuk kanë formën as të gjuhës së huaj as të gjuhës marrëse dhe se ato kanë status gjysmë të huaj. Kjo gjendje e fjalëve të huaja quhet *kompromis fonetik*.

Gjatë vështimit të “sjelljes” së fjalëve angleze kur paraqiten në shqipet, mund të vërehen disa të dhëna fonetike. Kur fjalët angleze paraqiten për herë të parë në shqipet, është konstatuar se ato hasen në njërën nga këto forma:

a) Fjala shkruhet në trajtën origjinale të anglishtes. Ky rast është më i shpeshtë tek emrat e përveçëm të njerëzve dhe tek emrat gjeografikë, por

² Këtu nënkuptohen ato fjalë që mbeten në gjuhën marrëse, përkatësisht ato që ajo i pranon, sepse fjala e huaj mund të mbetet në fazën e parë dhe të mos përshtatet më tutje, ose gjuha marrëse të mos e pranojë për gjithnjë në fjalorin e saj.

kjo dukuri haset edhe në fjalët e tjera, p.sh. *love story*.³

b) Fjala angleze shkruhet në trajtën origjinale, ndërsa në kllapa jepet trajta e shqiptimit të saj në shqipet, si p. sh.: *Watergate* (votergejt).

c) Fjala angleze paraqitet me shkrimin shqip dhe shpeshherë brenda thonjzave, kurse në kllapa shkruhet në trajtën origjinale, për shembull: “*skajlab*” (skylab).

ç) Shkruhet trajta origjinale, kurse në kllapa jepet përkthimi i saj në shqipet, për shembull: *fibreglass* (fije qelqi).

d) Fjala angleze shkruhet në trajtën origjinale, por brenda thonjzave, p.sh.: “boom”.

dh) Fjala angleze shkruhet në thonjzë, kurse në kllapa jepet edhe përkthimi i saj, p.sh.: “miss” (bukuroshe).

e) Shkruhet me shkronjë të madhe, brenda thonjzave ose pa to, p.sh.: “Mis”, Lejzer.

ë) Fjala angleze shkruhet me shkronja kursive ose me grafi tjetër dalluese.

Për këtë arsye shpesh ndodh që e njëjta fjalë e huaj të ketë disa forma alternative, të paraqitet shpesh në përdorim paralel, madje të haset në të njëjtën faqe të gazetës a të revistës në dy apo më shumë trajta, p.sh.: *laser, lazer, lazër. lejzer dhe lejser*.

Gjatë përshtatjes së fjalëve angleze në gjuhën shqipe, si në çdo gjuhë, patjetër bëhet zëvendësimi i fonemave angleze me fonema të gjuhës shqipe. Shikuar me sy të mprehtë nga këndvështrimi fonemik, mund të vërehet se thuaja secila fonemë e anglishtes, më atë rast, zëvendësohet me fonemën përkatëse ose më të afërt të gjuhës shqipe. Tiparet e çdo foneme të gjuhës dhënëse, sado që mund të jenë të ngjashme me ato të fonemave të gjuhës marrëse, konkretisht të anglishtes me të shqipes, ato nuk përkojnë plotësisht në mes tyre. Natyrisht, këtu nuk do ta përqendrojmë vëmendjen vetëm mbi çështjet e tipareve fonemike, por për hir të anës praktike, fonemat e ngjashme në mes dy gjuhëve i konsiderojmë të jenë identike, si b.f. fonemat /b/, /n/, /s/ etj. Këtë e bëjmë edhe për arsye se sado që të argumentojmë se, b.f., fonema angleze /d/ nuk është plotësisht identike me fonemën /d/ të shqipes, sepse e para është okluzive dhëmbore, kurse e dyta okluzive ndërthëmbore; e para është e aspiruar në disa pozita a kontekste brenda fjalës, kurse e dyta thujse nuk e njeh dukurinë fonetike të aspirimit, megjithatë nuk ka asnjë fonemë tjetër të shqipes, e cila do t'i

³ Shembujt janë marrë nga korpusi i mbledhur për një studim më të gjerë, prandaj për të mos e rënduar tekstin, nuk po e shënojmë burimin e çdo shembulli veçmas.

afrohej më shumë se kjo, madje as sa kjo /d/, fonemës /d/ të anglishtes. Pra, nuk ka zgjidhje tjetër praktike, përveç që të themi se /d/ e anglishtes të zëvendësohet me /d/ të shqipes. Prandaj, po të kishim të bënim me fjalët që kanë vetëm fonema me ngjashmëri të tillë në mes dy gjuhëve, puna e gjuhës dhe e gjuhëtarit do të lehtësohej shumë.

Mirëpo, gjuha angleze në sistemin e saj fonemik ka disa fonema, të cilat nuk ekzistojnë në gjuhën shqipe. Kjo është çështje mbizotëruese në këtë punim. Këtij grupi i përkasin sidomos fonema zanore /æ/ dhe gjysmëzanore /w/. Është me interes të veçantë të shohim edhe çështja e fonemës /ə/ - (ë), e cila deri diku i afrohet kësaj të shqipes, sidomos kur kjo e fundit është në rrokje të theksuar.

Meqë fonema angleze /æ/, e cila është tingull i hapur, nuk ka ekui-valent të saj në gjuhën shqipe, ajo në huazimet angleze në gjuhën shqipe është zëvendësuar pa ndonjë pa ndonjë rregull të përcaktuar saktësisht. Ajo zëvendësohet ose në bazë të shkrimit, ose në bazë të shqiptimit së saj. Përshtatja e saj, pra, bëhet kryesisht në dy mënyra: /æ/ > /a/, /æ/ > /e/.

1. Zëvendësimi /æ/ me /a/, i cili është bërë kryesisht me ndikim të grafisë, mund të shihet në këta shembuj:

brandy /'brændi/ - brandi,
skylab /'skailæb/ - skajlab etj.

2. Zëvendësimi /æ/ me /e/, i cili është më shumë rezultat i të dëgjuarit, haset në shembujt e njëjtë:

brandy /'brændi/ - brendi,
skylab /'skailæb/ - skajleb etj.

Një faktor për këtë zëvendësim nën 2. është gjuha ndërmjetëse. Për arsye se vendet ku flitet anglishtja si gjuhë amtare janë larg vendit tonë, një numër i madh fjalësh të kësaj gjuhe depërtojnë në shqipet përmes një apo ndonjëherë edhe të më shumë gjuhëve ndërmjetëse. Në këto gjuhë fjalët angleze mund të pësojnë ndryshime të mëdha fonemike, përkatësisht t'i përshtaten sistemit fonemik e morfemik të tyre. Fjalët e tilla në gjuhën shqipe vijnë në trajtë të krijuar me zëvendësim /æ/ > /e/. Aty nuk mbetet gjë tjetër për gjuhën shqipe, përveç ta pranojë fjalën e tillë tashmë të përshtatur fonemikisht si të formuar, të gatshme.

Faktor tjetër për këtë mënyrë të zëvendësimit të /æ/ me /e/ është fakti se në disa të folme të gjuhës shqipe ekziston një tingull /ɛ/ që në të vërtetë është një /e/ shumë e hapët.⁴ Pra, meqë shqipja ka një tingull të

⁴ A. Dodi, 1960, f. 60, e quan këtë fonemë *tingullëfonemë* dhe thotë se në trans-

tillë (sigurisht alofon i fonemës /e/, e jo fonemë), na e merr mendja se fonema angleze /æ/ për veshin e shqipfolësit është më afër fonemës /e/ sesa /a/. Prandaj, kur fjala angleze me këtë fonemë në vete depërton në shqipet me anë të gjuhës së folur dhe pa ndërmjetësim të ndonjë gjuhe tjetër, ka shumë gjasa që fonema angleze /æ/ të zëvendësohet me fonemën shqipe /e/. Mbase kjo, si dhe ndikimi i gjuhës ndërmjetëse, janë arsyeja që, ndonëse në gjuhën shqipe huazimet angleze depërtojnë më së shumti me anë të mediumit të shkrimit, në shqipet ka numër përafërsisht të njëjtë huazimesh angleze me zëvendësim /æ/ > /e/ si dhe /æ/ > /a/.

Për shkak se gjuhës shqipe i mungon fonema /æ/, shpesh hasen dy forma po të njëjtit huazim të anglishtes, që ka atë fonemë në trup, herë me zëvendësim të bërë /æ/ > /e/ e herë me /æ/ > /a/. Për shembull:

jazz /dʒæz/ > xhez dhe zxhaz,
 match /mæt/ > meç dhe maç,
 sandwich /sændwit/ > senduiç dhe sanduiç.

Megjithatë mendojmë se ka më shumë arsye fonemike që të bëhet zëvendësimi i /æ/ angleze në shqipet me /a/, sesa me /e/. Këtë qëndrim e mbështesim në këto dy të dhëna: 1) kjo fonemë angleze, sipas vendit ku artikullohet në gojë dhe mënyrës si artikullohet, është më e afërt me fonemën /a/ sesa /e/ të shqipes, dhe 2) në këtë lloj të zëvendësimit kontribuon edhe grafia e fjalëve angleze që e kanë këtë fonemë.

*

Një fonemë angleze tjetër, e cila gjatë procesit të përshtatjes së fjalëve të kësaj gjuhe në shqipet tregon zëvendësim të ndryshëm është /w/. Kjo fonemë nuk ekziston në sistemin fonemik të gjuhës shqipe. Kjo gjysmëzanore, meqë nuk ka ekuivalent në gjuhën shqipe, zëvendësohet kryesisht në dy mënyra: a) me bashkëtingëlloren frikative buzore-dhëmbore të shqipes /v/, dhe b) me zanoren e shqipes të ngritjes së lartë të sprasme /u/. Mënyra e parë e zëvendësimit të kësaj foneme angleze në shqipet, së pakut gjer tani, është më e dendur.

a) tramway /'traæmwei/ - tramvaj, waggon /'wægən/ - vagon etj.
 b) zëvendësimin /w/ me /u/ e hasim në këso fjalësh:
 esquire /is'kwaiə/ - eskuajër, quiz /kwiz/ - kuiz etj.

Sipas drejtshkrimit të gjuhës shqipe,⁵ konsiderohet se zëvendësimi i

kriptim duhet shënuar me /æ/. Autori cek se kjo dëgjohe në gegërishten veriore me përdorim të kufizuar vetëm në disa fjalë, p.sh. hæ, pæ, ti thæ, ti ræ etj. Shih edhe shënimin 27 më sipër.

⁵ Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe – projekt, 1967, paragrafi Ç6.

/w/ me /u/ është më i drejtë. Fonema /w/ si gjysmëzanore që është, në bazë të mënyrës së artikulimit, u afrohet si bashkëtingëllores /v/ ashtu zanores /u/, por mund të thuhet se gjendet diku në mes të këtyre dy fonemave të shqipes. Nga ana tjetër, mbase zëvendësimi i /w/ angleze me zanoren /u/ është i mundshëm në përgjithësi. Por ky zëvendësim nuk mund të bëhet në rastet kur ajo fonemë i paraprin zanores /u/ në huazimin anglez, sepse në atë rast nuk ka mundësi të shqiptohen dy zanore /u/ njëra pas tjetrës, pra /uu/, b.f. wool /uul/.⁶ Fundja, shqipja nuk njeh një shpërndarje të tillë të zanoreve.

Meqë nuk ka një kriter të bindshëm për transkriptimin e kësaj foneme në gjuhën shqipe, shpesh haset përshtatja e saj në të njëjtën fjalë në të dyja mënyrat e zëvendësimit të cekura më sipër, për shembull:

kuiz /kwiz/ - *kuiz* dhe *kviz*; weekend /'wi:kend/ - *uikend* dhe *vikend*.⁷

Pra, siç shihet, ka laramani në të zëvendësuarit e fonemës /w/ angleze. Përdorimi me hezitim dhe laraman nuk është gjë e mirë në gjuhë dhe shkakton hutë. Prandaj parashtrahet pyetja se cila nga këto dy forma të zëvendësimit është më e drejtë.

Meqë kjo fonemë as nuk është zanore e plotë sepse nuk mund të krijojë rrokje, por as që është bashkëtingëllore e mirëfilltë. Më tutje duhet të cekem edhe të dhënat si më poshtë.

1. Gjuhësia pranon rolin e madh që loz drejtshkrimi me ndikimin e vet gjatë procesit të përshtatjes së fjalëve të një gjuhe kur përdoren në gjuhën tjetër. Ky faktor ka të bëjë shumë, veçmas me fonemën /w/ të anglishtes, e cila në shkrimin e shqipes i ngjan më shumë bashkëtingëllores /v/ (ajo edhe quhet dubël v), sesa zanores /u/. Në gjuhën gjermane shkronja w shqiptohet /v/. Meqë në gjuhën shqipe kanë hyrë shumë huazime gjermane, ky fakt mund të ndikojë te folësit në mënyrë të tërthortë që ta shqiptojnë më shumë /w/, sesa /u/. Prandaj mendojmë se zëvendësimi i fonemës angleze /w/ mund të bëhet me /v/ në gjuhën shqipe.

2. Kjo fonemë angleze në shumë gjuhë, me rastin e përvetësimit të fjalëve angleze, është zëvendësuar me /v/, b.f. në frëngjishte, gjermanishte, në gjuhët sllave etj. Kjo e dhënë ndikon që, deshëm a s'deshëm, do të ketë pasoja në gjuhën shqipe.

3. Fonema angleze /w/ nuk mund të formojë rrokje në fjalë. Kjo

⁶ V. Nuhiu, 1972.

⁷ Zëvendësimi /w/ > /u/ bëhet më shpesh në Shqipëri, kurse zëvendësimi /w/ > /v/ bëhet në shqipen në Jugosllavi.

vërteton se ajo nuk ka cilësi të zanores, por më tepër të bashkëtingëllores. Prandaj edhe nuk mund të shihet shumë e arsyeshme që në shqipet ajo të zëvendësohet me zanoren /u/.

4. Përvoja ka treguar se kur nxënësit fillojnë të mësojnë gjuhën angleze, shqiptimi i drejtë i tingullit /w/ arrihet me vështirësi të konsiderueshme. Nxënësit ende pa e përvetësuar mirë shqiptimin e tij të drejtë e shqiptojnë si /v/ dhe shumë më vonë dhe rrallë si /u/. Kjo e dhënë dëshmon afërsinë më të madhe të /w/ angleze me /v/, sesa me /u/ të shqipes.

5. Fonema shqipe /v/ është më pak e labializuar dhe e dentalizuar se /v/ angleze. Përkatesisht, dhëmbët e epërm e shtypin më pak dhe më nga maja buzën e poshtme sesa bëjnë këtë anglezët kur e shqiptojnë /v/ në gjuhën e tyre. Kjo e dhënë e përshkrimi fonetik flet për një afërsi më të madhe të /v/ shqipe me /w/ angleze sesa është /v/ angleze me /w/ e tyre. Prandaj edhe kjo afërsi në mes të /v/ shqipe me /w/ angleze i jep disi të drejtë shqipfolësit që ta zëvendësojë këtë të fundit me të parën në gjuhën shqipe.

6. Ajo që është e rëndësishme për gjuhësinë është e dhëna se me zëvendësimin e /w/ angleze me /u/ të shqipes në disa huazime angleze krijohen grupe zanoresh dhe bëhet rishpërndarje e tillë fonemash, e cila nuk njihet në gjuhën shqipe, siç janë: /ua-/ në Uashington (Washington), /uo-/ në Uollstrit (Wall Street), /ui-/ në uikend (weekend), uiski /whisky/, /ue-/ uestern (western) etj. Më sa dimë ne, asnjë fjalë shqipe nuk fillon me ndonjë nga grupet e zanoreve të cekura më sipër.⁸ Kjo domethënë se fjalët angleze kanë sjellë inovacione në shpërndarjen e fonemave në gjuhën shqipe. Kjo vlen sidomos për inovacionet e krijuara që shkaktojnë vështirësi të drejtshqiptimit.

7. E dhëna kryesore dhe për të cilën nuk gjendet zgjidhje, është rasti kur fonema /w/ në fjalët angleze gjendet para zanores /u/, si b.f. në Wood /wud/, Wolf /wulf/, Holiwood /'holiwud/ etj., është e pamundur që në shqipet të bëhet zëvendësimi /w/ > /u/, sepse në ato raste do të krijoheshin fjalë me grupe të tilla zanoresh, që nuk i njeh shqipja. Për shembull, fjalët e shënuara më sipër do të duhej të shkruheshin: Uud, Uulf, Holiuud. Kjo domethënë se me pranimin e zëvendësimit /w/ > /u/, do të kemi shumë raste që bëjnë përjashtim. Ndërsa dihet se çdo rregull me përjashtime është më e pavlefshme sesa rregulla pa përjashtime.

⁸ Këtu shqyrtoam vetëm grupet e zanoreve në pozicionin fillestar, ku mund të shihet më lehtë inovacioni i shpërndarjes së fonemave në gjuhën shqipe. Padyshim, inovacione të tilla mund të gjenden edhe në pozicione të tjera (mesore dhe fundore) të fjalëve shqipe.

Për zëvendësimin e /w/ angleze me /u/ të shqipes, përveç të dhënës se kur krahasohen përshkrimet në fonetikat – të gjuhës angleze dhe të gjuhës shqipe – duket se në artikulum /w/ i afrohet më shumë /v/ sesa /u/ shqipe. Nuk kemi ndonjë argument tjetër të bindshëm fonemik. Nga e gjithë kjo del se zëvendësimi i /w/ angleze me /v/ shqipe, është shumë më i arsyeshëm, sesa zëvendësimi i /w/ me /u/. Na duket se zëvendësimi i /w/ me /u/ mbahet pa u analizuar sa duhet, prandaj hidhen të gjitha të dhënat e cekura më sipër dhe përqafohen të gjitha vështirësitë gjuhësore që, po ashtu, u cekën më sipër (prej 1 deri në 7). Fundja, kjo mënyrë e zëvendësimit ruhet vetëm me arbitrazhin e rregullave të hartuara të drejtshkrimit. Në gjuhën e folur, marrë në përgjithësi, masat e gjera të folësve nuk e zbatojnë zëvendësimin e fonemës /w/ të anglishtes me /u/ të shqipes.⁹ Ky fakt dhe na ka nxitur t'i rrekemi këtij problemi.

Kur është fjala për fonemën angleze /w/, e cila në drejtshkrimin anglez në të shumtën e rasteve shënohet me shkronjën w, duhet të vihet në dukje edhe një gabim i rëndomtë që bëhet për analogji me këtë shkronjë. Dihet se drejtshkrimi i gjuhës angleze nuk ka ndryshuar gati fare qysh nga koha e Çoserit (Chaucer), në shek. XIV, ndërkohë që shqiptimi i fjalëve, si në çdo gjuhë tjetër, ka pësuar ndryshime të mëdha. Në këtë mënyrë, raporti midis drejtshkrimit dhe drejtshqiptimit ka ndryshuar shumë në anglishte. Prandaj sot, jo çdo herë që shkruhet w, shqiptohet /w/, por mund të shqiptohet disi ndryshe, ose nuk shqiptohet fare.¹⁰ Për këtë arsye, ndodh që kur shqipfolësi do të përdorë një huazim të ri anglez, i cili ka në drejtshkrim shkronjën w, për analogji me fjalët e tjera, ai e shqipton atë, përkatësisht e shkruan edhe atë si /w/ në trungun e huazimit në shqipet, ndonëse ajo mund të mos shqiptohet fare në anglishte. Për shembull:

bungallow /'bʌŋgələu/ - bungalov,

Glasgow /'glazgəu/ - Gllazgov etj.

Forma e tyre e drejtë, shihet nga shembujt, është *bungalou* (ose edhe më mirë *bungəlou*), përkatësisht *Gllazgou*.

*

⁹ Një numër informantësh e lexuan tekstin e përpiluar enkas, në të cilin kishte mjaft huazime angleze me fonemën /w/ në trung të fjalëve, dhe gati në të gjitha rastet atë e shqiptonin /v/. Vetëm folësit më pedantë e shqiptonin /u/, por në aso mënyre që ishte bulur larg nga /w/ angleze. Kur në bisedën e organizuar, e cila ishte e inçizuar në shirit manjetofoni, bashkëbiseduesit nxiteshin të përdornin fjalë (huazime) me fonemën /w/, asnjëri nga ata nuk e shqiptonte atë /u/, por vetëm /v/.

¹⁰ Shih: now /nəu/, knowledge /'nolidʒ/ etj.

Kësaj radhe po ndalemi pak për të shoshitur edhe çështjen e zëvendësimit të zanores qendrore të lartësisë së mesme, fonemën /ə/, e cila është mjaft e afërt dhe e ngjashme me këtë, sidomos kur ajo është në pozicion (rrokje) të theksuar. Mirëpo, përkundër kësaj, më materialin e mbledhur kjo fonemë thuhet në 99 për qind të rasteve nuk është zëvendësuar me /ë/ të shqipes. Se cila është arsyeja, nuk mund të thuhet me siguri të plotë, por duket se ka disa faktorë që ndikojnë në këtë dukuri.

a) Fonema /ə/ angleze, në të shumtën e rasteve, në huazimet angleze gjendet në rrokjen ku në gjuhën shqipe bie theksi. Sipas natyrës së vet, theksi – sidomos ai dinamik, siç është i gjuhës shqipe – kërkon që zanorja në rrokjen ku ai bie, të jetë më e qartë, më e gjatë dhe më e fuqishme se zanoret e tjera, ose, së paku, të ketë njëri nga këto cilësi. Zanorja përkatëse /ə/ e shqipes nuk e ka thuhet asnjëri nga tiparet e cekura më sipër, prandaj gjuha ka tendencë që t'i ikë kësaj zanoreje, po të ketë mundësi të gjendet ndonjë tjetër. Për të parë vendin e theksit, mund të na shërbejnë këta shembuj:

corner /'ko:nə/ - korner (kor'ner),

dollar /'dɒlə/ - dollar (do'llar),

gallon /'gælən/ - gallon (ga'llon) etj.

b) Gjuha ndërmjetëse ka bukur ndikim të madh që fonema angleze /ə/ të mos zëvendësohet me fonemën shqipe /e/. Në gjuhët ndërmjetëse, përmes të cilave një numër fjalësh angleze depërtojnë në shqipet, kryhet deri diku përshtatja e shqiptimit të huazimeve dhe kjo, natyrisht, bëhet sipas sistemit fonemik të atyre gjuhëve. Gjuhët ndërmjetëse mund të mos e kenë këtë fonemë në sistemin fonemik të tyre (siç është serbokroatishtja) dhe në këtë mënyrë fonema /ə/ nga fjala e huazuar zhduket që në atë gjuhë. Në këso rastesh, gjuha shqipe e merr në leksikon e vet huazimin anglez tashmë të formuar, të gatshëm, pa fonemën /ə/.

c) Gjatë zëvendësimit të fonemës /ə/ si dhe të fonemave të tjera, drejtshkrimi origjinal i huazimit ka ndikim të madh, dhe në shumë raste përshtatja e fjalës në gjuhën shqipe bëhet sipas atij shkrimi. Gjatë analizës së zëvendësimit të kësaj foneme në bazë të shkrimit mund të hasen këto raste:

1. Zëvendësimi i /ə/ me /a/, për shembull:

slogan /'slɒgən/ - slogan, taboo /tə'bu/ - tabu etj.

2. Po kështu është bërë zëvendësimi i /ə/ me /e/:

detergent /di'tədʒənt/ - deterxhent, happening /'hæp ənɪŋ/ - hepening etj.

3. Zëvendësimi i /ə/ me /o/, për shembull:

nylon /^ˈnailən/ - najlon, Harold /^ˈhærəld/ - Harold etj.

4. Zëvendësimi i /ə/ me /ar/, për shembull:

dollar /^ˈdolə/ - dollar, standard /^ˈstændəd/ - standard etj.

5. Haset bukur shpesh zëvendësimi i /ə/ me /er/:

boxer /^ˈboksə/ - bokser, docker /^ˈdokə/ - doker etj.

6. Po ashtu haset zëvendësimi i /ə/ me /or/:

humour /^ˈhju:mə/ - humor, tractor /^ˈtræktə/ - traktor etj.

7. Në fund, në bazë të shkrimit, bëhet edhe zëvendësimi i /ə/ me /ir/. Kjo formë e zëvendësimit të kësaj foneme deri tani është hasur vetëm tek emrat e përveçëm ose në fjalët e prejardhura nga emrat e përveçëm, për shembull:

Virginia /vəˈdʒiniə/ - Virxhinia, - Virxhinia, Yorkshire /ˈjo:kʃə/ - jorkshir etj.

Mirëpo, përveç të dhënës së zëvendësimit të fonemës angleze /ə/ nën ndikimin e shkrimit të huazimeve, ekzistojnë shumë raste kur zëvendësimi i saj bëhet pa ndikim të madh të shkrimit, siç janë, për shembull, rastet:

- Zëvendësimi i fonemës /ə/ me /e/: congressman /^ˈkongresmən/ - kongresmen, Ashbury /^ˈæbəri/ - Eshberi etj.

- Zëvendësimi i /ə/ me /or/, për shembull:

computer /kəmˈpjʊ:tə/ - kompjutor.¹¹

3. Materiali i mbledhur për korpusin tonë dëshmon edhe zëvendësimin e /ə/ të anglishtes me /ər/ të shqipes, për shembull:

leader /^ˈli:də/ - lider (dhe lidër),

pullover /^ˈpuləvər/ - pulover (dhe pulovër) etj.

Mënyra e fundit e zëvendësimit të /ə/ me /ər/, pa dyshim, është më adekuatja, meqë në atë rast shfrytëzohen të gjitha mundësitë ekzistuese që gjatë procesit të përshtatjes së fjalës shqiptimi t'i afrohet më së shumti origjinalit. Çdo zëvendësim tjetër, që u cek më sipër, ndikon që shqiptimi i huazimit në shqipet t'i afrohet më pak shqiptimit të origjinalit.

Në fund, edhe pse në shqipet ekziston fonema /ə/, bukur shumë e ngjashme me atë angleze dhe nuk ka asnjë zanore tjetër më të afërt me të, /ə/ e shqipes nuk e zëvendëson në raport një me një atë të anglishtes gati në

¹¹ Ky është ndër rastet e rralla kur shkrimi i huazimit anglez –er të japë /or/, dhe kjo mënyrë e zëvendësimit të fjalës *computer* të bëhet *kompjutor* e jo *kompjuter* e madje *kompjutër*.

asnjë rast. Kjo bën që raporti midis këtyre dy fonemave më të ngjashmet midis tyre të bëjë përjashtim nga raportet që ekzistojnë midis çdo pale fonemash të tjera të ngjashme në gjuhën shqipe dhe në anglishte. Këtu, si duket, çështja qëndron në tiparet dalluese që posedojnë këto dy fonema të ngjashme në dy gjuhë të ndryshme. Fonema /ə/ e anglishtes është më e fuqishme dhe me intensitet të zërit më stabil në rastet dhe pozicionet e ndryshme brenda fjalës sesa /ə/ e shqipes, sidomos kur kjo e fundit është në pozicionin fundor. Fjala angleze *boxer* /'boksə/, e cila rrjedh nga fjala *box* /boks/, shqiptohet gjithnjë me /ə/ fundore të pandryshueshme,¹² ndërsa fjala *box* edhe pas shtimit të mbaresës –er /ə/, e ruan fonemën, zanoren /ə/ të pandryshuar nga zëshmëria në rrokjen e parë, përkatësisht ajo nuk pëson asgjë në cilësi. Kurse në gjuhën shqipe, kur i shtohet fjalës *plak* mbaresa ë /ə/, nuk ka vetëm proces matematikor *plak* + *ë* > *plakë*,¹³ por më atë rast bëhen ndryshime edhe në rrokjen e parë, përkatësisht zanorja në rrokjen e parë fiton në gjatësi (kuantitet) dhe kështu nga trajta *plak* pason trajta *plakë*, fonetikisht /'pla:kə/. Nga ana tjetër, në shqipet kuantiteti (gjatësia) i zanoreve në gjuhën standarde (së pakut nga ajo që është vlerësuar deri tani) nuk ka vlerë fonemike,¹⁴ kurse në gjuhën angleze ka. Po të bëhej zëvendësimi i fonemës angleze /ə/ me /ə/ të shqipes, do të formoheshin fjalë të tilla si: *boxer* > *boksë*, *docker* > *dokë* etj., të cilat do të dallonin më pak nga fjalët nga të cilat kanë ardhur: *boks*, *dok*, mu për arsye se shqipja nuk është shumë konsekuente në shqiptimin e /ə/ në të dy dialektet dhe në të folme të ndryshme.

Meqë fonema /ə/ e anglishtes në pozicionin fundor të fjalës rëndom është zëvendësuar me /er/ dhe variante të tjera të cekura më sipër, theksi i fjalës rëndom është bartur në atë rrokje të fundit:

boxer /'boksə/ > *bokser* /bok'ser/,

humour /'hju:mə/ > *humor* /hu'mor/,

dollar /'dɒlə/ > *dollar* /do'llar/ etj.

Megjithatë, mund të hasen raste të huazimeve kur theksi të mos ketë ndërruar pozicionin nga rrokja përkatëse e fjalës. Ky lloj shqiptimi dëgjohet sidomos në Shqipëri, në fjalët si: *lidër*, *spikër*, *kompjutër* e ndonjë tjetër.

¹² Është fjala për shqiptimin e anglishtes britanike.

¹³ Natyrisht formantët -er anglez dhe -ë shqip nuk kanë të njëjtën vlerë morfemike; i pari formon emrin nga folja, kurse i dyti formon gjininë (gramatikore femërore nga trajta e gjinisë mashkullore e emrit).

¹⁴ Në dialektin geg kuantiteti (gjatësia) e zanoreve ka vlerë fonemike dhe gjatësia e zanoreve paraqet opozicion fonemik.

Mirëpo, në pozicionet mesore, në të shumtën e rasteve fonema /ə/ në huazimet angleze do të mund të ruhej dhe do të duhej të ruhej, përkatësisht të përcillej edhe kur huazimet integrohen në leksikun e gjuhës shqipe. Në këtë mënyrë, shqiptimi i huazimeve në shqipet do t'i afrohej më shumë shqiptimit të anglishtes, kurse dihet se shumë gjuhë (ndër to edhe shqipja) tentojnë që shqiptimin e huazimeve t'ia afrojnë sa më shumë shqiptimit të origjinalit. Zëvendësimi i /ə/ angleze me /ə/ shqipe, do të mund të bëhej në këto raste:

bungəlou në vend të *bungalou*,
komənuelth në vend të *komonuelth*,
pentəgon në vend të *pentagon* etj.

Përveç faktit që i afrohen më shumë shqiptimit të origjinalit, format e dyta kanë më shumë petk të shqipes, kështu që do të paraqisnin një shkallë më të lartë të përshtatjes në sistemin fonemik të gjuhës shqipe.

*

Jehona, nr. 3, ff. 39–53, 1975, Shkup.

TERMA ME PREJARDHJE NGA ANGLISHTJA

Kur është fjala për terminologjinë në gjuhën shqipe, mendoj se në parim duhet të mbështesim qëndrimin që si masë për formimin e një termi të çdo lëmi të jetë brumi i shqipes, duke vjelë gjithë thesarin gjuhësor dhe duke i shterur të gjitha mundësitë gjuhësore, madje edhe gurrën popullore, e pastaj të drejtohem në burime të krijimeve të reja, të kalkeve dhe të huazimeve. Mirëpo, sikurse në asnjë këndvështrim tjetër, as këtu nuk duhet tepruar. Nuk duhet ngulur këmbë që patjetër çdo term të jetë i brumit të shqipes. Puna qëndron pikërisht në faktin se sa ia kemi arritur ta respektojmë fjalën e urtë shqipe: të pjekim mishin e të mos e djegim hellin.

Lidhur me termat a fjalët e prejardhura nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, për një çast po zëmë ngoje vetëm disa të dhëna statistikore të anglizmave në gjuhën shqipe. *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* (FGJSSH) regjistron pak mbi 100 anglizma si elemente tashmë të gjuhës shqipe. Kurse *Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe* (FDGJSH) regjistron një numër më të madh, rreth 140 anglizma. Është interesant të shihet se FGJSSH-ja i ka rreth 20 anglizma që nuk i ka FDGJSH-ja, kurse në anën tjetër, Fjalori drejtshkrimor i ka mbi 50 anglizma, që nuk gjenden në FGJSSH. Nga kjo del se këta dy fjalorë së bashku kanë më shumë anglizma, sesa tregojnë ata një nga një, përkatësisht, aq sa ka ai me numër më të madh, duke ia shtuar edhe dallimin e fjalorit tjetër, përkatësisht $140 + 20 = 160$ fjalë. Në gjurmimet tona, në anën tjetër, duke i regjistruar anglizmat që paraqiten nëpër shkrime shqipe dhe në gjuhën e folur deri në vitin 1974,¹ kemi hasur rreth 500 anglizma, që janë gjetur të përdorur më shumë se tri herë, qoftë në materiale të shkruara, si në gazeta, revista, buletine etj., dhe në televizion e radio, por edhe në gjuhën e folur.

Për nga shkalla e përshtatjes dhe e përvetësimit në gjuhën shqipe, anglizmat mund t'i ndajmë në tri grupe: a) ato që tashmë janë legalizuar dhe 'rehatuar' në gjuhën shqipe (janë përfshirë në fjalorë), b) ato që bien në sy menjëherë si truptha të huaj e që nuk kanë bërë

¹ Në këtë vit kemi mbrojtur punimin e magistraturës në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Zagrebit me titull *Utjecaj engleskog jezika na albanskom jeziku – fonološka analiza* (Ndikimi i gjuhës angleze në gjuhën shqipe – analizë fonologjike).

thuaje asnjëfarë përshtatje ndaj sistemit të gjuhës shqipe, siç janë: *bodi bilder*, *bodi bilding*, *play off*, *renta-a-car*, *sparing partner* etj. dhe c) ato që kanë bërë njëfarë përshtatje ndaj gjuhës shqipe dhe janë përfshirë në regjistra të ndryshëm të gjuhës shqipe, si në gjuhën e mjeteve të informimit, në ligjërim të përgjithshëm etj.

Në fund të këtij shkrimi do të bëjmë fjalë për grupin e parë të tyre. Grupin e dytë nuk do ta prekim kësaj radhe, sepse ka disa vësh-tirësi për zgjidhjen e të cilave lypset ende kohë. Do të zëmë ngoje ve-tëm disa prej huazimeve të grupit të tretë, duke u përpjekur që të japim ndonjë mendim (shpesh nxitës) për përdorimin, respektivisht, për zëvendësimin e tyre. Për të qenë më të saktë, për disa huazime do të japim edhe burimin prej nga e kemi marrë në kontekst të gjuhës shqi-pe. Por kjo nuk do të thotë se i kemi hasur vetëm një herë në gjuhën shqipe. Paraqitja e tyre në gjuhën shqipe është evidencuar disa herë. Radhitjen e tyre e kemi bërë sipas rendit alfabetik.

1. Termi i lëmit të grimit *ajlajner* (*eye-liner*) shënon njëfarë lapsi për ngjyrosjen e vetullave dhe mbase edhe të kapakëve të syve. Kjo fjalë përdoret nëpër shkrime dhe në ligjërim kur flitet për grimin e grave. Mendojmë se në gjuhën shqipe, nëse ajo fjalë duhet patjetër të përdoret si një mjet grimi, në vend të atij huazimi mund të përdoret togfjalëshi *laps vetullash*.

“Nëse përdorni ajlajner, filloni prej këndit të brendshëm, por vijën mos e tërhiqni deri në fund të syrit.” Rilindja, 19.06.1986.

2. Njësia e masës së lëngjeve *barel* (*barrel*), me peshë prej 120 deri 155 litrash, që përdoret në Britani të Madhe dhe në SHBA, haset shpesh në shkrimet tona. Nuk mund të mohohet fakti se ky huazim i anglishtes tashmë ka depërtuar në shumë gjuhë të botës. Ajo masë do të mund të shprehej me terma të gjuhës shqipe: *fuçi*, *bucelë*, *vozgë*. Termi *fuçi* do të ishte më i përshtatshëm, meqë ka përdorim bukur të gjerë në shqipe dhe ajo masë ka madhësinë bukur të përafërt me atë anglo-amerikane.

“Nafta u lirua duke rënë gjer në 15 dollarë për një *barel*.” Ditari II i TVP-së, 15.04.1986.

3. Togfjalëshi i dëgjuar ndonjëherë *boks meç* (*boxing match*) nuk duhet të përdoret në gjuhën shqipe. Si trajtë shqipe për këtë nocion do të duhej të ishte togfjalëshi *ndeshje boksi*. S’do mend se këtu na mbetet në shqipe elementi tashmë i huazuar *boks*, të cilin tashmë e kemi përvetësuar. Në togfjalëshin *ndeshje boksi* edhe rendi i fjalëve është i natyrës së shqipes.

4. Huazimi nga anglishtja *broiler* (broiler) në shqipe e ka ngushtuar kuptimin origjinal. Në anglishte ai emërton furrën elektrike për ngrohjen e vezëve për të çelur zogj si dhe zogjtë e pjekur në skarë. Kurse në gjuhën shqipe, sipas përdorimeve që i kemi hasur deri tani, ka marrë kuptimin e zogjve që çelin në furra të tilla elektrike. Mendojmë se fjala *inkubator* tashmë është rrenjosur në shqipe dhe shpreh po atë nocion të asaj furre, kurse togfjalëshi *zog pule* është fjalë e mirëfilltë e shqipes, e cila duhet ta nxjerrë nga përdorimi emrin *brojler*, me kuptim të shtrembëruar dhe të huaj. Pra, do të mund ta quanim *inkubator zogjsh*.

“Ferma e *brojlerëve* kushton mbi 318 milionë dinarë.”
Rilindja, 2.07.1986.

5. Në kohë të fundit haset termi *buking* (booking) me kuptim të rezervimit të dhomës në ndonjë hotel, të rezervimit të biletës për tren, aeroplan etj. Mendojmë se fjala tashmë e përvetësuar *rezervim* i përgjigjet plotësisht atij kuptimi, kurse fjala *buking* duhet të largohet nga shqipja sa nuk ka shtënë rrenjë të thella.

“Sivjet *bukingu* i vendeve në hotele është rregulluar...” Radio Prishtina, 9.05.1986.

6. Shtëpiza njëkatëshe ose përdhese e dedikuar për të kaluar pushimin ose për ndonjë qëndrim turistik, quhet shpesh *bungalou* (bungalow), me variante *bungalov*, *bungalo*. Fjalët shqipe *shtëpizë* ose *kasolle* janë mjaft të përshtatshme për të shprehur nocionin e atij lloji ndërtese dhe për të flakur këtë huazim anglez nga shqipja.

7. Termi *dragstor* (drug store) në anglishte shënon lokalitë e barnatores. Për çudi, në Prishtinë, e ndoshta edhe diku tjetër, ka marrë kuptimin e shitores së madhe të artikujve ushqimorë apo të artikujve të tjerë. Mendojmë se ai term duhet të hiqet nga përdorimi dhe termi *vetëshërbim*, edhe pse është kalk, por i përvetësuar në mbarë shqipen kosovare, duhet ta zëvendësojë atë element fare të huaj – *dragstorin*.

8. Stabilimenti për rregullimin e ajrit në ndonjë lokal ose ndërtesë quhet ndonjëherë *erkondishën* (air conditioning). Haset edhe togfjalëshi *rregullator klime*, si kalk nga serbishtja (*klimouredjaj*), për të emërtuar të njëjtin aparat. Së pari, mendojmë se termi *rregullator klime* nuk i përgjigjet punës që bën ai aparat, meqë ai nuk rregullon klimën, por ajrin, sepse klimë ka në natyrë, kurse në dhomë dhe në ndërtesë ka vetëm ajër (të pastër ose të ndotur). Fjalori i gjuhës shqipe ka termat: *ajërftohës* – aparat i posaçëm për ftohjen e ajrit, dhe *ajërngrohës* – aparat i posaçëm për ngrohjen e ajrit. Prandaj ky aparat do të mund të quhej *ajërdhënës*, si term i përgjithshëm pa cilësuar nëse e ftoh ose e ngroh ajrin, ndërsa në kuptime të veçanta, të dalluara hollësisht, mund të quhet *ajërftohës* (verës) dhe

ajërngrohës (dimrit). Besojmë që edhe ndërtimi *ajërdhënës* është i ngjashëm me dy termat e cekur më sipër.

9. Emri i dëgjuar shpesh në gjuhën e folur, po edhe në gjuhën e shkruar ndonjëherë, *farmerka*, rrjedh nga fjala angleze *farmer* (bujk), kurse prapashtesa *-ka* është e origjinës sllave. Në anglishte nuk përdoret ky term. I përdorur në shqipe ai shënon lloj pantallonash për meshkuj a për femra, i punuar nga materiali i posaçëm – (jeans) *xhinz*. Mendojmë se huazimi *farmerka*, edhe pse ka depërtuar në gjuhën shqipe (sidomos në të folur), nuk do të duhej të përdorej. Këtë lloj veshjeje mund ta quajmë *pantallona xhinz* (ose *xhinse*), *bluzë xhinse*, *rrobe xhinse* etj. Parapëlqejmë trajtën *xhinz* nga *xhins* për shkaqe fonetike, përkatësisht për arsye të asimilimit fonetik.

10. Ndonjëherë dëgjohen e shkruhen huazimet angleze *fit* e *fit* (foot, feet²) që në përkthim *ad lit.* do të thotë *këmbë*, *shputë*. Është kjo një masë angleze për gjatësi prej 30.48 cm. Në gjuhën shqipe e kemi hasur të përdoret më së shumti në kontekst me fluturimet e aeroplanëve, përkatësisht me lartësitë e tyre. Kjo mund të quhet shputë nëse nuk duam ta shndërrojmë në njësinë e masës me metër, por më së miri do të ishte të shndërrohej në gjatësi me metër, përkatësisht me centimetra. Kurse huazimet *fit* e *fit* nuk duhet ta rëndojnë gjuhën shqipe.

“... mori lejen nga pyrgu kontrollues për zbritje deri në 5 mijë fit.” Rilindja, 11.07.1982.

11. Anglizmi me trajtën *flert* (flirt), i cili në *Fjalorin drejtshkrimor* haset me trajtën *flirt*, tregon se në Kosovë e gjetiu (jashtë Shqipërisë) është formuar nga ndikimi i serbishtes (ose i maqedonishtes) si gjuhë ndërmjetëse, në të cilën ai është përshtatur dhe në shqipen këtu ka hyrë i gatshëm, kurse në FDGJSH është marrë me ndikim të drejtshkrimit të anglishtes. Ky huazim shënon njëfarë dashurie të rreme, pa ndonjë qëllim serioz. Mendojmë se fjala shqipe *lajkë* mund të përdoret fare mirë për të shprehur kuptimin e këtij anglizmi.

“Rasti më i mirë i ‘flertit politik’ është ai i Fransoa Meteranit.” Rilindja, 4.03.1982.

12. Në kohë të fundit ka marrë hov termi *fri-shop* (free shop), i cili në përkthim, fjalë për fjalë, do të thotë ‘dyqan i lirë’. Ka kuptimin e dyqanit në zonën doganore apo edhe gjetiu, ku shiten artikuj të liruar nga taksa doganore, dedikuar kryesisht turistëve. Mendojmë se në gjuhën shqipe mund të përdoret togfjalëshi *dyqan pa doganë/ dugojë*

² Trajta *feet* në anglishte është shumësi i *foot*, pra: *shputë* – *shputa*, ose siç thuhet *këmbë*.

pa doganë për të shprehur atë nocion. Propozimi ynë ka një mangësi pse togfjalëshi është i gjatë.

13. Fjala *hendikep* (handicap) haset bukur shpesh në ligjërimin e intelektualëve shqipfolës, po edhe në mjete të informimit publik. Fjala shqipe *pengesë* e shpreh plotësisht kuptimin e këtij anglizmi, prandaj, nuk e shohim fare të arsyeshme që shqipja të rëndohet me këtë balast.

“Ky është një *hendikep* i rëndë.” Rilindja, 9.05.1986.

14. Ndër të rinjtë po edhe në mjetet e informimit masiv haset shpesh fjala *imixh* (image). Kjo fjalë angleze ka kuptimin e shëmbëlltyrës, figurës, përfytyrimit, idealit. Në gjuhën shqipe po përdoret kryesisht me kuptimin e idealit a të shëmbëlltyrës. Prandaj fjala me prejardhje nga gjuhët romane: *imazh* (nga e cila ka prejardhjen edhe ky huazim anglez) për shkak se është huazuar shumë para huazimit me trajtë angleze, shpreh kuptim të njëjtë me atë të huazimit anglez dhe tashmë është bërë pjesë e thesarit të shqipes, huazimi me trajtën *imazh* duhet ta përzërë nga gjuha shqipe këtë term të ri anglez.

“Në vitin tjetër e ndërroi *imixhin* e vet.” Rilindja, 6.02.1983.

15. Fjala angleze *kidnaper* (kidnapper) dhe trajta e saj më e shqipëruar *kidnapues* shënojnë personin që rrëmben a plaçkit dikë a diçka, sidomos në aeroplan po edhe gjetiu. Madje përdoret ndonjëherë edhe folja *kidnapoj*. Mendojmë se emri shqip *rrëmbyes* dhe folja *rrëmbej*, me të gjitha cilësitë e tyre semantike, nuk duhet t’i lërë vend këtij huazimi që nuk ka ndonjë kuptim shtesë në gjuhën shqipe.

16. Arkat apo rezervuarët e hedhurinave (bërllokut) a të ndonjë materiali tjetër, në kohë të fundit po quhen *kontejner* (container). Ndonjëherë haset edhe trajta *kontajner*. Mendojmë se duhet t’i shmangemi përdorimit të këtij termi dhe duhet të përdorim fjalën shqipe *arkë hedhurinash* ose *arkë bërlloku*. Ky huazim duhet të shmanget edhe kur përdoret për një lloj ndërtese, të cilën tashmë e quajmë *barakë*.

17. Nuk dëgjohet shumë shpesh, po megjithatë haset në shqipe termi *lobi* (lobby), që shënon grup personash (privatë) të organizuar në mënyrë që të ndikojnë në votime, në judikaturë etj., për të mirën e atij grupi.

“Ky proporcion edhe është ruajtur në saje të forcës së *lobit* grek në Kongresin amerikan.” Rilindja, 21.02.1983.

18. Në manifestime të rëndësishme, në tubime të mëdha, në kongrese etj., themelohet një qendër e përkohshme për të dhënë informacione për mjetet e informimit publik përkitazi me ecurinë e manifestimeve të tilla. Qendra e tillë po shprehet me togfjalëshin hibrid *pres qendër* (press centre), përkatësisht me elementin *pres* të huazuar dhe me elementin

qendër të përkthyer. Në këtë togfjalësh, përveç të tjerash, rendi i fjalëve u vjen ndesh rregullave sintaksore të gjuhës shqipe, meqë elementi përcaktor (pres) del para fjalës bosht (qendër). Shqip mund dhe duhet të thuhet *qendër për shtyp*, ose *qendër e shtypit*, ose *qendër shtypi*.

“Kryetari i delegacionit vizitoi *pres qendrën*” (titull), Rilindja, 25.05.1986.

19. Nga të rinjtë dëgjohet fjala *singël* (single), me të cilën shënohet disku i gramafonit që ka të incizuar një këngë në vetëm në njërën anë. Fjala angleze single do të thotë: vetëm një, tek. Prandaj për të shprehur këtë nocion mund të përdoret fjala shqipe *tek* për të emërtuar diskun e tillë të gramafonit.

“Xhon Lenoni botoi 8 albume solo dhe 10 pllaka *singël*.”
Rilindja, 12.12.1980.

20. Termi me prejardhje angleze *smog* (smog) rrjedh nga përngjitja smoke + fog (tym + mjegull) dhe shënon ajrin e ndotur, i cili ka lagështi të përzier me pluhur. Dëgjohet mjaft shpesh në gjuhën e folur, por haset edhe në shtyp. Besojmë se shqip do të mund të thuhej *tym e mjegull*. Në shqipe ekziston shprehja “u bë tym e mjegull”, por me kuptimin: *u zemërua shumë, u tërbua nga zemërimi*. Më tutje ky togfjalësh mund të përngjitet, ashtu siç ka ndodhur edhe në anglishte, dhe të prodhojë një fjalë *tym e mjegull*.

21. Fjala për të shënuar punën e spikerit në shqipe ndonjëherë quhet *spikeroj*. Analizuar për nga formimi strukturor ose për nga fjalëformimi, duket sikur ekzistua një folje **spikeroj*. Mirëpo, një folje e tillë nuk ekziston as në anglishte as në shqipe. Prandaj, mendojmë se një fjalë e tillë artificiale nuk duhet të kultivohet në gjuhën shqipe. Mund të thuhet dhe duhet të thuhet shqip: *punë spikeri* a *punë e spikerit*. Kurse termi *spiker* duhet të mbetet si huazim në shqipe, meqë shënon një nocion të veçantë. Fjala *folës* i televizionit nuk e zëvendëson me kuptim të veçantë këtë huazim anglez.

“Është e vërtetë se *spikerimi* dallon shumë nga profesionet e tjera.” Rilindja, 4.03.1983.

22. Termi me prejardhje angleze, *stjuardesë* (stewardess) shënon profesionin e një vajze a gruaje e cila u shërben pasagjerëve, sidomos në aeroplan. Na duket se në vend të këtij termi mund të përdoret një fjalë shqipe që e përcakton edhe gjininë sipas rregullave të gjuhës shqipe, pra një trajtë më e shqipëruar – *stjuardeshë*, e cila edhe haset ndonjëherë në gjuhën e folur shqipe.

23. Huazimi anglez *shopping* (shopping) ka marrë hov bukur të madh, posaçërisht në gjuhën e folur shqipe, por haset edhe në gjuhën e

shkruar. Në gjuhën shqipe tashmë e kemi fjalën që ka zënë rrënjë - *pazar* ose *tregti*, varësisht nga konteksti. Edhe pse fjala *pazar* është e burimit të huaj (e turqishtes), në rrjedhë e sipër të kohës ka zënë vend në shqipe, prandaj ajo mund të mos ia lëshojë vendin fjalës *shopping*. Madje, kur kjo e fundit nuk shpreh asgjë më shumë se blerje nëpër dyqane a shitore e gjetiu të gjësendeve të nevojshme për shtëpi. Po ashtu edhe togfjalëshat e tjerë me elementin *shopping* duhet të shqipërohen. Kështu në vend të *shopping qendra*, duhet të thuhet *qendra tregtare*, kurse për *shopping udhëtimi* duhet të thuhet *udhëtim për tregti*.

“Nuk udhëtohet sikur dikur as për *shopping* në Turqi.” Rilindja, 22.05.1986.

“*Shopping qendra* e parë kosovare” (titull), Rilindja, 12.04.1978.

“Ende po organizohen *shopping udhëtime*...” Rilindja, 15.07.1982.

24. Nja dy-tri fjalë edhe për ndonjë anglizëm nga FGjSSH-ja mund të mos jenë të tepërta në këtë shkrim.

a) Termi *bojskaut* (boy scout), sipas FGjSSH-së shënon një “anëtar të grupeve të fëmijëve e të të rinjve që formohen në disa vende borgjeze gjoja për veprimtari sportive, për udhëtime zbuluese e hulumtuese në krahina të panjohura etj., por që në të vërtetë kanë synime politike e ushtarake.” Edhe pse këtë fjalë e shënon Fjalori, na duket si gjë e çuditshme të përdoret në shqipe kur nuk na hyka në punë, sepse përshkruaka diçka të realitetit të huaj. Ndërsa, Fjalori nën fjalën *vëzhgues* nuk e regjistron kuptimin e anëtarit të organizatës së të rinjve që merren me veprimtari sportive, me udhëtime hulumtuese e zbuluese. Por kjo fjalë me kuptimin e shënuar më sipër haset dendur në shqipe, sidomos në Kosovë. Prandaj gjykojmë se duhet të përdoret termi *vëzhgues* i brumit shqip dhe që shpreh realitetin tonë, kurse duhet të lihet anash termi *bojskaut*, si huazim i paqëlluar.

b) Termi *kloun* (clown) (shqiptimi më i drejtë do të ishte *klaun*) shënon palaçon, artist cirku që i bën spektatorët të qeshin me lëvizjet, me veshjen dhe me veprimet e tij të shkathëta. *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* i ka të dy huazimet: *kloun* dhe *palaço*. Meqë huazimi italian *palaço* ka hyrë më herët në gjuhën shqipe, ka krijuar përdorim më të gjerë dhe për nga struktura dhe akustika e vetë fjalës i përgjigjet më shumë nocionit të vet në shqipe, mendojmë se ai duhet të mbetet në përdorim në shqipe, kurse *klouni* apo *klauni* duhet të shporret.

c) Për termin *slogan* (slogan) në FGJSSH thuhet se shënon një frazë të shkurtër që përsëritet për të propaganduar diçka; parullë e zbrazët ose mashtruese, e stilit libror, kryesisht me kuptim të keq. Po ky fjalor edhe fjalën parullë, e cila ka fushë paksa më të gjerë semantike

sesa i përshkruhet *sloganit*, po edhe sipas përshkrimit të kuptimit që i jepet, duket se e mbulon edhe kuptimin e termit *slogan*. Prandaj mendojmë se fjala *parullë* duhet t'i mbulojë kuptimet e të dyjave që janë thuaja një, kurse slogani do të duhej të largohej nga shqipja.³

Në fund, të themi se këtu, përveç që paraqitëm disa huazime të kohës së fundit, bëmë një përpjekje modeste për të gjetur ndonjë zgjidhje më të mirë për përdorimin e fjalëve të brumit të shqipes në vend të disa fjalëve që vijnë nga anglishtja. Pa dyshim, mund të mos ia kemi qëlluar më së miri në të gjitha rastet, por kjo nuk do të thotë se me këto propozime mbyllet çështja. Përkundrazi, çështja e huazimeve të anglishtes sapo po hapet për të biseduar për të së bashku dhe për të gjetur shtigje edhe më të mira. Qëllimi është vetëm i mirë, ndërkohë që do të jemi të kënaqur po qe se edhe vetëm një propozim yni të zinte vend në fjalorin e gjuhës shqipe.

*

Gjendja e terminologjisë shqipe në Jugosllavi, ff. 129-134, 1988, Institutit Albanologjik i Prishtinës.

³ Në kohën e ribotimit të këtij artikulli në këtë përmbledhje, përdorimi i termit *slogan* nuk ka më kuptimin përbuzës, siç përshkruhet në FGjSSh. Megjithatë, mendojmë se ai duhet të shmanget nga shqipja.

SHKRIMI I DISA HUAZIMEVE ANGLEZE

Diskutohen Rregullat e drejtshkrimit të shqipes (Projekt)

Për të kontribuar, sadopak, në gjuhën letrare shqipe dhe në stabilizimin e drejtshkrimit të saj, sidomos tani kur po afrohet nëntori, muaji në të cilin do të mbahet kongresi kushtuar drejtshkrimit, po përiqemi të vëmë në dukje disa vërejtje tonat rreth drejtshkrimit të fjalëve dhe të emrave të huaj në gjuhën shqipe.

Së pari, na duken plotësisht të drejta qëndrimet parimore që kanë të bëjnë me këtë çështje në Rregullat e drejtshkrimit të shqipes (projekt), ku thuhet: “Emrat e përveçëm të huaj të njerëzve dhe gjeografikë duhet të shkruhen përgjithësisht sipas shqiptimit, që ata kanë në gjuhën përkatëse, në përshtatje me alfabetin e gjuhës shqipe dhe me traditën e krijuar në gjuhën shqipe.”

Këtë çështje e ka trajtuar edhe Anastas Dodi në librin e tij të fonetikës.¹ Siç thotë dhe profesori Dodi, fjalët që kanë hyrë më vonë në gjuhën shqipe janë ngulitur dhe nuk është e mundur t’i kthejmë ndryshe, edhe nëse shqiptohen gabimisht. Mirëpo, ato fjalë që hyjnë përditë, sidomos emrat e përgjithshëm, sipas parimit që aplikohet në kohë të fundit, duhet të shkruhen ashtu siç shqiptohen. Kuptohet se këtu bëhet transkriptimi fonologjik, gjë që nënkupton se të gjitha nuancat e një foneme në gjuhën e huaj, pra alofonet, paraqiten me një shkronjë të vetme në gjuhën shqipe, meqë është e pamundur dhe jo e nevojshme që të bartet e të inkuadrohet në shqipe shqiptimi plotësisht origjinal e i hollësishëm nga disa gjuhë të huaja. Është bindës edhe fakti se si bazë duhet marrë shqiptimi i fjalës përkatëse në gjuhën burimore a origjinale e jo i ndonjë gjuhe tjetër ndërmjetëse, nga mund të jetë marrë fjala, sepse çdo gjuhë e përshtat shqiptimin e fjalëve të huaja sipas veçorive të sistemit të vet fonemik.

Ndoshta do të ishte mirë që në rregullat e drejtshkrimit, ku bëhet fjalë për këtë çështje, të porositet që fjalët e futura si të reja në gjuhë, së paku në fillim, pas transkriptimit të jepen brenda kllapave ashtu siç shkruhen në gjuhën origjinale të tyre.

¹ A. Dodi, 1970, kapitulli XVI *Transkriptimi dhe transliterimi*.

Meqë e njoh më mirë këtë çështje, do të përpiqem të shtroj këtu problemin që paraqitet rreth fjalëve të gjuhës angleze. Në fokus të vërejtjes po e shtroj çështjen e transkriptimit të fonemës angleze [w]. Kjo fonemë në anglisht ka denduri mjaft të madhe, të cilën në shqip nuk e kemi, e mu kjo shkakton edhe kokëçarje. Vlera e saj fonemike qëndron diku në rrugë në mes konsonantit labiodental [v] dhe vokalit të pozicionit të lartë të sprasëm [u], duke qenë më afër kësaj foneme të fundit. Për të shqiptuar këtë tingull, buzët duhet të përgatiten si kur shqiptojmë zanoren [u], por buzët siç janë në pozicion të fundit, në vend se të shqiptojnë [u], shqiptojnë [v], e kështu del një tingull as [u] as [v], pra [w] angleze. Prandaj në fonologjinë angleze ai quhet gjysmëzanore. Në kohë të fundit fonema [w] po transkribohet me fonemën shqipe [u], si p.sh. Uashington (Washington), Urugvaj (Uruguay), më parë hasej edhe forma Urugvaj, Uiliam ose Uiliem (William) etj. Në parim, mbase mund të mbështetet kjo mënyrë e zëvendësimit të [w] angleze me [u] të shqipes. Mirëpo, shtrohet çështja çka të bëjmë me emrat Wood, Wolf, Woolf, Holiwood etj. Po të respektojmë atë që u tha më sipër, që [w] angleze të transkribohet me [u] të shqipes, del një kombinim tingujsh, përkatësisht zanoresh që nuk gjendet në asnjë fjalë të gjuhës shqipe (Uud, Uulf, Uudfërd etj.). Mendojmë se në fjalë të këtij tipi, përkatësisht, kur pas fonemës [w] vjen menjëherë [u], e cila është mjaft e afërt, por jo dhe identike me të parën, kjo [w] angleze duhet patjetër të transkribohet me [v] shqipe, e jo me [u].

Është interesant të ceket se në tekstin *Fjalor anglisht-shqip për shkollat të mesme*, ribotim i Entit të Botimeve të Teksteve dhe Mjeteve Mësimore, Prishtinë, 1969, fjalët e tipit *wood* jepen të transkriptuara me [u] të dyfishuar [uud], përkatësisht tingulli [w] i anglishtes jepet me [u] shqipe; këtu edhe disa fjalë angleze të tjera: *wolf* (uulf) – ujk, *woman* (uumën) – grua etj. Sipas kësaj edhe mbiemri i shkrimtares së njohur angleze Uirxhinia Vulf (Wirginia Wolfe) do të duhej të shkruhej Uirxhinia Uulf. Meqë kjo trajtë nuk paraqet trajtën më të afërt të shqiptimit në gjuhën shqipe dhe kumbon shumë çuditshëm, ajo patjetër duhet të shkruhet Vulf, përndryshe s'ka kuptim as mënyrë të shkruhej as të shqiptohet *Uulf*. Edhe fjalët e sipërhënuara të fjalorit duhet të transkribohen: *vulf*, *vumën*, *vud*. Kjo e dhënë është e nevojshme dhe e domosdoshme të vihet në pah edhe në rregullat e drejtshkrimit, aq më tepër kur dimë se shumë nga këto fjalë si dhe të tjera të ngjashme, mund të jenë emra vendesh ose mbiemra njerëzish dhe mund të na paraqitet rasti t'i hasim dhe nevoja që t'i përdorim në gjuhën e shkruar shqipe, e të mos flasim për nevojën e përdorimit në të mësuarit e gjuhës angleze. Fjalët e tilla janë të shpeshta. Ja vetëm disa shembuj emrash të vendeve dhe mbiemrash të njerëzve: *Wolf*, *Wolfe*,

Woolf (Vulf), Wollaston (Vulastën), Wolseley (Vulsli), Wolsey (Vulsi), Wolstanton (Vulstantën), Wolverhampton (Vulvërhemptën), Wolverton (Vulvërtën), Woodbridege (Vudbrixh), Woodbury (Vudbëri), Woodford (Vudford), Woodside (Vudsaid), Woodroff (Vudrof), Woodrow (Vudrou), Woods (Vudz), Woodstock (Vudstok), Woolard (Vulërd), Woolley (Vuli), Wooliams (Vuliemz) Woolner (Vulnër), Woolsey (Vulsi), Woolwich (Vulvixh), Wooster (Vustër), Wootton (Vutën), Worcester (Vustër), Worcestershire (Vustërshiër).

Mendojmë se duhet shoshitur këtë çështje gjuhësore mirë edhe kur fonema [w] i paraprin tingullit [e], si p.sh. në fjalët Wells (Uells), Mark Twen (Tuen), Broadway (Broduej), Hemingway (Heminguej) etj. Këtu, ndonëse në gjuhën burimore në fjalët e tilla nuk ka diftong, ai në shqipet na del si i tillë, diftongu [ue]. Po të transkriptohej [w] angleze me [v] të shqipes, do të kishim trajtat: Vels, Tven, Brodvej, Hemingvej etj., dhe ky problem nuk do të ekzistonte.

Me këtë shkrim ne vetëm po e shprehim një brengë tonën, përkatësisht po ua paraqesim këtë çështje albanologëve dhe gjuhëtarëve kompetentë, e ata duhet ta japin fjalën e fundit.

Në vijim po cekim se fjalët *vaterpolo* dhe *vikend* (waterpolo, weekend) janë futur në shqipe me [v], ndonëse, sipas rregullës së parashikuar dhe cekur më sipër, do të duhej të shkruheshin me [u]. Por këto fjalë ose janë marrë nga ndonjë gjuhë tjetër ndërmjetëse, ku është bërë ndryshimi – përshtatja fonologjike, ose ka pasur ndikim shkrimi në to, sepse mund të jenë importuar me anë të shkrimit, e në këtë fonema [w] nga pikëpamja vizuale i përngjan më shumë [v]-së, sesa [u]-së. Megjithatë, mendojmë se nuk duhet të kërkojmë të ndryshohet shkrimi i këtyre dy fjalëve dhe e ndonjë tjetre, sepse tanimë janë ngulitur në gjuhën shqipe si të tilla.

Fjalën *magnet* me derivatet e saj (magnetofon, magnetizëm etj.) në “Rilindje” e në shtypin tonë tjetër e hasim si *manjet* (manjetofon, manjetizëm etj.), ndonëse në Projektin e rregullave të drejtshkrimit, Kapitulli C paragrafi 1,13, thuhet se duhet të shkruhet *magnetofon*, gjë që është me vend, sepse as që shqiptohet e as që shkruhet me [nj], por me [gn], në gjuhën nga është marrë.

Të vetëdijshëm se në këtë rast cekëm vetëm pak çështje, dëshirojmë që këto raste dhe raste të tjera të ngjashme, të analizohen hollësisht nga komisioni kompetent për çështjet e rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

SI TË SHKRUHEN EMRAT ANGLEZË NË GJUHËN SHQIPE

Në kushtet e zhvillimit të sotëm shoqëror, politik, ekonomik dhe kulturor është evident shkëmbimi gjithnjë më i madh me vendet e jashtme në lëmin e tregtisë, shtimi i mjeteve të informimit, ekzistimi i shkollave (i grupeve, lëndëve, kurseve) në gjuhë të huaja etj., që ndikojnë të hyjnë fjalë të huaja¹ e njëherësh edhe angleze në fjalorin e shqipes, qoftë në të përditshmin apo në atë zyrtar.

Kur fjalët nga gjuhët e huaja hyjnë në gjuhën shqipe, ato mund të transkriptohen ose të transliterohen. Transkriptimi, shpesh i quajtur transkriptim praktik, ka të bëjë me përcjelljen e shqiptimit² të fjalës së huaj në shkrimin e shqipes. Meqenëse drejtshqiptimi dhe drejtshkrimi në shqipe janë të lidhura bukur ngushtë, për arsye praktike, me drejtshkrim si nocion do të nënkuptojmë edhe drejtshqiptimin.

Transliterimi ka të bëjë me bartjen e shkrimit të një gjuhe në gjuhën tjetër, kur shkrimet e tyre nuk përdorin të njëjtin alfabet, si b.f. alfabetin latin përballë atij cirilik. Në rastin e huazimeve të elementeve gjuhësore angleze në gjuhën shqipe, kemi të bëjmë me dy gjuhë që përdorin të njëjtin alfabet – latin, prandaj transliterimi këtu nuk ka vend, por transkriptimi praktik.

Në gjuhën shqipe, fatkeqësisht, ende nuk ekzistojnë studime e as punime shkencore që spikasin përcaktimet e kriterëve të transkriptimit praktik të fjalëve e të emrave të huaj. Për këto arsye sot kemi një laramani të madhe sa i përket çështjes së drejtshkrimit të fjalëve, përkatësisht të emrave të huaj të njerëzve dhe gjeografikë. Thënë drejt, shumica e tyre jepen të transkriptuar me shkrimin e shqipes, në bazë të shqiptimit të tyre. Kjo çështje është parashikuar me rregullat drejtshkrimore të gjuhës shqipe që kanë pasuar nga Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe në vitin 1972.

¹ Me nocionin fjalë këtu kuptohen të gjitha huazimet e elementeve gjuhësore – në përgjithësi. Kur flitet për emrat që janë temë e artikullit, mendohet për emrat e përveçëm (të njerëzve dhe gjeografikë).

² Mendohet për përcjelljen e përafërt të shqiptimit, sepse përcjellja e plotë nuk mund të arrihet me transkriptimin praktik.

Megjithatë, ka raste bukur të shpeshta, veçmas në revista, në përkthim poezish apo tregimesh të autorëve të huaj, që emrat të shkruhen në formën origjinale. Kjo dukuri është më e shpeshtë me emrat anglezë.³ Na merr mendja se kjo bëhet shpesh ngase përkthyesit e rinj, pa përvojë dhe dituri të nevojshme, gjenden para vështirësive për të paraqitur shqiptimin e huaj me shkronja shqipe.⁴

Fjalët e huaja, si në çdo gjuhë tjetër, ashtu edhe në shqipe, depërtojnë në dy mënyra kryesore:

a) Me anë të gjuhës së folur, fjalët e huaja sillen nga ata që e dinë gjuhën e huaj përkatëse - janë së pakut bilingë, pastaj nga turistët, nga njerëzit që punojnë ose qëndrojnë gjatë një kohe të caktuar në vend të huaj dhe kthehen në vendlindje etj. Për shkak të largësisë gjeografike midis vendit tonë dhe atyre vendeve ku flitet anglishtja, depërtimi i huazimeve angleze me anë të gjuhës së folur është shumë më i rrallë. Këtu në përgjithësi mungon kontakti i drejtpërdrejtë. Po qe se emri (apelativi) ose fjala e huaj depërton me anë të gjuhës së folur, ekzistojnë mundësi më të mëdha për t'iu afruar më shumë shqiptimit origjinal të gjuhës prej nga vjen huazimi.

b) Nëse huazimi, përkatësisht emri (apelativi) anglez, depërton në gjuhën shqipe me anë të shkrimit, drejtshkrimi i tij mund të ketë ndikim të madh në procesin e përshtatjes së shqiptimit në këtë gjuhë marrëse. Për depërtimin e fjalëve me anë të mediumit të shkrimit kontribuojnë materialet e shkruara, sidomos gazetatat, revistat, broshurat dhe librat e ndryshëm që shiten ose përkthehen në gjuhë të tjera.

Sa i përket formës ortografike të fjalëve të huaja në gjuhën shqipe, më parë ekzistonte parimi i shkrimit të tyre në formë origjinale. Viteve të fundit ka mbizotëruar parimi i transkriptimit praktik të tyre, ndonëse, siç thamë më sipër, aty-këtu përvidhet edhe shkrimi në trajtë origjinale, sidomos i emrave të njerëzve dhe i atyre gjeografikë.

Gjatë analizës së kësaj çështjeje kemi hasur në të dy qëndrimet që u cekën më sipër – të shkruar a transkriptuar me alfabetin e shqipes, dhe të shkruar në trajtën origjinale në gjuhë të huaj, përkatësisht në anglishte. Fitohet përshtypja se për shkrimin e emrave të huaj prej nga ata vijnë -

³ Me shprehjen emrat anglezë kuptojmë këtu të gjithë emrat (apelativat) që vijnë nga vendet ku anglishtja është gjuhë amtare dhe që kanë prejardhje ose domethënie angleze.

⁴ Këtu nuk po japim shembuj, por ata janë evidentë në shumë gazeta e revista tona, sidomos në Kosovë, kurse në "FJALA" gati çdoherë.

përkatësisht të emrave anglezë, anojnë më shumë ata që e dinë këtë gjuhë, kurse të tjerët anojnë më shumë për t'i shkruar ata sipas parimit të gjuhës shqipe.

Si për njërin parim dhe për tjetrin ka argumente bukur të bindshme.

Parimi i shkrimit në mënyrë origjinale të fjalëve dhe të emrave të huaj mbështetet në këto të dhëna:

a) Sistemet fonologjike kurrë nuk përkojnë plotësisht ndërmjet dy gjuhëve. Me 36 fonemat e gjuhës shqipe nuk mund të zëvendësohen 44 fonemat e gjuhës angleze, jo vetëm për nga sasia, por, sidomos, as sa i përket cilësisë. Prandaj, me transkriptim në shumë raste mund të largohemi nga shqiptimi i origjinalit.

b) Ka shumë gjasa që nga forma origjinale e shkruar e emrit anglez të arrihet drejtshqiptimi më i saktë (me ngritjen e përgjithshme arsimore të popullsisë), sesa nga forma e transkriptuar në shqipe, shpesh e gjymtuar në krahasim me drejtshqiptimin origjinal. Ndonëse ka shumë gjasa që drejtshkrimi i huaj të ndikojë në përcaktimin e shqiptimit të gabuar në gjuhën marrëse, veçmas nëse përdoruesi nuk ka shkallë të lartë të arsimit.

c) Për njerëzit e penës do të ishte shumë vështirë të gjenin emrin e ndonjë autori ose vendi gjeografik në katalogë të bibliotekave, në fjalorë dhe enciklopedi, sepse drejtshkrimi ndonjëherë dallon shumë nga drejtshqiptimi, sidomos i emrave anglezë të përveçëm, po edhe i emrave të njerëzve.

ç) Asnjë gjuhë europiane që përdor alfabetin latin, nuk bën transkriptimin as ndonjë formë tjetër të përshtatjes së emrave anglezë, as të emrave të ndonjë gjuhe tjetër.

d) Drejtshkrimi origjinal i fjalëve dhe i emrave (apelativëve) të huaj i identifikon ata, pa shumë përpjekje, se cilës gjuhë i përkasin, me anën e disa kombinimeve karakteristike të shkronjave ose me shkronja të veçanta për çdo gjuhë.

Nga ana tjetër, parimi i transkriptimit praktik të emrave e të fjalëve të huaja mbështetet në këto të dhëna:

a) Meqenëse drejtshkrimi i shqipes është fonologjik, domethënë vepron sipas rregullës: shkruaj ashtu si shqipton⁵ – për shqipfolësit (kup-tohet, për ata që nuk e njohin gjuhën e huaj përkatëse) përdorimi i alfabetit

⁵ Natyrisht, duhet marrë parasysh digrafet që përdoren në gjuhën shqipe, të cilat thuaja gjithmonë kanë vlerë fonologjike konstante.

të huaj do të sillte ngatërrim gjatë leximit të atyre emrave që në drejtshkrim dallojnë shumë nga drejtshqiptimi. Njerëzit e tillë do të shqiptonin emrat e huaj (anglezë) sipas rregullës së gjuhës shqipe, e kjo bën që shumë më pak t'i afrohen shqiptimit të origjinalit, sidomos kur emrat anglezë përmbajnë në shkrimin e tyre togje prej shumë shkronjash. Fjala vjen, askush, përveç atij që e di mirë gjuhën angleze, nuk do t'ia qëllonte se mbiemri i shkrimtarit të famshëm Sommerset Maugham shqiptohet /mo:m/.

b) Gjuha shqipe, si dhe shumë gjuhë të tjera, tregon një aftësi të veçantë për t'iu afruar (brenda mundësive të saj fonologjike dhe fonetike) shqiptimit të emrave dhe të fjalëve të huaja⁶. Kjo mund të arrihet më lehtë e për një kohë më të shkurtër, po që se emrat e huaj transkriptonen.

c) Nga gjuhët e tjera, huazimet dhe emrat e përveçëm të njerëzve dhe ata gjeografikë, kur hyjnë në gjuhën shqipe, i nënshtrohen përshatjes ortografike – transkriptimit. Emrat anglezë nuk mund të kenë në shqipet një status të dalluar nga ata të gjuhëve të tjera.

ç) Ajo që sipas mendimit tonë është më qenësore është e dhëna se shqipja në asnjë fjalë të veten nuk njeh në drejtshkrimin e saj rast që ajo të mos shkruhet ashtu si edhe shqiptohet (në përputhje me rregullat e drejtshkrimit të vet). Sa ia vlen atëherë barra qiranë që për hir të një gjuhe të huaj (anglishtes), të trazohen të gjitha rregullat e traditës së drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

Siç po shihet, këtu kemi të bëjmë me një çështje, që deri diku është, si thonë, “thikë me dy tehe”. Një gjuhë duhet të jetë e qartë gjithsesi: gjendja si qëndron tani përkitazi me drejtshkrimin e emrave të huaj (anglezë) – herë të transkriptuar e herë të shkruar në formën origjinale⁷ - nuk duhet të durohet. Nuk është e udhës të veprojmë kush si t'ia marrë mendja, pa e vërtetuar qëndrimin e vet me argument bindëse, sidomos nuk duhet të luajmë me drejtshkrimin tonë, të cilit iu kushtua aq shumë punë dhe kohë. Nga të gjithë njerëzit e penës shqipe duhet të zbatohet një qëndrim unik.

Cili qëndrim duhet të jetë ai – yni? Pamë argumentet për njërin parim dhe për tjetrin. Mirëpo, pasi që në gjuhësi dy dhe dy nuk bëjnë gjithmonë katër, siç bëjnë në matematikë, numri i argumenteve nuk

⁶ Këtë të dhënë e vërtetua duke bërë një analizë më të gjerë në një punim të veçantë të mbështetur në të gjitha huazimet angleze në gjuhën shqipe (të evidentuara deri tani).

⁷ Për gjuhët e tjera të huaja – në ndonjë nga ato paraqiten më pak dualizma të tillë – nuk duam të gjykojmë në veçanti. Por kemi bindjen se një gjendje e tillë e paqartë nuk duhet të durohet në asnjë gjuhë.

loz rol vendimtar, sa luan vlera e tyre linguistike.⁸ Jemi të bindur se po të shikohej çështja nga pikëvështrimi psikolinguistik i shqipfolësve si dhe nga ai i rrethanave dhe kushteve të gjithmbarshme të gjuhës shqipe – parimi që emrat e huaj të transkriptohen në gjuhën shqipe ka mbështetje më të fortë, sesa ka parimi i shkrimit të tyre në formën origjinale. Ky qëndrim mbështetet edhe nga përvoja e deritashme e zbatimit të këtij qëndrimi. Ndoshta zgjidhja më e mirë dhe, po ashtu, kompromise është që emrat e huaj të njerëzve dhe gjeografikë të shkruhen të transkriptuar dhe, menjëherë pas kësaj, të shkruhen në kllapa në formën origjinale,⁹ f.v, Daglas Hjum (Daglas Hume). Kështu veprohet edhe në disa gjuhë të tjera. Kështu do të duhej të shkruheshim emrat e huaj sidomos në veprat shkencore, por edhe në shtyp do të ishte mirë të praktikohesh kjo formë, veçmas për emrat e rrallë dhe për ata që kanë dallime të mëdha midis shkrimit dhe shqiptimit, shikuar sipas kritereve të gjuhës shqipe.

Përparimi, nr. 2, ff. 123-127, 1974, Prishtinë.

⁸ Mund, padyshim, të gjenden edhe argumente të tjerë në të mirë të njërit parim apo të tjetrit. Ata do të ishin të mirëseardhur dhe do të kontribuonin shumë për kristalizimin e kësaj çështjeje të rëndësishme.

⁹ Siç porositet edhe në Drejtshkrimin e gjuhës shqipe.

SHQIPJA DHE HUAZIMET ANGLEZE SOT¹

1. Përmbledhje hyrëse

Ky shkrim së pari shqyrton shkurtimisht gjendjen e gjuhës shqipe sot duke e theksuar mosrespektimin e normës së gjuhës standarde. Punimi pastaj përqendrohet kryesisht në dukurinë e të huazuarit të elementeve gjuhësore angleze në gjuhën shqipe. Vihet në dukje numri i madh i huazimeve që kanë depërtuar në shqipe pas luftës së Kosovës, me ardhjen e organizatave qeveritare dhe joqeveritare dhe me ndryshimin e sistemit shoqëror, si dhe pamundësia për t'i analizuar dhe për t'i kontrolluar ato fjalë të huaja, shumë prej tyre të panevojshme, për shkak të ardhjes së tyre të furishme brenda një kohe të shkurtër, po edhe për shkak të mosgatishmërisë qoftë subjektive ose objektive të institucioneve gjuhësore të vendit për t'i trajtuar huazimet si duhet. Në përputhje me këtë propozohen edhe masa përkatëse që duhet të merren për kontrollimin e huazimeve të panevojshme. Jepet edhe një pjesë shtesë ku flitet për disa huazime që mund të pranohen duke i arsyetuar propozimet, si dhe për disa huazime të pranueshme, të cilat duhet të refuzohen nga shqipja.

Fjalët kyçe: globalizmi gjuhësor, huazime, fjalë të huaja, procesi i të huazuarit, analizë e huazimeve, masa të nevojshme gjuhësore, lejimi i huazimeve, përshtatje e huazimeve: fonetike, gramatikore, semantike, organe/ institucione për trajtimin të huazimeve, trajtimi i huazimeve, huazime të pranueshme, të panevojshme.

2. Shqipja në përgjithësi

Globalizmi tashmë dihet se përfshin të gjitha fushat e veprimtarisë, prandaj edhe gjuhën. Siç qëndron gjendja në ekonomi, politikë e në fusha të tjera të veprimtarive, me globalizëm përfiton më shumë ai që është më i fuqishëm në fushën përkatëse. Madje në qarqet ndërkombëtare tashmë shprehet frikë nga globalizmi i skajshëm, kur përmes tij do të mund të kalonte në monopolizim të një fushe veprimi. Si rrjedhojë e globalizmit gjuha që ka prestigj dhe aftësi të tjera më të mëdha, e ato varen nga niveli

¹ Thesis Kosova, nr. 1, ff. 111-129, 2008, Universiteti AAB, Prishtinë.

më i lartë i zhvillimit ekonomik, teknologjik, shkencor, politik etj., po edhe që në bazë të këtyre është më e zhvilluar, ushtron ndikim mbi gjuhë të tjera, që kanë nivele më të ulëta në këto fusha dhe që janë më pak të zhbilluara. Si pasojë e kësaj, gjuha shqipe, si një gjuhë me ndikim të ulët mbi gjuhë të tjera dhe me zhvillim më të vogël dhe, siç po shihet tashmë, me aftësi të kufizuara për mbrojtjen e saj, ajo vetëm mund të pësojë nga dukuria e globalizmit. Ky globalizëm, qoftë formal ose joformal, tashmë ka përfshirë në përmasë të gjerë gjuhën shqipe, sidomos nga gjuha angleze, e cila ka prestigj dhe bazë më të fuqishme globale.

Vështrimet tona këtu kanë të bëjnë veçanërisht me gjendjen e shqipës në Kosovë, por edhe në përgjithësi, gjithandej ku flitet e shkruhet ajo.

Gjuha shqipe sot ka arritur në një gjendje të tillë kur i nevojitet një riparim i thellë. Ajo ka dalë nga suazat e normës letrare, nga norma e caktuar me Kongresin e Drejtshkrimit të vitit 1972. Gjuha shqipe sot ka rrëshqitur nga norma në shumë drejtime dhe në shumë rrafshje.

Shkeljet e gjuhës standarde shqipe sot janë dy llojesh kryesore:

- g) Mosrespektimi i normave gjuhësore në rrafshet gramatikore – morfologjike madje edhe sintaksore, por sidomos në rrafshin leksikor dhe veçanërisht në gjuhën e folur, por edhe në gjuhën e shkruar, dhe
- h) Përdorimi i fjalëve me prejardhje të gjuhëve të huaja, sidomos të anglishtes.

Natyrisht, objekt i shmangieve nga norma gjuhësore të shtjelluara në këtë shkrim është më shumë gjuha e folme në organe, forume e institucione zyrtare, në mjetet e informimit elektronik por shmangie hetohen edhe në gjuhën e shkruar në mjetet e shtypit si dhe në ligjërimitin edhe të një numri intelektualësh në përgjithësi. Në televizionet dhe sidomos në radiostacionet e ndryshme private në Kosovë, në ligjërimitin e shumë folësve zyrtarë, pra të gazetarëve, punëtorëve publikë e të tjerëve, përdoret një gjuhë që nuk është e asnjë të folmeje të caktuar, e aq më pak është gjuhë shqipe standarde.

Duket se kjo mospërfillje e shfaqur ndaj gjuhës shqipe rrjedh si një mospërfillje e përgjithshme ndaj shumë gjërave, si në shumë lëmenj të tjerë të jetës sot në Kosovë dhe gjetiu, sidomos pas luftës së fundit të Kosovës. Sikur merret me mend se çdo gjë është e lejuar, pikërisht siç u bënë uzurpime e keqpërdorime pronësore, ekonomike e të tjera, ashtu bëhen edhe keqpërdorime gjuhësore. Dhe kjo ndodh jo vetëm në njërën nga trevat e shqipfoljes, por, për fat të keq, në të gjitha ato, ku më shumë e ku më pak.

Ndonëse kjo dukuri e sjelljes së shqipfolësve është lëndë e studimit

gjuhësor, kjo dukuri mund të jetë fare mirë edhe temë dhe objekt i analizave dhe i studimeve të tjera, si sociologjike, psikologjike etj.

Folësit që nuk tregojnë kujdes as respekt dhe që nuk u përmbahen normave të gjuhës standarde shqipe, janë dy llojesh, sipas nesh. Një grup i tyre janë ata që me vetëdije bëjnë një shkarje të tillë. Në mesin e tyre ka edhe intelektualë, madje edhe profesorë e akademikë dhe të lëmit të filologjisë. Për fat, numri i tyre nuk është i madh. Ka raste edhe kur paraqitet ndonjë “ekspert” i gjuhës që orvatet për të treguar se di të veprojnë, siç është bërë shprehi të thuhet në kohët e fundit, ‘pak më ndryshe’. Edhe zërat e tillë janë të pakët, për fat të mirë, ndonëse kanë edhe ndonjë mjet të medias publike. Por, thënë të vërtetën, ata as që dinë të flasin, as të shkruajnë ndonjë dialekt të shqipes e, aq më pak, ‘dialektin kosovar’, meqë ky i fundit as ekziston as që ka ekzistuar ndonjëherë gjuhësisht i normuar si i tillë.

Grupi tjetër i folësve, që shtrembërojnë shqipen, është më i madh. Aty bëjnë pjesë shumë këngëtarë, punëtorë të kulturës e të artit, gazetarë, kryesisht më të rinj, e të mos flasin për tregtarët e kategoritë e tjera të shoqërisë. Të folurit e tyre shqip të bën të shtrosh pyetje nëse ata apo ato kanë kryer ndonjëherë ndonjë shkollë fillore, a të mesme, nëse kanë pasur mësues apo arsimtarë të gjuhës shqipe, e të mos pyesim nëse kanë kryer studime universitare, ndonëse ka të tillë që edhe i kanë kryer. Meqë numri i tyre është më i madh se i grupit të parë, edhe dëmi e dhuna që i bëhen shqipes nga ana e tyre janë më të mëdha.

S’do mend se gjuha shqipe ka nevojë për zhvillim të mëtejshëm, sigurisht edhe për ndryshime të arsyeshme dhe të gjykuara drejt nga ekspertë të saj. Kjo është thënë shumë herë deri tani publikisht, qoftë në forume ose në publikime të ndryshme gjuhësore. Prandaj në çdo gjuhë ka arsye dhe vend edhe për ndryshime brenda vetë saj, po edhe përmes huazimeve të reja.

Institucionet që duhet të marrin masa kundër këtyre shmangieve, shkeljeve normative të gjuhës, janë bërë anemike, para së gjithash për shkak të mangësisë së madhe të burimeve financiare që atyre u duhen, po edhe për shkak të shmangieve shumë të dendura që bëhen, prandaj edhe fuqia e tyre për të ndërmarrë masa përkatëse dhe të efektshme deri tani është treguar e dobët.

Megjithatë, e gjithë kjo duhet të jetë në radhë të parë brengë e albanologëve e pastaj edhe e të gjithë gjuhëtarëve dhe intelektualëve shqiptarë.

3. Huazimet në shqipe

Në këtë kumtesë do të përqendrohemi pak më shumë në depërtimin e fjalëve të huaja në shqipen e sotme, sidomos gjatë periudhës së pasluftës së Kosovës, meqë kjo fushë e gjuhësisë ka kohë që është përqendrim i vëmendjes sonë gjuhësore.

Huazimet thuhet se e kanë përcjellë gjuhën që nga fillimet e saj. Të huazuarit, pra, është një përvojë e gjatë e të gjitha gjuhëve. Në shqipe ka pasur huazim të pandërprerë, me intensitet të ndryshëm në periudha të ndryshme. Dhe e gjithë kjo është dukuri shumë normale. Mirëpo, ekzistojnë disa norma të përcaktuara në vija të trasha përkritazi me të huazuarit gjuhësor. Pra, të huazuarit deri para një kohe bëhej sipas disa rregullave tashmë të përcaktuara nga gjuhëtarët që merren me to (Weinreich: 1953; Haugen: 1950). Ata që merren me çështjet e huazimeve, duhet të jenë neutralë. As duhet të jenë puristë të skajshëm, sipas të cilëve thuajse nuk duhet të lejohet fare huazimi i fjalëve të huaja, po as të jenë liberalë të skajshëm, sipas të cilëve mund të lejohet huazimi i fjalëve të huaja, madje edhe jo shumë të nevojshme. Pra, duhet të zbatohet parimi që mbizotëron për lejjimin apo moslejjimin e huazimit të një elementi gjuhësor të huaj: të mos huazohet dosido, por edhe të mos ndërpritet plotësisht të huazuarit.

Elementi gjuhësor i huaj huazohet nëse paraqet një nocion të ri, i cili nuk ekziston në gjuhën marrëse dhe nuk është lehtë ose e mundshme të gjendet ndonjë term a shprehje përkatëse për ta zëvendësuar (Weinreich: 1953; Haugen: 1950). Të huazuarit bëhet sepse përmes këtij procesi edhe begatohet gjuha.

Të gjithë ata që merren me çështjet e huazimeve e dinë se, sipas përvojave të deritashme jo vetëm ndër ne, por edhe më gjerë, fjalët dhe shprehjet e huaja duhet analizuar mirë, si nga përbërja e tyre fonetike dhe fonemike, ashtu edhe nga struktura gramatikore e sidomos nga aspekti semantik. Pas një analize të hollësishme të elementeve gjuhësore nga ana e ekspertëve gjuhësorë, rëndom duhet të bëhen propozime që me elementet e tilla gjuhësore të veprohet në njërën nga mënyrat vijuese:

- i) fjala ose shprehja e huaj të përvetësohet;
- j) fjala ose shprehja e huaj të zëvendësohet me ndonjë fjalë ose shprehje të gjuhës marrëse;
- k) fjala ose shprehja e huaj të përkthehet në gjuhën marrëse;
- l) fjala ose shprehja e huaj të refuzohet.

Linguistët konsiderojnë se më lehtë është të huazohet, sesa të zëvendësohet ndonjë element i gjuhës së huaj me ndonjë element gjuhësor përkatës të gjuhës marrëse (Weinreich: 1953). Por, nga ana tjetër,

konsiderohet se për gjuhën marrëse është më mirë të zëvendësohet fjala a shprehja e huaj me ndonjë fjalë a shprehje të gjuhës marrëse, ose madje edhe të përkthehet në gjuhën marrëse, sesa të huazohet.

Për të vendosur se çka të bëhet me një element gjuhësor të huaj nuk është fare punë e lehtë. Kjo madje nuk do të duhej të ishte as detyrë e një personi, çfarëdo qoftë autoriteti i tij në atë lëmë. Puna institucionale do të ishte gjithmonë zgjidhja më e mirë, si në shumë fusha të tjera, edhe në këtë fushë veprimi.

Për të bërë këtë punë, kërkohet kohë e konsiderueshme dhe punë intensive dhe e vazhdueshme. Përveç kësaj kërkohet një përvojë e mirë sesi është vepruar me huazimet në të kaluarën, si brenda gjuhës sonë, ashtu edhe të gjuhëve të tjera. Por lipset edhe dije e mjaftueshme dhe përgjegjshmëri e madhe në këtë punë shumë të ndjeshme. E kjo, si duket, na mungon dhe nuk jemi duke vepruar në mënyrë adekuate krahas problemit me të cilin ballafaqohemi.

Sot duket sikur janë hequr pengesat që ndalin depërtimin e fjalëve të huaja dhe ato e kanë vërshuar gjithë truallin gjuhësor të shqipës. Askush më nuk bën përpjekje serioze për t'i dalë përballë një sulmi të tillë nga fjalët e huaja, përveç që bëhet ndonjë orvatje individuale në disa shkrime të rralla të botuara në gazeta.

Depërtimi i fjalëve të huaja në gjuhën shqipe gjatë kësaj periudhe, për dallim nga kohët e tjera, ka qenë dhe është shumë i vrullshëm dhe del sikur mbrojtësit e gjuhës shqipe nuk janë në gjendje të përballojnë një turr aq të madh të tyre. Zhvillimi i jetës dinamike ka shkaktuar që çdo gjë të jetë dinamike, ndërsa ne jemi mësuar më parë t'i trajtonim gjërat më ngadalë. Ky dinamizëm i depërtimit të fjalëve të huaja na ka gjetur të papërgatitur dhe të hutuar për të frenuar këtë dukuri dhe për t'i zgjidhur si duhet problemet që dalin përkitazi me të. Në të kaluarën, një fjalë e huaj sillej rreth e rrotull me vite të tëra në të folur, po edhe në shkrime shqipe, derisa përfundimisht e gjente vendin në këtë gjuhë marrëse, duke kaluar nëpër proceset e përshtatjes, të asimilimit dhe të integritimit në gjuhën marrëse. Mirëpo, tani ato vijnë në grumbuj me depërtimin dinamik nga jashtë të teknologjisë informative dhe të teknologjisë në përgjithësi, për shkak të një hapjeje globale të politikës, të ekonomisë dhe të kulturës së vendit tonë ndaj botës dhe për arsye të pranisë së institucioneve ndërkombëtare që u vendosën këtu pas luftës në Kosovë. Ritmi ynë i bërë shprehi për të reaguuar ndaj elementeve gjuhësore të huaja të futura në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe pa nevojë, nuk u del dot atyre përpara me sukses.

Para fillimit të transicionit në vendin tonë, elementet e gjuhëve të huaja (pra edhe të anglishtes) hynin në shqipe kryesisht sipas mëny-

rës së të huazuarit kulturor ose të tërthortë. Prandaj edhe numri dhe denduria e tyre ishin shumë më të vogla.

Me ardhjen në Kosovë të UNMIK-ut, të KFOR-it, të OSBE-së, të USAID-it, të UNHCR-it dhe të shumë organizatave të tjera ndërkombëtare nga shumë vende të botës, në ato u punësuan përkohësisht shumë të rinj e të reja, të cilëve u mungonte dija e mirëfilltë e anglishtes, po edhe e shqipes. Prandaj filluan të përdornin fjalë të huaja (angleze), qoftë në të folur ose në shkrime. Nevojiteshin shumë përkthyes në të gjitha organizatat e tilla ndërkombëtare dhe, për çudi, edhe në organizatat vendore. Ata përkthyes, ndihmës (asistentë), shoqërues e të tjerë filluan të përdornin fjalë angleze edhe për shumë nocione që ekzistonin në gjuhën shqipe. Prej asaj kohe ndryshoi mënyra e të huazuarit – nga mënyra e të huazuarit të tërthortë, kaloi në mënyrën e të huazuarit të drejtpërdrejtë.² Kjo pasoi ngase kontakti midis këtyre dy gjuhëve u bë i drejtpërdrejtë.

Si rrjedhojë e kësaj gjendjeje gjuhësore edhe qasja, shqyrtimi dhe analiza linguistike e tyre, tani duhet të bëhet ndryshe, në përputhje me mënyrën e të huazuarit, ashtu siç janë bërë studimet e ndikimit të anglishtes në gjuhët e ndryshme në Amerikë e gjetiu, ku folësit e anglishtes dhe të ndonjë gjuhe tjetër jetojnë dhe veprojnë në të njëjtën hapësirë gjeografike dhe shoqërore.

Nga ana tjetër, me ndryshimin e sistemit politik, ekonomik dhe kulturor në vendin tonë, është paraqitur nevoja për emërtimin e shumë nocioneve të reja, që nuk kanë ekzistuar më parë ndër ne. Ato duhej të emërtoheshin. Kurdo që nuk është gjetur në gjuhën shqipe si gjuhë marrëse një term ose shprehje përkatëse për to, ato janë huazuar. Me siguri disa elemente gjuhësore të huazuara do të duhej edhe të mbeteshin në gjuhën shqipe, siç ndodh gjithmonë me dukurinë e të huazuarit. Dhe huazimi i tyre, pas një analize të hollësishme të potencialit të gjuhës marrëse dhe të pamundësisë për t'i emërtuar me fjalë a shprehje shqipe, do të ishte veprim i drejtë. Por

² Një ndër linguistët e shquar të hershëm që u mor edhe me huazime gjuhësor ishte amerikani Leonard Bloomfield, i cili u bë i njohur me veprën e tij gjuhësore *Language* (Gjuha), të botuar në vitin 1935, e cila citohet nga shumë linguistë që erdhën pas tij. Ai, përveç tjerash, kishte përcaktuar se huazimet përvetësoheshin në një gjuhë marrëse në dy mënyra kryesore: në mënyrë të drejtpërdrejtë apo *intime* dhe në mënyrë të tërthortë apo *kulturore*. Sipas Bloomfieldit, forma e parë e të huazuarit bëhej kur folësit e dy gjuhëve jetonin dhe vepronin, prandaj dhe i përdornin gjuhët e tyre në të njëjtën hapësirë gjeografike dhe topografike, kurse forma e dytë e të huazuarit gjuhësor – ajo kulturore ose e tërthortë – bëhej kur dy gjuhët, gjuha dhënëse dhe gjuha marrëse, përdoreshin në dy hapësira të ndryshme gjeografike dhe topografike.

edhe elementet gjuhësore të huazuara për këtë arsye duhet t'i nënshtrohen procedurës së përshtatjes fonetike, gramatikore dhe semantike.

Në kohën e përhapjes së globalizmit, gjuha shqipe nuk ka aq fuqi të mjaftueshme për t'u përballur me turrin e fjalëve të huaja, siç do të mund t'u qëndronin gjuhët më të mëdha, si gjermanishtja, frëngjishtja, italishtja, turqishtja e të tjera, të cilat kanë me dhjeta miliona folës madje edhe me një traditë më të gjatë dhe organizim dhe regjim shumë më të sistemuar të gjuhëve të tyre. Në një rrethanë të tillë, shqipja vetëm mund të pësojë ndikime nga gjuhë të tjera e jo të ushtrojë ndikim mbi ndonjë sosh.

Përveç problemit të të huazuarit si të tillë, ekziston edhe çështja e të huazuarit në forma të ndryshme në trevat ku flitet shqipja, si b.f. në Kosovë dhe në Shqipëri. Disa huazime të elementeve gjuhësore angleze që huazohen në Shqipëri dhe në Kosovë marrin trajta të ndryshme, të cilat dallojnë midis këtyre dy vendeve. Një numër fjalësh që kanë zanoren /æ/ në anglishte, kanë një traditë që dallon në përshtatjen fonematike të tyre midis Shqipërisë dhe Kosovës. Në shqipen e Kosovës më herët ka mbizotëruar zëvendësimi i kësaj foneme zanore me /e/. Kjo është bërë nën ndikimin e serbishtes, e cila ndikonte si gjuhë ndërmjetëse, përmes së cilës zakonisht vinin këtu fjalët e huaja. Në atë gjuhë rëndom bëhej përshtatja fonetike e huazimeve angleze /æ/ > /e/. Shqipja e Kosovës e merrte atë në formë të gatshme të përshtatur, si gjë të kryer. Kështu ishte fjala angleze: jazz /æz/ që në shqipe shkruhej xhez; po ashtu fjala angleze training në shqipen e Kosovës shkruhej e shqiptohej trening ose më shpesh duke rrudhur diftongun /ei/ në /e/: trening (sipas serbishtes). Fjalët e prejardhura nga ajo ishin: trener/ trener, trenerka (për pantallonat xhinse, përsëri sipas serbishtes). Që të dyja këto fjalë në Shqipëri shkruheshin (pa dyshim edhe shqiptoheshin) xhaz dhe trajning. Kjo fjalë e fundit pas luftës së Kosovës, që kur këtu erdhën ndërkombëtarët, shkruhet dhe shqiptohet trajnim, dhe emri i prejardhur është trajner, madje haset edhe trajnues.

Është interesant se ajo 'traditë' e mëhershme vazhdon edhe sot. Edhe pse të rinjtë nuk e dinë gjuhën serbe as që kontaktojnë me atë gjuhë, fjala angleze *chat* /tʃæt/ në Kosovë shkruhet dhe shqiptohet *çet* /tʃet/, kurse në Shqipëri *çat* /tʃat/. Atje madje haset edhe folja *çatoj*, gjë që në të folurit as në shkrime në Kosovë nuk e kemi hasur. Edhe fjala angleze *rap* /ræp/, një stil bashkëkohor i muzikës, në Kosovë shkruhet dhe shqiptohet *rep*, kurse në Shqipëri shkruhet dhe shqiptohet *rap*.

Po ashtu fjala kompjuter/kompjuter ka dy shqiptime dhe shkrime të ndryshme - në Kosovë shqiptohet /kompju`ter/ dhe shkruhet kompjuter, ndërkohë që në Shqipëri shqiptohet /kom`pjuter/ dhe shkruhet kompjuter.

4. Përfundim

Siç mund të shihet nga të dhënat që u cekën, ka vend dhe nevojë për të biseduar dhe për t'u marrë me këto dallime si dhe për shumë çështje të tjera. E, të gjitha këto nuk mund të bëhen, as nuk duhet të bëhen njëanshmërisht, qoftë në Kosovë a në Shqipëri, por duhet të shqyrtohen dhe në fund të arrihet në një mendim dhe vendim të përbashkët, nga ndonjë grup punues, komision a si do ta quajmë tjetër.

Në vitet e fundit ka pasur përpjekje individuale të herëpashershme për të marrë në shqyrtim ndonjë fjalë a shprehje të huaj, por sa dimë ne, deri tani nuk është ndërmarrë ndonjë veprim konkret institucional nga institucionet kompetente, siç janë Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Universiteti i Prishtinës për t'i shqyrtuar këto çështje në mënyrë gjithëpërfshirëse.

Kur themi se do të duhej të formohej ndonjë grup punues, komision a sido që ta quajmë, kemi parasysh së pari faktin se gjuha shqipe standarde duhet të mbetet e unifikuar në të gjitha trojet ku shqipja është gjuhë zyrtare. Studimi i njëanshëm i huazimeve vetëm në njërën nga trojet shqipfolëse do të ishte i mangët, sepse nuk do të ngërthente njësoj dhe të gjitha dukuritë gjuhësore që paraqiten me rastin e të huazuarit gjuhësor. Ekzistojnë dallime si për nga denduria e të huazuarit ashtu edhe për nga përzgjedhja e gjuhëve prej nga huazohen elemente gjuhësore.

Këtu u zunë ngoje vetëm fjalët e prejardhura nga anglishtja. Do të duhej të shqyrtoheshin edhe fjalët që vijnë nga gjuhë të tjera. Edhe në këtë sferë ka dallime midis Kosovës dhe Shqipërisë; në Shqipëri huazohet nga italishtja më shumë se në Kosovë.

Me një hulumtim serioz, për disa prej huazimeve që tashmë janë të pranishme në shqipe, mund të gjenden ose të krijohen fjalë përkatëse të shqipes, me të cilat do të mund të zëvendësoheshin, e ndonjë tjetër edhe të huazohej, por pasi të jenë shterur të gjitha mundësitë për zëvendësim a përkthim të tyre.

Mendojmë se gjendja e palakmueshme në lëmin e përdorimit të elementeve gjuhësore të huaja në gjuhën shqipe ka arritur në një shkallë mjaft kritike. Është kohë e fundit që njerëzit dhe institucionet kompetente të mendojnë për këtë dhe të ndërmarrin ndonjë masë mbrojtëse për ta ruajtur gjuhën shqipe nga ndikimet e panevojshme të gjuhëve të huaja, para se të bëhet edhe më vonë.

Duhet të theksohet edhe fakti se disa nga vendet ku fliten gjuhë të "mëdha" (si Franca, Turqia e ndonjë tjetër) kanë krijuar mekanizma shtetërorë për të mbrojtur gjuhët e tyre nga ndikimet e pakontrolluara

të gjuhëve të tjera. Sa dimë ne, në Kosovë e as në Shqipëri, dhe as në Maqedoni, nuk ekzistojnë mekanizma shtetërorë as institucionalë për mbrojtjen e gjuhës shqipe nga ndikimet e huaja.

Si përfundim, mendojmë se do të ishte mirë të merreshin vesh institucionet përkatëse, që merren me gjuhë (e letërsi dhe kulturë), siç janë Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë, mbase edhe ndonjë institucion tjetër përkatës dhe i nevojshëm, dhe të formonin një organ të *përhershëm* për t'u marrë me këto çështje në mënyrë të vazhdueshme. Një komision *ad hoc* i këtyre dy akademive, i formuar para tre-katër vjetësh, me vetë statusin dhe përbërjen që ka, mendojmë se nuk ka arritur qëllimin e tij. Ka nevojë për një punë dhe bashkëpunim të vazhdueshëm të organeve të tilla, nëse synojnë që të arrijnë rezultate të mira.

Shqipja, ashtu siç ka mbetur sot, ka vërtet nevojë për një përkujdesje më të madhe nga shumë anë, prandaj edhe në çështjet e të huazuarit gjuhësor.

*

5. Vlerësime dhe propozime për disa huazime angleze të reja

Huazimet që ishin përvetësuar nga gjuha shqipe deri në gjysmën e dekadës së tetë të shekullit të kaluar, janë analizuar deri në hollësi në punimin tonë të magjistraturës dhe në botimet nëpër revista, buletine dhe gazeta të viteve të shtatëdhjeta dhe të tetëdhjeta.³

Tashmë ka një numër të madh fjalësh që janë bërë të përditshme në fjalorin ose, thënë më mirë, në përdorimin tonë. Më poshtë do t'i zëmë ngoje vetëm disa nga to, pak më të njohura dhe më pak të pazakonshme.

Gjatë procedurës së vlerësimit nëse duhet të përvetësohen ose jo fjalët e huaja, është vendimtare të shihet nëse ato emërtojnë ndonjë nocion të ri, i cili nuk ka emër përkatës në gjuhën shqipe. Ky parim mund të zbatohet edhe në rastet kur huazimi ndihmon për të bërë dallimet midis nocioneve të ngjashme por në kontekste të ndryshme.

Në përputhje me ato që u thanë më sipër përkitazi me huazimet nga anglishtja, këtu do të provojmë të japim disa vlerësime personale për një numër fjalësh të tilla, të cilat tashmë kanë hyrë në përdorim në gjuhën shqipe. Po japim një numër huazimesh që, sipas mendimit to-

³ Nja 13 shkrime janë përzgjedhur si kontribute nga kjo fushë e hulumtimit gjuhësor për këtë botim.

në, do të mund të pranoeshin në gjuhën shqipe për ndonjë arsye që do të theksohet me rastin e secilit huazim.

Me futjen e kompjuterit, në përdorim të dendur u fut një numër i madh fjalësh që vijnë bashkë me punën që bëhet me të. Lidhur me të u futën edhe fjalët e përdorimit të teknologjisë së internetit. Të gjitha këto e kanë ngulfatur gjuhën shqipe. Nevojitet shumë dije, përvojë dhe maturi për t'u dhënë përgjigje të gjitha atyre çështjeve që paraqiten lidhur me fjalët dhe shprehjet që hasen në shkrimet shqipe dhe në të folurit shqip.

Vetë fjala 'kompjuter', që në disa gjuhë më herët quhej 'llogaritës', nuk mund të mbërthehet më në konturat e fjalës "llogaritës", sepse ai tani nuk bën vetëm llogaritje. Madje më shumë përdoret për veprime të tjera, si për shtypje tekstesh, për disenjim, për komunikim me internet etj., sesa thjesht për llogaritje. Ky huazim është përkthyer në frëngjishte, në turqishte e në ndonjë gjuhë tjetër. Por në gjuhën shqipe deri tani as që ka pasur ndonjë përpjekje për ta shqipëruar. Prandaj ky huazim duhet të integrohet në gjuhën shqipe, siç edhe është bërë më. Mirëpo, siç u tha më sipër, ka mbetur ende e pazgjidhur çështja e përshtatjes fonetike të këtij termi: të shqiptohet dhe të shkruhet kompjuter (si në Shqipëri) apo kompjuter (siç shqiptohet dhe shkruhet në Kosovë)? Në korrektuesin gjuhësor elektronik është përvetësuar trajta kompjuter. Megjithatë kjo është një çështje që mbetet për t'u shoshitur edhe më tutje.

Po ashtu, a ka gjasë të thuhet shqip kuptimi i fjalës internet (që në përkthim fjalë për fjalë do të thotë "ndërrjet")? Natyrisht, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat gjuhësore dhe sociologjike, përfundimi do të dilte se një kompozitë kalk e tillë do ta kishte vështirë të funksiononte. Fjala internet ka denduri shumë të madhe të përdorimit dhe ka kaluar në grupin e huazimeve ndërkombëtare. Ky term tashmë është bërë shumë i rëndomtë dhe nuk ka më fuqi gjuhësore për ta lëvizur në ndonjë term tjetër.

Për termin bord ka pasur përpjekje të zëvendësohet me termin këshill. Kjo dhe do të mund të bëhej. Megjithatë ai vazhdon të përdoret si huazim. Bordi do të mund të zëvendësohej edhe me termin kolegji, i cili ka ekzistuar më herët. Mbase kuptimin më të afërt e ka me këshillin drejtues. Mendojmë që ky huazim do të mund të qëndronte e të konkurronte me termin këshill drejtues, por vetëm për organizatat ekonomike (duke përfshirë edhe ato arsimore, shëndetësore, kulturore etj.), por jo për organizatat partiake a politike. Këtyre të fundit u përgjigjet më mirë termi këshilli drejtues. Pra, me përvetësimin e fjalës bord, do të mund të bënim një dallim midis emërimit të këtij nocioni në organet përkatëse në ndërmarrje e institucione dhe në organet partiake e politike.

Fjala *staf* viteve të fundit po përdoret për të emërtuar njerëzit e punësuar në një organizatë a ndërmarrje. Edhe pse e kemi pasur më parë fjalën *personel*, mendojmë se kjo fjalë e huazuar duhet të pranohet në shqipe, sepse me të mund të bëhet dallimi semantik i të punësuarve në dy grupe, siç janë edhe sipas natyrës së punëve që bëjnë: në grupin e të punësuarve teknikë dhe të të punësuarve administrativë dhe profesionistë. Atyre që dikur u thoshim kuadro, tani mund t'u themi staf, kurse të punësuarit vetëm teknikë (pastruesit, shoferët, rojtarët, shërbyesit e mirëmbajtjes etj.) mund t'i quajmë personel.

Termi tender ka hyrë aq shumë në përdorim dhe ka zënë vend në gjuhën shqipe në Kosovë. Një term me kuptim të ngjashëm e kemi pasur më parë - licitacion. Mirëpo, mbase kuptimi i tenderit dallon nga ai i licitacionit për nga procedura e zbatimit të veprimit të tij, në disa raste. Prandaj mendojmë se termi tender duhet të pranohet në gjuhën shqipe.

Fjala prokurim ka hyrë po ashtu në periudhën e pasluftës në sferën e financave në Kosovë. Ekspertët thonë se ky term ka fushë semantike paksa më të gjerë sesa termi furnizim. Ai i përgjigjet sistemit financiar që funksionon tani këtu. Prandaj mund të pranohet si i tillë në shqipet. Mirëpo, vepruesi a zbatuesi i prokurimit nuk duhet të quhet prokuror, siç haset ndonjëherë, sepse ashtu do të shprehte një nocion tjetër të fushës së gjyqësisë, por personi i tillë duhet të quhet prokurues.

Menaxhment, menaxher dhe menaxhim janë terma që tashmë përdoren në jetën e përditshme. Ndonëse ka mendime se për termin menaxhment duhet të përdoret termi udhëheqje, për menaxher – udhëheqës dhe për menaxhim - të udhëhequrit/udhëheqje, këto huazime i bëjnë më të qarta, i saktësojnë më mirë semantikisht kuptimet përkatëse, meqenëse fjala udhëheqje me derivatet e veta është shumë më e përgjithshme në shqipet, ajo ka më shumë konotacion politik. Kështu që mendojmë se për çështjet ekonomike dhe financiare duhet të pranohen këto fjalë angleze të një rrënje, kurse për politikë e gjetiu të mbeten fjalët shqipe *udhëheqës*, *udhëheqje* etj.

Termi i aparatit printer, me të cilin shtypen materiale të prodhuara me kompjuter, shënon një nocion të veçantë në kontekstin e punës me kompjuter. Fjala shtypës, me të cilën mendojnë disa që duhet të zëvendësohet, ka një kuptim shumë të përgjithshëm, me një polisemi të gjerë: shtyp në makinë shkrimi, shtyp një revolucion a demonstratë, shtyp popullin etj. Prandaj, mendojmë se ky emërtim i aparatit të tillë duhet të përvetësohet. Mbase mund të përvetësohet edhe folja e dalë nga emri printer – *printoj*, sepse është një proces krejt ndryshe nga shqipja e rëndomtë.

Për të mos e zgjatur shumë me analizë të hollësishme të shumë huazimeve të tjera të reja nga anglishtja, këtu po i shënojmë disa nga huazimet që tashmë janë duke e gjetur vendin e tyre, madje dhe duke u integruar në gjuhën shqipe dhe të cilat mendojmë se mund të përdoren, qoftë për shkak se shënojnë nocion të ri në gjuhën marrëse, qoftë për shkak se bëjnë dallim semantik të nevojshëm me ndonjë term përkatës të gjuhës shqipe, apo për shkak se nuk mund të gjejmë ndonjë fjalë a term përkatës me brumë të shqipes, si dhe për arsye të tjera. Megjithatë, këto fjalë duhet të përcillen dhe pas një kohe të shihet se si përdoren në shqipet dhe pastaj të bisedohet për ndonjë prej tyre. Ndër fjalët e tilla mund të radhiten: *aplikant/ aplikim/ aplikoj, asete, auditor, auditim, çat/çet, doping, DVD/dividi, eksel, fajl, gigabajt, hardver/harduer, klip, softver/softuer, klon/ klonim/ klonoj, laptop, pin, plejbek, rap/rep, roker, server, skanim/skenim, skanoj/skenoj, stereo, toner, vindouz/uindouz, vord/uord*, e ndonjë tjetër.

6. Disa anglizma të panevojshëm

Me këtë rast do të marrim për shqyrtim vetëm disa fjalë e shprehje të anglishtes që në kohë të fundit po përdoren në gjuhën shqipe pa nevojë dhe shpesh me kuptim të gabuar. Me këta shembuj, natyrisht, nuk mendojmë se gjejmë ndonjë zgjidhje të sigurt të të huazuarit. Këta janë vetëm disa shembuj më të spikatur që vërtet nuk kanë kurrfarë arsyeje për t'u përdorur, përveç që përdoruesit e tyre për të shitur mend para publikut, kinse dinë të përdorin fjalë të huaja që të tjerët nuk i dinë. E ato, në të vërtetë, nuk bartin kurrfarë kuptimi të veçantë nga fjalët përkatëse shqipe ose nga ato të huazuara më herët.

Fjala adresoj (një çështje, problem etj.) është fare e panevojshme në shqipe kur për këtë kemi foljet shqipe të përdorura deri tani, si: shqyrtoj një çështje a problem, merrem me një çështje a problem, përpiqem të zgjidh një çështje a problem etj.

Kuptimi themelor i fjalës 'address' në anglishte është adresoj, drejtoj, dërgoj, paraqes (një letër, dokument, kërkesë, mall etj. dikujt ose diku). Dhe në këtë kuptim ajo edhe mund të përdoret si huazim, nëse na duket si shprehje më e bukur se drejtoj, dërgoj, paraqes (një çështje, problem etj.). Mënyra si e përdorin shpesh dhe konteksti kur e përdorin këtë fjalë, sidomos politikanët, duket të ketë kuptimin e foljes *shqyrtoj*. Mund të themi lirisht se shpesh ata që e përdorin këtë huazim, as që e dinë mirë se çfarë kuptimi ka. Mirëpo, me përdorimin e kësaj foljeje dhe të fjalëve të tjera si kjo, siç theksohet edhe në teorinë e interferencave gjuhësore (Weinreich: 1953), ata përpiqen të tregojnë një shka-

llë më të lartë të njohjes së gjuhëve të huaja. Kjo fjalë e huaj, pra *ad-resoj/adresim* në kontekstin që u cek më lart, është e panevojshme në shqipet. Ajo tingëllon si fjalë shumë artificiale në ligjërimin e shqipes, si një trupth fare i huaj dhe i rëndë, i pavend. Në vend të saj, pra, duhet të përdoret ndonjëra nga fjalët sinonimike të shqipes.

Fjalët *suport* (em.) ose *suportoj* (fol.), të cilat përdoren sidomos në Shqipëri dhe fatbardhësisht kryesisht në të folur e jo shpesh edhe në shkrime, janë për shumë çudi, sepse janë fare të panevojshme, meqë kemi dy fjalë themelore të shqipes që përdoren shumë gjatë dhe e shprehin shumë mirë kuptimin e kësaj lekseme të anglishtes. Pra, kemi fjalët *përkrrah/përkrrahje*, ose *mbështes/mbështetje* në gjuhën shqipe.

Termi *task force*, të cilin e dëgjojmë dhe e shohim të shkruar jo rrallë në shqipe, fillimisht në anglishte është përdorur në terminologjinë ushtarake për të shënuar një njësi operative speciale, por më vonë ka kaluar edhe në përdorim më të përgjithshëm të lëmenjve të tjerë edhe të shërbimeve joushtarake. Ky term tani emërton një grup punues a komision special, i cili shqyrton a merret me një detyrë më specifike nga ndonjë fushë e rëndësishme e veprimtarisë. Mendojmë se një trup i tillë mund të quhet shqip grup punues special (a specifik), duke mos i munguar asgjë nga përmbajtja semantike. Aq më parë duhet ta shmangim kur edhe shohim se përdoret me shkrim të anglishtes.

Termi i fushës ekonomike *spin off* është dëgjuar të përdoret bukur shpesh, sidomos me rastin e privatizimit të ndërmarrjeve ekonomike. Ka kuptimin që ndërmarrja (e privatizuar) mund të prodhojë (edhe) prodhime dytësore, të tjera, ose të merret me fitim anësor. Pra, në vend se të thuhet privatizim me *spin off*, duhet të thuhet shqip privatizim me *veprimtari dytësore*, ose privatizim me *fitim anësor*. Thjesht, mund të thuhet privatizim me destinacion të ndryshuar.

Termi bodigard që përdoret për kuptimin e rojës a rojtarit (personal), i cili dëgjohet në gjuhën e folur ose haset në shkrime, do të duhej të mos përdorej në shqip. Termet rojtar a roje (personale) shprehin kuptimin e njëjtë.

Fjala angleze *copyright*, që shënohet në libra e gjetiu dhe që ka domethënie e mbrojtjes së të drejtës së autorit, nuk do të duhej të përdorej as të shkruhej në shqipet. Sintagma shqipe *e drejta e autorit* e shpreh fare qartë nocionin e huazimit *copyright*.

Në vend të huazimit anglez *flash/flesh* mund dhe duhet të thuhet shqip: *shkurt*; lajmet shkurt. Shprehja *lajmet flash/flesh* është vetëm një tendencë e rreme për modë.

Termet për marrëdhënien e punës full time, part time, janë të panevojshme në shqipet, kur kemi tashmë shprehjet marrëdhënie e plotë pune ose punë e rregullt, përkatësisht marrëdhënie e punës plotësuese ose punë me honorar.

Fjala angleze *horror* për një lloj filmash të trishtueshëm ose tmerrues nuk është për t'u përdorur kur këtë mund ta themi me fjalë shqipe: film *trishtues* ose film *tmerrues*.

Trajta e fjalës së huazuar më herët nga frëngjishtja imazh dëgjohet shpesh të shqiptohet imixh (me shqiptim anglez) ndonëse edhe në anglishte është huazuar nga frëngjishtja. Kjo bëhet vetëm gjoja për të ndjekur modën. Na duket se duhet të përdoret trajta më origjinale – imazh.

Implementim /implemntoj/ implementues janë fjalë të gjata dhe të huazuara nga anglishtja pa nevojë, sepse kemi fjalët shqipe: *zbatim/zbatoj/ zbatues* të shqipes. Semantika e këtyre huazimeve nuk përmban as shpreh asgjë më shumë sesa fjalët përkatëse shqipe.

Edhe huazimi anglez *involvoj/involvim* nuk i duhet shqipes meqë kjo gjuhë marrëse ka fjalë që shprehin kuptimin e këtij huazimi, madje edhe në kontekste e kuptime të ndryshme, si: *përfshij/përfshirje* dhe *përzihem/përzierje*.

Termi i anglishtes që po përdoret, *sidomos* në muzikë, live (lajv), p.sh.: këndoj live, program live etj., nuk është zgjedhje e mirë, sepse kemi mundësi të themi shqip: këndoj drejtpërdrejt. Ndonëse kjo fjalë duket paksa e gjatë në shqipe, do të duhej të përdorej kjo e fundit dhe jo huazimi.

Këtu më poshtë po japim një listë të papërfunduar (sepse çdo ditë mund të shtohet ndonjë fjalë a shprehje e re) fjalësh e shprehjesh të huazuara nga gjuha angleze në vitet e fundit, të cilat ende nuk janë ngulitur në shqipet. Mbetet për t'u marrë ndonjëherë tjetër me to dhe me të tjera që do të paraqiten më vonë në gjuhën shqipe. Siç mund të shihet, disa prej këtyre fjalëve a shprehjeve janë përshtatur deri diku fonetikisht, kurse disa ende shkruhen në formë origjinale (anglisht). Trajtat e paraqitura këtu janë ashtu siç janë hasur në shkrime.

<i>akselerim</i>	<i>Hotmail</i>	<i>sajt</i>
<i>audio hyrje</i>	<i>Intel</i>	<i>sharing</i>
<i>audio dalje</i>	<i>interfejs</i>	<i>shou-biznes</i>
<i>kantri back up</i>	<i>jump drive</i>	<i>skajleb/skajlab</i>
<i>benchmark/ bençmark</i>	<i>kalkulator</i>	<i>sllot</i>
<i>bitrate</i>	<i>kernel</i>	<i>smajl</i>
<i>bodi-bilding</i>	<i>kikboks</i>	<i>spejsleb/ spaslub</i>
<i>brejn-drejn</i>	<i>kit</i>	<i>stardom</i>
<i>browser</i>	<i>konfidencialitet</i>	<i>stereoskopik</i>

<i>çipset</i>	<i>log-in/ login</i>	<i>street-ball</i>
<i>desktop</i>	<i>megapiksel</i>	<i>surfer</i>
<i>displej</i>	<i>memori stik</i>	<i>surfim</i>
<i>drajv/ drajver</i>	<i>mikroçip</i>	<i>tag</i>
<i>eipmen</i>	<i>mini aplikacione</i>	<i>tagim</i>
<i>ekselerometër</i>	<i>msn</i>	<i>tagoj</i>
<i>ekshën</i>	<i>multi-shot</i>	<i>taguar (i)</i>
<i>ekstern</i>	<i>on line</i>	<i>terabajt</i>
<i>ethernet</i>	<i>paket memorje</i>	<i>teraflop</i>
<i>evazive</i>	<i>pasuord/ pasvord</i>	<i>tuner</i>
<i>frontmen</i>	<i>piksel</i>	<i>ultralaptop</i>
<i>Google</i>	<i>piksel/pixel</i>	<i>USB – juesbi</i>
<i>haker</i>	<i>ping</i>	<i>vinçester</i>
<i>hakoj</i>	<i>procesor</i>	<i>VIP/ vip</i>
<i>hard disk</i>	<i>Rejting</i>	<i>virtual</i>
<i>haver</i>	<i>roadmap</i>	<i>virtualizim</i>
	<i>router</i>	<i>Yahoo</i>

LISTA E HUAZIMEVE ANGLEZE NË GJUHËN SHQIPE⁴

academic	akademik
ace	as
acomodate	akomodoj
acomodation	akomodoj
acre	akër
aero club	aeroklub
air conditioning	erkondishën
air meetint	aeromiting
all rigat	olrajt
Anglo-Saxon	anglosakson, anglo-sakson
anti-baby	anti-bebi
antitank	antitank, antitanks
apartheit	apartheit
auto-cross	autokros
baby boom	bebi-bum
back	bek
badge	bexh
badminton	badminton
bamboo	bambu
bar	bar
bard	bard

⁴ Këto janë huazimet angleze të evidentuara deri në vitin 1974, kur e kemi përfunduar hulumtimin në gjuhën shqipe të shkruar në mjetet e informimit e ndonjëherë edhe të dëgjuar në gjuhën e folur në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni.

barrel	barel
basball-player	bejsbollist/e
baseball	bejsboll
basket ball	basketboll
basket, adj.	basketbollistike
basket-ball player	basketbollist/e
beatles	bitëlls
beefsteak	biftek
best-seller	bestseller
bicycle	bajshikël
big band	big-bend
bingo	bingo
blackpool	blekpul
blazer	blejze
Bloomfieldian	Bloomfieldian
blue	blu
bluff	blof
bob	bob
bob-skater	bobist/e
body language	gjuhë me trup
body-builder	bodi-bilder/e
body-building	bodi bilding
bojler	bojler
booking	buking
bookmaker	bukmejker
boomerang	bumerang
boss	bos
box	boks
box, v.	boksoj
boxer	boksier, bokser/e
boxing	boksim
boxing club	boks-klub
boxing match	boks meç
boy scout	bojskaut
boycott	bojkot
brandy	brandi, brendi
bridge	brixh
brig	brig
broiler	broiler
brom	bum
budget	buxhet
buldog	bulldog
buldozer	buldozer
bul-dozer driver	buldozerist
bull-dozer	buldozer
bungalow	bungalou, bungalov
business	biznis, biznes

businessman	biznismen, biznesmen
butterfly	beterflaj
cake	kek, keks
cakes	keks
cambrick	kambrik
camp	kamp
camp, v.	kampoj
camper	kampist/e
camping	kampim, kamping
campus	kampua
cange	kanu
catch-as-catch-can	keç-es-keç-ken
catcher	keçer
CD	CD
cent	kent
Charleston	çarlston
Charter	çarter
Chartist	çartist
chery-brandy	sheribrendi
chess-club	shah-klub
clearing	kliring
clip	lip
clown	klaun, kloun, klovn
club	klub
Cockney	kokni
cocktail	koktejl, koktej
coke	koks
college	kolezh, kolegji
combine	kombajn
commonwealth	komonvelth, komonuelth
computer	kompjuter, kompjutër, kompjutor
computer, adj.	kompjuteresk
conformist	konformist
congressman	kongresmen
consulting	konsulting
container	kontejner, kontejner
convoy	konvoj
copyright	kopirajt
corner	korner/e, *korne
corporation	corporejshën
cottage	kotesh
cowboy	kauboj, kovboj
crawl	krol
cricket	kriket
cross	kros
cross runner	krosist/e
cross, v.	krosoj

cross-country	kroskantri, kroskontri
crossing	krosim
cup	kupë
cutlet	kotletë
cyclone	ciklon
dancing	dansing
darling	darling
Darwinism	darwinizëm
derby	derbi
design	dizajn
design	dizajn, dizajnim
designer	dezenator, dizajner
designer	dizajner
destroyer	destrojer
detector	detektor
detergent	deterxhent
dollar	dollar
dress	dres
dress, v.	dresoj
dresser	dreser/e
dressing	dresim
dribble, v.	dribloj
dribbler	dribler/e
dribbling	driblim
drug store	dragstor
dumping	dumping
DVD	DVD
ekspertizë	dkspertizë
ekstrem	dkstrem
engineering	inxhinjering
escalation	eskalacion
esquire	eskuajër
essay	esej, ese
essayist	eseist
export	eksport
export, v.	eksporto
express	ekspres
eye-liner	ajlajner
fair	fer
fair play	ferplej
fan	fen
farm	farmë, fermë
farmer	farmer, fermer
farthing	faring
faul	faul
fault, v.	fauloj
favorite	favorit

feet	fit
fibre-glass	fibërglas, fije qelqi
fifty-fifty	fifti-fifti
fighter	fajter/e
film	film
film, adj.	filmor
flannelette	flanelatë
flexibility	fleksibilitet
flickball	flikboll
flirt	flirt, flert
folklore	folklor
foot	fut
football	futboll
football player	futbollist/e
football, adj.	futbollistik/e
for	for/e
ford	ford
Foreign Office	Forin Office
foxtrot	fokstrot
free shop	fri-shop
freeze	friz
full-time	full tajm, fool time
furlong	farllong
galon	gallon
game	gem
gangster	gangster
gay	gej
GDP	GDP
gegman	gegmen
genteelness	gjentilencë
gentleman	xhentëlmen
geyser	gejzer
gigabite	gigabajt
globe-trotter	gloptroter
goal	gol, *gollë
goal out	gol-aut
goal-average	golaverazh
goal-getter	golgeter, golashënues/e
golf	golf
gong	gong
grape (fruit)	grejfrut
grapefruit	grejp (frut)
guiny	gini
half	half
half welter-weight	gjysmëvelter
handball	hendboll
handball player	hendbollist/e

handikap	hendikep
hand's	enc
happening	hepening
happy-end	hepiend
hat-trick	hettrik
helikopter	helikopter
hit	hit
hockey	hokej
hockey player	hokeist/e
hover-craft	hoverkraft
humour	humor
iceberg	ajsberg
image	imixh, imazh
import	import
import, v.	importoj
inch	inç
infrastruktüre	infrastrukturë
inkubator	inkubator
input	input
insert	insert
Intelligence Service	Intelixhens Servis
internet	internet
interview	intervistë
interview	intervju
Jambo Jet	xhamboxhet
jazz	xhez, xhaz
jazz band	xhezbend, xhazband, bandë xhazi
jeans	xhinse
jeep	xhip, xhips
jersey	zhersej
jockey	xhokej
jogger	xhoger/e
jogging	xhoging
joker	xhoker
jumper	xhemper
junior	junior/e
khaki	kaki
kidnap	kidnapoj
kidnapper	kidnaper, kidnapues
kidnapping	kidnapim
kilowatt	kilovat
king	king
knockdown	nokdaun
knock-down, v.	nokdounoj
knockout	nokaut
knockout, v.	nokautoj
labuor	laburist

lady	ledi
landlord	lendlord
larketing	marketing
laser	laser, lazër, lejsër, lazer
leader	lidër, lider
lieutenant	leftner
lift	lift
linotipist	linotajpist
live	lajf
lobby	lobi
logo	logo
long-play	longplej
lord	lord
lynch	linç
manager	menagjer
match	meç, maç
Mc Donald	mekdonald
meeting	miting, meting
megabite	megabajt
microphone	mikrofon
monitoring	monitorim
nylon	najlon
operate	operoj
output	autput
outsider	autsajder
partner	partner
performance	performancë
petting	petin
piramidal	piramidale
platform	platformë
portfolio	portofol
poster	poster
present	prezent
present v.	prezantoj, prezantoj
press centre	pres qendër
printer	printer
procesor	procesor
pull-over	pulovër
quart	kuart
quiz	kuis, kuis
racket	raketë, reketë, raket
radar	radar
raglan	reglan
reception	recepion
record	rekord
recorder	rekorder
recordman	rekordmen, rekordmbajtës/e

relay race	reli
reprint	reprint
revolver	revolver
ring	ring
roast	rosto
roast-beef	rozbif
rock music	rok muzikë
rock singer	rok këngëtar
roller skate	rollshne
rolls-royce	rols-rojs
round	rund, rundë, raund
rugby	ragbi, regbi
rugby player	ragbist/e
rump-steak	ramstek
sandwich	senduiç, sandviç
scalp	skalp
scheme	skemë
scooter	skuter
scotch	skotlandez
selotape	selotejp
senior	senior/e
sense	sens
server	server
set	set
set advantage	setavantazh
sex	seks
sex-appeal	seksipil
sexy	seksi
sexy bomb	seks bombë
sexy symbol	seks simbol
shakespearian	shekspirian
shilling	shiling
shock	shok
shock-room	shokdhomë
shock-therapy	shok terapi
shoot	shut
shoot, v.	shutoj
shooter	shutist/e
shopping	shoping
shopping centre	shoping qendër
shopping trip	shoping udhëtim
shorts	shorce, shorc
show	shou
show-gerl	shougerl
showman	shumen
single	singël
sir	sër, ser

sketch	skeç
ski	ski
ski lift	skilift
skier	skiator/e, skitar/e
skiing	skijim
sky-hawk	skajhouk
skylab	skajlab, skajleb
sky-liner	skajlajner
slang	sleng
slogan	slogan
smog	smog
smoking	smoking
snack-bar	snek-bar
sniper	snajper
snob	snob
softball	softboll
song	song
sophisticate	sofistikoj
sophisticated	i sofistikuar
sparing partner	sparing partner
speaker	spiker
'speaking'	spikerim
speedway	spidvej
sport	sport
sport, adj.	sportiv/e
sport-aid	sportejd
sportive	sportiv
sportsman	sportist/e
spray	sprej
sprint	sprint
sprinter	sprinter/e
squire	skuadër
stake	stekë
standard	standard
stand-by	stendbaj
start	start
start, v.	startoj
State Department	State Departamenti
sterling	sterlinë, sterling
steward	stjuard
stewardess	stjuardesë
stock	stok
stocks	stoqe
stop	stop
stopping	stopim
stres	stres
strip-tease	striptiz

summit	samit
super	super
superman	supremen
supermarket	supermarket
super-match	supermeç
super-show	supershou
taboo	tabu
tafting	taftin
talky-walky	tokivoki
tank	tank
tanker	tanker
tax	taksë
taxi	taksi
taxi-meter	taksimëtër
teenager	tinejxher
telecom	telekom
teletype	teletajp
tenis player	teniser/e, tenist/e
tennis	tenis
terminal	terminal
test	test
test, v.	testoj
testing	testim
tip-top	tiptop
tommy	tomi
top list	top listë
top secret	“top secret”
topless	toples
tractor	traktor
tractor driver	traktorist
trade union	tredjunion
train, v.	trajnoj
trainer	trajner/e, trajnues/e, trejner/e
training	trejning, trening, trajnim
training suit	trenjerkë
tramway	tramvaj
transparency	transparencë
trend	trend
trik	trik
trolley-bus	trolejbus
trust	trust
twist	tvist, tuist
twiggy	tvidi
twin-lid	tvinlid
uppercut	aperkat
version	version
viaduct	viadukt

volley	volej
volleyball	volejboll
volleyball player	volejbollist/e
volleyball, adj.	volejbollistik/e
volt	volt
waggon	vagon
waterpolo	vaterpolo
waterpolo player	vaterpolist/e
waterpolo, adj.	vaterpolistik/e
watt	vat
website	vebsajt, uebsajt
week-end	vikend, vikend
week-end	vikend, uikend,
welterweight	velter, velter
welvet	velet, uelvit
western	vestern, vestern
whisky	viski, uiski
windows	vindouz, uindouz
yacht	jaht, jahtë
yard	jard
Yorkshire	jorkshir

NDIKIMI I ANGLISHTES NË SHQIPEN E AMERIKËS

SHQIPTARËT NË AMERIKË DHE BRENGA PËR GJUHËN SHQIPE

1. Fillimi në vendin e ri

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, siç dihet, përbëhen nga një numër i madh kombësish, të cilat në atë vend njihen si grupe etnike të kombësive të ndryshme. Shumica e atyre grupeve deri vonë ishin me prejardhje vetëm nga Europa. Mirëpo, në dekadat e fundit, sidomos pas Luftës II Botërore, atje filluan të shkonin edhe pjesëtarë të kombeve të ndryshme nga Azia e, deri diku, edhe nga Afrika. Vendësit e vërtetë të Amerikës, të ashtuquajturit indianë të kuq, janë banorët e parë të kontinentit. Mirëpo, pas zbulimit të atij kontinenti, territorin e sotëm të SHBA-së e kanë banuar më së shumti anglosaksonët, prej këndeje edhe gjuha angleze ka mbetur gjuhë mbizotëruese. Çdo gjuhë tjetër, që ka ardhur në kontakt me të, është asimiluar, ndërsa anglishtja ka mbetur e vetmja gjuhë publike, administrative dhe gjuhë e prestigjit deri në ditën e sotme.

Grupe të ndryshme etnike janë shpërngulur në Amerikë në kohë të ndryshme, ndonjë më herët e ndonjë më vonë. Shqiptarët kanë filluar të emigrojnë në Amerikë⁵ relativisht vonë, krahasuar me popujt e tjerë të Ballkanit. Sipas disa të dhënave,⁶ njeriu i parë që ka shkuar në Amerikë ka qenë nga Korça. Emri i tij nuk është shënuar askund në literaturën që kemi pasur në dorë, por supozohet të ketë arritur atje në vitin 1876. Ai së shpejti kishte shkuar në Argentinë. Shqiptari i parë që ka shkuar në Amerikë dhe që dihet me emër, është Koli Kristoforidhi, ndërsa atje shënohej si Kole Christopher. Ishte nga fshati Katundi i rrethit të Korçës. Thuhet se kishte shkelur në “kontinentin e ri” në vitin 1884. Pasi kishte kaluar një gjashtë vjet në shtetin Masaçuset, ai ishte kthyer në vendlindje.

⁵ Me termin *Amerikë* në këtë punim nënkuptojmë Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

⁶ Stavro Skendi, *The Albanian National Awakening, 1898-1912*, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, 1967, ff. 5-6.

Më vonë kishte shkuar përsëri në Amerikë, për herë të dytë, më 1892, dhe kishte marrë me vete edhe disa kushërinj, miq dhe atdhetarë. Koli, me sa duket, ishte kthyer edhe disa herë të tjera në atdhe, dhe çdo herë kishte marrë me vete njerëz të tjerë nga farefisi dhe fshati i tij dhe i kishte shpënë përtej Atlantikut, sidomos në Boston dhe në rrethinën e tij, të shtetit Masaçuset.⁷ Pas një kohe, me Kolin (i cili më vonë u bë prift), kishin shkuar edhe shokë e miq të tij me të cilët kishte qenë në kurbet në Rumani dhe në Greqi. Numri i shqiptarëve të mërguar në Amerikë deri atëherë kishte arritur në 17 dhe të gjithë ishin nga fshati *Katund*. Në librin e tij K. Demo⁸ jep edhe emrat e atyre 17 shqiptarëve të parë që kishin shkuar në Amerikë.

Grupet e hershme të shqiptarëve, që mërgonin në SHBA, vareshin nga miqtë e tyre. Ata i jepnin të holla hua shumicës së tyre për të paguar biletën e udhëtimit për atë rrugë të gjatë përtej Atlantikut, e cila kushtonte rreth 50 dollarë. Ajo shumë ishte mjaft e lartë për xhepin e zbrazët të shqiptarit të varfër në atë kohë. Në vitin 1907 në Amerikë u miratua një ligj, me të cilin kufizohej kuota e migrimit, sidomos u ndalua emigrimi me të holla hua. Por kurbetçinjtë shqiptarë vazhduan edhe më tutje të mërgonin atje, natyrisht duke sjellë dëshmi se të hollat i kishin të vetat.

Në të vërtetë, e tërë historia e mërgimtarëve shqiptarë në Amerikë përshkohet me një ndjenjë të dukshme të solidaritetit. Ata ndihmonin njëri-tjetrin në çdo rast, të nxitur për këtë jo vetëm nga interesi i përbashkët për t'u përshtatur më mirë në atdhe të dytë të tyre, por edhe nga ndjenja e dashurisë për vendlindjen dhe për popullin e tij, të kultivuar dhe të trashëguar brez pas brezi gjatë historisë shqiptare.

Ndonëse shumica e shqiptarëve që emigruan në Amerikë, sidomos gjatë dy dekadave të para të shekullit XX, ishin bujq nga fshatrat e Shqipërisë, ndryshe nga mërgimtarët që vinin nga vende të tjera të Europës, ata nuk u morën me bujqësi atje. Shumica e shqiptarëve vendoseshin në qytete, e jo në fshatra, sepse emigrimi i tyre u bë në periudhën e zhvillimit industrial në SHBA. Ata nuk shprehnin dëshirë të merreshin atje me bujqësi. Disa i kishin lënë arat në vendlindje dhe kishin shkuar të punonin atje në fabrika. Dy ishin arsytet, sipas mendimit tonë, që ata nuk u morën me bujqësi. E para, të merreshe me bujqësi në atë vend, kërkohej një kapital i konsiderueshëm, i cili u mun-

⁷ Constantin Demo, *The Albanians in America, the first arrivals*, Society Fatbardha of Katundi, Boston, 1906, f. 7.

⁸ *Po aty*.

gonte shqiptarëve mërgimtarë. E dyta, dhe mbase më vendimtarja, ishte se shqiptarët fillimisht kishin shkuar në atë vend të huaj vetëm për të qëndruar përkohësisht atje. Qëllimi kryesor i tyre ishte të fitonin ca para atje dhe të ktheheshin e të jetonin si më të pasur me familjet e tyre, e jo të mbeteshin atje përgjithmonë. Prandaj nuk i kishin marrë as familjet me vete. Me ato para të fituara ata mendonin të blinin tokë ose diç të vlefshme në atdhe, e jo të vendoseshin në vend të huaj përgjithmonë. As që e kishin marrë me mend se do ta bënë Amerikën atdhe të tyre të dytë. Prandaj industria dhe restorantet ishin vendet kryesore ku gjenin punë shqiptarët në vendin e ri.

Orari i punës në atë kohë, si në industri ashtu edhe në restorante, ishte shumë i gjatë - dhjetë deri në dymbëdhjetë orë në ditë. Mirëpo, kjo atyre nuk u dukej edhe aq e mundimshme. Në vendlindje ata ishin mësuar të punonin ag e muzg, prandaj, përkundër një orari aq të gjatë të punës, ata shpesh punonin edhe pas orarit të punës. Qëllimi i tyre i vetëm ishte të fitonin sa më shumë para dhe të ktheheshin në vendlindje. Ata që gjenin punë jashtë orarit të përditshëm të punës konsideroheshin fatlumë. Madje disa jepnin edhe ryshfet për të gjetur një punë të tillë.

Edhe pse qëllimi fillestar i mërgimtarëve shqiptarë ishte të qëndronin përkohësisht në Amerikë, të fitonin sa më shumë që të mundnin për të siguruar një jetë normale në vendlindje, shumë pak prej tyre u kthyen në vendlindje për të vazhduar jetën atje. Arsye mund të jenë rrethanat politike dhe ekonomike gjithnjë në keqësim e sipër në vendlindje. Por na duket se arsye kryesore është se njeriu mashtrohet në kushte të tilla, duke menduar se do të rrijë vetëm edhe pak, edhe ndonjë vit, e kështu vitet kalojnë, kurse ai e sheh më në fund se nuk i mbetet përse të kthehet prapa. Kjo ndodh sidomos kur mërgimtari merr me vete familjen. Fëmijët i akulturohen në vendin e ri dhe vështirë vendosin, ose nuk mund të vendosin fare, të kthehen prej një vendi më të pasur, në një vend më të varfër. Këtë aq më pak e bëjnë brezat e rinj që nuk vuajnë shumë nga nostalgjia për atdheun. Këtë dukuri tashmë e përjetojnë shumë familje edhe në Europë e gjetiu.

Shqiptarët mërgimtarë të Amerikës vinin nga një vend gjysmë feudal dhe kur arrinin në qytete të industrializuara të Amerikës, nuk ishin në gjendje të përshtateshin lehtë në një shoqëri të zhvilluar ekonomikisht, e cila dallonte shumë nga ajo në të cilën ishin rritur dhe kishin jetuar deri dje. Madje, ky vend dallonte edhe nga vendet e tjera në të cilat kishin jetuar disa nga mërgimtarët para se të vinin në Amerikë. Pos që u pengonte mosnjohja e gjuhës angleze, u mungonin edhe kualifikimet dhe përvoja e kërkuar për punë. Duke kaluar Oqeanin Atlantik brenda gjashtë javëve të lundrimit, ata kalonin shekujt e zhvillimit të tyre

ekonomik dhe shoqëror. Prandaj, nuk është larg mendsh që ta ndjenin veten inferiorë në atë shoqëri të re. U dukej se çdo gjë ishte kundër tyre, se çdokush i urrente dhe i refuzonte, si materialisht ashtu edhe shpirtërisht. Mërgimtari, pra, në fillim ishte fare i tjetërsuar.

Shpëtim i vetëm nga ai tjetërsim i madh ishte shoqërimi dhe jeta e përbashkët me bashkatdhetarët, duke ndarë kështu të mirën dhe të keqen së bashku, sipas traditës së tyre shumëshekullore. Të vetmuar, siç ishin në atë botë të largët e të huaj, çdo gjë u dukej e ftohtë dhe misterioze, çdo gjë pos asaj se atje fitonin para shumë herë më shumë sesa do të fitonin në vendlindjen e tyre, madje më shumë se edhe gjetiu në mërgim.

Shumica e shqiptarëve që emigruan në Amerikë, sidomos nga ata më të hershmit, ishin tepër të varfër. Pothuaj të gjithë ishin analfabetë. Nuk kishin kurrfarë njohurie për degë të ndryshme të industrisë. Prandaj, statusi i tyre ekonomik përmirësohej mjaft ngadalë në Amerikë. Mungesa e shkollimit të tyre zgjati shumë kohë, derisa ndonjë nga brezi i dytë i tyre, duke u integruar pjesërisht në jetën amerikane, arriti të kryente ndonjë shkollë. Siç ka ndodhur edhe me grupe të tjera etnike, në kushte të ngjashme me këta, ajo gjendje e pavolitshme e mërgimtarëve shqiptarë, krahasuar me anglosaksonët dhe me grupet e tjera etnike, që kishin emigruar atje më parë dhe që ishin me numër më të madh, i dha këtij grupi të vogël etnik një status shoqëror shumë inferior. Me arritjen e disa personaliteteve shqiptare të arsimuar në atë komunitet të vogël të tyre, qenia shqiptare atje zuri të mëkëmbej e madje edhe të zinte vendin e vet të merituar në mesin e grupeve etnike të Amerikës.

2. Jeta në konakë

Meqenëse qëllimi kryesor i shqiptarëve të parë në Amerikë ishte të fitonin dhe të kursenin sa më shumë para për t'u ndihmuar familjeve në atdhe, ata jetonin nëpër konakë (si i thoshin "konaqe"). Mirëpo, duket se kishin vendosur të jetonin ashtu jo aq shumë për arsye të kursimit, sa për t'i ikur vetmisë, të cilën e njeh mirë vetëm ai që ka pasur rastin ta përjetojë në vend të huaj. Në një dhomë të cilën e merrnin me qira, jetonin bashkë deri në gjashtë, madje edhe më shumë veta; thonë se kishte raste ku kishte edhe dymbëdhjetë veta në një "konak". Në këtë mënyrë paguanin shumë pak për qira. S'ka dyshim se jeta nëpër ato "konaqe" ishte mjaft e vështirë, për shkak të kushteve të këqija të jetës në to. Megjithatë, shumica prej tyre e parapëlqenin më shumë jetën e tillë, sesa të vetmuar. Por duhet ditur se në atdhe shqiptarët ishin mësuar të kalonin mjaft kohë jashtë shtëpisë, ndërsa këtu ishin thujtë të mbyllur brenda katër mureve të shtëpive të këqija, në lagje të ndyra dhe të

varfra të qytetit. Meqenëse nuk i kishin gratë me vete, ata duhej ta pastronin vetë banesën, ta përgatisnin gjellën dhe t'i bënin punët e tjera të shtëpisë. Anëtarët e konakut punonin me radhë në kuzhinë. Më të vjetrit i ruanin të hollat e të rinjve. Të hollat pleqtë i mbanin në qemer që e bartnin krahu e qafë. Askush nuk i ruante të hollat në bankë, sidomos jo në fillim. Ajo mënyrë e ruajtjes së të hollave nuk ishte shprehur e shqiptarëve në atdhe, prandaj disi nuk u besonin bankave. Të vjetrit respektoheshin shumë nga të rinjtë. Prandaj pleqtë i zgjidhnin konfliktet kur ato paraqiteshin midis të rinjve, dhe në përgjithësi u shërbenin si këshilltarë.

Ana e këndshme e jetës në “konaqe” ishte se aty mbizotëronte fryma e miqësisë, e shoqërisë dhe e solidaritetit. Imigrantët kishin nevojë shumë të madhe për shoqëri dhe solidaritet, më shumë se kushdo tjetër. Anëtarët e “konakut” e ndihmonin njëri-tjetrin; kujdeseshin kur dikush sëmurej dhe u gjenin punë atyre që nuk kishin. Shpesh ndodhte që anëtari i papunë të mos detyrohej të paguante banesën dhe ushqimin në “konak”; e mbanin anëtarët e tjerë derisa ai të gjente punë. Po ashtu, kur në “konak” vinte ndonjë anëtar i ri, sidomos nga atdheu, ai nuk paguante gjë për javët e para - ishte mysafir i “konakut”. Pra, solidariteti ishte në shkallë shumë të lartë, e pikërisht kjo u nevojitej shqiptarëve në vendin e huaj.

Mirëpo, kjo jetë e mjerë nëpër “konaqe” ua dobësonte shumë shëndetin shqiptarëve imigrantë. Siç zihet shpesh ngoje nga dëshmitarët, pas një jete në kushte të këqija dhe në lagje të varfra e të ndyra të qytetit, shumë prej atyre që ktheheshin në atdhe nuk ishin në gjendje shëndetësore ta gëzonin atë pasuri të cilën e kishin fituar me aq shumë mundime dhe e kishin ëndërruar aq gjatë në mërgim për një jetë të lumtur. Pas jetës së mundimshme në ato “konaqe” dhe punës së rëndë në industri, fytyrat u zbeheshin dhe trupi u molisej. Meqenëse shpenzimet e mjekimit në Amerikë ishin shumë të larta, sidomos për xhepin e tyre të cekët, shqiptarët imigrantë kërkonin ndihmën mjekësore vetëm kur e shihnin se nuk kishte rrugëdalje tjetër, e kjo shpesh ishte tepër vonë.

“Konaku” ishte vend ideal për përhapjen e ideve dhe koncepteve kombëtare, gjë për të cilën imigrantët shqiptarë të viteve të para nuk kishin njohuri të qarta. Konaku u bë kështu edhe shkollë. Nëse ndonjë anëtar dinte të lexonte apo të shkruante, ai i mësonte të tjerët. Por kishte shumë “konaqe” ku asnjë anëtar nuk dinte shkrim e lexim. Gazetat shqipe priteshin me padurim në “konak”. Gazeta e parë shqipe e Amerikës, *Kombi*, lexohej gjatë gjithë fundjavës. Pas leximit, që ndonjëherë bëhej në grup, fillonte biseda; komentoheshin ngjarjet që përshkruheshin aty. Diskutimet ishin shumë të gjalla dhe të ngazëllyeshme. Në “konaqe” ndonjëherë arrinin libra nga klubet e shoqatave e ndryshme shqiptare, si nga Rumania, Bullgaria

ose Egjipti. Pasi lexoheshin në një “konak” librat kalonin për t’u lexuar në “konakun” tjetër. Në këtë mënyrë, “konaqet” u bënë çerdhet e para të arsimit në Amerikë, ndërsa disa shkollarë i vunë detyrë vetes për të arsimuar bashkatdhetarët. Ata u mësonin shqiptarëve si gjuhën angleze ashtu edhe gjuhën e shkruar shqipe. Në *Kombin* e vitit 1908 mund të gjen-deshin njoftime si ky: “Kuptuam se Kristo Dako hapi një shkollë në Natick me qëllim t’i mësojë shqiptarët anglisht... Ai po ashtu do t’u mësojë shqip-pen atyre që nuk dinë. Këto orë mësimi mbahen pa pagesë.” Me mësimin e lexim-shkrimin imigrantëve shqiptarë u hapeshin dyert për punë më të mira. Njerëzit e arsimuar bënë çmos t’i nxitnin atdhetarët të nxinin lexim-shkrim. Në gazetën shqipe shpesh haseshin thënie si këto: “Puna është më e fuqishme se shpata”, “arsimi sjell sukses” etj.

Të rinjtë më vonë vijonin shkollat e natës. Mirëpo, imigrantët e moshuar e kundërshtonin rreptë këtë veprim, duke pohuar se Amerika për ata ishte vetëm vend i përkohshëm. Pajisjen me njohuri vetëm elementare të anglishtes këta shqiptarë e konsideronin si mjet për të gjetur punë më të mirë dhe kështu për të fituar më shumë të holla para se të ktheheshin në vendlindje. Megjithatë, kishin frikën e arsyeshme se po të mësonin të rinjtë më shumë kishte rrezik të braktisnin fenë dhe kombin, mund të amerikanizoheshin dhe të mbeteshin atje për gjithmonë, gjë që ishte e papranueshme për ta. Si do të ndjeheshin prindërit e tyre që kishin dërguar të bijtë për t’u ndihmuar në kohën e pleqërisë! Pa marrë parasysh përpjekjet për ta penguar këtë proces të akulturimit, frika e pleqve u tregua me vend, sepse ashtu edhe ndodhi.

3. Shoqëritë shqiptare

Shqiptarët që shkuan në Amerikë gjatë fundit të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX ishin shumë homogjenë, si nga pikëpamja shoqërore ashtu dhe ekonomike. Të gjithë ishin nga Toskëria, sidomos nga regjionet e Korçës, të Gjirokastrës dhe të Beratit. Ishin gati të gjithë fshatarë, bujq ose punëtorë të thjeshtë. Kishin të njëjtin status ekonomik dhe bazë të njëjtë shoqërore e kulturore, si dhe interesa dhe aspirata të ngjashme. E gjithë ç’donin ata ishte të gjenin punë, të fitonin sa më shumë dhe të ktheheshin sa më shpejt në vendlindje, pranë familjeve të tyre. Shumë pak kishte të shkolluar, ose me ndonjë profesion. Ata nuk kishin as koncept të qartë sipas standardeve të atjeshme për identitetin e tyre kombëtar. Kjo e fundit del edhe nga fakti se shumica dërrmuese e tyre ishin analfabetë.

Mirëpo, në vendin e ri e të zhvilluar, duke jetuar midis shumë pakicave etnike e duke i parë si vepronin ata, e sidomos të nxitur nga disa

shkollarë të pakët që ndodheshin atje, si Petër Luarasi, Sotir Peci, Fan Noli, e më vonë edhe Faik Konica, ata filluan të zgjoheshin nga gjumi i shekujve. Tani të etshëm siç ishin, filluan të bënin çmos, madje edhe më shumë se shumë grupe të tjera etnike të Amerikës, për krijimin e një shteti të tyre. Si rrjedhë e një disponimi dhe entuziazmi të tillë, shqiptarët filluan të formonin shoqëritë e tyre kulturore e arsimore nëpër vendbanime të ndryshme të Amerikës. Ato shoqëri kishin për qëllim t'i tubonin shqiptarët në rrethin e tyre dhe t'u ndihmonin nga shumë anë. Shoqëritë përpiqeshin t'i vazhdonin traditat dhe zakonet shqiptare dhe ta ruanin gjuhën e tyre. Për këto qëllime organizoheshin programe të ndryshme arsimore dhe argëtuese, duke shfaqur folklor shqiptar, valle popullore, këngë shqipe si dhe ndonjë dramë. Shoqëritë e tilla, duke i bashkuar shqiptarët rreth vetes, përpiqeshin të krijonin atje një atmosferë të ngjashme me atë të atdheut, që sa më pak ta ndjenin nostalgjinë. Në atë shoqëri po ashtu ngjallehin edhe ndjenjat kombëtare dhe patriotike, duke u përpjekur të bënin diçka për atdheun e tyre.

Qysh në vitin 1905 u formua, si duket, e para shoqëri në Xhejmstaun, e quajtur *Malli i Mëmëdheut*, nën udhëheqjen e Petro Luarasit. Një vit më vonë u formua shoqëria *Koha e Lirisë* në Nju Jork. Në vitin 1907, pikërisht më 6 janar, në Boston u formua shoqëria *Besa Besën*, e cila më vonë luajti rol të rëndësishëm ndër shqiptarët e Bostonit dhe të mbarë Amerikës, duke e nisur botimin e gazetës *Dielli*. Kryetar i parë i kësaj shoqërie u zgjodh Fan Noli. Po atë vit në Seint Luis u formua shoqëria *Lidhja*. Nja dy vjet më vonë, më 1909, në Keimbrixh të Masaçusetit u themelua klubi i dardharëve të rinj me emrin *Përparimi*. Edhe korçarët po atë vit formuan shoqërinë *Arsimi* në Boston. Më vonë vijuan të themeloheshin shoqëri të shumta nëpër vendbanime të ndryshme, deri në themelimin e Federatës panshqiptare *Vatra*, e cila u paraqit si një organizatë unike me degët e saj në qendra të ndryshme ku jetonin shqiptarët.

Shoqëritë shqiptare vijuan të funksiononin edhe pas themelimit të *Vatrës*, ndërsa herë pas here formoheshin edhe të reja. Çdo vendbanim ku jetonin shqiptarët kishte shoqërinë e vet. Zakonisht njerëzit e ardhur nga një regjion i atdheut formonin shoqërinë e vet, për shembull, dardharët, trebickalinjtë, voskopojasit, përmetasit, korçarët, treskalinjtë etj. Gjithashtu, edhe studentët kishin shoqërinë e tyre *Drita*; gratë po ashtu formonin shoqëritë e tyre shqiptare. Organizimi nëpër degë të *Vatrës* ishte me karakter më të përgjithshëm, gjithëshqiptar, dhe kishte më tepër kolorit politik. Ndërsa shoqëritë kulturore e arsimore shqiptare kishin karakter më intim. Aty tuboheshin njerëzit prej një vendi të atdheut, me doke e zakone të

ngjashme. Shoqëritë ndihmonin pjesëtarët e tyre në raste dasmash dhe vdekjesh, për ceremonitë e tyre familjare e fetare.

Në Amerikë, pos shoqërive u organizuan dhe themeluan edhe institucione fetare, si kisha, xhamia dhe teqe. Ndër to rëndësi të madhe për gjithë shqiptarët pati themelimi i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Rëndësia e saj nuk ishte aq fetare sa patriotike dhe kombëtare. Në të vërtetë, institucionet fetare të grupeve etnike në Amerikë gjithmonë kanë pasur rëndësi më të madhe kombëtare sesa fetare; janë marrë më shumë me çështje të kombit ose të grupit etnik se të fesë, dhe të tilla mbeten edhe sot.

Pikërisht në ato institucione fetare zhvillohej dhe akoma zhvillohet e tërë veprimtaria arsimore dhe edukative në gjuhën amtare. Shqiptarët e Amerikës, aktualisht, nuk kanë vend tjetër të tyre, pos kishave, xhamive dhe teqeve. Në to ekzistojnë lokale që janë të caktuara për të mësuar fëmijët nga gjuha dhe kultura e të parëve të tyre. Këto “shkolla”, siç i quajnë shqiptarët e Amerikës (ndonëse në gjendjen në të cilën janë ato zor se mund të quhen shkolla) punojnë vetëm të dielave nga dy-tri orë. Puna në to është fakultative. Arsimitarët punojnë pa ndonjë plan a program të caktuar nga ndonjë organ profesional a kompetent. Dikur fëmijët në kësi shkollash mësonin anglisht, kurse sot mundohen të mësojnë shqip,⁹ ndonjë këngë a vjershë në gjuhën amtare. Mësimi i gjuhës shqipe u shkon shumë vështirë. Ushtrojnë pak lexim e përkthim (flitet anglisht) dhe mund të thonë disa fjalë të shkëputura në gjuhën shqipe. Por ajo shqipe nuk është fare komunikuese. Ky mësim bëhet më shumë për hir të dëshirës së prindërve sesa të vetë fëmijëve. Në “shkolla” të tilla prindërit i sjellin fëmijët shpesh edhe nga periferitë e largëta të qyteteve. Aty fëmijët takohen me shokë e shoqe dhe bisedojnë (kuptohet - në gjuhën angleze). Në të vërtetë, këto shkolla në kohët e mëhershme punonin me një përkushtim shumë më të madh dhe me më shumë orë në javë. Por sot ato aktualisht janë një formë për të kënaqur kërshërinë e prindërve. Ato shkolla janë shprehje e një kundërthënieje të veprimit të shqiptarëve të Amerikës, shprehje e realitetit amerikan. Prindërit u flasin fëmijëve shtatë ditë e shtatë net në javë vetëm anglisht, ndërsa duan që me ato “shkolla të së dielës”, me dy-tri orë në javë, t’ua mësojnë fëmijëve gjuhën shqipe e cila nuk u shërben asgjë në praktikë!

Sa i përket themelimit të kishës së parë ortodokse shqiptare në Amerikë, vlen të thuhet se vendimi përfundimtar për të u bë në rrethana mjaft të çuditshme, ndonëse për të kishin ekzistuar nevojat dhe kërkesat e shqiptarëve edhe më herët. Përkatesisht, më 25 gusht të vitit 1907 vdiq një

⁹ Ky hulumtim është bërë në vitet ‘70, prandaj mund të ketë ndryshime ndërkohë.

shqiptar ortodoks në Hudson të shtetit Masaçuset. Kisha greke, e cila i bënte ceremonitë fetare të varrimit edhe për shqiptarët ortodoksë gjer atëherë, refuzoi t'i bënte shërbimet e varrimit të tij, duke marrë si pretekst se ai kishte qenë nacionalist dhe kundër Greqisë. Të vdekurin shqiptarët u detyruan ta varrosnin pa prift, ndërsa të zemëruar nga ky rast, u tubuan përfaqësues nga Natiku, Marlboroja dhe Bostoni dhe vendosën që të emëronin një prift shqiptar. E propozuan Fan Nolin dhe Petro Luarasin. Me vota fitoi Fan Noli. Kryepeshkopi rus në Nju Jork më 1908 e emëroi Fan Nolin prift. Në mars të atij viti Noli filloi të mbante meshën në gjuhën shqipe, ndërsa fetarët këtë e konsideruan si çështje shumë të madhe. Më vonë u themelua edhe Kisha Ortodokse Autoqefale Shqiptare, në Boston, ndërsa Noli u emërua kryepeshkop i parë i saj. Kjo kishë më vonë do të luajë rol të madh në jetën e shqiptarëve të Amerikës, dhe jo vetëm të ortodoksëve. Ajo bëri përpjekje të vazhdueshme që sa më gjatë t'i ruante traditat dhe zakonet shqiptare si dhe gjuhën shqipe në Amerikë. Në vitin 1915, në Bedford u themelua edhe Shoqëria Fetare Myslimane Kombëtare Shqiptare e Amerikës. Mirëpo, pos rolit fetar duket se kjo nuk pati ndonjë rëndësi tjetër të madhe. Më vonë u themeluan edhe shumë kisha dhe xhamia të cilat patën rolin e tyre për komunitetin shqiptar në Amerikë. Duhet shquar posaçërisht Teqenë bektashiane në Detroit e cila ka lozur një rol të madh për gjithë komunitetin shqiptar të atjeshëm dhe më gjerësisht.

4. Shtypi shqip në Amerikë

Shqiptarët që emigruan në Amerikë më vonë filluan të mësonin lexim-shkrimin e anglishtes më shpejt se përpara. Leximi dhe shkrimi për imigrantët e Amerikës ishte gjë e pashmangshme, e domosdoshme, që të merreshin me punë si në tregti ose veprimtari të tjera. Deri nga fundi i dekadës së dytë të këtij shekulli, mbi 15,000 shqiptarë të Amerikës mësuuan lexim-shkrim. Shumica e tyre nuk vijuan asnjë shkollë, mësonin nga njëri-tjetri si dhe duke lexuar gazetatat në gjuhën shqipe dhe në anglishte.

Libri, pa dyshim, është ai që preokupoi më shumë pena shqiptare në Amerikë. Ndoshta menjëherë pas gazetarisë ky aktivitet zë vendin e dytë. Librin e parë, doracak për mësimin e anglishtes e hasim qysh në vitet e para (1906) të shekullit. Autori i tij, mbase nga modestia, nuk e ka shënuar emrin e plotë, po vetëm inicialet S. P. (që duhet të jetë Sotir Peci), e botoi në shtypshkronjën e *Kombit* dhe i dha titullin Methodë për të mësuar engleshçe. Në fillim të kësaj vepre autori jep disa shpjegime të shkoqitura rreth shqiptimit të disa kombinimeve të shkronjave angleze, sepse, siç thotë ai, “engleshça është shumë e rëndë dhe nuk rrëfehët dot me të shkrojtur, dhe në të shumtën e herëve nuk ka rregull”. Pas faqes së dhjetë jepet fjalori

në tri shtylla: fjalët shqipe, fjalët angleze dhe shqiptimi i tyre. Fjalori ndahet sipas lëmenjve të ndryshëm, të cilët autori i sheh të nevojshëm për të mësuar shqiptarët e Amerikës. Nga fundi i librit jepen shpjegime gramatikore dhe fjali e sintagma që hasen më shpesh. Autori nuk ka gjetur shkronja për të gjithë tingujt e gjuhës shqipe, 10 prandaj përdor kombinime të ndryshme për ekuivalentë të disa tingujve të shqipes.

Në dekadën e dytë të shekullit të kaluar paraqitet me gjasë numri më i madh i librave të ndryshme shkruar nga penat shqiptare në Amerikë. Janë doracakët e Kostandin Çekrezit dhe të Kristo Dakos, mandej një numër përkthimesh të Fan Nolit, si të veprave letrare ashtu edhe të atyre liturgjike. Periudha deri në vitin 1920 ishte më e vrullshme për shqiptarët e Amerikës, prandaj ajo shprehet si në lëmin politik ashtu edhe në lëmin botues dhe kulturor. Librat e shtypura pas kësaj periudhe janë më të rralla dhe me qëllime të ndryshme e të veçanta. Pas Luftës II Botërore janë botuar disa libra me karakter politik ose fetar, të cilat në të shumtën paraqesin pikëvështrime politike, të përcaktuara varësisht nga autori, por ka fare pak libra me vlerë letrare. Në këtë periudhë mund të dallohen botimet e dy albumeve të Fan Nolit (I dhe II) dhe vepra e papërfunduar e Faik Konicës në anglishte *Albania a Rock Garden of Eastern Europe* (Shqipëria kopsht shkëmbor i Evropës Lindore), të cilat u botuan pas vdekjes së autorëve nga redaktori i *Diellit*, Qerim Panariti.

Autorët shqiptarë në Amerikë u morën edhe me leksikografi. Ata shkruan disa fjalorë anglisht-shqip dhe shqip-anglisht. Fjalorin e parë shqip-anglisht e botoi Denis Kamburi, i cili një kohë ishte edhe redaktor i *Diellit*. Mendohet të jetë botuar nga gjysma e dekadës së dytë të këtij shekulli. Konstandin Çekrezi botoi një fjalor anglisht-shqip në vitin 1923. Të dy këta fjalorë nuk ishin të vëllimshëm. Nelo Drizari botoi në vitin 1934 një fjalor anglisht-shqip dhe shqip-anglisht. Si fjalori i Çekrezit ashtu edhe ai i Drizarit kanë nga një parathënie nga Faik Konica. Në vitin 1969, Gasper Këçi dhe Hysni Aliko botuan një fjalor anglisht-shqip dhe më vonë një tjetër shqip-anglisht me vëllim bukur të madh (rreth 20.000 fjalësh).

Në kuadër të këtyre veprave vlen të përmendet edhe teksti i Fehime Pipës Shqipe fillestare, që është një doracak për të mësuar shqipen, kështu të rinjve shqiptarë në Amerikë, që nuk e njohin gjuhën shqipe.

Shqiptarët e Amerikës kanë shkruar edhe vepra historike. Ndër ta dallohen: Kostandin Çekrezi me veprën e shkruar në gjuhën shqipe *Histori e*

¹⁰ Nuk duhet harruar se kjo kohë ishte para Kongresit të Alfabetit të Gjuhës Shqipe në Manastir (1908).

Evropës - e vjetër, e mesme dhe e ri (1921). Ai shkroi edhe anglisht veprën Shqipëria në të kaluarën dhe tani (1919). Kristo Dako shkroi në gjuhën angleze veprën Shqipëria çelës kryesor në Lindjen e Afërme, të cilën e botoi në vitin 1919. Faik Konica u kishte premtuar botuesve amerikanë për të shkruar një histori të përgjithshme të popullit shqiptar në anglishte, por meqenëse ishte i zënë me çështje të tjera, në radhë të parë politike, nuk gjeti kohë të mjaftueshme për të. E kishte filluar dhe punonte në të herë pas here pasi e kishte humbur postin e ministrit të Shqipërisë në Uashington, por sëmundja dhe në fund vdekja (1942) e ndërprejnë nga ajo punë. Punimin e pakryer e botoi *Vatra*, të redaktuar nga Qerim Panariti, siç u tha më sipër. Nelo Drizari, në vitin 1967, botoi një histori me vëllim pak më të madh se ato të mëparshmet, me titull Shqiptarët në atdheun e vjetër dhe të ri, në të cilën një pjesë e madhe u kushtohet shqiptarëve të Amerikës. Vepra u botua në gjuhën angleze. Një grup autorësh të paidentifikuar të Masaçusetit botuan në vitin 1939 një vepër kushtuar kryesisht shqiptarëve të Amerikës dhe vendlindjes së tyre. Kjo vepër titullohet *Albanian Struggles in the Old and New Contry* (Përpjekjet shqiptare në vendin e vjetër dhe të ri). Vlen të zihet ngoje se në Amerikë shqiptarët shpesh botonin libra përkujtimesh me rastin e ndonjë ngjarjeje kombëtare, si Pesëqindvjetori i Skënderbeut, Pesëdhjetëvjetori i botimit të gazetës *Dielli*, ndonjë përvjetor i *Vatrës* etj. Kanë rëndësi edhe dy kalendarët, njëri i *Vatrës* i botuar në vitin 1918, e tjetri i *Botës*, i botuar më 1939, të cilët shënojnë ngjarjet më me rëndësi të shqiptarëve të Amerikës.

Duhet të ceket se librat shqip në Amerikë gjithmonë kushtonin mjaft shtrenjtë në krahasim me librat e tjerë amerikanë. Kjo ishte për shkak se botoheshin me tirazh të kufizuar dhe të shumtën e herëve botoheshin privatisht. Edhe gazetat shqipe kushtonin shtrenjtë pikërisht për arsyet e cekura për librat. Ky fakt ndikonte që shumëkush të mos i blinte, sidomos brezat e rinj, të cilët nuk tregonin ndonjë interesim të veçantë për çështjet e gjuhës dhe të traditës shqiptare. Në të vërtetë, librat dhe gazetat shqipe në Amerikë në dekadat e fundit i lexonin vetëm pleqtë që ishin shpërngulur në Amerikë dhe të cilëve gjithmonë u kishte mbetur zemra dhe malli në atdheun ku u lindën.

5. Gazetat dhe revistat

Gjatë dekadës së dytë të shekullit XX në Amerikë u shtuan shumë gazetat dhe revistat në gjuhën shqipe. Por kurrë më vonë nuk e arritën atë vrull. Ndoshta ai zhvillim i hovshëm i shtypit të shqiptarëve të Amerikës ishte kompensim i asaj që u kishte munguar shekuj me radhë. Por kjo është mbase pasojë e gjendjes politike jashtëzakonisht

të vështirë të Shqipërisë gjatë asaj dekade. Kështu, vetëm midis viteve 1906 dhe 1918 u botuan nja 14 gazeta dhe revista të ndryshme, herë për një periudhë më të gjatë e herë më të shkurtër. Kjo periudhë sigurisht ishte ajo më dinamikja nga të gjitha të tjerat të shqiptarëve të Amerikës. Këtu po e japim një pasqyrë të gazetave dhe të revistave sipas Çekrezit,¹¹ të cilat u botuan midis viteve 1906 e 1918.

Viti	Titulli	Lloji	Qyteti	Gjuha
1906	Kombi	Javore	Boston	shqip
1909	Dielli	Javore	Boston	shqip
1910	Trumbeta e Krujës	Javore	Seint-Luis	shqip
1912	Zëri i Popullit	Javore	Nju-Jork	shqip
1915	Koha	Javore	Xhejmstaun	shqip
1915	Albanian Era	Mujore	Denver, Kolorado, Çikago	anglisht e shqip
1916	Mbrojtja Shqiptare	Javore	Seint-Luis	shqip
1916	Illyria	Mujore	Boston	anglisht e shqip
1916	Përlindja	Javore	Framington	shqip
1917	Përparimi	Mujore	Nju-Jork	shqip
1917	Ylli i Mëngjesit	Mujore	Boston	anglisht e shqip
1918	Albanian	Mujore	Uoterbëri	shqip
1918	Albania	Javore	Nju-Jork, Vuster	shqip
1918	The Adriatic Review	Mujore	Boston	anglisht e shqip

Për shumë nga këto gazeta e revista nuk dihet kur e ndërprejnë botimin, gjë që nuk mund të shihet as nga pasqyra e dhënë më sipër. Por dihet se përveç *Kombit*, jeta e të cilit ishte e shkurtër, dhe *Diellit* e *Lirisë*, këto dy të fundit me jetën më të gjatë nga të gjitha gazetat e gjuhës shqipe në Amerikë, të tjerat nuk gëzuan ndonjë famë të madhe dhe shpesh ishin organe të grupacioneve të ndryshme të vogla. Pushimi i botimit të tyre nuk dihet, sepse ato financoheshin nga vetë shqiptarët, ndërsa, për arsye të ndryshme, kur humbte interesimi për to, abonuesit largoheshin duke mos paguar obligimet. Kështu ato fillonin të rrallonin botimin dhe, më në fund, pushonin së botuari. Ndonjëherë dilte ndonjë sponsor dhe ndihmonte për të botuar edhe ndonjë numër të gazetës a revistës. Ndihma të tilla “altruiste” jepnin ata që kishin ndonjë interes personal, në të shumtën e rasteve interes politik. Por nuk duhet mohuar se kishte edhe shqiptarë të cilët jepnin shuma të mëdha të hollash për të vazhduar botimin e ndonjë gazete të shoqërisë së tyre pa pasur ndonjë interes të ngushtë personal.

¹¹ Kristë Çekrezi: *Albania in the Past and Today*, Vatra, Boston 1919, f. 11.

Është karakteristikë shumë e përgjithshme e gazetave dhe revistave të shqiptarëve të Amerikës, e kjo vlen edhe për të gjitha gazetat dhe revistat e grupeve etnike të tjera në atë vend, se gjithmonë ankoheshin për vështirësi financiare, u kërcënohej rreziku të pushoheshin, ose kështu së paku fiton njeriu përshtypjen kur i lexon ato. Ndonjëherë kjo mund të jetë edhe lloj reklame për të grumbulluar të holla në llogari të botuesit. Slogane e fraza të posaçme përdoren për t'i nxitur lexuesit të ndihmojnë financiarisht, si f.v., “kur jeni në Amerikë veproni si amerikanë, paguani atë që e shfrytëzoni”, ose “tregohuni se jeni shqiptarë të dimrit e të beharit, ndihmoni këtë gazetë që është e juaja dhe për juve” etj.

Përveç asaj që shënon Çekrezi në pasqyrën e dhënë më sipër, sipas disa shënimeve del se në Natic të Masaçusetit botohej gazeta *Vullnetari*, e cila dilte dy herë në muaj. Po ashtu në Boston, më 1917, botohej gazeta *Luftëtari i Drejtësisë*, por pas disa numrave pushoi së botuari, sigurisht për shkaqe financiare. Në Vustër të Masaçusetit botohej gazeta *Sezani* në gjuhët shqipe e angleze dhe trajtonte çështje politike dhe shoqërore. Në Seint-Luis, më 1920, botohej një gazetë me emrin *E vërteta*. Kuvendi i *Vatrës* vendosi të botonte gazetën javore në Korçë, më 1922, me titull *Shqiptari i Amerikës*. Numri i parë doli në tetor të atij viti. Gazeta kishte tetë faqe. Më vonë, përveç *Diellit*, herë pas here botoheshin gazeta të ndryshme në gjuhën shqipe. Prej vitit 1930 deri më 1932, në Boston botohej gazeta *Republika*, një herë në muaj, të cilën e filloi Fan Noli si kundërshtar të *Diellit*, sepse ky i fundit ishte në shërbim prozogist. Më 1936 në Boston filloi të botohej gazeta *Bota*, e drejtuar nga Xhorxh Prifti, pasi botimi i gazetës *Dielli* kaloi në Detroit. Kjo gazetë i ngjante shumë *Diellit*, si nga forma ashtu edhe nga përmbajtja. Botohej dy herë në muaj. Ndonëse provonte të tërhiqte lexuesit duke botuar fotografi e artikuj nga Shqipëria dhe të shqiptarëve amerikanë, ajo nuk gëzoi ndonjë sukses të madh. Kishte vetëm 500 abonues. Në korrik të vitit 1938 filloi të botohej edhe një gazetë tjetër në Boston me emrin *Demokratia*. I përkushtohej një programi të paqes, lirisë, demokracisë, punës dhe standardit të lartë të jetës. E drejtonte Arthur Tashko. Nga tematika ishte mjaft e ngjashme me *Republikën* e Nolit. Mirëpo është interesante të zihet ngoje se ajo, megjithatë, e kundërshtonte shumë politikën e Nolit. Kjo gazetë nuk gëzoi interesim të lexuesve shqiptarë dhe pushoi së botuari pas disa muajsh. Një gazetë që distancohej qartë nga çdo ambicie politike ishte *Lajmtari Shqiptar*, e cila botohej në Vustër, dy herë në muaj. Kishte program të pastër shqiptar. Por as jeta e saj nuk qe e gjatë. U botua vetëm midis viteve 1934 e 1937. Thuhet se kishte tirazh prej 1.600 ekzemplarësh. Në Vustër, më 1940, haset një gazetë me emrin *Drita*, që

botohej një herë në muaj, në 16 faqe. Botues dhe redaktor ishte Harallamp V. Dode. Si çdo gazetë tjetër, edhe kjo shkruante se ishte organ i shqiptarëve të Amerikës. Në Boston, midis viteve 1940 e 1941, botohej gazeta *The Albanian Times* (Kohët shqiptare). Ishte gazetë dyjavëshe. Shkruante shqip dhe anglisht.

Pas Luftës II Botërore, përveç *Diellit* dhe *Lirisë*, filluan të botoheshin edhe disa fletushka, gazeta e gjysmë-gazeta (herë të shtypura e herë të shaptilografuara) nga parti të ndryshme politike të përkrahura kryesisht nga imigrantët shqiptarë të pasluftës. Edhe ato herë shtypeshin e herë pushonin, varësisht nga gjendja financiare e atyre që i botonin dhe nga klima politike në Amerikë dhe në botë. Shënime më të hollësishme për to nuk gjenden lehtë.

Gazeta e parë shqipe në Amerikë, *Kombi*, filloi të botohej më 6 qershor 1906 dhe pushoi së botuari më 10 janar 1909. Botohej në Boston. Ishte mbrojtëse, ndihmëse, këshilltare dhe luftëtare e interesave të shqiptarëve të Amerikës. E botonte Sotir Peci. Siç mund të mësohet nga shkrimet e shtypit shqip në Amerikë, Peci ishte një njeri i ngritur, kishte kryer studimet në Athinë, ishte patriot i madh dhe punonte pa ndonjë interes personal për të mirën e shqiptarëve. Gati të gjitha punët rreth botimit të *Kombit* i bënte vetë. Thuhet se ai shpesh vuante nga uria, por kurrë nuk tundej nga ideali që kishte për kombin. Sipas një raporti të *Kalendarit të Botës* (1939), mësohet se një ditë në shtypshkronjën e Pecit (më 1906) erdhi kryeredaktori i gazetës greke *Thermopile*, që botohej në Nju-Jork, dhe pas një bisede të gjatë i tha Pecit se do t'i jepte 5,000 dollarë me kusht që të mos e botonte më gazetën *Kombi*. Peci ishte tërbuar nga kjo, e rrëmbeu për krahu dhe e nxori jashtë. Peci kishte pak shokë të pasur, por ishin miq të vërtetë dhe i ndihmonin shumë në punët e tij.

Liria është organ i organizatës së shqiptarëve të Amerikës *Shqipëria e Lirë*. Kjo organizatë u themelua më 1941, kur Shqipëria ende ishte nën sundimin italian. Botohej dhe ende vazhdon të botohet në Boston. Gjithnjë është botuar si javore. Përmbajtja e saj ishte politike dhe shoqërore, por me një qëndrim më të butë se gazetat e tjera ndaj Shqipërisë komuniste, së paku kështu ishte në vitet e shtatëdhjeta. Ndonëse gazetat *Liria* dhe *Dielli* nuk e sulmonin njëra-tjetrën botërisht, përkrahësit e njëres thoshin se nuk e pëlqenin atë që shkruante tjetra. Megjithatë një numër shqiptarësh parapaguheshin në të dyjat.

Dielli filloi të botohej vetëm 36 ditë pas pushimit të *Kombit*, pikërisht më 15 shkurt të vitit 1909. Botohej si gazetë e përjavshme. E themeloi, siç u tha më sipër, Shoqata *Besa Besën*. Drejtor i parë i kësaj

gazete, e cila do të jetë me stazhin më të gjatë nga të gjitha gazetat në gjuhën shqipe, ishte Fan Noli. Ai e mbajti këtë post deri më 22 tetor 1909, kur timonin e saj ia lëshoi në dorë Faik Konicës. Në të vërtetë, Shoqata *Besa Besën*, si patron i *Diellit*, e kishte ftuar Konicën qysh në mars të atij viti për ta drejtuar këtë gazetë. Konica, siç dihet, kishte qenë më parë drejtor i revistës në gjuhën shqipe “Albania” në Bruksel.

Më 9 tetor 1909, ditë që nuk u harrua për një kohë të gjatë nga shqiptarët e Amerikës, arriti nga Londra në Boston Faik Konica. Ardhja e tij la gjurmë edhe në gazetate e Bostonit në gjuhën angleze. *Dielli* i 15 tetorit të atij viti shkruante, përveç të tjerash: “vapori ‘Ivernia’ arriti më 9.30 dhe gjysmë ore më vonë doli jashtë atdhetari ynë i shkëlqyer, i veshur me kostumin kombëtar shqiptar. Menjëherë e rrethuan korrespondentët e gazetave të Bostonit, dhe cili i merrte fotografinë, cili e pyeste për çështjen shqiptare. Pasi shpëtoi prej duarve të tyre, u poq me shqiptarët që e prisnin me një karrocë dhe erdhën në hotelin Ylli i Shqipërisë, ku u poq me shqiptarë të tjerë. Po as këtu s’e lanë të qetë reporterët...”

Numri i *Diellit*, më 22 tetor 1909, doli nën drejtimin e Faik Konicës si kryeredaktor. Mirëpo, më 25 shkurt të vitit 1910 ai dha dorëheqje nga detyra e kryeredaktorit. Ai nuk dha arsytim për këtë. Por kur e pa se u paraqitën probleme rreth botimit të *Diellit* më tutje, ai përsëri, pas nja një muaji, e mori në dorë këtë gazetë. Ndërsa prej korrikut deri në tetor të vitit 1910, *Dielli* nuk u botua fare. Pas kësaj atë e mori në dorë Fan Noli, deri në korrik të vitit 1911. Pas tij për kryeredaktor të tij erdhi Efthim Naci, i cili e vazhdoi këtë post vetëm deri në nëntor të atij viti. Prej shtatorit 1911 deri në korrik 1912, *Diellin* e drejtonte Kristo Floqi. Prej kësaj kohe kjo gazetë u bë organ i *Vatrës* dhe si e tillë vazhdoi tutje. Faik Konica edhe një herë u bë redaktor i *Diellit*, më 1912, pas Floqit, kur u emërua edhe sekretar i *Vatrës*, ndërsa drejtor ishte Kristo Kirka. Por *Dielli* shpejt mbeti pa Konicën, kur ai shkoi si delegat i *Vatrës* në Londër, në dhjetor të vitit 1912, për të mbrojtur interesat e Shqipërisë.

Mund të ceket se prej datës 20 qershor 1910 *Dielli* filloi të botohej me dy emra, *Dielli dhe Flamuri*. Siç thuhet në disa shënime, emri i dytë (Flamuri) iu shtua për të mundur të hynte lirisht në Perandorinë Osmane. Këtë emër e mbajti deri më 28 shtator të atij viti.

Prej 11 mars 1913 *Dielli* botohej dy herë në javë, ndërsa prej 18 nëntor 1914 filloi të botohej tri herë në javë. Një vit më vonë ai filloi të botohej si gazetë e përditshme dhe kështu vazhdoi deri në vitin 1919.

Gjatë Luftës I Botërore, Amerika vuri censurë në të gjitha gazetate në gjuhë të huaja, domethënë në ato gjuhë të tjera veç anglishtes. Shkrimet e

Diellit duhej të përktheheshin në anglishte për t'u aprovuar, prandaj kur lënda nuk lejohej nga censura, mbeteshin faqe të zbrazëta, ose shtylla të bardha të gazetës, meqë gazeta tashmë ishte thyer për botim.

Siç u pa më sipër, redaktorët e *Diellit* ndërroheshin shpesh, sidomos në fillim. Kjo bëhej me dëshirë të tyre ose nga kuvendet e *Vatrës*. Pos Konicës, Nolit dhe Floqit, në listën e redaktorëve të *Diellit* u radhitën shumë personalitete të tjera, si Efthim Naci (korrik - shtator 1911; korrik - nëntor 1914), Denis Kamburi (shkurt - korrik 1914), Kostë Çekrezi (nëntor 1914 - dhjetor 1915). Bahri Omari e mbajti atë detyrë nja dy vjet (1916-1918). Më vonë redaktorët e *Diellit* qëndronin më gjatë, kështu f.v., Refat Gurrazezi ishte redaktor nja 12 vjet (1928-1939), ose Qerim Panariti afër njëzet vjet (1943-1961). Fan Noli ishte edhe njëherë redaktor i *Diellit* (dhjetor 1915 - korrik 1916), ndërsa Faik Konica prej vitit 1922 deri më 1926.

Vlen të shënohen edhe disa të dhëna të tjera që kanë të bëjnë me gazetën *Dielli*. Kjo gazetë e pati shtypshkronjën e vet që nga viti 1913, të cilën e bleu *Vatra*, por e humbi në vitin 1936, kur e usurpoi i besuari i saj, Xhorxh Prifti, dhe me atë shtypshkronjë e nisi botimin e revistës *Bota*.

Gjatë vitit 1914 *Dielli* dërgohej në Shqipëri, nga nja 400 copë dhe falas. Është si kuriozitet të thuhet se parapagimi i *Diellit* ishte më i lirë në Shqipëri (2 dollarë) sesa në Amerikë (3 dollarë) gjatë decenies së dytë të shekullit.

Deri në Luftën II Botërore *Dielli* nuk botonte artikuj në anglishte, ose botonte fare pak sish. Vetëm disa reklama botoheshin në anglishte. Mirëpo, pas kësaj kohe ai filloi të botonte shkrime në anglishte, dhe në faqet e tij vinte gjithnjë duke u shtuar prania e anglishtes, kurse në vitet e shtatëdhjeta botohej gjysmë për gjysmë anglisht dhe shqip. Kjo bëhej për shkak se shumë të rinj me prejardhje shqiptare nuk dinin shqip, kurse botuesit donin të depërtonin edhe tek ata për t'i njoftuar për jetën e shqiptarëve të Amerikës.

Tematika e *Diellit* thuaja gjatë tërë jetës së tij mbeti politika, ndonëse shpesh deklaronte se nuk merrej me politikë. Në vend të dytë ishte tematika e historisë shqiptare, ndërsa më pak e kulturës. Nuk ka pasur material të bollshëm për përhapjen dhe ruajtjen e kulturës dhe të traditave shqiptare. Një e metë e kësaj gazete ka qenë mungesa e materialeve për fëmijë dhe të rinj. Kurrë nuk u kushtoi faqe apo kënde këtyre brezave të rinj, në të cilët mbështetej e nesërmja. Këto janë përshtypjet e atij që e lexon këtë gazetë një kohë të gjatë. Arsyet për një gjendje të tillë, pos të tjerash, mund të ishin se ata që shkruanin ishin të moshuar, rënktonin gjithnjë për atdheun, njëherë që ta fitonte lirinë, pastaj të përparonte, më vonë të ndryshonte regjimin komunist. Në

kontakte me të rinjtë ata thoshin se kjo gazetë ishte e pleqve, gjithmonë me të njëjtat tema. Gjatë gjithë kohës ajo botohej në katër faqe me format herë më të vogël e herë më të madh.

Sa i përket anës gjuhësore, *Dielli* ka përdorur gjithnjë gjuhë më të pastër se çdo gazetë tjetër e botuar në Amerikë. Ai përdorte gjuhën sa më standarde dhe pati fatin të kishte redaktorë shpesh penat shqiptare më të spikaturat në Amerikë, si Nolin, Konicën, Floqin, Çekrezin etj. Kuptohet, në periudha të ndryshme edhe gjuha e kësaj gazete të vjetër ndryshonte deri diku, varësisht edhe nga redaktorët e saj.

Në fund vlen të ceket se në dhjetor të vitit 1947 *Dielli* fitoi çmimin e tretë ndër mija gazeta që botoheshin në SHBA në gjuhë të grupeve të ndryshme etnike. Konkursi kishte të bënte me përpjekjet që gazetatat kishin bërë kundër urrejtjes së racave dhe kombeve të ndryshme në botë, ndërsa ishte shpallur nga Këshilli i Përbashkët i Unitetit Amerikan.

Programet e radios në gjuhën shqipe të Amerikës kanë qenë një mënyrë tjetër, me të cilën është mbajtur gjallë çështja shqiptare dhe kultura e tyre në treva të ndryshme me numër të madh imigrantësh shqiptarë, siç është Bostoni. Ata kanë paguar kohën e emetimit në stacione lokale të Bostonit për emisionin e tyre gjysmë ore në javë, në të cilin janë dhënë lajme shoqërore, muzikë shqiptare dhe disa ngjarje politike në gjuhën shqipe. Ky grup imigrantësh kurrë nuk ka pasur mundësi të jepte emisione televizive.

6. Organizata *Vatra*

Historia e *Vatrës* është historia e lëvizjes kombëtare të shqiptarëve të Amerikës, sidomos në dekadat e para të shekullit XX. Faik Konica në një artikull të botuar në *Dielli* të 22 korrikut 1922, shkruante, pos të tjerash: *Në ditët e errëta kur Shqipëria ishte e shkelur nga ushtri të huaja, kur shteti ish përmbysur dhe kur flitej sheshit për copëtimin e vendit, Vatra e përkrahur nga patriotët, e shtyrë nga atdhesia dhe dëshira e anëtarëve të saj, e inkurajuar nga zëri i tërë popullit shqiptar, e mori përsipër të veprojë në vend të shtetit të vdekur. Nuk kërkoi nderet as të drejtat e shtetit, por mori përsipër vetëm detyrat dhe borxhet. Me shpenzime të Vatrës u mbajtën delegatë, u dërguan misione, u dërguan telegrame protestimesh...* Më tutje thuhet se kryeministri i Greqisë në Konferencën e Paqes në Paris tha se pengesën më të madhe rreth çështjes së Epirit Greqia e kishte hasur nga *Vatra*. Gjithashtu thuhet se shpenzimet e *Vatrës*, për këso punësh të shtetit, arritën deri mbi 200.000 dollarë.

Ideja e parë për t'i bashkuar të gjitha shoqatat dhe organizatat e shqiptarëve të Amerikës në një federatë ishte e Kristo Floqit, i cili shprehu

këtë mendim derisa ishte redaktor i *Dielli*, më 1911. Mbledhja e parë kushtuar një bashkimi të tillë u bë më 24 dhjetor 1911 në Boston. Mbledhjen e thirri shoqëria *Besa Besën*. Mbledhje të tjera vazhduan gjatë marsit të vitit 1912. Faik Konica dhe Kristo Floqi u angazhuan të përpilonin kanunoren e Federatës në gjuhën angleze të një avokat në Boston. Në një mbledhje, më 31 mars 1912, u vendos që kjo Federatë të quhej *Vatra*, ndërsa më 9 prill u bisedua për kanunoren e *Vatrës* dhe më 14 prill ajo u aprovua nga një komision i caktuar. Në procesverbalin e mbledhjes së 28 prillit, mbajtur në Kishën Shqiptare të Bostonit, nën kryesinë e Fan Nolit, thuhet se *Vatra* u themelua nga shoqëritë: *Besa Besën*, *Flamuri i Krujës*, *Shoqëria Kombëtare* dhe *Dallëndyshja*. Siç shihet nga kalendari i *Vatrës* (i botuar më 1917), në mbledhjen e 17 marsit disa shoqëri nuk kishin dashur të bashkoheshin me *Vatrën*, duke u arsyetuar se qëllimi i ekzistimit të tyre ishte kulturor e jo politik. Në këtë kohë shoqëri kishte në shumë rajone ku jetonin shqiptarët.

Komisioni themelues më 28 prill 1912 vendosi të formoheshin degë të *Vatrës* nëpër qendra të ndryshme, ku jetonin shqiptarët dhe për këtë qëllim zgjodhi një pleqësi të përkohshme, sekretar i së cilës ishte Fan Noli. Federatën *Vatra* qeveria e Masaçusetit e njohu me Kartën e 13 qershor të vitit 1913.

Në Kanunoren e *Vatrës*, e cila kishte nja 80 nene, përveç të tjerash, thuhej se qëllimi i *Vatrës* ishte të rriste dhe të kultivonte dashurinë e shqiptarëve për kombësinë e tyre dhe të ndikonte në respektimin e ligjeve dhe të institucioneve amerikane; të përhapte mësimin e anglishtes të shqiptarët dhe të stërviste doktrinën morale, të mbronte imigrantët shqiptarë, të mos merrej me politikë etj.

Prej datës 12 maj deri më 30 qershor 1912, nën udhëheqjen e Konicës dhe të Floqit, ishin themeluar nja 15 degë të *Vatrës*. Më 14 korrik 1912, në Boston, u mbajt Kuvendi i kësaj Federate gjithëshqiptare – *Vatrës*. Në vitet e para *Vatra* u zgjerua shumë. Kështu, në kuvendin e vitit 1916 u përfaqësuan 48 degë të saj. Ndërsa në vitin 1918 ajo kishte mbi 80 degë dhe nja 5.000 anëtarë, kurse në vitin 1920 kishte 89 degë dhe ky, si duket, ishte zeniti i saj. Mirëpo, më vonë imigrantët shqiptarë filluan të shpërngulehin prej një vendi në tjetrin, duke kërkuar vend më të mirë për të jetuar dhe punë më të përshtatshme. Prandaj edhe numri i degëve të *Vatrës* filloi të zogëlohej. Arsye tjetër mund të ketë qenë se *Vatrës* disi nuk i mbeti të lozte ndonjë rol politik të dalluar, meqë gjendja në Shqipëri ishte normalizuar deri diku; Shqipëria tani së paku ekzistonte si shtet. Një shënim i vitit 1922 tregon se *Vatra* atëherë kishte vetëm 52 degë.

Në dekadën e parë të ekzistencës së saj, *Vatra* bëri shumë punë rreth çështjes shqiptare si në Amerikë, ashtu edhe jashtë saj, tregojnë shënimet e ndryshme që flasin për të. Në vitin 1911, në Boston, u formua çeta e shqiptarëve e quajtur *Propatria*, për të luftuar për Shqipërinë. Ushtarët e saj kishin uniformë me ngjyrë kuqezi, ndërsa në kësula u shkruante *Liri ose vdekje*. Kjo çetë kishte një flamur të punuar në Boston. Sipas disa gazetave shqipe në Amerikë, del se ai flamur valoi në Vlorë në vitin 1912 në duart e Ismail Qemalit. Tregohet se atë flamur në Shqipëri e kishte sjellë një grua që e kishte mbështjellë rreth trupit nën rroba, për të mos u hetuar nga roja kufitare, kur në Shqipëri ende sundonte Turqia. Edhe nga fundi i dekadës së dytë të këtij shekulli shqiptarët e Masaçusetit kishin formuar trupa vullnetare në Boston. Ato trupa bënin ushtrime tri-katër herë në javë dhe kishin uniformë. Udhëhiqeshin nga Akif Permeti. Kur u shpall pavarësia e Shqipërisë, *Vatra* dërgoi Faik Konicën në Europë me shpenzime të saja për t'i mbrojtur të drejta kombëtare dhe ai mbeti atje deri në fund të Luftës Ballkanike. Në këtë kohë edhe Fan Noli shkoi në Europë, i dërguar nga Kisha Kombëtare Shqiptare e Amerikës, prej nga u kthye vetëm në vitin 1915, kur e mori në dorë *Vatrën*. Në vitin 1916, *Vatra* emëroi një përfaqësues në Nju-Jork për t'u kujdesur për imigrantët shqiptarë që zbritnin në truallin amerikan nga anijet e ndryshme që i sillnin nga Europa. Në vitin 1917, *Vatra* dërgoi një delegat, Mehmet Konicën, në Londër, për të mbrojtur të drejta e shqiptarëve. Në punën e tij atë e shoqëronte mikesha e shqiptarëve, Edith Durhami. Nga dr. Turtulli, i cili gjendej në Europë, *Vatra* kishte marrë një letër, me të cilën ai porosiste të hapej një fushatë e madhe për shpëtimin e Shqipërisë. Fushata u hap në qershor të vitit 1918 dhe u quajt *Dita Tre Qershori*. Kësaj fushate Fan Noli i kushtoi një poezi me titull "Jepni për Nënë", ndërsa refren i saj,

Mbahu nëno, mos kij frikë

Se ke djemtë në Amerikë.

u bë parullë e përditshme e shqiptarëve të Amerikës. Me këtë fushatë ishte paraparë të grumbulloheshin nja 40,000 dollarë për të ndihmuar përpjekjet që bëheshin në favor të Shqipërisë. Thuhet në disa gazeta të asaj kohe, në shkrime të tjera dhe në rrëfime të pleqve që i përjetuan ato ditë, se njerëzit jepnin për atë fushatë edhe fitimin e disa muajve. Disa thonë se u mbledhën 250.000 dollarë, por sipas të gjitha gjasave të mbështetura në shënime të sigurta, ishin mbledhur rreth 200.000 dollarë. Gazeta *Dielli*, e cila në atë kohë botohej e përditshme, njoftonte vazhdimisht se sa po jepnin *burrat e dheut*. Kështu nxiteshin njerëzit të jepnin sa më shumë. Kishte njeri që kishte dhënë deri më 500

dollarë, e kjo shumë ishte tepër e madhe për atë kohë, kur një punëtor i rëndomtë nuk fitonte më shumë se 30-50 dollarë në muaj.

Gjatë gjithë ekzistencës së *Vatrës*, vitet e dekadës së dytë të shek. 20 (1912-1920) ishin ato më të lavdishmet dhe më të frytshmet për të, siç është rasti edhe me aktivitetin e shqiptarëve të Amerikës në përgjithësi. Përveç ndihmës së madhe materiale që kishte dhënë, ishte me rëndësi të madhe edhe kontributi i Fan Nolit, si përfaqësues i *Vatrës*, i cili më 4 korrik 1918 u prit nga kryetari i SHBA-së, Vilsoni, të cilin e njoftoi gjerë e gjatë për çështjen shqiptare dhe për Shqipërinë, duke kërkuar nga ai të mbështeste ekzistimin e shtetit shqiptar, meqenëse në atë kohë shumë gazeta dhe autorë kishin shprehur bindjen se nuk kishte nevojë as arsye të ekzistonte një shtet shqiptar në Ballkan. Shënimet e gazetave shqipe në Amerikë dëshmojnë se ajo bisedë e Nolit kishte pasur ndikim të madh te kryetari amerikan dhe se ai e përkrahu me vendosmëri këtë çështje në konferencat e Europës. Në korrik të vitit 1920, Kuvendi i *Vatrës* zgjodhi Fan Nolin deputet të shqiptarëve të Amerikës në Parlamentin e Shqipërisë. Në këtë kohë Kostë Çekrezin, i cili ishte emëruar komisar i lartë i Shqipërisë në Uashington, e paguante *Vatra*, sepse Shqipëria nuk kishte mundësi financiare për ta mbajtur.

Gjatë krizës ekonomike, që kaploi gjithë botën, edhe *Vatrën* e gjetën ditë të vështira. Anëtarët e saj filluan të pakësoheshin, meqë nuk ishin në gjendje të kryenin obligimet materiale ndaj kësaj organizate. As *Dielli* nuk mund të shtypej rregullisht, dilte gjithnjë më rrallë. Si pasojë e të gjitha këtyre, *Vatra* kishte hyrë në borxhe. Nuk mund të paguante as qiranë e lokaleve që i shfrytëzonte në pronën e Xhorxh Priftit, i cili ishte konsull nderi i Shqipërisë në Boston. Si pasojë e kësaj, një ditë janari të vitit 1936 Prifti e shtrëngoi *Vatrën* të pushonte punën, duke ndërprerë edhe botimin e *Diellit*. Pas disa muajsh disa degë të *Vatrës* nga viset perëndimore të Amerikës, të udhëhequra nga Dega e Detroitit, u morën vesh me Priftin, i paguan atij disa borxhe dhe e tërhoqën *Vatrën* në Detroit. Prifti u dha gati çdo gjë, pos makinave me të cilat ishte shtypur *Dielli*. Në korrik të atij viti shumica e anëtarëve të Kuvendit votoi që kryesia e *Vatrës* të kalonte në Detroit. Kështu u legalizua ky akt. Për këtë akt reagoi ashpër Konica, i cili gjendej në Uashington, dhe urdhëroi bashkëpunëtorët e tij në Boston të themelonin një *Vatër* rivale. Edhe *Dielli* rival shtypej në Boston, nën drejtimin e Nelo Drizarit. Kështu, prej 1936 deri 1939 botoheshin dy gazeta *Dielli* dhe secila e mohonte tjetrën. Kur tri motrat e Ahmet Zogut (1938) vizituan Bostonin, bënë një përpjekje për t'i bashkuar të dy *Vatrat*, por nuk ia dolën dot. Ato u bashkuan vetëm pasi u pushtua Shqipëria (1939).

Gjatë Luftës II Botërore, shqiptarët e Amerikës përmes *Vatrës* formuan fondin për të ndihmuar Shqipërinë, fond nga i cili, sipas shënimeve të ndryshme, deri në vitin 1946 ishin dërguar në Shqipëri mbi 200 tonë mall të ndryshëm, si ushqim, veshmbathje, barëra mjekësore etj.

Gazetat në gjuhën shqipe dhe sidomos *Dielli*, si dhe njerëzit kudo që kishin rastin, kishin theksuar shpesh nevojën për një ndërtesë për *Vatrën*. Ndonëse shpesh ishte biseduar dhe ishte vendosur për këtë çështje në kuvendet e *Vatrës*, kjo dëshirë dhe nevojë kurrë nuk ishte përmbushur. Prandaj *Vatra* thaujse deri në fund mbeti në lokale me qira.

7. Edhe disa peripeci dhe suksese

Në vitin 1920 shumë shqiptarë kishin vendosur të ktheheshin nga Amerika, meqenëse, si dukeshin punët, po përmbushej ëndrra e tyre për një atdhe të lirë. Sipas disa burimeve,¹² midis vitit 1919 dhe 1925 u kthyen nja 20.000 deri 30.000 shqiptarë në atdhe. Mirëpo, thuhet se këta shqiptarë shpejt ranë në një gjendje të pakëndshme. Ndonëse u pritën mirë nga populli në fillim, më vonë u bënë lëndë për tallje. “Kush janë këta pjatallarës nga Amerika që duan të na e përmirësojnë jetën?” - pyesnin disa njerëz, sidomos reaksionarët dhe përfaqësuesit e bejlerëve, meqenëse ata përsëri filluan t’i përforconin pozitat e tyre. Shumë nga shqiptarët e kthyer nga Amerika, pas një gjendjeje të tillë, u kthyen përsëri në mërgim, por kësaj here për ta bërë Amerikën vend të përhershëm të tyre. Ata morën me vete edhe familjet, kështu që pos mallit për atdhe, nuk u mbeti gjë tjetër për t’i lidhur për Shqipërinë. Shumë beqarë u fejuan dhe u martuan me të shpejtë dhe i morën me vete gratë e tyre. Si shkak tjetër për t’u kthyer shumë prej tyre përsëri në Amerikë, ishte ligji amerikan për kufizimin e imigrimit, i cili u aprovua në vitin 1923.

Imigrantët shqiptarë gjetën kushte më të mira në Amerikë pas vitit 1920. Kishin ku të mbështeteshin, sepse kishte tani mjaft bashkatdhetarë atje, prandaj edhe standardi i jetës u përmirësohej më shpejt. Nuk jetonin më nëpër “konaqe”, sepse shumica i kishin familjet me vete ose i krijonin atje. Ata iknin nga kuartet e ndyra dhe vendoseshin nëpër periferitë e qyteteve, si gjithë amerikanët, ku jeta ishte më e mirë, më e qetë. Filluan të futeshin në klasën e mesme të popullsisë. Shumë prej tyre hapnin dyqane, tregti të tyre private dhe nuk punonin më nëpër mullinj e fabrika si më parë. Thuhet¹³ se nga viti 1939 shqiptarët kishin nja 60 dyqane në Vustër, duke përfshirë bakallhane, rrojtore, dyqane rrobaqepësish, bufë, kafene, restorante etj. Në Bostonin e gjerë shqiptarët kishin nja 300 dyqane

¹² *Përpjekjet e shqiptarëve në vendin e vjetër dhe të ri*, f. 65.

¹³ *Po aty*, f. 93.

të tilla. Disa kishin edhe fabrika të vetat. Pos që bënë këto punë, shqiptarët filluan të ndiqnin edhe shkollat e niveleve të ndryshme. Më vonë ata u bënë avokatë, mjekë, profesorë universiteti, aktorë, artistë, muzikantë. Në këtë mënyrë, ata u përfshinë në të gjithë dejtë e jetës amerikane. Sot thuajse nuk dallojnë me asgjë nga qytetarët e tjerë amerikanë, e sidomos nga pjesëtarët e grupeve etnike në atë vend të madh.

8. Këndvështrim gjuhësor

“Amerika na ka pajisur me një nga laboratorët më interesantë të përvojës së bilinguizmit, që nga fillimi i historisë së shënuar” - thotë Haugeni.¹⁴ Në një vend tjetër,¹⁵ ai ka vërejtur se në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka më shumë folës bilingë, sesa në çdo vend tjetër të botës.

Problemet që kanë të bëjnë me ndikimin e një gjuhe në tjetrën kanë luajtur rol të madh në bisedat shkencore të gjuhësisë. Çështja e kontaktit gjuhësor nuk është më temë e re. Janë shkruar shumë libra e punime të tjera për këtë çështje, por mbetet të shkruhen dhe të tjerë, sepse ka aq shumë çështje dhe pikëpamje, të cilat nuk janë shpjeguar sa duhet ose janë shpjeguar në mënyra të ndryshme. Shpresojmë që ky studim të jetë kontribut modest për gjuhësinë, në fushën specifike të kontakteve gjuhësore.

Sipas R. Filipovićit,¹⁶ “...një gjuhë europiane si huazuese mund të bjerë në kontakt me anglishten në dy rrethana dhe në dy lloje kushtesh:

- 1) Ajo gjuhë europiane është zyrtare dhe kombëtare, ndërsa anglishtja është gjuhë e huaj;
- 2) Anglishtja është gjuhë zyrtare dhe kombëtare e vendit. Këtu gjuha tjetër është në pozitë nënshtruese dhe i ekspozohet ndikimit të përditshëm dhe të fuqishëm.”

Bazuar në këto dy parime të Filipovićit, mund të thuhet se në këtë studim kemi të bëjmë me tipin e dytë të interferencës gjuhësore.

Shumë gjuhë të imigrantëve në Amerikë tashmë janë studiuar nga autorë të ndryshëm. Mirëpo, siç konstatonte Haugeni,¹⁷ ka me dhjetëra gjuhë të tilla që kurrë nuk janë studiuar nga pikëvështrimi i ligjërimit biling. “Kjo është një fushë e begatshme për disertacione”, sugjeronte ai. Kjo ishte një nga arsyet dhe faktet që më nxiti t’i përvishesha këtij studimi.

¹⁴ E. Haugen, *Bilingualism in the Americas*, University of Alabama Press, University of Alabama, 1956, p. 9.

¹⁵ E. Haugen, *The Norwegian Language in America, A Study in Bilingual Behavior*, University of Pennsylvania Press, Philadelphia, 1953, p. 1.

¹⁶ R. Filipović, *A Contribution to the Method of Studying Anglicisms in European Languages*, Studia Romanica et Anglica Zagrebiensia, No. 37, Zagreb, 1974, p. 143.

¹⁷ E. Haugen, 1956, f. 123.

As shqiptarët në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sa dimë ne, nuk kishin qenë ndonjëherë objekt studimi më të plotë, as gjuha e tyre nuk kishte qenë lëndë e studimit thjesht gjuhësor ose e studimit sociolinguistik të ndonjë autori të njohur. Arsyet për këtë mund të kenë qenë të ndryshme, në radhë të parë të karakterit shoqëror-politik, sepse Shqipëria, e cila do të mund të kishte ekspertë dhe mundësi për këtë punë, duke qenë shtet amë i shqiptarëve, nuk kishte marrëdhënie të mira politike me SHBA-në, ndërsa Kosova as kishte ekspertë as pavarësi politike për t'u interesuar për shqiptarët dhe gjuhën e tyre në diasporë. Por edhe numri relativisht i vogël i shqiptarëve në Amerikë, ose ndonjë mospërfillje e përgjithshme për këtë grup etnik, mund të kenë qenë arsye për atë mospërfillje. Meqenëse shqipja është gjuhë që dallon nga të gjitha të tjerat në Amerikë, duke mos qenë posaçërisht e afërt me asnjë tjetër në atë vend, mund të jetë një arsye, ndonëse kjo do të mund të ishte një nxitje e gjuhëtarit për t'u futur në brendinë e saj.

Këtë temë e zgjodha për ta hartuar për arsye se kishte kohë që më interesonte posaçërisht kjo fushë e gjuhësisë dhe nga dëshira për t'i dhënë kontribut modest shkencës së kontakteve gjuhësore, sidomos kontakteve midis shqipes dhe anglishtes. Ndonëse shqiptarët në Amerikë paraqesin një pakicë mjaft të vogël, sipas disa shënimeve të tërthorta, del të jenë gjithsej një njëqindmijë sish, studimi i ligjërimit të tyre u tregua me interes mjaft të madh për shkencën gjuhësore.

Gjatë vitit shkollor 1974/75 qëndrova nëntë muaj në SHBA si bursist i Fulbrajtit. Atje vijova programin e studimeve pasuniversitare në Universitetin e Çikagos. Njëkohësisht bëra hulumtime dhe mblodha të dhëna që kishin të bënin me ligjërimitin shqip të imigrantëve shqiptarë të Çikagos dhe me gjuhën e shkruar të shqiptarëve të Amerikës. Më vonë, në vitin 1977, qëndrova privatisht një 6 javë në Boston dhe në rrethinën e tij. Gjatë kësaj kohe hulumtova posaçërisht gjuhën e folur dhe mblodha material të bollshëm në saje të përgatitjes që kisha bërë më parë dhe të ndihmës që më dhanë shumë imigrantë shqiptarë, sidomos z. Antony Athanas, kryepriifti Arthur Liolin dhe znja. Paulina Lukas, sekretare e *Vatrës*. Me këtë hulumtim plotësues u begatua dhe u rumbullakua mjaft mirë materiali i nevojshëm për këtë studim.

Në Boston dhe në rrethinën e tij takova shumë informatorë të ndryshëm të brezit të parë dhe të dytë, me prejardhje kryesisht nga Korça dhe fshatrat e saj. Informatorët ishin nga nivele të ndryshme shkollore, si meshkuj ashtu edhe femra, dhe nga profesione të ndryshme. Prandaj, korpusi i studimit përbëhet si nga gjuha e folur, ashtu edhe nga gjuha e shkruar e shqiptarëve të Amerikës, të variantit të toskërishtes. Ndonëse këto dy forma të gjuhës dallojnë nga shumë pikëpamje, ato kanë shumëçka të për-

bashkët - fjalët që huazohen nga anglishtja në shqipen e Amerikës janë thuaja po ato, ndonëse ka një dallim të dendurisë së përdorimit të atyre huazimeve, duke qenë më të dendura në të folurit, sesa në të shkruarit. Po ashtu shkalla e përshtatjes është më e madhe në gjuhën e shkruar sesa në gjuhën e folur. Ata që shkruajnë, kanë më shumë kohë për të menduar dhe e ndjejnë përgjegjësinë më të madhe për fjalën dhe strukturën e përdorur, sesa vetë folësit e drejtpërdrejtë. Shumë huazime dhe dukuri gjuhësore në procesin e interferencës gjuhësore, si rezultat i kontaktit, janë vërtetuar si në gjuhën e folur ashtu edhe në gjuhën e shkruar. Në rast se ato huazime haseshin vetëm në njërin burim, ai fakt është vënë në dukje në këtë studim.

Anglishtja dhe shqipjadallojnë shumë midis tyre. Anglishtja i përket degës së gjuhëve gjermanike, ndërsa shqipja formon një degë më vete të familjes së përbashkët indoeuropiane. Gjithë ç'kanë të përbashkët është ajo që supozohet se që të dyja rrjedhin nga e njëjta familje gjuhësore e lashtësisë së largët. Si rezultat i kësaj largësie të tyre, strukturat e tyre dallojnë në shumë pikëpamje. Por "fakti se fjalët angleze janë huazuar nga gjuhë aq të ndryshme, siç janë japonishtja dhe kinezishtja",¹⁸ tregon se është fare e mundshme që të huazohen edhe në gjuhën shqipe.

Në këtë studim do të shqyrtohen vetëm rastet dhe kategoritë gramatikore, në të cilat është vërejtur interferenca e anglishtes mbi shqipen. Ajo interferencë tregohet me fakte të pranishme në materialin e mbledhur. Analiza do të jetë aq e thellë sa të sigurojë qëllimin e shtruar për studim. Pa marrë parasysh sa e rëndësishme mund të jetë një çështje gjuhësore, qoftë e njëres gjuhë apo e tjetres, nuk do ta shtrojmë këtu, nëse materiali nuk shënon ndonjë interferencë të gjuhës tjetër në atë pikë. Kjo për shkak se karakteri dhe qëllimi i këtij studimi është të vërë në dukje dhe të shpjegojë kontaktin midis anglishtes e shqipes së emigrantëve të Amerikës, të tregojë ndikimin e gjuhës së parë në të dytën, e jo të bëjë krahasimin e plotë midis dy sistemeve gjuhësore, siç do të bëhej në ndonjë studim thjesht kontrastiv.

Ky studim ishte shkruar në gjuhën angleze dhe u qe kushtuar folësve të anglishtes. Tani që po shkruhet në gjuhën shqipe, shumë hollësi që kanë të bëjnë me çështjet e gjuhës shqipe, nuk do të zihen ngoje, duke i konsideruar ato si çështje që dihen nga ana e studiuesve të shqipes. Mirëpo, do të flitet më shumë për dukuritë e gjuhës angleze, të cilat për shqipfolësit nuk mund të jenë të njohura sa duhet.

Burimi kryesor i materialit të gjuhës së folur janë 36 informatorë të zgjedhur nga një numër më i madh i të ekzaminuarve me prejardhje shqip-

¹⁸ E. Haugen, 1953, f. 381.

tare, në Boston, në Natick, në Vuster e në Southbrixh të Masaçusetit. Nga ata 17 janë të brezit të parë, domethënë të lindur në Shqipëri, por që kishin kaluar mbi 35 vjet në Amerikë, ndërsa të tjerët (19) ishin shqiptarë të lindur në Amerikë të brezit të dytë. Njëmbëdhjetë informatorë qenë pensionistë, pesë kishin shkollim universitar dhe ishin në punë, nëntë arsimtarë dhe me profesion të ngjashëm, katër biznesmenë, pesë shtëpiake dhe dy studentë. Njëmbëdhjetë informatorë qenë gra. Gjatësia e ligjërimit të tyre të incizuar arrin nja 500 minuta. Ky material i incizuar në magnetofon shërben kryesisht si bazë për analizë të gjuhës së folur me theks të veçantë në fonologji.

Pos kësaj, nja 700 numra të gazetave të ndryshme në gjuhën shqipe të Amerikës janë lexuar, fund e krye, për këtë qëllim. Kjo arrin në nja 3000 faqe gazetash, ose në rreth dhjetë milionë fjalë. Nja 600 numra të gazetës *Dielli* janë lexuar për këtë qëllim. Njëqind numrat e tjerë janë nga revista e gazeta të tjera, siç janë *Liria*, *Republika* etj. Po ashtu janë lexuar edhe materiale të tjera, kurdo që më kanë rënë në dorë. Të gjitha këto gazeta ishin botuar në Boston. Për t'i bërë një qasje diakronike zhvillimit të gjuhës shqipe në Amerikë, është lexuar *Dielli* nga tri periudha të ndryshme - nga ajo e viteve 1917/18 (kur botohej si gazetë e përditshme), pastaj nga periudha 1935/41 dhe, në fund, në periudhën 1967/75. Për fat të keq, ndonjë numër i kësaj gazete të periudhave të cekura këtu nuk është gjetur

Bisedat e incizuara në magnetofon janë analizuar hollësisht nga pikëpamja gramatikore dhe fonologjike e fonetike. Po ashtu është grumbulluar material i shumtë i gjuhës së shkruar. Është analizuar edhe të folurit nga disa emisione të radios në gjuhën shqipe të Amerikës. Shumë material dhe të dhëna janë grumbulluar edhe nga të dëgjuarit e drejtpërdrejtë të ligjërimit të folësve shqiptarë të Amerikës, kurdo dhe kudo që ka qenë e mundshme. Të gjitha çështjet që janë konsideruar të rëndësishme për studimin e interferencës gjuhësore nga anglishtja në gjuhën shqipe, janë shënuar në skedarë, duke formuar kështu një katalog të veçantë. Shembujt dhe çështjet gjuhësore që dukeshin të dyshimta për sa i përket interferencës, sidomos për ekuivalentët e anglishtes, janë kontrolluar dhe vërtetuar me folës burimorë të anglishtes, respektivisht, me studentë amerikanë. Shembujt që janë dukur të dyshimtë për saktësinë e shqipes, po ashtu janë vërtetuar me shqipfolës, që nuk e dinin anglishten, ose me ata që kanë kompetencë në gjuhën shqipe. Në studim nuk ka pasur mundësi të përfshihet denduria e paraqitjes së huazimeve angleze në shqipen e Amerikës, as të matet ndikimin e gjithmbarshëm në atë gjuhë nga interferenca e anglishtes. Ky studim, pra, ka më tepër karakter cilësor se karakter sasior.

Është thuaja e pamundur të bëhet listë e plotë e huazimeve angleze, që i përdorin shqiptarët e Amerikës. Së pari, për neve kjo ishte jopraktike,

sepse besojmë që nuk ka kufizim të numrit të huazimeve të tilla, sepse çdo individ mund të përdorë një huazim të ri që nuk e ka përdorur askush para tij. Së dyti, ka mundësi që çdo ditë të futen huazime të reja, që nuk janë përdorur më parë. Së treti, qëllimi parësor nuk ka qenë që të bëhet ndonjë listë e gjatë e huazimeve, por më tepër të vështrohen dukuritë gjuhësore që paraqiten gjatë interferencës ndërgjuhësore në rrjedhë e sipër të kontaktit të drejtpërdrejtë të anglishtes dhe të shqipës së folur dhe të shkruar në Amerikë, me vështrim të posaçëm në Boston dhe në rrethinën e tij.

Haugeni thotë se asnjë autor nuk ka gjetur më shumë se një mijë huazime me pretendime serioze për studim.¹⁹ Ky numër është përqindje e vogël e fjalorit të çdo gjuhe. Madje edhe në tekst vijues të shqipës së Amerikës, huazimet angleze mezi arrijnë nja dhjetë për qind të fjalëve, ato rëndom janë më pak se kaq.

Sa u përket çështjeve që kanë të bëjnë me kontaktet gjuhësore, në studim është vepruar sipas Haugenit dhe Weinreichut (Weinreich), sipas mendimit tonë, dy prijësve kryesorë në këtë fushë të gjuhësisë. Haugeni ka më shumë vepra në këtë fushë dhe ka shërbyer si orientues kryesor, ndërsa Weinreichu, i njohur me veprën e tij klasike,²⁰ ka shërbyer si gjedhe për disa terma të posaçme në fushën e kontakteve gjuhësore. Megjithatë, është shfrytëzuar terminologjia e të dyve, siç mund të shihet më poshtë. Rudolf Filipovići, nga Zagrebi, ishte ai që na ka futur që në fillim në këtë fushë të studimit gjuhësor, së pari si mentor imi për hartimin e disertacionit, po ashtu edhe me veprat e tij të botuara nga fusha e kontakteve gjuhësore.

Termi *huazim* do të përdoret për elementet leksikore të anglishtes që përdoren si fjalë të rëndomta në gjuhën shqipe. Pos kësaj, janë krijuar shumë kompozita në bazën *huazim*, si f.v. *emër i huazuar*, *folje e huazuar*, *mbiemër i huazuar*, *huazim i përfaqësues*, *kalk (përkthim) i huazuar* etj. Gjerdhja origjinale e elementit të anglishtes do të quhet *model*, ndaj të cilit huazimi mund të jetë pak a shumë i ngjashëm. Elementi gjuhësor i anglishtes i bartur në gjuhën shqipe do të quhet *replikë*, në kuptim të përgjithshëm. Gjuha angleze shikuar nga aspekti i dhënies së elementeve gjuhësore mund të quhet *gjuhë dhënëse*, ndonjëherë quhet edhe gjuhë *model*. Weinreichu e quan gjuhë *burimore*.²¹ Kurse shqipja, si huazuese e elementeve të huaja, në këtë rast mund të quhet *gjuhë marrëse*. Nëse interferenca e anglishtes paraqet riprodhim jo adekuat të modelit në gjuhën shqipe, mund të thuhet se modeli është zëvendësuar me një formë të ngjashme nga gjuha marrëse.

¹⁹ E. Haugen, 1956, f. 65.

²⁰ U. Weinreich, 1953, (rishtypur më 1963).

²¹ U. Weinreich, 1953.

Ekuivalenti i atij modeli mund të quhet *zëvendësim*, apo *substitucion*.

Për arsye praktike, do të përdoret termi *shqipe e Amerikës* e jo ndonjë term i posaçëm për shqipen e përdorur në Boston dhe në rrethinën e tij. Pos kësaj, na merr mendja se nuk ekziston dallim i madh midis kësaj treve dhe trevave të tjera, ku janë vendosur emigrantët shqiptarë nëpër ShBA, sa i përket interferencës gjuhësore si rezultat i kontaktit gjuhësor. Në Amerikë ka ngjashmëri të përgjithshme të interferencës jo vetëm brenda një gjuhe të vetme, por edhe midis gjuhëve të ndryshme të emigrantëve që huazojnë nga anglishtja. Ndonëse, shikuar hollë e hollë, dallime mund të gjenden dhe midis anëtarëve të një familjeje të vetme, gjë që varet nga shumë faktorë, të cilët gjatë studimit do të zihen ngoje në pjesë të ndryshme të tij. Për këtë arsye përshkrimi i ligjëritimit të shqipes i Bostonit dhe i rrethinës së tij në këtë studim, përkundër tipareve të posaçme, mund të vlejë edhe për të gjithë shqipen e folur dhe të shkruar në Amerikë nga shumë pikëpamje.

Termet *shqipe standarde* ose *shqipe letrare* do të përdoren për të shënuar gjuhën e sotme shqipe, ndërsa termi *shqipe* do të shënojë këtë gjuhë në kuptim të përgjithshëm.

Për hir të thjeshtësisë, termi *anglishte* do të përdoret për të shënuar edhe anglishten amerikane, ngase të gjitha interferencat nga anglishtja kanë të bëjnë, po ashtu, edhe me anglishten amerikane, kurse anglishtja britanike nuk është marrë këtu për t'u krahasuar me anglishten amerikane, as me gjuhën shqipe.

Fjalët angleze me prejardhje të huaj, që kanë marrë tiparet e gjuhës angleze, qoftë në shkrim ose në shqiptim, do të trajtohen këtu si anglizma për arsye të thjeshtë se shqiptarët e Amerikës janë ndeshur me to përmes anglishtes, të pavetëdijshëm se ato nuk janë elemente të saj. Çfarëdo trajtimi tjetër i tyre vetëm do ta ndërlikonte punën.

Në gjuhën standarde hulumtuesi ka në dispozicion zgjedhje të madhe të informatorëve, kompetenca gjuhësore e të cilëve nuk vihet në dyshim. Në gjuhën e emigrantëve në Amerikë, siç është ajo e shqiptarëve atje, hulumtuesi has në problemin e zgjedhjes së informatorëve përkatës dhe të burimeve të tjera që paraqesin gjendjen mesatare të kompetencës gjuhësore. Për të punuar me informatorë të tillë në gjuhën shqipe të Amerikës, njeriu duhet të jetë shumë i kujdesshëm që të provojë të përfitojë besimin e tyre. Personalisht na u ka dukur më praktike t'u drejtoheshim informatorëve së pari në gjuhën angleze, dhe pastaj t'u tregonim se jemi shqiptarë dhe se i flisnim që të dyja gjuhët - shqipen dhe anglishten, ashtu si i flasin edhe ata. Kjo mënyrë e njoftimit me ta u jepte guxim të flisnin normalisht, sikur të flisnin me miqtë e tyre shqiptarë të Amerikës, dhe kështu të mos e "pastronin" ligjëritimin e tyre nga huazimet angleze për hir tonin. Pas një

njoftimi të tillë, ata zakonisht ishin të qetë dhe bisedonin në mënyrë shumë normale, madje duke harruar edhe arsyeën për bisedën që bënim me ta. Mirëpo, disa informatorë, ata më të moshuarit, ishin thuaja gjithë kohën të vetëdijshëm për praninë tonë dhe për qëllimin tonë, prandaj bënin çmos të flisnin shqip sa më mirë e më pastër. Në çdo rast interference, që paraqitej në ligjërimin e tyre e për të cilën ishin të vetëdijshëm, provonin të përmirësonin gabimin, duke thënë ndonjë ekuivalent të shqipes (nëse ai ishte fare ekuivalent), ndërsa disa prej tyre madje edhe kërkonin falje pse përdornin ndonjë fjalë angleze. Ata duket se i brente ndërgegjija pse nuk e dinin gjuhën e tyre të nënës, dhe sikur turpëroheshin nga ky fakt.

9. Interferenca gjuhësore

“Interferenca është përdorim i tipareve që i përkasin një gjuhe derisa flitni ose shkruani gjuhën tjetër” - thotë linguisti i mirënjohur Mackey.²² Anglishtja dhe shqipja në SHBA janë në kontakt, sepse përdoren në mënyrë alternative nga folësit e njëjtë, domethënë nga emigrantët shqiptarë. Ata folës mund të quhen bilingë, sepse mund t’i përdorin dhe i përdorin së paku dy gjuhë - anglishten dhe shqipen. Çdo shmangie nga norma e shqipes, që haset në ligjërimin e tyre konsiderohet si pasojë e interferencës gjuhësore nga ana e anglishtes. Kjo interferencë haset në leksik, në gramatikë dhe në fonologji. Kjo shkaktohet për shkak se folësit që janë bërë njeje e kontaktit e bëjnë ndikimin vetëm në gjuhën e tyre. Është shqipja, pra, ajo gjuhë e cila pëson ndikimin, e jo anglishtja. Njohja e shqipes mund të ndikojë vetëm në gjuhën angleze të vetë emigrantit, por jo në gjuhën angleze në tërësi.²³ Ky drejtim njëkahësh i ndikimit gjuhësor shkaktohet për arsye se trysnia shoqërore është, po ashtu, njëkahëshe - nga anglishtja në shqipen e Amerikës, sepse gjuha e parë gëzon prestigjin shoqëror.

Janë dhënë shumë arsye nga gjuhëtarët për interferencën gjuhësore, domethënë për përdorimin e disa elementeve të gjuhës tjetër, siç është nevoja për të zhvilluar marrëdhënie pune a tregtare me folësit e gjuhës tjetër - të anglishtes - në rastin tonë, mungesa e terminologjisë përkatëse në fjalorin e shqipes për nevojat e rrethit të ri, humbja e kompetencës së shqipes si pasojë e harresës etj.

Gjësendet e reja zakonisht vijjnë me emra të rinj. “Fjalët e reja vijjnë me ide të reja” - thoshte Haugen.²⁴ Prandaj nevoja për të mësuar gjësendet

²² William F. Mackey, *The Description of Bilingualism*, the Canadian Journal of Linguistics, Vol. 7:2, p. 68, Toronto, 1962.

²³ E. Haugen, 1953, f. 370.

²⁴ E. Haugen, 1956, f. 12.

dhe konceptet e reja është “arsye universale e risisë leksikore”.²⁵ Kjo duket se është arsyeja kryesore e interferencës leksikore. Linguistët mendojnë se është më lehtë të merren huazime nga gjuhët e huaja, sesa të krijohen fjalë të reja me brumin gjuhësor të gjuhës marrëse.

Gjuha “e cila përdor morfema relativisht të lira dhe të pandryshueshme në paradigmen e saj... shërben si gjedhë për t’u imituar”.²⁶ Përveç faktit se gjuha e parë këtu gëzon prestigj të posaçëm, e dhëna e përmendur ua lehtëson punën fjalëve angleze për t’u bartur në shqipen e Amerikës.

Weinreich thotë se fjalët e huaja, po ashtu, huazohen për t’i ikur homonimisë në gjuhën marrëse.²⁷ Po edhe një arsye tjetër pse huazohen fjalë nga gjuhë të tjera, është nevoja që “fjalët afektive të humbin nevojën e tyre të shprehjes”.²⁸

Interferenca gjuhësore, po ashtu, mund të jetë “çështje e prestigjit”.²⁹ Nëse folësit e një gjuhe dëshirojnë të tregojnë se dinë një gjuhë tjetër, ata përdorin elemente të gjuhës tjetër në ligjërimin e tyre, domethënë, i huazojnë ato elemente. Zëvendësimi i elementeve të tilla mund të jetë edhe pasojë e vijës së rezistencës më të dobët.

Sa u përket folësve shqiptarë të Amerikës, ata përdorin elemente gjuhësore të anglishtes, kryesisht, për shkak se u nevojiten. Duke i përdorur ato fjalë, ata mund të shprehin realitetin amerikan shumë më mirë. Ata, po ashtu, përdorin fjalë angleze për arsye se u mungojnë fjalët përkatëse të komunikimit në gjuhën shqipe për të shprehur atë që dëshirojnë dhe për të cilën kanë nevojë. Kjo ndodh për shkak se i kanë harruar ato fjalë, nëse fare i kanë ditur ndonjëherë, ose për shkak se shqipja mund të mos i ketë disa terma që përdoren për të shprehur praktikën reale amerikane.

Sipas Haugenit, interferenca gjuhësore është proces historik prandaj duhet të identifikohet me metoda historike. Kjo do të thotë se lypset “të bëhet një krahasim midis etapave më të hershme dhe atyre më të vonshme të një gjuhe të dhënë për t’i hetuar risisë e mundshme”,³⁰ dhe pastaj ato mund të krahasohen me gjedhet e gjuhës model. Kjo, e zbatuar në ligjërimin e emigrantëve shqiptarë të Amerikës, do të thotë të bëhet një krahasim i të folurit dimension diakronik nëpër gjuhën shqipe të Amerikës,

²⁵ U. Weinreich, 1953, f. 56.

²⁶ U. Weinreich, 1953, f. 41.

²⁷ U. Weinreich, 1953, f. 58.

²⁸ *Po aty*.

²⁹ E. Haugen, 1956, f. 51.

³⁰ Einar Haugen, *Problems of Bilingualism*, Lingua, International Review of general Linguistics, Vol. II, No. 4, f. 22, Harlem, Holland, 1950.

mund të vërehet shumë qartë se stadi i hershëm i kësaj gjuhe dallonte shumë nga stadi i mëvonshëm i saj, sa i përket interferencës së saj nga gjuha angleze. Në vitet e hershme mund të tërhiqej një segment, ndonëse jo shumë i mprehtë, në mes periudhës që i parapriu Luftës së Dytë Botërore dhe periudhës pas kësaj lufte. Në periudhën e parë, shqipja e folur në Amerikë bënte përpjekje të ishte më e “pastër”. Kjo mund të dëshmohet në publikime të ndryshme dhe, po ashtu, me atë që thoshin pleqtë e asaj kohe për gjuhën e folur. Në gazetatat shqipe të Amerikës të asaj kohe vetëm disa reklama shkruheshin në gjuhën angleze, për të cilat ishte vështirë të gjendejshin shprehje përkatëse në gjuhën shqipe të asaj kohe. Thuaja e gjithë pjesa tjetër e shkrimeve botohej në gjuhën shqipe, dhe mund të thuhet në një gjuhë bukur standarde, kur të kihet parasysh gjendja e gjuhës shqipe e asaj kohe. Mirëpo, kjo gjendje filloi të ndryshohej në periudhën e pasluftës. Gjithnjë më shpesh filluan të dukeshin artikuj në gjuhën angleze nëpër ato gazeta. Dhe, më në fund, gazetatat filluan të botoheshin me disa artikuj ose materiale në gjuhën shqipe, ndërsa me disa të tjerë, rreth gjysma, në gjuhën angleze. Por kjo nuk është e gjithë çështja. Fundja, kjo gjendje dhe mënyrë e botimit të gazetave shpreh një kërkesë për t’iu përgjigjur nevojave reale të lexuesve, sepse tani mbi gjysma e popullatës me prejardhje shqiptare nuk e njihnin gjuhën shqipe. Fundja, kjo nuk ka të bëjë me interferencën gjuhësore, por më shumë me kushtet sociolinguistike të atij rrethi. Çështja që ka të bëjë me interferencën gjuhësore është se artikujt nëpër gazeta kanë ardhur duke u pushtuar gjithnjë më shumë nga huazimet angleze dhe nga strukturat e asaj gjuhe. Kur dihet se gjuha e shkruar zakonisht pasqyron gjuhën e folur, por duke qenë gjithnjë më e pastër se kjo e dyta, ka arsye të supozohet se prania e elementeve gjuhësore të anglishtes ishte shumë më e evidente në shqipen e folur në atë vend.

Haugeni ka vënë në dukje se emigranti e mëson anglishten “bashkë me procedurën teknike, me zakonet e reja shoqërore, me qëndrimet e reja të të pranuarit ose të mospranuarit”. Ai e quante këtë “të mësuarit për të menduar”³¹ në gjuhën e re dhe shtonte se kurdo që folësi duhej të mendonte në atë gjuhë, ai praktikisht “duhej të përdorte gjedhe që dallonin nga ato të gjuhës së tij amtare”. Në këtë mënyrë emigranti filloi të zëvendësonte fjalë dhe shprehje të gjuhës shqipe me ato të gjuhës angleze.

Elementet gjuhësore të anglishtes tek emigrantët e Amerikës duket se fillojnë të përdoren së pari rastësisht. Më vonë ato vijojnë të përdoren gjithnjë më dendur, ndërkohë që fjalët shqipe të përdoren

³¹ E. Haugen, 1953, f. 370.

gjithnjë më pak. Pra, gjatësia e kohës gjersa vepron interferenca gjuhësore qëndron në përpjesëtim të drejtë me numrin e huazimeve angleze, ndërsa në përpjesëtim të zhdrejtë me vëllimin e brumit gjuhësor të shqipes. Pas një kohe, e cila mund të jetë më e gjatë ose më e shkurtër, varësisht nga gjendja e përgjithshme sociolinguistike, huazimet angleze mund t'i zëvendësojnë plotësisht fjalët shqipe dhe, më në fund, fjalët e shqipes mund të harrohen. Shpesh ndodh që folësit e shqipes të ankohen se nuk u kujtohen fjalët e duhura shqipe për të shprehur një gjë apo mendim të posaçëm. Disa indormatorë bënin çmos të përdornin shqipen e pastër, prandaj shumë shpesh ndaleshin për një çast për ta gjetur fjalën ose shprehjen e saktë shqipe për ndonjë gjësend, ide apo veprim. Ndjeheshin të turpëruar kur e kuptonin se përdornin ndonjë fjalë angleze dhe, shpesh, siç u tha edhe më herët, kërkonin ndjesë që bënin një lëshim të tillë. Mirëpo, të shumtën e herës, ata as që e hetonin se përdornin elemente gjuhësore angleze. Ato që i hetojnë janë, zakonisht, huazimet më të reja, ndërsa huazimet e vjetra, me të cilat janë mësuar, nuk i hetojnë fare. Shembull tipik për të ilustruar këtë dukuri mund të shërbejë dialogu që bëmë me një informator:

Unë: - A flitni shqip?

Ai: - Oh, yes.

Unë: - Po në shtëpi a flitni shqip?

Ai: - Yes, of course.

Unë: - Po anëtarët e familjes a flasin shqip?

Ai: - Sure, they do.

Atëherë unë i thashë:

- Ju, Zotëri, nuk më thatë asnjë fjalë në gjuhën shqipe.

Ai u habit fare dhe më shikoi me mosbesim. Kur ia lëshova kasetofonin të dëgjonte se ç'kishte folur, gati u turpërua dhe klithi: - Oh, boy!

Nuk ishte puna se ai informator nuk dinte fare shqip. Ishte brezi i dytë i shqiptarëve të Amerikës, do të thotë i lindur në Amerikë. Më vonë, me një kujdes më të madh, mund të fliste shqip, natyrisht me shumë anglizma, madje mund të tregonte edhe me se merrej. Mirëpo, informatorët si ai ndjejnë lehtësi thuaja të njëjtë të flasin shqip ose anglisht, prandaj dhe shpesh nuk janë të vetëdijshëm se nuk flasin shqip, sepse kalojnë lehtë e lehtë në anglishte e pastaj edhe në shqipe, siç do të flitet më vonë mbi transferin gjuhësor.

U tha më sipër se huazimet angleze përdoren në shqipen e Amerikës për shkak se ata që i përdornin konsiderojnë se u nevojiten. Është punë e vështirë të provohet nëse atyre vërtet u nevojiten në çdo rast kur ata

përdorin elemente të tilla. Teorikisht, ka gjithmonë mundësi që gjuha të krijojë fjalë të reja nga brumi vetjak e të mos përdoren fjalë të huaja. Por, kjo në praktikë nuk del evidente tek emigrantët shqiptarë të Amerikës. Folësit e përmendur si objekt të këtij studimi janë bilingë. Ata i kanë dy sisteme komunikimi, dy rrugë të hapura, kur duhet të emërtojnë një koncept apo ide. Ata mund të përdorin fjalë të reja (huazime) nga rrethi i ri kurdoherë si zëvendësim për idetë apo gjësendet e reja, ose të përdorin fjalë shqipe për t'i emërtuar ato. Sjellja e parë është quajtur *modifikim ndërgjuhësor* dhe është tipike për shumicën e emigrantëve të Amerikës, ndërsa sjellja e dytë quhet *modifikim brendagjuhësor*, dhe vepron në kohë të kufizuar, sidomos tek informatorët objekt të këtij studimi.³² Shqiptarët e Amerikës janë të detyruar, por edhe të prirë, të përdorin anglishten si një mjet komunikimi adekuat për të shprehur realitetin amerikan. Kjo rrjedh si pasojë e një gjendjeje shumë të ndërliqshme, në radhë të parë socio-linguistike, e cila mbretëron në atë vend.

Pak emigrantë shqiptarë të shkolluar të brezit të parë u bëjnë rezistencë më të madhe elementeve angleze krahasuar me atë që bëjnë njerëzit e rëndomtë, për shkak se kanë fjalor më të pasur të shqipes dhe për shkak se mund të krijojnë edhe shprehje e fjalë të reja në shqipe. Mirëpo, eksperti me prejardhje shqiptare, por i lindur në Amerikë, është më i prirë të përdorë huazime angleze, sesa terma shqipë kur flet për gjësende dhe ide të posaçme, që i përdor në profesionin e tij. Kjo ndodh, së pari, për shkak se ai është shkolluar në gjuhën angleze dhe thuaja gjithçka nga profesioni i tij ka mësuar në gjuhën angleze. Ai mund të dijë disa terma në gjuhën shqipe, por sigurisht jo të gjitha. Pos kësaj, ai të shumtën e kohës flet vetëm anglisht derisa bisedon me folësit e anglishtes. Ka pak rast të bisedojë në gjuhën shqipe për jetën e tij profesionale. Do të ishte punë shumë e rëndë për të gjetur ekuivalentë të shqipes për çdo gjë që bën dhe për çdo gjësend që përdor në punën e tij edhe po të kishte një dëshirë dhe motiv të tillë, gjë që rëndom u mungon. Nëse edhe ndodh të dijë disa terma në gjuhën shqipe, atij i duken jo plotësisht të sakta për të shprehur kuptimin adekuat që ato kanë në anglishte. Çdo shqiptar i Amerikës do të donte të bënte dallime të njëjta semantike, siç i bën folësi i anglishtes. Kur të dëgjojnë një ekspert të tillë, të tjerët që kanë kualifikime më të ulëta, i pranojnë ata terma anglezë si të përligjshëm dhe i përhapin më tutje. Por kontakti me folësit anglezë është aq i dendur dhe gjithmonë i pranishëm,

³² Paul D. Seaman, *Modern Greek and American English in Contact*, a socio-linguistic investigation of Greek-American bilingualism in Chicago, Chicago University Press, Chicago, 1970, ff. 177-78.

saqë çdo shqiptar i Amerikës ndjen nevojë të përdorë huazime të anglishtes. Fakti se ata dëgjojnë shprehje ose huazime nga njëri-tjetri vetëm i bën ato të duken më të përligjshme dhe të arsyetojnë përdorimin e tyre. Kjo është ajo që Haugeni e quante *situatë e të mësuarit*.³³

10. Bilinguizmi

Gjuha shqipe e folur në Amerikë është, pa dyshim, jo aq stabile sa shqipja e folur në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni etj. Ndonëse gjuha shqipe është ende gjuhë e parë e shumë amerikanëve me prejardhje shqiptare, për një numër tjetër shumë më të madh, sidomos për të rinjtë, ajo tani është gjuhë e dytë, ndërsa shumë prej tyre nuk e dinë fare.

10.2. Edhe ata shqiptarë që kanë dashur të ruajnë gjuhën e tyre nuk kanë përdorur gjuhën standarde shqipe. Kjo varet shumë nga e dhëna se në cilin dialekt ka folur ai në atdhe. Meqenëse shqipja ka dy dialekte kryesore dhe disa nëndialekte apo të folme, gjuha e disa gazetave, madje edhe e disa librave, e periodikut, si dhe e artikujve të ndryshëm, u përket të folmeve të ndryshme. Ndryshimet dhe normat që janë bërë e respektuar në shqipen standarde kanë ardhur me vonesë në shqipen amerikane, ose nuk janë respektuar fare. Në të njëjtën gazetë hasen shkrime të hartuara në dialekte ose në të folme të ndryshme, varësisht nga autori. Kjo dukuri është e pranishme në shqipen amerikane dhe gjithnjë më e dukshme në deceniet e fundit. Kjo shpjegohet si përpjekje e zbatimit të demokracisë, që çdokujt t'i jepen të drejta të barabarta për ta përdorur të folmen e tij vetjake, meqenëse ato gazeta u përkasin të gjithëve në mënyrë të barabartë. Drejtshkrimi i gjuhës së sotme letrare, i aprovuar më 1972, nuk është respektuar shumë në shqipen e Amerikës. Prandaj, mund të përfundohet se atje nuk ekziston model i respektuar në mënyrë të përgjithshme i gjuhës standarde shqipe. Kjo mungesë e normës standarde të shqipes e ndihmon shumë përshpejtimin e “rrenimit” të saj dhe shton interferencën në të, që nga çasti kur shqiptari arrin në SHBA. Megjithatë, mund të thuhet se në përgjithësi, në pjesën më të madhe të shkrimeve, sidomos në ato ku kishin dorë ose mbikëqyrje Noli, Konica e vijuesit e tyre të gjuhës, siç ishte Panariti, e ndonjë tjetër, mbanin një normë mjaft standarde të shqipes dhe me një qëndresë pa amplitudat që i pësonte shqipja standarde hove-hove në Shqipëri dhe në Kosovë.

Sa i përket përcaktimit të bilinguizmit, autorë të ndryshëm kanë mendime që dallojnë, pak a shumë, njëri nga tjetri. Derisa Bloomfieldi kishte propozuar që biling mund të quhej dikush që ka “kontroll të dy gju-

³³ E. Haugen, 1953, f. 375.

hëve thuaja si folësi burimor”,³⁴ Haugeni thoshte se biling mund të quhej njeriu i cili mund të prodhonte “thënie plotësisht me kuptim në gjuhën tjetër”.³⁵ Dieboldi supozonte se bilingu duhej të kishte “dije pasive të gjuhës së shkruar ose çfarëdo kontakti me modelet e mundshme në gjuhën e dytë dhe aftësinë t’i përdorë ato në rrethanat e gjuhës burimore”.³⁶ Haugeni pohon se mjafton që dikush të dijë (nuk është e domosdoshme t’i përdorë) dy gjuhë që të mund të quhet biling.³⁷ Shkalla e zotërimit të secilës gjuhë nga ana e bilingut, sipas publikimeve bashkëkohore, pra, dallon që nga zotërimi i gjithmbarshëm i dy ose më shumë gjuhëve, deri në njohjen elementare të gjuhës së dytë. Biling i plotë, me kompetencë të barabartë në dy e më shumë gjuhë duket se nuk ekziston. Nëse ekzistojnë të tillë, sipas Foktit, “është vështirë të shihet pse t’iu interesojnë gjuhëtarëve rastet e tilla, sepse dukuria e interferencës aty do të përjashtojë vetvetiu”.³⁸ Lidhur me këtë Mackey pohon se “pika në të cilën folësi i gjuhës së dytë bëhet biling, është ose arbitrare ose e pamundshme të caktohet”.³⁹

Folësi biling ka kompetencë të dyfishtë. Ai përpiqet të krijojë një gjedhe që i rrafshon dallimet në mes gjuhës dhënëse dhe gjuhës marrëse. Në situatën e “kontaktit gjuhësor, përvoja e bilingut rrallë është e tillë, sa që ai të mund t’i ruajë dy kode plotësisht të dalluara”.⁴⁰ Rezultati i një përvoje të tillë gjuhësore është që bilingu dalëngadalë të zhvendoset prej dy gjuhëve në një gjuhë të vetme, me elemente të të dyjave të përfshira në të.

Sipas kriterit të zënë ngoje më sipër, shumica dërmuese e brezit të parë dhe të dytë të shqiptarëve të Amerikës mund të konsiderohen plotësisht bilingë. Meqenëse bilinguizmi është tipar i individit,⁴¹ nuk mund të gjurmohet as të përshkruajmë zhvillimin e çdo bilingu nga grupi i folësve të shqipes në Amerikë, që janë objekt të këtij studimi. Ky studim mbështetet vetëm në rezultatet e shumicës së bilingëve të tillë.

Sa u përket bilingëve shqiptarë në Amerikë, shumë prej tyre duket sikur të kenë kërkuar të amerikanizoheshin sa më shpejt që ishte e mundur, për arsye të thjeshtë se shumë pak prestigj i ishte dhënë faktit të të qenët

³⁴ L. Bloomfield, *Vep. e cit.*

³⁵ E. Haugen, 1953, f. 7.

³⁶ Richard, Jr. A. Diebold, *Incipient Bilingualism*, Language, No.37, f. 111, 1961.

³⁷ Einar Haugen, *Bilingualism, Language Contact and Immigrant Languages in the United States*, a research report 1956-1970, Current Trends in Linguistics, Vol. 10, The Hague – Paris – Mouton, 1973, p. 521.

³⁸ Hans Vogt, *Contact of Languages*, Word, Vol. 10, No. 2/3, p. 369, New York, 1954.

³⁹ W. Mackey, 1962, f. 52.

⁴⁰ E. Haugen, 1973, f. 521.

⁴¹ W. Mackey, 1962, f. 51.

biling. Sikur të ishte bërë trysni e padukshme mbi bilingët, që të flisnin vetëm anglisht. Emigranti shqiptar si biling ka jetuar në zonën e muzgut, diku midis gjuhës së vjetër (shqipes) dhe gjuhës së re (anglishtes). Shqiptarët atje, sidomos ata të hershmit, që në fëmijëri ishin orientuar t'i ruanin traditat dhe t'i kultivonin si gjuhën shqipe ashtu edhe anglishten. Mirëpo, koha rëndonte gjithnjë më shumë mbi shqipen dhe e favorizonte gjithnjë më shumë anglishten.

Të gjithë emigrantët në Amerikë gëzojnë të njëjtin fat dhe pësojnë të njëjtën fatkeqësi. Në një shkallë më të lartë apo më të ulët, gjuha e grupit etnik nuk është e rëndësishme dhe nuk gëzon fare prestigj. Vetëm anglishtja është gjuhë që vlen dhe bën punë për të gjithë. Emigrantët shqiptarë, siç thekson Theodore Blegen⁴² për emigrantët norvegjezë, nuk u larguan nga njerëzit e tjerë me të cilët jetonin ose punonin. Ata as nuk hoqën dorë nga gjuha e tyre shqipe, as që e zotëruan mirë anglishten, ndonëse mësuan nga ajo. Kjo vlen sidomos për brezin e parë. Ajo që bënë ata ishte njëfarë gjuhe ndërmjetëse. Ai brez u përshtatej mënyrave të jetës amerikane, jo me ndonjë shndërrim të shpejtë magjik, po dalëngadalë, hap pas hapi.

Shqiptari që nuk di anglisht, do të gjendej i hutuar po të gjendej në mesin e tyre, kur do të dëgjonte emigrantët shqiptarë duke folur në mes vete, e shpesh nuk do të ishte në gjendje t'i kuptonte fare për çka po bisedonin. Kjo ndodh pjesërisht për shkak të shumë huazimeve angleze të futura në ligjërimin e tyre në gjuhën shqipe, pjesërisht për shkak të shmanגיעve të shpeshta nga gjedhet sintaksore të shqipes standarde, si dhe për shkak të inovacionit të sintagmave e fjalive sipas gjedheve të anglishtes.

Emigrantët e vjetër shqiptarë e flasin anglishten bukur mirë dhe rrjedhshëm, duke rënë në sy një sasi interference e shqipes në anglishten e tyre. Në përgjithësi shqipen e flasin më dobët se anglishten. Sipas Pealit e Lambertit (Peal and Lambert, 1962),⁴³ këta mund të quhen "pseudobilinggë", të cilët, në të vërtetë, kurrë nuk e mësuan anglishten plotësisht, kurse e harruan shqipen në rrjedhë të kohës. Prandaj, ata nuk kanë kompetencë të plotë as në anglishte e as në shqipe. Ata kalojnë prej një gjuhe në tjetrën sa herë që e kërkon rasti. Mund t'i kenë ruajtur rregullat gramatikore të gjuhës shqipe pa ndonjë efekt të madh nga anglishtja, por intonacioni i anglishtes dhe përdorimi i huazimeve të shumta angleze (shpesh edhe i rendit të fjalëve) ndikojnë në ligjërimin e tyre në gjuhën shqipe.

Emigrantët shqiptarë të brezit të dytë flasin anglisht rrjedhshëm,

⁴² Cituar sipas E. Haugen, 1973.

⁴³ Pas: Die Pietro, *Bilingualism*, Current Trends in Linguistics, V.4, p.399, Mouton, 1968.

rrallë me ndonjë interferencë nga shqipja, por shqipen e flasin mjaft dobët, me interferencë të dukshme nga anglishtja. Ky brez nuk është fare i njëtrajtshëm. Pjesëtarët e këtij brezi shtrihen që prej folësve bilingë të mirë me zotërim thuaja të mirë të të dyja gjuhëve, deri në folës monolingë të anglishtes, të cilët mund të dinë fare pak shqip. Emigrantët shqiptarë të këtij brezi pohojnë, kudo që kanë rast, se u lindën në Amerikë dhe u shkolluan në gjuhën angleze, dhe se do të dëshironin të ruanin gjuhën shqipe, por mundësitë për të bërë këtë punë janë shumë të vogla. Më të rinjtë nga ky brez janë amerikanizuar plotësisht si me gjuhë, me sjellje, ashtu edhe me botëkuptime. Ata mezi flasin ndonjë fjalë shqipe, ndërsa në anglishten e tyre thuaja nuk vërehet ndonjë gjurmë interference nga shqipja. Ndërsa, thuaja asnjë nga brezi i tretë i emigrantëve shqiptarë në rrethin ku bëmë hulumtime nuk gjetëm që të fliste, sadopak, shqip.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjendja shoqërore për bilingët është aq dinamike, saqë bën të mundur që gjuha e emigrantëve të shuhet në favor të anglishtes. Kështu, shqiptarët e Amerikës teorikisht mund të klasifikohen në shkallë të ndryshme të interferencës, duke filluar prej folësve monolingë të anglishtes, pastaj bilingëve me njohje më të mirë të njëres gjuhë apo të tjetres, ose (jo shpesh) me njohje bukur të barabartë të të dyja gjuhëve, madje edhe me interferencë nga të dyja gjuhët, deri në folës monolingë të shqipes. Vetëm anëtarët e brezit të dytë e të tretë, domethënë, ata që janë lindur në Amerikë, mund të llogariten ndër ata me zotërim më të mirë të anglishtes ose si folës monolingë të anglishtes. Grupi i folësve monolingë të shqipes është ose vetëm mundësi teorike ose përbëhet prej emigrantëve që posa kanë arritur atje. Shumica e emigrantëve shqiptarë i përkasin grupit të bilingëve. Prandaj, kur të flitet për shqipen e Amerikës, mund të thuhet se kemi të bëjmë shumë ngushtë me çështjen e bilinguizmit. Nga kjo del se bilinguizmi meriton një vend të posaçëm në shqyrtimin jo vetëm të gjuhës shqipe, por edhe të çdo gjuhe tjetër të grupeve etnike në Amerikë. Posa të jetë zhdukur bilinguizmi, s'ka më vend për studim të atyre gjuhëve nga ky këndvështrim.

11. Gjendja e gjuhës

Vetëm shqiptarët që shkuan në Amerikë para mbarimit të dekadës së dytë të shekullit njëzet kishin qëllimin të ktheheshin në vendlindje. Shumica dërmuese e atyre që emigruan më vonë atje nuk mendonin të ktheheshin prapa. Ata kishin vendosur të kalonin atje pjesën tjetër të jetës dhe të krijonin familjet e t'i linin fëmijët e tyre në vendin e ri. Ky fakt pati ndikim në vendimin e tyre që t'i përshtateshin jetës amerikane që nga fillimi, ndoshta edhe pavetëdijshëm, njëherë e përgjithmonë, prandaj dhe të mos brengoseshin sa duhet as për ruajtjen

e gjuhës shqipe. Sikur të mendonin të ktheheshin një ditë nga atje, do të kishin vepruar më shumë për ta mbajtur atë gjuhë të gjallë. Ndërsa të vendosur për të ngelur atje, ata bënë vetëm aq përpjekje për ruajtjen e gjuhës dhe të traditave të tyre, sa të kënaqnin nevojën e tyre psikologjike për gjuhën e tyre të fëmijërisë, aq sa rrjedh nga ndjenja e nostalgjisë për të.

Emigrantët shqiptarë vazhdimisht kanë qenë nën trysinë e gjuhës së prestigjit dhe kështu, pak nga pak, shpesh pavetëdijsëm sa duhet, kanë futur fjalë e shprehje angleze në gjuhën e tyre. Kontrolli mbi gjuhën e tyre të parë gjithnjë është dobësuar, ndërsa gjuha e re duke u forcuar dhe duke e zëvendësuar të parën.

Emigranti shqiptar që jeton në shoqëri ku anglishtja është e vetmja gjuhë e komunikimit publik, ku gjuhët e tjera kanë pak prestigj apo nuk kanë aspak, provon që në fillim të gjallërimit të tij në Amerikë të mësojë sa më shumë anglisht. Nevoja e tij për anglishten është gjithnjë më e madhe, sepse shqiptarët, marrë në përgjithësi, me disa përjashtime, nuk jetojnë në grupe të mëdha kompakte, siç jetojnë disa grupe të tjera etnike. Prandaj për t'u zhvilluar bilinguizmi ndër shqiptarët atje duhet kohë relativisht e shkurtër, dhe ashtu, deshi s'deshi, ai fillon të eliminojë fjalët shqipe një nga një për t'i zëvendësuar ato me fjalë angleze.

Shqiptarët që shkruajnë në gjuhën shqipe në SHBA me qëllim që të lexohen nga atdhetarët emigrantë, janë ballafaquar me probleme, të cilat nuk qëndrojnë në atdhe. Ata gjithnjë kanë luftuar kundër pasojave të gjedheve mbizotëruese të anglishtes në gjuhën e tyre.

Shqiptarët që bartën mbi supet e tyre barrën e themelimit të gazetave të hershme, si Sotir Peci, Fan Noli etj., nuk kishin pasur paraardhës që t'i kishin udhëzuar. Ata kishin vetëm njohurinë e tyre me gazeta në vendlindje ose në shoqatat shqiptare jashtë atdheut, dhe ndonjë kontakt të dobët me gazetatat amerikane. Askush prej tyre nuk kishte qenë gazetar profesionist, ndonëse disa prej tyre u bënë të tillë me kohë. Si shumë liderë emigrantësh, gazetarët dhe shkrimtarët shqiptarë të Amerikës kishin detyrë të dyfishtë. Ishte detyrë e tyre e jashtëzakonshme t'ua sqaronin atdhetarëve të tyre mënyrat e jetës amerikane, por njëherësh ata dëshironin që t'i mbanin ata të informuar për ngjarjet dhe ecuritë e gjithmbarshme në vendlindjen e tyre.

Emigranti shqiptar në Amerikë, si çdo grup tjetër etnik, erdhi në kontakt të drejtpërdrejtë me rrethanat amerikane në të gjitha sferat e jetës. Ai kishte nevojë për fjalor të ri, si për administratën publike, ashtu edhe për jetën ekonomike dhe jetën shoqërore. Reklamuesit amerikanë krijojnë probleme të posaçme në fjalor me listat e gjata të prodhimeve amerikane dhe me gjuhën estetike të përdorur për të përshkruar tiparet e atyre prodhimeve. Shqiptari atje as që i kishte njohur shumë nga nocionet që shënonin ata terma, as që kishte pasur a parë prodhime e veprime të tilla në vendlindje. Nuk

kishte nga t'ia mbante dhe detyrohej të përdorte fjalët e reja si *business, bill, store, grocery, sheriff*, e shumë të tjera. Shmangia nga këto fjalë bëhej gjithnjë më e vështirë, sepse nocione të tilla ose nuk ekzistonin ose nuk ishin klasifikuar në atë mënyrë në atdheun e emigrantit shqiptar.⁴⁴

Shqiptari në Amerikë duke i mësuar gjësendet që i duheshin në jetën e tij të përditshme, e merrte terminologjinë e re gjithnjë më shumë si gjë të natyrshme, sado që ajo kishte shumë dallime nga gjuha e tij e parë, shqipja. Redaktorët dhe gazetarët e gazetave të ndryshme kanë bërë përpjekje të mëdha për ta zgjidhur këtë çështje duke futur terma angleze në fjalitë shqipe. Mirëpo, secili nga ata terma apo secila nga ato shprehje që futeshin në përdorim të ligjërimit shqip, atje krijonin probleme gjuhësore, siç janë, b.f., si të shkruheshin, si të shqiptoheshin dhe çfarë përshtatjeje gramatikore e tyre të bëhej në gjuhën shqipe të Amerikës.

Njeriu mund të supozojë se nevoja për ekzistencë e shtynte shumicën e shqiptarëve të Amerikës të mësonte sa më shumë anglisht për të gjetur rrugën në rrethin e ri. Emigrantët nuk kishin filluar të përdornin fjalë angleze vetëm pse kishin dëshiruar, por për të i kishte detyruar nevoja. Siç rritej trysnia shoqërore dhe psikologjike e anglishtes si gjuhë mbizotëruese, rritej edhe tendenca që të pranohej gjuha e asaj kulture superiore më shumë sesa mund të merrej me mend, kështu që zvogëlohej mundësia që ato nevoja t'i shprehnin me gjuhën shqipe. Megjithatë, shumë emigrantë shqiptarë vazhdonin të përdornin gjuhën e tyre të parë kudo që u jepej rasti.

Kur të kihen parasysh të gjitha këto rrethana, nuk ka dyshim se në një gjuhë si shqipja në Amerikë bëheshin ndryshime, sepse ajo gjallëronte në kushte të dukshme të trysnisë bilinge. Numri i folësve monolingë të shqipes ishte zvogëluar dhe kishte arritur thuaja në zero. Po ashtu ishte në zvogëlim e sipër numri i folësve bilingë i shqiptarëve të Amerikës, derisa numri i folësve monolingë të anglishtes nga radhët e individëve me prejardhje shqiptare ishte shtuar dhe vinte gjithnjë duke u shtuar. Emigrantët shqiptarë, pra, janë integruar gradualisht në rrjedhën e kulturës kryesore të atij vendi. Ata janë akulturuar, siç do të thoshte Haugeni,⁴⁵ pa marrë parasysh nëse dëshironin apo jo. Procesi i “akulturimit është të mësuarit e sjelljes shoqërore prej një kulture tjetër që dallon nga e vetja”.⁴⁶ Kështu, emigranti, përmes përvetësimit të huazimeve angleze dhe elementeve të tjera të asaj gjuhe, përvetëson njëherësh edhe kulturën amerikane.

⁴⁴ E. Haugen, 1953, f. 26.

⁴⁵ E. Haugen, 1956, f. 99.

⁴⁶ E. Haugen, *Po aty*.

Procesi i akulturimit e zë fillin së pari në gjuhën e folësit, në fillim në ndryshime, pastaj me kufizime graduale të përdorimit të asaj gjuhe. Pas një kohe, folësit të tillë i duket gjuha e vet joadekuate për të shprehur kulturën, në të cilën është duke hyrë, prandaj është i shtrënguar të përdorë fjalë angleze dhe ta “zgjerojë” ashtu fjalorin e tij. Në këtë mënyrë, gjuha shqipe në SHBA është bërë gjithnjë më e kufizuar për të kryer funksionin e saj, duke kërkuar gjithnjë më shumë elemente angleze për ta plotësuar fjalorin e saj.

Ajo që është simptomatike dhe e çuditshme tek emigrantët shqiptarë është fakti se ata shpesh përdorin anglishten edhe kur komunikojnë me atdhetarët e tyre. Ndonëse po të jetë vetëm një folës që nuk e di shqipen, biseda zhvillohet vetëm në anglishte, madje edhe në mes emigrantëve shqiptarë. Kështu ata flasin në një gjuhë që ndoshta nuk e kanë zotëruar plotësisht. Duket haptas se ata nuk e konsiderojnë gjuhën e tyre të vlefshme sa duhet, prandaj përvetësojnë fjalë e shprehje angleze, madje edhe kalojnë plotësisht në anglishte - shpesh si rrjedhojë e të çmuarit të saj si gjuhë të prestigjitetit. Shpesh kalojnë prej shqipes në anglishte, e përsëri në shqipe, pa qenë madje as të vetëdijshëm se bëjnë kapërcime të tilla prej një kodi në tjetrin. Kjo rrjedh ngase janë mësuar të jetojnë me folës bilingë dhe janë të vetëdijshëm se për bashkëbiseduesin cilado gjuhë është e kuptueshme.

Dy nga karakteristikat kryesore që i dallojnë brezin e parë dhe të dytin të emigrantëve shqiptarë janë këto (dhe duket se janë të përbashkëta për shumë grupe etnike në Amerikë:⁴⁷ E para, brezi i parë përdor më shumë fjalë angleze të përshtatura, ndërsa brezi i dytë përdor më shumë fjalë angleze të papërshtatura. E dyta, brezi i parë e zotëron më mirë gjuhën shqipe sesa brezi i dytë, kurse brezi i dytë e zotëron më mirë gjuhën angleze sesa brezi i parë, dhe e zotëron më shumë anglishten sesa shqipen.

Shënimet statistikore dhe analizat e hollësishme të përmbledhura në studimet e Fishmanit⁴⁸ tregojnë mjaft qartë zvogëlimin drastik të numrit të folësve të joanglishtes në SHBA. Fishmani thekson nevojën e urgjencës për studime të gjuhëve të emigrantëve, të cilat do të zhduken shumë shpejt. Prandaj, rrezik i ngjashëm mund t’i kërcënohet edhe shqipes së Amerikës.

Në përgjithësi, gjendja ndër shqiptarët e Amerikës është, ashtu siç përfundon Jutronic⁴⁹ për kroatët në SHBA, sa më shumë që të ketë interfe-

⁴⁷ Paul Seaman, *Američki-ingleski i hrvatski (ćakavski dijalekt) u kontaktu*, Ćakavska rič, br. 1, 1973; po ashtu, P. Seaman, 1970.

⁴⁸ Joshua A. Fishman, *Language Loyalty in the United States*, The maintenance and perpetuation of non-English mother tongues by ethnic and religious groups, Mouton, The Hague, 1966.

⁴⁹ Dunja Jutronic: *Američki-ingleski i hrvatski (ćakavski dijalekt) u kontaktu*, Ćakavska rič,

rencë gjuhësore, aq më pak do të ketë përdorim të gjuhës e cila pëson interferencën, pra të gjuhës shqipe në rastin tonë.

Haugeni pohonte se “zhvendosja gjuhësore⁵⁰ mund të jetë e pjeshme ose e tërësishme. Zhvendosja gjuhësore e pjeshme ndërlihet me bilinguizmin, i cili jo që vetëm e plotëson por edhe e eliminon gjuhën e parë nga disa funksione”,⁵¹ siç është rasti kur shprehen nocionet që kanë të bëjnë me biznesin, me aktivitetet politike dhe me teknikën dhe mekanikën, e sidomos me elektronikën dhe me kibernetikën në kohë të fundit, si dhe me fjalët që pasqyrojnë kontaktin e drejtpërdrejtë me anglishten. Për funksione të tilla përdoret terminologjia e gjuhës dhënëse, e cila është më adekuate për ato sfera të aktivitetit. Zhvendosja gjuhësore e tërësishme është rezultat i fundit logjik i interferencës gjuhësore.⁵²

Përfundimi i natyrshëm që del nga këto të dhëna tregon se fitorja e anglishtes është e pashmangshme në një të ardhme jo të largët. Në të vërtetë, kjo është vërtetuar dhe provuar në shumë raste gjuhësh etnike deri tani, ndërsa mund të dëshmohet çdo ditë. Shumë gjuhë të folura në Amerikë janë zhdukur.⁵³ Vetëm spanjishtja në jugperëndim të Amerikës, frëngjishtja në Luizianë dhe gjermanishtja në Pensilvani kanë shënuar një rezistencë më të gjatë se të tjerat ndaj zhdukjes, por edhe trualli i tyre është duke u shembur. Pra, grupe etnike shumë më të mëdha se ai i shqiptarëve janë asimiluar nga shoqëria amerikane. Ka shumë familje emigrantësh me prejardhje shqiptare, që kanë shkuar në Amerikë para shtatë a tetë dekadave dhe sot nuk e përdorin shqipen dhe as që dinë fare ta flasin.

Më në fund, të vështrojmë edhe ndonjë çështje. Është thuaja e pamundur të studiohet shqipja në Amerikë në kuptim të një kohe relativisht të gjatë. Kjo rrjedh nga ndryshimet e shpeshta që bëhen çdo ditë në atë ligjërim. Ajo që nuk është dëgjuar dje, dëgjohet sot, e sigurisht edhe më shumë nesër. Duket se ky ligjërim i emigrantëve i nënshtrohet një shkalle të lartë të interferencës, dhe ndoshta nuk shkon as deri në gjysmë të rrugës së të huazuarit, domethënë të zëvendësuarit të fjalëve shqipe me huazime angleze, kur një ditë padukshëm folësit e gjuhës së “vjetër” kalojnë njëherë e përgjithmonë në anglishte. Kjo nuk do të thotë se ata nuk dinë më shqip fare. Ata mund të dinë dhe zakonisht dinë edhe pak nga ajo gjuhë e “vjetër” e tyre, por nuk e vënë në përdorim. Natyrisht, në ligjërimin e tyre ata ruajnë për një kohë të gjatë tipare të shqipes që paraqiten si interferencë në

br. 1, 1973, f. 27.

⁵⁰ E. Haugen, 1956, f. 101.

⁵¹ U. Weinreich, 1953, ff. 106-110.

⁵² E. Haugen, 1953, f. 261.

⁵³ U. Weinreich, 1953 (rishtypur në vitin 1963), f. 14.

anglishte, sidomos te të rriturit, por jo edhe te fëmijët që janë lindur dhe rriten atje. Meqenëse gjuhën e përbëjnë folësit individualë, janë pikërisht ata që bëjnë kalimin e tillë një nga një, ose të gjithë së bashku brenda një periudhe kohore dhe në një komunitet të caktuar.

12. Ruajtja e gjuhës

Me rastin e vlerësimit të faktorëve të ndryshëm që ndikojnë në ruajtjen e gjuhës, shumë gjuhëtarë e vënë rolin e familjes në vend të parë. Institucioneve të religjionit, shkollave, shoqatave folklorike dhe shtypit u japin rëndësi të dorës së dytë në këtë çështje.

Ruajtja e gjuhës shqipe brenda familjes shqiptare të Amerikës varet shumë nga dëshira dhe gatishmëria e prindërve që ta flasin atë gjuhë me fëmijët e tyre, nga autoriteti i prindërve të fëmijët dhe nga shkalla e presionit që bëhet nga jashtë. Prindërit që kanë emigruar në SHBA si të rritur zakonisht nuk shprehin dëshirë për të pranuar anglishten si gjuhë të familjes. Shumica e tyre janë vendosmërisht kundër përdorimit të saj, madje edhe u duket gjë e vështirë ta zotërojnë atë gjuhë të re - anglishten - në rrethin familjar. Familja në vete mund të vazhdojë traditën gjuhësore nëse kohezioni i saj është mjaft i fuqishëm. Familjet nuk ia dalin të vijojnë traditën bilinge për kohë të gjatë, përveç nëse u ndihmon prania e familjeve të tjera të së njëjtës gjuhë e kulturë që mund të jenë në fqinjësi.⁵⁴

Prindërit shqiptarë të Amerikës gjenden në pozitë shumë të vështirë sa i përket ruajtjes së gjuhës shqipe. Shpesh shtrohet çështja e autoritetit të tyre si prindër ndaj fëmijëve, të cilët shpesh janë të padëgjueshëm. Prindërit në një gjendje të tillë luhaten midis vendimit për t'ua imponuar fëmijëve gjuhën shqipe dhe dëshirës për t'i parë ata të lumtur dhe me perspektivë. Por ajo që bëjnë disa nga ata prindër është shumë kundërthënëse. Nga një anë, ata bisedojnë me fëmijët e tyre thua vetëm në anglishte, por njëherësh, nga ana tjetër, presin që fëmijët e tyre të mësojnë shqipen nga dy apo tri orë mësimi në javë, që i mbajnë në të ashtuquajturat shkolla të së dielës në kisha, xhami, teqe apo gjetiu.

Gjedhet shoqërore amerikane kanë favorizuar dobësimin e autoritetit prindëror, prandaj, siç thekson Haugeni⁵⁵ për emigrantët në përgjithësi - "rebelimi ndaj gjuhës shkon krah për krah me lirimin e fëmijëve nga mënyrat tradicionale shoqërore të sjelljes". Edhe fëmijët që kanë arritur të mësojnë pak shqip në fëmijëri, e zotërojnë vetëm pjesërisht këtë

⁵⁴ E. Haugen, 1953, f. 236.

⁵⁵ E. Haugen, 1953, f. 235.

gjuhë, pa kompetencë të plotë të saj. Përpyekjet e prindërve për t'i detyruar fëmijët të mësojnë shqip në përgjithësi janë shumë të mëdha. Ata ndjehen shumë të lumtur kur fëmijët e tyre dinë sadopak shqip. Fëmijët, nga ana tjetër, kanë shumë pak raste të flasin dhe të ushtrojnë gjuhën shqipe. Ata me gjasë flasin në atë gjuhë vetëm me një ose me pak anëtarë të familjes, zakonisht me gjyshin, gjyshen apo me prindërit. Ndërsa anglisht flasin me çdo njeri tjetër - me shokët dhe shoqet e tyre, me njerëzit e tjerë në rrugë, në dyqane, në shkollë, madje edhe me motrën apo vëllain. Është mjaft tipike kjo situatë bilinge: prindërit apo gjyshi a gjyshja të flasin shqip, ndërsa fëmijët të përgjigjen dhe të flasin anglisht. Kjo situatë bën që, të përdorim fjalët e Haugenit,⁵⁶ “si fëmijët ashtu edhe prindërit duken si pijunët që as vetë nuk e kuptojnë çfarë loje bëjnë. Prindërit ankohen se fëmijët e tyre nuk i dëgjojnë dhe e akuzojnë brezin e ri se u kanë kthyer shpinën idealeve të prindërve dhe të gjyshërve të vet, se kanë humbur fenë që kishin prindërit dhe gjyshërit e tyre, se janë bërë ‘janki’” etj. Fëmijët, nga ana e tyre, ankohen se prindërit dhe gjyshërit i detyrojnë të mësojnë një gjuhë që për ata është e huaj, dhe e cila nuk i shërben fare ndonjë qëllimi të dobishëm. Ata i akuzojnë pleqtë se janë antiamerikanë, jopraktikë etj. E vetmja gjë që u pëlqen fëmijëve të shqiptarëve të Amerikës në atë gjuhë, është se mund ta përdorin atë si kod sekret kur duan të mos i kuptojnë diçka shokët apo shoqet e tyre joshqiptarë. Por shumë më shpesh ndodh që prindërit të përdorin shqipen si kod sekret, duke fshehur diçka nga fëmijët.

Grupi etnik i shqiptarëve, si çdo grup tjetër etnik në Amerikë, pos përpjekjeve për ta ruajtur identitetin gjuhësor brenda familjes, ka organizuar edhe forma të tjera për të kufizuar ndikimin e anglishtes në gjuhën e tyre. Kjo është bërë zakonisht përmes grupeve dhe shoqërive të ndryshme të këngëve dhe valleve popullore, pastaj duke botuar libra, gazeta dhe revista, si nga kishat ortodokse dhe katolike si edhe nga xhamitë e teqetë dhe grupet lidhur me jetën klerikale. Mirëpo, këto përpjekje, siç thekson edhe Simani për imigrantët grekë,⁵⁷ kanë krijuar vetëm një qasje shoqërore e psikologjike ndaj traditave, por jo edhe ndonjë hap të rëndësishëm të përvetësimit gjuhësor, madje as hap të madh të pezullimit ose të shtyrjes së dukshme të asimilimit të emigrantëve. Ajo që kanë mundur të bënin më së shumti ka qenë të shtyhej për ndonjë ditë më vonë asimilimi gjuhësor.

Klubet dhe shoqëritë folklorike dhe të ngjashme kanë qëndruar pranë kishave dhe xhamive e teqeve në çështjen e forcimit të autorite-

⁵⁶ *Po aty.*

⁵⁷ P. Seaman, 1970, f. 212.

tit të familjes në të mirë të ruajtjes së gjuhës shqipe, por nuk kanë pasur shumë sukses në këtë detyrë. Kjo ka ndodhur pjesërisht për shkak se rrallë kanë mundur ta përfshijnë tërë familjen në aktivitetet e tyre. Ato shoqëri kanë tërhequr babanë ose të dy prindërit, por jo pa tjetër edhe fëmijët e tyre. Ato kanë ofruar dhe shfaqur programe që nuk kanë nxitur gjithmonë ndonjë interesim të madh te fëmijët.

Fëmijët e grupeve etnike në Amerikë mësimet duhet t'i ndjekin në gjuhën angleze, pa marrë parasysh se cilën gjuhë e flasin në shtëpi. Kjo, përveç disa përjashtimeve, është politikë e përgjithshme e shkollave publike në SHBA. Meqenëse fëmijët në shkollë përdorin vetëm gjuhën angleze, shumë emigrantë shqiptarë i detyrojnë fëmijët e tyre t'i vijojnë shkollat e së dielës. Kjo nënkupton disa orë mësimi që të dielave mbahen zakonisht pranë ndonjë institucioni fetar (kishë, xhami, teqe), apo më rrallë pranë ndonjë institucioni shoqëror a kulturor. Në ato "shkolla" qëllimi i programit mësimor është gjuha shqipe, por mund të ketë edhe ndonjë lëndë tjetër që përfshin kulturën e përkatësisë kombëtare: histori, gjeografi dhe muzikë. Mirëpo, në rrjedhë e sipër të kohës, ka gjithnjë më pak interesim për mësim të tillë nga ana e prindërve, ndërsa edhe më pak nga ana e fëmijëve. Fëmijët e emigrantëve shqiptarë shkojnë në "shkollë" të tillë për t'u takuar me shokë e shoqe dhe për të luajtur me ta para orës së mësimet e në pushime në mes orëve, natyrisht, duke biseduar në gjuhën angleze në mes vete, por jo shumë me qejf për të mësuar shqip. Kjo e dhënë na u dëshmuar në bisedat që bënim me fëmijët në "shkolla" të tilla. Por këtë e pohojnë edhe arsimtarët në bisedat joformale.

Përveç shkollave private të së dielës, ruajtja e shqipes është mbështetur edhe nga mjetet e ndryshme të informimit publik: shtypi në gjuhën shqipe, publikimet dhe radio-programet. Shtypi në gjuhën shqipe ka qenë një ndër mjetet më efektive për ruajtjen e gjuhës shqipe në Amerikë. Janë botuar gazeta dhe revista të ndryshme.⁵⁸ Mirëpo, natyrisht, qëllimi kryesor i këtyre gazetave nuk ka qenë ruajtja e gjuhës; shumë prej tyre kanë pasur qëllime të tjera, si f.v. politike. Megjithatë, ato në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kanë ndikuar në ruajtjen e gjuhës shqipe në Amerikë.

Një mjet tjetër, por me më pak efekt, për të ruajtur gjuhën shqipe në Amerikë ka qenë korrespondenca me farefisin ose me miqtë qoftë në atdhe ose në Amerikë, ose gjetiu. Vlen të theksohet me këtë rast se, sipas Mackeyut,⁵⁹ bilingët duket se i rezistojnë interferencës më shumë kur i

⁵⁸ Shih për këtë më sipër, kur flitet për shtypin dhe botimet (nën 4. dhe 5.)

⁵⁹ W. Mackey, 1962, f. 69.

shkruajnë dikujt sesa kur flasin me të tjerët. Mirëpo, tani kjo mënyrë e komunikimit është zvogëluar deri në formë simbolike. Komunikimet miqësore bëhen kryesisht me anë të telefonit. Ndërsa shumica e shqiptarëve atje tani shumë më mirë dhe më lehtë mund të shkruajnë anglisht sesa shqip.

Ka interes të theksohet se emigrantët shqiptarë në përgjithësi nuk ia kanë dalë ta ruajnë gjuhën e tyre aq gjatë sa kanë mundur ta ruajnë disa grupe etnike të tjera, siç janë norvegjezët, gjermanët, grekët etj. Një përqindje e madhe e brezit të dytë nuk dinë shqip, madje shumë prej tyre as që e kuptojnë këtë gjuhë. Arsyet janë të shumta. Emigrantët shqiptarë, siç u tha më sipër, marrë në përgjithësi, nuk jetojnë në grupe të mëdha. Ata janë shpërndarë nëpër pjesë të ndryshme të Shteteve të Amerikës dhe brenda një qyteti jetojnë nëpër lagje të ndryshme të tij. Ndërsa, siç ka përfunduar edhe Haugeni,⁶⁰ emigrantët që janë të shpërndarë nëpër qytete, amerikanizohen më shpejt, sesa ata që jetojnë në fqinjësi kompakte. Emigrantët shqiptarë kanë banuar kryesisht nëpër qytete, madje në qytete të mëdha, e shumë rrallë nëpër fshatra apo vendbanime të vogla, ku do të qëndronin të grumbulluar. Fakti se ata takohen në kisha, xhami, teqe apo diku tjetër në raste të ndryshme fetare dhe kombëtare, nuk i ndihmon sa duhet ruajtjes së gjuhës sa për t'i rezistuar presionit të anglishtes që ndjehet i pranishëm kudo që të sillet njeriu.

⁶⁰ E. Haugen, 1953, f. 237.

INTERFERENCA FONEMIKE E ANGLISHTES NË SHQIPEN E AMERIKËS

1. Në përgjithësi

Interferenca fonemike, sipas Weinreichut, është dukuri “*kur folësi biling identifikon fonemën e sistemit të dytë me fonemën e sistemit të parë, dhe duke riprodhuar atë, ua nënshtron rregullave fonetike të gjuhës së parë*”.¹

Shumë gjuhëtarë kanë ardhur në përfundim se ai që përdor elemente gjuhësore të huaja, i zëvendëson tingujt e gjuhës së huaj me tingujt më të afërt (të ngjashëm) të gjuhës së vet.

Kemi konstatuar se interferenca gjuhësore në rrafshin fonemik paraqitet te folësit bilingë ndër shqiptarët e Amerikës, pa marrë parasysh cilën gjuhë e kanë të parë, shqipen apo anglishten. Mirëpo, në këtë studim nuk do të shfaqim interesim për interferencën e atyre folësve, të cilëve u është ndikuar anglishtja, por vetëm të atyre folësve, të cilëve u është ndikuar shqipja.

Nuk do ta përshkruajmë fonologjinë e asnjërës gjuhë në hollësi. Problemet fonematike të çdo gjuhe do të shqyrtohen këtu vetëm aq sa është e domosdoshme për qëllimet praktike për një krahasim të përgjithshëm midis këtyre dy fonologjive. Shqyrtimi mund të thellohet në disa çështje të posaçme me interes për këtë studim, por ai do të jetë bukur i përgjithshëm në pikat e tjera.

Interferenca fonematike fillon posa shqipfolësi i Amerikës ta huazojë një fjalë nga anglishtja në gjuhën e vet, domethënë, në kontaktin e tij të parë me anglishten. Interferenca e këtij lloji vazhdon të bëhet më e begatshme, siç ecën shqipfolësi i Amerikës, drejt bilinguizmit të plotë.

Gjatësia e periudhës së interferencës dhe shkalla e saj varen nga shumë faktorë gjuhësorë dhe jogjuhësorë dhe dallojnë nga një individ te tjetri. Megjithatë, ekziston një mesatare e përgjithshme midis folësve të shqipes të një treve dhe të një brezi të caktuar. Interferenca këtu mund të ketë të bëjë me shqiptimin, theksin, rishpërndarjen dhe

¹ U. Weinreich, 1953 (rishtypur në vitin 1963), f. 14.

importimin e fonemave nga gjuha marrëse. Lista e inventarit të fonemave të të dyja gjuhëve, e dhënë në pasqyrën më poshtë, mund t'i ndihmojë lexuesit të përftojë një ide të përgjithshme për pikat e ngjashmërisë dhe të dallueshmërisë së tyre.

Llojet	Dybu- zore	Buzore- dhëm- bore	Ndër- dhëm- bore	Palatale (Qiellë- zore)	Alveo- palatale	Mesgju- hore	Velare (Para- gjuhore)	Grykore (Farin- gale)
	A Sh	A Sh	A Sh	A Sh	A Sh	A Sh	A Sh	A Sh
Eksplozive të shurdhëta	p p			t t		- q	k k	h h
të zëshme	b b			d d		- q	g g	
Fërkimore shteg.								
të hurdhëta		f f	θ θ	s s	ʃ ʃ			
të zëshme		v v	ð ð	z z	ʒ ʒ			
Afrikate të shurdhëta				- c	tʃ tʃ			
të zëshme				- x	dʒ dʒ			
Hundore	m m			n n		- n		
Laterale				l ll	-			
				r r	λ			
				- rr				
Glide	w -					j j		

PASQYRA 1

Bashkëtingëlloret e anglishtes dhe të shqipës të krahasuara

Në këtë studim kemi të bëjmë kryesisht me ndikimin e anglishtes në të folurit shqip të shqiptarëve të Bostonit dhe të rrethinës së tij. Folësit objekt të këtij studimi janë kryesisht shqiptarë, që kishin emigruar para Luftës II Botërore dhe brezi i dytë i tyre, të cilët, në të vërtetë, janë brezi i parë i lindur në Amerikë. Ka mundësi të gjenden huazime angleze në të folurit e tyre që njëherësh janë të pranishme edhe në shqipen standarde, por të cilat ata nuk i dinë për shkak të mungesës së kontaktit me atdheun e tyre. Prandaj ka shumë folës të shqipës së Amerikës, që bëjnë përpjekje të mëdha për t'i përshtatur edhe ato huazime angleze që janë huazuar dhe përshtatur gjuhësisht qysh përpara në shqipen standarde. Disa shembuj të dhënë mund ta sqarojnë këtë çështje.

Huazimi 'ping-pong', i cili fare lehtë ka gjetur rrugën në shqipen standarde si *pingpong*, shqiptohet me një pasiguri bukur të madhe nga disa folës të shqipës të Amerikës, ndërsa në gjuhën e shkruar përdoret me trajta të ndryshme drejtshkrimore, b.f. me thonjëza ("ping-pong"), me kllapa ((ping-pong)), me vizë ndarëse (ping-pong), me shkronjë të madhe

(Ping-pong) etj., e gjithë kjo për ta shënuar si element të huaj. Kur përdoret ky emër në trajtë të shquar, mbaresa *-u* ndahet me vizë, e ndonjëherë tjetër shënohet me mënyra të tjera të të dalluarit. Paraqiten vështirësi të ngjashme me huazime të tjera shumë të njohura sot për secilin që flet shqip në Shqipëri e në Kosovë, siç janë, *ragbi, nokdaun, brixh, boks*, e ndonjë tjetër.

Një dukuri tjetër interesante që e ka vërejtur Simani² në dialektet e greqishtes, vlen edhe për folësit e shqipes në trevën objekt të këtij studimi. Është një tendencë e përgjithshme për rrafshimin e nëndialekteve e të të folmeve të ndryshme të shqipes në SHBA. Kjo dukuri shkaktohet pjesërisht për arsye se përfaqësuesit e nëndialekteve dhe të të folmeve të ndryshme, siç janë ata të Devollit, të Korçës, të Përmetit etj., ndodh të jetojnë në fqinjësi dhe të vijojnë të njëjtat ceremoniale fetare dhe kombëtare dhe, pak a shumë, lexojnë të njëjtat gazeta. Është po ashtu karakteristikë e përbashkët e të gjithë atyre që t'u dobësohet kompetenca gjuhësore e shqipes. Ky rrafshim i nëndialekteve dhe i të folmeve të shqipes mund të bëhet një temë interesante për punë hulumtuese të mëtejme, por ne këtu nuk do të merremi më shumë me këtë çështje gjuhësore.

Shqipja ka 36 fonema, nga të cilat 7 janë zanore dhe 29 bashkëtingëllore. Anglishtja amerikane, nga ana tjetër, ka 50 fonema,³ nga të cilat 22 janë zanore (17 të thjeshta dhe 5 diftongje) dhe 28 janë bashkëtingëllore. Nga pasqyra e zanoreve mund të përfundohet se thuaia të gjitha zanoret e shqipes, pos [y], i kanë ekuivalentet e tyre në anglishte, gjë që nuk vlen për drejtimin e kundërt, sepse anglishtja ka më shumë fonema zanore se shqipja.⁴ Shqipja po ashtu ka diftongje, por studiuesit e albanistikës nuk i konsiderojnë ato fonema; ato quhen grupe zanoresh. Pa marrë parasysh terminologjinë, ato diftongje mund të zëvendësohen me diftongjet e shqipes pa ndonjë vështirësi, natyrisht nëse përbëhen nga zanore të afërta ose të ngjashme me të shqipes. Gjatësia e zanoreve nuk ka vlerë fonematike në gjuhën shqipe të sotme, por këtë e ka në dialektin geg. Në përgjithësi, pos fonemave [æ] dhe [ɛ] të cilat mund të hasen edhe si alofone të fonemës /e/ në disa nëndialekte dhe të folme, ndonëse jo në nëndialektin në shqyrtim e sipër, çdo zanore tjetër teorikisht dhe praktikisht mund të shqiptohet pa ndonjë vështirësi nga folësi i shqipes, prandaj dhe mund të përvetësohet në të folurit e tij së bashku me huazimet e anglishtes.

² P. Seaman, 1970, p. 126.

³ Kur të krahasohen të dy sistemet e zanoreve, mund të shihen dallime cilësore dhe sasiore.

⁴ Këtu nuk e kemi përfshirë fonemën angleze (amerikane) [ð^r] sepse ajo është zëvendësuar me kombinimin e shqipes amerikane (zanore + r), sipas shkrimit.

2. Zanoret

Nëse krahasohen zanoret e të dyja gjuhëve, mund të përfundohet se emigrantët shqiptarë nuk hasin në vështirësi të veçanta për shqiptimin e përafërt të zanoreve të anglishtes, përkundër faktit se shqipja ka numër bukur më të vogël të zanoreve. Kjo domethënë se 14 fonemat zanore të thjeshta të anglishtes amerikane mund të përmbliken në 6 zanore të shqipes (pra, duke përfshirë [y] që nuk ka ekuivalent në anglishte), siç mund të vërehet nga sa vijon:

Anglisht	Shqip
[i] dhe [i:]	[i]
[e] [æ] dhe [ɛ]	[e]
[ə] dhe [ə:]	[ë]
[a] [a:] dhe [ʌ]	[a]
[o] dhe [o:]	[o]
[u] dhe [u:]	[u]

Mirëpo, ky krahasim është vetëm teorik. Në praktikë, gjatë përshtatjes së fonemave zanore të anglishtes në ato të gjuhës shqipe marrin pjesë shumë faktorë. Ndikimi i shkrimit të fjalëve është i dukshëm në shumë raste të përshtatjes fonematike të zanoreve të anglishtes në gjuhën objekt të këtij studimi, ndërsa vendi i theksit në fjalët shqipe ka po ashtu ndikim të veçantë.

Përshkrimi fonetik ndërlikohet për arsye se emigrantët shqiptarë, të cilët mund të huazojnë elemente gjuhësore nga anglishtja në gjuhën e tyre, nuk i përshtatin gjithmonë ata në të njëjtën mënyrë. Që me kontaktin e tyre të parë me anglishten duket se bëjnë shtrembërim të madh të elementeve gjuhësore të anglishtes, kurse më vonë, në rrjedhë të kohës, fillojnë ta zotërojnë gjuhën e dytë gjithnjë më mirë dhe ashtu mësohen me të dhe i përvetësojnë dhe përshtatin elementet e saj shumë më ndryshe, duke iu afruar mjaft gjuhës dhënëse. Këtu ka rëndësi, po ashtu, shkalla e bilinguizmit, i cili është i pranishëm ndër emigrantët shqiptarë të Amerikës. Meqenëse e kishim të pamundur të gjurmonim procesin e interferencës së fjalëve individuale ose të çdo elementi tjetër gjuhësor, në disa raste vetëm mund ta marrim me mend në bazë të disa të dhënave dhe faktorëve që mund të kenë ndikuar në to. Një qasje ndaj kësaj çështjeje, ndonëse jo edhe aq adekuate, ishte studimi i materialeve të shkruara më herët në shqipen e Amerikës, ku njeriu mund të shohë paraqitjet e para të fjalëve të anglishtes. Ato huazime kanë qenë shumë më të pakta në fillim, por kanë qenë përshtatur

shumë më afër mundësive fonematike të gjuhës shqipe, sesa huazimet që kanë hyrë më vonë në këtë shqipe.

Shpesh ndodh që një gjedhe e anglishtes të ngelë në trajtë të pasigurt gjatë një kohe, pasi të jetë huazuar në gjuhën shqipe të Amerikës. Ajo mund të marrë trajta të ndryshme të replikës kompromise me ngjashmëri më të madhe a më të vogël me gjedhen. Kjo ka të bëjë si me zëvendësimin fonetik, ashtu edhe morfemik.⁵ I tillë është rasti me huazimin *agendë* ose *agjendë* (rend i ditës), trajta e dytë, siç shihet, pas përshtatjes fonemike i është nënshtruar edhe palatalizimit të shqipës [g] > [gj]. Ka edhe shumë shembuj të tjerë në shqipen e Amerikës, siç janë *aplikatë* dhe *aplikacion* (paraqitje për ndonjë post, punë, regjistrim etj.), e para i është nënshtruar përshtatjes më të madhe, sesa vetëm fonemike, d.m.th., ajo ka ndryshuar plotësisht në përputhje me shumë fjalë të tjera të shqipës me origjinë të huaj, siç janë *deklaratë*, *administratë* etj. E njëjta mënyrë e përshtatjes bie në sy edhe në këto fjalë: *korporacion* dhe *korporatë*, *observacion* dhe *observatë*, *restoracion* dhe *restoratë*, *investigatë* (por nuk e kemi hasur në trajtën e mundshme *investigacion*) etj.

Të huazuarit e fjalës angleze *chairman* meriton shqyrtim të veçantë. Ajo fjalë ka marrë disa trajta në shqipen e Amerikës si: *çairman*, *çairmen*, *çermen*, *çarmen*. Po ashtu fjala angleze *club* ka marrë trajta të ndryshme në shqipe: *klub*, *kllub*, *kllup*. Fjala *dance* është huazuar si: *dancë*, *dencë*, *densë*. Huazimi i fjalës *English* sigurisht paraqitet me spektrin më të gjerë të replikës kompromise: *engleshqe*, *engleshte*, *englisht*, *inglisht*, *inglishçe*, *inglishqe*, e ndonjë tjetër. Këto trajta mund të kenë pasuar nga kontakti i gjatë gjuhësor gjatë të cilit e njëjta fjalë është bartur në shqipen e Amerikës në mënyra të ndryshme nga folës të ndryshëm.⁶

Në rrjedhë të përshtatjes fonematike të huazimeve angleze në shqipen e Amerikës, fonemat e shqipës, si zanoret ashtu edhe bashkëtingëlloret, i kanë zëvendësuar fonemat angleze, pos disa rasteve për të cilat do të flitet më poshtë. Ndonëse fonemat e këtyre dy gjuhëve nuk kanë tipare fonetike të njëjta, disa prej tyre dallojnë vetëm pak, ndërsa të tjerat dallojnë qartë, kemi pranuar si parim të përgjithshëm që fonemat angleze më të afërta me ekuivalentet e shqipës janë zëvendësuar me fonema të shqipës, siç janë: a[t] > sh[t]; a[m] > sh[m]; a[e] > sh[e] etj.

⁵ E. Haugen, 1956, p. 55; R. Filipović, 1958; R. Filipović, *Phonemic Importation*, 1960; sidomos R. Filipović, *Principi lingvističkog posudjivanja III*, Semantički aspekt, Filološki pregled, I-IV, Beograd, 1967.

⁶ E. Haugen, 1953, ff. 392-3; E. Haugen, 1956, f. 56; U. Weinreich, 1953, f. 27.

Mirëpo, kurdo që ekzistojnë dallime më të mëdha midis dy fonemave 'ekuivalente' në këto dy gjuhë, kemi bërë përpjekje të japim disa të dhëna që kanë të bëjnë me ato dallime, siç është importimi i a[l] > sh[l], në të cilin rast sh[l] është shumë më qiellzore, ose a[r] > sh[r], kur sh[r] është lateral, ndërsa a[r] është vibrante (dridhëse) etj.

Nga kjo del se nuk kemi ndërmend të përkruajmë fonemat e të dyja gjuhëve në hollësi, meqë një punë të tillë e konsiderojmë të parëndësishme për qëllimin e kontaktit të gjuhës ashtu si është pararenduar në këtë studim. Në vend të kësaj, jemi përqendruar më së shumti në ato raste kur fonemat e ndryshme të shqipes kanë zëvendësuar fonema të ndryshme të anglishtes për shkak të rrethanave të ndryshme gjuhësore, për të cilat do të bisedojmë kurdo qoftë që ka mundësi, kur janë të mundshme të jepen fakte relevante. Do të bëjmë përpjekje, po ashtu, të studiojmë më hollësisht çështjen e përshtatjes fonemike, sidomos zëvendësimin si ndikohet nga drejtshkrimi.

Në përshtatjen fonemike, pas shqiptimit, drejtshkrimi ka ndikim të madh. Këtë çështje e konsiderojmë me rëndësi gjuhësore në procesin e përshtatjes së huazimeve, ndonëse Weinreich⁷ e kishte klasifikuar ndikimin e drejtshkrimit në shqiptimin e gjuhës burimore nën kategorinë e faktorëve ekstralinguistikë. Drejtshkrimi, si dhe gjetiu, ka ndikuar shumë në procesin e përshtatjes së huazimeve të anglishtes në të folurit e shqipes së Amerikës. Ndonëse përshtatja fonemike në bazë të drejtshkrimit është më e evidente në gjuhët që nuk kanë kontakt të drejtpërdrejtë me njëra-tjetrën, për emigrantët shqiptarë të Amerikës kjo megjithatë është një fakt i qartë. Ky mjet i përshtatjes në procesin e interferencës gjuhësore mbështetet edhe nga fakti se shqipja shkruhet pak a shumë në formë fonemike, domethënë se një shkronjë paraqet një fonemë.⁸ Kjo e dhënë ndikon që folësit të mësohen të mbështeten deri diku në drejtshkrim. Kjo mund të jetë sidomos e vërtetë në ato raste kur është vështirë të shqiptohen disa sekuenca fonemike që nuk janë të njohura në gjuhën e parë (burimore) të folësit. Në rastin tonë të posaçëm, një arsye tjetër pse folësit zgjedhin drejtshkrimin si një mënyrë të përshtatjes fonemike është njohja paraprake e një gjuhe tjetër, si f.v., e frëngjishtes, disa fjalë të së cilës kanë shkrim të ngjashëm me anglishten por shqiptim tjetër. Prandaj, hasim në shumë raste kur janë përshtatur huazimet në mënyrë analoge me përshtatjen e

⁷ Uriel Weinreich, *On the Description of Phonic Interference*, Word, Vol. 13, No.1, p. 2, New York, 1957.

⁸ Janë nëntë digrame që vazhdimisht paraqesin në mënyrë konsistente vlerat e njëjta fonematike.

huazimeve të frëngjishtes në shqipen standarde, d.m.th., me zëvendësimin e *-(a)tion* me *-(a)cion* në vend se me *-(ei)shën*. Shumë shembuj të këtij lloji janë dhënë në shkrimin mbi interferencën leksikore në këtë botim.

3. Zëvendësimi i fonemave zanore

Zëvendësimi i fonemave bashkëtingëllore nën ndikimin e drejtshkrimit mund të ilustron me nga disa shembuj për secilin rast.

- [ʰ] > [a]: certificate [ˈsə:ʰtəfɪkɪt] > *sertifikatë*; manager [ˈmænɪdʒəʰ] > *manaxher*; passage [ˈpæsɪdʒ] > *pasazh*; sondage [ˈsndɪdʒ] > *sondazh* etj.
- [ə] > [e]: abnegation [ˌəbnəˈgeɪən] > *abnegacion*.
- [i] > [e]: event [iˈvent] > *eventë*; English [ˈɪŋɡli] > *engleshqe* etj.

Shembulli: impinge [ɪmˈpɪndʒ] > *impenjoj*, nuk tregon këtë zëvendësim sipas drejtshkrimit; këtu duhet të ketë vepruar ndonjë faktor tjetër.

- [æ] > [a]: act [ækt] > *aktoj*; yankee [ˈjæŋki] > *janki*; cafeteria [ˌkæfəˈtɪrə] > *kafeteria*; gallon [ˈgælən] > *gallon* etj.

Është vetëm një numër i vogël i huazimeve, në të cilat zanorja [æ] është zëvendësuar në përputhje me shqiptimin e saj, domethënë, me ekuivalentin e saj më të afërt [ɛ], por në gjuhën shqipe standarde ky alofon i përket fonemës [e], si b.f.:

- cash [kæ] > *kesh* (por edhe: *kashë*), dance [dæns] > *dencë*, por edhe – *dancë*, stamp [stæmp] > *stempë* (por edhe – *stampë*), broadcast [ˈbr:dˌkæst] > *brodkest*.

Zëvendësime të tjera janë:

- a) [u] > [u]: adults [əˈdʌts] > *adultër*, club [klʌb] > *kllub*, gulf [ɡʌlf] > *gulf*, insult [ˈɪnslt] > *insulltoj*, currency [ˈkræns] > *kurrenci* etj.
- b) [o] > [o]: comfort [ˈkɒmfəʰt] > *konfort*, govern [ˈɡvəʰn] > *governë*.
- c) [ə] > [a]: admit [ədˈmɪt] > *admitoj*, apartment [əˈpɑ:ʰtmənt] > *apartiment*; anniversary [ˌæniˈvɜ:səri] > *aniversari*; balance [ˈbæləns] > *ballancë*; brigand [ˈbrɪɡənd] > *brigand* etj.

Shumë pak shembuj të huazimeve angleze tregojnë zëvendësimin e [ə] angleze me [ë] shqipe, si b.f.:

- a) elevator [ˈlæveɪtəʰ] > *elëvatë*; dhe agenda [əˈdʒendə] > *agjendë* etj.
- b) [ə] > [u]: common [ˈkɒmən] > *komun* (i rëndomtë); custom [ˈkʌstəm] > *kostum* (adet, zakon) etj.

Në këta shembuj nuk janë përshtatur plotësisht nën ndikimin as të shkrimit as të shqiptimit.

Përshtatja e [æ] me [o] është bërë po ashtu pjesërisht sipas shkrimit dhe pjesërisht sipas shqiptimit në këto raste:

generous [ˈdʒænərəs] > *xheneros* (bujar); gallon [ˈgælən] > *gallon*; police [pəˈli:s] > *policë* etj.

Fonema angleze [ə^r] përndryshe është zëvendësuar kryesisht me dy ose më shumë fonema të shqipes, natyrisht nën ndikimin e drejtshkrimit. Kemi hasur në shembujt dhe mënyrat vijuese:

- a) [ər] > [ar]: dollar [ˈdlər] > dollar; radar [ˈreidər] > radar; triangular [traɪˈæŋgələ] > *triangolare* etj.
- b) [ə^r] > [er]: banker [ˈbæŋkə] > *banker*; governor [ˈgvəˈnə^r] > *governer*; intercept [ˌɪntəˈsept] > *intersepto* etj.
- c) [ə^r] > [or]: comfort [ˈkɒmfə^rt] > *komfort*; director [dɪˈrektə^r] > *direktor*; editor [ˈeditə^r] > *editor*; translator [trænsˈleɪtə^r] > *trasllator* etj.

Vetëm një shembull është gjetur i zëvendësimit [ə^r] > [ur]: nurse [nɜː^rs] > *nursa*.

Me gjasë përshtatja më e afërt e kombinimeve me [r] që vijon pas një zanoreje është bërë në shembujt vijues:

- a) [ə^r] > [ër]: advertize [ˈædvə^rtaɪz] > *advërtajz*; monster [ˈmnsə^r] > *monstër*; perform [pə^rfɔːm] > *përformoj* etj.
- b) [a^r] > [ar] > apartment [əˈpɑːtmənt] > *apartiment*; department [dɪpɑːtmənt] > *departiment*; embark [ɪmˈbɑːk] > *imbarkoj*; martial [ˈmɑːʃəl] > *marcial*; yard [jɑːd] > *jardë* etj.

Diftongjet e anglishtes po ashtu janë përshtatur në mënyrë fonemike sipas mjeteve drejtshkrimore në shqipen e Amerikës. Disa shembuj janë:

- [ai] > [i]: advisor [ədˈvaɪzə^r] > advisor; citation [saɪˈteɪən] > citacion; compromise [ˈkɒmprəmaɪz] > kompromizoj; digestion [daɪˈdʒestən] > digjestion etj.

Në të njëjtat huazime mund të ndeshen dy tipa të zëvendësimit fonemik: sipas shqiptimit dhe sipas shkrimit. Për shembull: retire [rˈtaɪə^r] > *ritiroj* (dal në pension), [i] e parë është bartur në mbështetje të shqiptimit, domethënë, në mbështetje të vlerës fonemike, meqenëse [i] është ekuivalenti më i afërt me [i] e anglishtes amerikane, ndërsa [i] e dytë e shqipes ka zëvendësuar diftongun e anglishtes [ai], në mbështetje të shkrimit.

Bie në sy edhe zëvendësimi me fonema ose me diftongje të gjuhës shqipe i bërë nën ndikimin e shkrimit të fjalëve të anglishtes, si b.f :

- a) [ɪ] > [a]: football [ˈfʊtbɔ:l] > *futball*; hall [h:l] > *hallë* etj.
 b) [ɪ] > [au]: cause [k:z] > *hauzë*; inaugural [inˈgʃərəl] > *inaugural*; audience [ˈdiəns] > *audiencë*; precautionary [priˈkəʊnəri] > *prekaucional* etj.
 c) [ju] > [u]: community [kəˈmjuntɪ] > *komunitet*; confuse [kənˈfju:z] > *konfuzoj*; universe [ˈjunvəːs] > *universë* etj.

Por kjo nuk bëhet gjithherë. Ka raste të tjera, siç janë:

university [ˌjuːnəˈvɜːsti] > *universitet*,
 unanimously [juˈnænəməsli] > *junanimisht*.

Nën ndikimin e shkrimit, fonema [y] e shqipes, e cila nuk ekziston fare në sistemin fonemik të anglishtes, është imponuar ndonjëherë në huazimet e anglishtes, meqenëse haset në shkrimin e fjalëve të asaj gjuhe. Janë hasur shembuj me zëvendësime të tilla, si:

hypnotism [ˈhɪptɪzɪzəm] > *hypnotizëm* dhe physicist [ˈfɪzɪsɪst] > *fyzicist*.

Këto zëvendësime të fonemës [y] janë bërë, natyrisht, nën ndikimin e shkrimit të fjalëve të anglishtes.

4. Zëvendësimi i fonemave bashkëtingëllore

Zëvendësimi i fonemave bashkëtingëllore në huazimet e anglishtes në shqipen e Amerikës është bërë edhe me ndikimin e drejtshkrimit. Këtu do të jepen disa shembuj për çdo rast të zëvendësimit të tillë, ashtu siç janë gjetur në materialin e mbledhur, për ta vënë në dukje këtë çështje:

[s] > [c]: assistance [ˈæsɪstəns] > *asistencë*; dance [dæns] > *dencë*; ounce [aʊns] > *once* po ashtu dhe *onçe*; police [pəˈli:s] > *policë*; proceed [prəˈsi:d] > *procedoj* etj.

Mirëpo, mund të hasen shumë raste të zëvendësimeve fonemike të kësaj bashkëtingëlloreje në të folurit shqip të Amerikës të bërë nën ndikimin e shqiptimit, siç tregojnë shembujt vijues:

cent [sent] > *sent*; ceremony [ˈserəməni] > *seremoni*; grocery [ˈgrɔːsəri] > *grosari*; certificate [ˈsəːtɪfɪkət] > *sertifikatë*; decency [ˈdisənsi] > *deisensi* etj.

Fonema [dʒ] është zëvendësuar me [zh] në këto huazime: message [ˈmesdʒ] > *mesazh*; passage [ˈpæsɪdʒ] > *pasazh*; vantage [ˈvæntɪdʒ] > *vantazh* etj. Besojmë se ky lloj zëvendësimi i [dʒ] me [zh] është bërë nën ndikimin e huazimeve frënge tradicionale në gjuhën shqipe. Prandaj duket se përvoja e periudhës para emigrimit ka pasur ndikim edhe më vonë te shqiptarët e Amerikës.

Mirëpo, përkundrazi, ka raste (ndonëse në numër të kufizuar) të të huazuarit kur [xh] e shqipes e ka zëvendësuar [dʒ] e anglishtes, si b.f.:

subject [ˈsbdʒəkt] > *sub**x**həkt*; gest [dʒest] > ***x**hest*; generous [ˈdʒənərəs] > ***x**həneros*.

Weinreichu ka vënë në dukje se “kurdo që folësi biling i klasifikon tiparet e tingujve si të ndryshëm, që në gjuhën burimore janë redundante, ose nuk ekzistojnë fare si tipare të tilla; kjo dukuri quhet mbidallim” (over-differentiation).⁹ Kjo dukuri gjuhësore është paraqitur në rrjedhë e sipër të përshtatjes së huazimeve të anglishtes, do të thotë, të fonemave të kësaj gjuhe në shqipen e Amerikës. Kështu, fonema [dʒ] e anglishtes është zëvendësuar me [gʒ] të shqipes në disa huazime. Disa shembuj të dhënë mund ta ilustrojnë këtë dukuri:

agenda [əˈdʒendə] > *ag**j**endë*;
generosity [ˌdʒənəˈrɪsɪ] > *g**j**enerositet*;
genteel [ˈdʒenˈti:l] > *g**j**entil*;
sergeant [ˈsaːˈdʒənt] > *sarg**j**ent* etj.

Ndonjëherë këto huazime përshtaten fonemikisht edhe me zëvendësim të [dʒ] angleze me [xh] të shqipes.

Në përshtatjen e huazimeve që kanë në trup fonemën [w], bëhet procesi i nëndallimit (under-differentiation).¹⁰ Kjo ndodh për shkak se shqipja nuk ka fonemë [w], prandaj mbeten dy mënyra për t’u përshtatur ajo - të zëvendësohet me [v] ose me [u] të shqipes. Sipas rregullave të drejtshkrimit të shqipes në fuqi, fonema [w] në fjalët të huaja duhet të zëvendësohet me [u] të shqipes.¹¹ Mirëpo, kjo çështje, përveç të tjerash, krijon vështirësi që të realizohet parimisht, sidomos atëherë kur pas saj vijon zanorja [u] në fjalët e huazuara, si f.v.: *Holiwood* > *Holiuud* (?), *Woodrow* > *Uudrou* (?) etj. Megjithatë, gjendja e huazimeve të përshtatura në shqipen e Amerikës tregon se kjo fonemë, rëndom, zëvendësohet me fonemën [v] të shqipes. Ka shumë shembuj, por disa prej tyre që mund ta ilustrojnë këtë çështje do të ishin:

⁹ U. Weinreich, 1953, f. 18 dhe 1957, f. 5.

¹⁰ U. Weinreich, *Po aty*.

¹¹ Ndonëse në Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe nuk ishte thënë në mënyrë të veçantë se si duhet të zëvendësohet a shkruhet gjysmëzanorja angleze [w], përveç që nën paragrafin 37, f. 105, ishte dhënë shembulli *Uashington*, në praktikë vazhdoi që në fjalët me fonemën [w] kjo të shënohet përkatësisht zëvendësohet me [u], kurse diftongjet zëvendësohen: [wa] me [ua] (*Uashington*), [we] me [ue] (*Uestern*), [wi] me [ui] (*uikend*), [wo] me [uo] (*Uollstrit*), madje haset dhe rasti absurd [wu] i zëvendësuar me [uu] në një fjalor të gjuhës anglisht-shqip.

sandwich [ˈsændwɪtʃ] > *sandviç*; tramway [ˈtræmwei] > *tramvaj*; waggon [ˈwæɡən] > *vagon* etj.

Shumë pak shembuj nga shqipja e Amerikës dëshmojnë zëvendësimin e fonemës angleze [w] me [u] të shqipes, si f.v.:

quarter [ˈkw:ˈtɚ] > *kuarter*.

Duket se zëvendësimi i [w] angleze me [v] të shqipes, është shumë më i arsyeshëm se zëvendësimi me [u] të shqipes, siç tentohet me rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe.¹² Ekzistojnë disa arsye për një përshtatje të tillë, në mes të të cilave janë sidomos:

1) fonema [w] nuk është zanore në gjuhën angleze për shkak se nuk mund të formojë rrokje;

2) në zëvendësimin e [w] angleze me [u] të shqipes duhet patjetër të ketë përjashtime, siç është rasti kur ajo i paraprin zanores [u], siç u theksua më sipër për fjalët *Holiwood* > *Holivud* e jo *Holiuud*; *Wolf* > *Vulf* e jo *Uulf*;

3) në shqipe nuk gjendet asnjë fjalë e mirëfilltë që fillon me diftongjet:

[ua-]: *Uashington* < Washington, *Uajthaus* < White House,
 [ue-]: *uestern* < western, *uelter* < Welter,
 [ui-]: *uikend* < weekend, *uiski* < whisky,
 [uo-]: *Uolt Strit* < Walt Street, *Uoren* < Worren etj.

Prandaj zëvendësimi i fonemës angleze [w] me [u] të shqipes u krijon shqipfolësve vështirësi të veçanta për ta shqiptuar.

Anglishtja e Amerikës ka vetëm një fonemë likuide [l], ndërsa shqipja ka dy të ngjashme me të, por asnjëra nuk është plotësisht si ajo fonemë e anglishtes. Gjegjësisht, shqipja ka [l] dhe [ll], e dyta shpesh e quajtur nga gjuhëtarët si [l] e mbyllët, ndërsa e para si [l] e hapët. Mirëpo, shumë shqiptarë të Amerikës, sidomos ata të brezit të dytë, e kanë vetëm një fonemë [l] në ligjërimin e tyre në shqip, dhe ajo është e ngjashme me [l] të anglishtes. Këtu japim disa shembuj ashtu siç janë regjistruar në të folurit e informatorit (32), por ka edhe informatorë të tjerë të ngjashëm me këtë:

një kllasë; llegendë; Vllora; fllamuri; kalluar etj.

Informatorët e tillë nuk mund të shqiptojnë as disa fonema të tjera të shqipes, të cilat nuk ekzistojnë në sistemin fonologjik të anglishtes. Kjo është për shkak se gjuha e tyre e parë është anglishtja. Fonema të tilla janë:

¹² V. Nuhiu, *Interferenca fonemike e anglishtes në shqipen e Amerikës*, Filologji, nr. 5, ff. 81-98, Fakulteti i Filologjisë i UP, Prishtinë, 1998; V. Nuhiu, 1976.

eksplozivët qiellzore [q] dhe [gj]. Për shembull, informatori (17) nuk mund të shqiptonte fonemën [gj], por në vend të saj përdorte grupin [g-j], si b.f.:

- (1) You see, kanë sevda të dijnë një **g-juhë** tjetër.
- (2) Edhe njerëzit na **dëg-jonin** si me çudi...

Fonema [q] në shqipen e Amerikës bukur shpesh zëvendësohet me fonemën [k] të shqipes. Për shembull:

- (3) So, he also është në librat në *Shqipëri*.
- (4) Neve flasim *shkip*.
- (5) Këtu **g-juhën shkip** nuk e dinja.

Informatori (17) përdorte ndonjëherë [jk] në vend të [q] të shqipes, për shembull:

- (6) Po *shojket, shojket*, kur të dinë...

Tek ata shqiptarë të Amerikës, të cilët e kanë anglishten gjuhë të parë, ose gjuhë mbizotëruese, nuk dëgjojnë fare fonema [c]. Ata e zëvendësojnë atë me fonemën [s]. P.sh.:

- (7) - Si thoni, *sigare* apo *sigaretë*?
- *Cigare*. (autori)
- Ah, *sigare*.

- (8) Neve bëmë disa gjëra për *selebrim*.

Në këtë të folme dhe thua ja në gjithë dialektin e toskërishtes në Shqipëri fonema [rr] thua ja se nuk dëgjojnë. Në vend të saj përdoret fonema [r], pra është bërë rrafshimi i atyre dy fonemave, ndonëse kjo dukuri ndonjëherë mund të krijojë fjalë homofone që kanë kundërvënje fonemike në shqipen standarde. Kjo dukuri është e pranishme në ligjërimin e shqipfolësve të Amerikës objekt të këtij studimi. S'do mend se këtë dukuri në Amerikë e ka forcuar edhe më shumë fakti se anglishtja nuk ka [rr] në sistemin e saj fonemik.

Në këtë dialekt fonema [h] është shumë e dobët dhe shpesh zhduket në ligjërimin e folësve të gjuhës shqipe. Por kjo nuk ka pasur ndonjë efekt në fjalët e anglishtes që përmbajnë fonemën [h]; domethënë, ajo fonemë shqiptohet gjithmonë drejt në fjalët angleze që e kanë, qoftë të jenë përshtatur apo të mos jenë përshtatur në mënyrë fonemike. Kështu mund të hasen fjalët: *humor*, *hinterland*, *homazh* etj.

Gjatë procesit të përshtatjes së huazimeve angleze në të folurit shqip të Amerikës, bëhen disa përpjekje të natyrës fonemike për t'ia përshtatur sistemin e anglishtes rregullave fonetike të shqipes, gjë që do ta shqyrtojmë më poshtë. Weinreichu kishte vërejtur se sekuencat e panjohura të tingujve folësi i përshtat sipas atyre sekuencave që i

njuh,¹³ domethënë sipas tingujve të gjuhës së tij burimore. Prandaj, janë vënë re shumë dukuri fonetike gjatë rrjedhës së përshtatjes së huazimeve angleze në shqipen e Amerikës.

5. Palatalizimi

Eksplzivet velare të shqipes [k] dhe [g] në pozitën para zanoreve të përparme [i] dhe [e] palatalizohen në eksplozive [q] përkatësisht [gj]. Nuk gjenden shumë shembuj për këtë rregull fonetike ndër huazimet e anglishtes në ligjërimin e shqipfolësve të Amerikës. Ja disa:

[k] > [q]: market [ˈmaːˈkət] > *marqetë*; ticket [ˈtikət] > *tiqetë etj.*

Palatalizimi i fonemave bashkëtingëllore [k] dhe [g] zbatohet edhe në trajtën e shumësit të disa emrave që mbarojnë me këto bashkëtingëllore:

[paːˈk] > *park* – *parqe*, meeting [ˈmiːti] > *miting* – *mitingje*, parking [ˈpaːˈki] > *parking* – *parkingje etj.*

6. Metateza

Procesi i metatezës ka ndodhur me gjasë për shkak të togjeve të bashkëtingëlloreve të panjohura ose të rralla në shqipen e Amerikës. Kemi hasur, për shembull, në fjalën garden [ˈgaːˈdæn] > *gradinë*.

7. Tinguj epentetikë

Në disa huazime janë ndërfutur disa tinguj epentetikë (zanore) për t'i ndërprerë togjet e bashkëtingëlloreve, të cilat janë bartur me anglizmat në shqipen e Amerikës. Kjo tregon se shqipja nuk ka prirje të madhe të ketë togje me shumë bashkëtingëllore. Arsye mund të jetë se togjet e tilla janë të rralla dhe mbase nuk ekzistojnë në sistemin fonemik të gjuhës shqipe. Nuk kemi të dhëna të sakta mbi përndarjen e fonemave të shqipes, prandaj nuk mund të themi asgjë me siguri të madhe. Kishim provuar më herët të konstatojmë diçka mbi përndarjen e fonemave të gjuhës shqipe,¹⁴ por rezultatet e arritura nuk i konsiderojmë të mjaftueshme dhe shteruese, prandaj as plotësisht të sigurta. Megjithatë, kemi hasur në shumë raste të thyerjes së togjeve të bashkëtingëlloreve të anglishtes në huazimet e shqipes me anë të zanoreve,

¹³ Uriel Weinreich, *On the Description of Phonic Interference*, Word, Vol. 13, No. 1, New York 1957, pp. 1-11.

¹⁴ V. Nuhiu, *Ndikimi i huazimeve angleze në togjet bashkëtingëllore të shqipes*, Buletini, Fakulteti Filozofik i Universitetit të Prishtinës, nr. 13, ff. 411-432, Prishtinë, 1976.

siç do të shihet më poshtë.

Fonema [i] është ndërftuar në huazimet vijuese të anglishtes për të ndërprerë togjet e bashkëtingëlloreve:

apartment [ə`pa:rtmənt] > *apartiment*; department [di`pa:rtmənt] > *departiment*; investment [in`vestmənt] > *investiment*; debtor [`detə] > *debitor* etj.

Në huazimin *vizhdan* është ndërftuar fonema [d] si tingull epenetetik në huazimin anglez *vision* [ˈviʒən], ndonëse është vështirë të gjendet ndonjë arsye për këtë ndërftje fonemike.

8. Shurdhimi i bashkëtingëlloreve fundore të zëshme

Në të folurit objekt të këtij studimi, domethënë në atë që rrjedh nga Korça dhe rrethina e saj, dhe thuaja në gjithë dialektin e toskërishtes, bashkëtingëlloret e zëshme fundore shurdhohen.¹⁵ Kjo rregull fonetike vepron edhe në disa huazime nga anglishtja në të folurit për të cilin bëhet fjalë këtu. Disa shembuj të dhënë mund ta bëjnë të qartë këtë çështje:

club [klb] > *kllyp*; brigand [ˈbrɪgənd] > *brigant*; post-card [ˈpəʊst,kɑ:ˈd] > *postkartë*; standard [ˈstændəˈd] > *standart* etj.

Përshtatja fonemike e huazimit anglez “level” ngreh një çështje të rëndësishme në rrafshin e fonetikës. Kjo fjalë si huazim në shqipen standarde është *nivel*. Ngjan që ajo fjalë të jetë pjesërisht e huazuar dhe pjesërisht e zëvendësuar. Fonema e parë [l] duhet të jetë huazuar, ndërsa e dyta [i] të jetë zëvendësuar, kurse është vështirë të thuhet për pjesën tjetër të fjalës (-vel) nëse është huazuar apo zëvendësuar, meqenëse trajta origjinale në të dyja gjuhët është e njëjtë - *vel*. Kjo fjalë, pra, është pasojë e njëloj përshtatjeje hibride, ndonëse është fjalë me vetëm një temë. Këtu po japim skemën e saj:

Anglisht: l - e - vel
Shq. amer: l - i - vel
Shq. stand: n - i - vel

Kjo dukuri duhet të studiohet më tutje në praktikën e gjuhëve të tjera. Tani për tani mund të konsiderohet edhe si rezultat i kontaminimit të dyfishtë, nga shkrimi i anglishtes dhe shqiptimi i shqipes standarde, ose i kontaminimit të pjesërishtëm të shkrimit të anglishtes dhe të shqiptimit nga gjuha marrëse.

¹⁵ Jorgji Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSAK-së, Prishtinë, 1975.

9. Theksi në huazimet angleze

Të dyja gjuhët objekt të interferencës në këtë studim kanë theks të ashtuquajtur *dinamik*. Mirëpo, këto dy gjuhë kanë rregulla të ndryshme përkitazi me çështjen e theksit. Rregullat e anglishtes lejojnë liri shumë më të madhe, sesa të shqipes sa i përket vendit të theksit në fjalë të ndryshme, në përgjithësi. Shqipja ka rregulla të përgjithshme sa i përket vendit të theksit në fjalë. Në këtë gjuhë marrëse theksi zakonisht vihet në rrokjen e parafundit ose të fundit të fjalëve. Sipas kësaj rregulle, në procesin e përshtatjes fonemike në shqipen e Amerikës, fjalët e shpërngulin theksin në përputhje me rregullat e shqiptimit të gjuhës shqipe. Prandaj ka raste si këto vijuese, për t'i zënë ngoje vetëm disa nga shumë sosh:

anniversari [ˈæniˈvɜːsəri] > *aniver`sari*,
 brigand [ˈbrɪɡənd] > *bri`gant*,
 cafeteria [ˌkæfəˈtiəriə] > *kafete`ria*,
 elevator [ˌeləˈveɪtəː] > *ele`vatë*,
 promis [ˈprɪmɪs] > *pro`misë*,
 responsible [rɪsˈpɒnsɪbl] > *respon`sibël*,
 superman [ˈsupəˈmæn] > *super`men* etj.

Megjithatë, ka shumë huazime në të cilat theksi mbetet në të njëjtën pozitë si në gjuhën angleze edhe pasi të jetë huazuar në shqipen e Amerikës. Kjo ka gjasa të ndodhë, sidomos, nëse theksi në fjalën e anglishtes është në rrokjen e parafundit ose të fundit. Disa shembuj mund ta bëjnë të qartë këtë çështje:

agenda [æˈdʒendə] > *a`gjendë*,
 attempt [əˈtɛmpt] > *a`tempt*,
 investigation [ˌɪnvɛstˈɡeɪən] > *investi`gatë*,
 negro [ˈniːgrəu] > *`negër*,
 police [pəˈliːs] > *po`licë* etj.

Por këto dy dukuri hasen vetëm në huazimet e përshtatura në mënyrë fonemike. Përkundër kësaj, në fjalët angleze të përdorura nga folësit e shqipes së Amerikës në trajtë të papërshtatur, domethënë, kur ata folës bëjnë transfer kodit, shumë shpesh në vend se të përdorin huazim të anglishtes të përshtatur, ata nuk ndryshojnë asgjë në fjalë, madje as vendin e theksit.

10. Përfundim

Në këtë shkrim u vunë në dukje disa dukuri të ndikimit të anglishtes në rrafshin fonemik. Nga sa u tha më sipër u pa se ndikim më të madh

kishte në grupin e zanoreve me rastin e huazimit të anglizmave. Po edhe bashkëtingëlloret nuk mbeten pa u ndikuar. Anglishtja amerikane, si dhe ajo britanike, ka më shumë zanore, sesa shqipja; raporti është 14 me 7. Prandaj, ndonjëherë dy a tri zanore të anglishtes zëvendësohen me një të shqipes, kurse zanorja [y] e shqipes mbetet e papërfshirë në huazime. Mirëpo, shpesh nuk huazohen anglizmat po me të njëjtat fonema, edhe pse ato ekzistojnë në të dyja gjuhët. Ndërsa shqipja ka më shumë bashkëtingëllore, sesa anglishtja; raporti është 29 me 24. Prandaj, disa bashkëtingëllore të shqipes nuk gjenden në huazimet angleze të Amerikës. Shkronja *r* edhe pse nuk shqiptohet kur vjen pas një zanoreje, ajo haset si fonemë në huazimet angleze në shqipen e Amerikës. Shkrimi ka bukur shumë ndikim në procesin e të huazuarit gjuhësor.

Disa huazime angleze u nënshtrohen dukurive fonetike të shqipes, si palatalizimit. Paraqiten edhe raste të metatezës, të epentezës, të cilat varen nga faktorë të ndryshëm gjuhësorë dhe jogjuhësorë.

Çështja e vendit të theksit paraqitet si dukuri që herë respektohet modeli i anglishtes, e herë bëhet përshtatja në mbështetje të rregullave të shqipes.

Filologji, nr. 5, ff. 81-98, Fakulteti i Filologjisë i Universitetit të Prishtinës, Prishtinë, 1988.

INTERFERENCA LEKSIKORE E ANGLISHTES NË SHQIPEN E AMERIKËS

1. Hyrja

Interferenca gjuhësore, pa dyshim, bëhet më së shumti në rrafshin leksikor. Kjo bëhet për shkak se fjalët e reja mund të barten lirisht jo vetëm si rezultat i kontaktit midis dy gjuhëve por edhe për shkak se numri i fjalëve rëndom shtohet në një gjuhë ku ka nevojë të emërtohen objekte, ide dhe situata të reja. Haugen dallon tri forma të interferencës leksikore: *huazimet, kalket dhe huazimet semantike*.¹

Përvoja me interferencën gjuhësore ka dëshmuar se elementet gjuhësore nuk barten në gjuhën marrëse në trajtën e tyre të plotë dhe me gjithë rjetin e tyre të kuptimeve. Kështu, Elementet e huazuara shikohen rëndom si “*pjesërisht importim dhe pjesërisht zëvendësim*”.² Çdo gjë që është e ngjashme midis elementeve gjuhësore në gjuhën dhënëse dhe të atyre në gjuhën marrëse, pas kalimit të tyre, mund të quhet importim, ndërsa dallimet midis tyre konsiderohen zëvendësim i elementeve në gjuhën marrëse. Zëvendësimi dhe importimi i elementeve gjuhësore e përjashtojnë njëri-tjetrin.

2. Huazimi

Huazimi, sipas Haugenit,³ paraqet njëfarë interference gjuhësore, në të cilën si trajta (qoftë fonetike ose drejtshkrimore) ashtu edhe kuptimi i elementit linguistik të gjuhës dhënëse, barten së bashku në gjuhën marrëse. Për shembull, folja advërtajz (reklamoj) përdoret në shqipen e Amerikës me një shqiptim bukur të afërt me atë të anglishtes dhe plotësisht me kuptimin e foljes angleze (advertise). Lista e huazimeve të tilla është shumë e gjatë në të folurit shqip të Amerikës. Në të vërtetë, huazimet përbëjnë pjesën më të rëndësishme të interferencës gjuhësore midis dy gjuhëve çfarëdo qofshin ato, në rastin tonë midis anglishtes amerikane dhe

¹ E. Haugen, *The Norwegian Languages in America...*, 1953, p. 390.

² E. Haugen, *The Norwegian Languages in America...*, 1953, f. 388.

³ E. Haugen, *Po aty*.

shqipes në Amerikë. Do t'i zëmë ngoje këtu vetëm disa nga huazimet më karakteristike dhe me përdorim më të dendur, ndërsa më vonë⁴ një listë e nja 200 huazimeve të përshtatura do të jepet përballë një liste të njëjtë të huazimeve të papërshtatura që janë hasur në ligjërimin ose shkrimin e folësve shqiptarë të Amerikës. Si rezultat i përshtatjes ndaj gjuhës marrëse disa syresh kanë pësuar ndryshim të vogël në trajtën e tyre fonetike.⁵

Thuaja të gjitha fjalët e asimiluara të bartura nga anglishtja në shqipen e Amerikës janë të thjeshta (d.m.th. me temë njërrënjëshe), ndërsa ndër huazimet e papërshtatura në mënyrë fonetike dhe morfemike, pos fjalëve të veçanta, gjendet një numër i madh i kompozitave dhe i sintagmave.

Shumica e fjalëve angleze që janë huazuar në shqipen e Amerikës në trajtë të përshtatur, janë emra (afër 70% nga korpusi). Pjesa dërrmuese e atyre emrave janë fjalë të thjeshta. Vetëm një duzinë sosh mund të quhen kompozita. Siç është vërejtur më herët, folësit e shqipes të Amerikës janë shumë më të gatshëm të bëjnë transfer kodi, sesa përshtatje fonemike ose morfemike të elementeve gjuhësore të anglishtes. Kjo e dhënë vlen sidomos për periudhën e mëvonshme dhe kur është fjala për kompozitat dhe sintagmat. Kështu, lista e fjalëve të papërshtatura është shumë më e gjatë sesa lista e fjalëve të përshtatura: 950 ndaj 670 në materialin tonë. Huazimet e papërshtatura paraqiten me përdorim shumë më të dendur, sesa huazimet e përshtatura në shqipen amerikane. Lyrë⁶ ka konstatuar se huazimet e paasimiluara janë shumë më të pakta në ligjërimin e polonishtes amerikane, ndërsa të dhënat tona, ngjashëm me Simanin⁷ për të folurit e greqishtes në Amerikë, tregojnë se ato janë shumë të bollshme dhe të dendura në gjuhën e folur të shqiptarëve të Amerikës.

Shumica e folësve të shqipes së Amerikës janë të vetëdijshëm për elementet gjuhësore që i përdorin në të folurit e tyre. Kjo vlen sidomos për pjesëtarët e brezit të parë. Kjo vetëdije shprehet me mjete të ndryshme: me një pushim të shkurtër para përdorimit të tyre, me ndryshim të intonacionit, me koment të dhënë për përdorimin e tyre, siç është: “duhet ta them në anglishte”, ose “siç thonë në anglishte” etj.; ose shpeshherë duke i dhënë si ekuivalentët e anglishtes ashtu edhe ata të shqipes, dhe në këtë rast ekuivalenti i shqipes në të shumtën e rasteve është i gabuar.

⁴ Shih pasqyrën 1 më poshtë.

⁵ Për hollësitë e përshtatjes së tyre shih kaptinat që kanë të bëjnë me interferencën fonetike dhe morfematike.

⁶ Franciszek Lyrë, *The Polish Language in the United States: Some problems and findings*, The Polish Review 7/2, p. 202, New York, 1962

⁷ P. D. Seaman, 1972, p. 180.

Termt për politikë, sport, sëmundje, judikaturë, shkollë, medie, mjetet e trafikut dhe për jetën ekonomike në ligjërimin e shqipes së Amerikës janë kryesisht angleze. Kjo është ashtu pjesërisht për shkak të faktit se shumë terma të këtyre fushave të jetës ata kurrë nuk i kanë ditur në gjuhën e tyre amtare. Shumë terma lidhen me realitetin e jetës së tyre në atë vend të ri. Termt e tilla janë pranuar nga folësit e shqipes në Amerikë, sidomos nëse janë përdorur me denduri të madhe.

Pos huazimeve që kanë plotësisht përmbajtje të re, importimi ose zëvendësimi i fjalëve të huaja mund të ndihmojë në leksikun e gjuhës marrëse në tri mënyra:⁸ a) mund të ngatërrohet kuptimi i fjalës së re të bartur nga gjuha dhënëse me kuptimin e fjalës që ka ekzistuar përpara në gjuhën marrëse; b) fjala që ka ekzistuar përpara mund të zhduket; c) si fjala e re, e transferuar dhe e zëvendësuar, ashtu edhe fjala e vjetër mund të mbeten gjallë, por secila me një kuptim të veçantë.

Ngatërrimi i kuptimit ose i identitetit të plotë të përmbajtjes midis fjalës së re dhe fjalës së vjetër, merret me mend se haset në fazën e hershme të kontaktit gjuhësor.⁹ Shembuj të tillë te folësit e shqipes amerikane mund të jenë: kartë dhe postkartë, cigare dhe cigaretë, bilion dhe miliardë, kryetar dhe president etj.

Nëse fjala e re e huazuar nga gjuha dhënëse e mbulon plotësisht fushën e kuptimit të fjalës së vjetër, fjala e vjetër zakonisht zhduket. Kur fjala *gazolinë* e anglishtes amerikane u huazua nga gjuha shqipe e atjeshme, fjala e përparme shqipe për atë nocion, *benzinë*, ngadalë doli nga përdorimi. Fjala *kamatë* u zhduk në rrjedhë të kohës nga shqipja e Amerikës, meqenëse huazimi anglez *interest* (me trajtën shqipe të atjeshme *interes*) e mbuloi fushën e saj semantike. Po kjo u ndodhi edhe këtyre fjalëve shqipe: *qeveri* u zëvendësua me *guvernë*, *dyqan* me *store*, *redaktor* me *editor*, *tregti* me *biznes*, *shpikës* me *inventor*, *pushim* me *vakancë*, *tatim* me *tax* (e papërshtatur as grafikisht) etj.

Fjalët e vjetra që shënonin masa të ndryshme e që u zëvendësuan me termt anglezë, të cilët ishin më praktikë në rrethin e ri, po ashtu i përkasin këtij grupi huazimesh. Në mesin e palëve të tilla të fjalëve janë inçi si njësi e gjatësisë që zëvendësoi fjalën centimetër apo santin; paundi e zëvendësoi kilogramin, galloni e zëvendësoi litrin etj. Ky zëvendësim që i doemosdoshëm për shqiptarët në Amerikë, meqenëse njësitë e masave të vjetra nuk përputheshin fare me masat që i hasën atje. Kjo vlen edhe për të hollat.

⁸ U. Weinreich, 1953 (rishtypur në vitin 1963).

⁹ U. Weinreich, *Po aty*.

Në vendin e ri, me sistem tjetër monetar, i nevojitet njeriut që nga fillimi, madje edhe kur gjendet si turist, të llogarisë me njësinë monetare që e has atje, ndonëse mund të bëhen krahasime me njësinë monetare të vetën për të vlerësuar çmimet. Por shumë shpejt njeriu fillon të përdorë vetëm njësinë e re monetare që vlen për atë vend.

Nëse mbeten gjallë si fjala shqipe ashtu edhe ajo angleze, rëndom fjalës së vjetër i kufizohet fusha semantike, ndonëse që të dyja mund të marrin kuptim paksa të specializuar. Huazimi anglez *dancë* (ose edhe folja e prejardhur *dancoj*) përdoret vetëm për vallet moderne, ndërsa ekuivalenti i shqipes *valle* (emër) dhe *vallëz* (folje) përdoren për vallet popullore në të folurit shqip në Amerikë. Po ashtu, në gjuhën shqipe përdorej huazimi i vjetër nga anglishtja *futboll* (ose *fuzball*, nga gjermanishtja), kurse sot vetëm *futbolli* amerikan quhet *futboll*, ndërsa huazimi i papërshtatur *soccer* [ˈsokɛʃ] përdoret për të shënuar lojën e futbollit europian. Këtu kemi rastin kur një huazim i vjetër nga anglishtja, që mbulonte një fushë më të gjerë semantike, erdhi e u ngushtua vetëm në një lloj loje sportive. Fjala shqipe *drejtor* përdoret vetëm kur flitet për një pozitë të tillë në vendlindje, në Shqipëri, kurse fjala manager [ˈmænɪdʒəʃ] përdoret për të shënuar atë pozitë në Amerikë. Termi shkollor *gradë* e ka zëvendësuar fjalën e mëhershme klasë. Por termi *klasë* ka mbetur gjallë ose është përputhur me po atë term të anglishtes për të shënuar klasën vetëm në kontekstin shoqëror a politik.

Pasqyra 1

Huazime të përshtatura në shqipen e Amerikës

Anglisht	Shq-Amerikane	Shqip
ability	<i>abilitet</i>	mundësi
absence	<i>absencë</i>	mungesë
abuse	<i>abuzoj</i>	shpërdoroj
act	<i>aktoj</i>	veproj
admit	<i>admitoj</i>	pranoj
adventure	<i>adventurë</i>	aventurë
advertize	<i>advërtajz</i>	reklamoj
agenda	<i>agjendë</i>	rend dite
agriculture	<i>agrikulturë</i>	bujqësi
aeronaut	<i>aeronaftia</i>	aeronautikë
anniversary	<i>aniversar</i>	përvjetor
announce	<i>anuncoj</i>	shpall
apartment	<i>apartment</i>	banesë, apartament
application	<i>aplikatë</i>	fletëparaqitje
appreciate	<i>aprecioj</i>	çmoj
Irish	<i>Ajrish</i>	irlandez
assassin	<i>asasin</i>	vrasës
attempt	<i>atempt</i>	përpjekje

bartender	<i>bartender</i>	pijeshitës
bill	<i>billë</i>	ligj
boss	<i>bos</i>	pronar, shef
brigand	<i>brigant</i>	kusar
broadcast	<i>brodkest</i>	transmetoj, emetoj
business	<i>biznat</i> (sh.)	tregti, afarizëm
cafeteria	<i>kafeteria</i>	restorant me vetëshërbim
cancel	<i>kancelloj</i>	anuloj, pezulloj
cash	<i>kesh</i>	të holla
cashier	<i>kashier</i>	arkëtar
cartoon	<i>kartune</i>	filma vizatimorë
celebrate	<i>selebroj</i>	kremtoj
cent	<i>senc</i>	qindarkë
ceremony	<i>seremoni</i>	ceremoni
chairman	<i>çairman</i>	kryesues
champion	<i>çampion</i>	kampion
chart	<i>çartë</i>	kartë
Christmas	<i>Kristmesë</i>	kërshëndellë
cigarette	<i>sigaretë</i>	cigare
cinema	<i>çinema</i>	kinema
clarification	<i>klarifikim</i>	sqarim
clerk	<i>klerk</i>	nëpunës
club	<i>kllup</i>	klub
collar	<i>kollaro</i>	jakë
collision	<i>kolizion</i>	ndeshje
comfort	<i>konfort</i>	ngushëllim
comfortable	<i>komfortonjës</i>	komod
common	<i>komun</i>	i rëndomtë
competition	<i>kompeticje</i>	konkurrencë
compromise	<i>kompromisoj</i>	bëj kompromis
concession	<i>koncesje</i>	lëshim (pe)
conductor	<i>konduktor</i>	dirigjent
confidence	<i>konfidencë</i>	besim
conform	<i>konformoj</i>	pajtohem
confuse	<i>konfuzoj</i>	ngatërroj, hutoj
concensus	<i>konsens</i>	pëlqim
constitution	<i>konstitutë</i>	kushtetutë
conviction	<i>konvikcion</i>	bindje
cord	<i>kord</i>	kubik, turrë
cordiality	<i>kordialitet</i>	përzemërsi
correct	<i>korrektoj</i>	korrigjoj
course	<i>korsë</i>	kurs
court	<i>kort</i>	gjyq
currency	<i>kurrenci</i>	devizë
customs	<i>kostume</i>	zakone
dance	<i>dancë</i>	valle
dancer	<i>dancator</i>	vallëzues
decide	<i>decidoj</i>	vendos
dedication	<i>dedikacion</i>	kushtim

deport	<i>deportoj</i>	internoj, përzë
divisible	<i>diviziv</i>	i ndashëm
different	<i>diferent</i>	dallues
digestion	<i>digjestion</i>	tretje
direct	<i>direktaj</i>	drejtor, bëj regjinë
director	<i>direktor</i>	regjisori
diversity	<i>diversitet</i>	shumëllojshmëri
draft	<i>draft</i>	thirrje nën armë
edit	<i>editoj</i>	redaktoj
education	<i>edukatë</i>	arsim
elevator	<i>elevatë</i>	ashensor
embark	<i>imbarkoj</i>	ngarkoj
embarras	<i>embarasoj</i>	trazoj, zë ngushtë
English	<i>englisht</i>	anglisht
eternity	<i>eternitet</i>	përjetësi
evolve	<i>evolvoj</i>	zhdrivilloj
exams	<i>eksame</i>	provime
excellent	<i>ekselent</i>	shkëlqyeshëm
exception	<i>eksepcion</i>	përjashtim
excuse	<i>ekskuzje</i>	ndjesë
exigency	<i>eksigjencë</i>	nevojë e madhe
exploration	<i>eksplorim</i>	hulumtim
extraordinary	<i>ekstraordinar</i>	i jashtëzakonshëm
facility	<i>facilitet</i>	lehtësi
farmer	<i>farmadhor</i>	bujk, fermer
favor	<i>favoroj</i>	favorizoj
fibre	<i>fibra</i>	fije
flu	<i>flu</i>	grip
foreman	<i>forman</i>	mjeshtër
garden	<i>gradinë</i>	kopsht
gasoline	<i>gazolinë</i>	benzinë
generous	<i>xheneros</i>	bujar
gift	<i>gift</i>	dhuratë
glory	<i>glorje</i>	lavdi
govern	<i>guvernoj</i>	qeveris
grade	<i>gradë</i>	klasë
grocery	<i>grosari</i>	dyqan bakalli
homage	<i>homagj</i>	nderim
hospitality	<i>hospitalitet</i>	mikpritje
influx	<i>influks</i>	derdhje
insult	<i>insulltoj</i>	ofendoj
intention	<i>intencion</i>	qëllim
interfere	<i>interferoj</i>	përzihem
mile	<i>majl</i>	mile
military	<i>militare</i>	ushtarake
minority	<i>minorancë</i>	pakicë, minoritet
minuteman	<i>minutman</i>	procesverbalist
missile	<i>misil</i>	predhë
monster	<i>monstër</i>	përbindësh

mortal	<i>mortallë</i>	i vdekshëm
musician	<i>muzicist</i>	muzikant, muzicient
nationalism	<i>nashionalizëm</i>	nacionalizëm
(aero)nauts	<i>naftër</i>	detarë
negro	<i>negër</i>	zezak
nurse	<i>nursë</i>	infermiere
observation	<i>obzervatë</i>	vrojtim
park	<i>parkegjoj</i>	parkoj
passage	<i>pasazh</i>	pjesë leximi
penetration	<i>penetracion</i>	depërtim
perform	<i>përformoj</i>	shfaq
physicist	<i>fizicist</i>	fizicient
picnicker	<i>piknikas</i>	ai që shkon në shëtitje
pilgrimage	<i>pelegrimazh</i>	haxhillëk
point	<i>point</i>	qëllim
police	<i>policë</i>	polici
pollute	<i>pollutoj</i>	ndot
postcard	<i>postkartë</i>	kartë postare
pound	<i>paund</i>	funt
precautionary	<i>prekaucional</i>	i kujdesshëm
predominate	<i>predominoj</i>	mbizotëroj
prejudice	<i>prejudikë</i>	paragykim
prerequisite	<i>prerekuizitë</i>	parakusht
preserve	<i>prezervoj</i>	ruaj
principle	<i>pricipli</i>	parim
produce	<i>produkoj</i>	prodhoj
profit	<i>profitoj</i>	përfitoj
prominently	<i>prominentërisht</i>	dallueshëm
promise	<i>promis</i>	premtim
promoter	<i>promotor</i>	përkrahës
promulgate	<i>promulgoj</i>	shpall
pronounce	<i>pronuncoj</i>	shqiptoj
quarter	<i>kuartier</i>	lagje
quart	<i>kort</i>	njësi matjeje (0.9463 l.)
rocket	<i>roket</i>	raketë
rebel	<i>ribel</i>	kryengritës
record	<i>rekordoj</i>	marr shënime
report	<i>report</i>	raport
resolve	<i>resolvoj</i>	zgjdh, vendos
responsible	<i>responsibël</i>	përgjegjës
restoration	<i>restoratë</i>	restaurim
retire	<i>ritiroj</i>	pensionohem
retirement	<i>ritiratë</i>	pension
revolutionize	<i>revolucionoj</i>	bëj revolucion
redicule	<i>ridikullizoj</i>	përqesh
role	<i>roll</i>	listë
rooms	<i>rume</i>	dhoma
rumors	<i>rumore</i>	thashetheme
scheme	<i>skimë</i>	skemë

sergeant	<i>sargjent</i>	rreshter
sequester	<i>sekuestroj</i>	veçoj
simplicity	<i>simplicitet</i>	thjeshtësi
slogan	<i>slogan</i>	parullë
society	<i>societë</i>	shoqëri
sophisticated	<i>i sofistikuar</i>	me shije të hollë
spirit	<i>spiritë</i>	frymë
sportsman	<i>sportsman</i>	sportist
stamp	<i>stempë</i>	pullë postare
store	<i>store</i>	dyqan, shitore
successor	<i>suksesor</i>	trashëgues
sum	<i>sumë</i>	shumë
superficially	<i>supërficialisht</i>	sipërfaqësisht
supremacy	<i>supremaci</i>	epërsi
superstition	<i>supërsticion</i>	besëtytni
supplementary	<i>suplimentar</i>	plotësues
supporter	<i>suportues</i>	përkrahës
suspect	<i>suspekt</i>	dyshoj
sympathetic	<i>simpatetik</i>	simpatik
taxation	<i>taksim</i>	tatim
ticket	<i>tiqetë</i>	biletë
tobacco	<i>tobako</i>	duhan
translator	<i>transllator</i>	përkthyes
trench	<i>trenç</i>	llogor
trick	<i>trikoj</i>	bëj truk
unanimously	<i>junanimisht</i>	njëlësi
universe	<i>universë</i>	gjithësi
vacation	<i>vakancë</i>	pushim (vjetor)
vegetable	<i>svexhitebla</i>	perime
violation	<i>violacion</i>	dhunë

3. Kompozita dhe fjalë të përbëra

Sa u përket fjalëve të përbëra dhe sintagmave, mund të jenë tre tipa interferencash nga gjuha burimore (dhënëse) në gjuhën marrëse.¹⁰

a) Të gjitha elementet e kompozitës a të fjalës së përbërë mund të huazohen në gjuhën marrëse. Këtë dukuri gjuhësore Weinreich u quan “*transfer (bartje) e fjalëve të përbëra të analizueshme*”,¹¹ ndërsa Haugeni e quan thjesht “*fjalë e përbërë*”.¹²

b) Të gjitha elementet e fjalës së përbërë mund të zëvendësohen në gjuhën marrëse. Këtë dukuri Haugeni e quan *loanshift*¹³ (transfer

¹⁰ U. Weinreich, 1953, f. 50.

¹¹ U. Weinreich, *Po aty*.

¹² U. Weinreich, 1953, f. 462

¹³ E. Haugen, *The Norwegian Languages in America...*, 1953, f. 388.

kodi), ndërsa Weinreich u e quan *loan translation*¹⁴ (kalk).

c) Disa elemente të një fjale të përbërë mund të barten nga gjuha dhënëse në gjuhën marrëse, ndërsa elementet e tjera mund të zëvendësohen me elemente të gjuhës marrëse. Kjo dukuri gjuhësore quhet *loanblend* (fjalë e shkrirë a e përzierë) nga Haugeni,¹⁵ ndërsa Weinreich u e quan *hybrid compound*¹⁶ (kompozitë hibride).

Shumica e fjalëve të përbëra (kompozitave) të përshtatura përbëhen nga konstruktet: *emër + emër*. Këta janë disa shembuj që janë hasur në të folurit e shqipes së Amerikës:

address-type > *adresotip*,
 bonus bill > *billi i bonusit*,
 banquet-dance > *banketë-dancë*,
 money order > (*çek*) *mani order*,
 military academy > *militari akademi*,
 sportsman > *sportsman*,
 assistant-professor > *asistent-profesor*,
 auto-stop > *autostop*,
 roll-call > *roll kolli* etj.

Shumica e kompozitave barten drejtpërsëdrejti në të folurit e shqipes së Amerikës, pa treguar ndonjë shenjë të përshtatjes, pos të dhënës se në gjuhën e shkruar ata shpesh vihen brenda thonjëzave ose kllapave, apo shkruhen me shkronja të mëdha, pra shënohen me ndonjë shënues për të treguar se janë elemente të huaja. Ato mund të konsiderohen transfer i thjeshtë.¹⁷ Mund të konsiderohen edhe *transfer kodi*, sepse ai që përdor një element të tillë duke qenë binling, mund të dalë i pandërdijshëm nga njëra gjuhë në tjetrën.

¹⁴ U. Weinreich, 1953, *Po aty*.

¹⁵ E. Haugen, *The Norwegian Languages in America...*, 1953, f. 388.

¹⁶ E. Haugen, *The Norwegian Languages in America...*, 1953, f. 388.

¹⁷ U. Weinreich, 1953, f. 50.

Pasqyra 2

Kompozita emërore e togfjalësh të papërshtatur në shqipen e Amerikës

ABM System	boyfriend
administrative director	boys club
advisory council	bridemaids
air condition	British Broadcasting Corporation
Air Force	B.S. degree
air lines	buffet-style
air mail	burlesque shows
aeronaut	businessman
airplane	bus station cablegram
airport	cake sale
alien enemy	cake pushers
American citizen	canister shot
American Legion Award	car fare
American style of life	Central Intelligence Agency
American way of life	chairman
anarchy advocacy	chairwoman
Anglo-Saxons	charge d'affaires
anti-missile-missile	check money order
arms limitation	chewing gum
assistant professor	Christmas party
assistant	Christmas present
Atlantic seaboard	circle line
attorney general	City Government
Attorney Prosecuting	City Hall
Bachelor of Arts	city-state
Bachelor of Science	civilian dissenters
baking soda	cum laude cocktail
ball room	cocktail hour
banquet-dance	cocktail lounge
banquet room	cocktail party
barber shop	collective leadership
bar-room	Commercial High School
bayonet attack	Common Law
beauty parlor	Commonwealth
bell boy	Coney Island
best man	Congressional Record
best-seller	congressman
Betty Speck Award	constitutional convention
Bible students	Constitution Week
board of regents	cooks agency
board of trustees	copyright
bonus bill	costume ball
bomb-proof-shelters	cowboy
bomb shelter	Declaration of Independence
bold face	Decoration Day
bookbindery	defense bonds

defense officials	icebox
degree Mason	ice cream
deputy sheriff	illusions of grandeur
dinner-dance	income tax
dining hall	insurance man
dining room	insurance service
downtown	kilowatt
drug store	Labor Day
drive-in restaurant	Labor Party
emergency door	ladies room
emergency fund	Lady of the year
every other day	land-rover
Farm Credit Administration	lecture room
father-in-law	League of Nations
Federation of Labor	Lewis gun
fingerprints	liberty bond
fire roof	liberty loan
flower girl	life insurance
foreign aid	light lunch
fox trot	linotypist
fruit store	living corpse
funeral home	Lord's Prayer
gas station	loudspeaker
gasoline station	Loyalty Day
general strike	lump sum
Globetrotters	lunar flyer
godfearing man	luncheonette-pizzeria
going American	Magna Charta
Golden Rule Fund	mailbox
graduation day	main speaker
grandchildren	man of the month
grandpa	man of the year
grandson	manuscript
grape fruqit	marine corpse
Greenich mean time	Master of Arts
grocery store	master of ceremonies
guest conductor	Master of Science
guide book	master's degree
Hall House	Mediterranean Fleet
high commissioner	member of the board
high school	Memorial Day
highway	men's room
hijackers	military academy
hinterland	mini-skirt
honeymoon	money order
honored guest	moving picture
horseshoe	night club
hospital corpsman	night school
House of Commons	Nobel Prize

nude look	serviceman
nursing home	shoemaker
office of the recorder	shoe shine
pall-bearer	shoe shine parlor
paperback	short-wave
papyrus boat	silver plate award
part-time job	Sinn Feiner
Patnam Bonus Bill	Skyhawk
Patriots Day	sons of the eagle
peace offensives	son-of-a-bitch
ping-pong	souvenir book
pipe-line	sportsman
playboy	stag-party
P.O. box pool room	state board examination
postcard	State Department
postmaster	State of the Union
post office	station wagon
presidential suite	Statue of Liberty
printing press	steam heat
proletarian organization	stock market
public school	storage house
Quartermaster General	strawberry shortcakes
radiogram	surip-tease
rattlesnake	suiside squads
raw material	Sunday school
real estate	supermarket
recorder's court	sympathy card
rheumatic fever	tape recorder
roast beef	teen-agers
rock'n roll	telephone book
roll-call	Thanksgiving Day
Rolls Royce	toastmaster
room clerk	top award
routine exercise	Trojan horse
savings banks	TV color
skolarship award	typewriter
Scotland Yard	Uncle Sam
scrap-book	Union Jack
screwdriver	war corpses
second cook selectman	week-end
self-service	welfare board
sense of proportion	zip code
series editor	

4. Fjalë të përbëra hibride

Shpesh ndodh që në gjuhët në kontakt një fjalë e përbërë ose një sintagmë të huazohet vetëm pjesërisht, domethënë, ndonjë element të huazohet nga gjuha burimore, kurse ndonjë tjetër të zëvendësohet me elemente të kësaj gjuhe. Kjo tregon se ai që përdor një strukturë të tillë, përpiqet të identifikojë atë me diçka të ngjashme në gjuhën e tij. Si shembuj nga shqipja e Amerikës mund të merren: *aniversari martesor* (përvjetori i martesës) nga *wedding anniversary* (përvjetori i dasmës, *ad.lit.*) - elementi i parë i gjuhës angleze, kurse i dyti (martesor) i shqipes; *mini-xhupë* - elementi *mini* i huazuar, ndërsa fjala *xhupë* (xhup) zëvendëson fjalën angleze *skirt* (fund, si veshje grash).

Këtë lloj të interferencës Haugeni e quan *loanblend*,¹ kurse Weinreich u e quan *hybrid compound*.² Sipas Weinreichut, si kompozita hibride mund të konsiderohen edhe ato në të cilat tema huazohet nga gjuha dhënëse, ndërsa ndajshitesat e prejardhura zëvendësohen në gjuhën marrëse, ose mund të ndodhë e kundërta, domethënë ndajshitesat të huazohen, kurse tema të zëvendësohet.³ Fjalë të tilla të përbëra ka shumë në shqipen e Amerikës, sidomos me temë të anglishtes e me ndajshitesë të shqipes.

Ndajfoljet e anglishtes që mbarojnë me *-ly*, janë huazuar në shqipen e Amerikës duke përvetësuar temën dhe duke zëvendësuar këtë prapashtesë të anglishtes me prapashtesën *-isht* të shqipes. Kështu janë ndajfoljet:

aktualisht (në të vërtetë), *aksidentalisht* (rastësisht),
informalisht (jo formalisht), *probabilisht* (me gjasë), *specialisht*
(sidomos), *supërfaqësisht* (sipërfaqësisht), *universalisht* (në mënyrë universale) etj.

Disa ndajfolje të tjera janë formuar me një zëvendësim disi tjetër:

-ly -isht: incidentërisht, prominentërisht etj.

Prapashtesa tashmë e përvetësuar në shqipe me prejardhje nga gjuhët romane *-acion* e ka zëvendësuar prapashtesën e anglishtes me shkrim *-ation* e që shqiptohet [ein] në shembujt si këta:

abnegation *abnegacion* (vetëmohim), application *aplikacion*
(zbatim paraqitje), citation *citacion* (citim), *dedikacion* (përkushtim), escalation *eskalacion* (shkallëzim), education *edukacion* (arsimim), inflation *inflacion*, naturalization *natura-*

¹ E. Haugen, 1953, ff. 397-399.

² U. Weinreich, 1953, f. 52.

³ Shih po ashtu Haugen, 1953, f. 461, e sidomos në veprën e 1950, f. 219, ku ai këtë dukuri gjuhësore e quan *blended derivation* (derivacion i përngjitur).

lizacion (natyralizim), penetration *penetracion* (depërtim), recommendation *rekomandacion* (rekomandim, porosi), relation *relacion* (raport), veneration *veneracion* (nderim), violation *violacion* (dhunim) etj.

Vlen të theksohet se ka pak shembuj të përshtatjes së prapashtesave *-ation* dhe *-tion* që të jenë huazuar me shqiptim të atyre shtesave ngjashëm me anglishten: [ein]. Kjo ndoshta rrjedh nga fakti se ato raste na janë dukur si shembuj të trajtave të papërshtatura, pra vetëm si transfer kodi.

Disa huazime të tjera të anglishtes që mbarojnë me prapashtesën *-ation*, janë zëvendësuar me prapashtesën *-atë* në shqipen e Amerikës, si për shembull:

application *aplikatë* (fletëparaqitje), education *edukatë* (arsimim, shkollim), immigration *imigratë* (imigracion), investigation *investigatë* (hulumtim), observation *obzervatë* (vrojtim, shqyrtim), restoration *restoratë* (restaurim), e ndonjë tjetër.

Në disa huazime të ngjashme prapashtesa shqipe *-im* e ka zëvendësuar prapashtesën *-(a)tion* të anglishtes, si b.f.:

assassination *asasinim* (vetëvrasje), clarification *klarifikim* (sqarim), investigation *investigim* (hulumtim), naturalization *natyralizim* (natyralizim), e ndonjë tjetër.

Një grup tjetër i huazimeve me prapashtesën *-(s)sion* të anglishtes e kanë zëvendësuar atë me prapashtesën shqipe të huazuar *-sion*, p.sh.:

admission *admision* (pranim), concession *koncesion* (lëshuarje pe), procession *procesion*, succession *sukcesion* (sukcesion) etj.

Në disa huazime, disa prapashtesa të anglishtes janë zëvendësuar me prapashtesën e shqipes *-icje*, si p.sh.:

competition ~ *kompeticje* (garë), concession ~ *koncesje* (koncesion), demission ~ *demicion* (dorëheqje) etj.

Pastaj në mënyrë analogjike është bërë përshtatja e fjalës: controversy ~ *kontraversje* (kontraverzë).

Duhet shtuar se disa prej fjalëve të zëna ngoje këtu, siç pamë më lart, kanë bërë tjetër zëvendësim prapashtesash.

Prapashtesa angleze *-sion* në disa huazime angleze në shqipen e Amerikës është zëvendësuar me *-zion* të shqipes, sidomos kur shqiptohet *-zhën*: collision *kolizion*, evasion *evazion* etj.

Në huazimet angleze vijuese prapashtesa shqipe *-or* i ka zëvendësuar prapashtesat angleze të ngjashme nga shkrimi. Për shembull:

collector *kollektor* (mbledhës), debtor *depitör* (borxhli), depositor

depozitor (depozitor), successor *suksesor* (trashëgimtar).

Ndërsa dy huazime të tjera kanë marrë prapashtesën shqipe *-tor*: announcer *anunciator* (zëdhënës), dancer *dansator* (vallëzues).

Ky model i zëvendësimit të prapashtesave mund të shpjegohet edhe si huazim i plotë së bashku si i temës së fjalës ashtu edhe i prapashtesës, pos në dy rastet e fundit.

Është një numër i huazimeve angleze në të cilat, prapashtesat e ngjashme të shqipes, i kanë zëvendësuar prapashtesat e anglishtes, por shqiptohen ndryshe. Kështu është rasti me prapashtesën *-er*, që shënon vepruesin. Ajo është bartur në gjuhën shqipe me anë të huazimeve nga gjuhët e huaja, si nga frëngjishtja, anglishtja etj. Shembujt e regjistruar në shqipen e Amerikës përfshijnë edhe:

banker *banker*, boxer *bokser*, broadcaster *brodkaster* (emitues), cashier *kashier* (arkëtar), bartender *bartender* (kamarier bari), interpreter *interpret(er)* (përkthyes), partner *partner* (*partner*, *ortak*) etj.

Disa syresh, për shkak të ngjashmërisë në shkrim (si: *banker*, *bartender*, *interpret*, *partner*) vështirë mund të identifikohen si shembuj të huazimeve të përshtatura në gjuhën e shkruar. Mirëpo, ka dallime në gjuhën e folur, dhe vetëm kjo e dhënë na ndihmon t'i identifikojmë si huazime të përshtatura ndaj gjuhës shqipe. Pos tyre, në këtë grup huazimesh është rasti i përshtatjes së fjalës *adventurer* *adventturist* (aventurist), e cila ka marrë prapashtesën e shqipes.

Prapashtesa shqipe *-onjës*, që përdoret për të shënuar vepruesin, ka zëvendësuar prapashtesat e anglishtes në këta shembuj:

applicant *aplikonjës* (paraqitës)
assassinator *asasinonjës* (vrasës)

Prapashtesa e anglishtes *-er*, që shënon banorin e një vendi, është zëvendësuar me prapashtesa të shqipes *-as/-ez*:

Irlander *irlandas*, Londoner *londinez*, New Yorker *njujorkas*, ndonjëherë edhe *newyorkas*.

Në variantin e shembullit të fundit ka rëndësi të shihet se prapashtesa e shqipes i është shtuar fjalës angleze të papërshtatur, domethënë një emri gjeografik, meqenëse, si duket, emrat gjeografikë amerikanë nuk i nënshtrohen shumë përshtatjes në shqipen e Amerikës.⁴ Në anën tjetër, ka raste të huazimeve të tilla si:

⁴ Shih për këtë më tutje, nën Emra të njerëzve (8.).

Californian *kalifornian*, Londoner *londonian*, dhe Bostonian *bostonian*

ku prapashtesa *-ian* e shqipes ka zëvendësuar prapashtesën *-ian* dhe *-er* të anglishtes dhe kështu janë përshtatur emrat (sidomos *kalifornian*).

Prapashtesa angleze *-ship* është zëvendësuar në mënyra të ndryshme. Në huazimin *chairmanship* është zëvendësuar me *-si*, që shënon gjendje abstrakte në gjuhën shqipe: *çairmanshi* (të kryesuarit). Po ajo prapashtesë në fjalën *foremanship* është zëvendësuar me prapashtesën e turqishtes *-llëk*, që përdoret në shqipen jo standarde: *formanllëk* (mbikëqyrje). Nga ana tjetër, kjo prapashtesë e anglishtes përdoret në shumë huazime të papërshtatura, si:

partnership, *relationship*, *scholarship*, *leadership* etj.

Prapashtesa e anglishtes *-ment* është huazuar në shqipen e Amerikës vetëm në disa huazime të përshtatura të anglishtes, si:

apartment *apartiment* (banesë); department *departiment* (sektor, repart); parliament *parlament* dhe investment *investiment* (investim),

si edhe në trajtat e papërshtatura të huazimeve:

entertainment (zbavitje), *statement* (deklaratë, kumtesë).

Në disa huazime të tjera ajo prapashtesë është zëvendësuar me prapashtesa të ndryshme të shqipes, si b. f.:

government *guvernë* (qeveri); retirement *retiratë* (pension) (pra me prapashtesën *-atë*, ndonëse nuk ka trajtë *retir* në shqipen e Amerikës).

Mirëpo, është interesante të vërehet se kjo prapashtesë e anglishtes i është imponuar një huazimi, siç shihet në:

isolation *izolament* (izolim) ose, së paku, është ndërruar me një prapashtesë tjetër: *-sion ment*.

5. Kalke

Dukuria kur morfemat e gjuhës marrëse përdoren në një gjedhe të re të ngjashme me atë të gjuhës dhënëse, quhet *kalk*. Ai që përdor modele të tilla, mund të mos jetë i vetëdijshëm se ato i përkasin një gjuhe tjetër.⁵ Këto modele mund të përdoren me denduri të madhe, ndërsa nën trysninë e gjuhës dhënëse ajo denduri mund të shtohet, ose mund të mos njihet fare në gjuhën marrëse, por gjuha tjetër bën trysni që ato të futen në të. Një huazim i tillë është burimor për nga trajta,

⁵ E. Haugen, 1953, f. 459.

ndonëse ka gjasa të mos jetë përdorur ndonjëherë në gjuhën marrëse - në shqipen e Amerikës. Një shembull tipik i këtij lloji është fjala e shqipes amerikane *qiellaprekës*, një kompozitë që është krijuar nën ndikimin e fjalës angleze *skyscraper*. Kjo kompozitë e anglishtes është huazuar nga shumë gjuhë. Në shqipen standarde ajo është huazuar me trajtën *rrokaqiell*. Në pasqyrën më poshtë po paraqesim disa huazime të këtij tipi (kalke) të huazuara në shqipen e Amerikës.

Pasqyra 3

Disa kalke në shqipen e Amerikës

Anglisht	Shqipe e Amerikës	Shqipe standarde
<i>aerofield</i>	fushë aeroplanësh	aeroport
<i>boxing match</i>	lodër grushti	boks-meç, ndeshje boksi
<i>honeymoon</i>	muaj i mjaltit	(pushim) i martesës
<i>new-comer</i>	ardhës i ri	i ardhur rishtas
<i>post office</i>	zyrë postare	postë
<i>poor health</i>	shëndet i varfër	shëndet i dobët
<i>rich food</i>	ushqim i pasur	ushqim i fortë
<i>Sunday school</i>	shkollë diellore	shkollë e së dielës
<i>wedding-anniversary</i>	aniversari martesor	përvjetor i martesës
<i>week-end</i>	fund jave	uikend, fundjavë
<i>Middle East</i>	Meslindje	Lindje e Mesme

Kalket e anglishtes në shqipen e Amerikës mund të ndahen në **kalke të pastra, kalke të përiferëta dhe në krijime të huaja.**

5.1. Kalke të pastra

Kalke të pastra janë ato trajta të interferencës në të cilat gjedhja e gjuhës dhënëse zëvendësohet element për element në gjuhën marrëse. Këta togfjalësha ose kompozita, ose kombinime të tjera, nuk njihen në gjuhën marrëse, pra në shqipen standarde. Ata ekzistojnë vetëm në këtë gjuhë objekt të këtij studimi. Këtu mund të përfshihen kalket e tipit siç është *gjysmë-gjysmë* sipas modelit të anglishtes *half (and) half*. Më poshtë po japim një listë kalkesh të tilla, të cilat janë nxjerrë nga materiali gjuhësor i mbledhur. Të gjitha fillojnë me folje.

Pasqyra 4

Kalke të pastra në shqipen e Amerikës (sintagma foljore)

Shq. e Amerikës	Sipas anglishtes	Shqipe standarde
<i>ndaj një dhomë</i>	share a room	jetoj bashkë (me X) në një dhomë
<i>vijnë lot në sy</i>	tears come to the eye	më dalin lot
<i>ndërroj mendjen</i>	change my mind	pendohem

<i>më zë e ftohta</i>	catch a cold	ftohem
<i>bëj shumë</i>	do a lot	punoj shumë
<i>bëj telefon</i>	make a (phone) call	thërras me telefon
<i>më vien në ment</i>	it comes to my mind	më kujtohet
<i>bëj propozime</i>	make a proposal	jap propozime
<i>lark të jenë</i>	far from being	larg asaj që të jenë
<i>pres shkurtër</i>	cut short	ndërpres, shkurtoj
<i>marr vent</i>	take place	ndodh
<i>marr vent</i>	take a seat	zë vend
<i>marr mësim</i>	take lessons	ndjek mësim
<i>marr fotografi</i>	take pictures	bëj fotografi
<i>jetoj jetën</i>	live a life	bëj jetën
<i>bie në dashuri</i>	fall in love	zë dashuri, dashurohem
<i>punoj rënd</i>	work hard	punoj shumë
<i>vij nga Korça</i>	come from Korça	jam nga Korça
<i>e gjej interesant</i>	find sth. interesting	duket interesant
<i>marr tren</i>	take a train	udhëtoj me tren
<i>gëzoj muzikë</i>	enjoy music	kënaqem me muzikë

Këta shembuj zakonisht përbëhen nga një folje dhe një emër, një mbiemër ose një ndajfolje. Tani mund t'ju hedhim një vështrim disa rasteve të kalkeve, në të cilat mund të vërehet interferenca e anglishtes vetëm në kontekst të plotë, pa marrë parasysh nëse kemi të bëjmë me emër, me folje ose me ndonjë pjesë tjetër të ligjëratës. Janë disa shembuj të kalkeve të tilla në pasqyrën më poshtë që hasen vetëm në shqipen e Amerikës dhe, në të vërtetë, shikuar nga këndvështrimi i shqipes standarde, ato janë struktura të shtrembëruara.

Pasqyra 5

Disa kalke të tjera të pastra në shqipen e Amerikës (folje)

Shq. e Amerikës	Sipas anglishtes	Shqipe standarde
<i>s'e zë këmbën</i>	doesn't fit one's shoes	s'i vjen krah
<i>pëlqej të besoj</i>	like to believe	besoj
<i>paraqitet interesant</i>	appears interesting	duket interesant
<i>dëshmoj filmin</i>	witness the film	shoh filmin
<i>marr kohë</i>	take time	duhet kohë
<i>mirëseardh</i>	welcome	dëshiroj mirëseardhje
<i>arxhoj kohë</i>	spend time	kaloj kohë
<i>rëndoj</i>	weigh	peshoj
<i>ruaj kohën</i>	keep time	mbaj mend kohën
<i>përballoj</i>	face	ballafaqoj
<i>pjesëtoj dëshirën</i>	share the desire	i bashkohem dëshirës
<i>drejtoj mbledhjen</i>	direct a meeting	udhëheq mbledhjen
<i>mbuloj largësinë</i>	cover a distance	kaloj largësinë
<i>fluturoj (me aeroplan).</i>	fly (by plane).	udhëtoj me aeroplan.

Kemi hasur sintagma të ndryshme ose shprehje që janë krijuar nën ndikimin e gjedheve të anglishtes, por me elemente gjuhësore të shqipes në një radhitje që nuk haset në shqipen standarde, disa prej të cilave nuk do të pranoheshin e as kuptoheshin. Ja një pasqyrë e tillë:

Pasqyra 6

Kalke të ndryshme në shqipen e Amerikës

Shq. e Amerikës	Sipas anglishtes	Shqipe standarde
<i>në moshën 83</i>	at the age of 83	në moshën 83-vjeçare
<i>pesë dollarë e lart</i>	five dollars and up	mbi pesë dollarë
<i>tre dollarë e poshtë</i>	three dollars and down	nën tre dollarë
<i>gjer në një pikë</i>	to a certain extent	deri-diku
<i>me çdo mjet</i>	by all means	sidoqoftë, gjithsesi
<i>përtej deteve</i>	overseas	përtej oqeanit
<i>çaj për dy</i>	tea for two	-
<i>copë muzike</i>	a piece of music	pjesë muzike

Të gjithë këta dhe shembuj të tjerë tregojnë se ata që përdorin kalke të tilla e kanë shumë të dobësuar kompetencën gjuhësore të shqipes, prandaj shpesh përdorin fjalë a sinonime të ngjashme, por që nuk i plotësojnë kërkesat gjuhësore të shqipes. Në raste të tilla paraqitet haptazi konfuzion gjuhësor. Kjo huti për të dalluar çka është e drejtë, e saktë dhe çka është e gabuar, është aq e madhe saqë këta folës shpesh bëjnë edhe disa gabime shumë të rënda, duke ndryshuar radhitjen e sintagmave dhe të shprehjeve shqipe të shtresuara shumë mirë. Këtu po zëmë ngoje një shembull shumë tipik të shprehjes *shumë a pak* të përdorur shpesh nga folësit e shqipes së Amerikës, e cila është përkthim fjalë për fjalë i po asaj shprehje nga anglishtja *more or less*; por dëgjohet edhe shprehja me radhitje të shqipes standarde *pak a shumë*. Një prej shembujve do të ishte ky:

Shqipe e Am.: Ato *shumë a pak* kanë shprehur këto mendime.

Në fjalinë vijuese fjala *tjetër* ka zëvendësuar fjalën angleze *the other* në një mënyrë që nuk i përgjigjet shqipes standarde, ose e ndryshon kuptimin e fjalisë, p. sh.:

Shqipe e Am.: Siç ju lajmëruam në numrin *tjetër*...
 Anglisht: As we informed you in the *other* number...
 Shqipe stand.: Siç ju informuam në numrin *e kaluar*...

Fjala *tjetër* në gjuhën shqipe duket se mund të ketë të bëjë me gjësend (ose ngjarje) që vijon, ndërsa vështirë mund të pranohet për gjësend apo ngjarje që ka kaluar; pra, ajo disi tregon të ardhmen e jo të kaluarën.

Kalket vijuese dhe të tjera të ngjashme tregojnë se këto ecuri të përkthimit fjalë për fjalë mund të shpien në gabim, duke ndikuar gjuha dhënëse mbi gjuhën marrëse. Kemi gjetur dy shembuj tipikë në

materialin tonë: *blackmail*, e cila ishte përkthyer fjalë për fjalë si *posta e zezë*, ndërsa kuptim i kësaj fjale është *shantazh*. Për shembull:

Kapni armën e fundit në dollap dhe luftoni *postën e zezë*.

Po ashtu sintagma angleze *literary criticism*, me përkthim fjalë për fjalë ka dalë *letërsi kritike*, duke dhënë kështu një nocion të pakuptimtë në gjuhën shqipe:

Ajo është një manifesto e vërtetë për botën e *letërsisë kritike*.

5.2. Kalke të përafërta

Kalke të përafërta janë ato forma të interferencës, në të cilat kompozita ose togfjalëshi i gjuhës dhënëse jep vetëm një kuptim të përafërt për zëvendësim në gjuhën marrëse. Në ligjërimin e shqipes së Amerikës, sipas materialit të vjelë, kalke të këtij tipi mund të konsiderohen këto:

Shqipe e Amerikës	Sipas anglishtes	Shqipe standarde
<i>folësja e ditës</i>	main speaker	folësja kryesore
<i>rritje e mirë</i>	good upbringing	edukatë e mirë
<i>koska pa mish.</i>	bare bones.	asht e lëkurë.

Kalket, sipas Haugenit⁶ dhe sipas Weinreichut,⁷ mund të ndahen në *krijime* dhe *zgjerime*. Po nuk është lehtë të bëhet çdo herë dallimi i qartë midis këtyre dy dukurive gjuhësore, sepse asnjë fjalor i shqipes nuk i përfshin të gjithë togfjalëshat.

Kalket krijime janë farkime të reja në gjuhën marrëse, të cilat stimulohen jo vetëm nga gjuha dhënëse në mënyrë të drejtpërdrejtë, por edhe nga “*nevoja për t’i arritur qëllimet e mundshme në gjuhën në kontakt*”.⁸ Në gjuhën dhënëse nuk ekziston kurrfarë modeli i atyre krijimeve. Në gjuhën shqipe të Amerikës mund të konsiderohen këta shembuj të krijimeve të huazuara, nga ata që janë në materialin e vjelë:

Shqipe e Amerikës	Anglisht	Shqipe standarde
<i>kohë-dhënës</i>	meteorologist	meteorolog
<i>zëdhënie</i>	announcement	shpallje
<i>xhepan</i> ⁹	pocket money.	të holla xhepi.

⁶ E. Haugen, 1953, f. 391.

⁷ U. Weinreich, 1953, f. 50.

⁸ Weinreich, 1953, f. 51.

⁹ Kjo fjalë duket se është një lloj hibridi që përbëhet prej *xhep* + (*m*)oney, pra prej pjesës së parë shqipe dhe pjesës së dytë angleze; natyrisht, pjesa e anglishtes e krijuar pavetëdijshtëm.

Mund të klasifikohen edhe fjalët teke në grupin e kalkeve të krijuara nga ato që përdoren në shqipen e Amerikës si gjuhë marrëse. Këto huazime marrin materialin gjuhësor burimor por nuk hasen fare në trajta të tilla në shqipen standarde. Ato janë trajta të krijuara rishtas që hasen vetëm në shqipen e Amerikës dhe shpesh si rrjedhojë e humbjes së kompetencës gjuhësore nga ana e folësit të shqipes.

Pasqyra 7

Kalke të krijuara në shqipen e Amerikës

Shq. e Amerikës Anglisht Shqipe standarde

<i>fuqizoj</i>	empower	forcoj
<i>efektoj</i>	effect	bëj efekt
<i>mbijetoj</i>	overlive	jetoj më shumë se tjetri
<i>këmbë</i>	foot	shputë
<i>shfletësim</i>	inflation	inflacion
<i>drejtim</i>	address	adresë
<i>sëmurëtore</i>	hospital	pital
<i>të ndenjura.</i>	seats	ulëse
<i>të ftohta</i>	cold (drinks)	pije joalkoolike
<i>të ëmbla</i>	sweets	ëmbëlsirë
<i>të vështira</i>	difficulties	vështirësi
<i>miqtore</i>	friendly	miqësore
<i>emërisht</i>	namely	gjegjësisht
<i>trupërisht</i>	physically	fizikisht
<i>nxehhtësisht.</i>	warmly.	ngrohtësisht.

5.3. Kalke të zgjeruara

Zgjerimet në ligjërimin e shqiptarëve të Amerikës përbëhen nga termat shqip në trup të njëjtë të togfjalëshit, siç është huazuar nga anglishtja. Ato mund të përputhen me huazimet semantike, kuptimet e të cilave janë zgjeruar.¹⁰ Pika e kontaktit që shpie në zgjerimin e fushës semantike, mund të jetë ngjashmëri fonetike ose semantike, ose edhe njëra edhe tjetra. Zgjerimet ndonjëherë pleksin kuptime të plotësuar që mund të kenë çfarëdo lidhjeje në fushën semantike me gjerësi të mëhershme të një fjale. Nëse zgjerimi paraqitet vetëm për shkak të ngjashmërisë së trajtës fonetike (ose rastësisht të drejtshkrimit), ai mund të quhet, sipas Haugenit, *huazim i zhvendosur homofon*.¹¹

¹⁰ E. Haugen, 1953.

¹¹ E. Haugen, 1953, f. 466.

Kemi hasur shumë shembuj të huazimeve të anglishtes në shqipen e Amerikës, të cilat janë të ngjashme qoftë në shqiptim, qoftë në drejtshkrim me fjalë shqipe ose me huazime të tjera që në gjuhën shqipe tashmë kanë hyrë nga ndonjë gjuhë tjetër ose madje edhe nga vetë anglishtja në kohë të mëhershme. Fjalët e tilla janë integruar në shqipen e Amerikës, por ato vazhdojnë të ruajnë kuptimin origjinal që kanë pasur në anglishte.

Ndonëse Haugeni¹² mendon se palët e pastra homofone fonetike të atyre grupeve mund të shihen nga ky këndvështrim vetëm si rastësi, na e merr mendja se në raste të tilla njeriu ka të bëjë me përshtatjen e huazimeve angleze në fjalë fonetike të ngjashme të shqipes, por me kuptime të ndryshme. Zëvendësimi që bëhet këtu e ka pikënisjen e vet në ngjashmërinë fonetike.

Prandaj, në shqipen e Amerikës emri *konduktor* përdoret për një person që e drejton koncertin, për të cilin fjala *dirigjent* përdoret në shqipen standarde. I vetmi kuptim i fjalës *konduktor* në shqipen standarde është personi që jep bileta dhe kontrollon udhëtarët në autobus, në tren etj., kurse për folësit objekt të këtij studimi ajo fjalë është zgjeruar në ndikimin e anglishtes duke përfshirë edhe kuptimin e personit që drejton orkestrën.

Fjala *direktor* ndonjëherë përdoret si huazim frëng apo sllav në shqipen jostandarde në Kosovë, në vend të fjalës *drejtor*. Mirëpo, në ligjërimin e shqiptarëve të Amerikës ajo zëvendëson fjalën angleze *director*, domethënë një njeri që drejton një film, një shfaqje, dramë a diç tjetër të ngjashme, pra në vend të fjalës *regjisor*, pos asaj që ka edhe kuptimin e drejtorit të firmës, të ndërmarrjes etj.

Fjala *influenca* e huazuar në shqipen standarde, do të thotë vetëm ndikim i dikujt ose i diçkahes mbi dikë ose diçka tjetër. Në shqipen e Amerikës kjo fjalë e ka zgjeruar kuptimin e fjalës *flu* (influenca) të anglishtes, që do të thotë *rrufë* apo *grip* në shqipen standarde.

Fjala *edukatë* në shqipen standarde do të thotë formim i personalitetit dhe i karakterit të njeriut me anë të sjelljes së drejtë, të qytetëruar, nga ana e familjes, e arsimit dhe e shoqërisë. Fjala *education* e anglishtes është ekuivalente me fjalën shqipe *arsim(im)*, *shkollim*. Mirëpo, në shqipen e Amerikës fjala *edukatë* përdoret me kuptimin *education* të anglishtes. Nga ajo rrjedh edhe folja *edukoj* dhe mbiemri *i/e edukuar*. Kjo fjalë shqipe, pra, është zëvendësuar me një fushë tjetër

¹² E. Haugen, 1953, f. 456.

semantike të afërt me të parën, si rezultat i trysnisë së fjalës së zënë ngoje të anglishtes. Fjala *arsim(im)* nuk ka gjetur vend në shqipen e atij vendi të ri të shqiptarëve, dhe me gjasë për shumicën e folësve të shqipes ka pushuar së ekzistuari, ose nuk është përdorur asnjëherë. Kuptimi i vjetër *edukatë* është zëvendësuar me një kalk nga anglishtja - *rritë*, sipas fjalës angleze *grow*, e cila është identifikuar, me gjasë, në mënyrë të tërthortë me fjalën tjetër angleze *up-bringing* (edukatë).

Fjala *librari*, sigurisht për shkak të dendurisë së përdorimit të saj, krijon huti të madhe në shqipen e Amerikës. Kjo del si rrjedhojë e të dhënës se kuptimi i fjalëve *librari* dhe *bibliotekë* janë të afërta për nga fusha semantike, të dyja kanë të bëjnë me libra, njëra shënon vendin ku shiten librat e tjetra vendin ku ruhen librat dhe mund të shfrytëzohen. Anglisht fjala *library* shënon vendin ku librat ruhen, pra, bibliotekën, kurse librarisë i thonë krejt ndryshe: *book shop* (dyqan librash). Pra, *hutia* këtu del vetvetiu. Për disa njerëz, sidomos më të vjetrit, fjala *librari* ende ka kuptimin si në shqipen standarde, kurse për shqipfolësit e rinj të Amerikës ajo fjalë do të thotë *bibliotekë*. Hutia në këtë rast zakonisht zgjidhet duke i shtuar fjalën *book shop* si sinonim fjalës *librari*, nëse përdoret në kuptimin e vjetër. Kështu kemi hasur në këso fjalish:

Qeshë në *librari* (*book-shop*).

Mora një libër nga *libraria* (jo nga *book-shop*).

Në shqipen e Amerikës folja *forcoj* e përdorur nën ndikimin e foljes angleze me trajtë të ngjashme “force”, ka kuptimin edhe *detyroj*. Pra, ngjashmëria fonetike me foljen e anglishtes ka ndikuar që ajo folje të zgjerohet fushën e vet semantike duke mbuluar edhe fushën e foljes *detyroj*.

Gradoj është një folje tjetër që ka trajtë që përdoret në shqipe, por nga shqipfolësit e Amerikës përdoret me kuptimin e foljes së anglishtes “graduate” (diplomohem). Emri i përdorur në shqipe *gradë*, nga e cila trajtë rrjedh kjo folje, ka kuptim të shkallës a të nivelit, kurse si folje kuptimin themelor e ka të dhënët *gradë* më të lartë ndonjë oficeri. Pra, edhe këtu është bërë identifikimi i dy fjalëve, i njëres në gjuhën shqipe dhe i tjetres në gjuhën angleze, për arsye se kanë trajtë fonetike të ngjashme, por edhe për arsye se i përkasin një fushe të përbashkët semantike, por më të gjerë, sepse të diplomohesh, do të thotë të marrësh një “gradë” më të lartë në lëmin e shkollimit.

Folja *provoj* ashtu siç përdoret në shqipen e Amerikës, nuk përputhet semantikisht plotësisht me kuptimin që ka në shqipen standarde. Të dyja këto folje kanë diçka të përbashkët në të njëjtën hapë-

sirë të fushës semantike, por secila prej tyre ka edhe diçka që ndodhet jashtë asaj fushe të përbashkët. Fushën e tyre semantike mund ta paraqesim si këtu më poshtë:

Provoj: shq + (shq-/ang-) + ang > shq am: (shq-am: *provoj* < ang prove).

Për shembull folja angleze “prove” në fjalinë më poshtë nuk e mbulon fushën e njëjtë semantike si të foljes *provoj* të shqipes:

Anglisht: John *proved* that Mary was wrong.

Shq-amer: John-i *provoi* se Mary qe gabim.

Shq-stand: Xhoni *vërtetoi* se Maria qe gabim.

Mirëpo, në ligjërimin e shqiptarëve të Amerikës folja *provoj* është identifikuar me foljen “prove” të anglishtes në tërë fushën semantike, dhe natyrisht, kjo është bërë me ndikimin e anglishtes. Për shembull:

Shq-amer: Kjo *provon* se disa njerëz punojnë për një ideal.

Shq-stand: Kjo *vërteton* se disa njerëz punojnë për ideal.

Nga këta shembuj mund të shihet qartë se kalket paraqiten në shqipen amerikane në mes palëve të fjalëve që i përngjajnë njëra-tjetrës, sidomos për nga trajta fonetike e ndonjëherë edhe për nga kuptimi (si: *edukatë, librari*). Kurdo që paraqiten fjalët që janë homofone për nga tingulli dhe të ngjashme nga drejtshkrimi, është gjë e natyrshme që shqipfolësit e Amerikës t’i zëvendësojnë me fjalët shqipe çfarëdo termash të anglishtes që t’u paraqiten. Një ndryshim i tillë i kuptimit të fjalës shqipe në ligjërimin e shqipfolësve të Amerikës mund të quhet *zhvendosje semantike e fjalëve shqipe*.

Hutime semantike, ndeshje të vërtetë të kuptimit, kemi hasur në një numër rastesh kur fjalët shqipe kanë zgjeruar kuptimin për të përfshirë përdorimin e fjalëve angleze me kuptim dhe trajtë fonetike, pjesërisht të ngjashme (siç janë *librari, forcoj, provoj*) duke dhënë si rezultat të fundit përrjashtimin e fjalëve shqipe të përdorura më herët në kontekste të njëjta. Në këtë mënyrë materiali gjuhësor i shqipes (sekuenca fonematike) zëvendësohet me sekuencë të ngjashme fonematike të anglishtes dhe përvetësohet përmbajtja semantike e anglishtes, kurse në rrjedhë të kohës i humbet përmbajtja e mëhershme semantike. Ose mund të ndodhë që përmbajtja e mëhershme semantike (kuptimi) të fillojë të shprehet me disa sekuenca të tjera fonemike, sidomos të huazuara nga anglishtja, domethënë, në vend të saj fillon të përdoret një fjalë tjetër e anglishtes.

Ka shumë kalke në shqipen e Amerikës, që kurrë nuk janë përdorur gjetiu në gjuhën shqipe. Komponentët e kalkeve të tilla paraqiten me semantema të njohura, por përdoren në atë kontekst nën ndikimin e gjuhës dhënëse - anglishtes. Në këtë mënyrë, një element apo më shumë të tilla

mund të marrin pjesë në zgjerimin ose ndryshimin semantik. Elementet e tilla linguistike në gjuhën marrëse mund të quhen huazime semantike.

6. Huazime semantike

Një numër fjalësh shqipe përdoren në shqipen e Amerikës në aso kontekstesh në të cilat përdoren edhe fjalët angleze. Çdo fjalë e tillë ka një kuptim të caktuar në shqipen standarde, por ato nuk përputhen me kuptimet që hasen në shqipen e Amerikës. Disa prej tyre janë huazime edhe në shqipen standarde, të bartura nga gjuhë të ndryshme, madje edhe nga anglishtja, por ato kanë kuptime të ndryshme. Fjala rekord mund të merret si një shembull i tillë, fjalë kjo që në shqipen standarde do të thotë vetëm një arritje, që nuk është bërë dot më parë, sidomos në garat sportive, por edhe në garat e tjera. Kuptimet e tjera të dhëna më poshtë nuk njihen nga shqipfolësit jashtë Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Këto fjalë as janë zgjerime të fushës semantike, as krijime të reja. Ato janë, thjesht, fjalë shqipe që i kanë zëvendësuar disa fjalë angleze në bazë të ndonjë identifikimi me to. Këto fjalë, thjesht, e kanë ndërruar fushën e tyre semantike me një fushë tjetër semantike që është rezultat i interferencës së drejtpërdrejtë nga anglishtja. Prandaj, ato i kanë ruajtur trajtat e tyre, por kanë pranuar vetëm kuptime të tjera. Këto fjalë i kemi quajtur huazime semantike. Këtu është një listë e huazimeve të tilla me shembuj të kontekstit dhe të ekuivalentëve të shqipes standarde.

1. adresoj:

Shq-amer: N.N. duke *adresuar* kuvendin,¹³ bëri një deklaratë.

Shq-stand: N.N. duke iu *drejtuar* kuvendit, dha një deklaratë.

2. detyroj:

Shq-amer: Me mirësinë e tij do të na *detyrojë* pa masë.¹⁴

Shq-stand: Me mirësinë e tij do të na *shtjerë në borxh* të madh.

3. kaloj:

Shq-amer: Rezultatet i *kalohen* një kalkulatori.

Shq-stand: Rezultatet i *jepen (përcillen)* një kalkulatori.

4. lë:

Shq-amer: Miqtë e *lanë* qendrën shumë të gëzuar.¹⁵

Shq-stand: Miqtë *ikën (u larguan)* nga qendra shumë të gëzuar.

¹³ Vërehet edhe shmangia e rasës - *kuvendin* (kallëzore) në vend të *kuvendit* (dhanore).

¹⁴ Shihet po ashtu përzgjedhja e fjalëve që dallojnë në mes të shqipes së Amerikës dhe të shqipes standarde.

¹⁵ Fjalja këtu mbetet me dykuptimësi: qenë miqtë të gëzuar, apo mbeti qendra e gëzuar.

5. ndal:

Shq-amer: Zoti Prifti *ndali* katër ditë këtu.

Shq-stand: Zoti Prifti *qëndroi* katër ditë këtu.

6. përmend:

Shq-amer: Kjo na *përmend* përrallën e qenit të pangopur.

Shq-stand: Kjo na *përkujton* përrallën e qenit të pangopur.

7. realizoj:

Shq-amer: E *realizoj* që nuk do të gjej atmosferë të ngushtë.

Shq-stand: E *kuptoj* (marr me mend) se nuk do të gjej atmosferë të ngrohtë.

8. rekorde:

Shq-amer: Do të blejnë *rekorde* e mjete të tjera mësimi.

Shq-stand: Do të blejnë *shirita të incizuar* dhe mjete të tjera mësimore.

9. rekorde:

Shq-amer: I ka shërbyer me besnikëri popullit dhe ka lënë kujtime të mira dhe *rekorde* të pastra.

Shq-stand: I ka shërbyer me besnikëri popullit dhe ka lënë kujtime të mira e rezultate të pastra.

10. rekorde:

Shq-amer: Editori lexoi *rekordet* e kuvendit të vitit të kaluar.

Shq-stand: Redaktori lexoi *procesverbalin* e kuvendit të vitit të kaluar.

11. shitesë:

Shq-amer: Qëllimi ishte *shtesa* e anëtarëve të ri.

Shq-stand: Qëllimi ishte *shtimi* i anëtarëve të rinj.

12. origjinale:

Shq-amer: Kongresi federal i 13 shteteve *origjinale*.

Shq-stand: Kongresi federal i 13 shteteve *fillestare*.

13. vrahem:

Shq-amer: Në aeroplanin që u rrëzua u *vranë* 13 shpirt.

Shq-stand: Në aeroplanin që u rrëzua u *mbytën* 13 vetë.

7. Transfer kodi

Ndodh shpesh që emigrantët shqiptarë, sigurisht duke mos qenë në gjendje të shprehen në gjuhën shqipe, shprehen plotësisht në anglishte.

Linguistët me famë nuk janë plotësisht të një mendjeje për për-

caktimin e transferit të kodit. Haugeni në punimet e tij më të hershme¹⁶ pohonte se transferi i kodit kishte të bënte me dukurinë “*kur bilingu në ligjërimin e tij përdor një fjalë plotësisht të paasimiluar nga ndonjë gjuhë tjetër*”. Ai mendonte se transferi i tillë bëhej zakonisht në kufirin leksikor.¹⁷ Mirëpo, ai duket se më vonë kishte ndryshuar mendimin, kur me transferi kodit nënkuptonte përdorimin e ndërsjellë të dy gjuhëve, duke mos lënë asnjë kufizim deri ku mund të shkonte ai.¹⁸ Haugeni po ashtu e zgjeroi termin *transfer* në *transferi kodit*.

Weinreichu, nga ana tjetër, pohon që nëse dikush thotë në anglishte vetëm një fjalë, nuk mund të konsiderohet transfer, por thjesht kapërcim gjuhësor, ndërsa fjala model konsiderohet si transfer i thjeshtë, do të thotë, huazim.¹⁹

Simani²⁰ dhe disa gjuhëtarë të tjerë konsiderojnë transferin e një fjale si huazim gjuhësisht të papërshtatur. Fogti (Vogt) e konsideron transferin e kodit jo si dukuri gjuhësore, “*por më shumë si dukuri jo gjuhësore*”, dhe mendon se arsyet për transfer janë jashtëgjuhësore.²¹

Kemi konstatuar se shqiptarët e Amerikës bëjnë transferi kodit jo vetëm në kufij të fjalës së vetme, por edhe në kufij të sintagmës ose madje në kufij të tërë fjalisë. Transferi i kodit duket se është përgjigje e një situate të të folurit, përdorim i sintagmave të rëndomta të përsëritjeve duke prodhuar shprehje të njohura vetëm në anglishte. Transferi i kodit, po ashtu, duket se është një mjet retorik, sidomos kur folësi dëshiron të nxjerrë ndonjë kontrast ose të bëjë ndonjë vërejtje.

Një çështje tjetër është nëse bilingët hezitojnë kur kalojnë nga një gjuhë në tjetrën. Haugeni²² citon Lansin duke thënë se informatori i tij nuk tregonte as vetëdijen më të vogël kur dilte prej një gjuhe në tjetrën. Ai refuzonte idenë se transferi i kodit bëhej për shkak të kompetencës gjuhësore joadekuate, por pohonte se folësit përdorin cilëndo shprehje që e kanë më afër “majës së gjuhës”. Kjo çështje duket se varet shumë nga individi. Shumë linguistë pohojnë se ka një vetëdije të folësit, e cila tregohet kur ai del në një gjuhë tjetër. Mjete të ndryshme paraqiten me folësit kur ata tentojnë të bëjnë kalimin, siç janë

¹⁶ E. Haugen, 1956, p. 40.

¹⁷ E. Haugen, 1956, f. 50.

¹⁸ E. Haugen, 1973, 521

¹⁹ U. Weinreich, 1953, f. 47.

²⁰ Seaman, 1970.

²¹ H. Vogt, 1954, p. 368.

²² E. Haugen, 1973, f. 530.

pauza, ndryshimi i zërit etj., në gjuhën e folur, ndërsa shumë më tepër mjete përdoren në gjuhën e shkruar.

Gjatë përvojës sonë me folësit e shqipes së Amerikës tregohet njëfarë reagimi nga ana e tyre kur detyroheshin të kalonin në anglishte. Shqipfolësit e lindur në Amerikë, të cilët flisnin shumë më mirë anglishten sesa shqipen, kalonin në anglishte me lehtësi shumë të madhe, duke mos qenë të vetëdijshëm se bënin diç të tillë, prandaj duke mos dhënë as shenjë më të vogël në rrjedhën e të folurit të tyre. Folësit më të moshuar, nga ana tjetër, të cilët ishin lindur në vendin e vjetër (në Shqipëri), tregonin njëfarë vetëdijeje kur, duke folur shqip, dilnin me ndonjë strukturë gjuhësore në anglishte, qoftë ajo fjalë, togfjalësh apo fjali. Ky akt shënohet me ndonjë pauzë të shkurtër në rrjedhën e të folurit, me njëfarë hezitimi. Kemi takuar shumë pak folës, që mund të dilnin njësoj lehtë prej shqipes në anglishte si edhe prej anglishtes në gjuhën shqipe. Këta të fundit duket se kanë kompetencë bukur të barabartë në të dyja gjuhët. Është pikërisht transferi i kodit ai i cili i shpie gjuhëtarët të mendojnë se fjalia me gjasë formohet në mënyrë abstrakte para se folësi të jetë i sigurt se cilën gjuhë do ta përdorë.

Transferi i kodit prej shqipes në anglishte me vetëm një fjalë ose një sintagmë është me gjasë më i shpeshtë se ai me fjali ose periudhë. Kurdo që një shqipfolës i Amerikës ka nevojë të përdorë një fjalë apo një shprehje për të cilën nuk është i sigurt nëse është e saktë në shqipe, ai më me ëndje do të kalonte në anglishte, në atë gjuhë që e kupton ‘çdokush’. Kjo është një përpjekje e pavetëdijshme për t’u ikur situatave të papërshtatshme, për të mos u turpëruar gjuhësisht, gjë që ndodh shumë shpesh kur flasin shqip shqiptarët e Amerikës.

Transferi i kodit prej shqipes në anglishte është provë se shqipfolësit e Amerikës kanë më pak kompetencë gjuhësore në shqipe sesa në anglishte. Kompetenca gjuhësore e zvogëluar rrjedh nga e dhëna se shqipfolësit kanë pak raste për të biseduar me shqiptarët e tjerë të Amerikës, në krahasim me rastet që kanë për të biseduar me njerëz të tjerë. Në këtë mënyrë, ata folës herë pas here kalojnë në anglishte madje edhe me fjalë që tashmë janë huazuar në gjuhën standarde shqipe dhe janë bërë pjesë e leksikut të përditshëm. Kjo përsëri rrjedh nga mungesa e njohurive dhe e kontakteve të tyre me zhvillimin e shqipes standarde. Ka mjaft shembuj të këtij tipi të transferit të kodit. Këtu po japim vetëm disa syresh për ta ilustruar këtë çështje:

Pasqyra 8

Anglizma të papërshtatura (transferi kodit)	Trajta të përshtatura (në shq. e Amerikës)
outsider	autsajder
blazer	blejzer
boxing club	klub boksi
business	biznes
charter	çarter
dumping	dumping
finish	finish
handicap	hendicap
insert	insert
laser	lejzer, laser
mixer	mikser
off side	ofsajd etj.

Shqipfolësit e Amerikës, në mbështetje të shumë shembujve të hasur në material, duket që shpesh kalojnë në anglishte me struktura më të gjata, siç janë fjalitë ose madje edhe periudhat. Ka disa lloje të transferit të kodit, disa nga të cilat i japim më poshtë.

Transferi i kodit, i cili duket si përkthim i asaj që është thënë së pari në gjuhën shqipe. Ja disa shembuj:

- (1) Ligështia e epokës sonë mbështetet në nevojë të njerëzve me rëndësi. *The weakness of our age is the want of a great man*, siç thotë peshkopi Fulton.
- (2) Por Amerika kësaj here nuk bëri zë: *America is being remarkably quiet or silent*.
- (3) Traktati gjermano - rus është një gjë e koklavitur miedis shpresës dhe frikësimeve, ose një “*mix of hopes and fears*”.
- (4) U Thant tha: Tre Pionerë të mëdhenj - *Three Great Pioniers!*
- (5) Delegatët u rrëmbyen kur Armstrongu u tha: Përfaqësonjës të nderuar të planetës tokë - *The distinguished representatives of the planet Earth!*
- (6) Dhe për më tepër është një pykë e futur në kokën e Amerikës - *A chronic headache for Americans!*
- (7) Kjo nuk është një shkelje marrëveshjes: *Does not appear to be a violation of any firm agreement*.

Nganjëherë folësi i shqipes së Amerikës del së pari në anglishte për ta bërë veten të qartë, dhe pastaj ai kthehet prapa në shqipe për të vazhduar bisedën. Shpesh ndodh që shqipja e tij të jetë shumë e dobët, ose të mos japë kurrfarë kuptimi, pa marrë parasysh drejtimin në të cilin bën transferi kodit. Zakonisht teksti i tij në anglishte është shumë më i mirë se ai i shqipes. Këtu janë disa shembuj të transferit të kodit, së pari në anglishte e pastaj kthimi prapa në shqipe.

- (1) Në Filton, Angli, ku përgatitet tipi inglez 001, teknikët thonë: *CONCORDE will shrink the world to half its present size*: Concorde do të pakësojë për gjymës rrethin e botës së sotme.
- (2) Çka na thotë shkurtazi kjo Konstitutë: *To make a more perfection union*: të bëjmë një bashkim sa më të përsosur.
- (3) Ata deklaruan se me ndërhyrjen e Rusisë në Çekosllovakia kjo Kartë në *Clauses of the United Nations Charter* ose disa klauza për këtë gjë nuk kanë më vlerë.
- (4) Po kjo gjë nuk ngjau: *At last that is not to be!* S' do të bëhet kurrë.
- (5) Z. Stowe vazhdon të shpjegojë se për një vëzhgonjë të huaj Evropa sot është një "*stupendous laboratory in human behavior*", domethënë njëfarë kazani ku tretet natyra e njeriut me qëllim për të hyrë në një formë të re.
- (6) Këto demonstrata janë të drejtuara kundër Amerikës si *un-American Activities* (si vepra anti-Amerikane).
- (7) *The Carnival is coming!* Po avitet Karnivali.

Transferi i kodit ndonjëherë bëhet për të shtuar pak më shumë informacion, ose për t' u shprehur pak më mirë në anglishte, sesa do të mund të shprehej në shqipen e Amerikës. Kjo ndodh për shkak se shpesh janë disa shprehje ose togfjalësh tipikë për të shprehur një gjë apo dukuri të posaçme në anglishte, dhe do të ishte shumë vështirë ose e pamundur për folësin e shqipes së Amerikës të shprehte atë në mënyrë të drejtë në gjuhën e tij. Këtu janë disa shembuj të tillë:

- (1) ...që të Dielë me 26 të Nëntor festohet Dita e Flamurit - *The Albanian Independence Day*.
- (2) E President Johnson i këshilloi Rusët që të mos trazojnë situatën ndërkombëtare: *Not to "unleash the dog's war"*...
- (3) Por në të njëjtën kohë edhe Familja e Tij - *The Proud First Family of America* - u dftua para publikut.

Shqipfolësit e Amerikës, po ashtu, bëjnë transferi kodit prej shqipes në anglishte edhe kur nuk mund të sjellin ndërmend një term ose shprehje përkatëse, sidomos nëse termi i tillë ka të bëjë me jetën dhe rrethanat e vendit të tij të ri. Mungesa e termave dhe e shprehjeve të tilla madje edhe midis rojtarëve të shqipes (gazetarëve, redaktorëve, shkrimtarëve) shkaktohet qartas nga ndikimi i anglishtes nga një anë, por edhe nga harresa ose nga dobësimi i kompetencës së tyre gjuhësore në shqipe, nga ana tjetër. Mund të jetë po ashtu e vërtetë se ata kurrë nuk i kanë ditur në gjuhën shqipe disa nga termat dhe shprehjet që u hyjnë në punë në vendin e tyre të ri. Këtu janë disa shembuj sa për ilustrim:

- (1) Z. Edward është *Assistant and Vice President of First National Bank* në Kearny

- (2) Këtë gjë e kanë në dorë *The Legislative Branch, The Executive Branch, The Courts* ose *The Juridical Branch*.
- (3) Artikujt janë interesant, radhitja është e bukur, *spelling is correct*, kryeartikujt aty janë korrekt *and do the point*, vazhdo kështu.

Shumë përshëndetje dhe urime kanë hyrë në shqipen e Amerikës përmes anglishtes. Ndonëse mund të ketë gjedhe të ngjashme në gjuhën e tyre, duket se shprehjet e tilla në anglishte u duken më shprehëse, prandaj ata i përdorin më mirë ato sesa përshëndetjet dhe urimet në gjuhën shqipe. Po japim disa shembuj për ilustrim:

- (1) Me këtë u dërgojmë të gjithë Shqiptarëve urimet e përzemërta: "*Happy Christmas and Happy New Year*".
- (2) ...për një jetë më të lumtur dhe plot me të mira. *Good Luck, Judy!*
- (3) Urojmë që Presidentit mos t'i ngjajë një gjë e tillë. *Good Luck, Mr. President*.
- (4) *Hallo Mr. Alaj*: Si na kujtove atdheun tonë!

Transferi i kodit mund të bëhet në rastet kur duhet të thuhet diçka pos asaj që tashmë është thënë dhe e cila, sipas bindjes së folësit, më së miri mund të shprehet në anglishte. Ja disa shembuj:

- (1) Gjendja e sotme, pa fjalë, mund të ndryshojë me kohë ose për së shpejti - *history leaps sometimes*.
- (2) Për çudi, gjithë ato gabime që bënë në Evropën e veriut i përsëritën edhe në Greqi: *this is the famous policy of muddling through*.
- (3) ...dhe kështu lajmet nga Franca munt të kenë patur për qëllim t'u bëjnë qejfën Englezëve: *Soften them somewhat for peace offensive*.

Transferi i kodit mund të haset në situatat në të cilat kërkohet ndonjë e thënë ose fjalë e urtë e anglishtes, dhe shqipfolësi i Amerikës e ka shpesh shumë vështirë të gjejë fjalë të urtë adekuate shqipe ose të shprehë atë me fjalë gjegjëse të shqipes. Kështu që e vetmja mënyrë në situata të tilla është që folësi të përdorë atë që tashmë e ka në dorë, pra trajtën anglishte. Ka shumë shembuj në shqipen e Amerikës, por vetëm disa po i japim këtu:

- (1) Ai u thotë atyre që e ndjekin: *Momentum is what is important*.
- (2) Presidenti është duke kërkuar njerëz me kompetencë për vende me përgjegjësi: *Right men for the right jobs*.
- (3) Në krye qëndron ky parim: *All men are created equal*.
- (4) Me një fjalë, siç thotë Amerikani, neve kemi "*Too many Indian Chiefs but no Indians*".
- (5) Shpesh njerëz fanatikë nuk rendin në shesh të luftës; se fanatikët nuk besojnë në thënien: *he who fights and runs away, lives to fight another day*.
- (6) Profesorë pa numër këtu në Amerikë kanë shkruar libra për të shpjeguar se *all is fair in love and war - and trade*.

Kur bashkëbiseduesi duhet të përcjellë fjalët e dikujt tjetër, ai e thotë në anglishte nëse atë fjalë, sintagmë a fjali e ka dëgjuar në atë gjuhë. Na duket se ky është një qëndrim i përgjithshëm në shumë gjuhë. Në këtë mënyrë folësi ruan origjinalitetin e fjalëve të dikujt tjetër. Disa shembuj e ilustronë këtë:

- (1) ...ëndërruam për më se tri orë duke jetuar në një botë tjetër. *"It's part of my dream collection"*, thotë ai.
- (2) Na lajmërojnë se A. Emin është i sëmurë... nga një letër që morëm, na thotë: *Best regards to everyone and may God bless you all.*
- (3) *"Our Gregory"*, siç e quajten pas vdekjes ca njerëz që e njihnin mirë,...
- (4) *Think imperially* qe slogan i kohës.

Shpeshherë folësi i shqipes së Amerikës prej shqipes del në anglishte në mënyrë të pavetëdijshme në pjesën e dytë të fjalisë apo të periudhës. Zakonisht nuk gjen njeriu arsye për një transfer kodit të tillë. Si duket, është një shprehje e përgjithshme e folësve të tillë të bredhin prej gjuhe në gjuhë, të dalin herë në gjuhën tjetër, e herë në gjuhën e tyre. Por është pyetje e madhe se cila në të vërtetë është gjuha e tyre, gjuha të cilën e zotërojnë më mirë. Ata zakonisht janë më të rrjedhshëm në anglishte, sesa në shqipe, prandaj edhe u duket më lehtë të shprehen në anglishte. Transferi i kodit në këto raste bëhet zakonisht në kufi të sintagmës, të fjalisë ose të ndonjë strukture tjetër. Ka shumë shembuj në materialin tonë. Ja disa:

- (1) Zunë gjëra të tjera pastaj Florence, *I mean they make all the way a trip now...*
- (2) Ca të tjerë që gjejnë gjëra të tjera, *more exciting games, some skiing, and they go on the week-end.*
- (3) Unë akoma i mbaj zakonet, pastaj *another reason* është *because I have* edhe *my mother-in-law*, e cila *likes it.*
- (4) Po të rrimë brenda *he hates it.*
- (5) Edhe pleqtë edhe plakat *the same thing.*
- (6) Vete në dyqan, domethënë, *that's all. I enjoy it.*
- (7) Kishin nisur shqiptarët kur erdhën këtu me një *simplicity that had a charm to it.*
- (8) Në të \$ 7,000,000,000 që mbetën për grupet e tjerë, \$ 3,600,000,000 *were allowed in legal deductible items.*

E kundërta e transferit të kodit të zënë ngoje menjëherë më sipër haset në një grup tjetër të folësve, të cilët fillojnë fjalinë në gjuhën angleze, ndërsa pastaj dalin në gjuhën shqipe. Këta folës, na merr mendja që ose u binte në mend prania jonë si hulumtues ose bëheshin të vetëdijshëm për identitetin e tyre me folës të shqipes, prandaj bënin

përprjekje për t'i përfunduar mendimet e tyre në gjuhën shqipe. Disa shembuj të dhënë këtu mund ta ilustronjë këtë të dhënë:

- (1) *I don't think n'është ajo the point.*
- (2) *Forget the emër, shko atje dhe pastaj le të vijë njerëzia.*
- (3) *This is I've done for Vatra, domethënë, dhe do të bëj anything.*
- (4) *Well, in the meantime, t'ju them edhe këtë...*
- (5) *She never did, ashtu apo jo?*
- (6) *And so we did a couple of times, but you know, she felt guilty pse s'ia bënte.*
- (7) *It's too bad because këto janë ato që na mbajnë.*
- (8) *So he's also në librat në Shqipëri.*

Kemi hasur shumë folës të shqipes së Amerikës, të cilët dalin në gjuhën angleze kur përdorin datat dhe vitet. Ata veprojnë ashtu edhe kur duhet të tregojnë ndonjë largësi në masa e terma të anglishtes. Nga shumë shembuj të regjistruar, po japim vetëm disa:

- (1) Faik Konitza ardhi *ninety twenty one* nga Evropa.
- (2) Mamaja e kishte në *July twenty seven*, shiko.
- (3) Shqipja...që nga sqepi edhe në funt të bishtit është *thirty six inches long*.
- (4) Ajo është *two miles and a half*. si ta thom shqip?

8. Emra të njerëzve

Një ndër problemet e para që has emigranti në Shtetet e Bashkuara të Amerikës është nevoja për të gjetur një emër dhe mbiemër të përshtatshëm për vete, me të cilin ai do të mund të identifikohet. Ky është problem i veçantë për shqiptarët, meqenëse, varësisht nga religjioni i tyre, ata kanë emra myslimanë, ortodoksë apo katolikë. Emrat e gjatë paraqesin vështirësi të posaçme për t'u shqiptuar nga njerëzit e grupeve etnike të tjera dhe, në përgjithësi, nga ata që flasin anglisht në atë vend. Prandaj emrat e shqiptarëve duhet të thjeshtohen ose të shkurtohen në mënyrë që të mund të shqiptohen nga ata.

Emrat e shqiptarëve katolikë janë sigurisht më të ngjashëm me emrat e zakonshëm në Amerikë, ndonëse emrat e shqiptarëve katolikë kanë krijuar trajta tipike në rrjedhë të shekujve. Ata nuk përputhen patjetër plotësisht me emrat e tjerë katolikë të grupeve etnike në Amerikë, sepse këta emra në rrjedhë të kohës janë përshtatur sipas një tradite të gjatë të fonetikës së gjuhës shqipe. Emrat më të rëndomtë të këtij grupi të shqiptarëve të Amerikës, zënë ngoje vetëm disa prej tyre, janë:

<i>Anton</i>	<i>Dedë</i>	<i>Gjergj</i>	<i>Gjon</i>
<i>Katë</i>	<i>Linë</i>	<i>Lizë</i>	<i>Lush</i>

<i>Mark</i>	<i>Mari</i>	<i>Nushë</i>	<i>Pal</i>
<i>Palok</i>	<i>Pashkë</i>	<i>Pren</i>	<i>Zojë</i>
<i>Zef</i>	<i>etj.</i>		

Meqenëse shumica e këtyre emrave janë të shkurtër nga trajta, ata nuk kanë ndryshuar shumë. Megjithatë, disa prej tyre, duke qenë të ngjashëm me emrat e anglezëve, paksa kanë ndryshuar. Kështu, Gjoni është bërë Xhon (John), Pali është bërë Poll (Paul), Pjetri është bërë Pitër (Peter) etj. Disa të tjerë kanë mbetur të pandryshuar, siç janë Mark, Pren, Zef; ndonjë tjetër ose është ndryshuar, si f.v. Maria është bërë Mary, Liza është ndryshuar pak duke dhënë trajtën Liz, Kata është bërë Keit (Kate) etj.

Emrat e shqiptarëve ortodoksë, po ashtu, kanë ndryshuar deri diku, sidomos nëse kanë qenë të gjatë. Por, megjithatë, shumë emra ortodoksë tashmë ishin të njohur në kulturën perëndimore përmjet kulturës greke. Kështu që ata nuk paraqesin vështirësi të mëdha për shqiptim. Prandaj, shumë emra të tillë kanë pësuar vetëm ndryshim të pjesërishëm, disa vetëm në shkrim, si b.f.: *Vangjel* është bërë *Vangel*, *Çaço* është bërë *Chacho*, *Luka* është kthyer në *Lucas*, ose në *Luke*, *Jorgo* është bërë *George* etj.

Emrat e shqiptarëve myslimanë kanë krijuar probleme më të dukshme si për shqipfolësit që i kishin ata ashtu edhe për ata që duhej t'i shqiptonin ata emra. Vështirësi për shqiptim krijonin sidomos emrat e gjatë, siç janë: Abdylaziz, Abdylshyqyr, Demirali, Hajredin, Sabahudin, Nuredin, Sulejman etj. Si pasojë e kësaj, emrat e tillë zakonisht shkurttoheshin duke ruajtur vetëm njërin pjesë të tyre - atë fillestare, apo të fundit, ose ndonjëherë i tërë emri ndryshohej. Kështu Demiraliu është bërë Dem ose Ali, Sabahudini është bërë Sab, Sulejmani u ndryshua në Sul (shqiptohet Sall), Ramadani bëhej Dan, Behajdini, Hajredini, Sabedini dhe emra të tjerë të ngjashëm për nga pjesa e fundit - din janë bërë zakonisht Din, i ngjashëm me emrin anglez Dean, së paku në shqiptim. Mjaft shpesh ndodh që edhe emrat e shkurtër të pësojnë ndryshime, në mënyrë që sa më shumë t'u afrohen emrave të ngjashëm anglezë, si b.f., emri Sami zakonisht bëhet Sam, po edhe Shaipi bëhet Sam, emri Sali zëvendësohet me Sally, Xhaferi ndryshohet në Jeff (Xhef), Fahredini në Frank, Sherafedini bëhet Sherry etj.

Përveç emrave të shqiptarëve që pak a shumë mbështeten në religjionin e personit, siç dihet, ka po ashtu emra të mirëfilltë të shqipes që lidhen me ndonjë personalitet historik, me ndonjë vend a vis gjeografik, po edhe me kuptim të diçkahes, sidomos që kanë të bëjnë me cilësi të ndryshme. Disa prej tyre kanë një traditë më të gjatë të përdorimit, e disa të tjerë kanë filluar të përdoren bukur vonë. Ndër shqiptarët e Amerikës këta emra kanë zënë vend, por jo edhe aq dendur sa të shqiptarët në Shqipëri

dhe sidomos në Kosovë. Si duket, në migrim rrymat e ndryshme të atdheut arrijnë me një vonesë të konsiderueshme. Ndonjëherë emrin ia vëjnë fëmijës edhe për t'ia kushtuar ndonjë paraardhësi të tyre, prandaj ai përsëritet nga gjyshi, stërgjyshi etj. Mirëpo, vërehet se ndryshim më i madh bëhet tek emrat që rrjedhin nga religjioni sesa tek ata që kanë lidhje me ndonjë tipar tjetër.²³ Pra, emrat me përmbajtje kombëtare gjithnjë vijnë duke u shtuar në dëm të atyre me përmbajtje fetare, ndonëse kjo dukuri dallon midis besimtarëve të feve të ndryshme. Shqiptarët katolikë duket se më së paku i ndryshojnë emrat e tyre, me gjasë për shkak të përputhjes më të madhe me emrat e vendit të ri. Ata mund të pësojnë vetëm ndryshime të vogla. Shqiptarët ortodoksë disi më shumë se ata të parët i ndryshojnë emrat duke ua përshtatur ata rrethit të ri. Kurse më së shumti i rezistojnë ndryshimit të emrave të tyre shqiptarët myslimanë, pikërisht për shkak të dallimeve të mëdha të tyre nga emrat anglezë. Mirëpo, nëse bëhen ndryshime të tyre, ato janë shumë të mëdha, dallojnë shumë nga trajtat burimore. Por në këtë çështje luan rol edhe faktori psikologjik. Ata e ndjejnë veten atje disi paksa më të huaj sesa shqiptarët e krishterë.

Shumica e pleqve që kanë shkuar nga atdheu i mbajnë emrat kombëtarë dhe fetarë, kurse u kanë dhënë emra të rinj (që shpesh quhen “emra modernë”) brezave të rinj, si atyre që vijnë rishtas nga atdheu, ashtu edhe atyre që janë lindur në Amerikë. Emrat më tipikë të shqiptarëve të brezit të ri në atdhe (dhe në Kosovë), pa marrë shumë parasysh se cilës fe i përkasin prindërit e tyre, janë ndër të tjerë:

<i>Alban</i>	<i>Agron</i>	<i>Bujar</i>	<i>Ilir</i>
<i>Arben</i>	<i>Baton</i>	<i>Faton</i>	<i>Lulzim</i>
<i>Arbër</i>	<i>Besnik</i>	<i>Fitim</i>	<i>Shpëtim</i>
<i>Agim</i>	<i>Blerim</i>	<i>Gen</i>	<i>etj.</i>

për djem, kurse për vajza:

<i>Arbëreshë</i>	<i>Dritë</i>	<i>Mimozë</i>	<i>Vjollcë</i>
<i>Artë</i>	<i>Jehonë</i>	<i>Shpresë</i>	<i>Vlorë</i>
<i>Blertë</i>	<i>Lule</i>	<i>Valbonë</i>	<i>Zanë etj.</i>

Mirëpo, duhet theksuar se këta dhe emra të ngjashëm nuk u jepen fëmijëve të shqiptarëve emigrantë në Amerikë aq shumë sa u jepen

²³ Kjo rrjedh ngase shqiptarët lidhen më ngushtësisht dhe më thellësisht me kombin dhe gjuhën e tyre sesa me religjionet e tyre të ndryshme. Në të vërtetë, ata mund ta ruajnë shumë më lehtë religjionin e tyre (sidomos shqiptarët katolikë dhe ortodoksë) sesa identitetin e tyre kombëtar dhe gjuhësor në kushtet e Amerikës. Këto dy aspekte të identitetit të tyre janë në zhdukje e sipër në mënyrë të pavërejtshme nga jeta e tyre.

fëmijëve në atdhe, sidomos gjatë decenieve të fundit. Ndër shqiptarët e Amerikës ende mbizotërojnë emrat religjiozë dhe emrat anglezë, një dukuri që vjen duke marrë hov gjithnjë më shumë.

Në rrjedhë të kohës fëmijëve të shqiptarëve të Amerikës, pra, u jepen gjithnjë më shpesh emra amerikanë. Por kjo tendencë është gjë e rëndomtë në përgjithësi në rrugë e sipër të asimilimit me botën e re. Emrat e njerëzve, pra, u janë nënshtuar shumë ndryshimeve në vendin e ri. Ata pasqyrojnë mënyrën më të shpejtë të akulturimit. Kështu që pas dy brezave njerëzit u shmangen plotësisht emrave burimorë dhe ata bëhen të papërdorshëm nëse nuk kanë ekuivalentë amerikanë. Prandaj tani njeriu mund të hasë emra të tillë, si:

<i>James Ally</i>	<i>Jack Ali</i>	<i>James Maliqy</i>
<i>Shirley Lupchishty</i>	<i>Charles Kochi</i>	<i>Cannie Bequari</i>
<i>James Demiry</i>	<i>Frank Shakir</i>	<i>James Tasho</i>
<i>Roland Pirra</i>	<i>Davis Qerimi</i>	<i>Donald Leka</i>
<i>Florence Pano</i>	<i>William Rashit</i>	<i>Judith Chicos</i>
<i>Denise Ben</i>	<i>Luis Zguro etj.</i>	

Sa u përket mbiemrave të njerëzve, shqiptarët në shumicën e rasteve i kanë ruajtur bukur mirë mbiemrat e tyre të vjetër, sidomos nëse ata mund të shkruhen dhe të shqiptohen në anglishte pa vështirësi të mëdha. Mbiemrat e shqiptarëve, sidomos ata të emigrantëve të Amerikës, shpesh e kanë rrjedhën nga fshatrat, qytetet apo trevat prej nga kanë ardhur. Prandaj ka shpesh mbiemra të tillë si:

Kosova, Shkodra, Korça, Berati, Drenica, Trebicka, Treska, Dibra etj.

Disa shqiptarë i kanë ruajtur mbiemrat e tyre të përparmë, veçanërisht nëse ata u ngjajnë mbiemrave të amerikanëve, siç janë:

Costa, Berati, Dashi, Berisha, Thanas, Cipo, Chacho, Oroshi etj.

Ka rëndësi të theksohet se shumë mbiemra të njerëzve janë përshtatur pjesërisht për t'iu përgjigjur përdorimit të tyre në anglishte, sidomos për nga shkrimi. Disa shkronja të shqipes që nuk ekzistojnë në anglishte, janë zëvendësuar me ekuivalentë të anglishtes, kështu /ç/ e shqipes bëhet ch e anglishtes, /q/ zëvendësohet me /k/, ose me qu, /xh/ ndryshon në /j/, /g/ në /g/, /c/ në ts; ndonjëherë /k/ bëhet /c/ në pozitën para zanoreve të prapme; shih: Kosta > Costa etj.

Mirëpo, një numri të madh emigrantësh shqiptarë u janë dukur emrat e tyre të përparshëm si burim vështirësish gjuhësore, në radhë të parë në shkrimin e tyre. Kolegët e punës, partnerët, fqinjët ose miqtë e tyre shpesh u kanë dhënë emra që mund të shqiptohen dhe shkruhen më lehtë. Mbiemrat e tyre nuk u ngjanin fare as emrave as mbiemrave, shikuar nga të tjerët, që kurrë s'i kishin dëgjuar më parë, prandaj tentonin që t'ua ndërronin.

Ndodh shpesh që shqiptarët e Amerikës të kenë një emër për familjen dhe farefisën e tyre, kurse një emër tjetër për të njohurit e tyre të punës dhe për këdo që flet anglisht. Në Amerikë, siç ka vërejtur Haugeni,²⁴ shpesh vetëm inicialet e emrit dhe të mbiemrit mund të funksionojnë si emër i dikujt, prandaj ndonjëherë emigrantët i kanë ikur problemit të shqiptimit dhe të shkrimit të emrit të tyre burimor duke identifikuar vetëm me inicialet. Për shembull, në vend se të thuhet Jetish Krasniqi, ai mund të identifikohet me J.K. (xhej-kej, në shqiptim), ose Gani Kelmendi (xhi-kej), Latif Abdullahu (el-ej) etj.

Në disa raste ka ngjashmëri të madhe madje edhe raporte kognitive midis emrave, siç janë:

Mark, Din (me Dean), Sami (me Sam), Xhafer me Jeffrey, Gjergj me George, Jusuf me Joseph etj.

Por kjo vlen vetëm për një numër të vogël të emrave të njerëzve, pjesa më e madhe e të cilëve kanë origjinë të përbashkët. Sikur të ekzistonin më shumë emra të ngjashëm nga shqiptimi (ndonëse është vështirë ndonjëherë të thuhet sa i ngjashëm është një emër me një tjetër), në raste më të shpeshta do të përvetësoheshin emra anglezë. Ndonjëherë ndodh që shqiptarët të përvetësojnë ndonjë emër që dallon plotësisht nga emri i tyre i mëparshëm si për nga shqiptimi ashtu edhe për nga shkrimi.

Disa nga emrat e dhënë kanë ngelur në trajtën thuaja origjinale të shqipes, duke i ruajtur tiparet e shqiptimit të shqipes. Kanë ndryshuar ndoshta ndonjë shkronjë për t'u përshtatur shprehjeve të drejtshkrimit të anglishtes. Kështu *Çaço* është ndryshuar në *Chacho*, *Konica* është ndryshuar në trajtën e shkruar në *Konitza*, *Kosta* në *Costa*, *Konari* në *Konary* etj.

Përkthimi i emrave të shqiptarëve me emra anglezë nuk ka qenë praktikë e rëndomtë, ndonëse disa prej tyre do të mund të përktheheshin lehtë, siç janë *Guri* me *Stone*, *Kodra* me *Hill* etj.

Nuk kanë hasur vetëm të rriturit në vështirësi në dyqane, biznese dhe fabrika. Edhe fëmijët e emigrantëve kanë përjetuar përvojë të ngjashme në shkollat publike. Fëmijët e emigrantëve ndonjëherë kanë hasur në vështirësi me emrat e tyre, sepse të tjerët nuk i shqiptojnë lehtë. Fëmijët e emigrantëve ishin madje edhe më të ndjeshëm se të rriturit kur emrat e tyre u dukeshin amerikanëve të papërshtatshëm. Jo rrallë, fëmija i ikën emrit të vet dhe provon të gjejë ndonjë zëvendësim të tij. Ky fakt mund të jetë njëri

²⁴ E. Haugen, 1953, f. 206.

ndër arsyet e rëndësishme që emigrantët shqiptarë u jepnin foshnjave të tyre të lindura në Amerikë emra amerikanë. Pos kësaj, martesat e përziera ndikojnë shumë për të përvetësuar emra të rinj dhe për t'u ngjitur fëmijëve të vet emra amerikanë, si kompromis midis bashkëshortëve.

Nga pikëvështrimi gjuhësor, emrat dallojnë nga huazimet e tjera.²⁵ Ata mund të kenë status të posaçëm shoqëror për shkak të të cilit mund të formojnë tipin më të rëndomtë të huazimeve. Ky mund të jetë rast kur individit njihet me emra të ndryshëm në dy gjuhët që i flet, do të thotë, në anglishte dhe në shqipe, në këtë rast. Nga pikëpamja e gjuhës marrëse, emrat shtrihen nga zëvendësimi deri në importim - huazim. Zëvendësimi i plotë nuk është gjë e rëndomtë për mbiemrat e njerëzve, por ai është bukur i rëndomtë për emrat e dhënë atje, sidomos për emrat e shqiptarëve të Amerikës të brezit të tretë.

Sa u përket emrave anglezë, emigrantët shqiptarë i përdorin në rastet më të shumta me shqiptim të anglishtes dhe i shkruajnë sipas drejtshkrimit anglez. Kurdo që zënë ngoje ndonjë familje amerikane ose emër gjeografik, ata provojnë ta shqiptojnë sa më ngjashëm me anglishten. Shumë pak përjashtime nga kjo rregull na kanë rënë në sy. Ata i shqiptojnë me theks në po atë rrokje si shqiptohen edhe në anglishte, ndonëse sipas rregullave të shqipes standarde ata emra do të duhej të shqiptoheshin krejtësisht ndryshe. Po kjo rregull vlen edhe për titujt e institucioneve të ndryshme dhe për emra të tjerë.

Emrat e përveçëm anglezë si edhe shumë huazime angleze të papërshtatura - ndërsa shumica dërrmuese e tyre nuk janë përcaktuar - u duken shqipfolësve pa përvojë me një gjuhë të tillë të përzier, sikur të ishin truptha të huaj në gjuhën shqipe. Ata dallojnë shumë nga intonacioni, dhe shumë shqiptarë të Amerikës i shqiptojnë me zë më të lartë ose në mënyrë që dallon nga fjalët e tjera. Kjo tregon se folësi është i vetëdijshëm për zanafillën e huaj të atyre fjalëve.

Megjithatë, njeriu mund të vërejë një shkallë të vogël të përshtatjes së disa emrave anglezë sipas rregullave gramatikore të gjuhës shqipe, si nga ana fonemike ashtu edhe morfologjike, nëse janë në përdorim më të shpeshtë ose nëse janë të njohur më shumë se emrat e tjerë për një kohë të gjatë, ose posaçërisht nëse ata emra u ishin të njohur shqiptarëve para se të shkonin në Amerikë. Një prej emrave të tillë është emri i vendit Boston. Nga shumë emigrantë shqiptarë ai emër shqiptohet [bos`ton] dhe përdoret me mbaresa të ndryshme kur përdoret në rase të ndryshme, si f.v. Bostoni

²⁵ E. Haugen, 1956, f. 64.

(em.), Bostonit (marginale),²⁶ Bostonin (kall.) etj. Po kjo vlen edhe për vetë emrin e vendit - Amerika/Amerikës/Amerikën.

Duke biseduar për marrëdhëniet ndërgjuhësore të emrave në Kanada dhe në SHBA, Rudnýckiy²⁷ paraqet definicionin dhe tipologjinë e “*bilinguizmit onomastik*” si vijon:

1. Asimilimi i plotë i emrit a) me ruajtjen e emrit të vjetër në një gjuhë dhe me inovacionin në gjuhën tjetër; b) me përshtatjen e emrit të ri (të ndryshuar) në të dy gjuhët në kontakt.
2. Asimilimi i pjesërishtëm i një emri, respektivisht: a) me anë të shkurtimit fillestar (dukuri më e shpeshtë); b) me anë të shkurtimit brenda emrit dhe c) me anë të shkurtimit fundor të emrit.

8.1. Hibridizim i emrit

Të gjitha këto dukuri janë ndeshur tek emrat e shqiptarëve të Amerikës, por vetëm tek emrat dhe mbiemrat (llagapet) e tyre, dhe jo tek emrat gjeografikë dhe emrat e tjerë amerikanë. Emrat e anglezëve nuk janë prekur dhe nuk kanë pësuar fare ndonjë ndryshim.

Në përgjithësi, është tendencë ndër emigrantët e Amerikës që të përdorin emrat anglezë dhe emrat e vendeve dhe të gjuhëve të tjera në të njëjtën mënyrë siç i përdorin folësit e anglishtes. Kjo tendencë bie në sy, veçanërisht, në gjuhën e shkruar. Njeriu shpesh mund të hasë në emra të shkruar: *China, Cypros, Canada, the Soviet Union* etj. në vend të trajtave të shqipes standarde: Kina, Qipro, Kanada, Bashkimi Sovjetik.

Lidhur me prejardhjen e fjalëve, një numër emrash që shënojnë banorët e një vendi apo visi të posaçëm kanë prejardhjen nga emrat gjegjës, siç janë: *kalifornian, Nju Yorkas, bostonian* etj.

Vlen të zihet ngoje që kur disa emra të huaj, siç janë ata francezë, përdoren në shtypin e shqiptarëve të Amerikës, shqiptimi i tyre shpesh jepet në kllapa, si b.f. *Voltaire* (Volterë), *Mirage* (Mirazhë), *Jules Verne* (Zhyl Vernë) etj. Mirëpo, kurrë nuk e japin kështu shqiptimin e ndonjë

²⁶ L. Newmark, 1957, p. 38, përdor termin *rasë marginale*. (Shih edhe Rexhep Ismajli, *Leonard Newmark: Structural Grammar of Albanian* Gjurmime Albanologjike, Seria Shkencore Filologjike, VI, f. 191-194, 1976.), ku Njumarku, për nga forma, i përfshin 3 rasat e gjuhës shqipe (gjinoren, dhanoren dhe rjedhoren) si rasë marginale, meqë kanë trajtën (bazë) të njëjtë të emrit.

²⁷ J. B. Rudnýckiy, *Immigrant Languages, Language Contact and Bilingualism in Canada*, Current Trends in Linguistics, No. 10, ff. 592-653, 1972.

emri të anglezëve. Kjo sigurisht bëhet për shkak se ata emra anglezë emigrantët shqiptarë i konsiderojnë të njohur dhe me ta ndjehen si në shtëpi të vet.

Emrat anglezë jo vetëm që përdoren me drejtshkrimin e anglishtes, por ata gjithashtu përdoren pa farë prapashtesash. S'ka fare shënues të rasave të emrave të tillë. Siç u tha më sipër, vetëm pak emra (si f.v. Boston, Amerika) përdoren ndonjëherë me paradigmat e tyre në shqipe. Këtu po citojmë vetëm disa shembuj. Shenja \emptyset shënon mungesën e mbaresës rasore:

- (1) ... që erdhi posaçërisht nga *Detroit* \emptyset .
- (2) Nga *Dallas* \emptyset shkruajnë gazetata...
- (3) Në këtë ditë shqiptarët e *Ohio* \emptyset do të gjejnë...

9. Përfundim i shkurtër

Shqiptarët e Amerikës i trajtojnë dhe i ndjejnë emrat e përveçëm anglezë gjithnjë më shumë si pronë të tyre dhe kanë një qasje ndaj tyre shumë të ngjashme me atë të folësve burimorë të anglishtes.

*

Filologji, nr. 2, ff. 137-156, Fakulteti i Filologjisë i Universitetit të Prishtinës, Prishtinë 1996.

INTERFERENCA MORFOLOGJIKE E ANGLISHTES NË SHQIPEN E AMERIKËS

1. Në përgjithësi

Studimet mbi kontaktet gjuhësore janë marrë më shumë me fonologji dhe leksik, sesa me gramatikë. Madje edhe Sapiri mendonte se vetëm ndikimi i brendshëm sipërfaqësor mund të haset në morfologji.¹ Kjo mund të jetë për shkak se ky problemi i fundit është më i ndërlikuar se i pari. Haugeni ka dhënë një pasqyrë më të plotë të studimeve të bëra në këtë fushë.²

Si pasojë i interferencës fonematike, gjuha shqipe në Amerikë ka pësuar ndryshime të cilat janë shkaktuar nga dy lloje dukurish: a) ndikimi i anglishtes në gjuhën e folësve të shqipes si rezultat i kontaktit gjuhësor që shkakton huazimin e dallimeve gramatikore në shqipen e Amerikës, dhe b) dobësimi gradual i kompetencës gjuhësore të shqipes te ata folës. Ndonëse nuk ka dallime të mëdha në çështjet kryesore sintaksore midis anglishtes dhe shqipes, ato dy gjuhë dallojnë në çështjet e derivacionit dhe të eptimit.³ Sipas Mackeyut, “dy gjuhë shpesh kanë të njëjtat pjesë të ligjëratës, por mund të dallojnë dukshëm në mënyrën si i sistemojnë ato në struktura”.⁴ Bilingët mund të jenë fare të pavetëdijshëm për interferencat e tilla. Janë bukur të shpeshta rastet kur vihet mbiemri para emrit në shqipen e Amerikës, gjë që në shqipen standarde bëhet vetëm për theksim të veçantë, kur radhitja e zakonshme bëhet emër + mbiemër. Ky model strukturor është sforcuar nga prania e përhershme dhe nga trysnia e kësaj radhitjeje të anglishtes. Anglishtja është gjuhë më analitike se shqipja, prandaj rendi i fjalëve ka rëndësi të madhe në atë, ndërsa gjuha shqipe është tepër sintetike në rrafshin gramatikor dhe mund të ketë renditje më të llojllojshme fjalësh.

Ka mendime të ndryshme përkitazi me gramatikën madje edhe ndër linguistët e mirënjohur. Shumë prej tyre nuk pajtohen për çështjet

¹ E. Sapir, 1921, f. 217.

² E. Haugen, 1973.

³ P. D. Seaman, 1972.

⁴ W. F. Mackey, 1962.

se ku duhet të tërhiqet vija midis morfologjisë dhe sintaksës. Megjithatë, kjo nuk duhet të jetë pengesë për analizën e interferencës gramatikore.⁵

Fjala që huazohet prej një gjuhe në tjetrën mund të bëhet objekt interference i sistemit gramatikor si edhe i sistemit leksikor dhe fonemik i gjuhës marrëse.⁶ Kjo interferencë është veçmas e dukshme kur fjala e tillë përdoret nga folësi monoling. Efektet e një interference të tillë mund të shtrihen prej trajtës plotësisht të papërshtatur deri tek integrimi i plotë gramatikor i atij elementi të huaj gjuhësor.

Procedura më e rëndomtë në këtë proces në të kaluarën ka qenë përshtatja gramatikore e huazimeve. Kur fjalët barten në një gjuhë, ato duhet të përshtaten në strukturën e saj gramatikore. Gjëja e parë që duhet bërë është të caktohen huazimet nëpër klasë të ndryshme gramatikore që njihen tradicionalisht si pjesë të ligjëratës, të cilat ekzistojnë në gjuhën marrëse.

Anglishtja dhe shqipja i përkasin familjes së gjuhëve indoevropiane, prandaj kanë kategori të ngjashme gramatikore, ndonëse kjo nuk do të thotë që ato patjetër duhet të jenë e as që janë të ngjashme në çdo aspekt gramatikor. Në përgjithësi, shqipfolësit e Amerikës emrat e anglishtes i huazojnë si emra, foljet si folje dhe mbiemrat si mbiemra. Pjesët e tjera të ligjëratës nuk huazohen veçmas, por vetëm në sintagma ose shprehje së bashku me fjalë të tjera.

Është veçanërisht interesant të vështrohet integrimi gramatikor i huazimeve kur janë në dispozicion disa klasë të gjuhës marrëse, në rastin tonë - të shqipes. Ndër raste të tilla është edhe gjinia e emrit.

2. Emri

2.1. Gjinia. Si anglishtja ashtu dhe shqipja, kanë të tri gjinitë e gjuhëve indoevropiane - mashkullore, femërore dhe asnjansë. por me denduri të ndryshme të përdorimit. Ato dallojnë shumë për nga mënyra e klasifikimit të emrave sipas gjinive. Anglishtja është bukur e thjeshtë në këtë pikëpamje, meqenëse në përgjithësi bën dallim të gjinisë vetëm tek emrat që kanë gjini natyrore (që kanë seks, madje përkufizohet vetëm në emrat gramatikorë të njerëzve), ndërsa gati të gjithë emrat e tjerë janë asnjansë. Gjuha shqipe, nga ana tjetër, ka gjini gramatikore, e cila përcaktohet nga

⁵ U. Weinreich, 1953, p. 29

⁶ U. Weinreich, 1953, f. 44; L. Bloomfield, 1935, p. 453.

mbaresat e emrave. Kur huazohen emrat gramatikorë të anglishtes në gjuhën shqipe, çdo emër i tillë që i përket gjinisë asnjane të anglishtes mund të integrohet në gjininë mashkullore ose femërore, dhe shumë rrallë në gjininë gramatikore asnjane.⁷ Kjo çështje vetvetiu u krijon probleme folësve të shqipes në Amerikë, për shkak se gjatë procesit të huazuarit të emrave të anglishtes në shqipen e Amerikës paraqitet disjunksioni logjik inkluziv. Kjo mund të shpjegohet si vijon:

→ aa √ Shm, Shf

Me fjalë kjo do të thuhet: nëse është aa (gjinia asnjane e anglishtes), atëherë ose gjini mashkullore e shqipes (shm) ose gjini femërore e shqipes (shf). Fakti se emrat e anglishtes gjatë procesit të huazuarit në gjuhë të tjera duhet të caktohen në gjini të ndryshme, ka nxitur interesim të madh ndër hulumtuesit e gjuhëve të grupeve etnike të Amerikës⁸ dhe ndër linguistët që kanë të bëjnë me elementet gjuhësore angleze në gjuhët e tjera.⁹

Janë bërë përpjekje të shumta për të mësuar pse disa emra caktohen më shumë në njërin gjini, sesa në tjetrën të gjuhës marrëse. Shpjegimet e dhëna në këtë fushë nuk na kanë dhënë mundësi të caktojmë rregulla me të cilat mund të parashihet gjinia e çdo emri në momentin kur emri huazohet në gjuhën marrëse. Duket se veprojnë disa faktorë për caktimin e gjinisë së një emri, prandaj është e pamundshme të përcaktohet se cili faktor vepron në një rast të posaçëm. Kjo punë bëhet edhe më e vështirë kur të shihet se ka aq shumë përjashtime nga çdo rregull e marrë me mend. Prandaj hulumtimet tona të bëra mbi këto çështje të gjuhës shqipe të Amerikës mbështeten vetëm në gjasa.

Kur folësit e shqipes së Amerikës bëjnë gabime në të përdorurit e gjinisë së duhur të emrit, duket se, pos interferencës që ekziston nga ana e anglishtes, këtu ka gisht edhe dobësimi i kompetencës së tyre në shqipe.

Haugeni, duke bërë fjalë për integrimin e emrave në gjini,¹⁰ pohon

⁷ Siç dihet, gjinia asnjane ka përdorim gjithnjë e më të rrallë në gjuhën shqipe.

⁸ E. Haugen, 1953, f. 440.

⁹ R. Filipović, 1966, ff. 1-16; *Some Problems in Studying the English Element in European Languages*, Studia Romanica et Anglica Zagrebiensia, Vol. 4, Nos. 1-2, ff. 141-158, Poznan, 1972, and in *English Series Today*, 5, Istanbul, 1973, ff. 25-52; *A Contribution to the Method of Studying Anglicisms in European Languages*, Studia Romanica et Anglica Zagrebiensia, No.37, ff. 135-148, Zagreb, 1974; *Primary and Secondary Adaptation of Loan-words*, Wiener Slavistisches Jahrbuch, XXIII, ff. 115-125, Wien, 1977.

¹⁰ E. Haugen, 1953, f. 441.

se kishte mundësi të viheshin në dukje disa raporte të tyre me trajtat e emrave të gjuhës amtare, e kjo shpinte në shumë raste që të caktohej gjinia e emrit. Ato raporte apo asociacione mund të mbështeten në ngjashmëri të tingujve ose të kuptimit të emrit ose edhe në njërën dhe në tjetrën.

Megjithatë, është vënë në dukje se shumica e gjuhëve tregojnë tendencë të fuqishme të caktojnë shumë më tepër emra të huazuar në njërën nga gjinitë. Baza e klasifikimit duhet të merret me mend të jetë produktiviteti më i madh i njëres nga gjinitë në gjuhën marrëse: mashkullorja në norvegjishten amerikane, në lituanishten amerikane dhe në portugalishten amerikane; femërorja në gjermanishten amerikane dhe në jidishten e Amerikës.¹¹ Surducki konstaton se emrat femërorë të serbokroatishtes tregojnë përshtatje në njëjës in e emërores, ndërsa emrat mashkullorë përshtaten pa ndonjë mbaresë në serbokroatishten e Kanadasë.¹²

Shumica e replikave të drejtpërdrejta të modeleve të anglishtes mund të gjenden në emrat e gjinisë mashkullore të shqipës në Amerikë, ndërsa shumë emra të gjinisë femërore (dhe rastësisht ndonjë i gjinisë asnjëse) duket se janë vetëm rezultat i derivacionit të dorës së dytë. Ndonjëherë mbasesat morfologjike u shtohen huazimeve të papërshtatura, ndonëse jo gjithmonë. Të shënojmë disa shembuj, ndonëse ndonjë me mbaresë me prejardhje sllave, të cilat janë bukur të shpeshta në ato të folme:

boss + ja > *bossja*; chairman + ka > *chairmanka*; reporter + ka > *reporterka* etj.

Në shumicën e gjuhëve të imigrantëve në SHBA mbizotëron një tendencë e qartë për gjininë mashkullore. Në shqipën e Amerikës kjo dukuri është shumë e dukshme. Të dhënat tona tregojnë se vetëm nja dhjetë për qind të emrave të huazuar kanë marrë gjininë femërore, ndërsa të gjithë emrat e tjerë kanë marrë gjininë gramatikore mashkullore. Vështirë mund të kuptohet arsyeja e kësaj çështjeje, sidomos kur të mbahet parasysh fakti se shqipja nuk duket të ketë më shumë emra të gjinisë mashkullore sesa të gjinisë femërore.¹³

¹¹ U. Weinreich, 1953., f. 45.

¹² M. I. Surducki, 1966, f. 56

¹³ Të nxitur nga ky mbizotërim i gjinisë mashkullore të emrave të huazuar nga anglishtja në shqipën e Amerikës, kemi bërë një provë të thjeshtë me gjuhën e shkruar shqipe për të parë nëse ka më shumë emra gramatikorë të gjinisë mashkullore sesa të gjinisë femërore në gjuhën shqipe. Ndonëse materiali i shfrytëzuar për këtë qëllim ishte i kufizuar dhe mbase nuk paraqet gjendjen e saktë reale, besojmë, megjithatë, se treguesit e fituar nga ajo provë kanë një vlerë. Për këtë qëllim morëm nga një kaptinë nga romanet *Afërdita* (e S. Spasses), dhe nga *Lumi i vdekur* (i J. Xoxes), një kaptinë nga libri *Historia e popullit shqiptar* dhe në fund gazetën e përditshme *Rilindja* (të 20 nëntorit 1975) dhe i numëruam të gjithë emrat që u paraqiten në tekstin vijues.

Nga ana tjetër, është një shkallë bukur e lartë e lëvizjes në caktimin e gjinisë; shumë emra janë përdorur në të dyja gjinitë - mashkullore dhe femërore. Mund të hasë njeriu në të dyja këto përdorime:

bill (m.) dhe *billë* (f.); *credit* (m.) dhe *kreditë* (f.); *kontribut* (m.) dhe *kontributë* (f.) etj.

Kjo dukuri duket e rëndomtë në shumë gjuhë të tjera të emigrantëve të Amerikës.¹⁴

Në të caktuarit se cilën gjini do të marrë emri, ndikimin më të madh e ka gjinia natyrore e tij. Pastaj prapashtesat dhe mbaresat luajnë rol të posaçëm, por shpeshherë edhe fjalët burimore sinonime të huazimeve. Emrat e papërshtatur janë zakonisht të gjinisë mashkullore, pos nëse tregojnë krijesa të gjinisë femërore.

Në mbështetje të materialit për studim, mund të shihet se në shqipen e Amerikës gjinia u ngjitet emrave në tri mënyra.

Nëse emri i anglishtes ka gjini natyrore, ai gjithmonë merr gjininë e njëjtë kur emri i huazuar bëhet njësi leksikore integrale e gjuhës shqipe të Amerikës, si f.v.:

aktresë - *aktresa*; *bestman* - *bestmani*; *nursë* - *nursa*, *sherif* – *sherifii* etj.

Shembull që t'i vijë ndesh kësaj rregulle nuk kemi hasur gjatë hulumtimit tonë. Mendojmë se këta emra dhe të tjerë të ngjashëm nuk e kanë marrë gjininë femërore për shkak të ndonjë kontaminimi me emrat përkatës të gjuhës shqipe,¹⁵ por vetëm pse shënojnë qenie njerëzore të gjinisë përkatëse.

Nëse emri i gjuhës shqipe është zëvendësuar me një emër të anglishtes, ose nëse huazimi i anglishtes ka zëvendësuar ndonjë emër të shqipes të ngjashëm nga kuptimi, ai ka marrë gjininë sipas gjinisë së emrit të ngjashëm në gjuhën shqipe, përkatësisht të emrit që e ka

Vlen të ceket se përpjestimi i emrave gramatikorë mashkulorë dhe femërorë në ato dy romane nuk u përputh. Në *Afërdita* (në kaptinën e zënë ngoje) mbi 62% të emrave kishin gjininë gramatikore mashkullore, ndërsa mbi 37% të tyre kishin gjinë femërore, kurse në *Lumi i vdekur* mbizotëronte gjinia femërore, mbi 53% ndaj rreth 46% të gjinisë mashkullore. Në librin e historisë të zënë ngoje mbizotëronin emrat e gjinisë mashkullore, me mbi 56% ndaj 43% të gjinisë femërore. Për çudinë tonë, emrat e të dyja gjinive qenë gati me numër të njëjtë në gazetën e zënë ngoje. Nga numri i përgjithshëm i emrave të këtyre burimeve të shkruara, nja 10% më shumë qenë emra të gjinisë femërore sesa të gjinisë mashkullore.

¹⁴ E. Haugen, 1953, f. 442.

¹⁵ R. Filipović, *The Morphological Adaptation of English Loan-words in Serbo-Croatian*, Studia Romanica et Anglica Zagrebiensia, No. 11, Zagreb 1961, p. 94; E. Haugen, 1953, f. 460..

zëvendësuar. Kjo dukuri shpjegohet si pasojë e kontaminimit¹⁶ midis emrit të huazuar dhe ndonjë fjale ekzistuese në gjuhën shqipe. Emrat vijues janë integruar në gjininë femërore si pasojë e kontaminimit:

assitencë - asistenca, sipas ndihmë - ndihma;
kurtinë - kurtina, sipas perde - perdja;
kontributë - kontributa, sipas ndihmë - ndihma etj.

Shembujt vijues janë, po ashtu, pasojë e kontaminimit nga emrat e gjinisë mashkullore të shqipes, prandaj janë integruar në gjininë mashkullore të shqipes së Amerikës, p. sh.:

holl - hollli, sipas korridor - korridori;
eksam - eksami, sipas provim - provimi;
klim - klimi, sipas mot - moti etj.

Për arsyet e panjohura për ne, duket se është më lehtë të shpjegohen rastet kur emrat marrin gjininë femërore, sesa gjininë mashkullore, së paku sa i përket shqipes.

Është tendencë e përgjithshme e emrave të anglishtes kur huazohen në gjuhën shqipe të Amerikës që të marrin gjininë mashkullore nëse ata mbarojnë me bashkëtingëllore të gjuhën angleze. Kjo shpesh bëhet edhe përkundër ndonjë fjale ekzistuese në shqipe, e cila do të mund të shërbente si mjet kontaminimi. Ka shumë shembuj, por mund të zihen ngoje vetëm disa:

atempt-i (qëllimi), kord-i (turra), draft-i (thirrja ushtar), kiçin-i (kuzhina), slogan-i (parulla) etj.

Këta shembuj, pra, do të mund të integroheshin fare lehtë në gjininë femërore, nëse do të kishte dorë kontaminimi nga emrat me kuptim të ngjashëm të gjuhës shqipe. Kështu do të kishim emrat: *atempta* i ndikuar nga *përpyjekja*; *korda* i ndikuar nga *turra*; *drafta* i ndikuar nga *thirrja*; *kiçina* i ndikuar nga *kuzhina*; *slogana* i ndikuar nga *parulla*, respektivisht *fjala* etj. Mirëpo, te këta emra të huazuar ky parim nuk pati fuqi ndikimi, me gjasë, pos tjerash, edhe për arsye të intuitës së dobësuar bukur shumë për gjuhën shqipe standarde, prandaj në këto raste dhe në të tjera të ngjashme, rregulla fonemike e mbështetur në bashkëtingëlloren e fundit të rrënjës së fjalës (emrit) në anglishte ka pasur vendimin përfundimtar.

Emrat e anglishtes që kanë prapashtesën *-(a)tion* ose *-(a)sion* marrin në përgjithësi gjininë mashkullore, nëse ato prapashtesa të emrave të anglishtes zëvendësohen me *-(a)cion* të shqipes së Amerikës, p.sh.:

¹⁶ R. Filipović, 1961, edhe 1971.

application > *aplikacion*; recommendation > *rekomandacion*;
violation > *violacion*; competition > *kompeticion* etj.

Mirëpo, në qoftë se emrat e huazuar të anglishtes me ato prapashtesa kur barten në gjuhën shqipe të Amerikës e zëvendësojnë atë prapashtesë me një prapashtesë fare tjetër të shqipes, ka mundësi që ata të marrin gjininë femërore, si b.f.:

application > *aplikatë*; competition > *kompeticje*; concession > *koncesje*; observation > *observatë*; vacation > *vakancë* etj.

Si rregull është një prirje që emrat e huazuar të anglishtes që mbarojnë me togun bashkëtingëllor *-ns* në shqiptim të marrin gjininë femërore në shqipen e Amerikës, p.sh.:

balance > *ballancë*; dance > *dancë*; preference > *preferencë*;
violence > *violencë* etj.

Megjithatë, ka përjashtime nga kjo prirje e përgjithshme në këtë gjuhë marrëse, siç është, b.f., licence > *laisenc-i*. Prandaj, prapashtesat *-anca*, *-enca*, *-ansa*, *-ensa* duken të jenë të prejardhura në disa huazime të shqipes së Amerikës.

Mirëpo, në përgjithësi është e paparashikueshme nëse një emër i huazuar nga anglishtja do të integrohet në njërin gjini apo në tjetrën në shqipen e Amerikës. Duket se kjo është një çështje shumë arbitrare dhe e ndikuar nga shumë faktorë të zënë ngoje më sipër. Megjithatë, mbeten edhe shumë emra të cilët nuk kanë mundësi të përcaktohen se si kanë marrë njërin gjini apo tjetrën. Se kësaj çështjeje nuk mund t'i përgjigjemi përfundimisht, mund të vërtetohet me faktin se disa emra të huazuar nga anglishtja janë integruar në të dyja gjinitë - në mashkullore dhe në femërore në të folur shqip të Amerikës. Kështu kemi rastet:

bill-i dhe *billë-a*; *kash-i* dhe *kashë-a*; *senc-i* dhe *sencë-a*; *event-i* dhe *eventë-a*; *taks-i* dhe *taksë-a* etj.

Disa emra të huazuar nga anglishtja që mabrojnë me zanore, nëse nuk kanë gjini natyrore dhe nëse nuk kanë kontaminim të gjinisë me ndonjë emër të shqipes, integrohen në gjininë femërore në shqipen e Amerikës. Disa nga shembujt mund të jenë:

agenda > *agjendë-a*; *cafeteria* > *kafeteri-a*; *grocery* > *grosaria* etj.

Emrat e anglishtes që mbarojnë me: *-ar*, *-er*, *-ir*, *-or* etj. nuk merren këtu parasysh, e as ata që mbarojnë me diftongjet në kombinim me [i] si pjesë e dytë e diftongut, siç janë:

dancer > *dansator-i*; *editor* > *editor-i*; *tramway* > *tramvaj-i* etj.

Në rastin e prapashtesave të zëna ngoje më sipër, mund të thuhet se aty kemi të bëjmë me morfemat që lidhen me ngjashmërinë semantike. Del e qartë puna se këtu mund të shihet fare mirë ndikimi i

prapashtesave si një rregull e veçantë, sipas së cilës morfema e fundit e përcakton gjininë, por kjo ndodh vetëm kur prapashtesa njihet si diç që lidhet me prapashtesën e ngjashme në gjuhën shqipe.

Zëvendësimi i prapashtesës *-ity* të anglishtes me prapashtesën *-itet* të shqipes në huazimet angleze është identifikim me fjalët e ngjashme të shqipes standarde, shumica e të cilave janë huazuar nga frëngjishtja, si p.sh.:

ability > *abilitet*; *facility* > *facilitet*; *generosity* > *gjenerositet* etj., ngjashëm si në shqipen: *prioritet*, *solidaritet* etj.

Janë disa emra të huazuar nga anglishtja, të cilët ka kohë që përdoren në shqipen standarde dhe mund t'u jenë të njohur folësve të shqipes në Amerikë. Ata emra tashmë janë integruar në njërin gjini të emrave të shqipes, ndërsa shqipfolësit e Amerikës vetëm mund t'i huazojnë dhe forcojnë në ligjërimin e tyre. Në mesin e fjalëve të tilla mund të jenë këto që vijojnë:

buxhet-i < budget; *xhungël-a* < jungle; *poker-i* > poker; *rekord-i* < record etj.

Një numër i kufizuar i emrave të huazuar nga anglishtja që kanë gjini natyrore femërore në shqipen e Amerikës i kanë ndërtuar trajtat e tyre të gjinisë femërore duke ua shtuar trajtave të mashkullores (apo mund të thuhet edhe temës) prapashtesën *-ka*.¹⁷ Kjo prapashtesë është me origjinë sllave, por haset në disa të folme të shqipes siç është rajoni i Korçës, prandaj duket se është bartur me disa fjalë të tjera shqipe në ligjërimin shqip të disa rajoneve të Amerikës. Në bazë të kësaj, ajo prapashtesë u shtohet edhe huazimeve nga anglishtja. Për shembull:

reporter + ka > *reporterka*; Ingliz + ka > *Inglizka*; chairman + ka > *chairmanka*; Ajrish + ka > *Ajrishka* etj.

Përveç emrave për të cilët është bërë përpjekje të klasifikohen sipas rregullave të ndryshme për të marrë gjininë përkatëse, është një numër i konsiderueshëm emrash, në të cilët nuk vërehet ndonjë rregull ose arsye për të marrë gjininë të cilën e kanë. Çkado që njeriu përpiket të gjejë si arsye për një caktim të tillë, del vetëm spekulim. Pse, për shembull, *aliverta* (nga “elevator”) ka marrë gjininë femërore, *gazolina* (nga “gasoline”) - femërore, *marketa* (nga “market”) - femërore, *kiçini* (nga “kitchen”) - mashkullore, *paundi* (nga “pound”) - mashkullore etj. Këtu lypset të mbështetet shpjegimi i Haugenit.¹⁸ Ai sugjeron që arsyet mund të

¹⁷ Shih për këtë çështje edhe artikullin *Interferenca leksikore në shqipen e Amerikës* në këtë botim.

¹⁸ E. Haugen, 1953, f. 449.

gjenden në mënyrën e rastësishme në të cilën janë marrë fjalët. “Ato nuk janë si huazimet që janë marrë nga njerëzit e mësuar (të shkolluar), që i kanë përvetësuar pas një shqyrtimi të nevojshëm dhe me vetëdije të plotë se cilat fjalë apo nocione të gjuhës marrëse do t’i zëvendësojnë ato huazime. Shumica e tyre përdoren pikërisht për shkak se folësit nuk i dinin ose atyre nuk u kujtoheshin fjalët gjegjëse të gjuhës së tyre ose, ndoshta, për arsye se ata kurrë nuk kishin dëgjuar fjalë të gjuhës së vet për të shprehur mendime apo nocione, të cilat i shprehin ato fjalë të huaja.”

Pos asaj që kemi thënë për caktimin e gjinisë së emrave të huazuar nga anglishtja në shqipen e Amerikës, është një numër shumë i madh i huazimeve të papërshtatura fonemikisht ose morfemikisht, të cilët nuk kanë marrë asnjërin nga gjinitë, ose që së paku nuk kanë ndonjë shënues që do të tregonte gjininë e tyre. Ata përdoren në trajtë neutrale dhe mund të përputhen me të dyja gjinitë, varësisht nga konteksti në të cilin paraqiten. Mbi këtë çështje Weinreichu vërente se “zgjedhja shpesh bëhet nga folësi duke integruar ose duke mos integruar fjalët e huazuara, një zgjedhje e cila duket edhe më e qartë në gramatikë, sesa në tinguj. Zgjedhja e tillë bëhet nga folësi mbi çështjen e gjinisë gjë që varet nga faktorë individualë psikologjikë dhe socio-kulturorë, të cilët mbizotërojnë në kontakt”.¹⁹

2.2. Numri i emrit

Si anglishtja ashtu dhe shqipja kanë dy numra të emrave: njëjës dhe shumës. Thuaja të gjithë emrat e anglishtes që janë përshtatur fonemikisht sipas sistemit gjuhësor të shqipes, e bëjnë shumësin njësoj siç e bëjnë edhe emrat e mirëfilltë të gjuhës shqipe. Këtu janë disa shembuj të ndërtimit të shumësit në shqipen e Amerikës.

Njëjës + -a > shumës. - Një numër emrash të gjinisë mashkullore e formojnë trajtën e shumësit duke shtuar mbaresën -a trajtës së njëjësit.²⁰ Emrat që i përkasin këtij grupi mbarojnë me bashkëtingëllore. E njëjta rregull vlen edhe për një kategori të emrave të huazuar nga anglishtja në shqipen e Amerikës, si f.v.:

Emrat në angl.	Huazime në shq. amer.	Si në shq. standarde
airplane	airplan + -a > <i>aiplana</i>	çun + -a > çuna
jeep	xhip + -a > <i>xhipa</i>	rrip + -a > rripa
license	lajsens + -a > <i>lajsensa</i>	lis + -a > lisa
inch	inç + -a > <i>inça</i>	viç + -a > viça

¹⁹ U. Weinreich, 1953, f. 46.

²⁰ Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSAK-së, Prishtinë, 1971. f. 33.

Njëjës + -e > shumës. - Bukur shumë emra të huazuar nga anglishtja të gjinisë mashkullore e bëjnë shumësin duke u shtuar mbaresën shqipe të shumësit *-e*. Edhe emrat e këtij grupi mbarojnë me bashkëtingëllore dhe veprojnë njësoj si edhe emrat e shqipes, p.sh.:

Emrat angl.	Huazime në shq. amer.	Si në shq. standarde
ability	abilitet + <i>-e</i> > <i>abilitete</i>	det + <i>-e</i> > <i>dete</i>
board	bord + <i>-e</i> > <i>borde</i>	vend+ <i>-e</i> > <i>vende</i>
rumor	rumor + <i>-e</i> > <i>rumore</i>	korridor+ <i>-e</i> > <i>korridore</i>
tranch	trenç + <i>-e</i> > <i>trençe</i>	ranç + <i>-e</i> > <i>rançe</i>
homage	homagi + <i>-e</i> > <i>homagje</i> etj.	

Demiraj vëren se emrat e huaj që mbarojnë me *-et* dhe me *-ion* në kushte normale e formojnë trajtën e shumësit duke u shtuar mbaresën *-e* të shqipes.²¹ Këtë rregull e kanë respektuar emrat si f.v.: abilitet +*-e* > *abilitete*; admision +*-e* > *admissione* etj.

Vlen të zihet ngoje se emrat e shqipes që i përkasin këtij grupi, kur përdoren me dëftorë dhe me mbiemra, kërkojnë gjininë femërore dhe, po ashtu, edhe dëftorët dhe mbiemrat i kërkojnë në gjininë femërore.²² Po kjo rregull vlen dhe tek emrat e huazuar nga anglishtja. Shembuj:

ky ekstrim > *këto ekstrime*; *ky rumor* > *këto rumore*; *ky bord* > *këto borde* etj.

Kjo dukuri ka mbizotëruar në gjuhën shqipe tashmë një shekull dhe ende nuk ka marrë fund. Prandaj në disa të folme ende përdoret gjinia mashkullore edhe në shumë të këtyre emrave dhe të emrave të ngjashëm. Kjo dukuri quhet ndryshim i gjinisë. Mirëpo, duket se nuk ka rregull morfologjike për të përcaktuar këtë çështje, prandaj ndryshimi i gjinisë së emrave në shumë duket të jetë gjë bukur arbitrare. Në bazë të kësaj, mendojmë se shumësi i disa emrave të huazuar nga anglishtja është bërë në bazë të të ashtuquajturit kontaminim nga disa emra të shqipes të marrë për nga kuptimi. Këtë të dhënë mund ta ilustruon me këta shembuj:

borde sipas fjalës shqipe ushqime;
inça sipas fjalës shqipe gishta;
rumore sipas fjalës shqipe thashetheme etj.

Njëjës + -ë > shumës. - Një numër i madh emrash e bëjnë shumësin duke i shtuar mbaresën *-ë* trajtës së njëjësit, si b.f. qytetar + *-ë* > qytetarë. Kështu kanë bërë shumësin shumë emra të huazuar nga anglishtja në shqipen e Amerikës. Për shembull:

²¹ Sh. Demiraj, 1971.

²² Sh. Demiraj, 1971.

Emrat në anglishte

assassin
banker
clerk
foreman
radar

Huazimet në shq. e Amer.

asasin + -ë > *asasinë*
banker + -ë > *bankerë*
klerk + -ë > *klerkë*
foreman + -ë > *foremanë*
radar + -ë > *radarë* etj.

Sipas Demiraj,²³ shumësi formohet në këtë mënyrë tek emrat që mbarojnë me prapashtesat: *-an, -or, -tor, -ar* (ose *-uar*), *-ak, -ok* etj. Shembujt e zënë ngoje më sipër dhe shumë të tjerë nga materiali i mbledhur i shqipes së Amerikës tregojnë se ka shumë emra që nuk mbarojnë me prapashtesa të tilla dhe, megjithatë, e formojnë shumësin duke ua shtuar emrave mbaresën *-ë*. Mendojmë se kjo nuk paraqet ndonjë risi në sistemin morfologjik të gjuhës shqipe, por kujtojmë se mund të ketë emra të tjerë të shqipes standarde që japin rezultate të tilla.

Një numër emrash të banorëve të një vendi formohen në shqipen e Amerikës duke ia shtuar emrit të vendit prapashtesën *-(i)an*, natyrisht, e kryer nën ndikimin e trajtave angleze të atyre emrave. Shumësi i tyre bëhet duke ia shtuar trajtës së njëjësit mbaresën *-ë*, si f.v. Boston + *ian* + > *bostonian* + *-ë* > *bostonianë*; Kaliforni + *ian* + > *kalifornian* + *-ë* > *kalifornianë* etj.

Në pajtim me këtë tip është edhe shumësi i emrit ilir + *ian* > *ilirian* + *-ë* > *ilirianë*, ndërsa në shqipen standarde shumësi i këtij emri është *ilirë*. S'ka dyshim se kjo trajtë e shumësit është bërë nën ndikimin e anglishtes: *Illyrians*. Ndonëse në shqipe ka raste kur krijohen emrat duke ia shtuar prapashtesën *-(i)an* një emri tjetër që shënon toponim, si Pejë + *-an* > *pejan*, Mat + *-ian* > *matjan* etj., mendojmë se në shqipe emri i drejtë i banorëve të Bostonit do të ishte *bostonas*.

Njëjës + -ër > shumës. - Një numër i vogël emrash të shqipes e formojnë shumësin duke ia shtuar trajtës së njëjësit prapashtesën *-ër*, si mbret + *-ër* > *mbretër*, nip + *-ër* > *nipër*, prift + *-ër* > *priftër* etj. Sipas kësaj rregulle e bën shumësin një numër shumë i kufizuar i emrave të huazuar nga anglishtja nga disa folës të shqipes së Amerikës, si f.v.: lord + *-ër* > *lordër*.

Ndikimi i formimit të shumësit sipas rregullës së lartshënuar është përhapur dhe te shumë emra të tjerë, madje edhe të gjinisë femërore në të folurit e shqiptarëve të Amerikës, duke i shtuar njëjësit prapashtesën *-ra*, si: këngë + *-ra* > *këngëra*, punë + *-ra* > *punëra*, kolloni + *-ra* > *kollonira* etj.

Kjo mënyrë e formimit të shumësit mund të ketë tipare dialektore

²³ Sh. Demiraj, 1971

apo të një të folmeje, por në shqipen e shumë shqiptarëve të Amerikës është përforcuar shumë më tepër se gjetiu. Kjo çështje mund të jetë interesante, sepse tregon se në gjuhë mund të ndodhë një zhvillim i ri, i shkëputur nga dega amtare, natyrisht nën ndikimin e një të folmeje a dialekti.

Njëjës + palatalizimi i [k] ose [g] + -e > shumë. - Disa emra të gjinisë mashkullore, që mbarojnë me velaret [k] ose [g], e formojnë shumësin me palatalizimin e atyre bashkëtingëlloreve fundore në [q] ose [gj], duke ia shtuar rrënjës mbaresën -e, si f.v.: burg + palatalizim > burgje; lak + palatalizim > leqe etj.

Disa nga huazimet e anglishtes në trajtë emrash që mbarojnë me [k] ose [g] e bëjnë shumësin në mënyrë të ngjashme me emrat e shqipes:

çek + palatalizim + -e > *çeqe*,^{&^)}
 park + palatalizim + -e > *parqe*;
 trik + palatalizim + -e > *triqe*²⁴ etj.

Por duhet të ceket fakti se jo të gjithë emrat e huazuar nga anglishtja, që mbarojnë me [k] ose [g], janë palatalizuar në shumësin e përdorur në shqipen e Amerikës. Kështu janë rastet si: miting > *mitinge*, piknik > *piknike*, stok > *stoke* etj.

Në të vërtetë, këta emra dhe të tjerë të ngjashëm me këta, përdoren shumë më shpesh si huazime të papërshtatura nga anglishtja sesa si huazime të përshtatura. Në shqipen standarde, megjithatë, të gjithë nga tre emrat e cekur më sipër (miting, park, piknik) përdoren me velare qiellzore të palatalizuar në trajtën e shumësit: *mitingje*, *parqe*, *pikniqe*.

Njëjës + -a > shumë. - Emrat e gjinisë femërore në gjuhën shqipe e formojnë trajtën e shumësit duke i shtuar trajtës së njëjësit mbaresën -a. Nëse ata emra mbarojnë me -ë në trajtën e pashquar të njëjësit, në trajtën e shumësit ajo -ë zhduket. E njëjta gjë ndodh nëse [ë] gjendet para bashkëtingëllores fundore [r], [l] ose [ll]. Prandaj edhe emrat e gjinisë femërore të origjinës së anglishtes që kanë hyrë në gjuhën shqipe të Amerikës e bëjnë trajtën e shumësit në të njëjtën mënyrë, siç e bëjnë edhe emrat e mirëfilltë të gjuhës shqipe: agjendë + -a > *agjenda*; aplikatë + -a > *aplikata*; bushël + -a > *bushla* etj.

Njëjës = shumë. - Disa emra të anglishtes të papërshtatur përdoren ndonjëherë me të njëjtën trajtë si në njëjës ashtu edhe në shumë nga

²⁴ Fonema /k/ e këtyre emrave duket të jetë palatalizuar më herët (Demiraj, 1971, f. 35), prandaj folësit e shqipes së Amerikës, që kanë arritur më vonë në SHBA, do të kenë pasur rast të kishin njohur këtë dukuri para se të shkonin atje nga Shqipëria apo gjetiu.

shqiptarët e Amerikës, për shembull:

- (1) U përdorën 812.000 *pound* me lesh.
- (2) Lindjet, martesat, *business* tuaja duhet përmendur...

Shumësi i anglishtes = shumësi i shqipes së Amerikës. - Shumë shpesh ndodh që emrat e huazuar në shqipen e Amerikës të përdoren në shumës në trajtë të anglishtes, d.m.th., me mbaresën angleze të shumësit -s. Në materialin tonë gjenden mbi gjashtëdhjetë emra me mbaresën e anglishtes -s të shumësit. Por kjo dukuri është e kufizuar vetëm tek emrat e papërshtatur të marrë nga anglishtja, por nuk është vërejtur ndonjë përdorim i tillë i emrave të shqipes. Ja disa shembuj:

- (1) Franca i shiti Libisë 100 *jets*.
- (2) *Gangsters* që njoh unë, ishin miqtë e mi.
- (3) Ish i rëndë 351 *pounds* etj.

Vlen të theksohet se ndonjëherë përdoret madje edhe trajta e shumësit jo e rregullt e anglishtes nga ata që shkruajnë shqip në Amerikë, si në shembullin:

- (4) Zonja, zotërinj, *businessmen* e kanë shqyrtuar...

Shumësi i anglishtes + shumësi i shqipes. - Jo rrallë përdoren si trajta e shumësit të anglishtes, ashtu dhe trajta e shumësit të shqipes për të njëjtin emër në të njëjtën fjali. Ato dy trajta jepen si dy alternativa. Për shembull:

- (1) Vetëm tri *miles* ose tri *milje* detare...
- (2) Katër *quarters* ose *kuarte* bëjnë një gallon.
- (3) *Leaders* ose *kryetarët* e partive politike... etj.

Emri i papërshtatur i anglishtes + trajta e shumësit të shqipes. - Ndonjëherë, jo shpesh, mbaresa e shumësit të shqipes i shtohet emrit që nuk është përshtatur fonemikisht as nga aspekti drejtshkrimor në shqipen e Amerikës, si f.v.:

drithëra: oatmeal, *wheatna*, ralston...

pra, kemi emrin e papërshtatur *wheat* të cilit i shtohet mbaresa e shumësit të shqipes -na (gege).

Trajta e shumësit në vend të njëjësit. - Ka rëndësi të shqyrtohen rastet kur trajta e shumësit e anglishtes bartet së bashku me huazimin në të folurit e shqipes së Amerikës. Nëse fjala asimilohet në gjuhën shqipe, shënuesi i shumësit nuk e bart, nuk e përcjell, kuptimin gramatikor, por funksionon si një pjesë integrale e rrënjës së huazimit. Për shembull:

- (1) Federata merr 1 *sents* për çdo gallon gazolinë.

Kjo vërteton se fjala *cent* u përvetësua nga ata folës në trajtë të shumësit dhe atë e marrin si të tillë kurdo që e përdorin. Ky huazim është

përshtatur fonemikisht deri në një shkallë, domethënë, shkronja e parë s'është dhënë në bazë të shqiptimit të saj. Mirëpo, shënuesi i saj i shumësit ka ngelur si pjesë e pandarë e emrit. Madje, ajo shqiptohet në mënyra të ndryshme, duke u shtrirë prej trajtës së papërshtatur deri te trajtat plotësisht të përshtatura, si, f.v.: *cents, sents, senc, sencë, senca* etj. Ja disa shembuj:

- (1) Uji i Bashkisë 20 *cents* tonelata.
- (2) ...se nuk vlej në asnjë *senc*.
- (3) Pastaj më dha mua 50 *senca*, mbajti 75 *senca* për vete.

Këtu kemi rastin **shumës + shumës**, domethënë emri me shënuesin e shumësit të anglishtes duke ia shtuar edhe shumësin e shqipes. Kjo dukuri nuk është e pazakonshme madje edhe në gjuhët e tjera të grupeve etnike të Amerikës.²⁵ Madje, kjo dukuri haset edhe gjatë huazimit të elementeve gjuhësore nga anglishtja në gjuhën shqipe.²⁶

2.3. Rasa e emrit

Anglishtja nuk ka dallim eptimor të rasave, prandaj nuk ka çka të bartet si morfema eptimore prej anglishtes në gjuhën shqipe. E vetmja interferencë gjuhësore në këtë pikë mund të jetë tendenca për rrafshimin e gjithmbarshëm, d.m.th., për shmangie nga normat shqipe të rasave në ligjërimin e shqipes së Amerikës. Këto shmangie shkaktohen edhe nga dobësimi i kompetencës gjuhësore të shqipes tek ata folës.

Gramatika e anglishtes dallon katër rasa të lakimit të emrave sipas kuptimit. Mirëpo, në të vërtetë, ekzistojnë vetëm dy rasa flektive në atë gjuhë: emërorja dhe gjinorja (saksone), ndërsa dhanorja dhe kallëzorja formohen në mënyrë analitike, d.m.th. me përdorim të parafjalëve para emrit, si dhe me pozitën e tyre në fjali u jepet funksioni i rasës, kurse forma e tyre është e njëjtë me atë të emërores.

Sistemi i emrave të gjuhës shqipe standarde ka pesë rasa, por vetëm tri rasa dallohen me trajta eptimore: emërorja, dhanorja dhe kallëzorja. Për t'i dalluar gjinoren dhe rrjedhoren nga dhanorja përdoren nyje të përparme (*I/e, të*) respektivisht parafjala *prej*. Njumarku shënon tri rasa të emrave të gjuhës shqipe: emëroren, kallëzoren dhe margjinalen.²⁷ Në rasën 'margjinale' ai përfshin gjinoren, dhanoren dhe rrjedhoren.

²⁵ E. Haugen, 1953, f. 218.

²⁶ Vesël Nuhiu, Ismail Mehmeti, *Disa çështje të përshtatjes gramatikore të anglizmeve në gjuhën shqipe*, Çështje të studimeve albanologjike, Instituti Albanologjik i Prishtinës, ff. 175-179, 1987.

²⁷ L. Newmark, 1957, p. 38.

Rasat e emrave të shqipes kanë trajta të ndryshme, të cilat dallojnë sipas gjinisë, numrit dhe shquarsisë së emrit,²⁸ çka do të thotë se një emër teorikisht mund të ketë 12 trajta të ndryshme: 3 rasa kryesore sipas trajtës dalluese, nga 2 numra (njëjës dhe shumës), nga 2 trajta sipas shquarsisë, pra: $3 \times 2 \times 2 = 12$. Pos kësaj, janë tri lloje të lakimit të emrave, dy lloje të emrave të gjinisë mashkullore dhe një lloj i emrave të gjinisë femërore. Lloji apo tipi i parë përmbledh emrat e gjinisë mashkullore që marrin mbaresën -i në njëjës të pashquar të rasës margjinale; tipi i dytë i emrave merr mbaresën -u po në atë rrethanë, ndërsa tipi i tretë i emrave përmbledh të gjithë emrat e gjinisë mashkullore që marrin mbaresën -a, po në ato kushte si edhe dy tipat e parë.

Huazimet angleze, në funksion të emrave që janë përshtatur fonemikisht ndaj gjuhës shqipe, lakohen në mënyrë të njëjtë ose të ngjashme me emrat e shqipes që i përkasin atij lakimi.

Sipas kësaj, ata emra anglezë që janë pranuar si huazime në gjininë gramatikore mashkullore dhe i përkasin lakimit të parë, e kjo vlen për shumicën e tyre, do të vijojnë paradigmen e njëjtë si emrat shqip të gjinisë mashkullore. Këtu janë disa shembuj sa për ilustrim:

Njëjësi i pashquar

Rasat	Emrash shqip	Huazimet angleze
Emërore:	(një) mur	(një) bord; (një) slogan
Kallëzore:	(një) mur	(një) bord; (një) slogan
Margjinale:	një muri	një bordi; një slogani

Njëjësi i shquar

Rasat	Emrat shqip	Huazimet angleze
Emërore:	muri	bordi; slogani
Kallëzore:	murin	bordin; sloganin
Margjinale:	murit	bordit; sloganit

Shumësi i pashquar

Rasta	Emarat shqip	Huazimet angleze
Emërore:	mure	borde; slogane
Kallëzore:	mure	borde; slogane
Margjinale:	murit	bordit; sloganit

Shumësi i shquar

Rasat	Emrat shqip	Huazimet angleze
Emërore:	muret	bordet; sloganet
Kallëzore:	muret	bordet; sloganet
Margjinale:	mureve	bordeve; sloganeve

²⁸ Sh. Demiraj, 1971, ff. 40-46; Riza, Selman, 1979, ff. 1-134.

Emrat e anglishtes që janë integruar në gjininë gramatikore mashkullore të shqipes dhe i përkasin lakimit të dytë, vijojnë të njëjtën paradigme si edhe emrat e gjuhës shqipe të këtij lakimi. Për shembull:

Njëjësi i pashquar

Rasat	Emrat shqip	Huazimet angleze
Emërore:	(një) zog	(një) <i>miting</i> ; (një) <i>stok</i>
Kallëzore:	(një) zog	(një) <i>miting</i> ; (një) <i>stok</i>
Margjinale:	një zog	<i>një miting</i> ; <i>një stok</i>

Njëjësi i shquar

Rasat	Emrat shqip	Huazimet angleze
Emërore:	zogu	<i>mitingu</i> ; <i>stoku</i>
Kallëzore:	zogun	<i>mitingun</i> ; <i>stokun</i>
Margjinale:	zogut	<i>mitingut</i> ; <i>stokut</i>

Shumësi i pashquar

Rasat	Emrat shqip	Huazimet angleze
Emërore:	zogj	<i>mitingje</i> ; <i>stoke</i> ²⁹
Kallëzore:	zogj	<i>mitingje</i> ; <i>stoke</i>
Margjinale:	zogjve	<i>mitingjeve</i> ; <i>stokeve</i>

Shumësi i shquar

Rasat	Emrat shqip	Huazimet angleze
Emërore:	zogjt	<i>mitingjet</i> ; <i>stoket</i>
Kallëzore:	zogjt	<i>mitingjet</i> ; <i>stoket</i>
Margjinale:	zogjve	<i>mitingjeve</i> ; <i>stokeve</i>

Emrat e anglishtes që janë integruar në gjininë gramatikore femërore në shqipen e Amerikës, i përkasin lakimit të tretë dhe vijojnë paradigmen e emrave të shqipes të atij lakimi. Ja disa shembuj:

Njëjësi i pashquar

Rasat	Emrat shqip	Huazimet angleze
Emërore:	(një) vajzë	(një) <i>bushël</i> ; (një) <i>investigatë</i>
Kallëzore:	(një) vajzë	(një) <i>bushël</i> ; (një) <i>investigatë</i>
Margjinale:	(një) vajze	(një) <i>bushle</i> ; <i>një investigate</i>

²⁹Ky huazim në shqipen standarde e ka palatalizuar /k/ fundore në /q/, pra, është bërë *stoke* (shih: *Palatalizimi nën Interferenca fonemike e anglishtes në shqipen e Amerikës në këtë botim*) në trajtën shumë, kurse në këtë huazim të përdorur në shqipen e Amerikës nuk është bërë ai palatalizim.

Njëjësi i shquar

Rasat	Emrat shqip	Huazimet angleze
Emërore:	vajza	<i>bushla; investigata</i>
Kallëzore:	vajzën	<i>bushlën; investigatën</i>
Margjinale	vajzës	<i>bushlës; investigatës</i>

Shumësi i pashquar

Rasat	Emrat shqip	Huazimet angleze
Emërore:	vajza	<i>bushla; investigata</i>
Kallëzore:	vajza	<i>bushla; investigata</i>
Margjinale:	vajzave	<i>bushlave; investigatave</i>

Shumësi i shquar

Rasat	Emrat shqip	Huazimet angleze
Emërore:	vajzat	<i>bushlat; investigatat</i>
Kallëzore:	vajzat	<i>bushlat; investigatat</i>
Margjinale:	vajzave	<i>bushlave; investigatave</i>

Duke mbajtur parasysh se janë tri gjini gramatikore dhe dy numra dhe se emrat e gjinisë mashkullore në njëjës kanë dy lakime, si dhe që të gjithë emrat kanë trajta të shquara e të pashquara, mund të merret me mend se, thënë matematikisht, ka shumë trajta në sistemin e lakimit të emrave në gjuhën shqipe në përgjithësi. Mirëpo, në gjuhë matematika nuk vlen gjithmonë. Numri i trajtave të ndryshme eptimore i emrave të shquar është shumë më i vogël, sesa mund të supozohet, për arsyt që vijojnë:

- a) emrat e gjinisë asnjane nuk kanë trajtë të shumësit;
- b) trajtat eptimore të emrave asnjane në njëjës përputhen me lakimin e parë të emrave mashkullore në numrin njëjës;
- c) emërorja dhe kallëzorja në trajtat e pashquara janë identike si në njëjës ashtu edhe në shumës.³⁰ Domethënë janë vetëm dy trajta eptimore të ndryshme të emrave të pashquar;
- ç) në shumësin e emrave të shquar emërorja dhe kallëzorja kanë të njëjtën trajtë, dhe kjo e zvogëlon numrin e trajtave eptimore prej katër në tri.
- d) Rasat marginale si të trajtës së shquar ashtu dhe të pashquarës në numrin shumës kanë të njëjtën trajtë.

Kështu numri i gjithmbarshëm i trajtave eptimore në gjuhën shqipe nuk është aq i madh siç mund të pritet. Vështirë është të jepet numër i saktë, sepse përveç faktorëve të tjerë, disa emra pësojnë ndryshime si

³⁰ Sh. Demiraj, 1971, f. 40.

pasojë e ligjeve morfofonemike, siç janë palatalizimi, trajtat e parregullta të shumësit etj. Por, megjithatë, shqipfolësi duhet t'i njohë jo vetëm trajtat e ndryshme eptimore, por edhe ato me trajta identike. Kjo ndodh për shkak të argumentit gjuhësor se madje edhe zeroja ka vlerën e saj në gjuhë.

Këto paradigma i kemi paraqitur dhe diskutuar për të treguar se trajtat e shumta eptimore të emrave të shqipes të përdorura në rása, numra, gjini dhe në shquarësi të ndryshme paraqesin barrë të rëndë për shqipfolësit e Amerikës. Ata tani njohin një gjuhë tjetër - anglishten - e cila është jashtëzakonisht e thjeshtë sa u përket trajtave eptimore të emrit, me gjithsej dy deri në katër trajta më së shumti. Për shkak të kësaj dhe duke marrë parasysh që kompetenca e folësve të shqipes vazhdimisht dobësohet, duhet të priten vështirësitë që ata hasin gjatë përdorimit të emrave të shqipes dhe sidomos kur i përdorin huazimet e anglishtes, t'i përdorin drejt dhe në rásë të duhur. Duke u ikur trajtave të shumta të paradigmave të emrave të shqipes, ata duket sikur shkojnë vijës së rezistencës më të vogël.

Të dhënat tona, pra, na japin shumë shembuj të përdorimit të gabuar të rásave të emrave në shqipen e Amerikës, si rezultat i tendencës së rrafshimit të trajtave eptimore.

Këtu japim disa shembuj të përdorimit të gabuar të emërores së shquar:

- (1) Ata që dalin nga *cinema*...
- (2) Tashi më është prishur *televizion* qe tre muaj.
- (3) Shpresojmë që *bibliotekë* e Fan Nolit mund të jetë...
- (4) Edhe *çupë* e madhe është 12 vjeç.

Trajtat e drejta të emrave të sipërshënuar janë: *kinemaja*, *televizori*, *biblioteka*, *çupa*.

Përdorimi i gabuar i kallëzores:

- (5) Duke lënë më anësh nganjëherë *business* që e kanë...
- (6) Një shumë vatanësh vizituan *Funeral Home*.
- (7) Unë pëlqej *bukë*, po s'gjej dot bukë të mirë.
- (8) Si vajte me *Profesor Kosta*?

Trajtat e drejta të emrave të sipërshënuar janë: *business-in*, *Funeral Home-in*, *bukën*, *Kostën*.

Përdorimi i gabuar i rásave margjinale.

A. Rása gjinore:

- (9) A. Athanas në tridhjetëvjetorin e *business*.
- (10) Filluan derdhjet e mija *dollarë*.
- (11) Ky sot është dyzetëvjeçar dhe u ritirua nga loja e *football*.

Trajtat e drejta do të ishin: *business-it*, e mija *dollarëve*, e *footballit*.

B. Rasa dhanore:

(12) Sot, tani kemi bërë një thirrje të gjithë *shqiptarët*. (duhet: *shqiptarëve*).

Këtu rasa dhanore është identifikuar me rasën kallëzore. Shpjegimi i kësaj çështjeje është shumë i thjeshtë. Anglishtja nuk bën dallim të trajtave midis këtyre dy rasave, ose thënë në kuptim të funksionit, midis dy kundrinave; vetëm rendi i fjalëve përcakton funksionin e tyre. Kështu, duket se folësi duhet të ketë vijuar sipas gjedhes së anglishtes.

C. Rasa rrjedhore:

(13) Na arriti në zyrë një çek prej 150 *dollarë*.

(14) Kishin ardhur nga lark, prej *Toronto, Detroit, New York*.

(15) Dërgojmë duhan prej gjithë *lloj* nga gjysmë pound e lart.

Trajtat e drejta të emrave të lartshënuar në rasën rrjedhore do të ishin: *dollarësh, Torontos, Detroitit, New - York-ut, llojeve*.

Siç mund të vërejë lexuesi, ishin bërë gabime në përdorimin e emrave në shumicën e rasteve kur përdoreshin huazimet, d.m.th. kur ato shqiptoheshin ose shkruheshin në mënyrën angleze. Prandaj, mund të merret me mend se derisa emrat të përshtaten sipas sistemit fonemik të shqipes ose sipas shqiptimit të tyre, duket se nuk përdoren me mbaresa përkatëse të rasave. Por materiali dëshmon se madje edhe emrat e shqipes përdoren gabueshëm nga disa shqipfolës të Amerikës. Ndërsa materiali në dispozicion për këtë studim tregon se mund të gjenden shumë shembuj kur të njëjtit emra ndonjëherë përdoren në rasa të ndryshme, kurse herëve të tjera nuk përdoren në rasa. Kjo ka të bëjë me emrat e huazuar të papërshtatur. T'i zëmë ngoje vetëm disa prej tyre:

(16) Në Kishën Françeskane të *Detroitit* (gjinore).

(17) Arritëm me tren nga *Westi* (emërore).

(18) Për së shpejti Dega e *Torontos* do të arrijë (gjinore).

Numri më i madh i gabimeve është regjistruar në përdorimin e rasës kur përdoret me parafjalën *nga*. Në vend se të përdorej trajta e shquar, siç është shembulli më sipër: *nga Westi*, shpesh përdoret trajta e pashquar, për shembull, *nga Detroit, nga Dallas*, e shumë rrallë: *nga Detroiti, nga Dallasi* etj.

Fakti se emrat *Boston* dhe *Amerikë* thuaja gjithmonë përdoren në trajtë të drejtë, në rasë të duhur, tregon se emrat më të njohur përdoren me të gjitha mbaresat eptimore në shqipen e Amerikës. Bostoni është vendi i parë ku banonin shqiptarët në numër të madh dhe së bashku me rrethinën ai është njëri nga qendrat kryesore të popullatës shqiptare në SHBA, dhe sigurisht ka qenë qendra më me rëndësi kulturore e të gjithë imigrantëve shqiptarë në Amerikë gjatë shekullit të 19. Por,

megjithatë, ndodh që të dëgjojë njeriu përdorimin e gabuar të emrit Boston, madje edhe në rasën emërore, për shembull:

(19) *Boston* ka afër gjysmë milion njerëz.

Mirëpo, mund të thuhet se përdorimi i rasave të emrave është bërë mjaft i parregullt te shqipfolësit e Amerikës në përgjithësi. Ndodh mjaft shpesh që kur përdoren madje edhe emra të thjeshtë të shqipes, shqiptarët e Amerikës bëjnë gabime në përdorimin e rasave, madje edhe në përdorimin e përemrave vetorë. Disa shembuj të tillë i kemi hasur në materialin tonë, gjë që mund të jenë pasojë e të folmes nëndialektore të sjellë nga atdheu i folësve. Ja disa shembuj:

(20) Gjatë *këto jave...* (duhet: *këtyre javëve*)

(21) Një *prej ta* që Harry (duhet: *prej tyre*).

(22) Përveç *shqipe e anglishte* flet edhe katër gjuhë të tjera (duhet: *shqipes dhe anglishtes*) etj.

Gjatë gjithë kohës shqipfolësit e Amerikës përdorin emrat e ditëve të javës në rasë të gabuar; i përdorin në trajtë të pashquar në vend se në trajtë të shquar të rasës kallëzore, si f.v.:

(23) Mbledhja mbahet të *Mërkurë...*

(24) Ejani të *Diele* të bashkohemi.

(25) Mos harroni, mbledhja është të *Shtunë*.

Siç shihet nga shembujt e mësipërm, emrat e ditëve në gjuhën shqipe në Amerikë shkruhen me shkronjë të madhe, ngjashëm me rregullat e gjuhës angleze. Na merr mendja se ky përdorim i gabuar i emrave të ditëve është pasojë e ndikimit të drejtpërdrejtë të anglishtes sepse në këtë gjuhë dhënëse ditët e javës kanë vetëm një trajtë, prandaj shqiptarët e Amerikës, nën ndikimin e anglishtes, zbatojnë të njëjtin model, duke përdorur gati gjithmonë të njëjtat trajta - emëroren e pashquar (ose kallëzoren e pashquar, meqë ato dy rasa kanë trajtë të njëjtë), por duke përdorur kështu trajtë të gabuar, shikuar nga këndvështrimi i shqipes standarde.

Në fund, ka interes të theksohet se nuk është bërë studim i nevojshëm për çështjen e përdorimit të rasave në punën hulumtuese reprezentative që ka të bëjë me gjuhët e emigrantëve në SHBA.

3. Mbiemri

Mbiemrat janë fjalë me eptim në gjuhën shqipe, që dallojnë gjininë, numrin dhe rasën dhe të cilët pajtohen me emrin të cilin e përcaktojnë. Mbiemrat në gjuhën shqipe përdoren në trajtë të shquar dhe në të pa-

shquarën.³¹ Mbiemrat e shqipes më tutje ndahen në mbiemra me nyje të përparme dhe pa nyje të tillë.

Nga mbiemrat e përshtatur që janë gjetur në materialin tonë të gjuhës shqipe në Amerikë, vetëm nja një çerek syresh janë përdorur me nyje të përparme, të tjerët janë pa nyje të tillë. Në të vërtetë, mbiemrat me nyje të përparme kishin thuaja të gjithë prejardhjen nga pjesorja. Për shembull:

i/e akompanuar nga pjesorja e fol. akompanoj - *akompanuar* (bëj shoqëri);
i/e inkorporuar nga pjesorja e fol. inkorporoj - *inkorporuar* (përfshij);
i/e rekorduar nga pjesorja e fol. rekordoje - *rekorduar* (inçizoj) etj.

Numri më i madh i mbiemrave të përshtatur në shqipen e Amerikës, mbi 70 për qind, janë pa nyje të përparme, për dallim nga shumica e mbiemrave të shqipes. Duket të jetë një prirje e mbiemrave të huazuar në shqipen e Amerikës që të integrohen në këtë grup mbiemrash. Këtu po zëmë ngoje vetëm disa prej tyre: komun (*i/e* rëndomtë), ekselent (*i* shkëlqyeshëm), gjeneros (bujar, dorëlibër), majore (kryesore), prekaucional (qortues, që të tërheq vërejtjen) etj.

3.1. Gjinia e mbiemrit

Mbiemrat e huazuar nga anglishtja e të përshtatur në gjuhën shqipe të Amerikës e shënojnë gjininë femërore në një rën nga dy mënyrat, varësisht nga ajo nëse janë me nyje të përparme ose pa të. Mbiemrat me nyje të përparme e bëjnë trajtën e gjinisë femërore duke ndryshuar nyjen *i* të mashkullores në nyjen *e* të gjinisë femërore, siç veprohet edhe me mbiemrat e shqipes. Për ilustrim:

i amerikanizuar > *e amerikanizuar*
i devorcuar > *e devorcuar*
i resolvuar > *e resolvuar* etj

Mbiemrat e përshtatur që janë pa nyje të përparme e bëjnë trajtën e gjinisë femërore njësoj si dhe mbiemrat e shqipes të këtij grupi, duke ua shtuar mbaresën *-e* trajtave të gjinisë mashkullore:

komun > *komunë* (*i/e* rëndomtë),
gjeneros > *gjenerosë* (bujare),
marcial > *marcialë* (ushtarake),
simpatetik > *simpatetikë* (dashamirës, ngushëllues) etj.

Emrat që përdoren në shqipen e Amerikës në trajtë të papërshtatur nuk shënojnë kurrfarë ndryshimi kur përdoren në funksion të mbiemrit (gjegjësisht me emra) të gjinisë mashkullore ose femërore. Kjo gjendje

³¹ Sh. Demiraj, 1971, f. 68.

paraqet gjedhen e papërshtatur morfemike ndaj sistemit të gjuhës shqipe. Për shembull:

vend *complementary*; rasë *complementary*;
 gjykim *tangible*; çështje *tangible*;
 mashkull *sexy*; femër *sexy* etj.

3.2. Numri i mbiemrit

Thuaja në të gjitha rastet kur përdoren në shumës mbiemrat e huazuar me nyje të përparme, atyre u jepen nyje të përparme të shqipes, sipas klasave të mbiemrave të shqipes, të cilëve u përkasin ata, d.m.th. marrin njëjën të në vend të *i/e* të njëjësit:

i/e devotuar > të devotuar;
i/e parkeguar > të parkeguar;
i/e sofistikuar > të sofistikuar etj.

Mbiemrat pa nyje po ashtu vijojnë rregullën e mbiemrave të shqipes që i përkasin kësaj klase për të formuar trajtat e shumësit, d.m.th. trajtës së njëjësit i shtohet mbaresa -ë për gjininë mashkullore dhe mbaresa ø (zero), pra, pa mbaresë për shumës mbiemrat e gjinisë femërore, siç mund të shihet më poshtë:

Mashkullore:
 (djalë) *gjeneros* > (djem) *gjenerosë*
 (djalë) *responsibël* > (djem) *responsibël*
 (djalë) *simpatetik* > (djem) *simpatetikë*
 Femërore:
 (vajzë) *gjenerose* > (vajza) *gjenerose*
 (vajzë) *responsibël* > (vajza) *responsibël*
 (vajzë) *simpatetike* > (vajza) *simpatetike* etj.

Kur mbiemrat e anglishtes përdoren në trajta të papërshtatura në shqipen e Amerikës, nuk vërehet dallim midis trajtave të njëjësit dhe të shumësit, ashtu siç është rasti edhe në gjuhën angleze. Për shembull:

rasë *complementary* > rasa *complementary*;
 gjykim *tangible* > gjykime *tangible*;
 vajzë *sexy* > vajza *sexy* etj.

3.3. Përshtatja e mbiemrit në rasë

Mbiemrat e shqipes kanë mbaresa sipas rasave të emrave që i përcaktojnë. Huazimet angleze që i përkasin kategorisë gramatikore të mbiemrave kur të huazohen në shqipen e Amerikës u nënshtrohen rregullave të fleksionit të rasave të emrave, nëse ata janë përshtatur fonemikisht në këtë gjuhë marrëse. T'i zëmë ngoje disa shembuj:

Rasa	Mbiemra shqip	Huazime të anglishtes - mbiemra
Emërore:	(vajza) e mirë,	<i>e devotuar</i> , ³² <i>e resoluvar</i> ³³
Kallëzore:	(vajzën) e mirë,	<i>e devotuar</i> , <i>e resoluvar</i>
Margjinale:	(vajzës) së mirë,	<i>së devotuar</i> , <i>së resoluvar</i>

Siç mund të shihet nga këta shembuj, tema e mbiemrit nuk ndryshon fare gjatë gjithë lakimit. Vetëm nyja e përparme e mbiemrave i nënshtrohet lakimit. Kjo vlen edhe për mbiemrat e të dy numrave gramatikorë dhe të dy gjinive si në trajtë të shquar, ashtu dhe në trajtë të pashquar; ata nuk e ndryshojnë trajtën në rasa të ndryshme, ndërsa trajta e çdo rase është e njëjtë (të themi) me trajtën e emërores. Vetëm emrat e përcaktuar nga ata mbiemra kanë trajta të ndryshme rasash, ndërsa rasa e mbiemrit identifikohet vetëm përmes rasës së emrit që e përcakton.

3.4. Krahasimi i mbiemrit

Si mbiemrat e anglishtes ashtu dhe ata të shqipes, i kanë tri shkallë të krahasimit, domethënë mbiemrin bazë (trajtën pohore apo pozitivin) dhe dy shkallë të krahasuara me të: krahasoren (komparativin) dhe sipëroren (superlativin). Mirëpo, derisa anglishtja bën krahasimin e mbiemrave në mënyrën analitike dhe sintetike (bigger - në mënyrë sintetike; more interesting - në mënyrë analitike), në gjuhën shqipe krahasimi i mbiemrave bëhet vetëm në mënyrë analitike.³⁴ Por ne e gjejmë shkallën sipërore të ndërtuar në mënyrë të gërshetuar, si në mënyrë analitike, ashtu dhe në mënyrë sintetike. Në trajtat (vajza) më e mira (në trajtën emfatike: më e mira (vajzë)), (vajza) më bujarja, kemi elementin e konstruktit analitik: më + e mira; ndërsa me mbiemrin e panyjshëm trajtën: më + bujarja, kemi ndërtimin analitik dhe sintetik.

Mund të përfundohet se superlativi ka një trajtë paksa të dalluar nga dy trajtat e shkallëve të tjera të mbiemrit. Përkatesisht, superlativi është në trajtë të shquar si në anglishte ashtu edhe në shqipe: *the most beautiful* (flower); *më e bukura* (lule). Për shkak të kësaj ngjashmërie ndërmjet këtyre dy gjuhëve, fare rrallë është hasur ndonjë lajthitje në këtë përdorimin në shqipen e Amerikës.

Kur huazimet (mbiemrat) e anglishtes përshtaten në mënyrë fonemike në shqipen e Amerikës, ata zakonisht i formojnë trajtat krahasuese njësoj si edhe të mbiemrave të shqipes:

³² e përkushtuar

³³ e zgjidhur, e vendosur

³⁴ Sh. Demiraj, 1971, f. 73.

Shkalla	Shqip	Huazimet angleze-mbiemrat
Pohore:	i nderuar	<i>i amerikanizuar; i sofistikuar</i>
Krahasore:	më i nderuarmë	<i>i amerikanizuar; më i sofistikuar</i>
Sipërore:	më i nderuari	<i>më i amerikanizuari; më i sofistikuari</i>

Mbiemrat e panyje të huazuar nga anglishtja e bëjnë krahasimin njësoj sikur edhe mbiemrat e panyje të shqipes. Për shembull:

Pohore:	Ai është <i>ekselent</i> . Ai është <i>inosent</i> .
Krahasore:	Ai është <i>më ekselent</i> se X. Ai është <i>më inosent</i> se X.
Sipërore:	Ai është <i>më ekselenti</i> në klasë. Ai është <i>më inosenti</i> në klasë.

Në sintagmën emërore, e cila përbëhet nga një emër dhe një mbiemër i panyjshëm si përcaktor i tij, është emri ai që vihet në trajtë të shquar kur përdoret në shkallën sipërore dhe jo mbiemri, siç mund të pritët. Sipërorja nuk ndryshon fare nga krahasorja në formën e saj, si b.f.:

Shkalla	Shqip	Huzimet angleze - mbiemrat
Pohore:	(djale) trim	<i>ekselent; inosent</i>
Krahasore:	(djale) më trim	<i>më ekselent; më inosent</i>
Sipërore:	(djali) më trim	<i>më ekselent; më inosent</i>

Mirëpo, në disa raste të shqipes së Amerikës gjuha angleze ka ndikuar në ndërtimin e krahasimit të mbiemrave. Shkalla krahasore shpesh është ndërtuar sipas modelit të ngjashëm me anglishten, me ndihmën e ndajfoljes much (shumë) që i paraprin mbiemrit, si f.v.:

(1) Shpresoj se raportet e Degëve kanë për të qenë më shumë impersonale.

Kur flitet për mbiemrat në gjuhën e shqipfolësve, duhet të theksohet se pozita normale e mbiemrit në sintagmën emërore në shqipen e Amerikës është zakonisht emër + mbiemër, domethënë mbiemri përcakton emrin bosht. Megjithatë, kjo radhitje shpesh është prishur në shqipen e Amerikës. Ajo ka ndryshuar në topikën e anglishtes si pasojë e kontaktit gjuhësor me anglishten.

Këtu po bashkëngjesim një pasqyrë të mbiemrave të përshtatur fonemikisht në shqipen e Amerikës, ashtu siç i kemi gjetur në korpusin e mbledhur në terren.

Pasqyra 1

Mbiemrat e huazuar nga anglishtja të përshtatur në shqipen e Amerikës

Shqipe amer.	Anglisht	Shqipe standarde
<i>absent</i>	absent	i pranishëm
<i>adapt</i>	adaptable	i përshtatshëm
<i>adoptiv</i>	adoptive	i adoptuar (i përvetësuar)
<i>ambiguous</i>	ambiguous	i dykuptimtë

<i>augural</i>	augural	profetizues
<i>britanik</i>	British	britanik
<i>diferent</i>	different	i ndryshëm
<i>ekselent</i>	excellent	i shkëlqyeshëm
<i>ekstraordinar</i>	extraordinary	i jashtëzakonshëm
<i>ekstrim</i>	extreme	ekstrem
<i>ekuivoke</i>	equivocal	i dyshimtë
<i>fantazmagorik</i>	fantastic	fantastik
<i>favorabël</i>	favorable	i volitshëm
<i>financial</i>	financial	financiar
<i>funeral</i>	funeral	funeral
<i>futbolliste</i>	football ^{*35}	futbollistike
<i>gjeneros</i>	generous	bujar
<i>gjentil</i>	genteel	i urtë, i butë
<i>humoristik</i>	humorous	humoristik
<i>inaugural</i>	inaugural	inaugural
<i>independent</i>	independent	i pavarur
<i>inferior</i>	inferior	inferior
<i>informal</i>	informal	jo formal
<i>ingleze</i>	English	angleze
<i>inosent</i>	innocent	i pafajshëm
<i>komplimentar</i>	complementary	plotësues
<i>komun</i>	common	i rëndomtë
<i>konfortonjës</i>	comfortable	ngushëllues
<i>laburiste</i>	labor [*]	laburiste
<i>luksorioze</i>	luxurious	madhështore, luksoze
<i>majore</i>	major	kryesore
<i>marciale</i>	martial	luftarake
<i>medievale</i>	medieval	mesjetare
<i>memorjale</i>	memorial	përkujtimore
<i>militare</i>	military	ushtarake
<i>misilistike</i>	missile [*]	balistike
<i>navale</i>	naval	detare
<i>prekacionale</i>	precautionary	preventive
<i>protestante</i>	protestant	protestante
<i>raciale</i>	racial	raciale
<i>respektive</i>	respective	përkatëse
<i>responsibël</i>	responsible	përgjegjës
<i>seksi</i>	sexy	seksi ^{**}
<i>simpatetike</i>	sympathetic	simpatike
<i>simpatike</i>	sympathetic	simpatike
<i>senatorial</i>	senatorial	senatorial
<i>solid</i>	solid	i ngurtë
<i>spaciale</i>	spatial	hapësinor

³⁵ Fjalët e shënuara me yllzë në këta shembuj janë emra dhe mund të përdoren në funksion të mbiemrit vetëm kur u paraprijnë emrave në anglishte.

<i>sublim</i>	sublime	madhështor
<i>triangolare</i>	triangular	trekëndshme
<i>virile.</i>	virile.	burrërore.

Një numër mbiemrash janë formuar në shqipen e Amerikës nga foljet e anglishtes. Në shumicën e rasteve tema e foljes, e plotë ose jo e plotë, është huazuar në shqipen e Amerikës. Përveç parashtesës së pajtimit i është shtuar prapashtesa e pjesores shqipe *-uar*, kështu që ata mbiemra janë të ngjashëm me pjesoret e gjuhës shqipe, të cilat shpesh përdoren në funksion të mbiemrit. Këtu është një pasqyrë e mbiemrave të tillë të gjetur në materialin tonë:

Pasqyra 2

Mbiemrat e shqipes së Amerikës të krahsuar me mbiemrat e shqipes standarde

Shqipe amer.	Anglisht	Shqipe standarde
<i>i/e akompanuar</i>	accompanied	i/e shoqëruar
<i>i/e adresuar</i>	addressed	i/e drejtuar
<i>i/e amerikanizuar</i>	Americanize	i/e amerikanizuar
<i>i/e destinuar</i>	destinated	i/e përcaktuar
<i>i/e devotuar</i>	devoted	i/e përkushtuar
<i>i/e dispozuar</i>	disposed	i/e gatshëm-me
<i>i/e favorizuar</i>	favored	me përparësi ^{*)} ; i favorizuar
<i>i/e iluminizuar</i>	illuminated	i/e ndriçuar
<i>i/e inkorporuar</i>	incorporated	i/e bashkuar
<i>i/e misinformuar</i>	misinformed	i/e painformuar drejt
<i>i/e parkegjuar</i>	parked	i/e parkuar
<i>i/e rekorduar</i>	recorded	i/e shënuar
<i>i/e resolvuar</i>	resolved	i/e vendosur
<i>i/e simplifikuar</i>	simplified	i/e thjeshtuar
<i>i/e sofistikuar</i>	sophisticated	me shije të hollë ^{*)36}

4. Folja

Foljet janë pjesë të ligjëratës që, pos emrave dhe mbiemrave, huazohen më së shpeshti. Në mes huazimeve angleze që janë bartur në gjuhën shqipe të Amerikës, ka nja njëqind folje në korpusin tonë. Ka interes të zihet ngoje fakti se për dallim nga pjesët e tjera të ligjëratës, gati të gjitha foljet e huazuara i janë përshtatur sistemit fonemik të shqipes, prandaj edhe sistemit morfemik. Vetëm dy folje u gjetën të papërshtatura (*apologize* dhe *blockade*), por edhe ato ishin shkruar

³⁶ Këto ekuivalente të shqipes standarde nuk janë mbiemra, por sintagma parafjalore të përdorura me funksion mbiemri.

brenda kllapave ose në thonjëza përballë foljeve ekuivalente shqipe, me të cilat shpjegoheshin, çka tregon se ai që i përdorte ishte i vetë-dijshëm se ishin fjalë të huaja. Foljet thuaja pa ndryshim kishin eptim të plotë të shqipes, praktikisht pa bartje nga anglishtja. Kjo dukuri e foljeve është vërejtur edhe në disa gjuhë të tjera të grupeve etnike në Amerikë³⁷ dhe meriton një shqyrtim të posaçëm.

Foljet e shqipes eptohen në tri vete dhe në dy numra. Kategoria e vetes së foljes shprehet me trajta gramatikore që në përgjithësi ndërtohen me mbaresa të vetave dhe në disa raste me mbaresa zero. Edhe foljet e anglishtes kanë tri veta dhe dy numra, por në përgjithësi vetëm veta e tretë njëjës dallon sintaktikisht prej të gjitha vetave të tjera. Këtu po shënojmë të njëjtën folje në të dy gjuhët në kohën e tashme të thjeshtë, si ilustrim:

Folja	Njëjës			Shumës		
Vetat	I	II	III	I	II	III
Shq. shkoj ³⁸	shkoj shkon shkon,			shkojmë shkoni shkojnë		
Ang. (to) go	I go you go he goes			we go you go they go		

Gjuha shqipe ka nëntë mënyra të foljeve që ndahen në të shtjelluara dhe të pashtjelluara. Mënyrat e shtjelluara hasen në trajta të ndryshme pos zgjedhjes së foljeve në vete dhe në numër. Ato mënyra janë: dëftorja, lidhorja, kushtorja, dëshirorja, urdhërorja dhe habitorja. Mënyrat e pashtjelluara nuk e ndryshojnë trajtën e tyre gjatë zgjedhimit të foljeve në numër as në vete. Ato janë mënyrat: paskajtorja, pjesorja dhe gjerundi progresiv.

Kategoria gramatikore e mënyrës së foljes në gjuhën shqipe shprehet me trajta të posaçme gramatikore, të cilat mund të jenë analitike ose sintetike. Mënyrat e ndryshme të foljeve në shqipe, siç mund të supozohet nga emrat e tyre, mund të shprehen me ndonjë kohë foljeje të anglishtes ose janë ekuivalente me to. Po të krahasoheshin këto mënyra dhe kohë të ndryshme të foljeve të anglishtes dhe të shqipes, do të ishte një studim interesant në gjuhësinë kontrastive, por ne nuk do të merremi më shumë me këtë çështje.

Si anglishtja ashtu edhe shqipja mund të shprehin diatezën veprorë dhe pësore të foljeve, por mënyra e ndërtimit të tyre është e ndryshme. Diateza pësore në gjuhën angleze ndërtohet vetëm në mënyrë analitike nga diateza veprorë. Diateza pësore e shqipes mund të ndërtohet si në mënyrë

³⁷ E. Haugen, 1953, f. 398.

³⁸ E. Haugen, 1953, f. 398.

analitike, ashtu edhe në mënyrë sintetike.³⁹ Në përgjithësi, diateza veprare e foljes është ajo e cila merr kundrinë dhe ajo mund të shndërrohet në diatezë pësore. Prandaj vetëm foljet kalimtare, të cilat i kanë të dyja gjuhët në fjalë këtu, mund të kenë diatezë pësore.

Klasifikimi i foljeve të gjuhës shqipe në tipat e zgjedhimit ka qenë temë diskutimi për shumë albanistë. Autorë të ndryshëm kanë propozuar kritere të ndryshme për të përcaktuar llojet e ndryshme të zgjedhimit të foljeve. Ne do të vijojmë sipas Demirajt⁴⁰ në këtë çështje të gramatikës së shqipes. Ai propozon dy zgjedhime të foljeve në gjuhën shqipe: a) foljet që mbarojnë me *-n*⁴¹ dhe b) foljet që mbarojnë me çdo bashkëtingëllore tjetër. Grupi i parë përfshin shumicën dërrmuese të foljeve, ndërsa grupi i dytë përmbledh një grup të vogël foljesh.

Foljet angleze të huazuara në shqipen e Amerikës janë integruar në grupin e parë të foljeve shqipe me një për qind të të gjitha rasteve, kurse vetëm disa prej tyre janë integruar në zgjedhimin e dytë. Këtu më poshtë japim 4 folje të huazuara nga anglishtja të integruara në zgjedhimin e parë të krahasuara me një folje të shqipes në atë zgjedhim (këndoj).

Shqip

Huazimet e anglishtes

v. I nj.	Këndoj	<i>aksepto</i> +	<i>imbarkoj</i> ++	<i>guvernoj</i> * ⁴²	<i>rekordoj</i> **
v. II nj.	Këndon	<i>akseptin</i>	<i>imbarkon</i>	<i>guvernon</i>	<i>rekordon</i>
v. III nj.	Këndon	<i>akseptin</i>	<i>imbarkon</i>	<i>guvernon</i>	<i>rekordon</i>
v. I sh.	Këndojmë	<i>akseptomë</i>	<i>imbarkojmë</i>	<i>guvernojmë</i>	<i>rekordojmë</i>
v. II sh.	Këndoni	<i>akseptoni</i>	<i>imbarkoni</i>	<i>guvernoni</i>	<i>rakordoni</i>
v. III sh.	Këndojnë	<i>akseptonë</i>	<i>imbarkojnë</i>	<i>guvernojnë</i>	<i>rekordojnë</i>

Siç mund të shihet nga këta shembuj dhe nga të gjithë shembujt e tjerë, foljet e huazuara dhe fonemikisht të përshtatura, gjithmonë kanë marrë mbaresa vetore të përngjitura drejtpërdrejt temave të foljeve të anglishtes, si f.v.:

aksept + -oj > *aksepto*j; imbark + -oj > *imbarkoj* etj.

Foljet e huazuara angleze, nga korpusi, janë integruar në zgjedhimin e dytë në shqipen e Amerikës: *advërtajz* (nga “advertize”), *llus* (nga “lose”), *servis*, *telegrafis*, *brodkest* (nga “broadcast”), *helpi* (nga “help”), *çenjxh* (nga “change”). Ato e formojnë zgjedhimin e tyre sikur foljet e

³⁹ Në gjuhën e sotme shqipe veta e parë njëjës e foljes në kohën e tashme (të thjeshtë) merret si njësi fjalësi në fjalorë dhe gjetiu, si ekuivalent i mënyrës paskajore të anglishtes.

⁴⁰ Sh. Demiraj, 1971, f. 171.

⁴¹ Kjo mbaresë dikur paraqitej edhe në veten e parë njëjës të kohës së tashme të foljeve, kurse tani ajo haset vetëm në vetat e dyta dhe të treta të foljeve në numrin njëjës.

⁴² pranoj+; ngarkoj++; qeveris*; shënoj**

shqipes të zgjedhimit të dytë. Më poshtë japim disa shembuj të zgjedhimit të tyre, të krahasuar me folje të shqipes të ngjshme për nga mbaresat:

Shqip		Anglisht	Shqip	Anglisht
v. I nj.	zbraz	<i>advërtajz</i>	vulos	<i>llus</i>
v. II nj.	zbraz	<i>advërtajz</i>	vulos	<i>llus</i>
v. III nj.	zbraz	<i>advërtajz</i>	vulos	<i>llus</i>
v. I sh.	zbrazim	<i>advërtajzim</i>	vulosim	<i>llusim</i>
v. II sh.	zbrazni	<i>advërtajzni</i>	vulosni	<i>llusni</i>
v. III sh.	zbrazin	<i>advërtajzin</i>	vulosin	<i>llusin</i>

Folja me trajtë *servoj* është integruar në zgjedhimin e parë në shqipen standarde dhe përdoret vetëm në sport (volejbol): *servoj* (hedh) topin nga këndi i fushës. Një trajtë tjetër, *serviroj*, përdoret në kuptim të “ndihmoj”, “bëj një shërbim”.

Në gjuhën shqipe të Amerikës, foljet e huazuara angleze të cilat janë integruar në mënyrë mbizotëruese në zgjedhimin më produktiv, me mbaresa përkatëse në shqipe, tingëllojnë fare të pranueshëm si të shqipes, por për folësit e shqipes standarde janë të pakuptimta. T’i zëmë ngoje vetëm disa nga foljet e tilla:

<i>aktoj</i> (veproj),	<i>admitoj</i> (pranoj),
<i>aprecioj</i> (vlerësoj, çmoj),	<i>kancelloj</i> (shtyj, pezulloj),
<i>decidoj</i> (vendos),	<i>editoj</i> (redaktoj, botoj),
<i>guvernoj</i> (qeveris),	<i>embarrasoj</i> (turpëroj),
<i>insaltoj</i> (fyej),	<i>interferoj</i> (ndërhyj),
<i>investigoj</i> (hulumtoj),	<i>parkegoj</i> (parkoj),
<i>performoj</i> (kryej, zbatoj),	<i>pollutoj</i> (ndot),
<i>promulgoj</i> (shpall, botoj),	<i>rebeloj</i> (ngre krye),
<i>ridikullizoj</i> (bëj qesharak),	<i>vakancoj</i> (pushoj, veroj), etj.

Ndonjëherë një mbaresë jokorrekte (e re) e foljes është zëvendësuar në disa folje të huazuara të reja, që po ashtu, përdoren në shqipen standarde, por me mbaresë tjetër, me gjasë jo në përputhje të plotë me orientimin e përgjithshëm të shqipes. Kjo zakonisht dëgjohet nga ata folës të shqipes së Amerikës, kompetenca gjuhësore e shqipes së të cilëve është dobësuar, ose të cilët kurrë nuk e kanë zotëruar si duhet shqipen. Për shembull: *favoroj* (për *favorizoj* në shqipen standarde), *parkegoj* (për *parkoj* në shqipen standarde). Shumë shembuj të tjerë mund të gjenden në ligjërimin individual të folësve të shqipes amerikane, por këto dyja ishin “standardizuar” tek ata.

Disa nga foljet e huazuara që përdorin shqipfolësit e Amerikës nuk tingëllojnë fare shqip. Ato kanë trajta shumë artificiale. Kjo mund të jetë për shkak se ndër ata folës është një prirje për ta thjeshtësuar ndërliqshmërinë e sistemit foljor të shqipes ose për shkak se është aktive një prirje për rrafshime gramatikore. Për shembull, *brodkest* (nga

“broadcast” - emitoj) dhe *chejnxh* (nga “change” - ndryshoj) nuk kanë tipare të mirëfillta të asnjërës nga të dyja zgjedhimet e foljeve në gjuhën shqipe. Ato kanë më shumë tipare të përbashkëta të zgjedhimit të dytë, por ndonjëherë përdoren edhe në zgjedhimin e parë. Këtu më poshtë po ofrojmë një pasqyrë të foljeve të huazuara e të përshtatura ashtu siç i kemi hasur në gjuhën shqipe të Amerikës.

Pasqyra 3

Huazimet foljore të përshtatura në shqipen e Amerikës

Anglisht	Shqipe amer.	Shqipe standarde
abuse	<i>abuzoj</i>	shpërdorj (abuzoj)
accept	<i>akseptoj</i>	pranoj (akceptoj)
act	<i>aktoj</i>	veproj
admit	<i>admitoj</i>	pranoj; lejoj
adopt	<i>adoptoj</i>	adoptoj, përvetësoj
address	<i>adreso</i>	drejtoj, adresoj
advertize	<i>advërtajz</i>	reklamoj
announce	<i>anuncoj</i>	shpall
appreciate	<i>aprecioj</i>	çmoj
assassinate	<i>asasinoj</i>	vras
balance	<i>ballancoj</i>	bilancoj; peshoj
boycott	<i>bojkotoj</i>	bojkotoj
broadcast	<i>brodkest</i>	transmetoj
cable	<i>kablloj</i>	telegrafoj
cancel	<i>kancelloj</i>	pezulloj
celebrate	<i>celebroj</i>	kremtoj
change	<i>çejnxh</i>	ndryshoj
compromise	<i>kompromisoj</i>	bëj kompromis
conform	<i>konformoj</i>	përshtat
confuse	<i>konfuzoj</i>	ngatërroj
consist	<i>konsistoj</i>	konsistoj
correct	<i>korrektoj</i>	korrigjoj
cost	<i>koston</i>	kushton
credit	<i>kreditoj</i>	jap kredi
cure	<i>kuroj</i>	shëroj, kuroj
dance	<i>dansoj</i>	vallëzoj
decide	<i>decidoj</i>	vendos
deport	<i>deportoj</i>	internoj, dëboj
deposit	<i>depozitoj</i>	jap depozitë, depozitoj
develop	<i>devellopoj</i>	zhvilloj
direct	<i>direktoj</i>	dirigjoj
draft	<i>draftoj</i>	thirr nën armë
economise	<i>ekonomizoj</i>	kursej
edit	<i>editoj</i>	redaktoj
effect	<i>efektoj</i>	bëj efekt, veproj
embark	<i>imbarkoj</i>	ngarkoj
embarras	<i>embarasoj</i>	zë ngushtë, turpëroj
envy	<i>envidoj</i>	kam zili

evolve	<i>evolvoj</i>	zhdrivilloj
export	<i>eksportoj</i>	eksportoj
fabricate	<i>fabrikoj</i>	prodhoj, fabrikoj
familiarize	<i>familiarizoj</i>	familjarizoj, bëj të njohur
favor	<i>favoroj</i>	favorizoj
film	<i>fillmoj</i>	filmoj
force	<i>forcoj</i>	detyroj
frequent	<i>frekuentoj</i>	ndjek, frekuentoj
govern	<i>guvernoj</i>	qeveris
graduate	<i>gradoj</i>	diplomoj
help	<i>helpi</i>	ndihmoj
hospitalize	<i>hospitalizoj</i>	shëroj në spital, hospitalizoj
impinge	<i>impenoj</i>	dikoj
import	<i>importoj</i>	importoj
insult	<i>insulltoj (insalltoj)</i>	ofendoj, fyej
intercept	<i>interceptoj</i>	ndaloj
interfere	<i>interferoj</i>	ndërhyj
interview	<i>intervistoj</i>	bëj intervistë
introduce	<i>introduktoj</i>	paraqes; njoftoj
invade	<i>invadoj</i>	pushtoj
invent	<i>nventoj</i>	shpik
investigate	<i>investigoj</i>	gjurmtoj
limit	<i>limitoj</i>	kufizoj
lose	<i>lus</i>	humb
mature	<i>maturoj</i>	piqem
minimize	<i>minimizoj</i>	zvogëloj, minimizoj
park	<i>parkegoj</i>	parkoj
perform	<i>përformoj</i>	shfaq
pollute	<i>pollutoj</i>	ndot
post	<i>postaroj</i>	lëshoj në/ dërgoj me postë
predominate	<i>predominioj</i>	mbizotëroj, predominoj
preserve	<i>prezervoj</i>	mbrojt; ruajt
proceed	<i>procedoj</i>	vazhdoj, procedoj
produce	<i>produkoj</i>	prodhoj
profit	<i>profitoj</i>	përfitoj
promulgate	<i>promolgoj</i>	shpall
pronounce	<i>pronuncoj</i>	shqiptoj
rebel	<i>rebeloj</i>	ngre krye
recommend	<i>rekomandoj</i>	porosis, rekomandoj
record	<i>rekordoj</i>	shënoj; incizoj
repeat	<i>repetoj</i>	përsëris
report	<i>reportoj</i>	raportoj
resolve	<i>resollvoj</i>	zgjidh; vendos
respekt	<i>rispektoj</i>	nderoj, respektoj
restore	<i>restoroj</i>	restauroj
result	<i>rezullton</i>	rrjedh, rezulton
retire	<i>retiroj</i>	pensionohem
revolutionize	<i>revolucionoj</i>	bëj revolucion
ridicule	<i>ridikullizoj</i>	përqesh

sequester	<i>sekuestroj</i>	veçoj
serve	<i>servir, serviroj</i>	shërbej
sympathize	<i>simpathizoj</i>	simpatizoj; shpreh keqardhje
tax	<i>taksoj</i>	tatimoj, vë tatim
total	<i>totalizoj</i>	arrij shumën
trick	<i>trikoj</i>	mashtroj
(take) a vacation	<i>vakancoj</i>	bëj pushim

5. Përemri

5.1. Përemrat vetorë. - Nuk ka shembuj që tregojnë të jenë huazuar përemra vetorë në shqipen e Amerikës. Mirëpo, përdorimi redundant i përemrave vetorë pasqyron interferencën e ushtruar nga anglishtja. Kjo bëhet për arsye se përemrat në anglishte janë të obligueshëm për të treguar veten, kurse në gjuhën shqipe mjafton të përdoret folja me mbaresat që shënojnë numër dhe vete.

5.2. Përemrat pronorë. - Është hetuar një prirje e folësve të shqipes në Amerikë për të përdorur përemrat pronorë më shpesh sesa kërkohet në shqipen standarde. Kjo, përsëri, rrjedh nga ndikimi i anglishtes, e cila e ka të detyrueshëm përdorimin e përemrave pronorë, gjë që nuk është dukuri aq e sforcuar në gjuhën shqipe.

6. Numërori

Nuk është hasur ndonjë rast i huazimit të numrave të anglishtes në gjuhën shqipe të Amerikës. Mirëpo, kur shqipfolësi atje flet për vite e data, ai tenton të përdorë numrat në anglishte, pra bën transfer kodit. Për shembull:

- (1) Unë erdha këtu në *nineteen twenty* (1920)
- (2) Fan Noli ardhni në Amerikë më *nineteen o six* (1906).

Folësi i shqipes në Amerikë edhe numrat e telefonit i thotë në anglishte, po edhe numrat e shtëpive dhe të rrugëve. Por ata shembuj mund të konsiderohen si raste të transferit të kodit e jo si huazime në kuptimin e mirëfilltë të tyre.

7. Ndajfolja

Ndajfoljet e huazuara nga anglishtja nuk përdoren shumë dendur në ligjërimin e shqiptarëve të Amerikës në trajta të përshtatura. Vetëm nja dhjetë ndajfolje të tilla janë hasur në korpusin tonë. Ja lista e tyre.⁴³

⁴³ Shih edhe *Interferenca leksikore në shqipen e Amerikës* në këtë studim.

Shq. e Amerikës	Anglisht	Shqipe standarde
<i>aksidentalisht</i>	accidentally	rastësisht
<i>aktualisht</i>	actually	në të vërtetë
<i>incidentërisht</i>	incidentally	rastësisht
<i>informalisht</i>	informally	në mënyrë jo formale
<i>probabilisht</i>	probably	me gjasë, sigurisht
<i>prominentërisht</i>	prominently	dallueshëm
<i>specialisht</i>	specially	sidomos, veçmas
<i>supërfaqësisht</i>	superficially	sipërfaqësisht
<i>junanimisht</i>	unanimously	njëlëzëri
<i>universalisht</i>	universally	përgjithësisht

Por shumë më tepër ndajfolje përdoren në trajtë të papërshtatur, si transfer kodi. Bukur shumë fjalë ndërhyrëse⁴⁴ apo partikula të papërshtatura përdoren, po ashtu, siç janë: *all right, OK, of course, sure, no, so, yeah, oh yes, anyway*; pastaj: *I know, you know, I don't know, excuse me, I mean, oh boy, that's right, that's all* etj. Këto shprehje janë të izoluar, domethënë asindetike. Shumëkush i mëson ato pa e mësuar ende vetë gjuhën.

*

ASHA e Kosovës, nr. 2/1995, ff. 225-261, Prishtinë, 1995.

⁴⁴ Termi i përdorur sipas Seaman, 1970, f. 189.

INTERFERENCA SINTAKSORE E ANGLISHTES NË SHQIPEN E AMERIKËS

1. Rendi i fjalëve

Ndonëse praktika e analizave të ndikimeve gjuhësore në rrafshin sintaksor ka treguar se nuk ka shumë analiza të tilla në këtë rrafsh gramatikor, në analizën tonë të ndikimeve të anglishtes në gjuhën shqipe të Amerikës është vërtetuar se mund të gjenden raste interesante edhe të ndikimeve të tilla. Një gjuhë mund të ushtrojë ndikimin e vet edhe në rrafshin sintaksor të gjuhës tjetër. Duke u nisur nga kjo e dhënë, ka shpesh raste kur modeli i raporteve sintaksore të anglishtes të zbatohet në ligjërimin shqip të Amerikës, çka mund të paraqesë risi gjuhësore ose shkëlqje të rregullave gramatikore ekzistuese të gjuhës marrëse.

Anglishtja dhe shqipja kanë kategori gramatikore të ngjashme, siç janë gjinia, numri, rasa e emrit, pastaj veta, koha dhe mënyra e foljes etj.⁴⁵ Raportet gramatikore të shqipes janë sintetike dhe analitike, ndërsa raportet gramatikore të anglishtes janë kryesisht analitike. Prandaj këto dy gjuhë dallojnë shumë në mënyrën si i shprehin raportet e tyre gramatikore. Për të identifikuar funksionimin e fjalëve në gjuhën angleze ka rëndësi shumë të madhe konteksti konkret. Identifikimi i funksionit të fjalëve të izoluar është thuaja i pamundur. Nga ana tjetër, thuhet se shqipja është gjuhë flektive prandaj ka rend fjalësh relativisht të lirë. Në gjuhën shqipe fjalët zakonisht kanë morfema të varura flektive, të cilët vetvetiu përcaktojnë funksionin e tyre në raste të dhëna. Pra, funksioni gramatikor është i shënuar në fjalët shqipe. Ndërsa funksioni i fjalëve të anglishtes shënohet dhe identifikohet kryesisht nga konteksti. Në bazë të kësaj del se raportet sintaksore në gjuhën shqipe shprehen me seleksion, kurse rendi i fjalëve është në masë bukur të madhe çështje stili. Në anglishte, nga ana tjetër, rendi i fjalëve është zakonisht e vetmja mënyrë për të dalluar funksionet e ndryshme të fjalëve në fjali. Për ta ilustruar këtë po japim këto fjali:

⁴⁵ Kjo mund të shihet në artikullin *Interferenca morfologjike e anglishtes në shqipen e Amerikës*, botuar në këtë vëllim.

(1) *John insulted Mary.* (Xhoni ofendoi Marinë.)

(2) *Mary insulted John.* (Maria ofendoi Xhoni.)

Nuk ekzistojnë mënyra të tjera në anglishte për të shprehur kuptimet e fjalive 1) dhe 2) në diatezën veprorë. Në gjuhën shqipe, përkundrazi, në saja të morfemave të saja të eptimit ka mundësi (skajshmërisht) të shprehet secili nga kuptimet e atyre dy fjalive në gjashtë mënyra vetëm në diatezën veprorë dhe, po ashtu, në gjashtë mënyra të tjera në diatezën pësorë.

(3) **Veprorë:**

- a) *Xhoni ofendoi Marinë.*
- b) *Xhoni Marinë ofendoi.*
- c) *Marinë ofendoi Xhoni.*
- ç) *Marinë Xhoni ofendoi.*
- d) *Ofendoi Xhoni Marinë.*
- dh) *Ofendoi Marinë Xhoni.*

(4) **Pësorë:**

- a) *Maria u ofendua nga Xhoni.*
- b) *Maria nga Xhoni u ofendua.*
- c) *Nga Xhoni Maria u ofendua.*
- ç) *Nga Xhoni u ofendua Maria.*
- d) *U ofendua nga Xhoni Maria.*
- dh) *U ofendua Maria nga Xhoni.*

Një fjali, pra, e përbërë nga tri fjalë (kryefjalë, kallëzues, kundri-në) mund të thuhet në gjuhën shqipe në 8 mënyra pak a shumë të kuptueshme, ndërsa kjo nuk është e mundshme në gjuhën angleze. Meqenëse gjuha është sistem i organizuar, përkundër faktit se disa gjuhë janë flektive, mund të pritët ekzistimi i njëfarë renditjeje fjalësh, dhe ai rend i fjalëve nuk është plotësisht i lirë. Edhe në gjuhën shqipe ka kufizime.

1. Nuk janë vërejtur shumë raste të përdorimit të gabuar të raporteve sintaksore të bëra nën ndikimin e gjuhës angleze mbi shqipen e Amerikës. Mirëpo, ka shembuj në të folur dhe në shkrime të fjalive me rend fjalësh të gabuar që rrjedhin si pasojë e interferencës së ushtruar nga gjuha angleze si edhe nga dobësimi i kompetencës gjuhësore në ligjërimin shqip të atyre folësve. Prandaj në sintagmën:

(5) ora tre pas dite *ekzakt*,

pozita e fjalës *ekzakt* është jo shumë e drejtë. Ajo do të duhej të kishte pozitën diku afër fillimit të sintagmës dhe jo e përdorur në trajtë mbiemërore, por si ndajfoljor, ose si mbiemër i përdorur menjëherë pas emrit *ora*, për ta përcaktuar atë. Sintagmë e drejtë do të ishte:

- a) në orën *e saktë* (*ekzakt*) tre pas dite, ose
 b) *saktësisht* në orën tre pas dite.

Një rast i ngjashëm haset edhe në fjalinë vijuese:

(6) Në ora katër *prerë* fillon mbledhja.

Si në rastin nën (5) edhe nën (6), përveç që kanë pozitë të gabuar, fjalët janë zgjedhur në mënyrë jo të drejtë. Në sintagmën (5) mbiemri i huazuar është përdorur në vend të ndajfoljorit, kurse në fjalinë nën (6) është zgjedhur ndajfoljor i shqipes, por i pasaktë, d.m.th. njësia leksikore nuk e mbulon semantikisht fushën që i është dhënë. Mirëpo, asaj i është dhënë edhe pozicioni i gabuar.

2. Siç u zu ngoje më sipër,⁴⁶ për dallim nga anglishtja, mbiemri në gjuhën shqipe vijon pas emrit të cilin ai e përcakton. Mbiemri fare rrallë vendoset para emrit dhe atë vendosje mund ta bëjë vetëm në poezi dhe në të folurit emfatik. Mirëpo, rendi i fjalëve Mb / - E/ është fare i shpeshtë në shqipen e folur në Amerikë, pa dyshim, si rezultat i interferencës nga anglishtja. Ka shumë raste të përdorimit të mbiemrave, po edhe të numërorëve rreshtorë në pozitë të tillë:

(7) *me të njëzetin* shekull

(8) *i 19-ti* zhvillim i lojërave Olimpikë

(9) *më e vjetra* revistë mujore etj.

Si u tha më sipër, rendi i tillë i fjalëve mund të haset në gjuhën shqipe standarde vetëm në raste të rralla; ai mund të haset më shpesh në të folurit e përditshëm në disa të folme të gjuhës shqipe. Mirëpo, ajo topikë është sforcuar shumë në shqipen e Amerikës, si pasojë e përputhjes me rendin e fjalëve në gjuhën angleze.

3. Një prishje tjetër e rendit të fjalëve sipas normës standarde të shqipes në ligjërimin shqip të Amerikës është vërejtur në përdorimin e kohëve të ardhshme të foljeve në trajtën mohore. Si trajtë standarde supozohet të jetë kjo:

s'/nuk + do + koha e tashme e mënyrës lidhore.

Mirëpo, shpesh kemi hasur në struktura ku, pa dyshim, nën ndikimin e rendit të fjalëve në anglishte, është dhunuar rendi i fjalëve të shqipes, si për shembull:

do + të + mos + koha e tashme e mënyrës lidhore⁴⁷ (me

⁴⁶ Shih nën mbiemrat, në artikullin e këtij botimi *Interferenca morfologjike në shqipen a Amerikës*.

⁴⁷ Ndonëse mund të përdoret në disa të folme të shqipes, ajo topikë është sforcuar nga interferenca e ushtruar nga anglishtja.

të të veçuar), e cila është shumë e ngjashme me strukturën e anglishtes për atë kohë të foljes: will + not + infinitiv (rrënja e paskajores)

Një shembull mjafton për ta ilustruar këtë çështje:

(10) Franca *do të mos marrë pjesë...* (France will not take part...)

Në të vërtetë, këtu kemi të bëjmë me futjen e elementit të mohores *mos*, e cila nuk është zgjedhur drejt, sepse është element për formimin e mohores së mënyrës urdhërore, qoftë në ligjëratë të drejtë ose të zhdrejtë:

Thuj: “*Mos merr pjesë!*” (ligj. e drejtë)

Thuj *të mos marrë pjesë*. (ligj. e zhdrejtë)

Në fjalinë (10), pjesëza *mos* e shqipes ka zënë pozitën e pjesëzës *not* të anglishtes, ndërsa *do + të* është marrë si ekuivalent i modalit *will* të anglishtes. Pra, janë bërë dy shkelje të normës së shqipes: rendi i fjalëve i gabuar dhe fjala e zgjedhur gabimisht.

4. Rendi i fjalëve i gjuhës shqipe nuk respektohet sidomos nga folësit e shqipes të brezit të dytë të shqiptarëve të Amerikës, të cilët shpesh vijojnë rendin e fjalëve sipas gjedhes së anglishtes pikë për pikë. Me fjalë të tjera, ata thjesht përkthejnë fjalë për fjalë nga anglishtja në shqipe. Më poshtë po japim një fjali, jo si i vetmi shembull i këtij lloji. Ta krahasojmë atë fjali, të shqiptuar nga një informator, me ekuivalentin e saj në anglishte.

(11) Unë jam në e fundit vjeta e gjimnazit. (I am in the final year of high school.)

Siç mund të shihet, kjo fjali është e padrejtë në gjuhën shqipe. Shumica e fjalëve janë vënë në pozitë të gabuar, duke vijuar sipas modelit të anglishtes: Unë-I, jam-am, në-in, e fundit-the final, vjeta-year, e gjimnazit-of high school. Pos kësaj, emri “vjeta” është përdorur në gjini të gabuar (femërore), kurse gjinorja: e gjimnazit – of high school është përkthim jo shumë i saktë. Por këto dy gabime nuk mund t’i hidhen interferencës nga anglishtja, natyrisht, por janë pasojë e kompetencës së dobësuar ose të mangët të folësit në gjuhën shqipe.

5. Kemi hetuar disa raste të prishjes së rendit të fjalëve nga folësit e gjuhës shqipe në Amerikë gjatë përdorimit të disa ndajfoljorëve. Disa ndajfolje janë futur midis foljes ndihmëtare dhe foljes bosht në sintagmën foljore të kësaj të folmeje, gjë fare e natyrshme, në përputhje të plotë me rendin e fjalëve të anglishtes në ata shembuj të posaçëm. Ky rend fjalësh është plotësisht i gabuar në shqipen standarde. Në të vërtetë, ai është fare i papranueshëm. Ja disa shembuj të tillë:

- (12) ...e cila ka *gjithmonë* ndihmuar shumë.
(...who has *always* helped very much.)
- (13) ...të cilat zemra jonë ka *sinqerisht* dëshiruar.
(...which our heart has *sincerely* desired.)
- (14) Shqiptarët e kanë *shpesh* përdorur këtu në Boston.
(Albanians have *often* used it here in Boston.)

6. Rendi i fjalëve në këtë gjedhë: *gjatësi kohe + më parë* përdoret ndonjëherë në të folmet e shqipes prej nga e kanë prejardhjen folësit që janë objekt të këtij studimi. Mirëpo, ai rend fjalësh është bërë vërtetë shumë më i dendur në ligjërimin e shqiptarëve të Amerikës që e kemi studiuar. Kjo s’do mend se është përforcuar nga ndikimi i anglishtes, e cila ka pikërisht rend të tillë fjalësh në shprehjen e zënë ngoje më sipër për të treguar diçka që ka ndodhur para çastit kur bëhet fjalë për të. Po ofrojmë disa shembuj:

- (15) ... i cili vdiq *pak muaj më parë*. (...who died *a few months ago*.)
- (16) *Ca ditë më parë* edhe \$100 në gazetën “Dielli. (*A few days ago* another \$100 for the newspaper *Dielli*.)
- (17) ...siç deklaroi *ca ditë më parë*. (...as he stated *some days ago*.)
- (18) ...ashtu sikundër e gjeti *47 vjetë më parë*. (...as he found it *47 years ago*.)

Prandaj, shumë rrallë haset sintagma me gjedhe: para – gjatësi kohe, e cila po ashtu është e shqipes. Për shembull: *Para dy orësh* e takova mikun tim të studimeve..

7. Meqenëse edhe gjedhja e gjuhës burimore, njësoj si fjalët, mund të bartet në gjuhën marrëse gjatë procesit të interferencës gjuhësore, është huazuar gjedhja amerikane për shënimin e datave në shqipen e atjeshme; kjo do të thotë që muaji të shënohet para datës (ditës), gjë që është një rend fjalësh shumë i shpeshtë i anglishtes amerikane, por i cili nuk përputhet me normën e shqipes standarde. Ja disa shembuj të atij lloj huazimi:

- (19) *Prill më 26*: udhëtimi në Genazzano.
- (20) Hapja: *Shtator 2* në orën 9 a.m.
- (21) Numri dyfish (i revistës), *Maj 15*, 1968.
- (22) Kishin një program të posaçëm në *Maj 30*, 1975.

Madje, ky model është vijuar edhe kur data shënohet vetëm me numra. Kështu data 9 maj 1968, është shënuar:

- (23) *Më 5-9-68* muarrëm një letër.

Pos kësaj, është një tendencë shumë e fuqishme e folësve të shqipes në Amerikë, që të ruajnë strukturën e obligueshme, siç u pa edhe më sipër. Ky rend fjalësh i sforcuar është pasojë e interferencës dhe e trysnisë nga anglishtja.

Mirëpo, gabimet që bëjnë shqiptarët e Amerikës në raportet sintaksore, nuk mund të shpjegohen gjithmonë si pasojë e interferencës nga anglishtja. Ato mund të jenë edhe rezultat i dobësimit të kompetencës së përgjithshme gjuhësore të shqipes tek ata folës. Kjo duket të jetë ashtu, sidomos kur kemi parasysh se shqipja kërkon përputhje të saktë të trajtave të saj të pasura eptimore ndërmjet vete. Pëlqimi kërkon përputhje të kategorive gramatikore të shqipes në rasë, në numër dhe në gjini të atyre pjesëve të ligjëratës që i kanë këto raporte sintaksore.

2. Diateza pësore

Diateza pësore përdoret dukshëm shumë më rrallë në gjuhën shqipe sesa në anglishte. Për shkak të dendurisë së madhe të përdorimit në gjuhën angleze, diateza pësore ka përdorim shumë më të dendur në shqipen e folur në Amerikë, sesa ka rëndom në shqipen standarde në përgjithësi.

Përsorja në gjuhën shqipe ka ngjashmëri të madhe me vetvetoren, sa u përket mjeteve gramatikore.⁴⁸ Në fjali me diatezë pësore funksionet sintaksore dallojnë nga ato të diatezës veprore. Kryefjala e fjalisë veprore bëhet kundrinë e kallëzuesit të fjalisë pësore, shikuar nga pikëpamja thjesht formale gramatikore, duke i mundësuar kundrinës së fjalisë veprore të bëhet kryefjalë gramatikore (formale) e fjalisë pësore, kurse agentivi shprehet me plotësin e vepruesit. Vetëm kuptimi i një fjalie të dhënë mund të përcaktojë qartë për cilën diatezë është fjala, veprore apo vetvetore. Për shembull:

- (1) Kjo njollë *lahet* vetëm me benzinë, (pësore);
- (2) Ai *lahet* me ujë të ftohtë, (vetvetore).

Diateza pësore në gjuhën shqipe formohet në mënyra të ndryshme dhe me mjete të ndryshme gjuhësore, siç janë: a) ndajshtesa të posaçme; b) folja ndihmëse *jam* dhe c) partikula paraemërore *u*. Diateza pësore e ndërtuar me ndajshtesa të posaçme (mbaresa) është, pa dyshim, karakteristike tipike e shqipes. G. Mejer i konsideronte këto mbaresa të shqipes për formimin e diatezës pësore trajta gramatikore origjinale të foljes *jam*.⁴⁹ Ato i janë përngjitur temës së foljes të zgjedhurar në kohë dhe mënyra të ndryshme. Foljet pësore flektive po ashtu gjenden në kohën e pakryer të shqipes, duke u ndërtuar nga mbaresat përkatëse.

⁴⁸ Sh. Demiraj, 1971. ff. 166-169.

⁴⁹ G. Meyer, 1880, cituar në Sh. Demiraj, 1971, ff. 168-9.

Mirëpo, disa trajta të diatezës pësore në gjuhën shqipe ndërtohen sikur edhe në gjuhën angleze, në mënyrë analitike. Struktura e tyre është: *jam + pjesore*. Folja ndihmëtare *jam* zgjedhohet në numër dhe në vete duke i marrë kështu mbi vete të gjitha kategoritë gramatikore, si dhe çdo gjë që ka për detyrë folja ndihmëtare, kurse pjesorja mbetet e pandryshuar. Kohët e kryera të përbëra të mënyrave dëftore, lidhore, kushtore, dëshirore dhe habitore ndërtohen në këtë mënyrë.

Disa trajta gramatikore të pësores në gjuhën shqipe ndërtohen duke përdorur partikulën *u*, e cila ose i paraprin foljes si fjalë proklitike ose vijon pas foljes si pjesë enklitike. Mësojmë se në shqipen e vjetër kjo partikulë ishte përemër vetvetor. Sot kjo partikulë përdoret për formimin e pësores në kohën e kryer të thjeshtë: *u kritikova*; dhe në mënyrën dëshirore: *u marroftsh* si dhe në mënyrën habitore: *u kritikua kësha*.

Përkundër faktit që *jam* folës burimor i shqipes dhe me gjasë kam kompetencë të plotë në gjuhën shqipe, kam dashur të provoja vlefshmërinë e përfundimeve të mia sa i përket përdorimit të diatezës pësore në materialin e mbledhur për këtë studim. Prandaj studentëve të albanologjisë në Universitetin e Prishtinës, të cilët nuk dinin anglisht, ua kisha dhënë disa fjali gramatikisht të dyshimta nga korpusi i mbledhur në gjuhën shqipe të Amerikës, në mënyrë që ata t'i vlerësonin sipas gjykimit të tyre. Studentëve u dhashë një test me fjali të ndryshme dhe u thashë që t'u përgjigjeshin në mënyrë sa më të saktë dhe të bënin çfarëdo komenti që të donin. Koha ishte e kufizuar. Për këtë qëllim ishin zgjedhur 20 studentë.

Ky shembull i përdorimit të diatezës pësore në gjuhën shqipe të Amerikës mund të ngrihet në çështje për bisedë:

(3) Ky kontinent është i banuar nga dy miliardë njerëz.

Siç mund të shihet, kjo është një fjali tipike e gjedhes së pësores angleze. Formula e saj mund të shënohet: sintagma emërore (SE) + *jam* + pjes. (pjesore) + nga agj. (agjentiv). Një fjali e tillë nuk duket të jetë shumë e pranueshme në shqipe, ndonëse duhet të thuhet që mund të haset edhe si e tillë, por natyrisht nuk mund të konsiderohet e drejtë. Duket qartë se interferenca e anglishtes ka kushtëzuar prodhimin e një fjalie të tillë, sepse i përgjigjet plotësisht strukturës së anglishtes. Në të vërtetë, nëse autori do të donte të prodhonte një fjali pësore me këtë brumë gjuhësor, ai do të mund të përdorte pësoren *banohet*, në vend të *është i banuar*. Megjithatë, na duket se shumica e folësve të shqipes do të përdornin diatezën veprorë, e cila do ta bënte fare të qartë kuptimin, dhe fundja veprorja është shumë më e dendur në shqipe sesa në

anglishte, e ajo merret si mjet sqarues kur pësorja krijon probleme kuptimi.

Mbi 70 për qind të informatorëve e kishin ndryshuar foljen e fjalisë (3) në diatezë veprorë. Dhe nuk ishte ndryshuar vetëm diateza, por disa e kishin zëvendësuar foljen *është i banuar* me *jetojnë*, kurse ndajfoljori i vendit ishte vendosur në pozitë të parë, ndërsa kryefjala në pozitë të fundit por në rasën emërore, e jo në trajtë agentivi. Pra, kishte dalë fjalia pak a shumë si kjo:

(4) Në këtë kontinent jetojnë më se 2 miliardë njerëz.

Të shohim tani një shembull tjetër i cili është pikë për pikë konstruksion i anglishtes:

(5) Ne të mërguarit nuk jemi të lejuar të vemi atje.

Struktura e saj është: SE + F (folja) + pës. (pësore) + lidhore + ndajfolje.

Edhe kjo fjali u ishte dhënë studentëve të cekur më sipër të Prishtinës. Vetëm 5 për qind prej tyre e kishin pranuar si fjali; nja 5 për qind të tjerë nuk e dinin nëse ishte fjali e drejtë ose jo. Të gjithë të tjerët kishin deklaruar se ajo ishte fjali e gabuar. Kur kërkua që të jepnin versionin e tyre, ata e ndryshuan strukturën e saj të përgjithshme. Nja 25 për qind të informatorëve shënuan "*s'na është lejuar*", e cila është fare e drejtë nëse insistohet të përdoret trajta pësore e shqipes dosido, por kuptimi, sido që të jetë, është i gabuar. Nja 10 për qind të tjerë e dhanë pësoren "*nuk na lejohet*", mbase forma më e drejtë e diatezës pësore në shqipe. Nja 25 për qind të informatorëve e kishin ndryshuar këtë fjali në diatezën veprorë: "*s'na lejojnë*". Duket se ndër shqiptarët e dialektit gegë diateza pësore përdoret shumë rrallë, ndryshe nga dialekti i toskërishtes, ku duket që diatezë përdoret më shpesh.

Fjalia vijuese e shqiptuar nga shqiptarët e Amerikës i përmbahet saktësisht strukturës së anglishtes, e cila nuk është fare e rëndomtë për folësit e shqipes standarde:

(6) Jemi duke pasur fitime nga ndasia midis X dhe Y.

Vetëm 5 për qind të informatorëve të Prishtinës e pranuan këtë fjali, me gjasë duke mos qenë shumë të kujdesshëm. Nja 50 për qind prej tyre dhanë versione të tjera, që janë më afër shqipes standarde, si b.f.: "*jemi duke fituar*"; "*kemi fitime*"; "*jemi në fitim*". Versioni i fundit duket të jetë i ndikuar nga sllavishtja te informatorët tanë. Pjesa tjetër e informatorëve thjesht nuk e pranuan fjalinë si shqipe.

Duke vijuar sipas rregullave të anglishtes për formimin e diatezës pësore, mund të shkohet aq larg sa të ndryshohet kuptimi i fjalisë.

Ne kemi hasur në një fjali e cila kishte strukturë tipike angleze, ku gjedhja e agjentivit të anglishtes kishte shkaktuar dykuptimësi. Për shembull:

(7) Tetë anëtarë të rinj u bënë vetëm nga zyra.

Kjo ka këtë strukturë: SE + SF (sintagma foljore) + ndajfolje + agj. Folësi i shqipes zakonisht do të kuptonte nga kjo fjali se tetë vetë që punonin në zyrë së bashku me të tjerë qenkëshin bërë anëtarë (të ndonjë organizate). Mirëpo, në të vërtetë, autori i kësaj fjalie kishte dashur të shprehte kuptimin që ata tetë vetë ishin bindur nga zyra të bëheshin (dhe të regjistroheshin) anëtarë, por që nuk nënkuptohej që ata tetë vetë punonin në zyrë. Testi me studentët e shqipes tregoi se 70 për qind të tyre kuptuan nga kjo fjali se 8 njerëz nga zyra ishin bërë anëtarë të ndonjë shoqate (të përmendur më herët në tekst).

Këtu do të vëmë në dukje se agjentivi i anglishtes u krijon probleme folësve të shqipes së Amerikës, sepse ai është pavetëdijshëm i pranishëm në mendjen e tyre, por rëndom nuk përputhet me rregullat e shndërrimit të fjalive në diatezë pësore të shqipes.

Duke vijuar me gjedhen e anglishtes: SE + jam + mb. (mbiemër) i pjes., shumë fjali të shqipes së Amerikës humbin kuptimin e tyre që kanë për qëllim, ose së paku e ndryshojnë përmbajtjen e tyre semantike. Po i zëmë ngoje këtu dy raste të tilla:

(8) Këto lajme janë të shqyrtuara nga Presidenti.

(9) Mirage është i shitur në shumë vende të botës.

Siç mund të shihet lehtë, të dy fjalitë përputhen pikë për pikë me ekuivalentët e tyre të marrë me mend në anglishte. Këto dy fjali dallojnë strukturalisht në faktin se fjalia (8) ka agjentiv, kurse fjalia (9) nuk ka agjentiv, por një rrethanor. Sipas kësaj, strukturat e tyre janë si vijon:

(8) SE + F pës. + SP (sintagmë parafjalore) = agjentiv

(9) SE + F pës. + SP = rrethanor.

Ajo që ka rëndësi lidhur me këto fjali është fakti se kuptimet e tyre në gjuhën shqipe ndryshon deri në një shkallë. Kuptimi i rëndomtë i strukturës SE + jam + pjesore (nga mb.) në shqipe është se veprimi ka marrë fund. Kjo rrjedh për arsye se diateza pësore në shqipe ndërtohet me mjete flektive, d.m.th. vetë folja shpreh gjendjen e të pësuarit, si në rastet: *shitet* në vend se *është shitur*; *shqyrtohet* në vend se *është shqyrtuar* etj. Trajtat e dyta janë përkthime fjalë për fjalë nga anglishtja të foljes në pësore: *is sold*, *are scrutinized*.

Ndonëse nuk kishte dyshim për pasaktësinë e këtyre fjalive, për ta kënaqur kureshtjen tonë, studentët shqiptarë i testuam duke ua dhënë edhe këto dy fjali të shqipes së Amerikës dhe i lutëm që të

zgjdhnin se cili nga kuptimet vijuese dilte nga fjalia (9):

- (10) Kryetari i ka shqyrtuar lajmet dhe tani ajo punë ka marrë fund.
- (11) Kryetari ende është duke i shqyrtuar ato lajme.
- (12) Kryetari i shqyrton ato lajme për çdo ditë.

Vetëm një 10 për qind të informatorëve i kishin pranuar fjalitë (11) dhe (12). Të gjithë të tjerët, një 90 për qind, kishin kuptuar që fjalia (8) e shqipes së Amerikës të ishte ekuivalente e fjalisë (10). Ndërsa, siç dihet, as fjalia (8) e shqipes së Amerikës, e as ekuivalenti i saj në anglishte, prej së cilës merret me mend të ketë rrjedhë fjalia (8), nuk e kanë atë kuptim, d.m.th. në anglishte një kuptim i tillë fare nuk mund të pranohet si i mundshëm nga një strukturë e tillë.

Po ashtu studentëve të Prishtinës u dhamë këto kuptime alternative të fjalisë (9):

- (13) Shumë vende të botës i kanë blerë ato.
- (14) Shumë vende të botës ende i blejnë ato.
- (15) Ka ende aeroplanë të tillë për t'u shitur.
- (16) Nuk ka më aeroplanë të tillë për t'i shitur.

Një 70 për qind të informatorëve u përgjigjën se ajo që ata kishin kuptuar nga fjalia (9), ishte kuptimi i shprehur në fjalinë (13), 30 për qind e zgjodhën kuptimin (14) si të saktë. Ndërsa në përpjesëtim të barabartë ishin për kuptimet e fjalive (15) dhe (16).

Kemi hasur edhe një fjali tjetër të ndërtuar në përputhje me strukturën e diatezës pësore të anglishtes nga folësit e shqipes së Amerikës, e cila kishte ndryshuar plotësisht kuptimin e saj shikuar nga pikëpamja e gramatikës standarde të shqipes. Fjalia është:

- (17) Pregaditjet për armatosje po bisedohen prej Kongresit.

Ajo ka këtë strukturë: SE + F pës. + SP.

Informatorët e Prishtinës i lutëm të zgjidhnin njërin nga dy alternativat e shënuara më poshtë si më të mirën për të shprehur kuptimin e fjalisë (17):

- (18) Për ato përgatitje po bisedohej që nga koha kur u mbajt Kongresi.⁵⁰
- (19) Kongresi po bisedonte për ato përgatitje.

Siç mund të pritej dhe siç është e natyrshme për folësit e shqipes buri-more, gati të gjithë informatorët e kishin pranuar fjalinë (18) si ekuivalente për të shprehur kuptimin e fjalisë (17). Kjo shpërputhje del nga dallimi që ekziston midis anglishtes dhe shqipes në të formuarit e konstrukcionit të

⁵⁰ Fjala kongres mund të ketë edhe kuptimin e ndonjë tubimi të madh të ndonjë organizate dhe jo organ të përhershëm ashtu si është ai i SHBA-së.

pësore. Agjentivi “nga Kongresi” për shqipfolësin e Amerikës identifikohet me strukturën angleze “by the Congress” dhe ka domethënie të caktuar, ndërsa për shqipfolësin e Kosovës parafjala nga mund të njësohet me parafjalën prej dhe sintagma parafjalore është marrë si një rrethanor i kohës e jo si agjentiv. Domethënë, në shqipe kjo fjali ka më shumë gjasa të tregojë një ngjarje në kohë të caktuar, kurse parafjala nga aty të tregojë pikën e fillimit të kohës, e jo të jetë agjentiv. Në bazë të gjithë kësaj, është e arsyeshme të pritet që folësi i shqipes nga shprehja prej Kongresit të kuptojë një pikë kohe, d.m.th. datën e mbajtjes së kongresit.

Një dukuri tjetër bukur interesante paraqitet në fjalinë vijuese të shqipes së Amerikës:

(20). Amerika dhe Rusia janë vendosur të kontrollojnë armët nukleare.

Struktura sintaksore e kësaj fjalie duket kështu: SE + jam + pjes. + inf. + SE.

Meqenëse pas foljes *jam* vijon pjesorja, në pamje të parë duket si ndërtim i diatezës pësore. Dallimet leksikore midis anglishtes dhe shqipes kanë mundësuar edhe dallimet e kuptimit. Rastësisht, folja *vendos* në shqipe ka dy kuptime: marr vendim dhe lë në vend të vet. Prandaj dyshonim se shumica e folësve burimorë do të mendonin se ajo folje në fjalinë më sipër do të kishte më parë kuptimin *gjej vend*, zë vend, sesa marr vendim, dhe shumica e informatorëve të Prishtinës kishin menduar pikërisht kështu. Kjo rrjedh nga e dhëna se me përdorimin e sintagmës foljore janë vendosur, mund të mendohet fare mirë se do të thotë “kanë zënë vend”, “kanë zënë pozitë”, kurse ky mendim i fundit i përshtatet edhe kontekstit që mund t’i jepet në këtë fjali:

(21) Amerika dhe Rusia kanë zënë vendet prej ku do të kontrollojnë armët nukleare.

Shembulli vijues nuk është aq interesant për çështjen e diatezës pësore, por më shumë për çështje të tjera të lidhura me pësoren në shqipen e Amerikës.

(22) Qe dënuar me vdekje pesë herë nga Franca.

Edhe këtu i tërë problemi qëndron në agjentivin, i cili nuk është aq i qartë në gjuhën shqipe sa në anglishte. Arsyeya për këtë huti është se parafjala nga ka dy ekuivalente angleze “by” dhe “from”. Përveç saktësisë së strukturës, ne donim të provonim nëse ishte kuptuar agjentivi drejt apo jo. Në kërkesën e parë 35 për qind të informatorëve të Universitetit të Prishtinës deklaruan se ishte fjali e qartë, 15 për qind thanë se ishte e paqartë, kurse 50 për qind të tyre nuk kishin dhënë asnjë shpjegim. Kjo do të thoshte se shumica e tyre nuk e kishin të qartë kuptimin e saj.

Më interesante ishte pjesa e dytë e pyetjes. Kërkuam nga ata që të thoshin nëse personi i dënuar jetonte në Francë ose jo, sipas asaj që ata kuptonin nga fjalia. Por ajo që ndodhi ishte kundërtë. Ata duket se kishin gjykuar sipas situatës nga përmbajtja logjike e fjalisë. Kështu, 50 për qind të tyre ishin përgjigjur se ai nuk jetonte në Francë, 25 për qind pohonin se jetonin atje, kurse 25 për qind të tjerë nuk ishin përgjigjur kësaj pyetjeje. Ndonëse rezultatet e dhëna këtu nuk tregojnë qartë çka kishin kuptuar në të vërtetë informatorët nga kjo fjali, kjo e dhënë tregon se është më mirë t'i shmangemi diatezës pësore në shumë raste kur folësi i anglishtes do ta përdorte atë, për t'i ikur kështu hutimit dhe dykuptimisë.

Më në fund, pasi kemi shqyrtuar të gjithë këta shembuj dhe shembuj të tjerë që s'ka nevojë të zihen nga këtu, del e qartë se ndërtimi i fjalive të shqipes në diatezën pësore sipas strukturës angleze të asaj diateze, siç veprojnë shpesh folësit e shqipes amerikane, jo vetëm që krijon hutim kuptimi, por mjaft shpesh e ndryshon edhe kuptimin e gjithë fjalisë. Ndonëse ndonjëherë, siç vumë re më sipër, arsyeja e hutimit të tillë ose e ndryshimit të kuptimit të fjalisë duket të jetë njësi leksikore, në të vërtetë ajo vetëm u ndihmon disi dallimeve strukturore që ekzistojnë midis këtyre dy gjuhëve. Arsyeja kryesore, na duket, mbetet në të dhënë se këto dy gjuhë kanë mjete të ndryshme për të ndërtuar diatezën pësore.

3. Kundrina

Kundrina në gjuhën angleze është funksioni i pozitës së tretë në fjalinë pohore me folje kalimtare.⁵¹ Kjo rregull është kështu për arsye se anglishtja udhëhiqet nga rendi i fjalëve në fjali si pasojë e mungesës së eptimit. Në të vërtetë, rendi i fjalëve është mënyrë për identifikimin e tipit të një fjalie dhe të pjesëve të saj funksionale. Pozita e tretë e fjalisë së diatezës veprorë, që ka kallëzues me folje kalimtare në anglishte, është:

(1) *John married Mary.* (Xhoni u martua me Marinë).

Në gjuhën shqipe, siç kemi thënë më sipër, rendi i fjalëve nuk është doemos të vijohet sipas ndonjë gjedheje. Megjithatë, parapëlqehet një rend fjalësh standard në një fjali normale të shkruar ose të folur me stil të bukur. Meqenëse shqipja është gjuhë flektive, domethënë ka trajta të shënuara për shumë role funksionale të fjalës në fjali (siç janë rasa, veta, numri etj.), ka mundësi që rendi i fjalëve të jetë shumë më i lirë se i anglishtes. Mirëpo, kjo nuk është çështja kryesore e këtij studimi.

⁵¹ Randolph Quirk, and Sidney Greenbaum, *A University Grammar of English*, Longman, London, 1973.

Problemi qëndron në faktin që dy folje fare ekuivalente për nga kuptimi në shqipe dhe në anglishte, nuk marrin patjetër kundrinë në të dyja gjuhët. Folja e shqipes e konsideruar ekuivalente e një foljeje të anglishtes mund të marrë, po edhe të mos marrë, kundrinë. Meqenëse paraqitet kjo dukuri, ajo mund shpjegë në interferencë kur një shqipfolës i Amerikës (sidomos i brezit të dytë) flet ose shkruan shqip. Meqë ai është folës biling, dhe gjuha mbizotëruese e tij rëndom është anglishtja, shqipja e tij del sipas kornizave strukturore të anglishtes. Një folës i tillë mund të përdorë elemente (fjalë) shqipe, por raportet e atyre fjalëve me fjalë të njëjta ose të ngjashme të anglishtes u imponohen fjalëve shqipe, ndërsa folësi nuk është në gjendje të gjykojë nëse ato i përgjigjen të njëjtit kontekst ose jo, për shkak të kompetencës së tij të dobët në gjuhën shqipe. Një folës i tillë i shqipes mund të përdorë kundrinën edhe me foljet jokalimtare të shqipes nëse foljet si të thuash ekuivalente për nga kuptimi janë kalimtare në anglishte, por jo edhe në gjuhën shqipe. Në këtë rast, replika e strukturës angleze prodhon një kuptim të padashur ose e dhunon tipin ekzistues të fjalisë duke prodhuar fjali të pakuptimtë.⁵² Një dhunim i tillë i raporteve sintaksore është ai i foljes me kundrinën. Një shembull i tillë mund të jetë folja dominoj (mbizotëroj). Fjalorët e shqipes deri tani nuk e kanë përfshirë këtë huazim, por ai ka përdorim mjaft të shpeshtë si në të folur ashtu dhe në të shkruar. Sipas kompetencës sonë gjuhësore dhe të kompetencës së informatorëve tanë të shqipes, folja dominoj në gjuhën shqipe mund të përdoret vetëm me një sintagmë parafjalore, por jo me sintagmë emërore, si f.v.:

(2) Skënderbeu *dominon* në historinë shqiptare.

Për këtë arsye fjalia e regjistruar në shqipen e Amerikës:

(3) Historinë shqiptare *e dominon* fytyra e Skënderbeut, nuk është e pranueshme në shqipen standarde. Arsye për këtë është folja *dominoj*, e cila është përdorur me sintagmë emërore si kundrinë të saj. Korrigjimi i saj mund të bëhet vetëm duke ndryshuar sintagmën emërore (kundrinën e drejtë) në sintagmë parafjalore (rrethanor), dhe të prodhohet kjo fjali:

(4) Fytyra e Skënderbeut *dominon* në historinë shqiptare, ose:

(5) Në historinë shqiptare *dominon* fytyra e Skënderbeut.

Fjalitë (4) dhe (5) kanë të njëjtën strukturë të thellë, ndërsa u ndryshon vetëm rendi i fjalëve. Ato janë shumë të ngjashme me fjalinë (2) më sipër.

Thuaja 95 për qind të informatorëve të shqipes e pranuan versionin e

⁵² U. Weinreich, 1953, p. 38.

foljes dominoj të vijuar me sintagmë parafjalore, kurse e refuzuan versionin me sintagmë emërore si kundrinë të fjalisë. Duhet të ceket se fjalia (3) më sipër, e cila ishte gjetur në të folurit shqip të Amerikës, është konstruktuar sipas modelit të anglishtes, dhe mund të pranohet vetëm në ligjërimin e shqiptarëve të atjeshëm.

Në shqipen e Amerikës dëgjohen fjali me kundrinë kognitive, kur përdoret kundrina me të njëjtin kuptim si dhe të foljes, si f.v.:

(6) Flas fjalë të këqija.

Arsyeja pse fjalia (6) ishte prodhuar në shqipen e Amerikës është se folësi nuk kishte kompetencë të plotë të shqipes, ndërsa anglishten duhet ta ketë zotëruar më mirë, prandaj e kishte marrë “ekuivalentin” e shqipes të “përkthyer” nga anglishtja.

Fjalia vijuese e hasur në shqipen e Amerikës:

(7) Ka dhuruar shkollën me 1,000 dollarë.

është një shembull tjetër i interferencës sintaksore të shkaktuar nga ndikimi i drejtpërdrejtë i anglishtes. Fjala është për përzgjedhjen e gabuar të kundrinës, në vend të kundrinës së zhdrejtë është përdorur kundrina e drejtë. Po ta testojmë “sjelljen” e foljes *dhuroj* në gjuhën shqipe, do të kemi këto rezultate:

(8) Dhuroj shkollës 1,000 dollarë: (Kf) + Fk + Kzh + Kd

(9) Dhuroj 1,000 dollarë shkollës: (Kf)⁵³ + Fk + Kd + Kzh

(10) Dhuroj shkollën me 1,000 dollarë:⁵⁴ (Kf)+Fk + Kd + Kzh

Duket se folja *dhuroj* mund të marrë të dy kundrinat, por jo në të njëjtën fjali, dhe kurrësi dy kundrina të drejta në të njëjtën fjali.

Ekuivalenti i anglishtes për fjalinë (7) duket se mund të jetë i pranueshëm për arsye të thjeshtë se folja e saj “award” (dhuroj) mund të marrë dy kundrina (të drejtë dhe të zhdrejtë). Mirëpo, për shkak të faktit se emrat e anglishtes nuk kanë shënues rase, trajtat e të dy kundrinave janë rrafshuar, prandaj nuk ka mundësi të identifikohen në strukturën e tyre sipërfaqësore, pos me rendin e fjalëve, me ç’rast kundrina e zhdrejtë shndërrohet në sintagmë parafjalore. Duke u nisur nga ky parim, ai që ka thënë këtë fjali ka provuar të bëjë rrafshimin e trajtave të dy kundrinave edhe në shqipen e Amerikës. Shqiptuesi i fjalisë (7) duket të jetë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga struktura e anglishtes dhe ai thjesht ka “përkthyer” fjalë për fjalë nga anglishtja në shqipen e Amerikës, pa qenë i

⁵³ U. Weinreich, 1953, p. 38.

⁵⁴ Në të vërtetë, kjo fjali mund të jetë e pranueshme në shqipen standarde, por me një kuptim tjetër: Dhuroj edhe shkollën edhe 1,000 dollarë (dikujt).

zoti të bëjë dallimin midis dy trajtave kundrinore të shqipes dhe kështu ka bërë zgjedhjen e gabuar të atyre trajtave kundrinore.

Këtu kemi edhe një fjali të shqipes së Amerikës me kundrinë të përdorur me folje dhe konstrukt të gabuar.

(11) Lajmëronin çdo gjë që interesonte shoqërinë.

Kjo fjali nuk është rezultat i ndikimit të drejtpërdrejtë të anglishtes, por i dobësimit të kompetencës gjuhësore në shqipe. Ndonëse folja lajmëroj është kalimtare, duket se ajo bën zgjedhjen e kundrinave, nuk mund të marrë çdo kundrinë. Gjegjesisht, ajo nuk merr kundrinë [jonjeri], siç mund të shihet nga shembujt vijues:

- (12) Ata lajmëronin shoqërinë për çdo gjë: (Kf+Fk+Kd+ Kd(SP));
- (13) Ata lajmëronin për çdo gjë shoqërinë: (Kf+Fk+Kd(SP)+ Kd);
- (14) *Ata lajmëronin çdo gjë shoqërisë: (Kf+ Fk+Kd+Kzh);
- (15) *Ata lajmëronin shoqërinë çdo gjë: (Kf+Fk+Kd+Kd);
- (16) *Ata lajmëronin çdo gjë: (Kf + Fk + Kd(+njeri));
- (17) Ata lajmëronin shoqërinë: (Kf+Fk+Kd(+njeri);
- (18) Ata lajmëronin për çdo gjë: (Kf+Fk+Kd(SP)).

Nga fjalitë (12) dhe (17) mësojmë se folja *lajmëroj* merr në të vërtetë një kundrinë (njeri) dhe kundrinë (jonjeri), pa marrë parasysh nëse kundrina (jonjeri) vijon menjëherë pas foljes (13) dhe (18), ose qëndron në largësi prej saj (12). Kjo folje e shqipes, pra, duket se mund të përzgjedhë kundrinë (jonjeri), por vetëm me kusht të veçantë që ajo të ketë strukturë të SP (12), (13) dhe (19).

Testi me informatorët e Prishtinës tregoi se 80 për qind e tyre nuk e kishte pranuar fjalinë (14), (15) dhe (16), 15 për qind prej tyre u kishin vënë atyre pikëpyetje, ndërsa të gjithë prej tyre e kishin pranuar variantin me kundrinë (jonjeri) por me strukturë të SP.

4. Fjalitë e theksuara

Fjalitë e theksuara⁵⁵ nuk janë shumë të rëndomta në shqipen standarde. Në të vërtetë, ato hasen, por vetëm mjaft rrallë. Në gjuhën angleze, nga ana tjetër, periudhat me këtë lloj fjalish janë mjaft të rëndomta kur dikush do të theksojë ose të vërë në dukje diçka të posaçme.

Mirëpo, në shqipen e Amerikës fjalitë e tilla janë mjaft të shpeshta si në gjuhën e folur, ashtu edhe në gjuhën e shkruar. E marrim me mend se denduria e përdorimit të tyre shkaktohet nga ndikimi i anglishtes.

Në fjalitë e theksuara çdo pjesë e periudhës mund të theksohet në

⁵⁵ R. Quirk and S. Greenbaum, 1973, i quajnë *cleft sentences*.

gjuhën angleze, si f.v. kryefjala, kundrina, ose rrethanori etj. Në shqipen standarde duket se kryefjala ndonjëherë mund të theksohet, ndërsa pjesët e tjera funksionale të fjalisë shumë më rrallë. Mirëpo, në shqipen e Amerikës mund të theksohet çdo pjesë e fjalisë. Këtu po japim disa shembuj ku kryefjala është theksuar:⁵⁶

- (1) *Ishin tre njerëz* që bënin ashtu.
- (2) Përpara *ishte shteti* që paguante çdo gjë.
- (3) *Ka qenë frika* që i ka mbytur të tjerët.
- (4) Mos qani, *jam unë* që po vdes.

Kundrina bukur shpesh theksohet në një fjali të tillë në shqipen e Amerikës, ndonëse kjo ndodh shumë më pak në shqipen standarde. Disa shembuj për ilustrim:

- (5) Sikur që thamë më sipër, *ish Dielli dhe Vatra* që mbollën të moshuarit.
- (6) Por *është Franca*, të cilën Presidenti Nixon u këshillua të mos e vizitojë në këtë moment.

Ndonjëherë edhe ndonjë rrethanor mund të bëhet fokus i të theksuarit në një fjali të tillë në gjuhën angleze, ndërsa shembuj të tillë paraqiten edhe në shqipen e Amerikës, si, ta zëmë:

- (7) *Ishte gjatë kësaj periudhe* që komuniteti dha kontributin më të madh.

Folësi biling i shqipes dhe i anglishtes mund të vërejë në thuaja të gjithë shembujt e mësipërm se fjalitë përkatëse të anglishtes prej nga mendohet të kenë rrjedhur këto fjali, tingëllojnë shumë më natyrshëm, sesa këto të shqipes. Këtyre të dytave u mungon diçka që ka të bëjë ose me stilin ose me kompetencën e përgjithshme të shqipes. Nuk ekziston kurrë vetëm një faktor i cili përcakton bukurinë e gjuhës, por shumë prej tyre marrin pjesë, duke përfshirë edhe fjalitë e theksuara për hir të theksimit, të përdorimit të diatezës pësore, përdorimit jo të drejtë të elementeve lidhore etj. Si rezultat i gjithmbarshëm i të gjitha këtyre përdorimeve jostandarde, folësit burimor të shqipes i duket shqipja e Amerikës si një gjuhë disi e vështirë dhe e paqartë.

5. Përdorimi i nyjave

Si anglishtja ashtu edhe shqipja kanë nyjë të shquar, të shquar dhe nyjë zero që u bashkohen ose përngjiten emrave. Nyjat e anglishtes janë analitike, prandaj edhe më të thjeshta, ndërsa nyjat e gjuhës shqipe janë sintetike dhe mjaft më të ndërliqshme. Këto të fundit dallojnë për nga

⁵⁶ Në gjuhën shqipe janë dy fjalë karakteristike që e bëjnë fjalinë të theksuar veçanërisht: fjala *pikërisht* dhe një përemër. P.sh. Fjalja (1) *Ishin pikërisht* tre njerëz *ata* që bënin ashtu; Përpara *ishte pikërisht* shteti *ai* që paguante çdo gjë.

gjinia, numri dhe rasa. Nuk do të bisedojmë për trajtat e nyjave, nga të cilat shqipja ka shumë, por vetëm për përdorimin e tyre krahasuar me anglishten.⁵⁷

Rastet kur përdoret nyja e shquar nga shqipfolësit e Amerikës, kur përdorimi i tillë nuk është i pranueshëm për shqipen standarde, do të konsiderohen si rezultat i interferencës së ushtruar nga anglishtja. Këto raste janë kryesisht strukturat e sintagmave parafjalore me parafjalët: *në, nën, nëpër*. Emri në SP të tilla nuk mund të përdoret në trajtë të shquar në gjuhën shqipe⁵⁸ përveç nëse ai emër paspërcaktohet. Mirëpo, në shqipen e Amerikës ka shumë raste të përdorimit të trajtës së shquar të emrit edhe me këto parafjalë. Kjo ndodh nga interferenca e drejtpërdrejtë nga gjuha angleze, sepse në anglishte sintagmat parafjalore rëndom shoqërohen me nyjën e shquar. Disa shembuj do të mjaftonin për të ilustruar këtë dukuri të pranishme në shqipen e Amerikës.:

- (1) *Në shtëpinë* neve më shumë shqip llafosemi.
- (2) Clyde-i nuk pësoi gjësendi *në aksidentin*.
- (3) Anija kaloi *nën urën* dhe...
- (4) Shumë njerëz kur këndojnë *nëpër gazetat* dhe *revistat* se sa sumëra të mëdha po harxhon Guverna...

Po edhe dobësimi i kompetencës gjuhësore mund të shkaktojë që të përdoren trajta të gabuara të emrave të shquar ose të pashquar nga shqipfolësit e Amerikës. Kështu, për këtë arsye, në shqipen e Amerikës shpesh ndodh të përdoren si emri ashtu dhe mbiemri (titulli, ndajshtimi) në trajtë të shquar, si në shembullin (5) më poshtë:

- (5) Në kohën e *Presidentit Eisenhowerit* Amerika...

Ndërsa sipas normës së gjuhës shqipe, vetëm emri ose vetëm mbiemri mund të përdoren në trajtë të shquar, varësisht nga konteksti.

Interferenca gramatikore në të përdorurit e nyjës paraqitet edhe lidhur me nyjën e pashquar *një* të shqipes nga ana e folësve të shqipes së Amerikës. Përdorimi i nyjës së pashquar është i domosdoshëm me emrat e përgjithshëm në gjuhën angleze, të cilët tregojnë një njësi të ndonjë gjësendi nga e tërë klasa. Mirëpo, në gjuhën shqipe nyja e pashquar *një* nuk është gjithmonë e nevojshme të paraqitet në strukturën sipërfaqësore, meqenëse shqipja ka trajtë të posaçme të emrit të pashquar dhe nyja e

⁵⁷ Vesel Nuhiu, *The Use of Articles, a contrastive analysis between English and Albanian*, Fakulteti Filozofik, **Buletini**, nr. 15, ff. 299-331, Prishtinë, 1978.

⁵⁸ Selman Riza, *Studime albanistike*, Rilindja, Prishtinë, 1979, ff. 149-220.

pashquar në atë rast thuaja se paraqitet si element redundant. Me fjalë të tjera, shqipja mund të përdorë një zero në vend të një s të pashquar. Mirëpo, në shqipen e Amerikës, për shkak të ndikimit të drejtpërdrejtë nga anglishtja, është shumë e dendur paraqitja e një s të pashquar me emrat e përgjithshëm. Ja disa shembuj:

- (6) Kisha ndërmend të mësoj të bëhem *një* avokat.
- (7) Lajmërohet se një shqiptar me *një* fytyrë të vrazhdë...
- (8) Më kanë thënë se kam *një* vesh të mirë, i dëgjoj sounds.

Nga fjalitë e mësipërme del sikur njeriu ka disa fytyra, ndërsa njëren prej tyre e paska të vrazhdë; ose (një apo) disa veshë dhe se një e paska për muzikë, e të tjerët për diç tjetër.

Bukur shpesh nyja e pashquar përdoret në ligjërimin e shqipes së Amerikës aty ku duhet të përdoret një përemër i pakufishëm. Megjithatë, mendojmë se denduria e përdorimit të një s të pashquar është shtuar nën trysinë e ndikimit nga anglishtja, meqenëse nyja e pashquar përdoret me denduri shumë të madhe në anglishte. Disa shembuj mund ta bëjnë këtë çështje më të qartë:

- (9) Nuk bënte dot *një* rojtje të mirë.
- (10) Në çdo rast që ishte *një* ndeshje futbolli...
- (11) Nga ana tjetër nuk parashihet *një* paqë miedis Rusisë dhe Kinës.
- (12) Un s'kam *një* çfaqje që e dua më shumë.

Herë pas herë, përdorimi i gabuar i një s të pashquar në ligjërimin e folësve të shqipes në Amerikë shkakton ndryshim semantik të fjalisë. Një shembull mund të ilustrojë këtë:

- (13) Turqia nuk kishte nënshkruar *një* traktat me Greqinë.

Kjo duket të ketë dalë si rezultat i ndikimit të ndonjë fjalie "ekuivalente" të anglishtes (*Turkey had not signed a treaty with Greece*). Por në shqipe nga një fjali e tillë mund të nënkuptohet sikur vetëm një traktat nuk ishte nënshkruar midis Turqisë dhe Greqisë, kurse të gjithë traktatet e tjerë ishin nënshkruar. Vetëm me mungesën e një s të pashquar këtu do të shmangej hutimi.

Është një dukuri tjetër gramatikore ose një lloj tjetër i përdorimit të gabuar të nyjave nga folësit e shqipes së Amerikës. Gjegjësisht, shqiptarët amerikanë shumë shpesh nuk i përdorin fare nyjat në strukturat ku ato janë të domosdoshme. Kjo dukuri përsëri i lihet ndikimit të anglishtes, meqë ato raste duket të jenë prodhuar për analogji me strukturat e ngjashme në atë gjuhë. Disa shembuj:

- (15) Në rast se *Shqipëtarë* nga New York dëshirojnë të marrin pjesë...
- (16) *Imigrantë* që hyjnë në SHBA duhet të prezentojnë pashaporta.
- (17) Do të dëgjoni fëmijët tonë që recitojnë në *gjuhë* shqipe.

Folësit e shqipes në Amerikë mjaft shpesh e zhdukin nyjën e shquar në emrat e ditëve të javës. Kjo, pa dyshim, është rezultat i interferencës nga anglishtja ku nuk përdoret kurrfarë nyje me emrat e ditëve. Ja disa shembuj:

(18) *Të premte, të shtunë* gjithë ditën dhe natën, *të dielë* në mëngjes...

(19) Dega e Vatrës Nr. 51 do të mbajë mbledhje *të diele* më 18 shkurt...

Por, natyrisht, ka mjaft raste kur emrat e ditëve të javës përdoren si duhet - me nyjë të shquar.

Përveç kësaj, folësit e shqipes në Amerikë shpesh kalojnë në anglishte kur duhet të zihen ngoje emrat e ditëve të javës, pra bëjnë transfer kodi.

Disa emra më pak të njohur, prandaj edhe më rrallë të përdorur, përdoren në trajtë unike - si trajta e anglishtes - pa marrë parasysh nëse ata duken të shquar apo të pashquar. Për shembull:

(20) Gjithashtu kemi rezervuar një *orquestra* për muzikë shqiptare...

Natyrisht, këtu, pos ndikimit që ushtron anglishtja me trajtat e saj uniforme, ka ndikim edhe harresa apo dobësimi i kompetencës së gjuhës shqipe.

6. Përdorimi i parafjalëve

Një lloj i veçantë i interferencës gramatikore ka të bëjë me trajtat funksionale të gjuhës. Këto trajta mund të jenë të lira dhe të varura. Parafjalët mund të konsiderohen trajta funksionale të lira të interferencës midis dy gjuhëve.

Është vështirë të tërhiqet një vijë e qartë midis ndikimit strukturor të anglishtes dhe ndikimit përmes përkthimit gjatë përdorimit të disa parafjalëve të shqipes në ligjërimin shqip të Amerikës.

Sintagma parafjalore e anglishtes me strukturë: "*for*" + *kohë*, e cila nuk është shumë e rëndomtë në gjuhën shqipe, i ka dhënë krah përdorimit bukur të shpeshtë të SP shqipe në shqipen e Amerikës me strukturë: *për* + *kohë*. Për shembull:

(1) Fjalimet vazhduan *për gjashtë orë*.

(2) Lufta mund të zgjatet *për shumë kohë*.

(3) Ky qe aktiv *për 50 vjet*.

Për të shprehur kuptimin që kishin për qëllim këto fjali, ato do të duhej të përdreshin pa parafjalën *për*. Kjo parafjalë ka kuptim funksional krejt tjetër në shqipen standarde, siç mund të shihet nga shembujt më poshtë:

(4) Erdha *për dy orë*.

(5) E korra grurin për një javë.

Cili është dallimi? Në gjuhën angleze struktura e SP: “for” + kohë përshkruan ose shpreh proces apo vazhdimësi të veprimit, dhe duket se ai proces është më i rëndësishëm, sesa vetë rezultati. Në fjalinë angleze:

(6) I read the book *for three hours*. (Lexova tri orë librin),

nuk del e qartë nëse lexuesi e ka kryer së lexuari librin ose jo, sepse duket se as që është me rëndësi ai fakt, por më me rëndësi është sa kohë ka lexuar ai person. Pra, në gjuhën shqipe struktura: *për + kohë* shpreh rezultatin e kryerjes së një veprimi, pra, sa kohë ka shpenzuar derisa është kryer përfundimisht ai veprim.

Është edhe një situatë tjetër kur folësi i gjuhës letrare do ta përdorte SP me strukturë: *për + SE (kohë)*, ndërsa shqipfolësi i Amerikës do ta përdorte SP me strukturë: *në + SE (kohë)*, natyrisht nën ndikimin e anglishtes. Kjo është e qartë në këta shembuj:

(7) *Në dy muaj* i bënë pesë anëtarë.

(8) Këtë largësi e kaloi *në tri ditë*.

Folësi i shqipes standarde do të thoshte: *për dy muaj; për tri ditë*, respektivisht.

Sintagma parafjalore me strukturë: *me + SE (kohë)* është zëvendësuar ndonjëherë me SP me strukturën: *në + SE (kohë)* në shqipen e Amerikës, si b.f.:

(9) *Në një fjalë*, ai vete në shkollë për...

Pra, shqip do të ishte e drejtë të thuhej: *me një fjalë*... Këtë e ka shkaktuar ndikimi i drejtpërdrejtë i anglishtes, me përdorim të strukturës angleze *fjalë për fjalë*.

Kur të krahasohen këto dy gjuhë, shihet qartë se anglishtja ka shumë më tepër parafjalë se shqipja. Nga pikëvështrimi krahasues, del se përdorimi i parafjalëve u krijon vështirësi të mëdha folësve të shqipes që mësojnë anglisht. Kjo rrjedh nga shkaku se para atyre folësve paraqitet disjunkcioni logjik i inkluzionit. Prandaj, me anë të këtij studimi është konstatuar se dallimet që ekzistojnë midis parafjalëve të këtyre dy gjuhëve e hutojnë folësin e shqipes në Amerikë. Kjo huti shtohet duke u dobësuar kompetenca e tyre gjuhësore për shqipen. Dhe atyre nuk u mbetet rrugë tjetër për të zotëruar përdorimin e parafjalëve, si edhe të pjesëve të tjera funksionale të gjuhës, pos përmes krahasimit të tyre me ato të anglishtes, e pikërisht kjo rrugë shpie në gabim. Mundësia për të gabuar është edhe fakti se parafjalë të ndryshme kanë ndonjëherë përdorim të njëjtë në të dyja gjuhët, mirëpo, jo edhe në të gjitha rastet, duke dhënë ndonjëherë kuptim të ngjashëm e

ndonjëherë të ndryshëm në këto dy gjuhë në kontakt. Kur dihet se anglishtja ushtron ndikim të vazhdueshëm mbi shqipen e Amerikës, nuk mund të pritet tjetër, pos të gabohet në përdorimin e parafjalëve. Fundja, ata që mësojnë gjuhët e huaja dinë nga përvoja se përvetësimi i drejtë i parafjalëve në gjuhën tjetër është një ndër barrierat e fundit.

7. Përdorimi i plotësorit kundrinor

Nga shumë gjedhe sintaksore tipike të gjuhës angleze është edhe struktura: Kf + Fk + Kd + Pk (plotës kundrinor).⁵⁹ Folja “find” (gjej) është njëra nga grupi i foljeve që përputhen në këtë strukturë sintaksore. Në gjuhën shqipe, megjithatë, ekuivalenti i përkthyer nuk i përgjigjet plotësisht asaj folje në atë kontekst. Mirëpo, në ligjërimin shqip të Amerikës ajo strukturë sintaksore me foljen gjej, haset bukur shpesh. Më poshtë ofrojmë disa shembuj siç i kemi hasur në materialin tonë nga ai ligjërim:

- (1) Libri *u gjet* interesant...
- (2) U këndua Roll-Call-i dhe *u gjetën* të gjithë delegatët në mbledhje.
- (3) Ju falem nderit për letrën tuaj që më dërguat, të cilën *e gjeta* shumë interesante.

Këtu mund të pohojë dikush se është fjala për kalk. Kjo mund të jetë e vërtetë. Por ‘fajin’, si të thuash, e ka vetë folja, e cila në anglishte është polisemike, me kuptimet: gjej, konstatoj dhe më duket. Mirëpo, ky kalk shkakton që e gjithë fjalia e shqipes të organizohet në përputhje me gjedhen e anglishtes. Në të vërtetë, folja gjej edhe në shqipen standarde mund të përdoret (rrallë) me kuptimet polisemike të dhëna më sipër. Për shembull:

- (4) E *gjetëm* të udhës që të vepronim kështu.
- (5) Na *u duk* e udhës që të vepronim kështu.
- (6) E *konstatuam* të arsyeshme që të vepronim kështu.

8. Përdorimi i mënyrës dëshirore

Anglishtja nuk ka forma eptimore që i përgjigjen mënyrës dëshirore ashtu siç ekziston ajo në sistemin foljor të gjuhës shqipe. Në të vërtetë, ajo mund të shprehë një nocion dëshiroreje me mjete të posaçme gjuhësore, siç do të shohim më poshtë, kur të përkthehen fjalitë e shqipes, por megjithatë ajo nuk është gjë tipike e anglishtes dhe haset me denduri shumë të vogël në këtë gjuhë dhënëse. Meqenëse shqiptarët e Amerikës janë vazhdimisht nën trysninë linguistike të anglishtes, denduria e përdorimit të mënyrës dëshirore në ligjërimin e tyre ka rënë bukur shumë ulët. Krahasimi midis

⁵⁹ R. Quirk and S. Greenbaum, 1973.

gjuhës së tyre të shkruar më herët dhe të asaj të shkruar më vonë, dëshmon se dëshirorja paraqitet më shpesh në gjuhën e tyre të mëhershme, kurse bukur rrallë në gjuhën e tyre të periudhës së mëvonshme. Sot njeriu rrallë mund të dëgjojë folësit e vjetër të shqipes së Amerikës të përdorin mënyrën dëshirore kur i dëshiron dikujt diçka. Ndërkohë që shumë shpesh dëgjohet nga shqipfolësit e rinj atje të përdoret mënyra lidhore në vend të mënyrës dëshirore, madje edhe mënyra urdhërore me modalitet të mënyrës dëshirore, sidomos për veten e tretë të foljes. Arsye për këtë mund të jetë se mënyra lidhore (madje edhe urdhërorja) janë shumë më të afërta dhe të ngjashme me mënyrën lidhore (subjunctive mood) të anglishtes, e cila përdoret për të shprehur atë që në shqipen standarde shprehet me mënyrën dëshirore. Këtu janë disa shembuj të marrë nga ligjërimi i shqipes në Amerikë për të parë si është shprehur mënyra dëshirore:

- (1) *Të trashëgohen dhe të kenë* dasmë të shpejtë!
- (2) *Të jetë* me jetë të gjatë dhe të lumtur!
- (3) *Të rrinë* gëzuar me plot shëndet!

Foljet e sipërshënuara në mënyrën dëshirore do të ishin: *u trashëgofshin; paçin; qoftë; mbetshin*. Mirëpo, duhet vënë në dukje se mënyra e tillë e shprehjes së dëshirores është dhe paksa tipike për të folmet prej nga e kanë prejardhjen folësit objekt të këtij studimi.

9. Përdorimi i mënyrës habitore

Mënyra habitore është një tjetër tipar i sistemit foljor të gjuhës shqipe, e cila përdoret jo edhe aq rrallë. Me të shprehet një befasi, një habi, me mjete të posaçme gjuhësore, pra, me trajta të posaçme, me mënyrën habitore. Mirëpo, në gjuhën angleze ky tipar gjuhësor thuaja nuk ekziston, prandaj kjo mënyrë e foljes paraqitet shumë rrallë ose thuaja nuk ekziston në ligjërimin shqip të shqiptarëve të Amerikës. Këtu, pra, kemi të bëjmë me procesin e rrafshimit midis anglishtes dhe shqipes, duke dhënë si rezultat zhdukjen e një kategorie sintaksore të shqipes së Amerikës.

10. Trajta alternative: po ose jo

Konstruksioni i anglishtes “*whether or not*” nuk përdoret me të njëjtin rend fjalësh në shqipen standarde. Mirëpo, në ligjërimin e folësve të shqipes në Amerikë prodhohet ky konstruksion me fjalët shqipe, por sipas rendit të fjalëve të anglishtes. Këtu kemi dy shembuj të nxjerrë nga korpusi për të ilustruar këtë dukuri:

- (1) Çdo ndenjës i Shteteve të Bashkuara *është ose jo* citizen, e zë nomi të paguajë tax.
- (2) Komisioni do të ketë të drejtën që të vendosë *për të bërë ose jo* shërbime.

Trajtat e shqipes standarde do të ishin: *qoftë qytetar ose jo; për të bërë shërbime ose jo* (ose: *për të bërë ose për të mos bërë shërbime*).

Nga kjo pason se konstruksioni i tillë i ligjërimit shqip të Amerikës është pasojë e interferencës së drejtpërdrejtë të raportit sintaksor nga anglishtja.

11. Zhdukja e fjalëve funksionale

Folësit e dialektit të cilit i përkasin informatorët tanë të shqipes së Amerikës tentojnë të zhdukin disa nyja dhe fjalë të ngjashme funksionale në kontekste të posaçme.⁶⁰ Mirëpo, pos kësaj kemi hasur edhe në shembuj të zhdukjes që janë shkaktuar nën ndikimin e sintagmave dhe fjalive të anglishtes.

Mbiemrat në gjuhën angleze nuk kanë nyja, prandaj ata nganjëherë i zhdukin nyjat edhe në gjuhën shqipe të Amerikës, si rezultat i interferencës gjuhësore nga anglishtja. Ja disa shembuj:

- (1) Tabaku turçe është shumë *ø famshme* në botë, apo jo?
- (2) Një xhaxha *ø vjetër* punon në...
- (3) Çupat janë më *ø fortë*.

Duhet theksuar se zhdukja e nyjave të mbiemrave bëhet posaçërisht nga folësit e shqipes që i përkasin brezit të dytë të shqiptarëve të Amerikës, shqipja e të cilëve është bukur e dobët.

Ndonjëherë zhduket ndonjë lidhëse. Kjo shkon sipas gjedhes së anglishtes, e cila e zhduk lidhësen “that”, kur ajo nuk ka ndonjë funksion sintaksor në fjalinë e nënrenditur. Kështu në shembullin e mëposhtëm, shohim se zhdukja e lidhëses *se* në shqipen e Amerikës, natyrisht nën ndikimin e anglishtes, ka shkaktuar që fjalia të jetë mjaft e gjymtë:

- (4) Ky raporter mori mundimin të bëjë disa investigata më parë (*ø*) të nxinjë kartën.

12. Mohimi

Ndonjëherë disa raporte gramatikore që ekzistojnë në gjuhën dhënëse, i nxjerrin në sipërfaqe disa që mezi ekzistojnë në gjuhën marrëse. Në disa raste është punë bukur e vështirë për gjuhëtarin të provojë nëse kjo është rezultat i interferencës gjuhësore. I vetmi tregues i vlefshëm në këso rastesh është denduria e përdorimit të tyre, e cila shtohet nën ndikimin e gjuhës dhënëse.⁶¹

⁶⁰ Jorgji Gjinar, *Mbi të folmen e Devollit*, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Seria Shkencore Shoqërore, Nr. 4, ff. 103-137, Tiranë, 1960.

⁶¹ U. Weinreich, 1953, ff. 33-35.

Në gjuhën angleze kërkohet vetëm një element mohues për të mohuar diçka në fjali. Ky element mohues mund të gjendet ose në vetë foljen, ose mund të jepet me ndonjë ndajfoljor mohor, por vetëm njëri prej tyre dhe vetëm një herë në fjali. P.sh.:

- (1) a) I have *not* said anything to anybody.
- b) I have spoken to *nobody* about her.
- c) I have spoken to *no* one about her.
- d) I have said *nothing* to anyone.
- (2) a) John is *not* anywhere here.
- b) John is *nowhere* here.

Mirëpo, sa i përket shqipes, çështja e mohimit ndryshon. Një fjali e shqipes kërkon dy mohime, ose mohim të dyfishtë. Kjo bëhet duke mohuar në vetë foljen dhe pos kësaj përdoret edhe ndonjë ndajfolje mohuese, nëse ka diçka të tillë. Për shembull:

- (3) Unë *kurrë s'*kam thënë *asgjë* të keqe.
- (4) Agimi *nuk* gjendet *asnjëherë* këtu.

Sipas kësaj, nuk duhet të befasohet njeriu kur të hasë fjali vetëm me një element mohues në shqipen e Amerikës, e cila rrjedh nga ndikimi i anglishtes, si f.v.:

- (5) Besohet se *as* Amerika *as* Rusia \emptyset të kenë gisht në këtë situatë.
- (6) *Asnjëri* prej tyre \emptyset bëri ndonjë histori.
- (7) *Asnjë* statujë \emptyset Ju është ngritur.
- (8) *As* Noli *as* ky raporter \emptyset besonin që miqësia shqiptaro-kineze do të vazhdojë.
- (9) *Kurrë* ndonjëherë \emptyset janë parë aq shqiptarë të ulur në një sofër.

Në testin me studentët e Prishtinës, asnjëra nga këto fjali prej (5) deri në (9) nuk ishte pranuar si e drejtë.

Një gjedhe e përforcuar në gjuhën angleze është që trajta mohore e foljes të vendoset në fillim të fjalisë, kur njeriu nuk pajtohet me një fakt ose me atë që ka thënë dikush. Kjo vlen sidomos në periudhat me fjali të nënrenditura që kanë fjali të nënrenditur lidhore me funksion të kundrinës, ose me funksion të fjalisë mbiemërore përcaktuese etj. Për shembull:

- (10) I *don't think* you are right.

Përdorimi më i rëndomtë i fjalisë ekuivalente në trajtë mohore të kësaj në gjuhën shqipe do të ishte:

- (11) Mendoj se *nuk e keni* mirë.

Mohimi, pra, është bërë në fjalinë e dytë (të nënrenditur) e jo në fjalinë kryesore, siç ishte rasti me anglishten. Kjo nuk e mohon faktin se ka

mundësi të përdoret edhe gjedhja e mohimit në foljen e fjalisë kryesore (të parë), por na duket se gjedhja e fjalisë (11) është më e rëndomtë për shqipen standarde, nëse nuk theksohet ndonjë pjesë e fjalisë në mënyrë të posaçme. Duket të jetë gjë më normale të tregojmë qëndrimin (mendimin) tonë pozitiv sesa qëndrimin negativ mbi një çështje, në kushte normale, pa nevojë për të theksuar ndonjë anë apo pjesë afektive të fjalisë. Mirëpo, gjedhja e anglishtes (10) paraqitet shumë më shpesh sesa gjedhja e shqipes (11), si për shembull:

(12) *Nuk jam* i bindur se shumë nga këto rrethana vetë ata i krijuan.

Ndonëse mund të gjenden trajta mohuese të ngjashme me atë të shqipes së Amerikës (12) edhe në gjuhën shqipe standarde, kjo ndodh rëndom kur nevojite të bëhet një kontrast që në fillim të fjalisë ose të thënies, duke shprehur një mendim apo (qëndrim, shpresë, besim) mohues mbi çështjen në fjalë, si b.f.:

(13) *Nuk dimë* se a kanë shkuar apo jo.

(14) *S'e besoj* që ai vetë i bëri të gjitha këto.

Fjalja (12) do të tingëllonte shumë më shqip sikur të kishte këtë trajtë:

(12a) Jam i bindur se shumë nga këto rrethana *nuk i krijuan* ata vetë.

Në mbështetje të kësaj, përkundër faktit se gjedhe të tilla mund të hasen në shqipen standarde, por më rrallë se në gjuhën angleze, interferenca e anglishtes ka shtuar dendurinë e përdorimit të kësaj gjedheje të mohimit në shqipen e Amerikës. Duket se ndonjëherë kjo mënyrë e prodhimit të fjalive mohore mund të shpjerë në prodhimin e fjalive të gabuara në ligjërimin shqip të Amerikës.

*

Filologji, nr. 4, ff. 83-104, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 1997.

(Versioni në anglishte botuar: *Recherches Albanologique*, nr. 2, ff. 95-119, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1980.)

DREJTSHKRIMI I HUAZIMEVE ANGLEZE NË SHQIPEN E AMERIKËS

Kur folësi dygjuhor i Amerikës ballafaqohet me problemin e të shkruarit në anglishte, ai ka zgjedhje të gjerë. Ai mund t'i shkruajë huazimet ashtu siç shkruhen në anglishte, ashtu siç i shqipton, si dhe në të gjitha varietetet e mundshme në mes këtyre dy mundësive të skajshme. Kështu vepron edhe ata që shkruajnë shqip në Amerikë. Spektri i mundësive të cekura më sipër është shumë i gjerë, meqenëse shqipfolësi i Amerikës mund të përdorë të gjitha mjetet dhe mënyrat drejtshkrimore që i ka në dispozicion si në anglishte ashtu edhe në shqipe.⁶²

Sintagmat që përdorin folësit për t'i veçuar disa mënyra të të shprehurit në anglishte janë të krahasueshme - sipas fjalëve të Haugenit⁶³ - me thonjëza të përdorura në të shkruarit.

Folësit e vetëdijshëm ndonjëherë mund të përdorin ndonjë mjet fonetik me një hezitim të vogël ose me pushim të shkurtër para fjalës. Kjo është aq më e rëndomtë para transferit të kodit.

Çdo shprehje e anglishtes që kanë në dispozicion emigrantët shqiptarë, sidomos gazetarët, redaktorët, shkrimtarët etj., ka paraqitur problem drejtshkrimor deri në një shkallë. Në shumë raste këto fjalë shënohen si truptha të huaj. Në shkrim ato vihen në thonjëza, në kllapa, midis vijëzave, e shënohen me shkronja të mëdha etj.

Viza qëndron në vend të hezitimit momental, e vijuar me fjalë të vetme në anglishte.⁶⁴

Kllapat duket se paraqesin një mendim të mëvonshëm për të dhënë të kuptohet se fjala angleze është më e saktë se ekuivalenti i saj në gjuhën shqipe. Në shumë shembuj fjalët shqipe dhe angleze përdoren në të njëjtin

⁶² M. I. Surducky, *English Loanwords in Serbo-Croatian Immigrant Press*. The Canadian Journal of Linguistics, Vol. 12;1, Toronto, 1966; *English Loanwords in Serbo-Croatian Immigrant Press*, The Canadian Journal of Linguistics, Vol. 12,1, ff. 123-135, Toronto, 1967.

⁶³ E. Haugen, 1953, p. 65.

⁶⁴ E. Haugen, 1953, *Po aty*.

shkrim apo artikull gjë që tregon mungesë të konsistencës.

Për t'ua bërë të njohura huazimet e anglishtes folësve shqiptarë të Amerikës, redaktorët, gazetarët dhe shkrimtarët në SHBA kanë provuar mënyra e mjete të ndryshme.

Përveç tendencës shumë të përgjithshme për t'i ripërsëhkruar (bukur shpesh të shkruara gabimisht) fjalët që pasqyrojnë shqiptimin e shqipes, po ata që përdorin huazime të anglishtes u kanë dhënë edhe prapashtesa eptimore, duke i futur shumë fjalë në kontekst të shqipes. Për shembull: *selectmen-it, Detroit-it, New York-un* etj.

Ndonjëherë, po për këtë arsye, emrave të anglishtes u jepet gjinia gramatikore, p.sh.: *boss-i, boss-ja* etj.

Shumësi e mjeteve të drejtshkrimit ekziston për shkrimin e huazimeve në shqipen e Amerikës. Për këtë arsye është shumë vështirë të arrihet në sistemin e kriterëve të qarta për përcaktimin e shkallës së përshtatjes grafemike të huazimeve angleze në shqipen e Amerikës. Sipas korpusit tonë, duket se ka shumë rregulla që veprojnë në shumicën e rasteve që kanë të bëjnë me drejtshkrimin.

Në përgjithësi, e pranojmë konkluzionin e Surdukit⁶⁵ që huazimi që përmban më shumë shkronja ose kombinime shkronjash dhe në bazë të kësaj, më pak shkronja ose kombinim shkronjash tipike për anglishten janë për nga shkrimi më të përshtatura sesa huazimet që kanë më pak shkronja të shqipes, sesa të anglishtes. Për shembull, *attempt* është më e përshtatur se *attempt, aventura* është më e përshtatur se *adventure*, ndonëse shikuar grafikisht vetëm dy pika janë vënë mbi shkronjën e fundit, por ato dy pika kanë vlerë fonematike në shqipen.

Nëse huazimet që përdoren në shqipen e Amerikës shkruhen si në anglishte, ato konsiderohen nga aspekti shkrimor plotësisht të papërshtatura, ndërsa huazimet e shënuara me alfabet të shqipes sipas shqiptimit të tyre, konsiderohen me grafema plotësisht të përshtatura ndaj gjuhës marrëse, si b.f. *axhensi, buxhet, kesh, elevatë* etj.

Si anglishtja ashtu edhe shqipja e përdorin të njëjtin alfabet – latinishten. Për shkak të kësaj ngjashmërie grafemike është e pamundshme të thuhet me saktësi nëse fare është paraqitur një zëvendësim grafemik në di-sa huazime që shkruhen njësoj në të dyja gjuhët. T'i zëmë ngoje vetëm di-sa shembuj nga shumë syresh: *bankrupt, report, gallon, slogan, petrol, telestar, marshall, unit* etj. Prandaj, identifikimi i përshtatjes ose mostërshtatjes

⁶⁵ M. I. Surduky, 1966, f. 124.

së tyre mund të bëhet vetëm kur këto fjalë të dëgjohen në gjuhën e folur.

Huazimi i përshtatur në mënyrë morfematike është më i përshtatur në mënyrë grafemike sesa huazimi i cili është i papërshtatur sa u përket morfemave, nëse të gjitha gjërat e tjera janë të njëjta, për shembull: *agjendë* është më e përshtatur sesa *agend*; *checket* është më e përshtatur se sa *checks* etj.

Surducki ka të drejtë kur thotë se huazimet e shkruara me më pak shenja drejtshkrimore të posaçme, janë më shumë të përshtatura nga ana grafemike, sesa huazimet e shkruara me më shumë shenja të posaçme, me të cilat shënohen tiparet e tyre të huaja.⁶⁶ Në mbështetje të këtij pohimi, qoftë *Business* ose “business” ose -business-, janë më pak të përshtatura sesa *business*.⁶⁷

Këtu ballafaqohemi me një problem shumë interesant por edhe të vështirë. Tani është çështja si të caktohet sasia e përshtatjes kur të krahasohen huazimet me shenja të posaçëm, por të ndryshëm të përshtatjes, për shembull, huazimi i përdorur në thonjëza “business”; huazimi me shkronjë të madhe *Business*, huazimi i përdorur në kllapa (lump sum), ose huazimi i përdorur midis vizash –car, dare- etj.

Nëse marrim parasysh dendurinë e paraqitjes së huazimeve me shenja të ndryshme në gjuhën shqipe të shkruar në Amerikë dhe e konsiderojmë këtë të dhënë si çështje të rëndësishme për shkallën e përshtatjes, mund të konstatojmë se huazimet e shënuara me shkronjë të madhe vijnë në vend të parë, huazimet me thonjëza në vend të dytë, ndërsa huazimet në kllapa ose me vijëz ndarëse, vijnë në vendin e fundit.

Sipas Surduckit,⁶⁸ përsëri, huazimi i paraprirë ose i vijuar nga modeli përkatës i anglishtes ose nga përkthimi i tij në gjuhën marrëse, është më pak i përshtatur nga ana grafemike, sesa huazimi pa asnjë

⁶⁶ M. I. Surducky, 1966, *Po aty*.

⁶⁷ Megjithatë, mund të pohohet se huazimet që shënohen me më shumë shenja janë më shumë “të përshtatura”, sepse autori është i vetëdijshëm se ato fjalë janë të huaja dhe i shënon me shenja ortografike për ta shënuar origjinën e tyre, ndërsa në huazime të papërshtatura nuk bëhet asnjë përpjekje për përshtatjen grafemike të tyre. Mirëpo, duket absurde të mendohet se huazimet e pashënuara kanë kaluar nëpër të gjitha fazat e përshtatjes grafemike (me thonjëza, shkronja të mëdha, etj.) dhe janë kthyer edhe një herë në fazën e parë. Gjuhësia, me sa dimë, nuk tregon asnjë shembull të tillë. Kur konsiderojmë se ka huazime që përdoren me shenja të dyfishta, si f.v., me kllapa dhe thonjza, me thonjza dhe shkronja të mëdha, etj., është e qartë se fjalët e tilla nuk mund të konsiderohen të jenë më të përshtatura se ato të shënuarat vetëm me një lloj mjetei për t’u dalluar.

⁶⁸ M. I. Surducky, 1966, *Po aty*.

koment, p.sh., *laisenc* (licencë), ose *societa* (shoqëria) etj.

Duket haptas se huazimet e shkruara në kllapa dhe në thonjëza, ose me vijëza ndarëse dhe thonjëza, ose me vijëza ndarëse dhe shkronja të mëdha, janë më pak të përshtatura se ato që përdoren vetëm me njërën nga këto mjete shënjuese. Prandaj mund të përfundojmë se:

- "*care fare*" - është më pak i përshtatur se "*car fare*", ose *-car fare-*, ose *Car Fare* etj.

Mund të shtrohet këtu pyetja pse folësit dygjuhorë përdorin këto shenja të posaçme. Duket se ata i përdorin për të treguar se fjala është e huaj, për t'i dalluar nga fjalët e tjera të cilat janë të padyshimta. Madje, thuaja të gjithë autorët që kanë pasur të bënin me kontaktin gjuhësor, sidomos në SHBA, kanë vërejtur se bilingët tregojnë një tendencë të dukshme për t'i shënuar huazimet si elemente të huaja, me intonacion të posaçëm ose me modifikim në të folur, ndërsa me shenja të posaçme në të shkruar.

Në mbështetje të materialit tonë të kufizuar, kemi nxjerrë këto përfundime që kanë të bëjnë me mënyrat e ndryshme të përdorimit të huazimeve angleze të shkruara në shtypin shqip në Amerikë dhe në vepra të tjera të botuara në SHBA. Do të analizojmë veçmas çdo tip të dukurisë drejtshkrimore.

1. Elementi shqip + elementi anglisht në kllapa: shq + (A). - Në këto rrethana, një fjalë shqipe i paraprin një fjale angleze, por sigurisht folësi ose ai që shkruan nuk është i sigurt nëse lexuesi e ka të qartë, prandaj ai shkruan fjalën angleze në kllapa për t'u siguruar që lexuesi ta kuptojë atë që ai thotë ose shkruan. Kemi gjetur shumë shembuj me këtë gjedhe: kutia (box), myshteri (customer), (libër) i lidhur (paperback) etj.

2. Elementi anglisht në kllapa, pa ndonjë ekuivalent të shqipes: (A) + Ø. - Fjala angleze, pra, qëndron në kllapa, pa asnjë shpjegim në shqipe, ose pa farë shpjegimi tjetër. Autori duket se është i vetëdijshëm për faktin se ai element gjuhësor është i huaj, por me gjasë duke mos ditur asnjë ekuivalent të tij në gjuhën shqipe, ai vetëm e shkruan dhe sikur e fsheh pak nga lexuesi. Ai thjesht e mbyll fjalën në kllapa sikur të kishte dhënë një ekuivalent të shqipes. Ka shumë shembuj të këtillë, por ja ndonjë sish:

(1) ... dhanë në hollin e kishës një (*Cake Sale*).

(2) ... më 29 shkurt 1920 (*Leap Year*).

3. Përshkrimi në gjuhën shqipe + anglisht në kllapa: Sh...(A). - Emigrantët shqiptarë ndonjëherë, duke mos ditur fjalën ose shprehjen e saktë për një gjësend ose mendim, e përshkruajnë atë me shumë fjalë dhe në fund ofrojnë një ekuivalent në anglishte (nëse ai është vërtet farë ekuivalenti) në kllapa, si zgjidhje të fundit. Për shembull:

- (1) ...kur ai ha bukë ose pi *sodë me të cilën mbrujmë bukët (baking soda)*.
- (2) Imitacioni po qe se është *një formë ose trajtë krenarie (flattery)*.
- (3) Fotografitë janë *bardhë-zi ose me bojë (in colour)*.

Autorit të fjalive të tilla i duket se fjala në kllapa mund të jetë më e njohur se ajo që ka thënë (shkruar) në shqipe.

4. Fjala shqip në thonjëza + fjala angleze në kllapa: “Sh” + (A). - Ndonjëherë, pos që shkruhet ekuivalenti anglisht i fjalës shqipe në kllapa, edhe fjala shqipe vihet në thonjëza. Kjo tregon se ai që përdor këto mjete të shkrimit (grafike) për një fjalë ose shprehje të tillë shpreh dyshim për përdorimin e drejtë të saj, prandaj i dyfishon përpjekjet për të dalluar dhe bërë të qartë atë fjalë apo shprehje. Duke dhënë fjalën ose shprehjen e shqipes në thonjëza, ai tregon se ajo fjalë për të nuk është shumë e njohur dhe ai ende mbetet i pasigurt nëse e ka qartësuar sa duhet. Për ta sqaruar më tutje kuptimin e saj, ai shkruan një ekuivalent në anglishte në kllapa. Në të vërtetë, mund të merret me mend se ajo që ai ka pasur në fillim në mendje është pikërisht fjala ose shprehja në anglishte e jo ajo e shqipes. Por duke qenë i vetëdijshëm se është duke shkruar në gjuhën shqipe, apo thënë më mirë, në shqipen e Amerikës, ai provon të prodhojë një fjalë apo një shprehje të shqipes, pa dyshim, duke përkthyer, por ende me një dyshim për saktësinë e përkthimit. Ja disa shembuj:

- (1) Disa mejtojnë se *Lufta e ftohtë (Cold war)* ka bërë aq shumë ndryshime.
- (2) Shoqëria studente prezenton...”*Valle Karnivale*” (*Costume Ball*).

5. Fjalët angleze pa ndonjë ekuivalent të shqipes: A + Ø. - Disa fjalë të anglishtes përdoren në trajtë shkrimi të anglishtes dhe nuk u shtohet asgjë për t’i shpjeguar. Kjo tregon se fjalët e tilla të anglishtes atij që i përdor i janë bërë shumë të rëndomta, kështu që ai nuk vëren asnjë dallim në mes të tyre dhe fjalëve shqipe, përkundër faktit se shkrimi i tyre nuk përputhet me rregullat e drejtshkrimit të shqipes. Na duket se ky lloj huazimi është përshtatur më shumë se të tjerët që janë shënuar në ndonjë mënyrë si të huaja. Fjalët e tilla, me gjasë, vijnë në vend të tretë për nga përshtatja ndaj shqipes, pas atyre që përshtaten në drejtshkrim dhe hibrideve. Të shohim disa shembuj:

- (1) Shumica e njerëzve janë *average*,...
- (2) Grekët i thyen Italianët vetëm me *bayonet attack*!
- (3) Kjo kryevepër është lidhur në formë *brochure*.

6. Fjalët angleze + ekuivalentët e shqipes në kllapa: A + (Sh). - Bukur shpesh fjalët ose shprehjet e anglishtes përdoren së pari dhe pastaj jepen fjalët (ekuivalentët) e shqipes ose përkthimi i tyre dhe ai në kllapa.

Ajo që shumë shpesh ndodh në raste të tilla është se në shumicën e rasteve ekuivalentët e shqipes të zgjedhura nuk janë të sakta, zakonisht janë të gabuara, si, f.v.:

- (1) Emërimi i Guvernarit të Michigan-it si *Attorney General* (Ministër i Drejtësisë) i SHBA...
- (2) ...të cilët kishin frikë nga *black mail-i* (dorë e zezë).
- (3) E vetmja hospitalitet që iu bë Z-it N.J. ishin dy javë *board* (ushqim) në hotelin Skënderbe.

E dhëna se emigrantët shqiptarë në Amerikë nuk përdorin fjalë të sakta kur shprehen në shqipen e tyre tregon se gjuha e tyre e parë është dobësuar në shkallë të lartë. Ata mund të përdorin ndonjë fjalor, por fjalorët zakonisht japin disa fjalë sinonime për një njësi të fjalësit të gjuhës tjetër, varësisht nga situata në të cilën përdoret fjala. Po që se kompetenca gjuhësore e dikujt është dobësuar, vështirë është të vendoset se cila nga shumë zgjidhjet e offruara është e saktë.

7. Fjalët angleze në thonjëza, pa asnjë ekuivalent në shqip: “A” + Ø. - Mjaft shpesh ndodh të shkruhen fjalët angleze në thonjëza në shtypin e shqiptarëve të Amerikës. Fjala angleze thjesht identifikohet si e tillë duke e vënë në thonjëza e ndonjëherë e shkruar me shkronjë të madhe, por asgjë nuk është bërë për ta shpjeguar kuptimin e saj në gjuhën shqipe ose për ta identifikuar me ndonjë ekuivalent tjetër. Kjo tregon se ai që përdor një fjalë të tillë është i vetëdijshëm se ajo është e huaj, por për arsye të panjohura për ne, asgjë tjetër nuk bëhet për t’ia bërë lexuesit më të njohur ose më të kuptueshme. Edhe kjo e dhënë tregon se ai që e përdor (shkruan) e konsideron si fjalë të njohur fare mirë, por që nuk është shqipe. Këtu janë disa shembuj të përdorimeve të tilla:

- (1) ...me instrumente muzikore si violina dhe “*accordions*”.
- (2) Kur shkoi e përcolla gjer në “*Bus Station*”.
- (3) “*Commandos*” komunistë kishin marrë urdhër të demonstrojnë.

8. Fjalët angleze në thonjëza të lidhura me lidhësen ose me ekuivalentin e shqipes: “A” ose Sh. - Bukur shpesh fjalët angleze vihen në thonjëza, kurse u shtohet një ekuivalent i shqipes i lidhur me fjalën ose. Meqenëse lidhori ose shënon zgjedhje alternative midis dy mundësive, mund të merret me mend se fjala angleze për atë që e përdor në këtë rast ka po atë vlerë si edhe fjala shqipe. Prandaj ajo vihet në vend të parë. Disa shembuj mund ta sqarojnë këtë:

- (1) Nuk u përgjegjën fare për “*Bill*” ose *ftesë kërkesë* që u dërguam.
- (2) Në këtë vit ai mori Bachelor of Arts “*Cum Laude*” ose *me lavdërim*.

9. Fjala shqipe vijon me fjalë angleze midis vijëzave ndarëse: Sh + -A-. - Një mundësi tjetër, pra, është kur fjala angleze përdoret midis vijëzave ndarëse. Ajo zakonisht shkruhet pas fjalës shqipe e cila duket se

është ekuivalente e saj. Është vështirë të thuhet nëse ka dallim në shkallë të përshtatjes midis fjalës angleze të vënë midis vijëzave ndarëse dhe të fjalës së vënë në kllapa. Që të dyja shënohen si të huaja. Ja disa shembuj për ilustrim:

- (1) Rreziku sot është mbrojtja e anarkisë - *The Anarchy advocacy* -
- (2) Çdo qytet ish një shtet në vete - *City State - dhe...*
- (3) Shpesh shumica e letrave për gazetat shkruhen prej njerëzve të çmendur - *cranks* -...

Siç mund të shihet lehtë nga të gjithë këta shembuj, ai që përdor shkrim të tillë nuk është i sigurt në atë që ka thënë (shkruar) në shqipe, prandaj ai përveç saj përdor një fjalë angleze për të zgjidhur problemin.

10. Fjalët ose shprehjet e shqipes vijojnë me fjalë ose shprehje të anglishtes dhe lidhen me lidhësen ose: Sh ose A. - Rastet kur fjalët e shprehjet e anglishtes paraprihen nga fjalë e shprehje shqipe, janë bukur të shpeshta në materialet e shkruara në shqipen e Amerikës. Të dyja këto komponente të lidhura me ose i ofrojnë lexuesit zgjedhje midis fjalës a shprehjes së shqipes dhe fjalës a shprehjes angleze. Ka mjaft shembuj të tillë, por ja vetëm disa prej tyre:

- (1) Njeriu vetë është një *kafshë ose animal* politik.
- (2) Rusia po flet për *kufizimin e armëve ose arms limitation*.
- (3) *Ekipazhi ose Crew* është i përbërë nga...

Mund të vërehet këtu se ndonjëherë, siç është rasti me shembujt më lart, një fjalë ose një shprehje ekuivalente e anglishtes i shtohet fjalës a shprehjes së shqipes, edhe pse ajo e shqipes është zgjidhje plotësisht e kënaqshme.

11. Fjalët ose sintagmat e shqipes vijojnë me ekuivalentët e anglishtes të shkruara në thonjëza: Sh + "A". - Siç ishte rasti me vijëzat ndarëse, ndonjëherë fjalët a sintagmat angleze shkruhen në thonjëza, zakonisht të paraprirë nga fjalët a sintagmat e shqipes. Ato ndonjëherë mund të vihen midis presjeve. Herë-herë fjala lidhëse ose shkruhet midis dy ekuivalentëve. Kujtojmë se këto huazime janë shumë të afërta me ato të vëna në kllapa ose midis vijëzave ndarëse, por me gjasë një çikë më pak të përshtatura.⁶⁹ Ka shumë shembuj të këtij tipi të shkrimit, si f.v.:

- (1) Të nesërmen u shtrënguem të *kërkojmë ndjesë, "apologize"*.
- (2) Shoku Gromyko mendon se nuk është bërë ndonjë *shndërrim "change"*.
- (3) Vendimi i tij që të marrë në dorë fuqinë një *kryesi kolektive ose "collective leadership"*, nuk është...

⁶⁹ M. I. Surduky, 1966, ff. 123-4.

Në korpusin tonë mund të hasen edhe lloje të tjera të këtyre kombinimeve të ekuivalentëve të ndryshëm, por ato janë me rëndësi më të vogël, meqenëse paraqitja e tyre është bukur e rrallë, ndërsa vështirë mund të nxirren rregulla.

Në fund, përkundër çdo gjëje që u tha më lart, mund të jetë që përdorimi i mënyrave dhe mjeteve të ndryshme nga ata që shkruajnë në gjuhën shqipe të Amerikës për t'i veçuar huazimet angleze si të huaja, bëhet shpesh në mënyrë të pavetëdijshme, pa ndonjë arsye të qartë dhe të menduar që përpara. Kjo është mënyra e vetme për të shpjeguar rastet e përdorimit të mjeteve të ndryshme për të shënuar të njëjtën fjalë, shpesh në të njëjtin kontekst dhe nga i njëjti person. Mund të vërehet se përdorimi i mjeteve të ndryshme në këtë gjuhë të shkruar, siç bëhet ndoshta edhe në çdo gjuhë tjetër të grupeve etnike të Amerikës, nuk ka vijuar sipas ndonjë sistemi të përcaktuar në mënyrë të qartë dhe konsistente. Konventë e caktuar nuk ekziston këtu. Qëllimi ynë i vetëm në këtë analizë të hollësishme është të tregohen mundësitë e ndryshme që kanë qenë në dispozicion, siç u vërejt më lart, për të shënuar sidomos huazimet angleze të papërshtatura në publikimet e ndryshme në gjuhën shqipe të Amerikës. Në këtë mënyrë edhe gjuha shqipe e shkruar e Amerikës bëhet objekt i këtij studimi, meqenëse është medium i rëndësishëm i komunikimit i këtij grupi etnik si dhe i çdo grupi tjetër në SHBA, dhe është shumë më empirike se gjuha e folur në atë trevë.

Mund të theksohet, në fund, se ky studim i jep rëndësi një çështjeje që zakonisht nuk përfillet nga shumë autorë. Pak njerëz janë të vetëdijshëm për ekzistimin e aq shumë mënyrave e mjeteve drejtshkrimore për të shënuar ekuivalentët e huazimeve ose vetë huazimet në një gjuhë që ka prestigj të vogël në një komunitet si ai i Amerikës, ku vetëm anglishtja është gjuhë e komunikimit publik, prandaj edhe gjuhë e prestigjit.

Përveç mjeteve drejtshkrimore të përdorura në huazime, ka edhe mjete të tjera që përdoren në fjalët e gjuhës marrëse duke imituar gjuhën dhënëse. Këtu do të flasim shkurtimisht vetëm për përdorimin e fjalëve me shkronjë të madhe dhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit në gjuhën e shkruar të shqiptarëve të Amerikës.

Rregullat drejtshkrimore të gjuhës dhënëse mund të vërehen në shkrimin e shumë emrave të përdorur me shkronjë e parë të madhe në shqipen e Amerikës, që nuk do të pranoheshin në shqipen standarde. Sidomos emrat e ditëve të javës shkruhen me shkronjë të madhe në atë gjuhë shqipe, si b.f.: e Diel, e Mërkurë, e Premte, e Shtunë etj.

Emrat e muajve, po ashtu, shkruhen me shkronjë të madhe si pasojë e ndikimit të drejtpërdrejtë të anglishtes. Kjo është karakteristike vetëm për

shqipen e Amerikës dhe nuk vlen fare për shqipen standarde. Këtu po japim disa shembuj:

- (4) Kuvendi u mbajt në *Shkurt* 15, 1918.
- (5) Në *Prill* të vitit 1939 Shqipëria u okupua nga Italia.
- (6) Në *Nëntorin* e atij viti bëri shumë të ftohtë.

Duhet të zihet ngoje se emrat e muajve shpesh shkruhen në anglishte, sidomos kur përdoren me datë të plotë, si f.v.:

- (7) Unë erdha në Amerikë në *July nineteen twelve*.

Të ndikuara nga rregullat drejtshkrimore të anglishtes, gazetat e shqiptarëve të Amerikës shpesh e bëjnë ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit sipas rregullave të anglishtes. Në anglishte një mënyrë e ndarjes së fjalëve në fund të rreshtit të shkruar është ndarja e shkronjave të dyfishta. Gazetat në gjuhën shqipe të Amerikës e respektojnë këtë rregull, ndonëse kjo nuk praktikohet në shqipen standarde, ose nuk do të duhej të bëhej.⁷⁰ Disa shembuj të dhënë këtu do të ilustrojnë këtë çështje (vijëza ndarëse paraqet ndarjen e fjalës në fund të rreshtit për ta përcjellë në rreshtin vijues.)

- (8) ...e thirri një mbledhje të dytë në *fil-lim* (do të duhej: *fi-llim*);
- (9) Sigurisht do të kenë parë një *bur-rë* (*bu-rrë*) etj.

Filologji, nr. 5, ff. 81-98, Fakulteti Filologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1998.

⁷⁰ Duhet theksuar se pas zbatimit të kompjuterëve për thyerjen e teksteve për shtyp, kjo shpesh ndodh edhe në gazetat e në shtypin tjetër në gjuhën standarde shqipe, meqë për kompjuterin vlejnë rregullat e anglishtes.

PËRFUNDIM

1. Këtu nuk do të flasim për çështjet, të cilat janë shqyrtuar në mënyrë të qartë në këtë studim, as do të bëjmë ndonjë përmbledhje të gjithë studimit. Do të zëmë ngojë disa çështje të cilat nuk janë thënë sa duhet në mënyrë të qartë në këtë vepër.

2. Ky studim është një përpjekje për të dhënë një pasqyrë të gjendjes së gjuhës së folur dhe të shkruar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në përgjithësi dhe në Boston dhe rrethinën e tij paksa në veçanti, ashtu siç është gjetur gjendja deri në vitet 1974-1977. Ndonëse kemi pasur qëllim shumë pozitiv dhe i kemi shfrytëzuar të gjitha mjetet që kemi pasur në dispozicion për të arritur rezultatet më të mira të mundshme, jemi të vetëdijshëm se ky studim ka të metat e veta. Hulumtuesi i një gjuhe të tillë, siç është gjuha shqipe e Amerikës, ballafaqohet me një numër vështirësish në studimet e tij në terren. Studimet e gjuhëve të grupeve etnike të Amerikës nuk janë aq të lehta siç janë studimet e tilla gjuhësore të bëra diku tjetër. Kjo mund të provohet nga shumë arsye. Së pari, hulumtuesi do ta ketë vështirë të përcaktojë objektin e tij në mënyrë precize. Folësit e një gjuhe të tillë kanë kompetencë shumë të llojllojshme gjuhësore, duke dalluar shumë në mes të njëri-tjetrit, madje edhe brenda një familjeje. Imigrantët amerikanë të brezit të parë (të lindur jashtë SHBA-së) normalisht flasin shqip relativisht mirë, me pak interferencë nga anglishtja. Shqiptarët amerikanë të brezit të dytë (dhe të fundit që flasin shqip) kanë kompetencë shumë heterogjene në gjuhën shqipe. Ajo kompetencë silllet nga zero deri në rreth 90 për qind, kurse nuk gjetëm thuaja asnjë nga brezi i tretë i shqiptarëve të Amerikës në rajonin që ne hulumtuam, i cili do të fliste, sadopak, shqip. Kur ballafaqohet njeriu me një gjendje të tillë të folësve me kompetencë heterogjene, ai mund të pyesë me seriozitet shumë të madh se çka duhet të marrë si shkallë relevante, sa të thellohet në këtë punë, ku ta vërë kufirin. Me gjasë njeriu nuk ka zgjidhje tjetër, përveç ta vërë një vijë kufizuese me disa variacione, duke u përpjekur të përfshijë sa më shumë material në studimin e tij. Mirëpo, ai mbetet i vetëdijshëm se atë që ka hasur një herë, mund të mos e gjejë më herën tjetër, sepse ligjërimi i shqiptarëve të Amerikës vuan nga zhdukja e shpejtë, dhe në vitet e fundit më shpejt se ndonjëherë më parë. Anglishtja, si gjuhë e prestigjit, ka depërtuar

në çdo pore të jetës atje, kështu që gjuhës së çdo grupi etnik dhe sidomos të shqiptarëve të Amerikës, po i shembet dhe nën këmbë.

3. Ndonëse gjuha shqipe e Amerikës e Bostonit trajtohet nëpër gjithë këtë studim duke u analizuar interferenca linguistike në rrafshet e ndryshme gjuhësore, në gjithë punimin flitet në mënyrë të posaçme për gjendjen e asaj gjuhe ashtu si është gjetur në atë kohë. Megjithatë, njeriu mund të thotë në mënyrë të hapët se as studimi si tërësi, as pjesët e tij në veçanti nuk mund të paraqesin gjendjen e plotë dhe ndonjë pasqyrë të hollësishme të studimit dialektologjik të asaj gjuhe. Karakteri i këtij studimi është pak më i gjerë, sesa përshkrim dialektologjik, sepse për përshkrim të mirëfilltë dialektologjik të shqipes së atjeshme as që mund të flitet. Qëllimi kryesor ka qenë të vihet në dukje kontakti gjuhësor midis dy gjuhëve, anglishtes si gjuhë mbizotëruese dhe e prestigjit, nga një anë, dhe shqipes së Amerikës si gjuhë e dorës së dytë pa ndonjë dobi praktike në jetën publike, nga ana tjetër. Motivi për një ndërmarrje të hulumtimit të tillë ishte në radhë të parë për të hedhur dritë dhe për të vlerësuar sa ka mundësi mbi gjendjen e këtij ligjërimi të shqipes në Shtetet e Bashkuara të Amerikës para se të bëhej shumë vonë për një studim të tillë. Disa nga faktorët që mund të bëhen pengesë e ndonjë studimi të duhur dialektologjik të kësaj të folmeje të shqipes në Boston dhe në rrethinën e tij, është dispersioni shumë i madh i shqiptarëve të Amerikës nëpër qytet dhe jashtë tij; trysnia e madhe e gjuhës dhënëse mbi këtë gjuhë marrëse; sfondi shumë heterogjen i folësve të shqipes nga fakti se vijnë nga treva të ndryshme të Shqipërisë së Jugut; nga numri i madh i fjalëve të shqipes që zhduken nga ligjërimi i tyre, i cili është kufizuar në rutinën e jetës së përditshme, të këmbimeve të rëndomta të përshëndetjeve etj. Megjithatë, kemi bërë çmos, brenda kohës dhe kushteve të tjera objektive që kemi pasur, që të paraqesim një pasqyrë sa më të qartë dhe të gjerë që ka pasur mundësi të gjendjes së asaj të folmeje siç e kemi hasur në terren.

4. Gjatë punës sonë hulumtuese në atë të folme kemi hetuar disa të dhëna, të cilat vlen të zihen ngoje. Shqipja e Amerikës, si një gjuhë e një grupi etnik të vogël, nuk mund t'i përballojë anglishtes aq gjatë sa munden disa grupe të tjera më të mëdha të imigrantëve, siç janë gjermanët, spanjollët, madje edhe grekët. Arsyeja duhet të kërkohet në faktorët sociolinguistikë dhe psikolinguistikë, dhe jo vetëm në faktorët gjuhësorë. Mirëpo, për fat të keq, në këtë studim nuk kemi mundur t'i marrim parasysh faktorët sociolinguistikë në shkallë të duhur, e aq më pak faktorët psikolinguistikë. Kjo rrjedh për arsye se i kemi pasur të kufizuara si kushtet kohore, ashtu dhe kushtet e tjera materiale për një studim më të thellë në këtë fushë. Mirëpo, që nga vetë fillimi i studimit nuk e kishim shtruar si

qëllim analizën e hollësishme të asaj natyre, duke i ditur mundësitë tona që përpara. Këto çështje shqyrtohen deri diku vetëm në kreun e parë. Mund të thotë njeriu, megjithatë, se kërcënim i asimilimit të shpejtë të gjuhës shqipe në Amerikë, në atë rajon dhe ndoshta në çdo rajon tjetër të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, është pasojë e faktit se, siç thamë, shqiptarët e Amerikës jetojnë shumë të shpërndarë brenda qytetit dhe qyteteve të ndryshme, se numri i tyre është shumë i vogël në krahasim me numrin e disa grupeve etnike të tjera, se ata nuk kishin pasur marrëdhënie të mira me Shqipërinë një kohë bukur të gjatë, prej nga janë shumica prej tyre, se atyre u mungojnë mjete dhe forma adekuate për ruajtjen e gjuhës dhe të traditave të tyre. Ata nuk kanë shkollim të rregullt në gjuhën shqipe, kanë shumë pak libra dhe gazeta, dhe kurrfarë forme tjetër të masmedias në gjuhën shqipe etj.

5. Ndonëse është treguar interesim i posaçëm për çdo rrafsh linguistik në studimin e kësaj të folmeje të shqiptarëve të Bostonit dhe të rrethit, vëmendja jonë ishte drejtuar në mënyrë më të posaçme në rrafshin e ndikimit sintaksor të anglishtes mbi shqipen. Mund të thuhet plotësisht se ky element e karakterizon këtë studim nga studimet e ngjashme në fushën e kontakteve gjuhësore. Interferenca sintaksore në studimet e ngjashme të gjuhëve të tjera zë vend relativisht të vogël. Natyrisht, interferenca linguistike në këtë rrafsh gjuhësor nuk mund të vrojtohet shumë lehtë, meqenëse këtu njeriu ka të bëjë, në radhë të parë, me raporte gjuhësore, ndërsa raportet si nocione të tilla janë abstrakte. Duke i vlerësuar raportet gjuhësore njeriu shpesh mund të ballafaqohet me dilema dhe hutitë të ndryshme. Nga përsëritjet e shpeshta të gjedheve të gabuara njeriu mund të arrijë deri në një shkallë të rrafshimit të dallimeve ose të konfuzionit midis asaj që është e drejtë dhe e gabuar, sa të humbë besimin në kompetencën e tij gjuhësore, madje edhe si folës i gjuhës burimore. Në raste të tilla të pasigurisë së plotë mbi saktësinë e raporteve gjuhësore, jemi detyruar të shfrytëzojmë indoratorë plotësues me kompetencë gjuhësore të pandikuar nga gjuha tjetër në kontakt, përkatësisht, studentë të studimeve albanologjike të Prishtinës, të cilët duhej t'i vërtetonin ose t'i hidhnin poshtë disa nga përfundimet tona.

5.1. Në raportet sintaksore të ligjërimit shqip të Amerikës janë vërejtur shmangie në përdorimin e diatezës pësore, të kundrinorëve, të rendit të fjalëve në fjali, të nyjave, të parafjalëve, të fjalive mohore (me një element mohues), të mënyrës dëshirore; në zhdukjen e disa fjalëve funksionale, në trysninë për të mos përdorur mënyrën habitore etj. Nuk ka dyshim se në këtë studim nuk janë përfshirë edhe dukuri të tjera sintaksore që kanë të bëjnë me interferencën nga anglishtja në gjuhën shqipe të

Amerikës. Nuk mund të mos zihen ngoje rastet kur raportet sintaksore janë të ngjashme në të dyja gjuhët në kontakt, por ato dallojnë në dendurinë e paraqitjes së tyre, gjë e cila nuk ka mundur të matet në hollësi në këtë studim me mjetet dhe kushtet e tjera që kemi pasur në dispozicion. Anglishtja në raste të tilla mund të ushtrojë interferencë në ligjërimin shqip të Amerikës duke e shtuar ose pakësuar dendurinë e paraqitjes së tyre, varësisht nga fakti se ato raporte janë më të dendura ose më të rralla në anglishte. Të ballafaquar jo rrallë me situata të tilla gjuhësore, jemi përpjekur t'i vëmë në dukje situatat e tilla të interferencës, kur ato kanë rënë në sy në mënyrë mjaft të dukshme, duke u mbështetur, kryesisht, në kompetencën tonë linguistike në shqipe, pa dhënë ndonjë tregues të saktë statistikor, meqë treguesit e tillë nuk kishim mundësi t'i matnim.

6. Ndonëse në asnjë kaptinë nuk janë trajtuar me kujes çështjet semantike në këtë studim, janë zënë ngoje dhe shqyrtuar, deri-diku, shumë çështje semantike që kanë të bëjnë me çështjen e interferencës gjuhësore, sidomos në kaptinën mbi interferencën leksikore. Janë zënë ngoje elementet gjuhësore të anglishtes që e kanë ngushtuar ose zgjeruar fushën e tyre semantike me rastin e të huazuarit në shqipen e Amerikës. Është folur edhe për elementet gjuhësore të shqipes që e kanë zgjeruar ose ngushtuar ose që e kanë ndryshuar plotësisht fushën e tyre semantike, si edhe për krijimin e fjalëve të reja me fushë të re semantike. Ngushtimi dhe zgjerimi i fushës semantike të fjalëve të mirëfillta të shqipes si rezultat i interferencës gjuhësore nga anglishtja janë trajtuar në nënkreun e kalkeve, ndërsa ndryshimet e fushës semantike të fjalëve të shqipes janë trajtuar në nënkreun e huazimeve semantike.

7. Në këtë punim, siç tregojnë edhe titujt e kaptinave, janë shqyrtuar çështjet e interferencës gjuhësore nga anglishtja në rrafshet linguistike, si në rrafshin fonematik, morfematik, po ashtu edhe në rrafshin leksikor.

8. Lexuesi i këtij studimi mund të fitojë mbresën se Haugeni dhe Weinreichu me punimet e tyre, në fushën e kontakteve gjuhësore, kanë shërbyer si udhëzues kryesorë, sidomos për të përcaktuar detyrat kryesore të punës hulumtuese në përgjithësi dhe, deri-diku, në fushën e interferencës leksikore. Ne jemi mbështetur në ata dy autorë, si edhe në të tjerë, kurdo që materiali ynë ofronte të dhëna të ngjashme me konstatimet e tyre. Çështje të tjera në këtë studim, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me interferencën fonematike, dhe sidomos me interferencën sintaksore, janë shqyrtuar në mënyrë plotësisht të pavarur dhe origjinale.

9. Më në fund, jemi të vetëdijshëm për ndonjë të metë që mund të jetë përvjedhur, pa dashje, ose për arsye të pamundësisë për ta bërë ndryshe në këtë studim. Do të kishte qenë shumë më i plotë dhe më i saktë

po të kishim kaluar më shumë kohë për hulumtime në terren dhe po të kishim pasur më shumë mjete teknike për matje të ndryshme gjuhësore. Për shkak të largësisë së madhe gjeografike nga treva ku është bërë hulumtimi, nuk kemi pasur mundësi t'i verifikonim përsëri disa të dhëna kur kishim nevojë për një gjë të tillë. Prandaj, kritika konstruktive gjithmonë do të jetë e mirëseardhur.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

1. Bloomfield, Leonard, *Language*, **Allen and Unwin**, London 1935.
2. Filipović, Rudolf, *The Phonemic Analysis of English Loan-words in Croatian*, **Studia Romanica et Anglica Zagrebiensia**, Zagreb 1960.
3. Filipović, Rudolf, *The Morphological Adaptation of English Loan-words in Serbo-Croatian*, **Studia Romanica et Anglica Zagrebiensia**, No. 11, , pp. 91-103, Zagreb 1961.
4. Filipović, Rudolf, *Semantic Changes in Adaptation of English Loan-words in Serbo-Croatian*, **Studia Romanica et Anglica Zagrebiensia**, Nos. 25-26, pp. 109-119, Zagreb 1968.
5. Filipović, Rudolf, *Primary and Secondary Adaptation of Loan-words*, **Wiener Slavistisches Jahrbuch**, XXIII, pp. 115-125, Wien 1977.
6. Filipović, Rudolf, *Prilog metodi proucavanja anglicizama u evropskim jezicima*, **Suvremena lingvistika**, 7-8, pp. 3-10, Zagreb 1978.
7. Goodman, Morris, *Languages in Contact*, **Current Trends in Linguistics**, Vol. 7. pp. 664-679, Mouton 1971.
8. Haugen, Einar, *The Analysis of Linguistic Borrowing*, **Language**, Vol. 26, No. 2, pp. 210-231, Baltimore 1950.
9. Haugen, Einar, *Language Conflict and Language Planning: The case of Modern Norwegian*, **Harvard University Press**, Cambridge, Mass. 1966.
10. Reed, Carroll, *The Adaptation of English to Pennsylvania German Morphology*, **American Speech**, No. 23, pp. 239-249, 1948.
11. Surducki, M. I., *English Loanwords in Serbo-Croatian Immigrant Press*, **The Canadian Journal of Linguistics**, Vol. 12:1, Toronto 1966.
12. Weinreich, Uriel, *Languages in Contact: Findings and Problems*, **Linguistic Circle of New York**, No. 1, New York, Mouton, The Hague, 1953 (ribotuar në vitin 1963).

LITERATURA E KONSULTUAR

1. Alexander, Pierre: *Multilingualism, Current Trends in Linguistics*, Vol. 7. Mouton 1971, pp. 654-663.
2. Annamalai, E.: *Lexical Insertion in a Mixed Language*, Papers from the Seventh Regional Meeting, **Chicago Linguistic Society**, Chicago 1971, pp. 20-27.
3. Bastinen, Hermes: *Le Bilinguisme au Canada*, Montreal, 1938.
4. Bazell, C. E.: *Meaning and the Morpheme*, **Word**, Vol. 18, New York 1962, pp. 132-142.
5. Benson, Morton: *American Influence on the Immigrant Russian Press*, **American Speech**, No. 32, 1957, pp. 257-263.
6. Bevington, Gary: *Albanian Phonology*, PhD, Graduate School of the University of Massachusetts, USA, 1970, p. 26.
7. Bloomfield, Leonard: *Language*, **Allen and Unwin**, London 1935.
8. Catford, J. C.: *A Linguistic Theory of Translation*, **Oxford University Press**, London 1965.
9. Çekrezi, Kristë: *Albania in the Past and Today*, **Vatra**, Boston 1919.
10. Christopher, Paul: *The Articles, a Study of Their Theory and Use in English*, Copenhagen - London 1939.
11. Christopher, Paul: *Bilingualism*, London 1944.
12. Demiraj, Shaban: *Rreth kategorisë së shquarësisë dhe pashquarësisë në gjuhën shqipe*, **Studime Filologjike**, nr. 4, Tiranë 1969, ff. 154.
13. Demiraj, Shaban: *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, **Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSAK-së**, Prishtinë 1971.
14. Demiraj, Shaban: *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, **Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë**, Tiranë, 1996, ff. 33-46.
15. Demo, Constatin: *The Albanians in America, The First Arrivals*, **Society "Fatbardha" of Katundi**, Boston 1960.
16. Desnickaja, Agnija V.: *Gjuha shqipe dhe dialektet e saj*, **Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSAK-së**, Prishtinë 1972.
17. Dimanet, Henry: *Anglicisms in the Speech of French Bilingual Immigrants in the United States*, Mexico City 1962.
18. Diebold, A. Richard, Jr.: *Incipient Bilingualism*, **Language**, No. 37, 1961, pp. 97-112.
19. **DIELLI** (gazetë), **Vatra**, Boston, (që nga 1909).
20. Di Pietro, Robert: *Borrowing: Its Effects as a Mechanism of Linguistic Change in American Sicilian*, **General Linguistics**, No. 5, 1961, pp. 30-36.
21. Di Pietro, Robert: *Bilingualism*, **Current Trends in Linguistics**, Vol. 4, Mouton 1968, pp. 399-414.
22. Dodi, Anastas: *Rreth sistemit vokalik të gjuhës shqipe*, **Studime Filologjike**, nr. 3, Tiranë 1967, ff. 144.
23. Dodi, Anastas: *Fonetika e gjuhës së sotme shqipe*, **Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSAK-së**, Prishtinë 1970.

24. Domi, Mahir: *Sintaksa e gjuhës shqipe*, **Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSAK-së**, Prishtinë 1971.
25. *Drejtkshkrimi i Gjuhës Shqipe*, **Instituti Albanologjik I Prishtinës**, Prishtinë 1974.
26. Dudek, J. B.: *The Americanization of Czech Given Names*, **American Speech**, No. 1, 1926, pp. 12-22.
27. Dyen, Isidore: *Lexicostatistically Determined Borrowing and Taboo*, **Language**, No. 39, 1963, pp. 60-66.
28. Eugene, Nida A.: *A System for Distinction of Semantic Elements*, **Word**, Vol. 7, No. 1, 1951, pp. 1-14.
29. Filipović, Rudolf: *The Phonemic Compromise*, **Studia Romanica et Anglica Zagrebiensia**, No. 5, Zagreb 1958, pp. 77-88.
30. Filipović, Rudolf: *Consonantal Innovations in the Phonological System as a Consequence of Linguistic Borrowing*, **Studia Romanica et Anglica Zagrebiensia**, No. 7, Zagreb 1959, pp. 39-62.
31. Filipović, Rudolf: *Phonemic Importation*, **Studia Romanica et Anglica Zagrebiensia**, Nos. 9-10, Zagreb 1960, pp. 177-189.
32. Filipović, Rudolf: *Compromise Replica and Phonetic Importation*, To Honor of Roman Jakobson, Essays on the Occasion of his Seventieth Birthday, **Mouton**, The Hague, Paris 1967, pp. 662-666.
33. Filipović, Rudolf: *The Phonemic Analysis of English Loan-words in Croatian*, **Studia Romanica et Anglica Zagrebiensia**, Zagreb 1960.
34. Filipović, Rudolf: *Principi lingvističkog posudjivanja I, Fonološki aspekt*, *Filoloski pregled*, I-II, Beograd 1965, pp. 117-131.
35. Filipović, Rudolf: *The Morphological Adaptation of English Loan-words in Serbo-Croatian*, **Studia Romanica et Anglica Zagrebiensia**, No. 11, Zagreb 1961, pp. 91-103.
36. Filipović, Rudolf: *Principi lingvističkog posudjivanja I, Morfoloski aspekt*, *Filoloski pregled*, I-IV, Beograd 1966, pp. 1-16.
37. Filipović, Rudolf: *Principi lingvističkog posudjivanja III, Semanticki aspekt*, *Filoloski pregled*, I-IV, Beograd 1967, pp. 83-94.
38. Filipović, Rudolf: *Semantic Changes in Adaptation of English Loan-words in Serbo-Croatian*, **Studia Romanica et Anglica Zagrebiensia**, Nos. 25-26, Zagreb 1968, pp. 109-119.
39. Filipović, Rudolf: *The English Element in the Main European Languages*, **Studia Romanica et Anglica Zagrebiensia**, Nos. 21-22, Zagreb 1966, pp. 103-112.
40. Filipović, Rudolf: *Prilog metodi proučavanja anglicizama u evropskim jezicima*, **Suvremena lingvistika**, 7-8, Zagreb 1978, pp. 3-10.
41. Filipović, Rudolf: *A Contribution to the Method of Studying Anglicisms in European Languages*, **Studia Romanica et Anglica Zagrebiensia**, No.37, Zagreb 1974, pp. 135-148.
42. Filipović, Rudolf: *Kontakti jezika u teoriji i praksi*, **Školska knjiga**, Zagreb 1971, XVI+142 p.
43. Filipović, Rudolf: *Some Problems in Studying the English Element in European Languages*, **Studia Romanica et Anglica Zagrebiensia**, Vol. 4, Nos. 1-2, Poznan 1972, pp. 141-158, and in **English Series Today**, 5, Istanbul 1973, pp. 25-52.
44. Filipović, Rudolf: *Nekoliko metodoloških pitanja proučavanja stranog elementa u srpsko-hrvatskom jeziku*, **Naucni sastanak slavista u Vukove dane**, Sveska 1, Beograd 1977, pp. 13-20.

45. Filipović, Rudolf: *Some Basic Principles of Languages in Contact Reinterpreted*, **Studia Romanica et Anglica Zagrebiensia**, 43-44, Zagreb 1977, pp. 157-166.
46. Filipović, Rudolf: *Primary and Secondary Adaptation of Loan-words*, **Wiener Slavistisches Jahrbuch**, XXIII, Wien 1977, pp. 115-125.
47. Filipović, Rudolf: *English Words in European Mouths and Minds*, **Folia Linguistica**, X, 3-4, The Hague 1977, pp. 195-206.
48. Filipović, Rudolf: *Tipovi transfonemizacije u jezicima u kontaktu*, **Filologija**, 8, Zagreb 1976, pp. 99-105.
49. Filipović, Rudolf: *Transphonemization: Substitution on the Phonological Level - Reinterpreted*, **Europäische Mehrsprachigkeit (Festschrift für Mario Wandruszka)**, Niemeyer Verlag, Tübingen.
50. Filipović, Rudolf: *Transfonemizacija – najčešći oblik supstitucije na morfološkom nivou*, **Filologija**, 9, Zagreb 1979.
51. Filipović, Rudolf: *Transphonemization: Substitution on the Morphological Level Reinterpreted*, **Studia Romanica et Anglica Zagrebiensia**, Nos. 49-50, Zagreb 1980.
52. Filipović, Rudolf: *Fonologizacija i aktiviranje latentnih fonema u jezičnom posudjivanju* (Reinterpretacija 'Importacije fonema') (Phonologization and Activation of Latent Phonemes in Language Borrowing (A Reinterpretation of 'Phoneme Importation)'), **Suvremena lingvistika**, 19-20, Zagreb 1979.
53. Fishman, Joshua A.: *Language Maintenance and Language Shift as a Field of Inquiry: A definition of the field suggestions for its further development*, **Linguistics**, 9, 1964, pp. 32-70.
54. Fishman, Joshua A.: *Language Loyalty in the United States: The maintenance and perpetuation of non-English mother tongues by American ethnic and religious groups*, **Mouton**, The Hague, 1966.
55. Fishman, Joshua A.: *Language Maintenance and Language Shift: Yiddish and other immigrant languages in the United States*, Research Conference, **YIVO Institute, Yeshiva University**, 1967.
56. Fishman, Joshua A.: *Sociologija jezika*, **Svjatlost**, Sarajevo 1978.
57. *Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, **Akademia e Shkencave e RPS-së të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë**, Tiranë 1976.
58. Flom, George T.: *English Loanwords in American Norwegian, as Spoken in the Koshkonong Settlement*, **American Speech**, No. 1, Wisconsin 1925/6, pp. 541-548.
59. *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme shqipe II*, **Akademia e Shkencave e RPS-së të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë**, Tiranë 1976.
60. Galinsky, Hans: *Stylistic Aspects of Borrowing: Proceedings to the Ninth International Congress of Linguistics*, London The Hague, Paris, 1964, pp. 374-381.
61. Gilbert, Glen G.: *English Loanwords in the German of Fredericksburg*, **American Studies**, No. 40, Texas 1966, pp. 102-112.
62. Gilbert, Glen G.: *The German Language in America*, **Simposium (1968), University of Texas Press**, Austin 1971.
63. Gjinari, Jorgji: *Mbi të folmen e Devollit*, **Universiteti Shtetëror i Tiranës, Seria Shkencore Shoqërore**, Nr. 4, Tiranë, 1960, ff. 103-137.
64. Gjinari, Jorgji: *Diftongjet [ua], [ue] dhe [ye] në të folmet e gjuhës së sotme letrare shqipe*, **Studime Filologjike**, Nr. 1, Tiranë 1968, pp. 97-104.
65. Gjinari, Jorgji: *Dialektologjia shqiptare, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSAK-së*, Prishtinë 1970.

66. Gjevori, Mehmet: *Frazeologjizma të gjuhës shqipe* (bot. II), **Rilindja**, Prishtinë 1972.
67. Goodman, Morris: *Languages in Contact*, **Current Trends in Linguistics**, Vol. 7. Mouton 1971, pp. 664-679.
68. Gordon, Milton M.: *Assimilation in America: Theory and Reality Daedalus*, 90, **American Academy of Arts and Sciences**, Boston, Mass., 1961, pp. 263-285.
69. Graham, Somerville R.: *Widespread Bilingualism and the Creative Writer*, **Word**, Vol. 12, No. 3, 1956, pp. 369-381.
70. Hewson, Robert H.: *Armenian Names in America*, **American Speech**, No. 13, 1963, pp. 145-165.
71. Haiman, John: *Targets and Paradigmatic Borrowing in Romantsch*, **Language**, Vol. 47, No. 4, 1971, pp. 797-809.
72. Haugen, Einar: *Language and Immigration*, **Norwegian-American Studies and Records**, No. 10, 1938, pp. 1-43.
73. Haugen, Einar: *Phonological Shifting in American-Norwegian*, **Language**, No. 14, 1938, pp. 112-120.
74. Haugen, Einar: *Problems of Bilingualism*, **Lingua, International Review of General Linguistics**, Vol. II, No. 4, Harlem, Holland, 1950, pp. 271-290.
75. Haugen, Einar: *The Analysis of Linguistic Borrowing*, **Language**, Vol. 26, No. 2, Baltimore 1950, pp. 210-231.
76. Haugen, Einar: *The Impact of English on American-Norwegian Letter-Writing*, Studies in Honor of Albert Morey Sturvtant, Lawrence (Canada), 1952, pp. 76-102.
77. Haugen, Einar: *The Norwegian Language in America; A study in bilingual behavior*, University of Pennsylvania Press, Philadelphia 1953.
78. Haugen, Einar: *Bilingualism in the Americas*, **University of Alabama Press**, University of Alabama 1956.
79. Haugen, Einar: *Language Conflict and Language Planning; The case of Modern Norwegian*, **Harvard University Press**, Cambridge, Mass., 1966.
80. Haugen, Einar: *Bilingualism, Language Contact and Immigrant Languages in the United States: A research report 1956-1970*, **Current Trends in Linguistics**, Vol. 10, Mouton, The Hague - Paris, 1973, pp. 505-591.
81. Hays, Francis G.: *Anglo-Spanish Speech in Tampa, Florida*, **Hespania**, No. 32, 1949, pp. 48-52.
82. Hoijer, Harry: *Linguistic and Cultural Change*, **Language**, No. 24, 1948, pp. 335-345.
83. Johnston, Ruth: *Language Usage in the Homes of Polish Immigrants in Western Australia*, **Lingua, International Review of general Linguistics**, North Holland Publishing Company, Vol. 18, No. 3, Amsterdam, 1967, pp. 271-289.
84. Jutronic, Dunja: *Americki-engleski i hrvatski (cakavski dijalekt) u kontaktu*, **Čakavska rič**, br. 1, 1973, pp. 71-79.
85. Jutronic, Dunja: *Upotreba i održavanje hrvatskog jezika (cakavskog i kajkavskog dijalekta) kod naših iseljenika i njihove dece rođene u Sjedinjenim americkim drzavama*, **Čakavska rič**, br. 1, 1974, pp. 17-39.
86. Jutronic, Dunja: *The Serbo-Croatian Language in Steelton*, **General Linguistics**, No. 1, 1974, pp. 15-34.
87. Jutronic, Dunja: *Review on Albin, Alexander and Alexander, Ronelle: The Speech of Yugoslav Immigrants in San Pedro*, **General Linguistics**, No. 2, 1975, pp. 107-114.
88. Kenyon, John S. and Thomas, A.: *A Pronouncing Dictionary of American English*, **G. and C. Merriam Company, Publishers**, Springfield, Mass., 1953.

89. Kimmerle, Marjorie: *Norwegian-American Surnames in Transition*, **American Speech**, No. 17, 1942, pp. 158-165.
90. Kolehmainen, John I.: *Finish Surnames in America*, **American Speech**, No.14, 1939, pp. 33-38.
91. *Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, I-II, Akademia e Shkencave e RPS-së të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë*, Tiranë 1973.
92. Krámský, Jiri: *The Article and the Concept of Definiteness in Language*, **Mouton**, The Hague - Paris 1972.
93. *LIRIA* (gazetë), **Free Albania**, Boston, Mass., (që nga 1941 deri më 1977).
94. Lontos, Sotirios: *American Greek*, **American Speech**, No. 1, 1926, pp. 307-310.
95. Lowie, Robert H.: *A Case of Bilingualism*, **Word**, No. 1, 1945, pp. 349-359.
96. Lyons, John: *Semantics, I-II*, **Cambridge University Press**, Cambridge, London, Melbourne 1977.
97. Lyrá, Franciszek: *The Polish Language in the United States: Some problems and findings*, **The Polish Review** 7/2, New York, 1962, pp. 81-95.
98. Lyrá, Franciszek: *Polish Surnames in the United States*, **American Speech**, No. 41, 1966, pp. 39-44.
99. Macris, James: *Changes in the Lexicon of New York City Greek*, **American Speech**, No. 32, 1957, pp. 102-109.
100. Mackey, William F.: *Bilingualism*, **Encyclopedia Britannica** (14th ed.), London 1960, p. 3,562.
101. Mackey, William F.: *The Description of Bilingualism*, **The Canadian Journal of Linguistics**, Vol. 7:2, Toronto, 1962, pp. 51-85.
102. Mackey, William F.: *Bilingualism as a World Problem*, E.R. Adair Memorial Lectures, **Harvest House**, Canada 1967.
103. Mackey, William F.: *Language and Ethnic Relations in Canada*, **Wiley**, New York, 1970.
104. Martinet, André: *Diffusion of Languages and Structural Linguistics*, **Romance Philology**, No. 6, 1952/3, pp. 5-13.
105. Newmark, Leonard: *Structural Grammar of Albanian*, **The Graduate School of Ohio State University and the Social Science Research Council**, Ohio, 1957.
106. Nuhiu, Vesel: *Fjalët angleze në gjuhën shqipe - Analizë fonologjike e tyre*, **Buletini i Fakultetit Filozofik të Prishtinës**, Nr. 11, Prishtinë, 1974, ff. 173-214.
107. Nuhiu, Vesel: *Ndikimi i huazimeve angleze në togjet e bashkëtingëlloreve të shqipes*, **Buletini i Fakultetit Filozofik të Prishtinës**, Nr. 13, Prishtinë 1976, pp. 411-432.
108. Nuhiu, Vesel: *The Use of Articles in English and Albanian*, **Buletini i Fakultetit Filozofik të Prishtinës**, Nr. 15, Prishtinë 1978, pp. 299-319.
109. Nuhiu, Vesel: *Upotreba člana u engleskom i albanskom jeziku*, **Godišnjak Saveza društava za primenjenu lingvistiku Jugoslavije**, br. 3, 1979, pp. 203-207.
110. Nuhiu, Vesel: *The English Element in Albanian, A Phonological Analysis* (in *The English Element in European Languages*, Vol. 2), **Institute of Linguistics**, Faculty of Philosophy, University of Zagreb, Zagreb 1982, pp. 1-27.
111. Nuhiu, Vesel: *Syntactic Interference of English on Am-Albanian* (in *Recherches albanologiques*, No. 2) **Instituti Albanologjik i Prishtinës**, Prishtinë 1982, pp. 95-119.
112. Oskar, Els: *Bilingualism*, **Current Trends in Linguistics**, Vol. 9, Part. 1, **Mouton** 1972, pp. 476-511.
113. Page, Eugene: *English in the Pennsylvania German Areas*, **American Speech**, No. 12, 1931, pp. 203-206.

114. Osmani, Zihni: *E folmja shqipe e Prespës*, Tezë magjstrature, **Fakulteti Filozofik i Prishtinës**, Prishtinë 1978.
115. Pap, Leo: *Portugese-American Speech*, New York 1949.
116. Prifti, Stefan: *Sintaksa e gjuhës shqipe*, **Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSAK-së**, Prishtinë 1971.
117. Quirk, Randolph and Greenbaum, Sidney: *A University Grammar of English*, **Longman**, London 1973.
118. Reed, Carroll: *The Gender of English Loan-words in Pennsylvania German*, **American Speech**, No. 17, 1940, pp. 25-29.
119. Reed, Carroll: *The Adaptation of English to Pennsylvania German Morphology*, **American Speech**, No. 23, 1948, pp. 239-249.
120. Reed, Carroll: *Loan-word Stratification in Pennsylvania German*, **German Quarterly**, No. 40, Appleton, Wisconsin 1967, pp. 83-86.
121. Riza, Selman: *Studime albanistike*, **Rilindja**, Prishtinë 1979.
122. Rosenquist, Carl M.: *Linguistic Changes in the Acculturation of the Swedes of Texas*, **Sociology and Social Research**, No. 16, 1931/32, pp. 221-231.
123. Rudnýckiy, J. B.: *Problems in Onomastic Bilingualism in Canada and U.S.A.; Proceedings of the English International Congress of Linguistics*, Oslo 1958, pp. 148-149.
124. Reed, Carroll: *Immigrant Languages, Language Contact and Bilingualism in Canada*, **Current Trends in Linguistics**, No. 10, 1972, pp. 592-653.
125. Sapir, Edward: *Language*, **Harcourt, Brace and World**, New York 1921.
126. Schach, Paul: *Hybrid Compounds in Pennsylvania German*, **American Speech**, No. 23, 1948, pp. 121-134.
127. Scotton, Carol M. and Okeju, John: *Neighbors and Lexical Borrowing*, **Language**, No. 4, 1973, pp. 871-889.
128. Seaman, Paul D.: *Modern Greek and American English in Contact*, a socio-linguistic investigation of Greek-American bilinguals in Chicago, **University of Chicago Press**, Chicago 1972.
129. Skendi, Stavro: *The Albanian National Awakening, 1898-1912*, **Princeton University Press**, Princeton, New Jersey 1967.
130. Stone, Howard: *Cushioned Loanwords*, **Word**, Vol. 9, No.1, 1953, pp. 12-15.
131. Surducki, M. I.: *English Loanwords in Serbo-Croatian Immigrant Press*, **The Canadian Journal of Linguistics**, Vol. 12:1, Toronto 1966.
132. Surducki, M. I.: *English Loanwords in Serbo-Croatian Immigrant Press*, **The Canadian Journal of Linguistics**, Vol. 12:2, Toronto 1967, pp. 123-135.
133. Swanson, Donald: *English Loanwords in Modern Greek*, **Word**, Vol. 14, New York 1958, pp. 26-46.
134. L. Tesnière, *Éléments de syntax structurale*, Paris, 1959.
135. Trager, George L. and Valdez, Genevieve: *English Loans in Colorado Spanish*, **American Speech**, No. 12, 1937, pp. 34-44.
136. Ullman, Stephen: *Semantics*, **Barnes and Noble**, Oxford, Blackwell and New York 1962.
137. Vaughan, Herbert H.: *Italian and Its Dialects as Spoken in the United States*, **American Speech**, No. 1, 1926, pp. 431-435; No. 2, 1926, p. 138.
138. Vogt, Hans: *Contact of Languages*, **Word**, Vol. 10, No. 2/3, New York 1954, pp. 365-374.

139. Weinreich, Uriel: *Language in Contact: Findings and Problems*, New York **Linguistic Circle of New York**, No. 1, Mouton, The Hague, 1953 (reprinted in 1863).
140. Weinreich, Uriel: *Linguistic Convergence in Immigrant America*, **Fifth Georgetown Roundtable**, 1954, pp. 40-49.
141. Weinreich, Uriel: *On the Description of Phonic Interference*, **Word**, Vol. 13, No. 1, New York 1957, pp. 1-11.
142. Wexler, Paul: *A Mirror Image Comparison of Languages in Contact: verbal prefixes in Slavicized Yiddish and Germanicized Sorbian*, **Linguistics**, No. 82, 1972, pp. 89-123.

TREGUESI I EMRAVE

- Alexander, 323, 326
 Aliko, 156
 Annamalai, 323
 Athanas, 169, 264
 Bastinen, 323
 Bazell, 323
 Benson, 323
 Bevington, 60, 323
 Blegen, 181
 Bloomfield, 17, 18, 19, 22, 126, 179,
 180, 248, 322, 323
 Catford, 323
 Çekrezi, 156, 158, 159, 162, 163, 166,
 323
 Christopher, 147, 323
 Dako, 152, 156
 Demiraj, 34, 255, 256, 257, 258, 261,
 263, 266, 269, 274, 286, 323
 Demo, 148, 323
 Desnickaja, 323
 Die Pietro, 181, 323
 Diebold, 180, 323
 Dimanet, 323
 Dode, 160
 Dodi, 31, 40, 60, 94, 111, 323
 Domi, 323
 Drizari, 156, 166
 Dudek, 324
 Dyen, 324
 Eugene, 324, 327
 Filipović, 9, 10, 16, 19, 22, 24, 25, 26,
 27, 28, 30, 37, 43, 65, 77, 91, 168,
 172, 195, 249, 251, 252, 322, 324
 Fishman, 185
 Flom, 325
 Floqi, 161, 162, 163, 164
 Galinsky, 325
 Gilbert, 325
 Gimson, 31
 Gjevori, 325
 Gjinari, 204, 303, 325
 Goodman, 322, 325
 Gordon, 325
 Graham, 325
 Greenbaum, 292, 295, 301, 327
 Gurrazezi, 162
 Haiman, 326
 Haugen, 10, 17, 19, 63, 124, 168,
 170, 172, 174, 175, 176, 179, 180,
 181, 184, 186, 187, 188, 190, 195,
 207, 214, 215, 219, 222, 226, 227,
 228, 233, 243, 244, 247, 249, 251,
 254, 260, 272, 273, 307, 319, 322,
 326
 Havránek, 19, 20
 Hays, 326
 Hewson, 326
 Hoijer, 326
 Ismajli, 9, 11, 245
 Jakobson, 27, 324
 Johnston, 326
 Jones, 31, 32
 Jutronic, 186, 326
 Jutronic, 186
 Kamburi, 156, 162
 Kenyon, 326
 Kiçi, 156
 Kimmerle, 326
 Kirka, 161
 Kolehmainen, 326
 Konica, 153, 156, 157, 161, 162, 163,
 164, 165, 166, 179, 243
 Krámský, 326
 Kristoforidhi, 147
 Liolin, 169
 Lontos, 327
 Lowie, 327
 Lowman, 40
 Luarasi, 152, 153, 155
 Lukas, 169

- Lyons, 327
 Lyra, 208, 327
 Mackey, 174, 180, 190, 247, 327
 Macris, 327
 Mann, 29
 Martinet, 18, 19, 27, 28, 327
 Mehmeti, 28, 77, 260
 Meillet, 17
 Meyer, 286
 Muljačić, 36
 Muller, 15
 Naci, 161, 162
 Newmark, 64, 245, 260, 327
 Noli, 152, 153, 155, 156, 159, 161,
 162, 163, 164, 165, 166, 179, 183,
 201, 264, 278, 304
 Nuhiu, 10, 11, 56, 63, 64, 77, 96, 201,
 203, 260, 297, 327
 Oskaar, 327
 Osmani, 327
 Page, 327
 Panariti, 156, 157, 162, 179
 Pap, 327
 Paul, 16, 17, 24, 178, 185, 240, 323,
 328
 Peci, 152, 155, 160, 183
 Permeti, 165
 Prifti, 159, 162, 166, 232, 327
 Quirk, 292, 295, 301, 327
 Rask, 15
 Reed, 322, 327
 Richard, 46, 180, 323
 Riza, 261, 297, 328
 Rosenquist, 328
 Rudnýckiy, 245, 328
 Sapir, 17, 18, 27, 247, 328
 Schleicher, 15
 Schönfelder, 16
 Schuchardt, 15, 22
 Seaman, 178, 185, 188, 193, 208,
 233, 247, 328
 Skendi, 147, 328
 urducki, 250, 308, 309, 322, 328
 Surducky, 250, 307, 308, 309, 313,
 322, 328
 Tashko, 159
 Tenier, 87
 Tesnière, 87, 328
 Thomas, 51, 326
 Vogt, 180, 233, 328
 Wandruszka, 325
 Weinreich, 17, 18, 19, 22, 25, 36,
 124, 132, 172, 175, 186, 191, 195,
 196, 200, 202, 203, 209, 214, 215,
 219, 226, 233, 248, 250, 255, 293,
 294, 304, 319, 322, 328
 Weinreichut, 10
 Whitney, 15
 Windisch, 15, 16
 Xhounz, 31
 Xoxe, 250
 Zogu, 166